

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË

KDU: 94 (05)

K O S O V A

**44
2019**

**PRISHTINË
2019**

REDAKSIA:

Prof.asoc.dr. Sabit SYLA (kryeredaktor), Prof.asoc.dr. Gjon BERISHA (sekretar i redaksisë), (anëtarë) Akademik Beqir META, Akademik Marenglen VERLI, Prof.dr. Pëllumb XHUFİ, Prof.dr. Frashër DEMAJ, Prof.dr. Hamit KABA, Prof.asoc.dr. Bedri MUHADRI, Prof.asoc.dr. Teuta SHALA-PELI

Redaktore gjuhësore:

Shqipe Doda

Korrektura:

Teuta ZEQRİ – ALIU

@2019 Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

Adresa e redaksisë:

Prishtinë, Lagja Spitalit, p.n

e-mail: institutihis@hotmail.com

tel.: +383 38 512 392

THE INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA

K O S O V A

44
2019

**PRISHTINA
2019**

PËRMBAJTJA-CONTENTS

Teuta SHALA-PELI

Prika dhe dhuratat në familjet arbërore me rastin e martesës (Gjysma e dytë e shek. XIV- shek. XV).....	9
Dowry and presents in albanian families on the occasion of marriage (Second half of the XIV – XV century).....	20

Gjon BERISHA

Baza ekonomike e Sanxhakut të Prizrenit në gjysmën e dytë të shek.XVI.....	21
Economic basis of the Prizren Sancak in half of the 16 th century.....	49

Paulin MARKU

Zgjedhjet parlamentare në Perandorinë Osmane dhe reformat e qeverisë Xhonturke në viset shqiptare (1908-1912).....	51
Parliamentary elections in the Ottoman Empire and reforms of the Young turks government in the albanian areas (1908-1912).....	80

Marenglen VERLI

Shqiptarët përballë ndërkombëtarëve në Paris, në mbyllje të konferencës së paqes (14 janar - 3 mars 1920).....	81
The great powers diplomacy and the challenge of albanians in january 1920.....	104

Sali KADRIA

Çështja e caktimit të kufijve shqiptaro-jugosllavë në vitet 1921- 1922.....	105
The question of the demarcation of the Albanian-Yugoslav borders in 1921-1922.....	122

Albana MEMA

Institucioni i këshillit të naltë (regjenca) në Shqipëri në vitet 1920-1924.....	123
---	-----

The Insitution of the higer council in Albania during 1920-1924.....	141
---	-----

Hasan BELLO

Aspekte të parlamentarizmit Shqiptar në vitet 1925-1939.....	143
Albanian parliamentary aspects in the years 1925-1939.....	164

Hamit KABA

Konflikti shqiptaro-sovjetik: vështrime të politikës greke.....	165
Albanian-soviet conflict: overview of greek policy.....	188

Kujtim MILLAKU

Roli i arsimit dhe ndikimi i tij në zhvillimin industrial të Kosovës gjatë viteve 1974-1990.....	189
Role of education and its impact on the industrial development of Kosovo during the period 1974-1990.....	200

Sedat KRYEZIU

Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë i vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e nacionalizmit serb.....	201
The memorandum of Serbian Academy of Sciences and Arts, drafted in 1986 and its impact on the resurrection of Serb nationalism.....	218

Mrika LIMANI- MYRTAJ

Elementët gjeopolitike dhe gjenocidi në luftërat e fundit të ish- Jugosllavisë.....	219
Geopolitical elements and genocide in the yugoslav wars.....	236

Miftar KURTI

Zona operative e Shalës në shtypin e Kosovës dhe Shqipërisë (1998-1999).....	237
Operational zone of Shala in the press Kosova and Albania (1998-1999).....	250

KUMTESA

Emine KALAJA-HAJDARI & Premtim ALAJ

Trashëgimia arkeologjike e Mitrovicës.....	253
--	-----

Luan TETAJ

Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze në luftën kundër pushtimit osman në shek. XVII.....259

Ilirjana KACELI & Alban DOBRUNA

Idetë arsimore dhe shkolla shqipe gjatë viteve 1908-1910.....267

Fitim RIFATI

Organizatat pararendëse të Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës” (1913-1916).....277

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Jeton DOKO

Gjendja e shqiptarëve katolikë në vitet gjatëdhjeta të shek.XX në Republikën e Maqedonisë sipas dy dokumenteve të arkivit shtetëror të Maqedonisë së Veriut.....289

RECENSIONE

Skënderbeu: ideja dhe ndërtimi i shtetit, Pëllumb Xhufi, Tiranë: Dituria, 2019, 239 f., (Gjon BERISHA).....299

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes,

Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes”, mbajtur në Prishtinë, më 16 tetor 2018), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2019, 317 f., (Gjon BERISHA).....305

Gjenocidi serb në rajonin e Pejës (mars-qershor 1999), Teuta Shala-

Peli, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2019, 348 f., (Miftar KURTI).....313

Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor dhe

arsimor, Sevdail Demiri, Shkup, 2015, 245 f., (Kosovar BASHA).....317

AKTIVITETE

Aktivitetet e Institutit të Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë gjatë vitit 2018 (Sabit SYLA & Gjon BERISHA).....	323
--	-----

Teuta SHALA-PELI

**PRIKA DHE DHURATAT NË FAMILJET ARBËRORE ME
RASTIN E MARTESËS
(GJYSMA E DYTË E SHEK. XIV- SHEK. XV)**

Një element i rëndësishëm të cilit familjet arbërore gjatë mesjetës i kushtuan vëmendje e kujdes të veçantë me rastin e martesës ishin edhe prika, dhuratat si dhe privilegjet e ndryshme, të cilat bëheshin jo vetëm nga familjarët por edhe nga një rreth më i gjerë. Në mesjetë në trevat arbërore me rastin e martesës së vajzave praktikohej dhënia e prikës, e cila zakonisht jepej në formë të pasurisë së patundshme apo në të holla (*perperë, heksagie*). Dhënia e prikës praktikohej si nga familjet fisnike ashtu edhe nga shtresat e tjera të shoqërisë. Natyrisht se tek familjet fisnike arbërore vlera e prikës ishte më e madhe, ku zakonisht jepeshin teritore të caktuara.

Qëllimi ynë në këtë punim është jo vetëm të prezantojmë apo të përmendim llojin dhe vlerën e prikës apo të dhuratave, por synim kryesor kemi, që duke marrë në shqyrtim disa shembuj aq sa na lejojnë dhe na ofrojnë të dhënat dokumentare, të vëmë në dukje rolin dhe rëndësinë e tyre në martesë, ngase prika që i jepej vajzës ishte e drejt ekskluzive në radhë të parë e saj e pastaj edhe e bashkëshortit të saj që të përdorej sipas nevojave dhe kërkesave të tyre, dhe si e tillë mund të ndikonte pozitivisht në gjendjen ekonomike të familjës.

Prika zakonisht jepej nga prindërit, në mungesë të tyre nga vëllezërit si dhe ka raste kur prika jepej nga përsone të autorizuar, vlere e saj varej në radhë të parë nga gjendja ekonomike dhe rangu shoqëror i familjeve. Sa më e pasur ishte familja edhe prika që i jepej vajzës ishte më e madhe. Dokumente të shumta që i referohen kësaj çështjeje dëshmojnë se përveç pasurive të patundshme dhe të hollave, për prikë jepeshin edhe orendi dhe gjëra të tjera me vlerë.

Në këtë aspekt, në vitin 1368 Luka nga Tivari, zgjedh që vajzës së tij, e cila po martohet me një raguzan ti jap për prikë një të tretën e pasurisë së tij të patundshme.¹ Më 4 shkurt të vitit 1400 Mark Thani nga Ulqini, dëshmon se ka marrë në dorzim si prikë të gruas së tij tetëqind perperë, dhe njëqind heksagie², ndërsa Marince Bratoslaviq nga Ulqini, më 7 gusht të vitit 1400 dëshmon se si prikë të gruas së tij Julianës, bijës së Kobellë de Barrullo, banuese e Raguzës, ka marrë pesëdhjetë perperë të mëdha, dhe një krevat me orendi të tjera të çmuara si dhe njëzet perperë.³ Edhe Tomko Ratmanoviq, i quajtur Vella, më 23 shkurt të 1401 dëshmon se si prikë të gruas së tij Katrinës, bijës së Marincës nga Tivari, ka marrë pesëqind perperë.⁴ Një formë e tillë e dhënies së prikës vazhdoi edhe në vitet në vijim në fillim të shekullit XV. Siç dëshmojnë dokumentet e kësaj periudhe, me 10 nëntor 1401, Nikolla bënë dëshmi se si prikë për gruan e tij Perves, bijën e Milutinit nga Ulqini, mori nga babai

¹ L.Tholloczy-C.Jericek- E.Sufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. II, Vindobonae 1913-1918, ribotim në Prishtinë nga Ekskluzive 2002, 251 (më tej: Acta Alb.): “*Ego quidem Luchas filius Nichi de Golebo de Antibaro confiteor, quod Nicus pater meus dabit et assignabit hinc ad menses sex Bochde de Boehdanelo tertiam partem omnium bonorum eius stabilium pro dote et perclivio filie dicti Nichi*”.

² Hrvatska-Državni arhiv u Dubrovniku, (më tej: HR-DADU), Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 39. Dokumentet e cituara nga Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut, janë huazuar nga studiuesi Gjon Berisha, të cilin e falënderoj për huazimin e tyre; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëllimi I, përgatitur nga Injac Zamputi, Luan Malltezi, Tiranë 1987, 4 (më tej: *Dokumente për historinë I*): “*Dieiij Februarij [1400]-Ego Marchus de thanj de dulcinio, Confiteor quod super me, et super omnia bona mea, pro dote seu perchiuio, Jellusse filie condam Marinj Johannis de Anthibaro uxoris mee, habui et recepi, ab ipsa Jellussa vxore mea, yperperos Octuagentos grossorum de Ragusio, et Exagia aurj Centum secundum consuetudinem Ragusij*”.

³ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 40v; *Dokumente për historinë I*, 55: “*die vij. mensis Augusti 1400 Indictione viij - Ego Marince bratoslauich, de Dulcinio habitator Ragusij, sartor, Confiteor quod super me et super omnia bona mea, pro dote sceu perchiuio Julliane fillie Chobelle de Barrullo habitatricis Ragusij. vxoris mee, habui et recepi, a, magistro Andrea de pelligijs de Barulo carugici Sallariati Ragusij presente et michi dante in dotem pro dicta Julliana, yperperos quinqueginta grossorum et vnum lectum cum alijs massaricijs extimatis. yperperos viginti. secundum consuetudinem, Ragusij...*”.

⁴ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 44v; *Dokumente për historinë I*, 94: “*die xxtercio mensis februarij [1401] Ego Thomcho Ratmanouich dictus Vella Confiteor quod super me et omnia bona mea habuisse et recepisse pro dote et perchiuio Catharine filie Marinze de Antibaro vxoris mee inuiatos (?) per ser volzium de baballio de denaris ipsius vxoris mee Catharine Jperperos Quingentos grossorum Ragusij secundum consuetudinem Ragusij...*”.

i saj Milutini dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër perperë dhe njëqind heksagie (*exagia*) floriri.⁵ Ndërsa më 9 maj të vitit 1407, Marin Dabivizi nga Shkodra dëshmon se si prikë të gruas së tij Slavisa ka marrë gjashtëqind perperë.⁶

Mirëpo, ka raste kur prika jepej nga vëllezërit apo përsone tjerë të autorizuar. Raste të tilla përmenden më 20 dhe 27 nëntor të vitit 1400. Në rastin e parë Gjon Progni Laiblemi nga Durrësi me profesion rrobaqepës, banues në Raguzë, dëshmon që për prikë të gruas së tij Stankës, bijës së të ndjerës Miltine, ka marrë në dorëzim nga Dobrulla Milcenoviqi, vëllai i gruas së tij Stankës dyqind perperë.⁷ Ndërsa në rastin e dytë Shtjefen Marini nga Ulqini dëshmon se për prikë, të gruas së tij Domenikës, bijës së të ndjerit Nikollë Spanit nga Drishti, ka marrë nga dom Pjetër Spani, vëllai i gruas së tij dyqind perperë.⁸ Për shkak të këtij veprimi, Pjetër Spanit e ëma e tij Vlasna me rastin e hartimit të testamentit të saj i lë pasurinë e tundshme dhe të patundshme, më arsyetimin se dom Pjetër Spani, pas vdekjes së Nikollë Spanit, babait të tij, me pasuritë e tij në të holla dhe pasuritë e tundshme, që i ka fituar vet, martoi dy motrat e tij, duke u dhënë atyre prikën e përshtatshme siç ra në marrëveshje, me burrat e tyre.⁹ Dhënia e prikës nga vëllau përmendet edhe në një dokument që

⁵ *Dokumente për historinë I*, 154: “die .x. Nouembris 1401-... nichola filius Jacobi de Sorgo confitetur super se, et omnia sua bona. pro perchiuo vxori sue. perue filie Millutinj de dulecinio cum consuetudine (sic) Ragusij. habuit et Recepit ab ipso Millutino patre predictae perue vxoris sue yperperos duo millia. quingentos quinquaginta quatuor. et exagia aurj...”.

⁶ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëllimi II (1406-1410), pjesa e parë, përgatitur nga Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, Tiranë 2019, 129 (më tej: *Dokumente për historinë II*).

⁷ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 41v; *Dokumente për historinë I*, 80: “Ego Johannes progni lalblemj (?) districtus Durachij sartor ad presens habitator Ragusij. Confi-teor quod super me, et super omnia bona mea, pro dote sceu perchiuo. Stanche filie quondam Miltinij uxoris mee, habui et recepi, a Dobrullo milcenouich fratre dicte Stanche presente et michi Dante in dotem pro dicta eius sorore vxore mea. yperperos Ducentos. secundum consuetudinern, Ragusij...”.

⁸ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 41v; *Dokumente për historinë I*, 81: “Die xxvij. Nouembris [1400] Ego Stephanus Marini de Dulcinio Confiteor quod super me et super omnia bona mea, pro dote sceu perchiuo Dominiche filie condan Nichole yspan de driuasto vxoris mee, habui et recepi, a dompno petro span fratre dicte Dominiche presente et michi dante in, dotem pro dicta eius sorore vxore mea, yperperos ducentos grossorum de Ragusio secundum consuetudinem Ragusij...”.

⁹ HR-DADU, *Diversa Notariae*, vol. XI (1402-1408), fol.24v; Acta. Alb., II/701: “...considerans, quod filius meus dompnus Petrus Ispanus post mortem Nichole Ispani predieti patris sui et mariti mei cum denariis suis et bonis mobilibus sua propria

mban datën 28 korrik të vitit 1403, kur Dhimitër Zvetkoviç, më profesion këpuctar, dëshmon se si prikë të gruas së tij Domushës, bijës së të ndjerit Pribosh nga Tivari, ka marrë nga prifti Dominik, vëllai i saj (Domushës), njëqind e dhjetë perperë.¹⁰

Në raste të veçanta përveç vëllezërve prika jepej edhe nga përsone të cilët ishin të autorizuar. Më 19 dhjetor 1402 pëmendet një rast kur një vajzë e quajtur Marusha bënë prokurator¹¹ dajën e saj, Menze Cudrouich nga Tivari për ta martuar më kë të do ai, por më kusht, që premtimet dhe detyrimet që do të bëhen për prikën që do të jepet, të mos e kalojnë shumën e dyqind dukateve flori dhe rrobat apo veshjet e stolisjet do ti blejë sipas zakonit të atij qyteti ku do të shkojë nuse Marusha¹², thuhet në prokurën në fjalë. Ndërsa në një dokument të 17 janarit të vitit 1405, Frank Zivki Dabojeviç dëshmon se ka marrë si prikë të gruas së tij Stanës, nga Simon Nikoliç nga Tivari ungji i saj, njëqind e pesëdhjetë perperë.¹³ Më 19 janar të vitit 1404, Domkoja, djali i një tivarasi dëshmon

industria aquisitis maritavit duas suas sorores. filias meas et dicti Nicholai dando eis dotes competentes prout fuit in concordia cum maritis earum, omni modo iure via et forma quibus melius possim mea ex certa sciencia et propria voluntate, non per errorem set libere et apensate do, trado atque dono titulo donationis inter vivos, que nulla ingratitudine uel offensa possit perpetualiter revocari, dompno Petro Hispano filio meo presenti et recipienti oinnia mea bona tam mobilia quam immobilia ubicumque consistant ac omnia iura mea...”.

¹⁰ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 60; *Dokumente për historinë I, 366: " Die xxvij. Jullij [1403] Ego Dymiter zuetchouich /cerdo/ Confiteor quod super me et super, omnia bona mea, pro dote seu puerchiuio Domusse, filie condam pribossi de anthibaro, vxoris mee, habui et recepi, a presbitero Dominicho, fratre dicte Domusse presente et michi dante in dotem pro dicta eius sorore secundum consuetudinem Ragusij. yperperos Centum et decem..."*.

¹¹ Prokurator: në praktikën e akteve civile (testamentare, përfaqëse etj.) prokuratori ishte kujdestar i ngarkuar për të mbrojtur interesat e atyre që përfaqësonte.

¹² HR-DADU, *Diversa Notariae*, vol. XI (1402-1408), fol. 29v; *Dokumente për historinë I, 285: " Millesimo iij^o secundo. Indictione deicima die xviii mensis decembris. Marussa. filia condam Chamissij Sassinouich. cum consensu et uoluntate Jelusse eius matris. fecit constituit et ordinavit ser vnze (sic) in predictia alia procura nominatum vt, in predicta catarina eius soror constituit. ad maritandum dictam Marussam. et in omniabus ut in ipsi continetur (?). Ita tamen, quod promissiones et obligationes fiende. pro dote danda non excedant sumam ducatorum ducentorum aurj, Et vestes seu vestimenta et ornamenta secundum vxum illius Ciuitatis vbi dicta Marussa constituens nupta fecerit "*.

¹³ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 68v; *Dokumente për historinë I, 487: " Die xvij. Januarij [1405] Ego Franchus. Ziuchi daboyeuich. Confiteor quod super me et super omnia bona mea. pro dote Seu perchiuio Stane filie Millossij. vxoris mee.*

se për prikë të gruas së tij Marushës, bijës së të ndjerit Stagno Nesnoviq, ka marrë nga Miltin Pribojeviqi dhe Tomko Grampa, kujdestarë të trashëgimtarëve të Stagnos, dyqind perperë. Dhe, për dyqind perperët që mbeten thot që i kanë dhënë gjysmën e shtëpisë së të ndjerit Stagno që është e përbashkët me trashëgimtarët e vëllaut të Stagnos.¹⁴ Edhe Miroslav Krenetiq më 9 tetor të vitit 1411, dëshmon se ka marrë prej dom Mateut nga Ulqini kapelan i zotit Marin Bona për prikën e gruas së tij Gojkes vajzës së Jursit pesëdhjetë perperë.¹⁵

Pas vdekjes së gruas burri ishte i detyruar që prikën tua kthej familjarve të gruas apo tua ndaj fëmijëve në rast se kishte fëmijë me të. Për kthimin e prikës një rast te veçante perfaqson ai i Marushes nga Ulqini. Pas vdekjes se saj dhe te te shoqit, mbi trashëgimime e prikes se saj ngritën pretendime si vellai i saj, dom Mateu, ashtu edhe vellezerit e te shoqit Milloje e Vitiko. Ne mirëkuptim te te dy paleve, zgjidhja ju la në dorë personave të besuar të tyre si: Mate Bicjes, Anthonja Butkut dhe Stipkum de Vocinja. Palët në fjalë gjithashtu kishin premtuar se do t'i përmbaheshin gjykimit dhe do t'u bindeshin çdo shpallje që jepet mes tyre, dhe të mos kundërshtojnë në asnjë mënyrë, për ndonjë arsye apo shkak, përndryshe dënohen me 50 perperë që do t'i paguhen bashkisë së Raguzës nga ana e atij që do të kundërshtonte”.¹⁶

Pavarësisht gjithë këtyre që u thanë, megjithatë kishte raste kur gruaja e humbte të drejten mbi prikën e saj, një gjë e tillë bëhej me rastin e shkeljesë së kurorës (*adultere*). Më 28 mars të vitit 1414 përmendet një rast kur Nikoleta, gruaja e Marsilit nga Ulqini paditet se ka kryer një adulteri (*adultere*). Për këtë ajo dënohet me katër muaj burg, gjithashtu

habujet Recepi a Symion nicholich de Antibaro barbano suo. michi dante in dotem pro dicta eius nepote. Perperos Centum quinquaginta. Secundum consuetudinem Ragusij... ”.

¹⁴ HR-DADU, Liber Dotium vol. III (1380-1412), fol. 64; *Dokumente për historinë I, 413: ” die xviii Januarij [1404] Ego Domcho filius condam Tripe de Antibaro, Confiteor, quod super me et super omnia bona mea, pro dote seu perchiuio Marusse filie quondam Stagni nesnouich dicti pretez. vxoris mee. Habuj et Recepi a Miltino priboieuich et Tomcho de grampa. Tutoribus heredum dicti condam Stagni michi dantibus et consignatibus. videlicet in contantis yperperos ducentos. Et Reliquos yperperos ducentos. michi consignarunt dicto tutorio nomine super quadam medietate domus dicti condam Stagnj pro Jndiuixa cum heredibus condam Milloslauj fratris dicti condam Stagnj... ”.*

¹⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëllimi III (1411-1415), përgatitur nga Injac Zamputi, Përparime Huta, Tiranë 2018, 63 (më tej: *Dokumente për historinë III*): “ a domno Mateo de dulcigno capelan ser Marinj de bona... pro dote goyche filie Lursi uxoris nise yperperos quinquaginta secunda... ”.

¹⁶ *Dokumente për historinë II*, 194.

humbë edhe prikën e vet, për të cilën vendoset që t'i mbetet burrit të saj. Me dy muaj burg dënohet edhe burri me të cilin Nikoleta kishte kryer kurorëthyerjen.¹⁷

Dokumentet në fjalë janë vetëm disa nga shembujt e dhënjës së prikës në formë të hollash, vlera e të cilës siç e pamë ishte 50 deri në 2554 perperë, me disa përjashtime të vogla ku për prikë jepeshin edhe ndonjë pjesë e caktuar e shtëpisë, stoli si dhe gjëra tjera më vlerë. Siç e përmendem edhe më lartë vlera e prikës varej nga statusi shoqëror dhe ekonomik i familjës, sa më e ngritur dhe e pasur ishte familja e vajzës aq më e madhe ishte prika që familja gjegjësisht prindërit i jepnin vajzës së tyre, gjithashtu dhënia e prikës varej edhe nga rangu shoqëror i familjës në të cilën martohej vajza.

Në radhët e bujarisë shqiptare martesë ishte, në radhë të parë, një akt politik. Ajo synonte të forconte pozitën politike dhe ekonomike të famljeve feudale dhe siguronte kalimin e zotërimeve të tyre tek trashëgimtarët ligjorë. Martesa lidhej në formën e kontratës, duke parashikuar midis të tjerash edhe prikën që duhej të sillte nusja me vete.¹⁸ Në këtë kontekst përmendet prika që Gjergj Arianiti ia dha vajzës së tij Donikës me rastin e martesës me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun në vitin 1451.¹⁹ Sipas Barletit kontratën e martesës së Skënderbeut e kishte lidhur Muzakë Topia,²⁰ dhe se paja u la në gjykimin e vjerrit dhe u pranua siç e vendosi ai, e denjë edhe për atë që e jepte, edhe për atë që e merrte.²¹ Edhe pse nuk flitet konkretisht se çka i dha Gjergj Arianiti për prikë Donikës, megjithatë mendohet se prika përbehej prej parash si dhe prej tokash. Po ashtu thuhet se vlera e madhe e prikës, kishte shërbyer si shkak që djemtë e Gjergj Arianitit nuk kishin marrë pjesë në ceremoninë e martesës së motrës së tyre Donikës me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun.²²

Çështja e prikës zinte vend më rëndësi edhe në Statutet e Shkodrës, të cilat ishin në zbatim që nga gjysma e parë e shek.XIV. Në këto statute dhënia dhe shfrytëzimi i prikës ishte e rregulluar kështu: për prikë nuk mund të jepeshin pronat të cilat ishin të lëshuara me qira qofshin ato

¹⁷ *Dokumente për historinë III*, 303.

¹⁸ Aleks Luarasi, "E drejta në shtetin e Skënderbeut", *Studime për Epokën e Skënderbeut* 3, Tiranë 1989, 41.

¹⁹ Fan Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, Rilindja Prishtinë 1968, 110 (më tej: Noli, *Gjergj Kastrioti*).

²⁰ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Rilindja Prishtinë 1989, 291 (më tej: Barleti, *Historia*); Noli, *Gjergj Kastrioti*, 110, shën. 31.

²¹ Barleti, *Historia*, 291.

²² Noli, *Gjergj Kastrioti*, 110.

vreshta, ara apo shtëpi,²³ poashtu vreshtat apo arat të cilat jepeshin për prikë në rast se ishin të punuara duhej të përcaktohej përkatësia e frutave në të kundërtën ato i kalonin përfituesit,²⁴ gjithashtu më këto statute ishte e ndaluar që të jepej për prikë prona e huaj, dhe për të gjith ata që do të praktikonin një gjë të tillë parashiheshin dënime.²⁵ Meqensë me rastin e martesës vajzave ju jepej për prikë një pjesë nga pasuria e prindërve, sipas këtyre statuteve ajo qka mbetej pas sigurimit të prikës së vajzave ju takonte vetëm djemëve, përjashtime bëheshin vetëm në rast se nuk kishte trashëgimtarë mashkuj.²⁶ Sipas këtyre statuteve përveç prindërve, të drejt për të dhënë prikën kishin edhe vëllëzërit, kjo praktikohet në rast kur vajzat ishin pa prindër.²⁷ Meqenëse prika ishte pronë ekskluzive e gruas, atëhere përdorimi i prikës mund të behej vetëm më pëlqimin e saj. Kësisoj nëse bashkëshorti merrete diçka nga paja e gruas edhe pse me pëlqimin e saj, megjithatë ishte i detyruar që më vonë ta kthejë dhe ta

²³ Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469, përgatiti për botim Luçia Nadin, Tiranë: Onufri 2010, kreu: 43: “Nëse dikush vendos të japë në prikë ose të shesë vreshta e ara të lëshuara më parë me qera apo shtëpi të dhëna me qera, këtë mund ta bëjë vetëm pas një viti, kur përfundon kontrata me përdoruesin”. (më tej: Statutet e Shkodrës).

²⁴ Statutet e Shkodrës, kreu:44: “Nëse dikush ka dhënë në prikë vreshta të punuara ose ara të mbjella duke mos u shprehur për përkatësinë e fryteve, urdhërojmë që edhe në mungesë të provës së shkruar, këto të fundit të mund t'i gëzojë gjithashtu përfituesi”.

²⁵ Statutet e Shkodrës, kreu: 163: “Askush nuk ka të drejtë të japë në prikë gjënë e huaj, sikurse nuk ka të drejtë ta shesë, ta dhurojë apo ta shkëmbejë atë. Nëse provohet se gjëja e dhënë është e huaj, dhënësi detyrohet të paguajë një gjobë prej hyperperësh Sklavonie si dhe vlerën e sendeve të dhëna, siç e caktojnë tre fisnikë të ngarkuar me këtë punë nga gjykatësit. Këtë shurnë duhet ta paguajë personi që ka dhënë në prikë, që ka shkëmbyer apo ka dhënë gjënë e tjetrit. Me t'u gjetur pronari, atij i kthehet sendi apo shtëpia, bashkë me të ardhurat dhe shpenzimet që ajo bart, duke filluar nga momenti kur është marrë. Kjo vlen për çdo pasuri të huaj, të përvetësuar me dhunë. Por nuk vlen për ato prona që mbahen prej mëse 40 vjetësh. Gjopa ndahet përgjysëm mes Kontit dhe paditësit”.

²⁶ Statutet e Shkodrës, kreu: 162: Kur një baba apo një nënë kanë vajza të martuara si dhe djem a djem të djemve, ata nuk duhet t'u japin gjë tjetër vajzave, veç prikës. Gjithë sa mbetet pas sigurimit të prikës së vajzave, i takon djalit apo djemve të djemve. Nëse nuk ka djem, vajzat duhet t'i ndajnë këto pasuri mes tyre, në mënyrë të barabartë, që asnjera të, mos marrë më shumë se tjetra nga pjesa e mbetur e pasurisë, pas dhënies së prikave.

²⁷ Statutet e Shkodrës, kreu: 160: “Vajzat e mbetura pa baba e pa nënë, kanë pjesë të barabartë në ndarjen e pasurisë dhe të drejtën të marrin prikën e virgjërisë. Nëse mbeten jetimë, vëllai me një apo më shumë motra, vëllai apo vëllëzërit kanë për detyrë të martojnë motrën apo motrat, me atë ç'kanë trashëguar ato nga babai e nga nëna. Pjesa që tepron, u takon të vëllëzërve ose vëllait, nëse është vetëm një”.

plotësojë atë nga pasuria e vet.²⁸ Gjithashtu gratë kishin të drejtë kur hartonin testament, që nga prika e tyre të linin një pjesë për lutjet për shpirtin e tyre.²⁹

Paja e gruas konsiderohej si diçka tepër e rëndësishme dhe shpërdorimi i saj shërbente si një pengesë serioze për ata meshkuj që kërkonin të martoheshin për herë të dytë.³⁰ Prandaj, sipas këtyre statuteve kur një burrë e humbë gruan e parë dhe dëshiron të martohet sërish, nëse nuk ka fëmijë më të parën, duhet fillimisht, ta dorëzojë prikën e gruas së parë tek njerëzit e saj. Në rast se nuk vepron kështu, nuk mund të marrë një grua të dytë.³¹ Përveç kësaj në qoftë se një burrë ka fëmijë më gruan e parë, e nese fëmijët e gruas së parë nuk e kanë marrë prikën e nënës, meqë babai është gjallë, edhe kur ky martohet më një grua tjetër dhe bën fëmijë të tjerë më të, në radhë të parë babai duhet të heqë mënjanë prikën e fëmijëve që ka me gruan e parë, pra me nënën e fëmijëve.³² Shikuar realisht Statutet e Shkodrës jo vetëm që rregullonin dhënien e prikës por parasgjithash ato edhe e mbronin dhe e fuqizoin të drejtën e gruas karshi mbajtjes dhe përdorimit të saj, ashtu si ajo, pra gruaja e shihte të arsyeshme.

Në rastin e krushqive mes familjeve aristokrate, bëheshin edhe dhurata të ndryshme jo vetëm nga familjarët apo të afërmit e tjerë, por edhe nga udhëheqësit e shteteve fqinjë. Dhurata të tilla kishte bërë Raguza më rastin e martesës së mbesës së Gjergjit II Strazimirit, si dhe Balshës III. Në fillim të tetorit të vitit 1395 Gjergji II Strazimiri, kishte filluar përgaditjet për martesën e mbesës së tij. Për këtë martesë ishin të njoftuar edhe raguzanët. Lidhur më këtë më 30 tetor të vitit 1395 në Raguzë ishte vendosur për pjesmarrjen në festimet me rastin e martesës që po përgaditej në Ulqin.³³ Natyrisht se përveç pjesmarrjes, Këshilli i Madh në Raguzë kishte vendosur që ti dërgohen disa dhurata Gjergj II Strazimirit.

²⁸ Statutet e Shkodrës, kreu: 165: “Nëse dikush jetëron diçka nga paja e gruas së tij, me pëlqimin e saj, më vonë duhet ta kthejë dhe ta plotësojë atë nga pasuria e vet, në mënyrë që gruas të mos humbë asgjë nga prika e saj. Nëse burri dhe gruaja bien në varfëri, gjithë sa ata vendosin me mirkuptim të shesin, konsiderohet si pronë e përbashka.”

²⁹ Statutet e Shkodrës, kreu:196: “Gruaja që ka fëmijë ka të drejtë të bëjë testament dhe të lërë mënjanë për lutje të shpirtit të saj, një të pestën e prikës, nëse këtë prikë nuk ia ka kaluar vajzës së saj. Përndryshe, të caktojë për përshpirtjen e saj, pjesën e mbetur, pasi t’u ketë shpërndarë djemve pjesën që u takon”.

³⁰ Baze, *Një qytet me statute*, 168.

³¹ Statutet e Shkodrës, kreu:172.

³² Ibid., kreu:173.

³³ Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe dinastia e Balshajve*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2009, 197.(më tej: Gelcich, Zeta).

Në fakt, më 31 nëntor dhe 1 dhjetor të vitit 1395 Këshilli i Madh në Raguzë kishte vendosur që t'i dhurojë atij një sasi stofrash të çmuara.³⁴

Ndërsa me rastin e martesës së Balshës III më vajzën e Kojë Zaharis,³⁵ Senati i Raguzës mbledhi Këshillin e Vogël dhe Këshillin e Madh për të vendosur për ambasadorët që do të shkonin në atë ceremoni, si dhe për dhuratën që do ti bëhej atij. Lidhur me këtë çështje Këshilli i Vogël dhe Këshilli i Madh i Raguzës ka diskutuar prej 8 deri më 25 nëntor të vitit 1412.³⁶ Më 11 nëntor 1412, në Këshillin e Rogatëve i cili përbëhej prej 32 vetave, u paraqiten dy propozime, i pari që dhurata të bëhet në vlerë të 600 perperëve, ndërsa propozimi i dytë që vlera e dhuratës të jetë deri në 800 perperë.³⁷ Këto dy propozime iu përcollën Këshillit të Madh, i cili përbëhej prej 98 vetave. Me sa duket në Këshillin e Madh kalon propozimi i dytë me gjithësejt 55 vota,³⁸ pra që dhurata të jetë në vlerë deri në 800 perperë.

Më 11 nëntor 1412, Këshilli i Madh i Raguzës diskuton mënyrat sesi do të përgatiten personat që do të përfaqësojnë Republikën në martesën e Balshës III. Për këtë u vendos që të dërgohën dy ambasadorë, dhe secilit prej tyre ti jepen nga 40 perperë, pastaj u vendos që tu jepen dy barka të armatosura si dhe gjashtë shërbyes dhe secilit shërbyes ti jepen nga 4 përper në muaj. Për ambasadorët që do të shkonin në dasmën e Balshës u vendos që për shpenzimet e tyre dhe të shërbyesve tu jepeshin çdo ditë nga dy perperë e gjysëm dhe ato që do tu tepronin t'i kthenin

³⁴ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXX (1395-1397), fol. 116r. Gelcich, Zeta, 197. Gjon Berisha, *Marrëdhëniet e Gjergjit II Strazimir Balshës me Republikën e Raguzës*, punim në dorëshkrim, 7: “*Die ultimo octobris. In ultrascripto maiori consilio, ballote ... est de faciendo dona domino Iure Strazimerii pro sponsallibus que est facturur de quadam nepte sua et de mittendo dicto Iure eius filium per brigantinum nostrum minorem*”, “*... est de faciendo dona domino Georgio Strazimerii pro sponsalibus neptis quam modo maritat, videlicet de media peçcia panni de schirlato, de media peccia panni de grana et de duabus fodris martirum vel fuinarum*”.

³⁵ Pranvera Bogdani, *Balshajt lufta e principatës së Balshajve dhe të sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, Tiranë 2018, 182.

³⁶ *Dokumente për historinë III*, dok.172, 173, 174, 178, 180, 181.

³⁷ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXIV (1412-1415), fol. 175v; *Dokumente për historinë III*, dok.173: “*... Prima pars est de donando vsque ad yperperos . vj. Captum per xxij. Secunda pars est de donando vsque ad yperperos viij. ...*”.

³⁸ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXIV (1412-1415), fol. 243v-244; *Dokumente për historinë III*, dok.174: “*Secunda pars est de donando ad valorem yperperorum octingentorum. Captum per 55. ...*”.

pastaj.³⁹ Ndërsa më 18 nëntor 1412 Këshilli i Madh i Raguzës emëron dy ambasadorët që do të shkonin në dasmën e Balshës. Për këtë qëllim u zgjodhën Saracen Bona dhe Nikollë Gondola.⁴⁰ Lidhur më dasmën e Balshës III, në Raguzë u morën edhe dy vendime më 24 dhe 25 nëntor 1412. Më 24 nëntor 1412 u zgjodhën tre veta për të blerë dhuratën që i duhej bërë Balshës III,⁴¹ ndërsa më 25 nëntor Ragusa mori vendim që të bëhet fletë pagesa për ambasadorët që shkojnë të Balsha III.⁴²

Edhe Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, me rastin e martesës më Donikën në prill të vitit 1451⁴³, i erdhën dhurata të shumta dhe nga më të ndryshmet si nga bujarët vendas ashtu edhe nga Venediku dhe Ragusa. Sipas Barletit, princërit fqinj dhe pothuaj gjithë bujarët e Epirit, ku qenë e s'qenë, ose muarën pjesë vetë në atë mrekulli me një suit fort të madhe e me dhurata madhështore, ose i dërguan urime dhe përfaqësues me peshqeshe nga më të bukurat. Edhe Senati i Venedikut kishte dërguar dhurata nga arka e shtetit.⁴⁴ Për dhuratat që Skënderbeut i erdhën nga Alfonsi, Barleti thotë se ishin aq të mëdha sa që Skënderbeu nuk deshë t'i mbante, porse u shtrëngua më në fund nga purpuratët dhe vetë të dërguarit e mbretit që t'i merrte dhe i dërgoi atij të tjera jo më të vogla, si kuaj, skllevër dhe sende të tjera barbarësh dhe plaçkë armiqsh të mundur, siç e kish zakon.⁴⁵ Pra përveçse traditë, dhuratat bëheshin edhe për të ruajtur apo relaksuar raportet mes vete, si dhe për ta dëshmuar miqësinë siç shprehet edhe vetë Barleti.⁴⁶ Si përfundim, bazuar në tërë atë që na ofrojnë të dhënat dokumentare, mund të konkludojmë se, prika ishte një element i rëndësishëm e juridikisht i sistemuar, i se drejtes private.

³⁹ Ibid: "...Prima pars est. de donando dictis Ambassiatoribus pro eorum expensis et Famulorum singulo die perperos duos cum dimidio et quidquid supererit restituant. Captum per 83...".

⁴⁰ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXIV(1412-1415), fol. 246v *Dokumente për historinë III*, dok.178: "die xvij noumbris .1412. In Maiorj Consilio Ballote lxxxij //Ambasiatores // Electio Ambasiatorum electorum secundum Ordines vl transcriptis. Qui Juri sunt ad nucas dominj Balse. //Remansit// ser Saracenus de bona ball. lij. //Remansit// ser Nicholinus de gondola ball.Xliij".

⁴¹ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXIV(1412-1415), fol. 49v; *Dokumente për historinë III*, dok.180: "1412 novembre 24, Raguze-Trois personnes sont éiues «pour acheter un présent à faire à Balsha»".

⁴² HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXIV(1412-1415), fol. 50; *Dokumente për historinë III*, dok.181.

⁴³ Noli, *Gjergj Kastrioti*, 110.

⁴⁴ Barleti, *Historia*, 292,

⁴⁵ Ibid, 292.

⁴⁶ Ibid.

Si traditë prika jepej jo vetëm nga prindërit por edhe nga vëllezërit, dhe nga përsone tjerë të autorizuar. Si element që prika ka ndikuar në lidhjet martesore mund të veçojmë dy çështje: e para marrëveshjet që bëheshin për prikën para martesës, dhe rastet kur martesat bëheshin në mes familjeve fisnike. Edhe dhënia e dhuratave me rastin e martesës përcjellte një mesazh të caktuar, e në veçanti kur dhurata bëhej nga bujarët vendas dhe udhëheqësit e shteteve fqinjë.

Teuta SHALA-PELI

SUMMARY

DOWRY AND PRESENTS IN ALBANIAN FAMILIES ON THE OCCASSION OF MARRIAGE (SECOND HALF OF THE XIV – XV CENTURY)

An important element to which albanian families during the middle Ages was paid a special attention on the occasion of marriage was dowry, presents and various privileges which were not only made by family members but also by a wider circle. In the Middle Ages in the albanian land on the occasion of marriages of girls there was practiced to give a dowry, usually in the form of real estate or money (*perperë, heksagje*), for dowry also was given furniture and other valuable items. Providing of dowry was practiced both from noble families and levels of society.

Of course, noble albanian families had a higher dowry value where usually were given certain territories. The dowry was usually given by parents and there were occasions when dowry was given by authorized persons. In addition to dowry, different presents were provided not only by family members or relatives, but also by leaders of neighboring countries at the time of marriage. Such presents were mentioned on the occasion of the marriage of Gjergj II Strazimir, Balsha III, as well as Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Based on all provided documentary data, we can conclude that the issue of dowry in addition to tradition in certain cases and moments can also be seen as an element effecting marital relationship. Also, giving of presents on the occasion of marriage conveyed a certain message, in particular when it was given by local noblemen and leaders of neighboring states.

Gjon BERISHA

BAZA EKONOMIKE E SANXHAKUT TË PRIZRENIT NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK.XVI

Lashtësia dhe trashëgimia e pasur kulturore e qytetit të Prizrenit ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e shumë studiuesve, të cilët kanë bërë hulumtimin si për qytetin e Prizrenit në tërësi ashtu edhe për Sanxhakun e Prizrenit në veçanti. Në mesin e tyre mund të përmendim, studiuesit: Kaleshi,¹ Tatjana Katiq,² Olga Zirojeviq,³ Machiel Kiel,⁴ Selami Hasan

¹ Hasan Kaleši, "Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname", *Buletini i Muzeut të Kosovës*, II (Prishtinë, 1957), 289-300; Idem, "Prizrenac Kukli-beg i vjegove zadužbine", *Prilozi za Orijentalnu Filologiju*, VIII-IX (Sarajevo, 1959), 143-168 (koautorë me Redžep Ismail); Idem, "Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda", *Gjurmime Albanologjike*, I (Prishtinë, 1962), 91-118.

² Tatjana Katić, *Opširni popis Prizrenskog sandžaka iz 1571. godine*, Beograd: Istorijski Institut, 2010; Idem, "The Sancak of Prizren in the 15th and 16th Century. 15. ve 16. Yüzyılda Prizren Sancağı", *OTAM*, Sayı 33 (Ankara Üniversitesi Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi), 2013, 113-138; Idem, "Prihodi kadiluka Prizren od trgovine svilom, rudnika Koriše i ostalog (1525-1545. godine)", *Mešovita građa (Miscellanea)*, br. XXX (Beograd 2009), 23-25; Idem, "Osmanizovanje srednjovekovnog grada: Urbani i demografski razvoj Prizrena od polovine XV do kraja XVI veka", *Istorijski časopi: organ Istorijskog instituta Srpske akademije nauka i umetnost*, knj. LXVII (Beograd, 2018), 101-139.

³ Një përmbledhje e listës së regjistrimit të sanxhakut të Prizrenit nga viti 1530, është botuar nga Olga Zirojević, "Vučitrnski i Prizrenski Sandžak u svetlosti turskog popisa 1530/31 godine", *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2 (1968), 103-120; Idem, "Prizren u defteru iz 1571 god.", *Istorijski časopis*, br. XXXVIII (Beograd, 1991), 243-263; Idem, "Prizren Şehri, İslamiyet ve Hristiyanlığın Beraber Yaşamının Bir Örneği", *XVI. Türk Tarih Kongresi*, Cilt V, Ankara: Türk Tarih Kurumu Yayınları, 1994, 2115-2123.

⁴ Machiel Kiel, "Prizren", *The Encyclopaedia of Islam*, new edition, Vol. VIII, Leiden 1995, 337-341.

Pulaha,⁵ Muhamet Tërnavë,⁶ Skënder Rizaj,⁷ Zija Shkodra,⁸ Sadullah Gülten,⁹ etj.

Botimi dhe përkthimi i Defterit të hollësishëm kadastral të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571 nga studiuesja T. Katiq si dhe përkthimi i pjesshëm i Defterit të Prizrenit të vitit 1591 nga studiuesit Selami Pulaha dhe Vexhi Buharaja,¹⁰ si dhe artikuj të shumtë të botuar në vitet e fundit kanë kontribuar në një masë të konsiderueshme për njohjen më të mirë të disa prej zonave të sanxhakut të Prizrenit që kanë të bëjnë, kryesisht me burimet ekonomike të këtij sanxhaku. Për arsye të mbledhjes së taksave, në këta defterë të hollësishëm, të dhëna të detajuara gjenden mbi veprimtaritë ekonomike. Andaj, mbështetur në të dhënat që na i sjellin këta dy defterë osman të gjysmës së dytë të shek.XVI dhe në literaturën relevante, në këtë punim vëmendje të veçantë i kemi kushtuar zhvillimit të degëve të ndryshme ekonomike të qytetit (zejtarisë, tregtisë, bujqësisë, bletarisë, blegtorisë dhe në masë me të vogël edhe xehetarisë), të cilat ishin jetike dhe ndikuan drejtpërdrejt jo vetëm në zhvillimin ekonomik të vetë sanxhakut të Prizrenit, gjatë shek.XVI, por edhe në stabilizimin dhe rritjen demografike të vendit. Hapa të rëndësishëm përpara drejt rritjes ekonomike dhe shtimit të popullsisë së qyteteve u bënë nga gjysma e dytë e shek. XVI. Regjistrimet kadastrale të qyteteve, me të dhënat mbi zejet që ushtroheshin nga qytetarët, mbi detyrimet në natyrë ose në të holla që ata

⁵ Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek.XV-XVI: studime dhe dokumente*, Tiranë, 1983.

⁶ Muhamet Tërnavë, *Qytetet e Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI*, Prishtinë, 2007.

⁷ Skënder Rizaj, *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva od XV do XVII veka*, Priština, 1968; Idem, "Prizreni deri te Tanzimati", *Gjurmime albanologjike: seria e shkencave historike*, nr. XIII/1983 (1984), 51-82.

⁸ Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare: shekujt XV-XX*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 1973.

⁹ Sadullah Gülten, "XVI. Yüzyilda Prizren kazasi - Prizren in 16th century", *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi -The Journal of International Social Research*, Vol. 5, Issue 20 (2012), 185-199. Për ndihmën e dhënë në konsultimin e literaturës në gjuhën turke falënderojmë kolegun Dr.sc.Eduart Caka.

¹⁰ Ankara, Tapu ve Kadastro Kuyûd-ı Kadîme Arşivi, Tapu Tahrir Defterlei, no 55 (Defter-i mufassal-i liva-i Prizrin), viti 1590/91, fl.8. Këtë defterë e kemi shfrytëzuar në versionin e përkthyer pjesërisht në gjuhën shqipe nga Vexhi Buharaja, i cili ruhet në fondet e Arkivit të Institutit të Historisë në Tiranë: *Defteri i Prizrenit i vitit 1591, A-III-413, nr.inv.694*. Kurse pjesa tjetër e po këtij Defteri që ka të bëjë me vetë qytetin e Prizrenit, fl.13a-17a, është përkthyer nga Selami Pulaha dhe është botuar në: Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 510-520. [Më tej: KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55]

paguanin dhe mbi numrin e vatrave, dëshmojnë qartë se forcat prodhuese, tashmë ata i kishin kapërcyer pasojat negative të luftës dhe deri në një farë mase edhe veprimin frenues të faktorëve të rinj, që lindën me vendosjen e regjimit ushtarak osman dhe që ngadalësonin ritmet e zhvillimit.

Krahas popullsisë ekzistuese, vazhdonin të grumbulloheshin këtu elementë të ndryshëm, sidomos fshatarë-zejtarë, të cilët, përveç bujqësisë, merreshin edhe me zejtari e tregti. Si nxitje për zhvillimin e zejeve shërbyen nevojat e banorëve të qyteteve për mallra konsumi. Kështu popullsia filloi të shtohet dhe qarkullimi i mallrave të rritej.¹¹ Në 150 vitet e para të sundimit otoman, Prizreni nuk kishte parë rritje të konsiderueshme të popullsisë. Vetëm në gjysmën e dytë të shek.XVI, qyteti i Prizrenit ishte rritur nga pikëpamja numerike e banorëve dhe ishte shndërruar në qendër të rëndësishme zejtare dhe tregtare. Për kah madhësia, Prizreni në regjistrimin e vitit 1591 kishte 557 shtëpi¹², që ishte dhe numri më i madh nga të gjitha qytetet e Kosovës. Është me rëndësi të theksohet se nga regjistrimi i defterit të vitit 1530 deri në regjistrimin e vitit 1571 numri i shtëpive ishte rritur për 200, kurse në regjistrimin e vitit 1591, numri ishte zvogëluar për 100 shtëpi, duke ndjekur një kurs në drejtim të kundërt, kurse numri i banorëve nuk ka ndonjë ndryshim të madh.¹³ Sipas disa vlerësimeve, qyteti kishte midis 2.000 dhe 2.500 banorë para pushtimit otoman, ndërsa shek.XVI, numri i banorëve arrite midis 2.500 dhe 3.500 banorëve.¹⁴

a) *Ekonomia e qytetit*

Në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Prizrenit një rol të dorës së parë ka luajtur zejtaria, sidomos zejet që ishin të lidhura me kërkesat ushtarake dhe me përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Defterët e Sanxhakut të Prizrenit, të vitit 1571 dhe 1591, duke qenë të hollësishëm (mufasal), përveç emrave të lagjeve, emrave dhe mbiemrave të kryefamiljarëve, ato na japin të dhëna të shumta edhe për burimet ekonomike, të cilat na bëjnë të mundur të shohim së cilat ishin profesionet që ushtronin banorët e Prizrenit. Andaj, të dhënat e këtyre

¹¹ Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 476.

¹² KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, 13a-17b; Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 510-520.

¹³ Përafërsisht, ndryshimi i numrit të banorëve nga viti 1571 deri në vitin 1591 ishte 725 banorë më pak. Gülten, "XVI. Yüzyilda Prizren kazasi", 187-188.

¹⁴ Kiel, "Prizren", 338.

defterëve kanë rëndësi të madhe edhe për njohjen e zhvillimit ekonomik në këtë kohë.

Të dhënat e këtyre defterëve na njoftojnë mbi zejet që ushtronin qytetarët, të cilat provojnë se Prizreni ishte shndërruar në qendër të rëndësishme zejtare. Kështu nga 55 zeje të ndryshme që ekzistonin në Kosovë, rreth 45 sosh ushtroheshin vetëm në Prizren dhe më shumë se dyqind artizanë që merreshin me këto zeje. Ndër më të përparuarat ishin ato të cilat ishin të lidhura me nevojat e pushtetit osman si dhe të popullsisë së vendit. Pjesën më të madhe e përbënin zejet e rrobaqepësve (*hajat*) (27 zejtarë), shajakpunuesve (*mutaf*) (23), lëkurëregjësve (*debag*) (19), këpucëtarëve (*shuster*) (17), karrocapunuesve (*arabaxhi*) (17), mbathtarëve apo *nallbanëve* (12), kasapëve (14), mëndafshpunuesve (*kazaz dhe ipekçi*) (16) dhe pastaj vinin bukëpjekësit (*habbaz*) (7), tregtarët (5), dylgjerët (5), bravapunuesit (*çilingjir*) (5), samarxhinjtë (4), argjendarët (5), gëzoftarët (*qyrkxhi*) (5), berberët (4), papuçëpunuesit (4), sandallëpunuesit (4), çizmexhijtë (4), saraçët (3), telakët, (3) boruzanët (3), sapunxhijtë (3), bojaxhijtë (3), gjellëbërësit (*ashçi*) (3), lugëpunues (2), serekxhinjë (2), gunëpunuesit (2), hallvaxhinjë (2), bazhdarë apo peshues (6), opingarët (2), argjendarë (5). Pos tyre, vepronin edhe nga një sazaxhinj, një mullis, një çikërrimtarë e shitës bimësh mjekësore (attar), një shpatpunues, një xhevzexhi, një farkëtar, një karvanexhi, një kasnec (tellall), qirapunues (mumxhi), fespunues (tekijxhi) dhe një hamamxhi.¹⁵

Shumica e banorëve të Sanxhakut të Prizren, të ardhurat e tyre ekonomike i siguronin nga zejtaria dhe zanatet e tyre. Në veçanti, fakti që në defterët e vitit 1571 dhe 1591 kryefamiljarët i kanë shkruar profesionet e tyre në vend të emrave të babait të tyre, është edhe një tregues që ka të bëjë si me rëndësinë që kishte zejtaria ashtu edhe për larminë e zejeve apo profesioneve.

Nga këto të dhëna mbi ushtrimin e zejeve në Prizren, del se ky qytet kishte rreth 246 kryefamiljarë që ushtronin zeje të ndryshme, prej të cilëve 227 kryefamiljarë ishin të përkatësisë fetare islame dhe 19 të krishterë.¹⁶ Zejtarët si rregull ishin të parët që kalonin në islam, ndërsa arsyet ishin, sikurse është supozuar nga Thirkell, presioni i tregut, gjegjësisht favorizimi i prodhimeve dhe shërbimeve të zejtarëve mysliman nga ana e elitës myslimane qytetare.¹⁷ Pra shumica e profesioneve të

¹⁵ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl.8, 13a-17b;

¹⁶ Po aty, 13a-17b; Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 478; 481-482; Muhamet Tërnavi, *Qytetet e Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI*, Prishtinë, 2007, 93-95.

¹⁷ J. Thirkell, shfaqë mendimin se zejtarët u konvertuan si rezultat i një presioni të krijuar

zejtarëve ishin në duart e kryefamiljarëve të besimit islam, kurse me sa mund të përcaktohet, midis të krishterëve kishte më shumë argjendarë, rrobaqepës, këpucar dhe bukëpjekës. Fakti që nga 5 argjendarë sa ishin gjithsej, prej tyre 4 ishin të krishterë është një detaj i rëndësishëm. Kjo tregon se jomuslimanët e kishin në duar menaxhimin e sektorit financiar.¹⁸

Rrjedha e lumit Lumbardhë (Bistricë) është shfrytëzuar edhe për ndërtimin e mullinjve të shumtë, të cilët sipas shënime të shek.XVI, ka disa që datojnë nga shek.XIV dhe XV. Sipas defterit të vitit 1591, sasia e mullinjve nga myslimanët e vetë Prizrenit ishte: në lagjen “Xhamia e Vjetër” ishin 9, në lagjen “Çarshi” e quajtur ndryshe edhe si Jakup beu, ishin 4, në lagjen “*Debagahane*” (lëkurëpunuesve) ishin 4, të cilat gjithsej ishin 17 mullinj me të ardhura prej 150 akçe. Kurse mullinjtë e rajave ishin: në lagjen “*Bogoi Ribar*”, ishin 4, kurse në lagjen “*Prend Vriça*” ishin 6, që gjithsej ishin 10 mullinj me të ardhura prej 300 akçe taksë.¹⁹

Nga zejet më të zhvilluara të kësaj periudhe ishin degët e përpunimit të lëkurës (tabakët). Lëkurat ishin artikuj të rëndësishëm edhe në periudhën paraosmane, dhe të tilla vazhduan edhe në shekujt që pasuan. Prizreni, sipas burimeve raguzane dhe atyre osmane vazhdoi të ishte qendra më e madhe e Kosovës për prodhimin e lëkurave cilësore të dhive dhe deleve. Tabakët e Prizrenit, sikur edhe të qyteteve tjera shqiptare, dalloheshin në mjeshtërinë e *regjjes* nëpër gropa, të përpunimit, dhe sidomos ngjyrosjes së lëkurës, zanatin e të cilës e ruanin me fshehtësi. Zejtarët prizrenas punonin lëkurë të çdo lloji, me ngjyra të kuqe, të verdha, punonin meshinin e hollë të bardhë, saftjanin e butë, kajzerin etj. Për shkak të natyrës së punës, punëtoritë e lëkurëpunuesve (tabakëve) ishin të vendosura pranë ujit, kryesisht pranë Lumbardhit, dhe për shkak të erës së pakëndshme dhe mbeturinave të tyre, i vetmi vend për ndërtimin e tyre ishte në dalje të qytetit.²⁰ Për të njëjtat arsye, aty gjendej edhe thertorja, si dhe mundësisht edhe punëtoritë për përpunimin e zorrëve dhe sapunëve. Në sajë të zhvillimit të kësaj zeje dhe koncentrimit të tabakëve dhe

përmes tregut për produktet dhe shërbimet e tyre. Ai mendon se institucionet ushtarake, civile dhe fetare myslimane në qytete, preferonin të blinin nga furnitorët apo prodhuesit, të cilët ishin të besimit të tyre, pra mysliman. John Thirkell, “Islamisation in Macedonia as a Social Process,” *Islam in the Balkans*, ed., Jennifer M. Scarce, (Edinburgh, 1979), 47; Anton Minkov, *Conversion to Islam in the Balkans: Kisve Bahasi Petitions and Ottoman social life, 1670-1730*, Leiden-Boston: Brill, 2004, 97.

¹⁸Gülten, “XVI. Yüzyilda Prizren kazası”, 190.

¹⁹KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, 14b, 16b.

²⁰Toma Popović, “Kordovani i montonini u balkanskom izvozu XVI veka”, *Istorijski časopis*, br.XXXVI (Beograd 1989), 65-66; Katić, “Osmanizovanje Prizrena”, 116.

familjarëve të tyre në këtë pjesë, kjo lagje e qytetit e mori emri sipas profesionit, lagja apo *mahalla* e Tabakhanes, e cila përfshinte anën e djathtë dhe të majtë të Lumbardhit, gjegjësisht hapësirën rreth mesxhidit të Ahmet beut dhe Suzit, si dhe lagjja e haxhi Kasëmit, në anën e majtë të Lumbardhit. Si e tillë, lagjja e Tabakhanes në regjistrimet e vitit 1571 dhe 1591 ishte e evidencuar si e pavarur. Numri i tyre u ul nga 36 sa ishte në regjistrimin e defterit të vitit 1571 në 19 në vitin 1591. Të ardhurat shtetërore nga thertorja prizrenase në shek.XVI arrinte në mes 1.200 dhe 1.300 akçe në vit, duke llogaritur një akçe në çdo katër dele apo dhi të therur (tur.: *davar*).²¹ Kërkesa më e madhe ishte për lëkurën e dhisë dhe qengjave, të ashtuquajtura "*kordovane*", sipas qytetit spanjoll të Kordovës, në të cilin u aplikua për herë të parë një mënyrë e re për tharjen e lëkurave.

Fakti që taksa e deleve ishte mjaft e ulët në zonën rurale të Sanxhakut të Prizren tregon se nuk kishte shumë bagëti në rajon. Andaj, tregtarët vendas të Prizrenit furnizoheshin me lëkurë të papërpunuar nga zonat përreth: nga Bjeshkët e Sharrit, nga rajoni i Dukagjinit, Bjeshkët e Nemuna dhe zona të tjera malore. Lëkurë e gatshme e importuar nga Kosova, më pas, eksportohej nga raguzanët në Itali, veçanërisht në Venedik, Gjenovë, Firence, Ankon dhe Mesina, e ndjekur nga Franca, Anglia dhe vendet gjermane.²² Prodhimi i lëkurëve "*kordovane*" tërhiqte një numër tregtarësh të huaj. Nga lëkurat, zejtarët e saraçëve punonin artikuj të ndryshëm, si: *shala*, *rripa*, *frenjë* e *dizgjinë*, *kuleta*, *silafe* (brez për armë), pajisje të tjera për nevojat e banorëve dhe ushtrisë, siç ishin *këpucët*, *çizmet*, *sandalet*, etj. Po nga lëkura e kafshëve shtëpiake apo nga ato të egra, në zejet e gëzoftarëve punoheshin prodhime të bukura për veshje (qyrke).

Zejtaria e punimit të lëkurës në shek.XVII arriti në rreth 30% të prodhimit të përgjithshëm, zinte vendin e parë në mesin e zejeve tjera, pasi, përveç kërkesave në rritje të popullsisë e të ushtrisë, ishin edhe ato të tregut të jashtëm. Kjo degë mori një karakter masiv, sepse punishte e shumta të ndërtuara në çdo qytete grumbulluan fuqi të mëdha pune në këtë zeje.²³ Në sajë të zhvillimit të kësaj zeje, prodhuesit e tyre u organizuan

²¹ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, 14a, 16b; Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 55, 61.

²² Popović, "Kordovani", 65-66, 78; Hamid Hadžibegić, "Zvanični podaci o stočnom fondu na području Novog Pazara, Trgovišta i Bihora iz 1585. Godine", *Istorijski Zapisi*, god. XXII, knj. XXVI, vol. 4 (Titograd 1969), 586-616; Bogumil Hrabak, *Izvoz žitarica iz Osmanlijskog carstva u XIV, XV i XVI stoleću: udeo Dubrovčana u prometu "turskim" žitom*, Priština: Zajednica naučnih ustanova Kosova, 1971, 452-462.

²³ Zijā Shkodra, *Esnafet shqiptare: shekujt XV-XX*, Tiranë: Akademia e Shkencave e

në *esnafin* e tyre si shoqatë e tabakëve, veprimtaria e brendshme e së cilës ishte e rregulluar në bazë të kanunoreve dhe statutit. Në formën e vendimeve aty shkruheshin edhe rregullat për funksionimin e brendshëm të organizatës, që ktheheshin në ligje të detyrueshme për të gjithë anëtarët dhe njiheshin si të tilla edhe nga organet e pushtetit e nga ato gjyqësore. Kështu, tabakët e Prizrenit kishin statute të shkruara të quajtura “*pirname*”, apo “*sexhere*”, në bazë të cilave administroheshin. Kurse, krahas rregulloreve dhe statuteve, esnafet kishin edhe ligjet e pashkruara (*sulle*), të mbështetura në traditën zakonore. Dallohen sidomos *sullet* e 13 esnafeve të bashkuara, të njohura me emrin *Sullet e Tabhanës*.²⁴ Nga të gjithë esnafët, tabakët (lëkurëpunuesit) ishin më të fuqishmit, jo vetëm në saje të rëndësisë së pozitës në ekonominë lokale, por edhe në saje të lidhjeve të veçanta që kishin me ushtrinë (për kalorësinë, të cilëve i nevojiteshin shala dhe frerë për kuaj). Numri i tabakëve në Prizren në shek.XVIII kishte arritur në 43 punëtori.²⁵ Organizmi i të gjitha zejeve në esnafe, u përhapë më të madhe në shekujt XVII-XVIII.

Në saje të prodhimit të mëndafshit dhe grumbullimit të leshit të deleve, Prizreni kishte një grup të madh rrobaqepësish që punonin në qytet në zeje të specializuara (terzinj, kazazë apo *gajtanxhinj*, etj).²⁶ Në lidhje me produktet e kësaj zeje që nga mesjeta ekzistojnë dëshmi nëpër freska, në formë rrobash të begatshme të aristokracisë. Kështu, që nga shek.XIV në mesin e saraçëve dhe farkëtarëve të këtij qyteti, përmendën edhe rrobaqepësit.²⁷ Në të vërtetë, në periudhën osmane, rrobaqepësit u regjistruan me dy emra: rrobaqepësit myslimanë u regjistruan me fjalën arabe *hayyat*, kurse rrobaqepësit e krishterë me fjalën persishte *derzi* (terzi).²⁸ Edhe pse kjo situatë u interpretua si një shenjë dallimi midis dy

Shqipërisë – Instituti i Historisë, 1973, 59.

²⁴ Kadri Halimi, “Tabački zanat u Prizrenu”, *Glasnik Muzeja Kosova*, knj.I (Prishtinë, 1956), 109; Idem, “Esnafet në Kosovë-Metohi: organizatat ekonomiko-shoqërore të zejtarëve”, *Përparimi*, nr.2-3 (Prishtinë, 1958), 113.

²⁵ Evlija Čelebi, *Putopis: odlomci o jugoslovenskim zemljama*, preveo Hazim Šabanović, Sarajevo: Svjetlost, 1967, 276, 338; Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shek. XVII*, vëll.I (1601-1634), Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1963, 168, 336; Halimi, “Esnafet në Kosovë”, 114, 147-149.

²⁶ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 14a, 16b.

²⁷ Novaković, *Zakonski spomenici*, 682-701; *Kosova dikur dhe sot*, Beograd: Ekonomska Politika 1973, 303.

²⁸ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 13a (*Sefer, hajat; Hasan, hajat; Hysein, hajat*), 13b (*Ali, hajat; Hysein, hajat; Hysein, hajat; Hysein, hajat; Sinan, hajat; Safer, hajat; Hasan, hajat; Memi, hajat; Osman, hajat*), 14a (*Hasan, hajat; Hysein, hajat; Musa, hajat; Mami, hajat; Ahmed, hajat; Mustafa, hajat*), 14b (*Hysein, hajat; Ibrahim,*

grupeve,²⁹ ato ishin të njëjta. Në të vërtetë, edhe mëndafshpunuesit u regjistruan me dy emra të ndryshme si *mëndafshpunues* dhe si *kazaz*,³⁰ por që kishin të njëjtin kuptim.

Në fushën e prodhimit të pëlhurave të leshta, prodhimi i shajakut zinte vendin e dytë pas rrobaqepësve. Kjo zeje u zhvillua aq shumë, sa që njihej edhe jashtë vendit me emrin "*arnaut kebesi*".³¹ Krahas zejeve tjera, një hov të madh zhvillimi mori ajo e përpunimit të pëlhurave të mëndafshita. Nga ky lloj tekstili i kërkuar, që në mesjetë në Prizren janë prodhuar lloje të ndryshme të pëlhurave për orendi shtëpiake e personale, si, bie fjala, mbulesa tavolinash, perde etj. Në fund të shek.XVI mëndafshpunuesit në mesin e zejtarëve të tjerë të Prizrenit zinin vendin e tretë.³²

Në grupin e zejeve artistikë, një vend të veçantë gëzonte argjendaria. Argjendarët (kujunxhinjtë) e Prizrenit prodhonin objekte të bukura, si vathë, bylyzykë, unaza, gjerdanë dhe prodhime të tjera prej ari, argjendi e tunxhi.³³

Përveç lëkurës, mëndafshit, leshit, drithit, verës dhe metaleve kishte shumë tregti me pëlhura liri, dylli dhe produkte të tjera artizanale të Kosovës. Në fillim të shek. XIV, tregtarët nga Kotorri, në Prizren, ngritën një punishte për përpunimin e dyllit dhe prodhimit të qirinjve të quajtur si "*shtëpia e prodhimit të dyllit*",³⁴ kurse gjatë sundimit osman, të ardhurat nga dylli (*şem'hane*) i Prizrenit i përkisnin sulltanit.³⁵ Tregtia me këtë produkt, i sillte Prizrenit të ardhura vjetore prej 3,333 akçe. Nga taksat e vjelura shihet se në rrethinën e Prizrenit prodhohej edhe një pije nga mjalti e quajtur *mjaltore* "*baldan içki*".³⁶ Të ardhurat të larta shteti osman nxirrte edhe nga minierat. Nga këto miniera, administrata osmane, nxirrte të ardhura, të cilat i kalonin thesarit shtetëror dhe përdoreshin për të mbuluar shpenzimet e administratës qendrore të shtetit. Në përputhje me kushtet

hajat; Dervish, hajat; Ahmed, hajat; Mehmed, hajat; Ahmed, hajat), 15a (*Bojo, terzi*), 16b (*Dimo, terzi; Todor, terzi*).

²⁹ Zirojević, "Prizren Şehri", 2119.

³⁰ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 13a-16b.

³¹ Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 60.

³² Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 478.

³³ Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 60.

³⁴ Stojan Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka*, Knj. 5, Beograd, Srpska kraljevska akademija, 1912, 640.

³⁵ 167 Numaralı Muhâsebe-i Vilâyet-i Rûm-ili Defteri (937/1530), II, 37; Katić, "Prihodi kadiluka Prizren", 27.

³⁶ Zirojević, "Prizren Şehri", 2120.

ekonomike e politike të secilës trevë, ato përfshinin zakonisht të ardhurat më të rëndësishme të vendit që vinin përveç tjerash, edhe nga minierat e Novobërdës, Janjevës, Trepçës, Prizrenit. Në saje të ardhurave që gjeneronin, të gjitha xeherorët e Kosovës, që në shek.XV ishin shpallë *hase* të sulltanit.³⁷

Miniera e vogël e Korishës afër Prizrenit, e cila po funksiononte në gjysmën e parë të shekullit XVI, nuk ofronte të ardhura të madha sepse, siç duket do të mbyllej.³⁸ Në një ferman të vitit 1577 flitet për një xeherore tjetër të argjendit në rrethinën e Prizrenit, pa u saktësuar vendndodhja. Sipas këtij fermi, Porta është informuar se në rrethinën e fortesës së Vllastadinit, ekziston një xeherore dhe se nevojitet që gjithsesi të eksploatohet, sepse prej saj pushteti shtetëror do të ketë fitime të mëdha. Andaj, sanxhakbeut të Bosnjës i jepet urdhër që ai personalisht të shikojë fushën minerale të përmendur, të nxirret xeheje dhe të konstatohet se sa do të jetë prodhimi, e sa shpenzimet e secilit pus, kështu që të mos shkaktohen humbje për shkak të sasisë së vogël të xehes. Për këtë të kujdesej beu i Bosnjës bashkë me ekspertët (ehli vakuf); të sigurohen sarafët dhe Porta të informohet për sasinë e të ardhurave të argjendit (gümüş) që do të jap xeherorja.³⁹

Megjithëse fermi i viti 1577 bën me dije vetëm për tentativën e ripërtëritjes së xeherores në rrethinën e Prizrenit, sepse është dashur të ekzaminohej mundësia e eksploatimit të xeherores së argjendit në afërsi të fortesës së Prizrenit, prapëseprapë, sipas studiuesit S.Rizaj, mund të konstatohet se xehetaria në Prizren ishte aktive së paku deri në fund të shek.XVI. Ky konstatim, vije nga fakti se sipas fermi të datës 26 shtator 1588, popullsia e *kadillëkut* të Prizrenit, meqë punonte në xeherore, ishte liruar prej eksportimit të deleve.⁴⁰ Sidoqoftë, të dhëna më të shumta kemi për minierën Zhezhna në kuadër të Sanxhakut të Prizrenit, e cila në dekadat e fundit të shek. XVI ishte e katërta në prodhimin e argjendit në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Më 1561 miniera Zhezhna i jepet me qira *emin* Mahmudit (iltizam), në kushte të timarit, në

³⁷ Zirojević, "Vučitrnski i Prizrenski sandžak", 103-116; Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek.XV-XVI)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988, 188, 190-191; N. Todorov, *Balkanskijat grad XV - XIX vek*, Sofia 1972, 89.

³⁸ Qiraja tre vjeçare e minierës së Korishës, kishte edhe disa të ardhura më të vogla, të cilat arrinin në 165,000 akçe, kurse qiramarrësit dhe menaxherët e Korishës në 1526 dhe 1532 ishin të krishterë. 167 *Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-ili Defteri*, Vol. II, 371.

³⁹ Rizaj, *Rударство Косова*, 187-188.

⁴⁰ Po aty, 23, 188.

lartësi prej 6.000 akçe. Edhe sipas defterit të hollësishëm të viti 1591 Zhezhna ishte nahije me 19 fshatra në kuadër të Sanxhakut të Prizrenit. Si nahije, si një e tërë, së bashku me minierën i përkiste pasurive të sulltanit. Qiraja e saj gjashtë vjeçare (1585 /1586-1591 /1592) ishte 861.036 dërhëmë, ose 2645 kg argjend i pastër (llogaritur në dërhëmët e Tabrizit) dhe të ardhur 940.000 akçe.⁴¹

Me rritjen e numrit të zejtarëve pjesëmarrës në prodhimin dhe shkëmbimin e mallrave, krahas tregjeve apo shesheve për shitjen e produkteve zejtare, bujqësore e blegtorale, u ndërtuan edhe një numër i dyqaneve, të cilat përbënin embrionet e sokakëve të parë zejtarë dhe tregtarë. Në të shumtën e rasteve, këto dyqane shërbenin njëkohësisht edhe si vendpunishte edhe si vendshitje të prodhimeve të tyre. Në qytetet osmane dyqanet zakonisht ishin pronë private, por më vonë zejtarët funksiononin edhe në dyqane që liheshin si donacione (vakëfe) nga pronarët e tyre. Dyqanet e grumbulluara në ambiente të posaçme radhiteshin sipas zejeve dhe profesioneve, i dhanë hovë zhvillimit të tregtisë së prodhimeve zejtare. Kurse numri i dyqaneve nga 117 sa ishte në vitin 1538 të përmendur më lartë, tani në vitin 1591 kishte arritur në rreth 300 (shiko: Tabela nr.3).⁴²

Sikurse në qendrat e banuara qytetare të Kosovës, ashtu edhe në Prizren, gjatë periudhës osmane, pazari apo çarshia, zinte një vend të rëndësishëm në fizionominë e qytetit. Pazari, ishte tregues i vërtetë karakterizues për cilësimin qytet të një qendre të banuar, në të cilin zhvillohej veprimtaria zejtare dhe tregtare. Përgjithësisht, komplekset e pazareve tradicionale formoheshin prej dy njësisish, pazarin e mbyllur (*bezistane*), një bashkësi dyqanesh, dhe pazarin e hapur me një hapësirë të caktuar, në të cilin një ditë të caktuar të javës fshatarët tregtonin prodhimet e tyre.⁴³ Pjesa më e madhe e dyqaneve të zejtarëve ishin rreshtuar sipas zejeve dhe profesioneve, duke formuar rrugët, rrugicat, sokakët e tyre. Prizreni kishte 24 sokakë të tillë. Vendosja e zejtarëve sipas zejeve ishte një traditë shumë e vjetër, e trashëguar nga periudha bizantine, por e zhvilluar më tepër në periudhën e sundimit osman.⁴⁴ Në Prizren ekzistonin

⁴¹ Srđan Katić, "Zakupi rudnika i hasova Žežna iz 1585/6 i 1591/2. Godine", *Mešovita građa (Miscellanea)*, Vol. XXXIV (Beograd 2013), 85-86; Rizaj, *Rudarstvo Kosova*, 179.

⁴² Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 478.

⁴³ Shkodra, *Esnafet Shqiptare*, 67-77; Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë 1984, 101-102; Emin Riza, "Ansamblet ndërtimore të pazareve dhe restaurimi i tyre", *Monumentet*, nr.15-16 (1978), 117-130.

⁴⁴ Shkodra, *Esnafet Shqiptare*, 67-68.

sheshet tregtare si Pazari i Vjetër, Pazari i Drithit, Arast Çarshia, Tregu i Saraçëve, Papaz Çarshia. Shumica e çarshive morën emrin sipas zejeve përkatëse që mbizotëronte në atë pjesë të qytetit, si: Tabahana, Bazhdarhana, Saraçhana, etj.⁴⁵

Krahas dyqaneve, në qytet kishte edhe depo publike për mallra me shumicë, në të cilën grumbulloheshin mallrat që më pastaj shiteshin gradualisht shitësve me pakicë dhe artizanëve. Në oborr apo para depove të tilla, zakonisht qëndronte një peshore shtetërore publike (tur.:kapan), në bazë të së cilës vetë depoja quhej *kapan-han* ose thjesht *kapan*. Nga këto depo dhe peshore, të cilat, zakonisht ishin *hase* të sulltanit, nxirreshin të ardhurat relativisht të larta vjetore. P.sh., vetëm në qytetin e Prizrenit nga *taksa e baxhit* për peshimin e mëndafshit vileshin 150,000 akçe, kurse nga deponimi i mjaltit dhe gjalpfit, nxirreshin të ardhura prej 5,000 akçe.⁴⁶

Në pjesën e qytetit nga ana verilindore nga mesxhidi i Jazixhi (Qatib) Sinanit ekzistonte *Bazhdarhanja* - ndërtesë me karakter ekonomik, emërtim i formuar prej fjalës turke *bacdarhane*, e cila tregon ndërtesën ku bëheshin pagesat e *baxhi* (taksë për tregtinë e brendshme), kantarinës, doganës, dhe taksave tjera në tregtinë e mallrave me shumicë. Ky objekt, zakonisht ishte vendosur në dalje të qytetit, në afërsi të urave, te portat e qytetit dhe të ngjashme, në një zonë mjaft të madhe të mjaftueshme që të mund të akomodonte karvanin e tregtarëve më mall, deri sa të përfundonte procedurën e nevojshme të doganimit. Afër bazhdarhanes, gjegjësisht doganës, gjendeshin edhe depot e mëdha.

Kjo doganë kishte një traditë të gjatë të veprimtarisë së saj, e cila kishte sjellë të ardhura të konsiderueshme që gjatë mesjetës, përkatësisht sundimit nemanjid.⁴⁷ Qiramarrësit e saj, gjatë shek.XIV, ishin raguzanët, kurse për një kohë të caktuar e kishin nën menaxhim edhe familja arbërore e Balshajve.⁴⁸ Edhe pse nuk dihet saktësisht vendodhja e këtij objekti, megjithatë, duke pasur parasysh vendin e kryqëzimit të rrugëve hyrëse nga drejtimi i Prishtinës dhe Shkupit, vendndodhja e doganës në epokën osmane, sipas supozimit të studiueses Katiq, duhet të jetë në hapësirën

⁴⁵ Po aty, 34; Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 478.

⁴⁶ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 34; *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë (gjysma e dytë e shekullit XV – fillim shekulli XVII)*, përg. Dritan Egro, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2012, 326.

⁴⁷ Katić, “Osmanizovanje”, 111-112.

⁴⁸ HR-Državni arhiv u Dubrovniku, *Diversa Cancellariae* vol.XXIV (1375-1376), fol.89r.

kyçe të qytetit, përkatësisht në mes xhamisë Jazixhi (Qatib) Sinanit dhe Bazhdarhanes.⁴⁹

Ndarja e punës në sferën profesionale pati një ndikim pozitiv në zhvillimin e tregut lokal brenda qytetit. Në këtë mënyrë, u paraqit nevoja për nxjerrjen e legjislacionit (kanunnameve) për rregullimin e jetës ekonomike në tregjet lokale. Për Sanxhakun e Prizrenit janë nxjerrë dy dispozita shtetërore: e para u hartua në vitin 1570 dhe e dyta 1583, të cilat rregullonin marrëdhëniet e blerjes dhe shitjes së produkteve bujqësore dhe u bë përcaktimi i taksave, peshave, masave, çmimeve etj.⁵⁰

Zhvillimi i tregut lokal, fuqishëm, ndikoi në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare të Prizrenit, sikundër edhe qyteteve të tjera të Kosovës dhe më gjerë atyre të pjesës evropiane të Perandorisë Osmane. Megjithëse këto marrëdhënie ishin akoma të dobëta për shkak të pamjaftueshmërisë së rrugëve, mund të thuhet se Prizreni që në gjysmën e parë e shek. XVI kishte lidhje ekonomike me qendra të ndryshme të Ballkanit, veçanërisht me Shkodrën dhe Lezhën dhe vendet tjera Ballkanike dhe Evropiane. Fondacioni Kukli Beut, konfirmon se përgjatë rrugëve që lidhnin këto qytete ishin ndërtuan disa karvansaraje.⁵¹ Shkodra ishte një qytet shumë i rëndësishëm për shitblerje me Prizrenit. Një pjesë e tregtisë së Ballkanit me Shqipërinë zhvillohej përmes Prizrenit.⁵²

Mallrat e blera në Kosovë transportoheshin kryesisht në Raguzë, e pastaj në Venedik, Split dhe tregje të vendeve tjera. Por, produktet e Kosovës transportoheshin edhe për në Stamboll, Sarajevë, Risan, Selanik dhe në vendet gjermane.⁵³ Në këtë drejtim, vend me rëndësi zinte pozicioni i Prizrenit në kryqëzimin e rrugëve tregtare për në vendet e Ballkanit dhe ato Perëndimore. Karvanet frekuentonin kryesisht rrugët e brendshme sipas itinerarit Shkodër-Pukë-Prizren-Prishtinë-Prokuplje-Nish-Beograd-Semlin-Budapest-Vjenë-Lajpcig. Rruga Shkodër-Prizren takohej me rrugën Raguzë-Prizren, dhe vazhdonte në lindje drejt qendrave tregtare bullgare si Sofja dhe bigëzohej në drejtimin Provadijë-Varnë dhe Filipol-Adrianopojë-Stamboll. Rruga që lidhte Prizrenin me Shkodrën kishte një drejtim tjetër që vazhdonte drejtë Maqedonisë dhe kryqëzohej

⁴⁹ Po aty, 112.

⁵⁰ Për kanunnamen e sanxhakut të Prizrenit me rrethinë, shiko: Kaleši, "Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname", 289-300; Egro, *Ligji osman*, 122-124.

⁵¹ Kaleši, Redžeb, "Prizrenac Kukli-beg", 161-162.

⁵² Đorđe Mikić, "O Trgovini Kosova i Okolnih Krajeva", *Glasnik Muzeja Kosova*, Serija B, XII (Priština, 1974), 78.

⁵³ Sergije Dimitrijević, *Dubrovački karavani u južnoj Srbiji i XVII veku*, Beograd: SANU, 1958, 173.

me Rugën Egnatia me anë të nyjës Prilep-Veles-Kumanovë, një zonë e pasur me shumë panairë.⁵⁴

Regjistrimet kadastrale të Prizrenit flasin se në gjysmën e dytë të shek.XVI tregtia ishte, kryesisht, në duart e tregtarëve vendas. Megjithatë nuk mungonin edhe tregtarët e huaj, sidomos atyre raguzan, ndonëse jo si gjatë mesjetës, të cilët luanin rolin e tregtarëve ndërmjetësues me vendet tjera. Është e njohur se tregtarët raguzan blinin vetëm kafshë dhe produkte blegtorale nga fshatrat përreth. Raguzanët eksportuan sasi të konsiderueshme të mëndafshit të Prizrenit për në Venedik para dhe gjatë periudhës së sundimit osman.⁵⁵ Kjo provohet edhe nga një shkresë e Stambollit që u dërgua në Prizren, përmes së cilës, Sanxhakbeu i tij urdhërohej që, përveç leshit, të mos eksportohej ndonjë artikull tjetër nga ky qytet. Në urdhëresë theksohej se me gjithë vendimet e organeve të pushtetit turk, në Raguzë nga viset e Perandorisë Osmane, eksportohej dylli, plumbi, saftjani, dhe gjalpi.⁵⁶

Me gjithë përparimin e zejtarisë e të tregtisë, qyteti ende nuk kishte arritur të tërhiqte në sferën prodhuese të mallrave një pjesë të mirë të popullsisë, e cila vazhdonte të lidhej me ekonominë. Kjo bëhet e qartë nga të dhënat e regjistrimeve mbi vjeljen e taksës së të dhjetës së produkteve bujqësore si gruri, elbi, thekra, meli, lini, bari, perimet, vreshtat etj., në vetë qytetin e Prizrenit (shiko: Tabela nr.1 & 2). Këto të dhëna dëshmojnë qartë se ekonomia e qytetit të Prizrenit, si qendër e sanxhakut, ruante ende një karakter gjysmëagrar.⁵⁷ Elementi zejtaro-tregtar i marrë së bashku përbënte shtresën kryesore qytetare, sidomos në Prizren, ku përfshinte 43% të popullsisë, kurse banorët e qyteteve që ishin të lidhur me ekonominë bujqësore përbënin 50-54% të popullsisë, ndonëse në regjistrime nuk jepeshin cilësime për banorët që merreshin me bujqësi, ashtu siç bëhej për zejtarët, funksionarët, etj.⁵⁸

⁵⁴ Alvin Saraçi, *Tregtia e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt XVII dhe XVIII*, Tiranë: QASA, Instituti i Historisë, 2018, 61-62.

⁵⁵ Ruža Čuk, "Izvoz svile iz Dubrovnika u Veneciju u XIV veku", *Istorijski časopis*, br. XXVIII (Beograd, 1981), 17-25.

⁵⁶ Hasan Kaleshi, "Shënime nga e kalumja e Prizrenit gjatë periods turke", *Përparimi*, nr.7-8 (Prishtinë, 1961), 504-505.

⁵⁷ Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 484.

⁵⁸ Po aty, 486.

Tabela nr.1: *Të ardhura nga lagjet myslimane në vetë qytetin e Prizrenit*

Emri i taksës prodhimit	Viti 1571		Viti 1591	
	Pesha/masa	Vlera në akçe	Pesha/masa	Vlera në akçe
Grurë	45 barrë	2250	50 barrë	2500
Elb	22 barrë	528	30 barrë	630
Thekër	17 barrë	612	20 barrë	720
Ujem (përzier)	28 barrë	560	30 barrë	750
Taksa e dynymit të vreshtave të myslimanëve Akseve	Për çdo dynym 4 akçe	500	Për çdo dynym 4 akçe	500
Livadheve/barit	-	420	-	420
E dhjeta e koshereve të bletëve	-	180	-	200
Mullinjtë	17	510	17	510
Livadhi i vakfit të të ndjerit Mehmed beu së bashku me drurët frutorë për çdo vit <i>bedel</i> i së dhjetës	-	100	-	100
Livadhi i Mustafait, i biri i Mehmed beut së bashku me drurët frutorë për çdo vit <i>bedel</i> i së dhjetës	-	60	-	60
Shuma sipas viteve	5720		6380	

Tabela nr. 2: *Të ardhura nga lagjet e krishtera në vetë qytetin e Prizrenit*

Emri i taksës prodhimit	Viti 1571		Viti 1591	
	Pesha/masa	Vlera në akçe	Pesha/masa	Vlera në akçe
Ispenxha	403	9373	287 shtëpi	6986
Grurë	25 barrë	1250	50 barrë	2500
Elb	20 barrë	480	40 barrë	960
Ujem (përzier)	25 barrë	500	50 barrë	1250
Mel	6 barrë	240	10 barrë	400
Grashinë/burxhak	4 barrë	160	10 barrë	400
Musht/shire	151 çubur	4832	276 çubur	8704
Taksa e govatës/kazanit	-	500	-	1200
Livadheve/barit	5 akçe për shtëpi	1305	5 akçe për shtëpi	1210

Kopshti i perimeve	-	522	-	484
Taksa e druve	-	522	-	484
E dhjeta e koshereve të bletëve	-	306	-	500
Nga Monopolja ⁵⁹	-	3500	-	4000
Nga taksa e fuçisë, baxhi i verës	15 akçe për çdo fuçi	2500	10 akçe për çdo	2500
Nga prodhimi i bozës	-	300	-	400
Nga thertorja	1 akçe për çdo 4 kafshë ⁶⁰	1250	1 akçe për çdo 4 kafshë	1300
Mullinjtë	10	300	10	300
Manastiri i Kryengjyve Mëhill dhe Gabriel	Për një vit	50	Për një vit	50
Vlera e kashtës	-	200	-	392
Baxhi i pazarit dhe bidati i derrave	50 akçe në vit	5800	50 akçe në vit	5800
Nga <i>nijabeti</i> ⁶¹ i vetë Prizrenit, taksa e martesës dhe <i>tapisë</i> së tokës dhe të tjera	-	1400	-	2500
Shuma sipas viteve		35290		42320

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 1 dhe 2 mbi të ardhura e përgjithshme nga lagjet myslimane të vetë qytetit të Prizrenit në vitin 1571 ishin 5,720 akçe, kurse në vitin 1591 ishin 6,380 akç. Kurse të ardhurat nga lagjet e krishtera në vitin 1571 ishin 35,290 akçe, kurse në vitin 1591 ishin 42,320 akçe. Shikuar sipas viteve, në regjistrimin e vitit 1571 të ardhurat e përbashkëta të dy lagjeve (myslimane dhe të krishtera) ishin 41,010, kurse në vitin 1591, ato arrinin në 48,700. Sipas lagjeve, del se

⁵⁹ *Monopolja* – e drejta e feudalëve që për një kohë të caktuar, zakonisht dy muaj në vit, të kishin monopolin mbi shitjen e verës ose ndonjë prodhim tjetër të caktuar, pa qenë të pranishme në treg konkurrentët (prodhuesit e fshatit). Spahinjtë kundrejt një shpërblimi hiqnin dorë nga monopoli. Në Sanxhakun e Prizrenit afati për një *monopol* shitjeje ishte dy muaj e dhjetë ditë dhe mund të përdorej dy muaj njëherësh ose, gjysmën në një stinë dhe një muaj në një stinë tjetër. Shitja e monopoleve ishte mjaftë e përhapur në Prizren dhe, si çdo tjetër, ishte subjekt i taksave të caktuara të tregut. Ky shpërblim quhej *taksa e monopolit* ose shkurtimisht *monopolye*. (Egro, *Ligji osman*, 123).

⁶⁰ Është fjala vetëm dele dhe dhi (tur: *davar*).

⁶¹ *Nijabeti*-taksë që vlej në favor të spahinjve nga popullsia, si dënime në të holla për fajë të ndryshme.

nga lagjet e krishtera vilesin shumica e të ardhurave, përkatësisht 86% në raport me ato myslimane me 18% e të ardhurave të përgjithshme.

Roli ekonomik i fondacioneve (vakëfeve)

Krahas vendosjes së institucioneve të shumta, që në fillim të pushtimeve osmane kemi edhe themelimin e vakëfeve të shumta, të njohur si institucion i *vakëfit* (fondacionit) osman. Krahas objekteve fetare, arsimore e kulturore, gjithashtu vakëf dhuruesit, ndërtuan edhe shumë objekte me karakter fitimprurës – ekonomik.⁶² Financimi dhe mirëmbajtja e fondacioneve të lartpërmendura, në shekullin XVI, përbëheshin nga mjete monetare, si dhe pasuri të paluajtshme si karvansaraje, dyqane dhe mullinj, banja, vreshta, pemishte, prona bujqësore dhe livadhe, të cilat gjeneronin të ardhura të shumta. Një pjesë e konsiderueshme e tyre lihej vakëf në para dhe patundshmëri në shërbim shoqëror të përgjithshëm si vepra të përshpirtshme. Meqë, qëllimi i këtij punimi është të nxirren të dhënat vetëm për fundshekullin XVI, andaj do të marrim për bazë ato të dhëna për vakëfet që na i ofrojnë regjistrimet e vitit 1571, dhe të cilat nuk kanë ndonjë ndryshim me ato të vitit 1591, pasi që në tërësi janë përshkruar sikurse në tekstin e defterit të vitit 1571.⁶³

Në mesin e vakëf dhuruesve (donatorëve) më të mëdhenj të shek.XVI, ndër më të njohurit për nga kapacitete ekonomike që ka lënë dallohet Mehmet Kukli beu, vakëfnameja (e përpiluar në vitin 1538) e të cilit është publikuar nga studiuesit Kaleshi dhe Rexhepi.⁶⁴ Ai, ka ndërtuar shumë objekte ekonomike që nga Shkodra, Lezha, Prizreni e Shkupi, dhjetë karvansaraje në rrugën prej Shkodrës gjer në Prizren, një urë mbi lumin Vardar në Shkup, në Prizren tri karvansaraje, mbi 100 dyqane, tri depo të mëdha, etj. Ndërtimi i karvansarajeve dhe dyqaneve të shumta është tregues i zhvillimit ekonomik të qytetit të Prizrenit. Në Prizren, sa i

⁶² Funkcioni ekonomik i vakëfit qëndron në atë se frytet e tij shfrytëzohen ndërsa, objekti apo esenca e vakëfit ruhet, me ç'rast sigurohet një përfitim i përhershëm i vakëfit për qëllimin e destinuar, të përshkruar më parë nga vakëf lënësi. Hasan Kaleshi, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arabskom jeziku*, Priština: Zajednica Naučnih Ustanova Kosova; studije, knj.23, 1972; Idem, "Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke", *Hikmet*, nr.10 (Prishtinë, 2015), 18; Sadik Mehmeti, "Roli i Vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimimit islam në vendin tonë", *Takvim 1430-1431-Kalendar 2009* (Prishtinë, 2009),132-133.

⁶³ Të dhënat për vakëfet e regjistruara në Defterin e Sanxhakut të Prizrenit për vitin 1571, vetëm sa i përkasin qytetit të Prizrenit, i ka përkthyer dhe botuar studiuesja Tataja Katiq. Cfr.: *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 551-556.

⁶⁴ Kaleši, Redžeb, "Prizrenac Kukli-beg", 143-168.

përket objekteve të karakterit socio-ekonomik, Mehmet Kukli beu ka lënë vakëf (donacion) 37 lokale dhe një karvansaraj, po ashtu ka vakëfnuar 10 dyqane midis dy lumenjve, 10 dyqane në hyrje të Çarshisë, dhe 50 dyqane në Tregun e vjetër, tri depo dhe çardakë prapa dyqaneve në Çarshinë e vjetër. Ka vakëfnuar edhe mullirin me dy gurë, karvansarajin me katin përdhes dhe katin e parë, si dhe karvansarajin që e ka ndërtuar në tokën të cilën e kishte blerë nga Ferhat beu dhe Daud vojvoda. Vakëf ka lënë edhe hamamin e ndërtuar në kasabanë Zinovë (Brodosan) të Opojës. Më tutje në Prizren ka lënë vakëf edhe kopshtin në lagjen (mëhallën) e Tabakhanës, një kopsht me pemë e me vresht dhe hardhi nën Atmejdan. Ka lënë donacion edhe mullinj të shumtë, pesë mulli në Çarshinë e vjetër, të cilat njihen si *Mullinj të Pashtroviqëve*, katër mullinj i ka lënë vakëf në lumin Topojan të Lumës (në atë kohë pjesë e Sanxhakut të Prizrenit), katër mullinj në fshatin Rapçë në Gorë. Kukli beu ishte para se gjithash i përkushtuar në ndërtimin e objekteve fitimprurëse, e më pak fetare, edhe konsiderohet meritues për zgjerimin e qendrës tregtare të Prizrenit (sheshi i vjetër dhe çarshia). Njëri nga tri karvansarajet e tij, të përmendura më lartë, gjendej afër mesxhidit të Jakup beut, i dyti ishte në sheshin e vjetër (në Pazar), pranë Lumbardhit, ndërsa i treti kufizohej me një kishë.⁶⁵

Përveç se në Prizren, Mehmet Kukli beu ka lënë vakëfe edhe në pjesët tjera shqiptare, ashtu që ka vakëfnuar karvansarajin me katin përdhes dhe katin në lagjen e Bojaxhinjve në Shkup. Në Lezhë ka lënë vakëf dy karvansaraje dhe 50 dyqane, një çardak me katet përdhese dhe me katet, depon për ruajtjen e sanës dhe kashtës dhe hamamin e ndërtuar. Në Shkodër ka lënë vakëfe, karvansarajin me katin përdhes dhe në kat, karvansarajin me katin përdhes dhe kat në fshatin Makosh në nahijen e Dukagjinit, karvansarajin afër Kalasës së Dukagjinit, karvansarajin në fshatin Klumin, në limanin Vaspas, në fshatin Goden, në fshatin Mamushë, dhe në fshatin Sopotnicë.⁶⁶ Siç shihet nga objektet e përmendura, Mehmet Kukli beu për dallim nga të tjerët përveç objekteve fetare i është përkushtuar ndërtimit të objekteve fitimprurëse dhe është njeri kyç për zgjerimin e qendrës tregtare të Prizrenit, sheshit të vjetër dhe çarshisë së re të Prizrenit.⁶⁷

Në regjistrimin e Defterit të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571, Mehmet beu, del se ishte i vdekur, ndërsa pas vetes ka lënë gruan Hyrijen dhe djemtë e tij, të cilët, sipas Defterit të Sanxhakut të Prizrenit të viteve

⁶⁵ Po aty, 159-161.

⁶⁶ Po aty, 160-161.

⁶⁷ Katić, "Osmanizovanje", 119.

1571 dhe 1591 kishin në dispozicion prona të shumta fshatrat e rrethit të Prizrenit (Vlashnje, Mamushë, Bellacërk dhe Ribnik i Epërm) dhe po ashtu kishin lënë vakëf të ardhurat nga 15 dyqane për mirëmbajtjen e krojeve të qytetit.⁶⁸ Nga regjistri i vakëfeve të defterit të vitit 1571 është regjistruar edhe pjesa e paluajtshme vakëfore e të ndjerit, nga të cilat nxirreshin të ardhura vjetore në shumën prej 73,000 akçe.⁶⁹ Ahmet Beu ka lënë 99 dyqane, 4 mullinj, 2 banjë dyshe (çifte); Hasan Çelebiu në lagjen “*Madhiq*”, ka lënë vakëfe, të cilat kishin një vlerë prej 68,000 akçe, kurse në mesin e patundshmërive kishte nëntë dyqane, mullirin me dy gurë dhe vresht.⁷⁰ Vakëfe tjera me vlerë ekonomike ishin ato të Haxhi Ramadanit më 90,000 akçe, Dervish Çelebisë më 80,000 akçe, Emin Mehmedit me 70,000 akçe dhe ato të Budak Hoxhës dhe Terxhuman Iskenderit me qëllim të mirëmbajtjes dhe rregullimit të ujësjellësit të Prizrenit kishte lënë edhe Kasim Beu.⁷¹

Krahas këtyre ishin edhe një varg qytetarësh prizrenas që kanë lënë vakëfe, sipas viteve të defterëve (regjistrave) në Prizren gjatë fundit të shek. XVI (1571 dhe 1591), në të cilin përveç tatimpaguesve të atëhershëm prizrenas që ishin të obliguar të paguanin taksa të ndryshme administratës vendore dhe qendrore osmane, janë shënuar edhe regjistri i taksave të vjelura nga aktivitetet fitimprurëse të vakëfeve sipas viteve të cekura më lartë. (shiko Tabela 3).

Tabela nr.3: Të ardhurat ekonomike nga vakëfet

Vakëf dhuruesi	Para të gatshme në akçe	Dyqane	Karvansaraje	Mullinj	Shtëpi (hane)	Banja (hamame)	Vreshta	Kopshte (bahce)	Livadhe	Depo	Çifligje
Ahmet beu, nipi i Evrenoz beut	18,700	99	-	4	-	2	-	-	-	-	-
Jakup beu	1,850	5	-	8	-	-	-	-	-	-	-
Shaban Hoxha	-	6	-	-	-	-	-	-	-	-	-

⁶⁸ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 56, 77, 183-184, 240, 243, 552; KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl.14b; Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 514.

⁶⁹ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 551.

⁷⁰ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 57, 551; KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl.15a; Katić, “Osmanizovanje”, 110; Kiel, *Prizren*, 339.

⁷¹ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 53, 552-553, 555.

Hasan (tabaku)	2,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hasanit (emin)	4,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>haxhi</i> Mustafa	2,100	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hyzri <i>çaushi</i>	3,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>zonja</i> Abide	2,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>zonja</i> Nadime	2,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>zonja</i> Sekine (Selime)	1,000	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-
<i>tregtari</i> Mustafa	1,100	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>zonja</i> Ajshe	1,000	5	-	-	1	-	-	-	-	-	-
<i>vojvoda</i> Ferhat	1,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Jazixhi Sinani	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
jeniçeri (<i>haxhi</i>) Sylejmani	1,000	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-
Mevlana (<i>zotëriu ynë</i>) Suziu	-	-	-	3	-	-	-	-	1	-	1
Ahmet bej Dukagjini (<i>veziri i madh</i>)	-	-	-	3	-	-	7	-	3	-	1
Vlera e përgjithshme	931,670	302	12	39	4	6	17	2	4	3	2

Në fund të shek.XVI, numri i përgjithshëm i pasurive të paluajtshme të vakëfnuara (donacioneve) në Prizren, sipas të dhënave të dy regjistrimeve (1571 dhe 1591) ishte: 931,670 akçe para të gatshme, 302 dyqane, 12 karvansaraje, 39 mullinj, 4 shtëpi (hane), 17 vreshta, 6 banje (hamame), 2 kopshte/bahçe, 4 livadh, 3 depo, 2 çifligje dhe pasuri tjera më të vogla. Nuk i kemi të njohur sa ishin të ardhurat njëzet vjet më vonë, pasi defteri i vitit 1591 përmban vetëm përshkrimin e shënimeve të vitit 1571.⁷²

⁷² Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 551; KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl.194a; Katić, “Osmanizovanje”, 108, not.31.

b) *Ekonomia agrare (bujqësia dhe blegtoria në fshatrat e nahijes së Prizrenit)*

Në shekullin e XVI, shumica e popullsisë së sanxhakut të Prizrenit jetonte në fshatra, të cilët ishin edhe prodhuesit kryesorë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale edhe për vetë qytetin. Si e tillë, fshatrat ishin një njësi e madhe prodhimi. Përveç fshatrave ekzistonin edhe njësi më të vogla, si: mezrat, bashtinat, çifligjet, të cilat brenda kufijve të fshatit, funksiononin si njësi më të vogla në kuadër të njësisë së madhe të prodhimit.

Midis dy regjistrimeve të viteve 1571 dhe 1591, vetë nahija e Prizrenit llogaritet të kishte mbi 113 fshatra dhe 11 mezra.⁷³ Disa nga këto ishin mjaftë të mëdha dhe për arsye praktike u ndanë në lagje, kurse disa fshatra tjera kishin popullsi shumë të pakët. Sasia e popullsisë në vendbanimet e caktuara të një fshati, struktura e tokës në të cilën ishin të vendosur, pozita gjeografike (terreni i thyer), ishin disa nga faktorët efektivë që ndikuan në ndarjen e tyre në lagje. Kështu, fshati Korishës, i cili i kishte gjithsej 94 shtëpi dhe bashtina, i kishte 2 lagje të mëdha, Lubizhda 3, Mushtishti 5 lagje, etj.⁷⁴ Kishte edhe raste kur fshati nuk kishte banorë. I tillë ishte fshati i quajtur Suhareka e ulët, e cila, sipas defterit të viti 1571 është rishkruar nga një defter i vjetër me një shtëpi dhe të ardhura vjetore prej 309 akçe, por që me rastin e regjistrimit nuk kishte asnjë banorë. Ndërsa toka e fshatit në fjalë ishte e përzier dhe shkrirë me tokën e Suharekës dhe nuk mund të ndahej, të ardhurat e saj llogariteshin me të ardhurat e Suharekës dhe në defterin e ri (1571) gjithçka ishte regjistruar si një fshat i veçantë.⁷⁵

Në krye të bashkësive prodhuese që hasim më së shumti brenda hapësirës së fshatrave vinin edhe *bashtinat*. Këto, nga shumë anë, u përngjajnë çifligjeve që kishin në posedim myslimanët porse bashtina, e cila nënkupton trashëgiminë dhe është një praktikë paraosmane, që sipas përshkrimit të studiuesit H. Inalçik, ishte një copë toke që mbreti ia dhuronte në mënyrë të përhershme, një personi si shpërblim për ndonjë shërbim të kryer prej këtij të fundit. Këto toka gëzonin statusin e pronës dhe i zoti kishte të drejtën e shitjes, braktisjes ose të tjetërsimit të pronësisë së saj. Gjithashtu, poseduesit e këtyre tokave ishin të çliruar nga

⁷³ Katić, *Prizrenkog sandžaka iz 1571*, 29-30 (lista e fshatrave dhe mezrave).

⁷⁴ Po aty, 34-37; 62-67; KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 5b, 16b, 17b, 46b.

⁷⁵ Katić, *Prizrenkog sandžaka iz 1571*, 74.

angaria dhe pagesa e taksës. Pas marrjes nga osmanët të zonave ku gjendeshin bashtinat, këto u futën brenda sistemit të timarit porse duke u lënë sërish në duart e të njëjtëve posedues.⁷⁶ Në vitet 1571 në periferitë e Prizrenit gjendeshin 439 bashtina, ndërsa në vitin 1591 hasim vetëm në 409 të tilla.⁷⁷ Të gjitha këto nuk ishin në përdorimin e njerëzve të zgjedhur por, një pjesë e tyre posedoheshin edhe prej fshatarësisë. Gjithashtu, nuk ishte e detyrueshme që poseduesi i bashtinës të banonte në fshatin ku gjendej prona e tij. Përveç kësaj, një person mund të kishte në pronësi më shumë se një bashtinë, sikurse një bashtinë mund të posedohej në të njëjtën kohë prej disa pronarëve. Në shumicën e rasteve bashtinat kishin ndërruar pronësi duke u blerë prej popullsisë myslimane. Në këtë kontekst, në vitin 1571 prej 439 bashtinash që kishte këtu, 104 ishin në duart e myslimanëve, ndërsa në vitin 1591 prej 409 bashtinash, 169 posedoheshin prej myslimanëve.⁷⁸

Sa për çifligjet, në vitin 1571 hasim 21 çifligje, ndërsa në vitin 1591 numri i regjistruar konsiston në 36 çifligje.⁷⁹ Ky ndryshim që vërejmë në numrin e çifligjeve duhet të lidhet me faktin e ndarjes së disa çifligjeve dhe me gjallërimin e tokave të shkretuara. Faktit se pronarët e disa bashtinave dhe çifligjeve nuk janë shënuar me popullatën e fshatit porse në pjesën e vjeljes së taksave, tregon se shumica e tyre mund të mos kenë jetuar në fshat dhe se, çifligjet dhe bashtinat që kishin në posedim i administronin dhe i punonin përmes personave të varur prej tyre. Përveç anëtarëve të klasës ushtarake (askerije) hasim edhe persona të tjerë me llagape ashçi (kuzhinier), terzi (rrobaqepës) e borazan që kanë lidhje me profesionet zejtare dhe që produktet e tyre që i tregtonin. Nga ana tjetër, taksat e kullotës dhe ato të dhenve ishin të ulëta, çka tregon se blegtoria në këto anë nuk ishte shumë e zhvilluar. Përveç këtyre taksave të prodhimit që përmendëm, një taksë tjetër e vjelë në këtë kohë ishte edhe ajo e ispenxhes që vilej prej popullsisë jomyslimane dhe taksën e kurorës. Ispenxha që një taksë e cila vilej prej të gjithë popullsisë jomyslimane dhe mbledhej nga shtëpitë dhe beqarët në shifrën e 25 akçeve, ndërsa prej vejushave vileshin nga 6 akçe ispenxhe. Në vitin 1571, shumica e

⁷⁶ Halil Inalcik, *Fatih Devri Uzerinde Tetkikler ve Vesikalar I* (Türk Tarih Kurumu Yayınları XI. Seri III, No.6), Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954, 171.

⁷⁷ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 29-159; KKA. TD. nr. 55, v. 21a, 24a, 28a, *passim*.

⁷⁸ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 36 ("Bashtinat e myslimanëve"); KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 6b; Gülten, "XVI. Yüzyılda Prizren kazası", 193.

⁷⁹ Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 34-157; KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 23a.

përgjithshme e ispenxhes që vilej në Prizren ishte 9373 akçe, ndërsa në vitin 1590 kjo shifër ishte tkurrur në 6986 akçe (shiko: Tabela nr.2).

Ashtu siç kuptohet edhe nga regjistrimet e taksave, në kazanë e Prizrenit nga drithërat më së shumti kultivohej: gruri, meli, thekra, elbi, tërshëra dhe ujemi; nga perimet: qepa, hudhra, spinaqi, bathët, fasulja, thjerrëza, bizelet, bishtajat, dhe perime të tjera; nga pemët: gështenja, arrat, kumbulla, qershitë, mollët; prej prodhimeve industriale liri dhe mëndafshi, etj.⁸⁰ Mund të thuhet se kjo zonë kishte llojshmërinë më të madhe të kulturave bujqësore. Në këtë aspekt, Prizreni dhe përgjithësisht Kosova ishte një hapësirë joshëse që siguronte prodhime strategjike për nevojat e ushtrisë osmane, të qytetarëve dhe eksportin, sidomos për drithin, që si mall esencial konsumi kërkohej gjetiu dhe për të bësheshin edhe përpjekje ushtrimi të monopolit.⁸¹ Këto produkte peshoheshin me peshën e *himl* (barrës) e cila konvertohej në 8 deri në 10 kile të Stambollit.⁸² Përveç grurit (drithërave) këtu prodhoheshin edhe fruta të ndryshme, arra, li, lakër, pjepër, fasule etj.

Në ekonominë bujqësore të shek.XVI dhe të shekujve të mëvonshëm, krahas drithërave të bukës, një vend të rëndësishëm, sipas defterëve osman, zinte kultura e rrushit apo vreshtaria. Në zona të veçanta rrushi kishte një përdorim të gjerë, jo vetëm si frutë i freskët, por edhe për prodhime të tjera si verë, raki, musht (shire), etj. Andaj, vreshtat në të shumtën e rasteve bënin pjesë në kategorinë e *haseve*, gjë që dëshmon se ato jepnin të ardhura të mëdha. Trevat e Prizrenit ishin të pasura me vreshta dhe të njohura për kultivimin dhe përpunimin e rrushit. Kjo del nga regjistrimet kadastrale që japin të dhëna mbi të dhjetën e verës, taksën për mushtin, taksën e govatës/kazanit, taksën e fuçisë së verës etj. Shlyerja e këtyre detyrimeve ndaj administratës osmane dëshmon për zhvillimin e vreshtarisë e në të njëjtën kohë për një traditë të vjetër në kultivimin e

⁸⁰ Adem Handžić, *Oblast Brankovića – Opširni katastarski popis iz 1455. godine (Defter-i mufassal-i vilayet-i Vlk, sene 859)*, Sarajevo: Orijentalni institut, 1972; Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë : Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1974; Pulaha, “Krahinat verilindore”, 185-336; Bogumil Hrabak, “Poljoprivredna proizvodnja Kosova i susednih krajeva sredinom XV veka”, *Glas SANU CCXC, Odeljenje istorijski Nauka* no. I (Beograd 1974), 37-70; Skënder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë: Rilindja, 1982, 90-95; Kaleši, “Jedna prizrenska i dve vučitrnske kanunname”, 289-300.

⁸¹ Bogumil Hrabak, “Dubrovački uvoz žitarica s Kosova i Zapadne makedonije, *Buletini i Muzeut të Kosovës*, nr.X (Prishtinë, 1970), 179.

⁸² Për vlerën e *barrës* si njësi metrologjike peshe, e barabartë me 153,936 kg (himl), shiko kanunnamenë e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1570: Kaleši, “Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname”, 292; Egro, *Ligji osman*, 122-123.

vreshtave, në përpunimin dhe nxjerrjen e nënprodukteve të tij si verë, musht, raki, etj.⁸³ Me interes është fakti se disa fshatra ishin të specializuara për kultivimin e vreshtave dhe konsideroheshin pothuajse fshatra të pastra vreshtarë. Ato gjenden kryesisht në viset kodrinore ku lagështia është më e pakët. Vreshtaria, prodhimi i verës dhe tregtia e verës ishin të përhapura veçanërisht në pjesën jugore të sanxhakut të Prizrenit. Nahija e Hoçës, gjatë periudhës osmane, kishte prodhimin më të madh të verës. Kultivimi dhe përpunimi i vreshtarisë, gjithashtu u rrit në një shkallë të gjerë edhe në nahijen të Prizrenit. Numri i vreshtave u rrit ndjeshëm në gjysmën e dytë të shekullit XVI.⁸⁴ Tregjet më të mëdha të verës, përveç Prizrenit, ishin Hoça dhe Tërgovishta, të cilat konsideroheshin si fshatra thjeshtë vreshtare. Fshatrat e vreshtave me siguri përbëjnë një përqindje ende modeste në raport me numrin e përgjithshëm të vendbanimeve. Vera shitej edhe me pakicë në taverna dhe bujtina në të gjithë sanxhakun e Prizrenit. Sidoqoftë, defterët regjistrojnë taverna (*meyhanes*) vetëm në nahijen e Hoçës, të cilat paguanin 6 akçe në vit (*resm-i meyhâne*).⁸⁵

Në vitin 1571, numri i vreshtave që gjendeshin brenda bashkësive prodhuese ishte 149 dynymë, ndërsa në vitin 1591 kjo hapësirë është përllogaritur në 214 dynymë. Përveç këtyre, në shumë fshatra hasim edhe vreshta të shkatërruara. Në fakt, diferenca prej 65 dynymësh që hasim midis dy regjistrimeve duhet të jetë nga këto vreshta të gjallëruara sërish. Në kanunnamenë e Prizrenit prej një dynymi vresht vilej një taksë prej 4 akçesh. Gjithashtu, çdo shtëpi rajaje që posedonte vreshtë i jepte spahiut edhe një taksë prej 5 akçesh të quajtur govatë (*kazanit*).⁸⁶ Në vitin 1571 taksa e govatës ishte 4240, ndërsa në vitin 1591 shuma në fjalë ishte 4045 akçe. Me sa kuptohet nga shifrat e taksimit, numri i vreshtave duhet të ketë qenë më i madh se numri i atyre të evidentuara. Kjo situatë mund të shpjegohet me aludimin se në regjistra, mund të jenë shënuar vetëm ato

⁸³ Përparime Huta, *Fshati në Sanxhakun e Shkodrës në shekujt XV-XVI (vështrim mbi demografinë dhe ekonominë)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 1990, 86-91.

⁸⁴ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 51b-79a; Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 68-109; I njëti, "The Sancak of Prizren", 131.

⁸⁵ Taverna të regjistruara kishte në fshatrat Hoçë e Madhe, Dubravë, Rahovec, Opterushë dhe Zoçishtë. Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, 166, 168, 173, 178, 181; I njëti, "The Sancak of Prizren", 131, not.98.

⁸⁶ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl. 3b; Kaleši, "Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname", 292; Egro, *Ligji osman*, 123; Gülten, "XVI. Yüzyilda Prizren kazasi", 193.

vreshta që ishin nën posedimin e myslimanëve. Dhe, kjo gjë rezultoi në vërtetë. Në vreshta vërejmë se një pjesë e madhe e rrushit të kultivuar shkonte në prodhimin e *shirës*, ndërsa një pjesë tjetër bëhej verë. Në vitin 1571 për 2374 çuburë shira paguhej një taksë prej 75170 akçesh, që i binte 32 akçe për 1 çuburë *shire*; ndërsa në vitin 1591 për 2546 çuburë shira taksa e dhënë ishte 88940 akçe, përkatësisht rreth 35 akçe për 1 çubur. Gjithashtu, taksa e marrë prej verës në vitin 1571 ishte 3800 akçe, ndërsa në vitin 1591 kjo shumë ishte 3075.⁸⁷

Nga prodhimet agrare industriale fshatrat e Kosovës ishin të njohur për kultivimin dhe prodhimin e lirit dhe mëndafshit. Lirin si bimë industriale përmes pagesës së taksës (të dhjetës së lirit) e gjejmë të kultivuar pothuajse në të gjitha zonat e Kosovës, e në veçanti në Rrafshin e Dukagjinit. Liri dhe konopi, si produkte bujqësor industriale shiteshin, gjithashtu në vendbanimet minerare të cilat ishin konsumatorë të mëdhenj si të ushqimit ashtu edhe të prodhimeve agrare industriale. Zona e Sanxhakut të Prizrenit ishte e njohur për kultivimin, prodhimin dhe eksportimin e mëndafshit. Krimbi i mëndafshit ishte kultivuar që nga shekulli XIV në Prizren, Korishë, Mushtishtë si dhe në rajonin e Pultit në veri të Shqipërisë së sotme.⁸⁸ Është i njohur fakti se raguzanët eksportuan sasi të konsiderueshme të mëndafshit të Prizrenit për në Venedik para dhe gjatë periudhës së sundimit osman.⁸⁹ Për rritjen e krimbit të mëndafshit fshatarët mbillnin pemishte të manit në të cilat rritej krimi i mëndafshit. Sipas regjistrave të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571, fshatrat Korishë dhe Mushtishtë ishin fshatrat e vetme që paguanin taksa për krimbin mëndafshi (*resm-i kokon; resm-i gügöl*), që do të thotë se prodhimi ishte në një shkallë disi më të madhe, se sa në fshatrat tjera. Të ardhurat relativisht të larta vjetore që dilnin po ashtu nga peshimi i mëndafshit (*mîzân-i harîr*) nënkupton për një prodhim dhe tregti të konsiderueshme. Ai shkonte nga 120.000 akçe në gjysmën e parë të shek.XVI në 150.000 akçe në gjysmën e dytë të po këtij shekulli dhe i përkiste *hasit* të sulltanit.⁹⁰ Sipas informacionit nga gjysma e dytë e shekullit XVI, të

⁸⁷ Më gjerësisht, shiko: Katić, *Prizrenskog sandžaka iz 1571*, passim dhe KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, passim.

⁸⁸ S. Mišić, T. Subotin Golubović, *Svetoarhandelovska hrisovulja*, Beograd: Istorijiski institut 2003, 89-91, 94, 99.

⁸⁹ Čuk, "Izvoz svile iz Dubrovnika", 17-25.

⁹⁰ 167 *Numaralı Muhâsebe-i Vilâyet-i Rûm-ili Defteri (937/1530)*, II, Dizin veTıpkıbasım, T.C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Osmanlı Arşivi DaireBaşkanlığı, Yayın nu: 69, Defter-i Hâkânî Dizisi: IX, Ankara 2004, 371; Katić, *Prizrenkog sandžaka iz 1571*, 34, 36, 68; Katić, "Prihodi kadiluka Prizren", 23-25. Në

ardhurat nga shitja e mëndafshit në tregun e Prizrenit ishin 8,000 akçe (të ardhurat nga baxhi i pazarit),⁹¹ dhe kjo përfshihej në të ardhurat e sanxhakbeut.

Përveç bujqësisë, blegtoria ishte një nga format kryesore të ekonomisë fshatare. Nga blegtoria më së shumti rriteshin delet, lopët, derrat, dhitë, buallicat, kuajt dhe gomarët. Bujqësia dhe blegtoria si dy anë të ekonomisë kishin qenë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Nuk kishte fshat thjeshtë bujqësorë ashtu siç nuk kishte edhe fshat thjeshtë blegtoral. Fshatarët merreshin në të njëjtën kohë me të dy degët e ekonomisë – me bujqësi dhe me blegtori, pavarësisht se në disa krahina, njëra prej këtyre degëve mund të ishte më e zhvilluar. Bujqësia dhe blegtoria, pavarësisht nga vendi i veçantë që zinte në vise të caktuara si dy degë të rëndësishme të ekonomisë, ishin ushtruar në të gjitha trevat e Kosovës, edhe pse epërsia i ka takuar në përgjithësi bujqësisë. Të dhënat e defterëve osman nuk japin të dhëna të mjaftueshme për të ardhurat e fshatarit nga ekonomia blegtorale prandaj nuk mund të gjykohet me saktësi për vendin që zinte blegtoria në ekonominë e çdo krahine. Zakonisht, në defterë janë regjistruar disa taksa që lidhen me blegtorinë si, p.sh., bidati i derrave, taksa për kullotën, për kashtën, për barin e korrur, taksa për tregtimin e tyre etj. Megjithatë për blegtorinë mund të gjykohet nga sasia e bagëtive prej të cilave pushteti osman vilte taksën e dhenve.

Përpunimi i lëkurave ishte ngushtësisht i lidhur me çështjen e zhvillimit të blegtorisë. Si zonë malore, sanxhaku i Prizrenit ishte zonë e përshtatshëm për blegtori, dhe veçanërisht për mbarështimin e deleve. Në fermat e deleve punonin pothuajse çdo familje fshatare. Në veçanti, banorët e nahijes së Gorës, Opojës dhe Sharrit kishin tufa të shumta, për shkak të qasjes më të lehtë në kullotat e pasura malore bjeshkëve të Sharrit. Edhe pse të dhënat e sakta na mungojnë, nisur nga shifra e 1300 akçeve që ishte taksa e dhenve, mendohet se kjo taksë që vilej në vitin 1570 ishte 2048 akçe, ndërsa në vitin 1590 kjo shifër arrinte në 3074 akçe.⁹²

dokument, qiramarrësi kryesor i shumicës së këtyre të ardhurave ishte njëfarë Mustafa, i cili mbledhi të ardhurat e tregtisë së mëndafshit, të dyllit dhe fiskës perandorake.

⁹¹ KKA, TD, Defteri i Prizrenit i vitit 1591, no.55, fl.15; Zirojević, “Prizren Şehri”, 2120.

⁹² Hamid Hadžibegić, “Zvanični podaci o stočnom fondu na području Novog Pazara, Trgovišta i Bihora iz 1585. Godine”, *Istorijski Zapisi*, god. XXII, knj. XXVI, Vol. 4 (Titograd 1969), 586-616; Katić, “The Sancak of Prizren”, 129-130; Gülten, “XVI. Yüzyilda Prizren kazasi”, 194.

Derrat si kafshë shtëpiake ishin mjaftë të përhapur dhe rriteshin në numër në gjithë nahijen e Prizrenit. Meqë taksa për derra,⁹³ (bidati i derrave) u takonte të ardhurave të spahiut në defterët osmanë ky lloj takse është e regjistruar rregullisht, andaj edhe shënimet për numrin e derrave janë më të sakta.⁹⁴ Sipas kanunnamesë së sanxhakut të Prizrenit, për derrat që ushqeheshin në formë tufe në natyrë (yabanda) merrej një akçe për çdo dy derra, ndërsa për ato që rriteshin në shtëpi merrej një akçe për derr.⁹⁵ Për nevojat e punimit të tokës, si kafshë transporti dhe lufte rriteshin edhe kuajt dhe gomarët. Megjithatë, kuajt dhe gjedhet, nuk regjistroheshin si lloje të veçanta, andaj edhe nuk figurojnë në regjistrimet e defterëve.

Bletaria po ashtu ishte degë e rëndësishme ekonomike e fshatarësisë. Taksa për koshere (*resm-i küvare*) i takonte spahiut, andaj është regjistruar në vazhdimësi në defterët osman. Kosheret tatimoheshin në para ose në natyrë (1 koshere në 10 koshere), kurse në territorin e Kosovës dhe në zonat fqinje me para. Për një numër kosheresh jo më shumë se dhjetë, merrej taksa në shumën 1 akçe për koshere, e llogaritur si e dhjeta e kosheres. Familjet numëronin 10 apo më shumë koshere. Lartësia e asaj takse nuk varej nga numri shtëpive të vendit ku gjendeshin kosheret, por më tepër nga kushtet natyrore. Duhet të theksohet menjëherë se e dhjeta e bletëve nuk figuron në fshatra thjeshtë vreshtare dhe në tregje.⁹⁶

Si përfundim i asaj që trajtuam më sipër, bazuar në të dhënat që dalin nga defterë e hollësishtëm kadastral të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571 dhe 1591 mund të konkludojmë:

Së pari, nga gjysma e dytë e shek.XVI, Sanxhaku i Prizreni, pas kapërcimit të pasojave të pushtimeve të para osmane, në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Prizrenit një rol të dorës së parë luajti zejtaria, sidomos zejet që ishin të lidhura me kërkesat ushtarake dhe me

⁹³ Kaleši, "Jedna Prizrenska i dve Vučiternske kanunname", 293-294.

⁹⁴ Më gjerësisht për taksën "*bidati i derrave*" shiko: Selami Pulaha, "Krahinat verilindore të Sanxhakut të Dukagjinit – Hassi dhe popullsia e tyre në gjysmën e dytë të shek.XVI", *Gjurmime Albanologjike: seria e shkencave historike*, nr. 2 (Prishtinë, 1972), 211-290.

⁹⁵ Kjo taksë e quajtur *bid'at-i hanazır* ose *bid'at-resmi* ka vijuar në të njëjtat vlera edhe në kanunametë e sanxhaqeve të shek.XVI (Halil Inalxhik, *Regjistrimi i Sanxhakut të Arvanidit i viti 1431*, përkthyer nga Mykerem Janina., Tiranë: ASA-Instituti i Historisë, 2017, LII.); Kaleši, "Jedna Prizrenska i dve Vučiternske kanunname", 293-294; Egro, *Ligji osman*, 124.

⁹⁶ Nicoară Beldiceanu, *Les actes des premiers sultans conservés dans les manuscrits turcs de la Bibliothèque nationale à Paris*, pars II (Règlements miniers 1390-1512), Paris: Mouton, 1964, 220, 200-201, 207; Hrabak, "Poljoprivredna", 59.

përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Krahas zejtarisë në qytetet vazhdoj të zhvillohej edhe bujqësia nga elementë të ndryshëm, sidomos fshatarë-zejtarë, të cilët, përveç bujqësisë, merreshin edhe me zejtari e tregti. Kjo tregon se ekonomia e qytetit të Prizrenit, si qendër e sanxhakut, ruante ende një karakter gjysmëagrar. Stabilizimi ekonomik dhe social ndikoi edhe në stabilizimin dhe rritjen demografike të vendit.

Së dyti, shumëllojshmëria e kulturave bujqësore në fshatrat e Prizrenit, shtrirja e tyre në të gjithë vendin, fakti që kryesisht mbi bujqësinë mbështetej sistemi i timarit, zhvillimi i vreshtarisë dhe i bimëve industriale dhe atyre të luksit, dëshmojnë për një nivel relativisht të lartë të zhvillimit të bujqësisë për kohën, për një vend kryesisht bujqësor me popullsi *sedentare*. Rëndësia që zinin të ardhurat nga vreshtat është një tregues se aty kishte një vreshtari të zhvilluar si shprehje e traditës së jetës urbane. Që në fillimet e shek. XV, përmes të dhënave regjistrimeve kadastrale dokumentohet se popullsia dinte t'i shfrytëzonte kushtet natyrore të vendit, ajo ishte e prirur për rritjen e sipërfaqes së tokave të punueshme. Mbizotërimi i karakterit bujqësor të fshatrave të Sanxhakut të Prizrenit do të duket shumë më qartë gjatë shek.XVI-XVIII. Kjo u vërejt dhe zihej në gojë edhe nga udhëpërshkrues perëndimorë të kësaj kohe, si dhe nga relatorët shqiptarë, të cilët shprehen në mënyrë pozitive për zhvillimin e zejtarisë dhe bujqësisë.

Gjon BERISHA

SUMMARY

ECONOMIC BASIS OF THE PRIZREN SANCAK IN HALF OF THE 16th CENTURY

The *sancak of Prizren* was located in the southern part of the Central Balkans. The edition of detailed cadastral (*mufassal defters*) survey of the sancak of Prizren in 1571 and partly that of 1591 as well as numerous articles published in recent years have contributed to a better understanding of certain areas of the *sancak*, its establishing, economic strength, and more. At the end of the survey book there is a list of Prizren endowments (*vakıfs*). Being on the road that led from the Adriatic Sea to the rich mining areas of Kosovo (via de Zenta), Prizren had become a large commercial center. Most of the residents of Sandcak in Prizren earned their living from their crafts and crafts. Domestic commerce and foreign trade were quite developed. There was trade in domestic goods as well as in imported merchandise.

Exported articles, chiefly were, wool, grain, wood; whereas gold, silver, wax, horses, lead, etc., were forbidden articles for export, because they were needed for the Ottoman military government. According to *Mufassal defter* (the dailed domestay book) of Prizren (1571 and 1591), at this city were about 600 houses. In the economic, social and cultural development of Prizren, craftsmanship has played a key role, especially those related to military requirements and the processing of agricultural and livestock products. From this data on craft practice in Prizren, it appears that this town had about 246 heads of households practicing different crafts. While annual proceeds of inhabitants of Prizren amounted to about 50,000 akçes (aspers). In addition to the handicrafts in the towns, agriculture continued to develop from various elements, especially peasant-craftsmen, who, in addition to agriculture, also engaged in handicrafts and commerce. This shows that the economy of the city of Prizren, as the center of the *sancak*, still maintained a semi-agricultural character. Economic and social stabilization also contributed to the stabilization and demographic growth of the country.

Paulin MARKU

**ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË PERANDORINË OSMANE
DHE REFORMAT E QEVERISË XHONTURKE NË VISET
SHQIPTARE (1908-1912)**

Shpallja e Kushtetutës në vitin 1908 dhe roli i lëvizjes xhonturke

Në fillim të shek. XX në Perandorinë Osmane po rritej numri i kundërshtarëve ndaj politikës së Sulltanit Abdyl Hamiti II. Popujt e kombësive të ndryshme si, turke, arabe, shqiptare, kurdë dhe armenë, i bashkonte urrejtja e përbashkët kundër regjimit hamidian. Fillimisht u krijuan organizata të fshehta me emrin “Bashkim e përparim”¹, e përbërë prej xhonturqve (turqit e rinj). Ato u bashkuan me Shoqërinë “Otomane e Lirisë”, në Kongresin e vitit 1907, nga ku zgjodhën emrin më të përshtatshëm për të dy grupet, “Bashkim e përparim”, i cili do të përfaqësonte Lëvizjen e Turqve të Rinj.² Komiteti synonte që të përfshinte brenda kësaj lëvizjeje, të gjitha lëvizjet nacionaliste për përmbysjen e regjimit. Në një deklaratë të përbashkët delegatët e Kongresit sulmuan despotizmin, kërkonin barazi për të gjithë popujt e Perandorisë; ruajtjen e tërësisë territoriale perandorake; vendosjen e paqes dhe të rendit publik si

¹ Komitetit i Fshehtë “Bashkim e përparim” (“İttihat ve Terakki”) lindi nga lëvizja nacionale-borgjeze xhonturke në vitet ‘80, shek. XIX dhe ishte kundër absolutizmit të Sulltanit Abdyl Hamiti. Pasiu formua në maj të vitit 1889 në Stamboll, Komiteti i Fshehtë “Bashkim e përparim” u sulmua pak vite më vonë nga Sulltani dhe vijuan veprimtarinë kryesisht jashtë vendit. Turqit e rinj formuan shoqëritë e veta dhe nxorën një varg organesh shtypi si dhe hartuan programin e tyre. Për më tepër shih: *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II (Rilindja Kombëtare vitet ‘30 të shek. XIX-1912), Tiranë: “Toena”, 2002, 371-373.

² George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja, Sundimi otoman, Islamizimi dhe shqiptarët, 1874-1913*, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2007, 221-222.

dhe rivendosjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 1876.³ Lëvizja shtriu veprimtarinë edhe në Ballkan, përfshirë viset shqiptare. Turqit e rinj krijuan lidhje me komitetet revolucionare shqiptare dhe përhapnin propagandën e tyre nëpërmjet anëtarëve xhonturq, oficerëve, ushtarëve të huaj dhe shqiptarë. Përfshirja e ushtarakëve në radhët e Komitetit “Bashkim e përparim”, shkaktoi probleme të mëdha për Abdyl Hamitin II. Në verë të vitit 1908, ata refuzuan kërkesën e Stambollit për të marrë pjesë në ekspeditat ndëshkimore.⁴ Gjatë muajit korrik të vitit 1908 trazirat shtoheshin dita-ditës dhe evidentohet se kishte mungesë të madhe të trupave ushtarake për të ndërhyrë. Një ndër faktorët kryesorë që ndikoi në përkeqësimin e situatës ishte mos angazhimi i 18000 ushtarakëve të dërguar për të shtypur kryengritjen në Maqedoni, dhe bashkimi i tyre me kryengritësit. Kryengritjet që shpërthyen në gjysmën e dytë të korrikut të vitit 1908 në Manastir, Serez, Shkup dhe Ferizaj, udhëhiqeshin nga oficerë dhe nga civilë të popullsisë myslimane, të organizuar nga Komiteti “Bashkim e përparim”⁵ Trazirat e ndodhura dhe pamundësia për t’i shtypur ato, vështirësuan pozitat e Abdyl Hamitit.

Një tjetër ngjarje që e rendoi situatën dhe pozitën e sulltanit ishte mbledhja në Ferizaj, më 20 korrik 1908. Nismëtar për organizimin e këtij takimi kishte qenë komandanti i trupave ushtarake në Mitrovicë, Shemsi Pasha, i cili ishte një ndër të besuarit e Abdyl Hamitit II. Ndonëse qëllimi i tij ishte që të organizonte popullatën për të dalë në shesh për të shprehur besnikëri ndaj sulltanit, xhonturqit u përpoqën ta shndërronin atë në një demonstratë për kushtetutën.⁶ Komiteti “Bashkim e përparim” ia arriti qëllimit duke përfutur nga mbledhja e zhvilluar, më 20 korrik 1908, nga ku doli telegrami me 180 firma drejtuar Stambollit, adresuar Jilldizit (Pallati i Sulltanit), vezirit të madh (kryeministrit) dhe Meshihatit (Selisë së Kryesisë Fetare Myslimane në Perandorinë Osmane), të cilët kërkonin shpalljen e Kushtetutës së vitit 1876. Gjithashtu në sarajin perandorak mbërritën disa telegrame nga vilajetet e provincat e Kosovës, Selanikut, Manastirit, po me të njëjtën kërkesë ndaj sulltanit.⁷

³ *Historia e Perandorisë Osmane*, nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: “Dituria”, 2004, 527.

⁴ Peter Bartl, *Myслиmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Tiranë: “Dituria”, 2006, 190.

⁵ *Historia e Perandorisë Osmane*, 534.

⁶ Bartl, *Myслиmanët shqiptarë*, 193.

⁷ Sulejman Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, përktheu dhe pajisi me shënime, Zyber Hasan Bakiu, Tiranë: “GLOBUS R”, 2004, 172-173.

Ndërkohë, ushtria nga ana e saj kërcënonte hapur se do të sulmonte Stambollin, nëse Abdyl Hamiti nuk do të bindej për të shpallur me dekret perandorak rivendosjen e Kushtetutës.⁸

Kërkesat e popullatës nga vise të ndryshme, kërcënimet e ushtrisë drejtuar Stambollit dhe zbrazja e 101 topave në Manastir si shenjë e shpalljes së Kushtetutës, e kushtëzuan Sulltanin që të merrte një vendim imediat dhe të rëndësishëm.⁹ Por, Abdyl Hamiti hezitoi deri në momentin e fundit që të aprovonte rivendosjen e rendit kushtetues të vitit 1876 dhe të njihte legjislacionin e saj, të cilin e detyronte të shpallte zgjedhjet parlamentare. Këto ndryshime kushtetuese i hapnin rrugën një procesi të gjatë reformimi dhe vështirësonte pozitat e sulltanit. Por, në këto rrethana që gjendej Perandoria, Abdyl Hamiti s'kishte rrugë tjetër manovrimi, ndaj ishte i detyruar të pranonte shpalljen e kushtetutës. Xhonturqit shmangnin sulmet e drejtpërdrejta ndaj sulltanit dhe në vend të tij, akuzonin bashkëpunëtorët e ngushtë, si fajtorë kryesorë të gjendjes së vështirë që mbizotëronte në Perandorinë Osmane.¹⁰

Një ditë para se të shpallte aktin kushtetues, Abdyl Hamiti ndërroi kabinetin qeverisës të kryesuar nga veziri i madh, Ferid Pasha (Vlora). Zëvendësimi i tij me Seit Pashën dhe ndryshimet në qeveri, u interpretua se bëheshin për dy arsye kryesore: *së pari*, që sulltani të mos humbiste ndikimin e tij në popujt e ndryshëm të Perandorisë Osmane dhe, *së dyti*, si ndëshkim ndaj Ferid Pashës që nuk arriti të mbante bashkëkombësit shqiptarë besnikë ndaj sulltanit.¹¹ Por, sipas vlerësimit të studiuesit Sulejman Kylçe, shkaku i vërtetë i shkarkimit të Ferid Pashës ishte se ai përkrahte shpalljen e kushtetutës.¹²

Komiteti xhonturk ia arriti qëllimit për rivendosjen e kushtetutës, përfshirë edhe shpalljen e zgjedhjeve parlamentare.¹³ Lajmi u publikua në gazetat e Stambollit, me një njoftimin zyrtar të Perandorisë Osmane, ku pohohej se Abdyl Hamiti kishte vendosur Shpalljen e Kushtetutës*. Ky

⁸ *Historia e Perandorisë Osmane*, f. 534.

⁹ Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, 173.

¹⁰ Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja*, 222.

¹¹ Po aty, 233.

¹² Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, 173.

¹³ Nuray Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë: "Dituria", 2002, f. 213.

*Shpallja e Kushtetutës e vitit 1908 nga Sulltani Abdyl Hamiti, referohet më datën 23 korrikashtu sikur edhe me datën 24 korrik. *Historia e Perandorisë Osmane*, f. 534 pohohet: Më 22 korrik 1908, ai (Abdyl Hamiti) emëroi vezir të madh, Seit Pashën dhe të nesërmen shpalli dekretin perandorak që rivendoste në fuqi Kushtetutën e vitit 1876. *Historia e*

akt pati jehonë të madhe për popujt e Perandorisë Osmane, i cili i hapte rrugën zgjedhjeve, për në Parlamentin e Stambollit si dhe krijimit të një qeverie parlamentare.¹⁴

Kjo ngjarje përbënte një eveniment të rëndësishëm si për turqit ashtu dhe për popujt me kombësitë ndryshme në Perandori, përfshi shqiptarët të cilët besonin në doktrinën e Komitetit “Bashkim e përparim” se s’do të kishte më dallim racash dhe të gjithë do të ishin të barabartë. Shumë njerëz mendonin që me rivendosjen e Kushtetutës, do të plotësoheshin dëshirat e tyre dhe për shtetin osman po agonte një ditë e re.¹⁵ Një pjesë e popullsisë e konceptonte aktin si shpallje të lirisë dhe vetëqeverisjes, si një grupim kombesh nën flamurin e kushtetutës osmane që do të forconte Perandorinë me anë të bashkimit rreth saj të sa më shumë popujve të ndryshëm, si dhe do të garantonte për secilin popull ekzistencën kombëtare.¹⁶

Shqiptarët e mirëpritën rivendosjen e kushtetues me shpresë se do ta fitonin lirinë politike të ëndërruar prej dekadash. Ndërkaq, popullsia e qyteteve të ndryshme, si: Vlora, Kruja, Durrësi, Tirana, Prizreni, Gjakova, Peja etj., sapo u shpall kushtetuta, me nismën e tyre filluan të dëbonin nëpunësit e vjetër të administratës dhe krijuan komisione të ndryshme. Komisionet e ngritura kryenin funksionet e organeve të vetëqeverisjes, pajtimit të gjakeve dhe mbanin rregullin e qetësinë publike.¹⁷ Kjo qasje e shqiptarëve nuk gjente mbështetje nga Porta e Lartë dhe as nuk pëlqej nga xhonturqit. Të dyja palët përpiqeshin që të ruanin vazhdimësinë e qeverisjes, zbatimin e ligjeve dhe mbledhjen e taksave dhe të detyrimeve si dhe sundimin e pandashëm në viset shqiptare. Administrata e pronave perandorake, për të qetësuar popullatën, disponoi uljen e taksave të detyrueshme nga 30 % në 20 %. Reduktimi i taksave u bë për të shmangur trazirat dhe për të mbajtur aktive popullatën në zbatimin administrativ të detyrimeve ndaj qeverisë. Administrata nuk e ushtronte më detyrën si më parë për mbledhjen e taksave dhe zbatimin e urdhrave të Stambollit.

Shqipërisë, Vëllimi II, (vitet e ‘30-ta të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “8 Nëntori”, 1984, 413 pohohet: më 23 korrik 1908 repartet revolucionare të përshëndetura nga popullsia hynë në Selanik, Manastir dhe në qytete të tjera, ku “në emër të ushtrisë dhe të popullit” e shpallën Kushtetutën. Në rrethana kur administrata osmane në Rumeli ishte shthurur dhe ishte përpara rrezikut të një sulmi të asaj ushtri kryengritëse kundër Stambollit, Abdyl Hamiti u detyrua të pranonte natën e 23-24 korrikut 1908 rivendosjen e rendit Kushtetues.

¹⁴ Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, Botim i III, Tiranë: “IDK”, 223.

¹⁵ *Historia e Perandorisë Osmane*, 534.

¹⁶ Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja*, 223.

¹⁷ *Historia e Shqipërisë...*, Vëllimi II, f. 414.

Ata dëboheshin dhe nuk ishin në gjendje të ushtronin plotësisht funksionin dhe të mbronin të drejtat e listave civile me mjete shtrënguese. Shembulli që po ndodhte me nëpunësit në zonat e vilajetit të Janinës, ishte një fenomen në rritje dhe ndikonte në mënyrë infektuese për moszbatimin e urdhrave qeverisëse në krahinat e tjera. Popullata e lidhte Shpalljen e Kushtetutës me idenë e çlirimit nga çdo lloj pagese e detyrimi në favor të shtetit.¹⁸ Për këtë arsye, xhonturqit dërgonin emisarë në zonat problematike për të sqaruar popullatën që kundërshtonte të paguante detyrimet ndaj shtetit, si dhe për të parandaluar kërkesat e tepruara të tyre. Qëllimi i tyre ishte që të sqaronte popullatën për taksat por më kryesorja për ta ishte të bindin popullatën që të paguanin tributin e detyrueshëm dhe të ruhej zbatueshmëria ligjore.¹⁹ Xhonturqit përgatisnin terrenin për ruajtjen e vazhdimësisë së sundimit të ligjit, detyrimeve financiare dhe për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Perandorisë Osmane.

Fushata elektorale dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 1908, në viset shqiptare

Dy javë pasiu rivendos kushtetuta, u shpall lajmi i mirë për të gjithë të dënuarit politikë në Perandorinë Osmane. Më 5 gusht të vitit 1908, me vendim të Këshillit të Posaçëm pranë Portës së Lartë, “shpall amnisti të përgjithshme për të gjithë ata që ishin të burgosur ose të arratisur politikisht.”²⁰ Kjo dispozitë ligjore ju jepte të drejtën që t’i riktheheshin të gjitha të drejtat civile dhe administrative.²¹ Nga kjo amnisti përfituan edhe shqiptarët e larguar politikisht në emigrim. Ndër ta, mund të përmenden, Ismail Qemali, Ibrahim Temo, Dervish Hima etj., të cilët deri atëherë regjimi Hamidian i kishte konsideruar rebelë e tradhtarë.²² Bejlerë dhe agallarë të Vlorës i drejtuan një telegram Ismail Qemalit, ku i kërkonin të rikthehej në vendlindje. Ai e mirëpriti letrën e bashkëkombësve dhe iu përgjigj pozitivisht lajmit nga Brukseli. Ismail Qemali drejtohej me një telegram Xhemil bej Vlorës, të cilin e njoftonte se shumë shpejt do të

¹⁸ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), Vj, 18-5-569, f. 160.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Kaliopi Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: “Shtypshkronja e Re”, 1987, 59.

²¹ *Ismail Qemali (përmbledhje dokumentesh 1888-1919)*, përgatitur për botim nga Teuta Hoxha, Drejtoria e Arkivave të Shtetit, Tiranë: “8 Nëntori”, 1982, 116. Porta e Lartë, Këshilli i Posaçëm, Kopje e vendimit, datë 8 rrexhep 326 (5 gusht 1908), dërguar më 5 gusht 1908.

²² Gawrych, *Gjysmëhëna dhe shqiponja*, 235.

rikthehet në atdhe. Për nder të tij u organizuan festime të ndryshme në këtë sanxhak, të cilët lartësonin virtytet dhe patriotizmin e Ismail Qemalit.

Nëpërmjet propagandës së gjallë kombëtare, ai arriti të fitonte simpatinë e shqiptarëve, ndërkohë ata shprehnin pakënaqësi ndaj kushëririt të tij, ish-vezirit të madh, Ferid Pasha, të cilin e akuzonin për qëndrime antikombëtare.²³ Kjo mbështetje e gjerë do ta shoqëronte gjatë për arsye se përkonte me periudhën zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve për në parlamentin e Stambollit. Zgjedhjet e vitit 1908 ishin shumë të rëndësishme për turqit e rinj, por njëkohësisht dhe për kombësitë e tjera, përfshirë shqiptarët pasi mund të përfaqësoheshin në Parlamentin osman. Xhonturqit e shtrinë fushatën politike parazgjedhore në katër vilajetet me shumicë shqiptare, Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë. Ata i kushtuan vëmendje të veçantë dhe e konsideronin të domosdoshëm bashkëpunimin me shqiptarët, në mënyrë që të siguronin mbështetjen e krerëve me influencë në zona të ndryshme shqiptare.

Fillimisht ata përpiqeshin të njiheshin nga afër me problemet e ankesat e popullatës dhe pastaj nëpërmjet propagandës për të iu kërkuar votën për kandidatët e listës xhonturke. Ata evitonin çdo konfrontim të mundshëm me shqiptarët. Xhonturqit ia arritën qëllimit që të fitonin simpatinë e shumë shqiptarëve, përfshirë dhe banorët e Prizrenit, Gjakovës, Prishtinës e Vuçiternës, të cilët gjendeshin të mbledhur në Ferizaj për të protestuar kundër marrëveshjes së arritur në Reval. Nga njëra anë ftonin shqiptarët që të mbështesnin programin e tyre politik dhe të marrin pjesë në zgjedhje, ndërkohë nga ana tjetër shfrytëzonin çdo mundësi për të penguar daljen e kandidaturave antixhonturke. Krerët shqiptarë ishin të ndarë, disa synonin që nëpërmjet bashkëpunimit politik me xhonturqit të arrinin të fitonin të drejtat e mohuara ndër shekuj, dhe të tjerë që vepronin individualisht pa bashkëpunuar me turqit e rinj. Nexhip Draga kishte ndihmuar në krijimin e një dege të turqve të rinj në Shkup dhe mbështeste vendosjen e një qeverie kushtetuese.²⁴ Po ashtu, Esat Pashë Toptani ishte deklaruar në favor të Komitetit në momentin që kishte shpërthyer Revolucioni Xhonturku.²⁵

²³ *Ismail Qemali (përmbledhje dokumentesh)*, 118. Relacion i konsullit Kraus dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Alois Lexa von Aehrenthal, ku përshkruhet jeta dhe aktiviteti i Ismail Qemalit dhe për ftesën që i kanë dërguar shqiptarët për t'u rikthyer në vendlindje pas shpalljes së Kushtetutës. Vlorë-Berat, më 3 shtator 1908.

²⁴ Gawrych, *Gjysmëdhëna dhe shqiponja*, 231.

²⁵ Ledia Dushku, "Disa të dhëna për Esat Pashë Toptani në fondet e arkivit diplomatik italian (1915-1916)", *Revista Studime historike* 1-2, Tiranë, 2015, 242.

Gjatë propagandës politike, xhonturqit premtuan para shqiptarëve se: do të zbatonin me korrektësi ligjet e kushtetuta perandorake; do të trajtonit me prioritet problemet emergjente të tyre që ishin (largimi i zyrtarëve të korruptuar, respektimi i privilegjeve të vjetra, reduktimi i taksave, sigurinë që do të lejoheshin të mbanin armët e tyre dhe do të çelëshin shkolla shqipe).²⁶

Në zgjedhjet e vitit 1908 xhonturqit nuk diskutonin mazhorancën parlamentare, qëllimi ishte që të nxirrnin sa më shumë deputetë xhonturq, ose së paku të mbështesnin kandidatët që shkonin në linjë politike me “Bashkim e përparim”. E vetmja opozitë e turqve të rinj ishte ajo e liberalëve që përkrahnin Princin Sabaudinin. Partia Liberale Osmane që u formua nga mesi i shtatorit të vitit 1908, ishte e organizuar thuajse vetëm në Stamboll. Programi i saj politik theksonte sidomos barazinë midis myslimanëve dhe jomyslimanëve të Perandorisë si dhe kërkonin decentralizim.²⁷ Kjo parti e formuar vonë, e cila vepronte kryesisht në Stamboll dhe që përkrahej më së shumti nga kombësitë joturke nuk mundi ta kundërshtonte dhe të fitonte kundër xhonturqve të mirorganizuar. Krahas forcave politike, amnistia e gushtit 1908, i kishte hapur rrugën për të bërë fushatë politike dhe për t’u zgjedhur, të gjithë individëve të larguar politikisht, si: Ismail Qemali, Ibrahim Temo, Dervish Hima etj..., që pretendohesh se kishin mbështetjen e shqiptarëve. Ky i fundit u rikthye nga Evropa dhe shkoi në Shkodër, ku u prit nga patriotë shqiptarë. Por, pas pak ditësh nga kthimi i Dervish Himës, komiteti xhonturk kërkoj arrestimin e tij dhe ai u burgos në Shkodër. Arrestimi bëhej për arsye se njëhej për veprime patriotike dhe ishte kundërshtar i xhonturqve.²⁸

Kandidatura e Ismail Qemalit shfaqte rivalitet në elitën politike shqiptare dhe në radhët e Komitetit xhonturk. Këtë e pohonte dhe diplomati austro-hungarez në Vlorë, Kraus i cili shprehej se, tri ditë para se të kthehej në Vlorë Ismail Qemali, ishte kthyer edhe Syrja bej Vlora për qëllime politike. Në relacion thuhej se kthimi i tij në vendlindje ishte që të vinte kandidaturën për deputet kundra kushëririt Ismail Qemal Vlora. Kraus

²⁶ Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtarë shqiptarë (1878-1912)*, Tiranë: “Plejad”, 2000, 312-313.

²⁷ *Historia e Perandorisë Osmane*, 537.

²⁸ Nebi Dervishi, “Veprimtaria e Dervish Himës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, *Albanologji*, Instituti Albanologjik, 1/2010, Prishtinë 2011, 97. Sipas autorit N. Dervishi gazeta të kohës dhe raporte diplomatike flasin për arrestimin e Dervish Himës dhe për veprimtarinë patriotike të tij. Ai u lirua nga burgu pas pesë muajsh arrestime nën presionin e madh të atdhetarëve shqiptarë, ndërkohë që kishin mbaruar zgjedhjet parlamentare të vitit 1908. Për më tepër shih: Dervishi, “Veprimtaria e Dervish Himës”, 97.

pohonte se i rezultonte që S. Vlora po mbillte një frymë ndasie dhe kjo po jepte efekte të shpejta.

Në vazhdim të opinionit rreth kushërinjve Vlora, ai shprehej se Syrjai do të bënte agjitacion kundër Ismail Qemalit në Stamboll dhe të ishte koherent me qarqet qeverisëse, ndërsa Eqremi do ta mbante atë korrent në vazhdimësinë e ngjarjeve.²⁹ Sipas dokumenteve austro-hungareze, Syrja bej Vlora shihej me sy të mirë nga ata, i cili gëzonte dhe mbështetjen e Portës së Lartë për shkak të postit shtetëror që mbante dhe falë marrëdhënieve familjare që i jepej si vëllai i ish Vezirit të Madh, Ferid Pasha.³⁰ Këtë e pohonte dhe konsulli rus nga Janina, në letrën e dërguar ambasadorit rus në Stamboll, ku shprehej, xhonturqit bënin përpjekje për të penguar zgjedhjen e Ismail Qemalit për deputet, në mënyrë që të favorizonin Syrja bej Vlorën.³¹ Austro-hungarezët e shikonin më pranë politikës së tyre, Syrjanë sesa Ismail Qemalin. Kraus njoftonte Vjenën zyrtare se Ismail Qemali është kundërshtar i fortë i politikës vjeneze.³²

Po ashtu, rivalitetet politik kishte midis kandidatëve kushërinjtë familjes Toptani, Esat Pasha dhe Fazil Toptani si dhe krerëve të tjerë të elitës politike shqiptare. Esati inicioi një lëvizjen që të mblidhte sa më shumë nënshkrime në sanxhakun e Vlorës dhe në Veri të Shqipërisë kundra Ismail Qemalit. Kjo iniciativë për të penguar zgjedhjen e Ismail Qemalit ishte e autorizuar dhe nga Pallati Mbretëror, të cilin vazhdonin ta konsideronin një kundërshtar të fortë politik.³³ Por patriotët dhe të gjithë të pakënaqurit me gjendjen që mbizotëronte në viset shqiptare, kishin shpresa të mëdha tek Ismail Qemal Vlora, madje i shtonin prestigjin dhe e bënin më të përmendur në vend. Rritja e këtij popullariteti të Ismail Qemalit shqetësonte Portën e Lartë dhe frikësonte xhonturqit pasi e shikonin si personi që do të përfaqësonte me ide të shquara bashkëkombësit shqiptarë në Parlamentin osman.³⁴ Por fushata e Esatit nuk arriti të pengonte kandidaturën e Ismail Qemalit.

²⁹ AIH, Vj. 18-6-619, NO 48/res, Vlonë, më 30 shtator 1908, 51.

³⁰ Po aty, 52.

³¹ *Ismail Qemali (përmbledhje dokumentesh)*, Nr. 89, f. 124, Kryekonsulli rus në Janinë njoftonte ambasadorit rus në Stamboll për përpjekjet xhonturke për të penguar zgjedhjen e deputetit Ismail Qemalit, më 12 nëntor 1908.

³² Po aty, Nr. 90, f. 124, Telegram i konsullit Kraus dërguar eprorit në Vjenë, ku e njoftonte për qëndrimin e Ismail Qemali ndaj politikës austro-hungareze. Vlorë, më 24 nëntor 1908.

³³ Po aty, 119-120. Relacion i konsullit Kraus dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Aehrenthal, që flet për qëndrimin e Ismail Qemalit. Vlorë, më 26 shtator 1908.

³⁴ Po aty, 119-120.

Përgjatë fushatës elektorale të vitit 1908u vunë në lëvizje dhe krerë të ndryshëm shqiptarë që mbështesnin kandidatët sipas interesave të disa grupimeve politike. Ata nuk patën linjë të përbashkët zgjedhore apo një platformë gjithëpërfshirëse kombëtare. Kjo mungesë organizimi ndikonte negativisht në zgjedhjen e kandidatëve si dhe për të bindur popullsinë që të regjistrohej në zgjedhje. Shqiptarët shfaqeshin skeptikë dhe dyshonin në regjistrimin e listave të popullsisë për disa arsye të ndryshme. Një ndër zonat më problematike shfaqej sanxhaku i Shkodrës. Popullsia refuzoi të shkonte për t'u regjistruar në listat e votimeve, pasi sipas tyre kjo bëhej për t'i detyruar që të paguanin taksat dhe detyrimet ndaj Stambollit si dhe për të kapur personat që kishin detyrim ushtarak.³⁵ Edhe diplomati austro-hungarez, Prohaska nga Prizreni raportonte të njëjtin shqetësim për përpilimin dhe hartimin e listave zgjedhor. Ai pohonte se procesi kryhej me vështirësi të madhe për shkak se popullsia refuzonte të regjistrohej nga frika se këto lista bëheshin për vjelje taksash e rekrutim ushtarak.³⁶ Diplomati Prohaska, shtonte se në sanxhakun e Pejës, meqenëse katolikët nuk mundën të paraqisnin asnjë zgjedhës delegat, nuk ushtruan asnjë ndikim në fushatë.

Në përmbledhje të analizës dërguar Vjenës, Prohaska pohonte: popullsia e atij rajoni konsullor nuk ishte e pjekur për një regjim kushtetues; parlamentin e marrin vetëm si një episod kalimtar dhe për këtë zgjedhjeve nuk iu japin rëndësi si dhe konstatonte që popullata shfaqej mosbesuese ndaj novacioneve xhonturke.³⁷ Krahas vështirësive që hasën komisionarët në regjistrimin e popullsisë për të votuar dhe asaj të mungesës së eksperiencës zgjedhore, faktor tjetër i rëndësishëm ishte ndikimi i xhonturqeve, të cilët ndërhyjnë për të penguar zgjedhjen e deputetëve që ishin kundër linjës politike të partisë “Bashkim e përparim”. Për shkak të këtyre problematikave zgjedhore, pati vonesa në nxjerrjen në kohë të listave të votuesve dhe të deputetëve shqiptarë. Zgjedhjet u zhvilluan në data të ndryshme gjatë muajve nëntor-dhjetor të vitit 1908. Një pjesë e mirë e shqiptarëve mbështeste programin elektorale të partisë “Bashkim e përparim” dhe kandidatët xhonturq. Krahas fitores së thellë të listave xhonturke, u bë e mundur që të hynin në parlament përfaqësues me kombësi të ndryshme,

³⁵ AIH, Vj, 18-5-568, dokument Nr. 38, 156-157, dërguar Ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë nga diplomati austriak në Janinë, Dr. Ranzi për interesin publik të zgjedhjes së deputetëve, Janinë, më 4 tetor 1908.

³⁶ AIH, Vj, 18-8-829, Njoftim i diplomatit austro-hungarez nga Prizreni, Prohaska për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, ku e njoftonte mbi mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe të listave të votimit të vitit 1908, Nr. 179, 12-13, Prizren, më 28 tetor 1908.

³⁷ Po aty.

përfshirë shumë deputetë nga katër vilajetet, Kosovë, Shkodër, Manastir e Janinë.³⁸

Kandidatët për deputetë nga viset shqiptare, kryesisht ishin krerë të njohur dhe disa prej tyre kishin lidhje me njëri-tjetrin, si dhe midis të zgjedhurve gjendeshin disa hoxhallarë. Për lidhjet midis shqiptarëve, referonte dhe diplomati austriak, Kral në njoftimin e tij, dërguar Aehrenthal, i cili pohonte se e kishte vizituar Esat Pashë Toptani para se të nisej për në Stamboll me mandatin e deputetit të sanxhakut të Durrësit* dhe i kishte pohuar se disa prej personaliteteve shqiptare myslimane, që pritej të dilnin deputetë, nuk kishin vetëm miqësi të ngushtë por ishin pak a shumë farefis ose krushqi me familjen Toptani. Ndërsa, për sanxhakun e Shkodrës, Esat Pasha shprehej se për shkak të mungesave në përpilim të listave të zgjedhësve, ndoshta do t'i takojë vetëm një mandat deputeti por shtonte se, deri në atë ditë që zhvilloi takimin me diplomatin Kraus as myslimanët, as katolikët nuk e kishin caktuar kandidatin e tyre.³⁹ Rolin kryesor në zgjedhjet e vitit 1908 e patën xhonturqit dhe për këtë arsye kryesisht u zgjodhën deputetë kandidatë të listës “Bashkim e përparim”, apo ata kandidat të mbështetur nga xhonturqit si dhe ndonjë subjekt politik që gëzonte reputacion në popull. Nga krahinat shqiptare, u zgjodhën 26 deputetë,^{40*} ku vetëm një pjesë e tyre si Ismail Qemali*, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Shahin Kolonja etj., përfaqësonin forcat patriotike shqiptare, të cilët shfaqen hapur kundërshtitë ndaj politikës xhonturke dheu rreshtuan në krahun e

³⁸ *Historia e Perandorisë Osmane, 552-553.*

* Në zgjedhjet e vitit 1908 dolën këto rezultate në sanxhakun e Durrësit, Esati mori 40 vota, 8 vota Fadil pashë Toptanin, ndërsa votat e tjera ishin të shpërndarë. Për më shumë shih: AIH, Vj, 18-6-668, dokument Nr. 59, 36-37.

³⁹ AIH, Vj, 18-3-352, Nr. 103, 89, Njoftim i diplomatit austro-hungarez nga Shkodra, Kral për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, ku e njoftonte mbi përgatitjen për zgjedhje të vitit 1908, Shkodër, më 19 tetor 1908.

⁴⁰ *Historia e Shqipërisë, Vëllimi II, f. 426-427. Po ashtu në Historia e popullit shqiptar, Vëllimi II, 2002, 397.*

*K. Naska shprehet se, midis përfaqësuesve të zgjedhur nga katër anët e Perandorisë Osmane, aty ndodheshin edhe 25 deputet shqiptarë të cilët mbajtën qëndrime të ndryshme, një pjesë mbajtën anën e xhonturqve, ndërsa të tjerë si Ismail Qemalin, Nexhip Dragën, Hasan Prishtinën etj., qëndruan në opozitë dhe u deklaruan kundërshtarë politik. Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, 37.*

*Në zgjedhjet parlamentare të 1908 në sanxhakun Berat-Vlorë dolën këto rezultate: Ismail Qemali Vlora (57 vota), Azis pashë Vlora (52 vota), Ymer pashë Vrioni (33 vota), Nushat be Vrioni (3 vota), Hajredinafëni Cakrani (3 vota). Dy të parët u zgjodhën deputet. Për më tepër shih: AIH, Vj, 18-6-625, Nr. 76, f. 67-69. Vlonë, më 24/11/ 1908.

opozitës parlamentare.⁴¹ Në Parlamentin osman të vitit 1908 nuk pati deputetë përfaqësues katolikë shqiptarë. Gazeta, “La nazione albanese” pohonte se me urdhër të Komitetit “deputetët shqiptarë ishin të gjithë myslimanë, sepse 300000 katolikët nuk kanë përfaqësues të tyre në Parlament”.⁴²

Nisma e qeverisë për zbatimin e reformave në viset shqiptare

Për shkak të vonesave të ndryshme gjatë procesit zgjedhor, parlamenti u hap, më 17 dhjetor 1908. Në fjalën e hapjes në parlament, Abdyl Hamiti ripohonte besnikëri ndaj kushtetutës dhe deklaronte se nuk do të kishte pengesa për zbatimin e saj.⁴³ Turqit e rinj dolën me një mazhorancë të madhe parlamentare dhe kjo e ndihmonte qeverinë për miratimin e reformave në dhomën e deputetëve. Pasi u formua kabineti qeverisës dhe u konsolidua pushteti, xhonturqit u angazhuan për realizimin e një sërë reformash administrative perandorake. Pjesë e projektit reformues të Portës së Lartë ishin dhe viset shqiptare. Reformat fokusoheshin përkatësisht në fusha: administrative; ekonomike me taksa dhe tatime të reja; kthimi i detyrueshëm i shërbimit ushtarak; për çarmatimin e popullsisë me çdo kusht, edhe me forcë; ndjekje policore kundër klubeve e atdhetarëve shqiptarë si dhe reaksioni xhonturk kundër shkollës e shkrimit shqip.⁴⁴

Krahas reformave, xhonturqit përpiqeshin për imponimin e alfabetit turk. Shqiptarët prisnin nga qeveria xhonturke që të jetësonte premtimet elektorale duke shpresuar se do të përmirësonte gjendjen ekonomike e sociale dhe ajo çka konsiderohej primare për të gjithë, ishte të arrinin të fitonin autonominë e Shqipërisë.⁴⁵ Synimi i tyre ishte të përparonte çështja kombëtare. Në këtë periudhë, në skenën politike shqiptare rezultonin dy qasje politike. Klasa e vjetër politike shqiptare që i kishte qëndruar besnik sulltanit dhe nëpërmjet lidhjeve të drejtpërdrejta kishte përfutur shumë nga regjimi i Abdyl Hamidit, e cila u zëvendësua nga një elitë e re intelektuale-nacionaliste shqiptare. Kjo elitë synonte të bashkonte shqiptarët të tri besimeve fetare nën flamurin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, dhe bënte thirrje për reforma në dobi në dobi të gjithë shqiptarëve.⁴⁶

⁴¹ *Historia e Shqipërisë*, Vëllimi II, 426-427. Po ashtu në *Historia e popullit shqiptar*, 397.

⁴² AIH, “La nazione albanese” - viti XV shtator 1911- Nr. 17, f. 15-16.

⁴³ *Historia e Perandorisë Osmane, f.* : Dituria, 2004, 537-538.

⁴⁴ *Historia e popullit shqiptar*, 426.

⁴⁵ Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi* f. 204-205.

⁴⁶ *Ismail Qemali (përmbledhje dokumentesh)*, Nr. 92, f. 126-127, Relacion i konsullit të

Ndërsa, nga krahu tjetër politik, xhonturqit i kishin bërë për vete shqiptarët me zotimin se do të plotësonin kërkesat e tyre, do të jepeshin të drejtat kushtetuese, si dhe do të zhdukej rreziku i kërcënimeve territoriale shqiptare. Pjesë e premtimeve ishte marrja fund e ndërhyrjeve të kontrollit të huaj, të arbitraritetit të administratës osmane, shpëtimi nga taksat dhe detyrimet e tjera të rënda, nga gjyqet e padrejta e të vjetra si dhe do të respektonin privilegjet e vjetra duke iu siguruar edhe lejjimin për të mbajtur armë se do të hapeshin shkolla shqipe dhe premtuan se do të respektonin paprekshmërinë e Sulltanit,...⁴⁷.

Me marrjen e pushtetit, shqiptarët pretendonin në zbatimin e premtimeve që do të përmirësonte jetesën e tyre. Turqit e rinj synonin të realizonin reforma të thella gjatë mandatit të parë parlamentar në të gjithë Perandorinë, përfshirë viset shqiptare. Disa prej iniciativave të Portës së Lartë ishin tepër të ndjeshme dhe preknin drejtpërdrejt sedrën kombëtare në të gjithë viset shqiptare.⁴⁸ Këto, e të tjera nisma xhonturke, shkonin në kundërshtim dhe me çka u ishte premtuar shqiptarëve. Porta e Lartë ishte e vendosur për zbatimin e reformave dhe përfaqësuesit shqiptarë në Parlament kishin dy alternativa: 1) të pranonin iniciativën e qeverisë për reformat, 2) të kundërshtonin reformat në mbrojtje të interesave të bashkëkombësve të tyre. Shumë prej deputetëve shqiptarë zgjodhën të mbanin anën e pushtetit me miratimin hapur apo në heshtje të projekt-reformave (kjo vinte për shkak se mandati i deputetit ishte siguruar nëpërmjet kandidimit apo me mbështetjen xhonturke). Por, kishte dhe prej atyre deputetëve shqiptarë që nuk hezituan të mbronin interesat e bashkëkombësve. Ata kundërshtuan hapur në Parlament reformat e qeverisë në viset shqiptare. Iniciativat e Portës së Lartë nxiti debate të ashpra midis qeverisë dhe deputetëve opozitarë shqiptarë si, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga etj. Ata diskutuan për çështjen e reformave në viset

Manastirit Postlin, dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Aehrenthal, në të cilin tregon për luftën e popullit shqiptar për të mbrojtur të drejtat e veta, si dhe për përgatitjen e atentateve kundër personaliteteve shqiptare, midis tyre edhe Ismail Qemali nga xhonturqit, Manastir, më 7 mars 1909.

⁴⁷ Ethem Çeku, *Shqiptarët nën Perandorinë Osmane 1870-1908*, Prishtinë: Focus Print, 2019, 436.

⁴⁸ *Ismail Qemali (përmbledhje dokumentesh)*, Nr. 92, f. 126-127, Relacion i konsullit të Manastirit, Postlin, dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Aehrenthal, në të cilin tregon për luftën e popullit shqiptar për të mbrojtur të drejtat e veta, si dhe për përgatitjen e atentateve kundër personaliteteve shqiptare, midis tyre edhe Ismail Qemali nga xhonturqit, Manastir, më 7 mars 1909.

shqiptare dhe sollën argumente që kundërshtonin nismën e qeverisë dhe u deklaruan se ishin kundër politikës xhonturke.⁴⁹

Ndër të tjera, ata pohonin se: *së pari*, reformat që po bëni ju janë filluar në një mënyrë të gabuar. Fillimisht, duhet të ishit konsultuar me deputetët që vijnë nga krahinat shqiptare, pasi ata njohin shumë mirë problematikat dhe pastaj të sillnit reformat në Parlament për diskutim e miratim, dhe *së dyti*, Porta e Lartë të tregohej e kujdesshme ndaj nismave që do të aplikojë, për vetë faktin se për dekada me radhë kishte pasur trazira në viset shqiptare. Sa herë që sulltanë të ndryshëm ishin përpjekur që të detyronin shqiptarët për të paguar taksa të plota, të bënin çarmatimin e popullsisë, t'i detyronin të kryenin shërbimin ushtarak, brenda dhe jashtë viseve shqiptare e shumë reforma të tjera.⁵⁰

Po ashtu edhe kur u diskutua çështja e alfabetit dhe zgjedhja e përdorimit të germave (arabe apo latine) për gjuhën shqipe, pati debate të ashpra midis shqiptarëve dhe Portës së Lartë. Sipas pretendimeve të disa përfaqësuesve të qeverisë, duhej të aplikohej alfabeti turko-arab si një zgjidhje e duhur për shqiptarët. Ato e justifikonin propozimin e tyre, me besimin fetar islam pasi shumica e shqiptarëve ishin myslimanë. Madje, ata pretendonin se ky alfabet do të gjente mbështetje të gjerë te krerët dhe në pjesën më të madhe të popullit shqiptar.⁵¹ Ndryshe nga sa pretendonte ky grup osmanësh, futja e alfabetit jo vetëm që nuk u mbështet nga shqiptarët por kjo nismë ngjalli rezistencë dhe u kundërshtua ashpër nga shqiptarët katolikë, të cilët u mbështetën nga shqiptarët myslimanë dhe ortodoksë në një qëndrim të përbashkët pa dallim feje e krahine për zgjedhjen e alfabetit me germa latine për interesa kombëtare për të ardhmen. Krerët politikë shqiptarë mendonin se futja e alfabetit arab në trojet shqiptare, ishte një tentativë e Perandorisë Osmane që synonte shkombëtarizimin e popullit shqiptar.⁵² Qëndrimi i shqiptarëve për çështjen e alfabetit u shfaq qartë dhe në "Kongresin e Alfabetit" në nëntor të vitit 1908, në Manastir, ku morën pjesë përfaqësues nga qendra e klube kombëtare, shoqëritë letrare dhe nga redaksitë e gazetave shqipe. Nga pjesëmarrësit në Kongres u përzgjedhën 32 delegatë, të cilët formuan komisionin⁵³ që do të caktonte alfabetin e

⁴⁹ Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare*, 67.

⁵⁰ AIH, A-IV-10, Carl, Rittervon Sachs, *Historia e tatëpjetës së Turqisë (pjesa që i përket Shqipërisë)*, Wien 1913, 16.

⁵¹ Po aty, f. 17.

⁵² AIH, A-IV-10, Carl, Rittervon Sachs, *Historia e tatëpjetës së Turqisë*, 17-18.

⁵³ Rezultatet e votimeve për komisionin e hartimit të alfabetit ishin: Kryetar i komisionit At. Gjergj Fishta, nënkryetar Mit'hat Frashëri, sekretar Luigj Gurakuqi, Dom Nikoll Kaçorri, Dom Ndre Mjeda, Lef Nosi, Dhimitër Buda, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Bajo

përbashkët për gjuhën shqipe. Vendosija e alfabetit me germa latine shkaktoi pakënaqësi tek xhonturqit. Katolikët e sanxhakut të Shkodrës, në shenjë mirënjohje, i dërguan një letër falënderimi Ismail Qemalit për qëndrimin e tij në mbështetje të shkronjave shqipe, ku veçonin se këto shkronja ishin themeli i përparimit të gjuhës shqipe dhe i qytetërimit të shqiptarëve.⁵⁴

Vendosmëria e Stambollit për zbatimin e reformave dhe reagimi i shqiptarëve në vitin 1909

Ndonëse, turqit e rinj morën pushtetin me moton liri e barazi për të gjithë popujt e Perandorisë dhe nëpërmjet premtimeve të ndryshme, ata shumë shpejt ndryshuan strategji politike. Pasi forcuan pozitat drejtuese dhe përqendruan pushtetin në duart e tyre, hoqën dorë nga lëshimet e propaganduara para se të vinin në pushtet dhe iu kundërvunë gjithnjë e më shumë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ata ndërmorën iniciativa reformuese në fusha të ndryshme si: administrative, në taksa e në detyrimin ushtarak.

Po ashtu, xhonturqit tentuan të drejtojnë popujt e Perandorisë drejt homogjenizimit turko-osman. Mobilizimi i qeverisë për të ripërtërirë Perandorinë nëpërmjet procesit të centralizimit dhe për të vënë në lëvizje programin e osmanizmit, si dhe aplikimi i reformave imponuese duke përdorur forcën e ligjit dhe të dhunës për jetësimin e tyre, shënonte nisjen e kaluarit të gjatë të reagimit të shqiptarëve. Nisma e tyre rezultoi një përpjekje kombëtarizimi e imponuar, krejtësisht jashtë kohës e cila përgjithësisht prodhoi polarizimin e kombësive në të gjitha provincat, ndërkohë që te shqiptarët dhe arabët shkaktoi rebelime të armatosura.⁵⁵ Xhonturqit donin me çdo kusht sundimin e pandashëm të popujve të shtypur. Për shkak të masave shtrënguese dhe të imponimit të reformave me çdo kusht në viset shqiptare, pakënaqësia ndaj autoriteteve xhonturke ishte në rritje. Në seancat parlamentare të vitit 1909 pati debate të vazhdueshme midis kabinetit xhonturk dhe deputetëve opozitar shqiptarë. Shqiptarët hynë në bashkëpunim me përfaqësues të kombësive të tjera në parlament, të cilët edhe ata ishin të interesuar për të fituar të drejta autonomiste dhe zbatimin

Topulli, Nyzhet Vrioni, Akile Eftimi Leonidha Naçi etj. marrë nga libri i Ramiz Abdylit *Lëvizja Kombëtare shqiptare 1908-1910*, Prishtinë: Instituti i Historisë Prishtinë, 2004, 116.

⁵⁴ *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Nevila Nika, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë: "KGT" 2003, 24.

⁵⁵ Egidio Ivetic, *Luftërat ballkanike*, Tiranë: "Dituria", 2008, 35.

e një politike decentralizuese nga ana e Portës së Lartë.⁵⁶

Megjithatë, bashkëpunimi opozitar i deputetëve nga vilajete të ndryshme të Perandorisë nuk ndikoi për ndalimin e nismës xhonturke për zbatimin e reformave. Qeveria i konsideronte të domosdoshme dhe jetike reformat, ndaj shprehej e vendosur në zbatimin e tyre. Krahas kundërshtimeve në parlament, disa krerë shqiptarë organizuan popullsinë për të kundërshtuar zbatimin e reformave në vilajetin e Kosovës. Me ardhjen e pranverës së vitit 1909 situata u përkeqësua si dhe filluan përplasjet midis autoriteteve osmane dhe shqiptarëve. Porta e Lartë reagoi menjëherë dhe urdhëroi Ministrinë e Luftës që të dërgonte përforcime ushtarake dhe të shtypte çdo lëvizje antiqeveritare. Nëpërmjet ndërhyrjes ushtarake, qeveria synonte të vendoste rendin dhe qetësinë, që t'i hapte rrugë zbatimit të reformave. Shqiptarët u përpoqën të rezistojnë, por u thyen nga forcat e shumta ushtarake të mirarmatosura. Gjenerali Xhavit Pasha arriti të shtypte lëvizjet antiqeveritare dhe mori nën kontroll territorin për të vijuar në zbatueshmërinë e reformat e qeverisë.⁵⁷

Kështu, sapo shtypën lëvizjen, autoritet vendore i ftuan krerët shqiptarë të uleshin në bisedime, duke u hequr sikur ato kërkonin të bashkëpunonin me shqiptarët dhe t'i zgjidhnin problemet në mënyrë paqësore. Përfaqësues të qeverisë shkuan, më 26 korrik 1909, në Dibër për të biseduar me shqiptarët. Në përmbajtje të kërkesave të shqiptarëve adresuar Portës së Lartë veçoheshin: ndalimi i dhunës ndaj shqiptarëve; investime nga qeveria në ndërtimin e godinave për shkollat shqipe dhe liri për zgjedhjen e alfabetit të shqipes, pa ndërhyrje apo imponime të autoriteteve vendore e lokale.⁵⁸ Përfaqësuesit e qeverisë premtuan se Stambolli zyrtar do të shqyrtonte me prioritet kërkesat e shqiptarëve, ndërkohë iu kërkuar që të rikthehen në shtëpitë e tyre së bashku me shqiptarët e tjerë që gjendeshin nëpër male. Këto bisedime, u prezantuan në parlament si një sukses i madh i xhonturqve, duke shpresuar se ia arritën qëllimit të rifitonin besimin e besnikërinë e shqiptarëve ndaj Perandorisë Osmane.⁵⁹ Deputetë shqiptarë kundërshtuan propagandën politike në parlament dhe u shprehen se gjendja në vilajetet shqiptare ishte tepër e rënduar dhe se shqiptarët prisnin përmirësime ekonomike-sociale dhe jo premtime retorike. Kjo që bënin xhonturqit ishte sa për të qetësuar situatën, pasi dhuna e forcave ushtarake e drejtuar nga Xhavit Pasha kishte shkaktuar

⁵⁶ Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare*, 67.

⁵⁷ Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: "Toena", 2009, 12.

⁵⁸ AIH, A-IV-10, Carl, Ritter von Sachs, *Historia e tatëpjetës së Turqisë*, 17.

⁵⁹ Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, 12.

mjaft urrejtje ndaj Portës së Lartë. Por, rendi dhe qetësia nuk zgjati shumë kohë në viset shqiptare. Në vjeshtë të vitit 1909 shpërthyen rebelime kundër vjeljes së të dhjetave. Populli i Vuçitërnës, Pejës dhe Lumës refuzuan të paguanin 1/8 të korrave si të dhjetë, për arsyen se më parë ata kishin paguar 1/10.⁶⁰ Për shkak të trazirave, Porta e Lartë ngriti një grup pune me në krye Xhavit Pashën, të cilin konsideronin si një ekspert të çështjeve shqiptare.

Misioni i tyre ishte që të vendosnin rendin dhe qetësinë si dhe të analizonin situatën në terren për të çuar përpara reformat e qeverisë. Komiteti ishte i vendosur që të jetësonte plotësisht programin e qeverisë në viset shqiptare, i cili konsistonte në pagimin e detyrueshëm të taksave të prapambetura; rekrutimin e detyruar ushtarak; marrje e masave të plota për çarmatimin e popullatës për t'i bërë të paaftë për të kundërshtuar si dhe t'i rekrutonte ata me forcë në ushtrinë osmane.⁶¹ Por, shqiptarët vijonin ta konsideronin të padrejtë vendimin e qeverisë dhe e kundërshtuan në forma të ndryshme. Drejtuesve të pushtetit, u mjaftoi preteksti që lumjanët nuk iu bindën urdhrat të autoriteteve për të hyrë në pazar të Prizrenit pa armë dhe Xhavit Pasha e nisi ofensivën e tij ushtarake kundër shqiptarëve. Pas betejës së ashpër dhe me një rezistencë të fortë, komandanti turk u detyrua të rikthehet në Prizren. Ai e justifikoi kthimin e tij me pretekstin e një moti të ftohtë. Por në terrenin e thyer malor, forcat ushtarake u përballën me një grup shqiptarësh të armatosur që iu kundërpërgjigjën ekspeditës së Xhavit Pashës. Turbullirat vazhduan për gati dy muaj në Dibër e në krahinat përreth saj. Qeveria nuk u tërhoq nga vendimi i marrë dhe ishte e vendosur që ta çonte deri në fund nismën reformuese dhe zbatimin e saj. Kështu në nëntor të vitit 1909 miratoi “Ligjin mbi bandat”. Po çfarë ishte ligji mbi bandat, sa ndikonte në zbatimin e reformave për shqiptarët?

Së pari, ky ishte një ligj i rreptë që kishte për qëllim të frikësonte masën që të mos i bashkohej rebelimeve kundër autoriteteve; *së dyti*, masa të rrepta ndëshkuese të ndryshme, ndaj të gjithë atyre që nuk i bindeshin urdhrave të Portës së Lartë. Sipas ligjit, ai që mbante armë dënohej me 6 muaj burg; kush merrte pjesë në banda dënohej me 10 vjet burg; prijësit dhe organizatorët dënoheshin me vdekje si dhe nëse një person merrte pjesë në çeta kryengritëse, dënimin do ta pësonte e gjithë familja dhe pasuria do t'i konfiskohej.⁶² Ligji mbi shoqatat ndalonte veprimtarinë e të gjitha

⁶⁰ Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptarë*, 358.

⁶¹ *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, 404-405.

⁶² Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptarë*, 358-359.

shoqatave që kishin karakter kombëtar ishte një tjetër nismë që shtonte të pakënaqurit ndaj Portës së Lartë dhe nxiste ndjenjat Kombëtare Shqiptare.⁶³

Qëndrimi i shqiptarëve ndaj Portës së Lartë për zbatimin e reformave në vitin 1910

Në fillim të vitit 1910 situata politike midis xhonturqve dhe opozitarëve shqiptarë shoqërohej me debate të ashpra dhe me përplasjet të vazhdueshme. Kjo vinte si rrjedhojë e ushtrimit të dhunës nga qeveria në vjeljen e taksave e tatimeve, në mbledhjen e armëve e municioneve dhe në rekrutimin e shqiptarëve. Shqiptarët brenda dhe jashtë Parlamentit kundërshtnin zbatimin e reformave në vilajetet shqiptare. Situata më e tensionuar midis autoriteteve vendore dhe popullatës shfaqej në pjesën verilindore të Shqipërisë. Në muajin mars të vitit 1910 disa grupe të armatosura nga Kosova u vunë në lëvizje në drejtim të Prishtinës. Rebelimet kryengritëse filluan si një protestë e armatosur kundër taksave të larta, por deputetët opozitarë shqiptarë bënë përpjekjet për ta lidhur me kërkesën themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sigurimin e autonomisë administrative të Shqipërisë.⁶⁴

Shqiptarët u hodhën në kryengritje në Kosovë. Betejat u përshkallëzua gjatë pranverës së 1910 dhe për pasojë shqiptarët u përballen me forca të shumta ushtarake, të vendosura me çdo kusht për të shtypur çdo lëvizje antiqeveritare. Krerët shqiptarë të organizuar në çeta u përpoqën që kryengritja të zgjerohej sa më shumë. Ata synonin që të detyronin Portën e Lartë të tërhiqej nga veprimet e saj të dhunshme në vjeljen e taksave e tatimeve, në mbledhjen e armëve e municioneve dhe në rekrutimin e shqiptarëve. Autoritetet më të larta në Stamboll ishin të shqetësuar për ngjarjet që ndodhnin në Kosovë. Për këtë arsye, Sulltani Mehmet Reshadi, nxori *Iraden* për shpalljen e shtetrrëhimit në sanxhakun Prishtinës dhe të Pejës. Me këtë dekret perandorak, sulltani shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në zonën e kryengritjes; urdhëroi që të shpërndaheshin forcat kryengritëse; arrestimin e krerëve organizatorë dhe nxjerrjen e tyre para gjykatës ushtarake; regjistrimin e popullsisë dhe të pasurisë së patundshme; po ashtu urdhëroi të respektohet shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe të mblidhen me çdo kusht taksat.⁶⁵ Sulltani e mbyllte *Iraden* duke u shprehur se pushteti do të kishte konsiderata ndaj atyre që iu

⁶³ Nika, *Përmbledhje dokumentesh*, 5.

⁶⁴ Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, 77.

⁶⁵ *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, f. 427.

bashkuan kryengritjes nga padija por të deklaronin se do t'i bindeshin pushtetit.⁶⁶ Nexhip Draga e quante të padrejtë dhe dënonte vendimin e Portës së Lartë. Sipas tij, shpallja e shtetrrëthimit në Pejë për shkak të vrasjes së dy ushtarëve shërbente si pretekst për të marrë atë vendim të padrejtë, pasi nuk mund të dënohet mbarë popullsia për një akt të kryer nga disa individë.

Për shkak të rezistencës së vazhdueshme të shqiptarëve dhe mosbindjes së tyre ndaj autoriteteve, qeveria vendosi që të merreshin masa më të rrepta ushtarake. Në mbledhjen e 7 prillit 1910, u vendos që të mobilizonte rreth 36-40 batalione këmbësorie, gjashtë bateri të artilerisë malore dhe gjashtë fushore për të shtypur kryengritjen shqiptare. Ajo urdhëronte Ministrinë e Luftës që të organizonte menjëherë ekspeditën ndëshkimore me në krye gjeneralin Shefqet Turgut pasha. Por, Porta e Lartë u përball me reagimin e menjëhershëm të disa deputetëve shqiptarë. Ata kundërshtuan nismën ushtarake, duke akuzuar qeverinë për shkelje të drejtave kushtetuese dhe për mos mbajtje të premtimeve, të cilët justifikonin ankesat dhe reagimin e shqiptarëve të drejtë. Për këto arsye, më 9 prill 1910, trembëdhjetë deputetë shqiptarë i paraqiten Parlamentit një relacion ku përshkruanin gjendjen e rënduar në zonat që ata përfaqësonin.

Sipas tyre, kjo vinte si rrjedhojë e politikës nacionaliste që zbatonte Komiteti "Bashkim e përparim". Deputetët Ismail Qemali, Myfit Libohova, Nexhip Draga, Hasan Prishtina etj., sollën prova që faktonin se ngjarjet e ndodhura në Kosovë u shkaktuan si pasojë e keqadministrimit të vendit nga sjelljet arbitrare të nëpunësve vendorë dhe nga karakteri anadollak e anakronik që vijonte të aplikonte qeveria xhonturke ndaj popullsisë shqiptare.⁶⁷ Por, natyrshëm qeveria i hodhi poshtë akuzat e shqiptarëve. Ajo akuzonte deputetët shqiptarë se ishin përkrahës të kryengritjes dhe se kishin qenë në lidhje të fshehta me kryengritësit për të nxitur konflikte politike.⁶⁸ Deputetët shqiptarë, ngritën vazhdimisht shqetësimin e bashkëkombësve të tyre duke sjellë prova në Parlament për të shpjeguar se çështja e revoltave të popullsisë së vilajetit të Kosovës ishin të drejta. Ismail Qemali akuzonte qeverinë se ajo po u mohonte të drejtat kushtetuese dhe se po cenonte të drejtat e shqiptarëve të siguruara me luftë.

⁶⁶ Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Tiranë, Shtëpia botuese, "8 Nëntori" 1982, 93.

⁶⁷ *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, 426-428 po aty shih dhe Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, 78.

⁶⁸ Jusuf Bajraktari, "Kryengritja antiosmane e vitit 1910 në Kosovë", *Albanologji*, Instituti Albanologjik, 1/2010, (Prishtinë 2011), 34.

Në fjalimin e tij në Parlament shprehej, se nuk janë gegët që nuk po mbanin fjalën, por janë xhonturqit që nuk zbatonin premtimet. Në mbështetje të qëndrimit të tij, u paraqitën disa deputetë të tjerë shqiptarë, si: Hasan Prishtina, Myfid Beu, Nexhip bej Draga, Fuat Pasha.⁶⁹ Një tjetër pikë që shoqërohej me debate të forta gjatë seancave parlamentare ishte ajo e alfabetit. Hasan Prishtina i kërkonte me këmbëngulje ministrit të Brendshëm, Talat Beu që nëpunësve të qeverisë t'u ndalohej ndërhyrja në çështjen e alfabetit.⁷⁰ Seanca u shoqërua me debate të ashpra, ku pati akuza dhe kundërakuzat midis kabinetit qeverisës dhe shqiptarëve. Por edhe pse deputetët shqiptarë, me në krye Ismail Qemalin protestuan në mbështetje të interesave të bashkëkombësve, përpjekjet e tyre rezultuan të pasuksesshme.⁷¹

Pavarësisht kundërshtimeve të vazhdueshme brenda dhe jashtë parlamentit, Porta e Lartë nuk pranonte të anulonte dërgimin e ekspeditës ndëshkimore dhe të komisionit hetimor. Ajo ishte e vendosur që: të shtypte çdo lëvizjeje anti xhonturke; të vendoste plotësisht rendin dhe qetësinë publike si dhe të zbatonte të gjitha iniciativat reformuese perandorake. Qeveria vendosi që fillimisht të shkatërronte çdo lëvizje kryengritëse, për t'i hapur rrugën realizimit të projekteve politike. Kabineti urdhëronte Ministrinë e Luftës që të angazhohej menjëherë për zbatimin e urdhrit të saj.

Ekspedita ndëshkimore, e udhëhequr nga gjenerali Shefqet Turgut pasha do të nisej menjëherë për në verilindje të Shqipërisë. Me të mbërritur në viset shqiptare, ushtria u përball me beteja të ashpra. Forcat e dërguara nga Stambolli ishin të shumta në numër dhe të armatosura mirë. Shqiptarët përpiqeshin të rezistonin me ato pak armë e municione që kishin, por e patën të pamundur të përballonin ekspeditën ushtarake. Lëvizja e armatosure shqiptarëve dhe të zonave të tjera përreth që shkuan në ndihmë rezultoi e fortë, por Shefqet Turgut pasha arriti të shtypte kryengritjen në Kosovë dhe më 24 korrik 1910, hyri në Shkodër. Krahas shtypjes së kryengritjes ekspedita angazhohej që të zbatonte aplikimin e reformave. Deputetë shqiptarë akuzuan Portën e Lartë se i sulmoi padrejtësisht dhe ndërhyrja e ekspeditës ndëshkimore nuk ishte për të vendosur rend dhe qetësi por për jetësimin e reformës xhonturke. Ata i bënë thirrje Portës së Lartë që të merreshin masa si dhe i kërkuan shpjegime kryeministrit për veprimet e dhunshme që kishin kryer trupat osmane në dëm të shqiptarëve.⁷²

⁶⁹ Qemali, *Përmbledhje dokumentesh*, 144-145.

⁷⁰ Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, 82.

⁷¹ Ivetic, *Luftërat ballkanike*, 51.

⁷² Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, 77-78.

Shqiptarët përpiqeshin të bindnin qeverinë se veprimet e dhunshme për imponimin e reformave ishin të padrejta dhe këto i faktonin nëpërmjet provave para parlamentit. Krahës, parlamentit, vunë në dijeni dhe diplomacitë e huaja për pakënaqësitë e shqiptarëve. Por midis Fuqive të Mëdha, më të interesuarat për çështjen shqiptare shfaqeshin Austro-Hungaria dhe Italia. Ndonëse kishin qëllime të kundërta me ato të Stambollit, ata mbështetnin veprimet e Portës së Lartë për shtypjen e lëvizjes në Kosovë dhe vazhdonin të ndiqnin politikën e ruajtjes së *status quo*-së në Ballkan me qëllim që të vendosnin sa më shpejt rendin dhe qetësinë.⁷³ Diplomatat e Vjenës këshillonin Portën e Lartë të tregojë tolerante me shqiptarët dhe të shikonte me përparësi çështjen e tyre.

Përplasja shqiptaro-xhonturke brenda dhe jashtë Parlamentit në vitin 1911

Debatet parlamentare ndaj çështjes shqiptare ishin bërë të udhës midis qeverisë dhe opozitës shqiptare. Kjo evidentohet dhe gjatë vitit 1911 në rastet kur reformat shkonin kundër interesave të shqiptarëve apo implementimi i tyre kryhej forcërisht në viset shqiptare. Në pranverë të vitit 1911, shqiptarët e sanxhakut të Shkodrës i kundërshtuan urdhrat e Portës së Lartë. Ata u ngritën kundër autoriteteve vendore me rebelime sporadike dhe në një hark kohor të shkurtër krahina e Mbishkodrës arriti të organizonte popullatën dhe në gjysmën e dytë të marsit 1911 shpërtheu kryengritja antixhonturke. Betejat qenë të vazhdueshme dhe të përgjakshme dhe me shumë dëme materiale e ekonomike në sanxhakun e Shkodrës.

Ndonëse vijonin luftimet, më 23 qershor 1911 disa krerë shqiptarë u mblodhën në Greçe të Malësisë së Madhe⁷⁴ për të marrë një vendim të përbashkët ndaj Portës së Lartë. Kuvendi miratoi kërkesat e tyre, në memorandumin me 12 pika në “Librin e Kuq”, të hartuara me ndihmën e Ismail Qemalit dhe Luigj Gurakuqit. Nëpërmjet ambasadorit osman në Mal të Zi, Sadedin Beut i dërguan një kopje të memorandumit Perandorisë Osmane. Po ashtu, disa krerë shqiptarë, si: Luigj Gurakuqi, Ded Gjo Luli, Sokol Baci etj., i dërguan nga një kopje të memorandumit diplomacive të huaja në Cetinë dhe Malit të Zi.⁷⁵ Libri i Kuq pati rëndësi të veçantë për

⁷³ Po aty, 81.

⁷⁴ Për më tepër shih: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Tiranë, 2017, 104.

⁷⁵ Sokol Gjermëni, *Kryengritja shqiptare e vitit 1911 në optikën e diplomacisë evropiane dhe ballkanike*, Tiranë: “Toena”, 2011, 44-46; Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë*, 121-122.

shqiptarët për tri motive kryesore: *së pari*, memorandum i ngjalli reagime në Stamboll dhe kërkesa e tyre u trajtua me përparësi në Portën e Lartë; *së dyti*, shënonte një moment të rëndësishëm për të ardhmen e shqiptarëve pasi hynte në linjën e kërkesave me karakter kombëtar; dhe; *së treti*, diplomacitë e huaja u njohën me kërkesat e shqiptarëve të paraqitura me shkrim.

Stambolli mori zyrtarisht kërkesat e shqiptarëve dhe shprehej se iu njihte atyre disa prej kërkesave. Por, veziri i madh, Haki Pasha, u kishte premtuar se të gjitha pikat e paraqitura në memorandum do t'i prezantonte para Parlamentit osman për diskutime.⁷⁶ Ndërkohë që me ndërhyrjen edhe të Malit të Zi, më 2 gusht 1911, u arrit të firmosej marrëveshja e reduktuar në interes të qeverisë xhonturke. Kështu, më 4 gusht 1911, Sadedin Beu dorëzoi nga një kopje të marrëveshjes, qeverisë malazeze dhe përfaqësuesve të kancelarive të huaja në Cetinë.⁷⁷ Rëndësia e kryengritjes së 1911 ishte se ndryshe nga ajo e vitit 1910 në Kosovë që nuk u finalizua me një program të posaçëm dhe ngeli në suazën krahinore,⁷⁸ kryengritja e Mbishkodrës doli me një program të caktuar ku parashtroheshin kërkesa me përmbajtje gjithëpërfshirëse për të gjithë shqiptarët.

Malësorët që u rikthyen në shtëpitë e tyre u gjenden përballë vështirësive të mëdha ekonomike-sociale për shkak të luftës. Kur malësorët kërkonin nga autoritete vendore zbatimin e marrëveshjes, iu thuhej se duhet të prisnin. Në ato raste që kishte këmbëngulje e presion të vazhdueshëm të popullatës ndaj autoriteteve lokale, mund të zbatoheshin ndonjë pikë e marrëveshjes. Ndërkohë nga ana tjetër, Porta e Lartë dërgonte përforsime ushtarake për të qenë vigjilente në viset shqiptare. Këtë e pohonte dhe gazeta "Times" ku shkruante se, njëkohësisht me këtë marrëveshje u përgatiten dhe forcat ushtarake pa ndërprerje. Në krye të tyre gjendej kryekomandanti Abdullah pasha, me një shtatmadhori të zgjedhur, pjesë e së cilës dhe gjenerali Xhavit pasha që së shpejti pritej të shkojnë në Shkodër.⁷⁹ Po ashtu, ngre dyshime për sa i përket paqes së qëndrueshme midis qeverisë dhe malësorëve ku shprehej: "Nëse qeveria osmane beson se paqja është e mundur dhe nëse dëshiron të lehtësojë kthimin e të arratisurve, fakti i dërgimit të trupave, topave e materialeve luftarake në

⁷⁶ Gjergj Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë e vitit 1911*, New York: Gjonlekaj Publishing Co, 2004, 295.

⁷⁷ Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë*, 149.

⁷⁸ Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, 134-135.

⁷⁹ AIH, "La nazione albanese" - viti XV shtator 1911- Nr. 17, f. 17.

Shqipërinë e Veriut, së paku është një gjë e çuditshme”.⁸⁰ Gjendja e rënduar vinte si pasojë e kushteve të vështira në viset shqiptare.

Porta e Lartë hezitonte për zbatimin e pikave të nënshkruara edhe për shkak të vështirësive që përjetonte vendi në dy skajet e Perandorisë Osmane që i shkaktuan një seri krizash politike xhonturqve. Nga njëra anë, ishte Italia që i hapi luftë shtetit osman më 29 shtator 1911 dhe vuri dorë mbi Tripolin, nga ana tjetër ishin rebelimet e brendshme të popujve të pakënaqur me qeverisjen e turqve të rinj. Si rrjedhojë e ngjarjeve të kohës, në qeveri ndodhën ndryshime që nisen me zëvendësimin e vezirit të madh (kryeministri i atëhershëm) Ibrahim Pasha që ia la vendin Seit Pashës dhe të tjera ndryshime në kabinet.⁸¹ Këto ndryshime në qeveri nuk i shuan, përkundrazi e shtuan grupin opozitar në parlament. Të pakënaqurit nga qeverisja xhonturke, u organizuan për të mbledhur në një grupim të përbashkët politik deputetë me kombësi të ndryshme, përfshi edhe shqiptarët dhe për të dalë në një parti të re. Kësaj lëvizje iu bashkuan deputetë të popujve të ndryshëm të Perandorisë, si: shqiptarë, maqedonas, grekë, arabë, armenë etj.,⁸² për shkak se nuk po duronin më pushtetin e centralizuar dhe regjimin xhonturk. Rritja e opozitës parlamentare gjente mbështetjen e deputetëve me kombësi të ndryshme si dheu përkrah nga disa deputetë osmanë.⁸³ Kjo opozitë parlamentare, e krijuar në dhomën e deputetëve në nëntor të vitit 1911, e cila njihej me emrin “Liri e Marrëveshje”* hapi frontin heterogjen antixhonturk dhe arriti të grumbullonte në pak kohë shumë të pakënaqur.

Lëvizja drejtohej nga Ferid Pashë Damati, Qamil Pasha dhe Sabaudini dhe shfaqej gjithnjë e më e ashpër në Parlament ndaj komitetit xhonturk. “Liri e Marrëveshje” kritikonte ashpër centralizimin e pushtetit xhonturk; zgjatjen e gjendjes së shtettrrethimit; përdorimin e dhunës nëpër popuj të ndryshëm brenda perandorisë dhe akuzonte qeverinë si oligarki dhe jo të ndershme.⁸⁴ Gjithashtu, opozita kritikonte xhonturqit për paaftësi qeverisëse dhe për dëmet e pësura në luftë me Italinë. Me anë të programit politik, partia “Liri e Marrëveshje” kërkonte decentralizimin e administratës, njohjen e të drejtave kushtetuese për të gjithë popujt e

⁸⁰ Po aty, 17.

⁸¹ *Historia e Perandorisë Osmane*, 557.

⁸² Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912, Libri 2*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2004, 180.

⁸³ K. Naska, *Ismail Qemali në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare...*, f. 67.

*“Liri e Marrëveshje” (Hyrriyet ve Ittilaf)

⁸⁴ *Historia e Perandorisë Osmane*, 557.

Perandorisë Osmane si dhe kritikonte autoritetet për përdorimin e dhunës.⁸⁵

Në këtë mënyrë synonte të zgjeronte opozitën parlamentare për një përfshirje sa më të gjerë në platformën politike, që nëpërmjet tyre, të fitonte besim e popujve që përfaqësonin në zgjedhjet e ardhshme. Ajo arriti të fitonte simpatinë edhe në radhët e anëtarëve të Xhemijetit. Për shkak se kriza në qeveri ishte thelluar dhe ajo ishte gjithnjë në rritje, seancat parlamentare zhvilloheshin me debate të ashpra. Në fund të vitit 1911, një grup deputetësh shqiptarë, me në krye Ismail Qemali, Hasan Prishtina etj., i paraqitën një kërkesë për të diskutuar në Parlament posaçërisht për reformat dhe për gjendjen në viset shqiptare. Qeveria refuzonte që të diskutonte për pasojat e reformës në vilajetet me popullsi kryesisht shqiptare, çka acaroi shqiptarët dhe hapi debate të ashpra mes dy palëve.⁸⁶ Në seancën parlamentare të datës 11 janar 1912, të Parlamentit osman, fjalën e mori deputeti Hasan Prishtina, i cili shprehej se fliste në emrin e tij dhe të gjithë shqiptarëve që dëshironin të drejta sovrane. Ai hodhi akuza të ndryshme ndaj qeverisë që fokusoheshin në fushën politike, ekonomike e sociale-kulturore. Hasan Prishtina shprehej se: “Mjerisht, në këtë vendin tonë shpërdorimi i pushtetit është bërë një gjë e zakonshme, prandaj ndodhemi para një problemi të rëndësishëm, kësaj detyre, sado e vështirë qoftë, ne duhet t’i kushtojmë vëmendjen e duhur”.⁸⁷

Hasan Prishtina bënte akuza ndaj shtetit osman, ku sipas tij, nuk ishte gjë tjetër veçse një shoqëri anonime me interesa të përbashkëta dhe u vinte në dukje xhonturqve se vendin po e rrokullisnin drejt një gremine. Ai u bënte thirrje deputetëve në parlament që nëse e konsideronin veten ndryshe le të bashkoheshin me qëndrimin e tij.⁸⁸ Por, natyrisht fjalimi i tij u kundërshtua po ashtu me tone të ashpra nga deputetët që mbështesnin qeverinë xhonturke. Kryetari i seancës, Ahmet Riza beu, i kërkoi deputetit H. Prishtina, që të linte të tjerët në punën e vet dhe të mos hapte debate të tilla. Por, Hasan Prishtina e rimori fjalën dhe vazhdonte të fajësonte qeverinë për të gjitha veprimet e dhunshme ku e akuzonte atë se kishte disa njerëz që e hiqnin veten si dashamirës të shqiptarëve, por në realitet përpiqeshin me lloj-lloj forme të shfrytëzonin prapambetjen në viset shqiptare dhe pastaj ta konsideronin atë si një njollë për qytetarinë. Ai

⁸⁵ Skëndi, *Zgjidhjet kombëtar shqiptar*, f. 381.

⁸⁶ AIH, A-IV-35, Ahmed Selahuddin, “Çështja e Maqedonisë dhe lufta në Ballkan”, 3.

⁸⁷ AIH, A-IV- 162, Hasan Prishtina, *Fjalimi i Hasan Prishtinës mbajtur në seancën parlamentare në Stamboll para se të shpërndahej parlamenti dhe të shkohej në zgjedhje të parakohshme, më 11 janarit 1912*, 1-2.

⁸⁸ Po aty, 3.

shprehej se ishte më mirë që gjërat të thuhen para Parlamentit dhe problemeve të popullit shqiptar t'iu gjendej rrugëzgjdhje, sesa të mos trajtohen duke i mënjanuar në hije.⁸⁹

Deputetët shqiptarë kishin ngarkuar Hasan Prishtinën që të përballej edhe me vezirin e madh, Hakki Pasha, në interpelance parlamentare. Ata kishin mbledhur dokumentacionin e nevojshëm dhe fakte konkrete që t'i provonte vezirit të madh gjendjen e vështirë që përjetonin shqiptarët. Kur Hakki Pasha u pyet në interpelancë se a kishte kryer Porta e Lartë ndonjë investim dhe në çfarë gjendje gjendeshin vilajetet shqiptare, veziri i madh u gjend pak ngushtë për të dhënë përgjigje. Hasan Prishtina kritikoi ashpër qeverinë se ajo po ndiqte politikë të gabuar në këto vilajete. Ai e mbyllte fjalimin e tij duke u shprehur se: “Në qoftë se kjo qeveri nuk ndërron politikë në mënyrën e administrimit në Shqipëri, si dhe nëse shqiptarët nuk i gëzojnë të drejtat e tyre, kanë për të shpërthyer një varg ndodhish të përgjakshme e të hidhura dhe kam për të qenë njëri prej atyre, e ndoshta edhe i pari që kam për të ngritur flamurin e kryengritjes”.⁹⁰

Deklarata e tij para deputetëve dhe qeverisë ishte aq e fortë se pati reagime të menjëhershme nga ana e qeverisë. Menjëherë fjalën e mori Hakki pasha duke iu drejtuar Hasan Prishtinës se po të përdorte këto fjalë për dobi të vendit do të kryente një shërbim të madh. Veziri i Madh shtonte se, “me këto fjalë që po shpreh Hasan beu, ka për qëllim me ia shti zjarrin krejt Perandorisë Osmane”.⁹¹ Porta e Lartë shprehej se do të ndërmernte disa reforma si: të zgjidhte funksionarë të duhur në administratë; të merrte masa për forcimin dhe riorganizimin e qeverisë; të zgjidhte gjykatësit e duhur që gëzonin besim; të punonte për forcimin dhe riorganizimin e xhandarmërisë; ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave; të përmirësonte dhe të ndërtonte burgje; të merrte masa për arsimin; të kryente investime për lundrimin e Bunës dhe të vaporëve në liqenin e Shkodrës.⁹² Por përfaqësuesit shqiptarë, shfaqnin mosbesim ndaj qeverisë dhe vazhdonin të akuzonin atë për mos përmbushje të premtimeve të tyre; mohimin e të drejtave kombëtare; shkëljen e të drejtave kushtetuese nëpërmjet politikës shtypëse-

⁸⁹ Po aty, 5.

⁹⁰ Hasan Prishtina, *Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*, Botimi i dytë, Bari: Società Tipografica Pugliese, 1925, 6-7.

⁹¹ Po aty, 7.

⁹² Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri, Roma (me tej: AMAE), Fondi: Serie Politica “P” (1891-1916), Pacco 674, (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, AIH), image 7244,7245,7246. Telegram i ambasadorit italian në Athinë, Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtme të Italisë ku përshkruan situatën në viset shqiptare, Athinë, më 5 shkurt 1912.

centralizuese, për dhunën e ushtruar në viset shqiptare dhe për dëmet e mëdha të shkaktuara në ekonomi, kulturë e në aspekte shoqërore.

Ambasadori i Italisë në Sofje, Bosdari njoftonte Romën, se deputetët shqiptarë në parlamentin osman kanë shprehur pakënaqësi për vonesat në kryerjen e reformave që u premtuan në vitin paraardhës nga ana e qeverisë dhe kanë braktisur seancat parlamentare.⁹³ Këto pakënaqësi të akumuluar ndaj politikës së otomanizimit e të centralizimit të Perandorisë, shtonin ndjenjat e nacionalizmit. Po ashtu, veprimet e dhunshme në zbatimin e reformave, shkaktuan mjaft largime të anëtarëve nga partia “Bashkim e përparim”. Disa anëtarë të Komitetit Xhonturk nga vilajeti i Kosovës, Shkodrës dhe Manastirit i paraqiten dorëheqjen Komitetit Qendror “Bashkim e përparim” me motivacionin se: kishin shpresuar që Komiteti do të sillte drejtësi për shqiptarët, por mos interesimi i qeverisë për zgjidhjen e plotë të problemeve të tyre, po i detyronte të largoheshin nga lëvizja e turqve të rinj.⁹⁴ Gjithashtu dhe në radhët e popullatës shqiptare komiteti humbiste çdo ditë e më shumë mbështetjen e shqiptarëve pasi ndiheshin të zhgënjyer nga politika e tyre. Diplomati italian në Korfuz, Labia njoftonte Ministrinë e Jashtme mbi gjendjen shumë të keqe të banorëve dhe lëkundjen e pozitave të autoriteteve osmane në viset shqiptare.⁹⁵

Rritja e opozitës parlamentare dhe shpërndarja e Parlamentit në janar të 1912

Nga fundi i vitit 1911, debatet parlamentare bëheshin gjithnjë e më të ashpra midis xhonturqve dhe deputetëve opozitarë të krahinave të ndryshme perandorake. Kjo ndodhte për shkak të rritjes së pakënaqësive ndaj qeverisë. Bashkërendimi i nismave politike dhe prezantimi në mënyrë të vazhdueshme në Parlament të ankesave nga ana e përfaqësuesve

⁹³ Fondi: Serie Politica “P” (1891-1916) në AIH, Pacco 674, image 7445. Telegram i ministrit fuqiplotë italian në Sofje, Bosdari, dërguar Ministrisë së Jashtme mbi gjendjen e rëndë në vilajetet shqiptare dhe për pakënaqësitë e deputetëve shqiptarë për moskryerjen e reformave të premtuara nga qeveria, Sofje, më 1 janar 1912.

⁹⁴ Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912*, Libri 2, 142-143.

⁹⁵ *Dokumente diplomatike italiane për historinë e shqiptarëve (1912)*, Vëllimi I, Paulin Marku, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2019, Pacco 674, img, 7999, 8000, 8001, Telegram i diplomatit italian në Korfuz, Labia dërguar Ministrisë së Jashtme mbi gjendjen shumë të keqe të banorëve dhe lëkundjen e pozitave të autoriteteve osmane, Korfuz, më 8 janar 1912.

shqiptarë, arabë, armenë, grekë dhe bullgarë, e vendosën në vështirësi të madhe kabinetin për t'u dhënë përgjigje.⁹⁶

Vlen të theksohet se themelimi i partisë opozitare “Liri e Marrëveshje” dhe përfshirja rreth saj e shumë deputetëve të pakënaqur, i shqetësonte teje mase xhonturqit. Këto shqetësime ishin publikuar dhe në gazetën “La nazione albanese”, e cila pohonte se Porta e Lartë i ndiqte me prioritet ngjarjet në viset shqiptare dhe po angazhohej që të shuante pakënaqësitë dhe të provonte nëse arrin të rifitojë besimin e tyre, ku shtonte se, Këshilli i Ministrave mori një vendim të rëndësishëm për memorandumin e paraqitur nga disa deputetë shqiptarë në Parlamentin osman.⁹⁷ Komiteti “Bashkim e përparim” përgatiti dhe dërgoi në Parlament për miratim, së bashku me disa projekt-ligje edhe ndërhyrjen në kushtetutë për ndryshimin e nenit 35*. Po ashtu, kërkonte zgjedhje të parakohshme, pa pritur përfundimin e mandatit katërvjeçar, në vjeshtë të vitit 1912.

Në këndvështrimin tonë, turqit e rinj patën disa arsye pse nxituan të shpërndajnë Parlamentin: *së pari* përballja me Italinë kishte shkaktuar mjaft probleme në radhët e ushtrisë osmane; *së dyti*, opozita parlamentare ishte gjithnjë e në rritje në radhët e elitës politike duke mbledhur rreth saj shumë përfaqësues të pakënaqur nga qeverisja xhonturke, e cila mund të rrezikonte pushtetin me forcimin dhe zgjerimin në parlament; dhe *së treti* konfliktet brenda Perandorisë Osmane kishin nxitur kombësi të ndryshme që kërkonin të drejtat e tyre dhe tek ata po zgjohej çdo ditë e më tepër ndjenjat e nacionalizmit, e cila shkaktonte trazira dhe kryengritje, duke i shkaktuar dëme të mëdha ushtrisë osmane dhe ekonomisë së shtetit. Po ashtu një tjetër arsye madhore pse qeveria këmbëngulte që të shpërndante Parlamentin ishte se ajo mund të përdorte në interesin e saj, ligjin mbi shtypin, mbi mbledhjet dhe shoqatat, si dhe kishte mundësinë që nëpërmjet pushtetit, mund të ushtronte presion dhe të përdorte forcat ushtarake.⁹⁸ Shqetësime për situatën shprehni edhe diplomatët italian. Ambasadorit italian në Vjenë, Avarna,

⁹⁶ Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare kundër osmane e vitit 1912*, Prishtinë: Libri Shkollor, 2016, 108.

⁹⁷ AIH, A-IV-383, “La nazione albanese” - viti XVI - 31 janar 1912 - Nr. 2. f. 45.

* Një grup deputetësh shqiptarë, në seancën parlamentare që drejtohej nën kryesinë e zotërisë së tij Ahmet Riza beu, i paraqitën rezolutën ku shtrohej mosbesimi ndaj qeverisë për orvatjen për të ndryshuar nenin 35 të Kushtetutës (sipas tyre në kundërshtim me regjimin konstitucional) që i jepte të drejtë sulltanit të shpërndajë Parlamentin, të shpallte zgjedhje të parakohshme, në mënyrë që parlamenti i ri të mbledhej brenda 90 ditëve. Për më tepër shih: AIH, A-IV- 162, Prishtina Hasan, *Fjalimi i mbajtur në Parlamentin osman, 11 janar 1912*.

⁹⁸ *Historia e Perandorisë Osmane*, 557.

dërguar Romës pohohet se ai kishte informacione se situata nuk ishte e qetë dhe për këtë arsye Porta e Lartë ishte në tension.⁹⁹ Edhe ambasadori italian në Sofje, Bosdari, njoftonte Romën se lajmet që vijnë nga viset shqiptare janë të rënda dhe sipas informacioneve që ai kishte nuk do të kalonte shumë kohë dhe shqiptarët do të ngrihen në revoltë.¹⁰⁰ Pra, në ato kushte të vështira qeverisëse perandorake, zgjedhjet e parakohshme ishin mënyra më e mirë për të qëndruar në pushtet dhe për të përdorur çdo mekanizëm që favorizonte xhonturqit në zgjedhje e ardhshme. Edhe pse opozita në Parlament ishte kundër zgjedhjeve të parakohshme dhe i kundërshtonte ato, ajo ishte e pafuqishme të ndalonte nismën xhonturke. Mazhoranca xhonturke, gjeti pretekst për shpërndarjen e Parlamentit në janar të vitit 1912 për shkak se atë ditë nuk u miratua buxheti dhe disa propozime ligjore të qeverisë. Kështu, pas dy ditësh Sulltani Mehmeti V miratoi shpërndarjen e Parlamentit.

Me Irade perandorake, më 18 janar 1912, shpalli zgjedhje të parakohshme dhe urdhëronte mbledhjen e kuvendit të ri, brenda tre muajve nga shpallja zyrtare.¹⁰¹ Xhonturqit përshpejtuan procedurat ligjore për të shpërndarë Parlamentin për shkak të rritjes së opozitës parlamentare që u rrezikonte pushtetin dhe vendoste në pikëpyetje të madhe mundësinë që ata të fitonin zgjedhjet e ardhshme nëse prisnin përfundimin e mandatit katërvjeçar, si dhe s'po përballonin më atë opozitarizëm të ashpër, ekonomi të dobët dhe një rënie të ndikimit në administratë, ushtri e xhandarmëri.

Të nxituar për të shpërndarë parlamentin dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja, Porta e Lartë bënte përpjekje për të parandaluar revoltat e popullatës dhe studionte çdo mundësi që të shuante konfliktet dhe të rifitonte besnikërinë e shqiptarëve. Kjo për arsye se sipas të dhënave që ata kishin, pritej trazira në pranverë të vitit 1912. Këtë e pohonte edhe ambasadori italian në Vjenë, Avarna, i raportonte Romës, se në bazë të informacioneve që kishte, autoritet perandorake në Stamboll janë të shqetësuar për situatën në viset shqiptare. Ai shtonte se për këtë motiv, Porta e Lartë po përgatiste të dërgonte një komision të posaçëm në vilajetin e Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës.¹⁰² Kabineti urdhëronte dërgimin e "Komisionit të

⁹⁹ AMAE, Fondi: Serie Politica "P" (1891-1916), Pacco 674, nëAIH, img, 6925. Telegram Nr. 82, nisur nga ambasadori italian në Vjenë, Avarna, dërguar Ministrisë së Jashtme të Italisë, Vjenë, më 1 shkurt 1912.

¹⁰⁰ *Dokumente diplomatike italiane për historinë e shqiptarëve 1912*, vëll.I, përzgjedhur, përkthyer dhe përgatitur për botim Paulin Marku, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botime Albanologjike 2019, 57-58.

¹⁰¹ Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare kundërosmane e vitit 1912*, 108.

¹⁰² AMAE, Fondi: Serie Politica "P" (1891-1916), Pacco 674, nëAIH, image 6925.

Reformave”, për të analizuar situatën në terren, i cili do të kryesohej nga ministri i Brendshëm osman, Haxhi Adil Beu në krye, i shoqëruar nga specialistë të fushave të ndryshëm të Perandorisë si dhe disa ekspert evropiansi (Graves, Ostrorog, Foulon).

Nëpërmjet kësaj lëvizjeje, Porta e Lartë përpiquej të krijonte besueshmëri në popull dhe të përcillte një mesazh pozitiv në arenën ndërkombëtare. Krahës takimeve dhe analizës së situatës në terren, komisioni duhej të realizonte edhe disa objektiva të tjera, si:¹⁰³ a) të shikonin situatën nga afër për të analizuar problemet dhe vlerësimin e atyre që konsideroheshin më emergjente për t’u zbatuar nga ana e qeverisë; b) për të vendosur rendin e qetësinë; c) të zhvillonin propagandë politike për të mbështetur kandidatët e Partisë “Bashkim e Përparim”. Pra, xhonturqit nxituan të shpërndajnë parlamentin dhe pa humbur kohë provonin çdo mundësi siç ishte dhe rasti “Komisionit të Reformave”¹⁰⁴ për të rifituar mbështetjen e shqiptarëve. Porta e Lartë përpiquej të shmangte përplasjet me shqiptarët. Ajo tregojë tolerante në mbledhjen e taksave dhe në shërbimet administrative si dhe ndiqte nga afër organizimet e krerëve shqiptarë.

Premtimet për “liri, drejtësi e barazi” të Komitetit “Bashkim e Përparim” ndaj popujve me kombësi të ndryshme në Perandorinë Osmane nuk u mbajtën nga xhonturqit. Përkundrazi, sapo ata morën pushtetin, shqiptarëve iu ishte imponuar aplikimi i reformave të thella dhe shtypja e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si përfundim, turqit e rinj, bënë përpjekjet të vazhdueshme për të centralizuar pushtetin, me shkatërrimin e klubeve shqiptare, me imponimin e reformave edhe nëpërmjet presionit dhe dhunës, me ndërhyrjet për të penguar shkollat dhe alfabetin kombëtar, si dhe me rekrutimin e shërbimit ushtarak, etj., që shkaktuan debate të ashpra parlamentare mes shqiptarëve opozitarë dhe xhonturqve. Pakënaqësitë e tyre, shqiptarët i shprehën në forma të ndryshme, si në arenën politike ashtu edhe para kancelarive të huaja ku i dëshmonin botës se Shqipëria nuk ishte vetëm një nocion gjeografik, por një tërësi etnike.

Telegram Nr. 82 nisur nga Vjena më 1 shkurt 1912 i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, dërguar për Ministrinë e Jashtme të Italisë.

¹⁰³ AMAE, Fondi: Serie Politica “P” (1891 – 1916), Pacco 674, në AIH image 7287, 7288, 7289. Telegram i ambasadorit italian në Athinë, Carlotti dërguar Ministrisë së Jashtme për situatën e shqiptarëve, Athinë, 6 mars 1912.

¹⁰⁴ Për më tepër për udhëtimin e dhe për veprimtarinë e Komisionit të Reformave, kryesuar nga ministri i Brendshëm osman shih: Paulin Marku, “Reagimi i Qeverisë osmane për të qetësuar situatën në viset shqiptare në fillim të vitit 1912, qëllimi dhe dështimi i “Komisionit të Reformave” i kryesuar nga ministri Haxhi Adil Beu”, *Studime historike*, 1-2, 2017.

Veprimtaria e tyre u shoqërua dhe me një varg betejash e kryengritjesh, të cilët organizuan popullatën në mbrojtje të kauzës së shqiptarëve që u finalizua me aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në Vlorë, më 28 nëntor 1912, ku shënon edhe shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe i hapi udhë procesit të formimit të shtetit kombëtar.

Paulin MARKU

SUMMARY

PARLIAMENTARY ELECTIONS IN THE OTTOMAN EMPIRE AND REFORMS OF THE YOUNG TURKS GOVERNMENT IN THE ALBANIAN AREAS (1908-1912)

1908 marks an important constitutional turn in the Ottoman Empire. The continuing demand of the “Union and Progress” Committee for the restoration of the constitutional order of 1876, the rise of riots under the influence of the Young Turks, and the army's total failure to suppress popular revolts, forced Sultan Abdyl Hamid to restore the constitution and proclaimed parliamentary elections. The 1908 elections declared the Young Turks the winners. The newly elected cabinet initiates a series of imperial reforms, including also the Albanian territories. Some of the Albanian deputy lined up in opposition and expressed dissatisfaction with the government's initiative to implement deep reforms, which they considered unfair to Albanians who were accompanied by fierce parliamentary debates.

There were discontents among the people that accompanied with rebellion and uprisings in Albanian territories, such as the 1910 uprising in the Kosovo vilayet and in 1911 in Shkodra. As a consequence of the determination of the High Gate to suppress any anti-government movement through punitive expeditions and to carry out the reforms undertaken at all costs, it caused great loss of life and great economic damage. The rise of dissatisfaction with the government was gathering many deputies from different imperial provinces into a fierce opposition in parliament. Because the Young Turks were not coping fierce opposition, a weak economy and a declining influence on the administration, the military and gendarmerie were risking the holding power, they were forced to dissolve parliament and call early elections. In conclusion, the promises of “freedom, justice and equality” to nationalities in the Ottoman empire of the “Union and Progress” Committee were not only not sustained after taking power but the Albanians were by all means forced to apply deep reforms and suppress Albanian national movement.

KUD: 94(496.5) .086.1 (093.2)
327(496.5:4/9) “1920”

Marenglen VERLI

**SHQIPTARËT PËRBALLË NDËRKOMBËTARËVE NË PARIS,
NË MBYLLJE TË KONFERENCËS SË PAQES
(14 JANAR - 3 MARS 1920)**

*Rreziku i asgjësimit të shtetit të pavarur shqiptar pas Luftës së Parë
Botërore*

Konferenca e Paqes në Paris, organizuar pas Luftës së Parë Botërore nga fuqitë fituese, (Franca, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia), ndër të tjera trajtoi edhe problemet e kufijve dhe të statutit të shteteve të Ballkanit dhe në kuadër të tyre edhe “çështjen shqiptare”. Autorë të shumtë e kanë bërë objekt të studimit dhe kanë dhënë opinionet e veta qoftë për Konferencën në përgjithësi, qoftë për aspekte të ndryshme të saj. Për “çështjen shqiptare”, ndër autorët shqiptarë më të njohur, janë dëshmuar me studime të thelluara profesorët: Muin Çami, Paskal Milo, Arben Puto etj., të cilët i kanë kushtuar kësaj teme monografi, pjesë monografish dhe artikuj të shumtë.¹

Është e njohur përgjithësisht ecuria e trajtimit të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes. Ndonëse asnjëherë në konfliktin botëror, Shqipëria ishte planifikuar të asgjësohej. Ricungimi i kufijve të caktuar për të në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913, në interes të fqinjëve tokësorë e detarë (Greqia, shteti Serbo-Kroato-Slloven dhe Italia), si edhe dhënia e asaj që mbetej nën protektoratin apo mandatin e Italisë, do të thoshte fund i pavarësisë. Delegacioni zyrtar shqiptar i Qeverisë së

¹ Muin Çami, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, monografi e papërfunduar në dorëshkrim (1990); Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*, vëllimi I, Tiranë: Toena, 2013; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009.

përkohshme të Durrësit, që shkoi në Paris, shumë shpejt u bind se jo vetëm korrigjim të padrejtësive të mëparshme ndaj Shqipërisë nuk do të kishte, por rreziku i ri ishte kërcënues deri në fatalitet. Pozicioni i tërheqjes dhe i lëshimeve nuk solli fryt. Për Fuqitë e Mëdha, veçanërisht për Francën dhe Britaninë, Shqipëria duhej të sakrifikohet sërish për të normalizuar situatën në rajon. Akordi apo kompromisi i 13-14 janarit 1920 ishte pika kulmore e më të keqes. Në mungesë të përfaqësuesit të SHBA-së, Franca, Britania e Madhe dhe Italia miratuan një variant zgjidhjeje që e kundërshtuan jo vetëm SHBA, por edhe Jugosllavia. Pikërisht që nga ky moment zhvillimet në terrenin shqiptar, të diplomacisë dhe të lëvizjes popullore, morën një drejtim interesant, për të cilin historiografia ka vend ende të thellojë vështirimin. Ky artikull synon të hedhë dritë për një periudhë disajavore pas kompromisit të 14 janarit, që ndikoi dukshëm në rritjen e rolit të faktorit shqiptar lidhur me marrjen e vendimeve për të ardhmen e Shqipërisë.

Situata dhe reagimi i shqiptarëve pas kompromisit të 13-14 janarit 1920

Tentativat e tre Fuqive të Mëdha evropiane (Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë), të sforcuara deri në nivelet më të larta, me pjesëmarrjen edhe të kryeministrave përkatës, për t'i gjetur një zgjidhje “Çështjes së Adriatikut”, prodhuan kompromisin e 13 janarit të vitit 1920. Me disa retushime, që synonin të siguronin edhe miratimin jugosllav, ai u paraqit në formën e plotë më 14 janar 1920. Ishte fat për shqiptarët, që delegacioni jugosllav për shkak të kontradiktave të brendshme midis kroatit, Ante Trumbiq (ministër i Jashtëm) dhe serbit, Nikolla Pashiq (kryeministër), nuk pranoi të hiqte dorë nga Fiumja për të pranuar kompensime në Shqipëri.

Kjo ngecje e procesit për një marrëveshje midis Italisë dhe shtetit SKS rreth caktimit të kufijve fuste në lojë SHBA-në, që nuk kishin firmosur kompromisin e 13-14 janarit, por që do të qenë detyruar ta pranonin, nëse jugosllavët dhe italianët do të binin dakort për zgjidhjen e ofruar nga diplomacia franko-britanike. Përmbajtja e diskutimeve dhe kompromisit të 13-14 janarit ishte shokuese për shqiptarët. Aty ishte firmosur katastrofa dhe asgjësimi i arritjeve të viteve 1912-1913. L. Bumçi, M. Frashëri, dr. Turtulli, Luigj Gurakuqi, Pandeli Evangjeli, Mithat Frashëri etj., u ndjenë të zhgënjyer e të tradhtuar nga Fuqitë evropiane. Vendi i vetëm ku mund të apelonin ishte SHBA-ja. Pas telegramit të përmendur të 12 janarit, dërguar presidentit Uillson, më 14 janar u përgatit një telegram tjetër. L. Bumçi në emër të delegacionit e adresoi atë, më 15 janar, te sekretari i Departamentit të Shtetit R. Lansing. “Konferenca me qëllim që të rregullojë konfliktin

italo-jugosllav, theksohej në telegram, nuk u shqetësua aspak të flijojë popullin e vogël e të dobët shqiptar, duke ofruar territorin e tij si kompensim për qëllimet imperialiste të fqinjëve të vet. Viktima nuk ka armë të tjera për mbrojtje veç parimeve të shpallura nga presidenti Uillon në emër të popullit të madh amerikan. Populli shqiptar në këtë moment të madh ankthi kërkon me ngulm mbështetjen e fuqishme e të drejtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.²

Po atë ditë, më 15 janar, ndonëse pa shpresa, delegacioni shqiptar i dërgoi një letër tjetër edhe Klemansoit.³ Në të shprehej dhimbja që ndjenin shqiptarët nga nëpërkëmbja e plotë dhe mosrespektimi i parimeve amerikane të përvetësuar nga Konferenca lidhur me respektimin e parimeve të kombësisë dhe të drejtës për vetëvendosje. Përsëri dhe si gjithmonë me një gjuhë të vetëpërmbajtur, pavarësisht nga presionet e datës 12 janar, që i ishin bërë nga përfaqësuesit e qarqeve të ndryshme patriotike në atdhe dhe nga diaspora, L. Bumçi i shprehte shqetësimin Zh. Klemansosë për mënyrën si po trajtohej çështja shqiptare: “Shqipëria e krijuar më 1913 si shtet i pavarur, neutral e i garantuar, shkruhej në letrën e kryetarit të delegacionit shqiptar, ka një të drejtë të fituar dhe nuk mund të shohë pa protestuar shkatërrimin e pavarësisë dhe integritetit të saj. Italia nuk ka asnjë të drejtë legjitime mbi Vlorën ... Greqia dhe Jugosllavia nuk kanë asnjë të drejtë mbi pjesët e tjera të territorit shqiptar. Dhënia e mandatit mbi Shqipërinë ...është në kundërshtim me klauzolën e nenit 22 të Traktatit të Versajës. Ndërhyrja në çështjet shqiptare e fqinjëve, përfundonte letra, ... do të cenojë pavarësinë e saj dhe kjo nuk do të mungojë të provokojë turbullira në Ballkan”.⁴

Një ditë më pas, më 16 janar, L. Bumçi, do të adresonte dy letra të tjera, njërën për Zhyl Kambonin, diplomatin francez me rol të rëndësishëm në Konferencë, kurse tjetrën për kryetarin e Lidhjes së Kombeve, organizatës së re ndërkombëtare që ishte krijuar me nismën amerikane në ditët e Konferencës. Në letrën e parë kryetari i delegacionit shqiptar i shfaqte francezit deziluzionin dhe hidhërimin që ai nuk e kishte mbajtur premtimin e dhënë lidhur me kufirin verior të Shqipërisë.⁵ Kurse në letrën

² P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 451-452, citon *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1920, dosja (më tej: D.). 34, fl. 216.

³ AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 33-34; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 449-450.

⁴ Po aty.

⁵ AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 40-41. Letër e L. Bumçit, dt. 16 janar 1920; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme ...*, vëll. I, f. 450.

drejtuar kryetarit të Lidhjes së Kombeve, L. Bumçi kërkonte mbrojtjen e kësaj organizate kundër vendimeve të Konferencës së Paqes në dëm të Shqipërisë. “Kombi shqiptar, i zhytur në trishtim më të thellë nga vendimet që Konferenca e Paqes po merr lidhur me Shqipërinë, duke konsakruar ndarjen e saj... thuhej në letrën e sipërpërmendur, përshëndet me entuziazëm inaugurimin e veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve, në të cilën ka vendosur gjithë shpresat e veta për ruajtjen e të drejtave të saj të marra nëpër këmbë”. E hartuar në frymën e qëndrimit të moderuar, të ndjekur në vazhdimësi, ku ishin forcuar notat e deziluzionit e, madje, të fatalitetit, letra përfundonte: “Delegacioni shqiptar proteston në emër të drejtësisë..., kërkon me lutje të përvojatur mbrojtjen e Lidhjes së Kombeve ... dhe shpreson se ajo nuk do të lejojë që të kryhet një padrejtësi e tillë”.⁶

Përçapjet e intensifikuara pas mbledhjes, që delegatët shqiptarë bënë më 14 janar, prodhuan edhe letra e telegrame të tjera. Duke konsideruar shpresë të vetme SHBA, me firmën e L. Bumçit, më 17 janar, iu dërgua një letër edhe ambasadorit amerikan në Paris e në Konferencë, H. Uolles (H. Wallace), i cili vizitohej rregullisht nga anëtarët e delegacionit shqiptar. Letra shoqërohej me një thirrje të përfaqësuesve të Korçës për të përforcuar idenë se rregullimi i “Çështjes së Adriatikut” duke sakrifikuar e copëtuar Shqipërinë kishte krijuar një pershtypje të hidhur te populli i saj. Uollesit me këtë rast i kujtohej memorandum i që ishte dërguar më 8 nëntor 1919, i shoqëruar me dokumente, të cilat dëshmonin qëndrimin e banorëve të Shqipërisë së Veriut për të mos pranuar zgjedhë të huaj.⁷

SHBA nuk kishin qenë në një mendje me partnerët evropianë për çështjen e Shqipërisë së Jugut. Në Memorandumin amerikano-franko-britanik të 9 dhjetorit, ata vërtet nuk ndanin ndonjë mendim ndryshe për çështjen e sovranitetit të Italisë në Vlorë dhe të mandatit mbi Shqipërinë, por nuk pajtoheshin me dhënien e Korçës Greqisë dhe të Shqipërisë së Veriut Jugosllavisë. Këtë çarje në pikëpamjet e të Mëdhenjve, delegacioni shqiptar u përpoq ta shfrytëzonte për të shpëtuar diçka nga arritjet e vitit 1913. Zëvendësimi i Zh. Klemansoit nga A. Milerand (A. Millerand) i dha rast delegacionit shqiptar të tentonte diçka me kryeministrin e ri të Francës. Natyrisht politika franceze e kishte thënë fjalën e vet, megjithatë, për të mos

⁶ Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi MPJ, D. 2. Letër e L. Bumçit për kryetarin e Lidhjes së Kombeve, dt. 16 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (1918-1920)* (Përmbledhje dokumentesh), redaktor përgjegjës Muin Çami, botim i Institutit të Historisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, vëll. II, dok.25, f. 37.

⁷ AMPJ, V. 1920, D. 34, fl. 44. Letër e L. Bumçit, dt. 17 janar 1920, për ambasadorin amerikan në Francë.

lënë asgjë mangut në veprimtarinë që kish marrë përsipër, delegacioni, më 19 janar 1920, përsëriti thirrjen që të pengohet padrejtësia që po i bëhej popullit shqiptar duke copëtuar Shqipërinë në interes të fqinjëve.⁸

Për situatën kritike në Konferencën e Paqes lidhur me çështjen shqiptare, L. Bumçi do të njoftonte disa ditë më pas më 22 janar 1920, Qeverinë e përkohshme në Durrës. “Lajmet e fundit... janë të dëshpërueshme, informonte ai, Konferenca për të ndrequr punën e Adriatikut, bëri një projekt i cili konsakron thelizimin e Shqipërisë. Ne protestuam me fuqi kundër kësaj padrejtësie, por zëri ynë nuk mjafton për ta ndalur zbatimin e saj. Megjithëqë kurrë nuk kemi ushqyer shpresa të mëdha, vijonte më tej letra, ... por prapë nuk besonim se puna jonë mund të dalë kaq keq”. Pasi theksonte se premtimet dhe shpresat e dhëna nga anëtarë të delegacionit amerikan e italian “u zhdukën njëra pas tjetrës”, L. Bumçi, duke iu bërë me dije kolegëve në Durrës se të dy variantet për zgjidhjen e çështjes shqiptare, qoftë projekti apo kompromisi i 14 janarit 1920, qoftë Traktati i Londrës i vitit 1915, “që të dy janë fort të këqij për ne dhe ... do të humbasim gjysmën e vendit”, i nxiste t’ia bënin të njohur popullit rrezikun, që “të protestojnë si t’u duket më mirë”.⁹ Kryetari i delegacionit shënonte posaçërisht se “duhet të lajmëroni dhe popullin e Korçës e të Shkodrës, që të mund të marrin masat, që do t’u duken më të mira për mbrojtjen e interesave kombëtare”.¹⁰

Në Shqipëri, ndërkohë, ishin ndërgjegjësuar për vendimet katastrofike të Konferencës për Shqipërinë dhe po zotëronte pikëpamja se duheshin radikalizuar qëndrimet kundër copëtimit të mëtejshëm të Shqipërisë së 1913-ës. Madje më 21 janar kishte filluar punimet Kongresi i Lushnjës, që më 28-31 janar, në kushtet kur përpjekjet diplomatike për ripohimin e pavarësisë së shtetit shqiptar dhe të tërësisë së tij tokësore nuk dhanë rezultat, mori përsipër organizimin e qëndresës së brendshme popullore. Anëtarë të Qeverisë së përkohshme të Durrësit, që vepronin në Shqipëri, veçanërisht Fejzi bej Alizoti, Myfit Libohova e Mustafa Kruja, u përpoqën hapur qysh më 12 janar ta pengonin organizimin e Kongresit,¹¹ por pa sukses. Urdhrat dhe qarkoret e lëshuara nga data 13 janar e në vijim,

⁸ *Po aty*, fl. 46.

⁹ *AQSH*, F. MPJ, D. 322. Njoftimi i L. Bumçit për Qeverinë e përkohshme në Durrës, dt. 22 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar*, vëll. II, përgatit për botim M. Çami etj., Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, dok. 35, f. 48-49.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *AQSH*, F. Drejtorja e Punëve të Brendshme (DPB), D. 197, dok.14. Informacion i inspektorit të përgjithshëm Avni Dabulla, dt. 12 janar 1920, dërguar nga Berati Delegacisë së Punëve të Brendshme; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok. 15, f. 26.

vrasjet politike si ajo e Abdyl Ypit, madje edhe kërkesa drejtuar Komandës së ushtrisë italiane në Shqipëri për të ndërhyrë, nuk prodhuan ndonjë rezultat.¹² Konsulli britanik, Iden, ndoqi punët e Kongresit, kurse autoritetet italiane deklaruan se nuk do të ndërhynin. Vetëm më 31 janar, ditën kur Kongresi përfundoi punimet, një inspektor i Komandës italiane në nënzonën veriore të Vlorës, i dërgoi një letër kryetarit të Kongresit, në emër të gjeneral Piaçentinit, me të cilën ai e njoftonte se “nuk mund të njihte zyrtarisht vendimet e marra nga delegatët ... në Lushnjë, për arsye se nuk i rezulton që pozita e tyre të jetë legale. Me qëllim që të mbahet qetësia publike, përfundonte letra ... u bëj thirrje zotërinjve delegatë të pezullojnë mbledhjen dhe të kthehen në vendet e tyre”.¹³

Por tashmë Kongresi e kishte përfunduar punën e tij. Qeveria e Durrësit ishte shpallur e rrëzuar. Ndër të tjera ajo u fajësua se “tue u mbështetë në politikë të veçantë, shtini në një situacion të keq gjendjen politike të Shqipërisë”.¹⁴ Kongresi gjithashtu kundërshtoi projektet e Konferencës së Paqes që cenonin pavarësinë dhe tërësinë tokësore të shtetit shqiptar dhe u shpreh për pavarësinë e plotë të Shqipërisë, kundër çdo mandati ose protektorati të huaj. Në telegramin e protestës adresuar kryetarit të Konferencës së Paqes, Kongresi shpalli se shqiptarët ishin gati të bënin “të gjitha sakrificat, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre, kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”.¹⁵ Me këtë vendim Kongresi iu kundërvu si planeve të Konferencës për ta vendosur Shqipërinë nën mandatin e një fuqie të huaj, ashtu edhe projekteve të delegacionit shqiptar të Qeverisë së Durrësit për të vënë në krye të shtetit shqiptar një princ italian, ose për ta vendosur atë nën “mbrojtjen” e Lidhjes së Kombeve, siç kishte propozuar ky delegacion më 22 janar në një notë drejtuar Konferencës.¹⁶

¹² AQSH, F. Kongresi i Lushnjës, D.2. Urdhër i firmosur nga F. Alizoti për ndalimin e mbledhjes së Kongresit të Lushnjës, dt. 13 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 23, f. 35; *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të PPSH, Tiranë: 1959, f. 18-19.

¹³ AQSH, F. Kongresi i Lushnjës, D.2, dok.21. Letër e inspektorit të komandës italiane, dt. 31 janar 1920.

¹⁴ *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok. 50, f. 63-67. Vendimet e Kongresit të Lushnjës, sipas procesverbale të Kongresit.

¹⁵ *Historia e popullit shqiptar...*, vëll. III, f. 145.

¹⁶ *Po aty*.

Kongresi, ndonëse shtypi francez kishte informuar qysh më 22 janar se 21 janari kishte shënuar fundin e Konferencës së Paqes,¹⁷ më 29 janar zgjodhi që delegacioni në Paris, “pranë Konferencës së Paqes” të përbëhej nga L. Bumçi, Mehmet Konica dhe dr. Turtulli (kryetari u la të zgjidhej midis tyre).¹⁸ Delegacionit do t’i duhej në vijim të punonte sa në Londër edhe në Paris, ku ndërkohë u përqendrua puna, përkatësisht e tre kryeministrave evropianë dhe ambasadorëve të Fuqive të Mëdha.

Ndërkohë që rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri finalizohet me Kongresin e Lushnjës, në Paris, ashtu si delegacioni shqiptar përpiquej të gjente një rreze shprese të qëndrimi i panjësuar amerikan me partnerët evropianë për çështjen shqiptare, edhe jugosllavët trokitën në të njëjtën portë. Ultimatumit të Fuqive të Mëdha evropiane e vuri në pozitë të vështirë delegacionin jugosllav, sepse qoftë projekti i 14 janarit 1920, qoftë Traktati i Londrës i vitit 1915, nuk ishin opsione të mira për të. Më 16 janar, Trumbiqi i kërkoi mbështetje ambasadorit amerikan. Dublini i ankesave, të adresuara nga shqiptarët përkatësisht më 12 janar (Uillsonit), 14 janar (Lansingut) dhe 17 janar (Uollesit) dhe jugosllavët më 16 janar (Uollesit), e nxiti diplomacinë amerikane të vepronte. Duke u ndjerë e anashkaluar, ajo përmes Sekretarit të Shtetit, Lansing, u komunikoi Ll. Xhorxhit dhe Zh. Klemansosë, me anën e një memorandumit, se “Çështja e Adriatikut” nuk mund të definohej pa shprehur pikëpamjen e vet edhe SHBA, përkatësisht presidenti Uillson.¹⁹ Përgjigjja justifikuese e evropianëve nuk u pëlqye nga amerikanët. Më 27 janar ata njoftuan se do të shpreheshin më tej për “Çështjen e Adriatikut” dhe nxitën delegacionin jugosllav të mos thyhej përballë ultimatumit për të miratuar projektin e 14 janarit.²⁰ Ndoshta në dijeni të ankesës jugosllave të 16 janarit pranë ambasadorit amerikan Uolles, ndoshta nxitur dhe nga diplomacia jugosllave, më 17 janar sikurse u përmend, pasoi letra e L. Bumçit për Uollesin. Por pati nisma për të

¹⁷ AQSH, F. MPJ, D. 322, dok.716. Njoftim i L. Bumçit nga Parisi, dt. 22 janar 1920. “Konferenca mori fund, a më mirë e nderoi fytyrën ... tani e tutje ajo do të jetë përfaqësuar prej mbledhjes së ambasadorëve që gjenden në Paris. Kjo do të merret me punët e vogla dhe për ato të mëdhatë do të mblidhen ngandonjëherë kryeministrat”; Arbër Hadri, *Presidenti Uillson dhe çështja shqiptare (Politika e SHBA në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920))*, botim i Institutit të Historisë Prishtinë:, 2011, f. 175.

¹⁸ *Lufia e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 50, f. 64.

¹⁹ P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll.I, f. 453; Shih edhe Tomaso Titoni, Vuorio Scialoja, *L'Italia alla Conferenza della Pace*, Discorsi e documenti a cura di Amedeo-Gianini, Roma: 1921, f. 153-154.

²⁰ R. L. Woodal, *The Albanian problem during the Peacemaking (1919-1920)*, Memphis State University, Ph.d., 1978, f. 220; Shih edhe P.Milo, *Politika e jashtme...*, vëll.I, f. 454.

bashkërenduar ndonjë qëndrim me jugosllavët edhe jashtë ambienteve të Konferencës. Më 25 janar, Komiteti “MKK” në Shkodër, mori vendim për të bërë përpjekje për bisedime me jugosllavët me qëllim që të dilej nga gjendja kritike në të cilën ndodhej çështja shqiptare. Në mbledhje të Kryesisë së Komitetit ishte vendosur që kryetari i Komitetit, Kadri Prishtina dhe Bajram Fevziu të takoheshin fshehurazi “me partinë që do një marrëveshje me Jugosllavinë” për të marrë vesh “se mbi ç’baza dhe në çfarë kushtesh mund të arrihet marrëveshja me jugosllavët”.²¹

Në fund të janarit 1920, Komiteti “MKK” duke llogaritur të përfitonte nga kontradiktat italo-jugosllave rreth Shqipërisë, vendosi të hynte drejtpërdrejt në bisedime me përfaqësuesin e Beogradit, Nishiq. Baza mbi të cilën palët do të mund të merreshin vesh, sipas Komitetit, ishte: “E para - veç ndihmës që [Jugosllavia] do të japë për luftimet që do të bëjnë shqiptarët për ta nxjerrë Italinë nga Shqipëria e për ta shpëtue Vlonën, ç’interes mund t’u sigurojë shqiptarëve? E dyta - në rast se shqiptarët bajnë një shërbim, tue e nxjerrë Italinë nga Ballkani, serbët a e pranojnë në parim që Kosova të bashkohet me Shqipërinë e si një qeveri me e shti në Konfederacionin Jugosllav?”.²²

Shqiptarët kërkonin një shteg shpëtimi. Hapat e ndërmarrë gjatë fundit të dhjetorit dhe gjatë janarit, që nga takimi i L. Bumçit me papën,²³ deri te promemoret e adresuara për U. Uillonin, Zh. Klemansonë etj., para dhe pas kompromisit të përmendur të janarit, nuk kishin dhënë rezultat.

Angazhimi i qarqeve të ndryshme të politikës shqiptare, për të bashkëpunuar me qarqet drejtuese të Beogradit, ku bënte pjesë edhe kryesia e Komitetit “MKK”, ishte një tentativë për të shfrytëzuar mungesën e konsensusit italo-jugosllav për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, edhe pse diheshin rreziqet që sillte afrimi me Jugosllavinë. Forcat jugosllave me pretekstin e pranisë së forcave të armatosura italiane në Shqipëri mbanin “kufirin strategjik” në brigjet e Drinit të Zi, përtej vijës së caktuar nga Konferenca e Londrës në vitin 1913 dhe, hera-herës, depërtonin edhe më në brendësi të trevave shqiptare, sikurse ndodhi në fillim të janarit, kur u ripushtuan krahinat e Nikaj-Mërturit,²⁴ por alternativat e favorshme për zgjidhjen e duhur të çështjes shqiptare mungonin.

²¹ AQSH, F. Komiteti “MKK”, D. 53. Vendim i Komitetit “MKK”, dt. 25 janar 1920; shih dhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, f. 51-52.

²² AQSH, F. Komiteti “MKK”, D.8.

²³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 138.

²⁴ AQSH, F. DPB, D. 250, dok. 89. Njoftim i prefekturës së Shkodrës, dt. 26 janar 1920, për Delegacinë e Punëve të Brendshme, rreth ripushtimit të Nikaj - Mërturit nga ushtria

Duke ndjerë se situata në rajon kishte pasur një evoluim në favor të Jugosllavisë, veçanërisht pas nxitjes amerikane që ta kundërshtonin ofertën dhe ultimatumin franko-britanik, delegacioni jugosllav në Paris, më 28 janar hodhi poshtë kërkesat e Fuqive të Mëdha evropiane.²⁵ Madje për të fituar kohë, Qeveria jugosllave dha dorëheqjen. Kështu në fund të janarit tentativat për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut” u kthyen në pikën e nisjes. Sigurisht ishte qëndrimi i SHBA dhe këmbëngulja personale e U. Uillsonit që, edhe pse shumë i sëmurë e pothuajse i paralizuar, nuk reshti së komunikuari me Lansingun dhe Polkun përmes së shoqes, që përcaktuan falimentimin e projektit franko-britanik të 14 janarit. Por, padyshim, luajtën rol edhe kundërshtimi këmbëngulës jugosllav dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare brenda vendit, që njëherësh iu kundërvu synimeve e veprimeve italiane, greke e jugosllave.

Kongresi i Lushnjës dhe përpjekjet e diplomacisë shqiptare në shkurt-mars 1920 për të penguar ricopëtimin e Shqipërisë

Kongresi i Lushnjës, me vendimet e rëndësishme të njohura, që mori, është dëshmia më e plotë për evoluimin e situatës në Shqipëri. Ndër aktet e para që miratoi ky Kongres ishte telegrami që i dërgoi më 30 janar Konferencës së Paqes, në të cilin protestohej kundër vendimit të marrë nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia, për copëtimin e Shqipërisë midis Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë.²⁶ Në vijim, në telegram theksohej se Kuvendi kërkonte për Shqipërinë “një pavarësi të plotë me kufijtë etnografikë dhe natyralë, duke korrigjuar kështu padrejtësitë që janë bërë nga Kongresi i Berlinit dhe nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913”. Theksohej gjithashtu se “Kuvendi vendosi të mos pranojë asnjë mandat ose protektorat të huaj”.²⁷

Në paragrafin e fundit të tekstit të telegramit dëshmohej vendosmëria për vendimet e marra. “Shqiptarët janë të gatshëm të bëjnë të gjitha sakrificat, thuhej në telegram, të derdhnin edhe pikën e fundit të

serbe; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll.II, dok. 40, f. 53.

²⁵ Ivo Lederer, *La Jugoslavia della Conferenza della pace al Trattato di Rapallo (1919-1920)*, Milano: 1966, f. 266.

²⁶ AQSH, F. MPJ, D. 7. Telegrami i firmosur nga kryetari i Kuvendit Kombëtar të Shqipërisë, Aqif pashë Elbasani, dt. 30 janar 1920; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 46, f. 58-59.

²⁷ *Po aty*.

gjakut të tyre kundër çdo vendimi që mund të verë në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”.²⁸ Në të njëjtën ditë, më 30 janar, Kongresi i Lushnjës, i drejtoi një protestë të ngjashme edhe senatit italian. Në të shprehej zemërimi kundër planeve antishqiptare në Konferencën e Pages dhe njëkohësisht vendosmëria për të mbrojtur me çdo kusht të drejtat kombëtare.²⁹ “Lajmi i frikshëm... ndezi kudo zemërimin e tërbuar dhe mërinë e shenjtë të popullit shqiptar, theksohej në protestën drejtuar senatit italian, Kuvendi i kombit i mbledhur në Lushnjë ... i dha fund me një zë t’u thotë përfaqësorjësve të ndershëm të Italisë se në dejtë e popullit shqiptar s’ka pushuar akoma së lëvrituri gjaku i kulluar i Skënderbeut, që të mundin pra stërnipat e tij të unjin kokën e të poshtërohen, aq sa të bëhen një koloni e përvuajtur italiane e të përdoren si shpërblim për të ngopur lakmitë imperialiste të fqinjëve të tyre lakmonjës; ... shqiptarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë në tjetrën si tufë delesh, e të bëhen plaçka e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Evropës”.³⁰

Më 31 janar, Aqif pashë Elbasani, në emër të Kongresit të Lushnjës, informoi për vendimet e marra edhe presidentin e SHBA, Uillson, dhe me një telegram të dytë, Kongresin Amerikan. Në këto telegrame kërkohej mbështetja e fuqisë përtej Atlantikut për të shpëtuar pavarësinë e Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial. Një telegram tjetër i adresoi U. Uillsonit edhe kryeministri Sulejman Delvina, i porsazgjedhur nga Kongresi i Lushnjës. Telegramet nga Lushnja shkuan gjithashtu në drejtim të kryeqyteteve të Fuqive të tjera të Mëdha.³¹ Në emër të delegacionit shqiptar, telegrame për presidentin e SHBA-së dhe Kongresin Amerikan, dërgoi nga Parisi edhe L. Bumçi.³² Për njohjen e opinionit publik botëror dhe të qarqeve politike të Fuqive të Mëdha, posaçërisht të SHBA-së, Italisë etj., me vendosmërinë e shfaqur në Shqipëri për të mos pranuar vendimet e Konferencës së Pages në dëm të popullit shqiptar, shërbyen në këtë kohë një mori protestash, thirrjesh e deklaratash të nisura nga kolonitë shqiptare dhe nga miqtë e Shqipërisë.

Në telegramin e kryesisë së kolonisë shqiptare të Rumanisë, dërguar Senatit të SHBA-së, kërkohej prej tij të dëgjohej thirrja e “dëshpëruar për të ndaluar një krim të tillë kundër popullit të lashtë shqiptar, pavarësia e të

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Kuvendi*, Romë, viti III, nr. 70, 21 shkurt 1920, f. 3.

³⁰ *Po aty*.

³¹ P. Milo, *Politika e jashtme ...*, vëll. I, f. 456.

³² *Po aty*, Telegrame të dt. 30 janar 1920.

cilit u njoh më parë në Londër, më 1913”.³³ Më 29 janar, Edit Durham shkruante në gazetën, që botohej në Londër, “Daily Herald”, se Fuqitë Aleate në Paris “ndodhen në pikën e kryerjes së një krimi ndërkombëtar, të vjedhjes së pavarësisë së një vendi të vogël”.³⁴ Kurse më 12 shkurt, Komiteti i punëtorëve shqiptarë në SHBA dhe në Kanada, në një letër drejtuar Komitetit drejtues të Partisë Socialiste Italiane, i bënte thirrje të luftonte kundër synimeve imperialiste të qeverisë italiane ndaj Shqipërisë. Pasi vinte në dukje apatinë dhe mosangazhimin e socialistëve italianë për t’i prerë rrugën “marrëzisë ekspansioniste, etjes për pushtime të imperializmit italian”, letra përfundonte se të ngresh zërin kundër “krimit të përbindshëm që po bën qeveria italiane e Romës, do të thotë ... t’i shërbesh më shumë sesa Shqipërisë, demokracisë dhe Italisë”.³⁵

Jo të gjithë e morën seriozisht reagimin e shqiptarëve, publikuar përmes përfaqësuesve të tyre në Lushnjë, Paris apo nga kolonitë e diasporës. Por në qarqet më të interesuara për zgjidhje sa më realiste të çështjeve të Ballkanit, zëri i shqiptarëve nuk kaloi pa jehonë. Në rrethanat komplekse, kur kishin reaguar edhe jugosllavët dhe kur SHBA ndihej e fyer nga anashkalimi i aleatëve evropianë në marrjen e vendimeve për “Çështjen e Adriatikut”, presidenti amerikan U. Uillson, më 10 shkurt u ktheu përgjigje kolegëve evropianë për memorandumën e tyre të 23 janarit. Ai theksonte si zgjidhjen më të mirë Memorandumin e 9 dhjetorit 1919 dhe kundërshtonte kompromisin e 14 janarit 1920, që i siguronte Italisë sovranitet në Fiume dhe në Istria. Për sa i përket Shqipërisë, Uillsoni i qëndronte pikëpamjes se Memorandumi i 9 dhjetorit “ruan në një masë të gjerë unitetin e shtetit shqiptar”, kurse kompromisi i 14 janarit “e ndan popullin shqiptar midis tre fuqive të huaja pavarësisht nga protestat e tij të fuqishme”.³⁶

Presioni i SHBA-së dukej qartë, kur u kujtonte kolegëve evropianë se Memorandumi i 9 dhjetorit ishte caku i koncesioneve që mund të ofronin amerikanët.³⁷ Ndërkohë që shkëmbimi i pikëpamjeve të kundërta midis amerikanëve dhe evropianëve për “Çështjen e Adriatikut” e, në kuadër të saj, për çështjen shqiptare, do të vijonin gjatë shkurtit të vitit 1920 dhe më

³³ AQSH, F. Kolonia e Rumanisë, D.125; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 51, f. 67.

³⁴ AMPJ, viti 1920, dos. 34, f. 127.

³⁵ AQSH, F. MPJ, D. 322. Letër e dërguar nga Lozana, më 12 shkurt 1920, në emër të Komitetit të punëtorëve shqiptarë në SHBA dhe Kanada.

³⁶ Adriaticus, *La Question Adriatique*, Recueil de documents officiels, Paris: 1920, f. 123-129; T. Tittoni, V. Scialoja, *L'Italia alla Conferenza della Pace ...*, f. 157-161.

³⁷ Po aty.

pas^{*}; shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur rrezikun e asgjësimit të atdheut. Gjatë shkurtit 1920 një varg protestash të tjera pasuan ato të janarit. Në një protestë të fillimit të shkurtit, dërguar komandës italiane në Durrës, qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës kërkonte të mos pengohej vendosja e saj në Durrës.³⁸ Më 3 shkurt përfaqësuesit e kolonive shqiptare të Rumanisë dhe të Turqisë, që ndodheshin në Paris, i kërkonin kryetarit të delegacionit qeveritar shqiptar aty, që një pjesë e anëtarëve të tij të kthehej në Shqipëri për të informuar popullin mbi projektet e hartuara në Konferencën e Paqes për copëtimin e vendit “me qëllim që vetë populli të mund të shprehë mendimin e vet dhe të veprojë si duhet”.³⁹

Nga letra bëhet e qartë se qysh në një mbledhje të organizuar më 21 janar ishte miratuar vendimi që delegacioni të zvogëlohej në tre vetë dhe të tjerët do të duhej të niseshin sa më shpejt në Shqipëri për të sqaruar popullin mbi situatën e vështirë të krijuar nga politika e Fuqive të Mëdha. “Mirëpo, thuhej në letër, na duket se një vendim i tillë nuk është marrë parasysht. Përpara një ngurrimi të tillë dhe këtyre shtyrjeve me sot e me nesër, në çastin më vendimtar dhe më kritik në të cilën ndodhet Shqipëria, e quajmë për detyrë, theksonin përfaqësuesit e kolonive, t’i parashtrojmë vëmendjes suaj se një qëndrim i tillë mund të ketë pasojë shumë të dëmshme për vendin tonë...”.⁴⁰ Nuk dimë nëse delegacioni shqiptar në Paris me L. Bumçin, M. Konicën dhe M. Turtullin në përbërje kishte dijeni për qëndrimin e presidentit amerikan pasqyruar në përgjigjen për kryeministrat e Britanisë së Madhe dhe Francës, të dt. 10 shkurt 1920, lidhur me memorandumin e tyre të 23 janarit. Sidoqoftë ai tashmë ishte nën presion gjithnjë e më të madh të përfaqësuesve të kolonive të diasporës shqiptare dhe të ngjarjeve politike në Shqipëri. Pavarësisht nga faktorët nxitës, delegacioni shqiptar, më 11 shkurt, tentoi sërish të ndikonte te Fuqitë e Mëdha. Në këtë datë ai i dërgoi një telegram të ri kryeministrit britanik D. Llojd Xhorxh, njëherësh

* Përgjigje e dr. Lloid Xhorxhit dhe A. Mileranit e 17 shkurtit; reagimi i U. Uillsonit i 25 shkurtit; kundërpërgjigjja e franko-britanikëve e 26 shkurtit, etj.; Shih Adriaticus, *La question Adriatique...*, f. 130-133, 138-144, 145-147; Shih edhe Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit* (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik), vëll. II, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, dok. 24, f. 148-250, dok. 25, f. 250-253, dok. 26, f. 254-255.

³⁸ AQSH, F. Prefektura e Durrësit, D. 1; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, dok. 56, f. 70.

³⁹ AQSH, F. MPJ, D.2. Letër e dt. 3 shkurt 1920, firmosur nga Pandeli Evangjeli për koloninë e Bukureshtit dhe Halil Gjirokastra për koloninë e Turqisë; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim ...*, vëll. II, dok. 59, f. 72-73.

⁴⁰ Po aty.

kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate, që vepronte në Londër në vijim të punëve të Konferencës së Paqes të Parisit të mbetura për t'u zgjidhur.

Në telegram kërkohej të hiqej dorë nga plani për copëtimin e Shqipërisë dhe për asgjësimin e pavarësisë së saj.⁴¹ Pasi përsëriste argumentet që provonin të drejtat e shqiptarëve për t'u vetëqeverisur, për të mbrojtur pavarësinë dhe për të mos lejuar prekjen e kufijve të tyre, nga fqinjët që kishin pasur "gjithnjë qëllime aneksioniste" e që "s'kishin lënë salvime e rrëime pa kryer", delegacioni theksonte: "Po i drejtohem pra për herën e mbrame edhe një thirrje të nxehtë ... kryeqeveritarëve të tri kombeve të mëdha... që në zgjidhjen e çështjes shqiptare të mos pranojnë masa të tjera përveç atyre që përkojnë me drejtësinë e me vullnetin e popullit shqiptar...".⁴² Në telegram tërhiqej vëmendja se shqiptarët besonin në aftësitë e tyre për t'u vetëqeverisur dhe ndihmën e kërkonin "të kufizohet vetëm në dërgimin në Shqipëri të disa ekspertëve civilë e ushtarakë të caktuar prej Shoqërisë së Kombeve, por që të mos jenë prej shteteve të interesuar". Vetëm zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare, shkruanin në fund të telegramit delegatët shqiptarë, do t'i shërbente "forcimit të paqes në Ballkan dhe sigurimit të së mbarës e së mirës për të gjithë popujt që rrojnë aty".⁴³

Në të njëjtën ditë, më 11 shkurt, delegacioni shqiptar, përsëri me firmën e kryetarit L. Bumçi i dërgonte një notë proteste përfaqësuesve të fuqive kryesore evropiane, me anën e së cilës hidhte poshtë pretendimin e përsëritur se populli shqiptar ishte "i papjekur" për vetëqeverim. "Me notat e 15 dhe 19 janarit, theksonte L. Bumçi, delegacioni shqiptar pati rastin të protestojë para Konferencës së Paqes kundër projektit të [14 janarit] hartuar nga tre Fuqitë e Mëdha, lidhur me zgjidhjen e "Çështjes së Adriatikut", projekt që parashikon copëtimin e Shqipërisë.... i cili është në kundërshtim flagrant me klauzolat e Konferencës së Londrës të vitit 1913...".⁴⁴

Nota e sipërpërmendur jepte gjerësisht argumentet përse duhej ndryshuar qëndrimi në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Aty përmendeshin këmbëngulja italiane, e pamotivuar realisht, për të aneksuar Vlorën dhe për

⁴¹ *Shqipnia përpara Konferencës së Paqes*, Ble i Dytë, Shkodër: Shtypshkronja Franceskane, 1921, f. 65-67.

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *AQSH*, F. MPJ, D. 6(26). Notë e delegacionit shqiptar, dt. 11 shkurt 1920, dërguar Mileranit, kryeministër dhe ministër i Jashtëm i Francës. Nga përmbajtja e notës ajo është përgatitur e dërguar edhe krerëve të Fuqive të tjera të Mëdha evropiane.

të marrë mandatin mbi Shqipërinë, mandej shkatërrimet që kishte sjellë pushtimi i përkohshëm i trupave jugosllave e greke në viset që pretendonin për t'i aneksuar Beogradi e Athina. Te argumentet e karakterit “moral”, sikurse shënohej në notë, numërohej edhe shkelja e dispozitave ligjore të Lidhjes së Kombeve (neni 220), lidhur me kriteret që përcaktonin vendosjen e një popullit nën mandat. Në notën e 11 shkurtit, adresuar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, delegacioni shqiptar nënvizonte edhe argumentet politike, për të cilat duhej respektuar pikëpamja shqiptare për zgjidhjen e çështjes. Ndër to renditej ruajtja në të ardhmen e paqes në Ballkan, dhe për pasojë paqes në mbarë botën.

Duke arsyetuar përse Shqipëria nuk kishte pasur stabilitet në vitet pas krijimit të saj, çka kishte frymëzuar mendimin se shqiptarët nuk ishin të zot të vetadministroheshin, delegacioni shqiptar numëronte gjashtë faktorë. Sipas tij, Shqipëria pas krijimit, edhe në kufijtë e përcaktuar në Londër, nuk ishte zbrazur kurrë nga ushtritë e huaja, të cilat me terror të vazhdueshëm kishin shkatërruar vendin e kishin sjellë destabilitet. Përveç ballkanasve në këtë drejtim kishte ndikuar edhe rivaliteti midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për dominim, që kishin sjellë përçarje me propagandën e zhvilluar në Shqipëri. Presioni i tyre mbi Princ Vidin dhe qeverinë e tij, e kishte paralizuar qeverisjen efikase të vendit dhe kishte rrënuar autoritetin e kryetarit të shtetit. Për të njëjtën gjë kishte ndikuar edhe veprimtaria e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, arsyetonte në notë delegacioni shqiptar, pasi anëtarët e tij u pozicionuan sipas interesave të kundërta të shteteve që përfaqësonin. Tejkalimi i kompetencave nga kreu i misionit të oficerëve holandezë dhe mosbindja e tij ndaj urdhrave të qeverisë, theksohej më tej në notë, ishte gjithashtu faktor që kishte ndikuar në destabilitetin e vendit. Përmendej gjithashtu, edhe ndikimi negativ që përcolli mosrealizimi i premtimit që Fuqitë e Mëdha i bënë shtetit të ri, për ta kredituar me një hua prej 70 milionë frangash. “Shkurt, në të tilla kushte të mjerueshme u ndodh Shqipëria në çastin kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, që pati si pasojë dhunimin e asnjësisë dhe pushtimin e territorit të saj nga ushtritë e huaja, shprehej delegacioni shqiptar. Çdo vend tjetër, që do të ndodhej në hapin e parë të jetës së tij politike në të tilla kushte, nuk kishte si t’u shpëtonte pasojave të hidhura ...”.⁴⁵

Së fundi, delegacioni shqiptar i lutej Fuqive të Mëdha, t’i kishin parasysh faktet e paraqitura para se t’i konsideronin shqiptarët “të paaftë të vetëqeverisen” dhe para se të vendosnin “të dënojnë një popull të tërë të humbë pavarësinë dhe kombësinë e tij”.

⁴⁵ Po aty.

Nota përfundonte me konstatimin se “e vetmja mënyrë për të ruajtur paqen në Ballkan dhe rendin e qetësinë në Shqipëri, është dhënia e pavarësisë ... ruajtja e tërësisë së saj tokësore ... zbrazja e plotë... e tokave të saj nga ushtritë e huaja, si edhe ripohimi i asnjësisë së Shqipërisë, duke e garantuar atë nga Lidhja e Kombeve ...”.⁴⁶

Nota, sikurse shihet, nuk përmbante elementë të rinj të paparaqitur më parë, por çështja kishte hyrë në një rreth vicioz dhe delegacionit shqiptar nuk i ngelej veçse të këmbëngulte, duke shpresuar në mosmarrëveshjen italo-jugosllave dhe veçanërisht në diskordancën e diplomacisë amerikane me atë të tre Fuqive të Mëdha të Evropës. Më 11 shkurt 1920, anëtarët e delegacionit zyrtar shqiptar në Paris, L. Bumçi dhe M. Turtulli, dërguan edhe një raport tjetër, këtë herë në adresë të Aqif pashë Elbasanit. Përmes tij ata informonin për situatën në të cilën ndodhej çështja shqiptare për momentin.⁴⁷ Në raport theksohej se Konferenca e Paqes nuk e pati biseduar kurrë çështjen shqiptare në mënyrë të veçantë, por të lidhur me çështje të tjera, duke e trajtuar si një mjet shpërblimi për të sheshuar mosmarrëveshjet midis fqinjëve të Shqipërisë. Rreth një vit, raportonin më tej L. Bumçi e M. Turtulli, u kapërcyen disa herë rreziqe të mëdha, por deri kohët e fundit nuk ishte marrë ndonjë vendim. Gjatë kësaj periudhe, delegacioni sipas raportuesve, kishte vepruar gjithnjë në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar, të përmbledhura në kërkesat për integritetin brenda kufijve etnikë, në independencën dhe në sovranitetin e vendit. Në raport këmbëngulej se, delegacioni “nuk kishte pranuar kurrë as ma të voglin lëndim (cenim - M.V.) të këtyne të drejtave”.⁴⁸ Delegatët, raportonin më tej, se situata ndryshoi pas Memorandumit të SHBA, Britanisë dhe Francës, të 9 dhjetorit 1919, paraqitur Italisë, si opsion për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut” e në kuadër të saj edhe të çështjes shqiptare. Duke i dërguar Aqif Pashës në zarfën që përmbante raportin edhe kopjen e Memorandumit, të cilin dr. Turtulli e kishte siguruar prej delegatit jugosllav Trumbiq, dy delegatët shënonin se pikërisht me Memorandumin në fjalë tri Fuqitë e Mëdha i njihnin Italisë pushtimin dhe sovranitetin mbi qytetin dhe krahinën e Vlorës si edhe mandatin mbi Shqipërinë. Pasi trajtonin përfitimet që siguronte Jugosllavia e Greqia nga Memorandumi i 9 dhjetorit (përkatësisht për të parën, e drejta e daljes tregtare në Shqipërinë e Veriut, kurse për të dytën aneksimi i trevës së Gjirokastrës dhe diskutimi për Korçën), L. Bumçi dhe

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ AQSH, F. MPJ, D.8 (26). Raport i L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 11 shkurt 1920, dërguar nga Parisi Aqif pashë Elbasanit; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok, 68, f. 86-87.

⁴⁸ Po aty.

M. Turtulli i vinin në dukje Aqif Pashës se, lidhur me kufijtë jugorë dhe veçanërisht me rivënien në diskutim të fatit të Korçës, deri para disa ditësh u kishte munguar informacioni.

Në mbledhjet e mbajtura fillimisht në Londër e pastaj në Paris, krerët e Britanisë, Francës dhe Italisë, thuhej më tej në raport, nuk e morën parasysh Memorandumin e 9 dhjetorit dhe preferuan një projekt të 13 janarit, të përgatitur nga D. Llojd Xhorxhi, i cili vendoste për copëtimin e Shqipërisë.⁴⁹ Për sa i përket qëndrimit të Jugosllavisë, theksohej se ishte kundër projektit të 13 janarit, por ajo njëherësh i përmbahej idesë që, nëse Shqipëria copëtohej, do të kërkonte pjesë, madje nuk do të kënaqej me territorin deri në lumin Drin, por do të donte “edhe ma tepër”.

L. Bumçi dhe M. Turtulli vinin në dijeni Aqif Pashën, se eksperti i delegacionit britanik, Liper, më 22 janar u kishte thënë atyre dhe Mehdi Frashërit, që të bëhej një kërkesë, sipas së cilës Korça e Shkodra të mos aneksoheshin nga Greqia e Jugosllavia, “por të liheshin nën mandatin e këtyre mbretërive”. Ndërkohë, eksperti amerikan, Harrison, të cilin e kishin pyetur për këtë çështje i kishte këshilluar jo zyrtarisht që mos të lëviznin nga qëndrimi i parë dhe të mos pranonin asnjë lëshim ndaj tërësisë së vendit. Më vonë edhe eksperti italian, Kastoldi, u kishte thënë se Italia ishte gati të bënte disa lëshime në interes të Shqipërisë, që t’i detyronte edhe fqinjët e tjerë të hiqnin dorë nga kërkesat e tyre, por ata nuk i besonin pa marrë siguri nga qëndrime zyrtare. Raportuesit i dërgonin Aqif Pashës, bashkëngjitur me raportin, edhe notën e 11 shkurtit dërguar kryeministrave të tre Fuqive të Mëdha, që ishin mbledhur përsëri në Londër. Rreth dy javë më vonë, më 29 shkurt, L. Bumçi dhe M. Turtulli i raportonin sërish Aqif pashë Elbasanit rreth bisedimeve të fundit për çështjen shqiptare.⁵⁰ Në këtë letër dy delegatët pranojnë se kanë dijeni për vendimet e Kongresit të Lushnjës, nga një letër e dërguar më 28 janar 1920, nga Eshref Frashëri, zëvendëskryetari i Qeverisë së dalë nga Kongresi, por që atyre ajo u kishte mbërritur më 16 shkurt. Kjo do të thotë se ata e dinin nga data 16 shkurt se ishin zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, anëtarë të Këshillit të Lartë.* Gjithashtu e dinin se kolegu i tyre Mehmet Konica, i cili ndodhej në Londër, ku ishte zhvendosur trojka e të Mëdhenjve të Evropës për të diskutuar çështjet e

⁴⁹ *Po aty*. Bashkëngjitur raportit, Aqif Pashës i dërgohej, krahas Memorandumit të 9 dhjetorit, edhe projekti i 13 janarit, sipas versionit të botuar në gazetën “Le Temps”.

⁵⁰ *AQSH*, F. MPJ, D.5 (26). Letër e L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 25 shkurt 1920 për Aqif Pashën; shih edhe *Lufta e popullit...*, vëll. II, dok. 94, f. 132-133.

* Përbëhej nga Aqif pashë Elbasani, imzot Luigj Bumçi, dr. Mihal Turtulli dhe Abdi bej Toptani.

mbetura ende nga Konferenca e Parisit, ishte emëruar ministër i Jashtëm dhe se për të tre ata ishte vendosur se duhej të qëndronin aty ku ishin, për të mbrojtur çështjen shqiptare.

Është disi e paqartë përse në letrën e datës 25 shkurt flitet për njoftime të marra nga letra e dt. 28 janar e Eshref Frashërit, kur vendimet e sipërpërmendura të Kongresit të Lushnjës i përkasin datave 30 dhe 31 janar. Gjithashtu duket e çuditshme që vendimet e Kongresit t'u kenë mbërritur vetëm përmes kësaj letrë që udhëtoi për dy javë. Gjithsesi, përmes prononcimit të dy delegatëve, që e përfundojnë letrën adresuar Aqif Pashës duke paraqitur vendimin e tyre “të premë e të patundshëm” për dorëheqjen si delegatë të Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe lutjen “për të emnue sa më shpejt delegatë të tjerë”⁵¹, krijohet përshtypja se ata e konsideronin të mbyllur misionin e tyre diplomatik në Paris, ku kishin shërbyer në emër të Qeverisë së mëparshme të Durrësit, por, ndoshta, edhe për faktin se Konferenca e Paqes e Parisit tashmë ia kish lënë vendin takimeve të Trojkës së kryeministrave evropianë në Londër, Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve.

Në letrën e 25 shkurtit, L. Bumçi dhe M. Turtulli theksonin ndër të tjera se kishin vepruar në përputhje, “një me një, me programin e vendosur prej mbledhjes së Lushnjës” dhe se në “këtë udhë do të vijojmë për sa kohë do të mbetemi këtu”. Më tej, ata informonin për bisedimet që po zhvilloheshin në Londër midis kryeministrave të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë dhe për dy nota që presidenti i SHBA-së u kishte dërguar partnerëve evropianë.⁵² Të informuar me sa duket prej M. Konicës, që ndodhej në Londër, L. Bumçi dhe M. Turtulli i bënë të ditur Aqif Pashës se nota e parë përmbante kundërshtimin amerikan për shkeljen nga franko-britanikët të Memorandumit të përbashkët të 9 dhjetorit 1919. Por, shpreheshin dy delegatët shqiptarë, “dhantë zoti, u baftë ndonjë ndryshim me rranjë, pse edhe zgjidhja e parapame prej mendores së përmendun, e që ka pëlqimin e Amerikës, Shqipërisë i sjell dëm të madh”.⁵³

Konferenca e Paqes pas një viti veprimtarie, i mbylli punimet në Paris pa i përfunduar të gjitha çështjet që duhet të zgjidhte. Konferenca e kryeministrave të tre Fuqive të Mëdha evropiane, e mbledhur për çështjet kryesore në Londër e San Remo, dhe Konferenca e Ambasadorëve në Paris, do të vijonin të merrnin vendime. Do të duhej të angazhoheshin më tej, ndër

⁵¹ *Po aty*.

⁵² Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy (1908-1939)*, The Centre for Albanian Studies, London: 2005, f. 141.

⁵³ *AQSH*, F. MPJ, D. 5 (26). Letra e L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 26 shkurt 1920.

të tjera, edhe për çështjen shqiptare, apo vargun e problemeve të ndryshme të saj. Do të angazhohej gradualisht edhe Lidhja e Kombeve. Çështja shqiptare do të trajtohej në këto instanca edhe për disa muaj, madje ndonjë problem edhe për disa vjet, por kjo periudhë nuk është objekt i këtij artikulli.

Shkurtimisht mund të përmendet se delegacioni shqiptar në Paris, tashmë përfaqësues i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, i vijoi përpjekjet për një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes shqiptare. Në këtë kuadër nuk u ndalën takimet, dërgimi i telegrameve, letrave, notave e memorandumëve ndaj përfaqësuesve të fuqive botërore vendimmarrëse.

Në një letër të datës 24 shkurt 1920, dërguar nga Parisi kryeministrit të Britanisë së Madhe, njëherazi kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate në Londër, D. Lloid Xhorxhit, kryetari i delegacionit shqiptar L. Bumçi, e vinte në dijeni mbi mbledhjen e Kongresit të Lushnjës dhe vendimet e tij. Më 2 mars 1920 pasoi një notë në adresë të presidentit të SHBA-së.⁵⁴ L. Bumçi këtë herë shprehej kundër zgjidhjes që Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, i iniciuar nga diplomacia amerikane, i jepte çështjes shqiptare. Në telegram, shkruhej se delegacioni shqiptar shprehte “përshtypjen e tij të hidhur lidhur me planin për t’i dhënë Gjirokastrën Greqisë dhe për të vënë në diskutim trevën e Korçës”. Pasi bënte prezantimin e përkatësisë etnike dhe fetare të rajonit në fjalë, tashmë të përsëritur shpeshherë, se ndër 290 mijë banorë, 170 mijë ishin shqiptarë myslimanë dhe të tillë ishin edhe shumica e 120 mijë të krishterëve, nota theksonte se “provincat në fjalë ishin njohur si shqiptare nga Konferenca e Londrës më 1913”, madje ishin pranuar si të tilla edhe nga ish-ministrat grekë, Zografos e Karapanos, në Konferencën e organizuar më 1914 në Korfuz, në prani të Komisionit Ndërkombëtar.⁵⁵ Prandaj nënvizohej në notë, kalimi i tyre nën sovranitetin grek, do të sillte “skllavërimin e së paku dyqind mijë shqiptarëve”, që do të futeshin “nën zgjedhën e padurueshme të grekëve”. Duke e konsideruar të padrejtë copëtimin e shumë viseve shqiptare, më 1913, dhe pasojat për rreth një milion banorëve shqiptarë të tyre, L. Bumçi në notën e 2 marsit nënvizonte se po të ndodhnin cungime të tjera “sakrificat e imponuara Shqipërisë do të ishin vdekjeprurëse”.

⁵⁴ *Po aty*, Notë e delegacionit qeveritar shqiptar në Paris, dt. 2 mars 1920 për presidentin e SHBA-së; shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok.102, f. 139-140.

⁵⁵ Është fjala për bisedimet që filluan në Korfuz, më 9 maj 1914, midis Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të autorizuar nga Qeveria shqiptare, dhe përfaqësuesve të “Lëvizjes së Vorio-Epirit”, që përfunduan më 17 maj 1914 me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit.

Përfaqësuesit shqiptarë në Paris e dinin se diplomacia amerikane, duke firmosur Memorandumin e 9 dhjetorit 1919, ishte pajtuar me humbjen e Gjirokastrës në favor të Greqisë dhe me diskutimin e të ardhmes së Korçës, prandaj ofronin një gjetje, apo formulë të re kompromisi. “Shteti shqiptar është gati t’u njohë popullsive të këtyre viseve, nën garancinë dhe mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve, të gjitha të drejtat që u përkasin bashkësive etnike ose që kanë të bëjnë me besimet e tyre”⁵⁶ shkruhej në notën e 2 marsit. Më tej atje ripërsëritej, apo i ritërhiqej “vëmendja dashamirëse” presidentit Uillson, se aneksimi i Vlorës dhe krahinës së saj nga Italia ishte “në kundërshtim me të drejtën dhe vullnetin e popullit shqiptar, që u shpreh në mënyrën më të qartë edhe një herë në Asambleenë Kombëtare të Lushnjës më 28 të janarit ...”. Propozimi i delegacionit shqiptar për sa i përkiste ndërtimit të hekurudhës në Shqipërinë e Veriut që do t’i shërbente Jugosllavisë, konsistonte në ndërtim nga shteti shqiptar me kapitale të huaja, kurse përdorimin e lirë të saj do ta garantonte Lidhja e Kombeve.⁵⁷

Një ditë më pas, më 3 mars, L. Bumçi së bashku me M. Turtullin i nisën një letër tjetër Aqif Pashës, me të cilën e njoftonin për gjendjen në të cilën ndodhej çështja shqiptare në atë moment në optikën e Fuqive të Mëdha. Fillimisht ata e informonin se ishin “tue vazhdue gjithnjë në punë” dhe do të vijonin të punonin derisa të emëroheshin zëvendësit e tyre. Më tej i dërgonin notat e shkëmbyera midis Uillsonit dhe Ll. Xhorxhit e A. Milerandit, të cilat ato ditë ishin botuar nga media. Në tekstin e letrës duket qartë zhgënjimi i thellë, që u kishte sjellë Konferenca e Paqes, me mënyrën se si i kishte nëpërkëmbur interesat e Shqipërisë e të kombit shqiptar, deri me diskutimet dhe projektet më të fundit. “Sikurse keni për ta pa edhe ju vetë, shkruanin dy delegatët, dyshimet dhe frikën që rrokull një vjeti kemi pasë mbi qëllimet e liga të qeverive të mëdha kundër nesh, po vërtetohen mjerisht, një nga një të gjitha”.⁵⁸

Trajtimi i çështjes shqiptare në projektin apo kompromisin e 14 janarit 1920, theksonin më tej dy delegatët, ishte vazhdë e qëndrimit të Francës dhe Britanisë së Madhe, që nga marsi i vitit 1919. Qysh atëherë, Parisi dhe Londra kërkonin t’i kalonte Greqisë, Korça dhe Gjirokastra. Por, Shqipëria pësonte edhe nga Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, firmosur nga dy fuqitë e sipërpërmendura dhe SHBA. Humbja e Gjirokastrës dhe Vlorës,

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *AQSH*, F. MPJ, D. 5 (26). Letër e L. Bumçit dhe M. Turtullit për Këshillin e Lartë (Aqif Pashën), dt. 3 mars 1920; shih edhe *Lufta e popullit ...*, vëll. II, dok. 103, fl. 141-143.

vënia në diskutim e Korçës dhe caktimi i mandatit etj., gjithashtu do të ishin katastrofë për Shqipërinë. Por, notat e fundit midis krerëve të shteteve të sipërpërmendura, të cilat e trajtonin çështjen midis këtyre dy opsioneve, tregojnë se për ne situata mbetet “fort e rrezikshme”, konkludonin L. Bumçi dhe M. Turtulli. Gjithsesi, arsyetimin ata, “mbasi nuk kemi tjetër mbrojtje përveç Z. Uillson, nuk kemi mund të kundërshtohemi drejt projektit të tij; po jemi përpjekë që t’i japim të kuptojë se sipas atij projekti Shqipëria do të futet nën zgjedhë të huaj”.⁵⁹

Dy delegatët informonin gjithashtu se po bënë të pamundurën të lobonin “me të gjitha mënyrat pranë miqve të paktë”, që mund të gjendeshin. Ishte fjala për personalitete të jetës publike e politike të Francës e të Britanisë, dashamirës të kombit shqiptar, ose miq personalë të tyre “që merren me punët e Ballkanit”. Nesër do të duhet të shkojmë në Londër për pak ditë, informonin më tej L. Bumçi dhe M. Turtulli, “që të veprojmë në mes të qarqeve politike angleze me anën e miqve që kemi atje e të kardinalit të Londrës”.⁶⁰ Të bën përshtypje fakti, se me gjithë kushtet e vështira në të cilat vepronin, delegatët shqiptarë arrinin të siguronin një informacion të vlefshëm mbi hapat që ndërmerre diplomacia e Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare. “Konferenca e Londrës, ndërmjet kryetarëve të tri qeverive të besëlidhuna po vijon gjithnjë, i shkruanin ata Aqif Pashës; disa gazeta thonë se në këto ditë do të përndahej për t’u mbledhur prapë në fund të marsit”. Mandej e vinin në dijeni, se në bazë të lajmeve që jepnin gazetatat amerikane kishin mësuar se presidenti i SHBA-së kishte përgatitur një notë rreth “Çështjes së Adriatikut” mbi bazën e qëndrimit të Memorandumit të 9 dhjetorit, e cila pritej të mbërrinte shpejt në Londër. Nuk dihet nëse nota e sipërpërmendur e 2 marsit e dërguar telegrafisht nga L. Bumçi, mbërriti në duart e U. Uillsonit, por dihet se më 6 mars, presidenti amerikan dha një përgjigje përfundimtare për “Çështjen e Adriatikut”.⁶¹ Është nota për të cilën kishte pasur njoftime në shtypin amerikan e për të cilën i raportonin Aqif pashë Elbasanit, më 3 mars, dy delegatë shqiptarë.

Duke përkrahur propozimin për bisedime direkte italo-jugosllave, që të rrafshonin kontradiktat midis tyre, kreu i Shtëpisë së Bardhë, kishte theksuar se çështja shqiptare “nuk duhet futur në diskutimin e propozuar midis Italisë e Jugosllavisë” dhe se ai “nuk do të miratonte asnjë plan që do t’i jepte Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë, për atë që mund t’i shkëputej gjetiu”.

⁵⁹ *Po aty.*

⁶⁰ *Po aty.*

⁶¹ O. Pearson, *Albania and King Zog...*, f. 142.

Për sa i përkiste kërkesës jugosllave për një dalje ekonomike në Shqipërinë Veriore, U. Uillsoni deklaronte se qëndronte në linjën e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, “i cili, sipas pikëpamjes së tij, ka dispozitat e nevojshme për t’iu përgjigjur nevojave të Jugosllavisë”.⁶²

Vendosmëria e presidentit të SHBA-së i detyroi aleatët evropianë të tërhiqen. Këmbëngulja e tij për rreth dy muaj i erdhi në ndihmë njëherësh si Jugosllavisë edhe Shqipërisë. Jugosllavia kishte tani rastin të negocionte drejtpërdrejtë me Italinë, kurse për Shqipërinë rreziku i copëtimit u shty dhe shqiptarët fituan një kohë shumë të vlefshme, që ditën ta shfrytëzonin. Pas ditëve të para të marsit nuk do të kishte më përpjekje kolektive të Fuqive të Mëdha për të marrë vendime për statusin dhe kufijtë e Shqipërisë. Italia dhe Jugosllavia hynë në negociata të drejtpërdrejta për të gjetur një zgjidhje kompromisi për “Çështjen e Adriatikut”, kurse Britania e Madhe dhe Franca, u ndjenë të lehtësuara që e lanë gjetjen e marrëveshjes në mirëkuptimin midis dy të interesuarve problematikë. Deri në marrëveshjen e Rapallos që do të arrihej në nëntor,⁶³ shqiptarët patën kohën dhe fatin të eliminonin rreziqet e shumta. Pasi kishte nënshkruar protokollin e gushtit me Qeverinë shqiptare, që u shoqërua me heqjen dorë nga pretendimet në Shqipëri, Qeveria italiane nuk mund të lejonte të realizoheshin aty pretendimet e Jugosllavisë dhe Greqisë.

Çështja shqiptare do të vijonte të mbetej kështu e pazgjidhur edhe pas mbylljes së punimeve të Konferencës së Paqes të zhvilluar në Paris deri në janar 1920, edhe pas Konferencës së Londrës në vijim, të kryeministrave të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë, dhe pas Konferencës së San Remos që mbledhi sërisht Ll. Xhorxhin, A. Milerandin dhe F. Nitin, më 18-25 prill 1920. Ngecja në zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, që u tentua të realizohej nga negociatat midis Italisë e Jugosllavisë mbi bazën e përmbajtjes së Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, vijoi të mbante pezull edhe zgjidhjen e çështjes shqiptare.⁶⁴ Ndërkohë që delegacioni shqiptar në Paris dërgonte drejt San Remos një telegram me të cilin i bënin thirrje përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha evropiane, të respektonin pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë,⁶⁵ qeveria e Sulejman Delvinës dhe

⁶² *Po aty; Adriaticus, La Question Adriatique ...*, f. 149-150; shih edhe A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, dok.26, f. 255-257. Notë e Uillsonit e dt. 6 mars, në përgjigje të notës së aleatëve të dt. 26 shkurt 1920.

⁶³ Vuk Vinaver, *Jugoslavija i Francuska izmetju Dva Svetsko Rata* (Da li je Jugoslavija bila francuski “satelit”), ISI, Beograd: 1985, f. 26-27.

⁶⁴ Pietro Pastorelli, *L’Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Editore Jovere, Napoli: 1970, f. 284-285; Shih edhe P.Milo, *Politika e jashtme...*, vëll.I, f. 469.

⁶⁵ *AMPJ*, V. 1920, D. 34/1, fl. 407. Telegram i Mehmet Konicës në cilësinë e kryetarit të

Regjenca, të dala nga Kongresi i Lushnjës, përpiqeshin përmes përshëndetjeve e falënderimeve të ndikonin te krerët e diplomacisë amerikane, te U. Uillsoni, R. Lansingu etj.

Përparësia që Shqipëria dhe diaspora shqiptare në Amerikë u dha marrëdhënieve me SHBA, u shfaq edhe në caktimin e një komisioneri në Uashington (Kostandin Çekrezi), i cili u pranua në kontakte jozyrtare nga Departamenti i Shtetit. Në fillim të majit 1920, Mehmet Konica, ministër i Jashtëm i qeverisë Delvina, ndërkohë kryetar i delegacionit shqiptar, i bënte thirrje U. Uillsonit të mos e kërkonte më zbatimin e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919. Këmbëngulëse në synimin për ruajtjen e pavarësisë dhe tërësinë territoriale të vendit, Qeveria shqiptare bëri demarshe për të paraqitur kërkesat e veta kombëtare e për të propozuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike edhe në Beograd, Athinë e Romë.⁶⁶ Ndërkohë në Britaninë e Madhe po shtohet interesi për Shqipërinë. Prania jo pasive e kryediplomatit britanik në Shqipëri, Iden (Eden) gjatë përgatitjeve dhe zhvillimit të punimeve të Kongresit të Lushnjës në dhjetor 1919 - janar 1920,⁶⁷ misionet e Harold Temperlit (Harold Temperley)* në Tiranë, në maj dhe në shtator 1920, tregonin interesimin e Londrës, jo thjesht për të pasur një informacion të besueshëm për gjendjen e brendshme në Shqipëri. Të bën përshtypje se raportet e britanikëve të dërguar në Shqipëri ishin realiste, madje A. Temperli rekomandonte njohjen e Qeverisë shqiptare.

Në të njëjtën linjë bënin punën e tyre pranë Foreign Office -it miqtë e Shqipërisë, Obri Herbert etj. Por kthesa e dukshme në qëndrimin britanik do të merrej në nëntor. Shqiptarët ndërkohë kishin bërë luftën e Vlorës, Italia që dërguar matanë Otrantos dhe Jugosllavia e Greqia, pa të nuk mund të realizonin synimet e tyre në Shqipëri. Britania ishte tani në situatë komode të konfirmonte interesin e saj për Shqipërinë, çka u duk qartë në dhjetor, kur inicoi dhe mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e

delegacionit shqiptar, dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në San Remo.

⁶⁶ P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 471-473.

⁶⁷ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Kujtime dhe vlerësime historike, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Marin Barleti, 1935, f. 184, 194. Sipas S. Vllamasit në dhjetor 1919, në takimin në Gjirokastrë me Javer Hurshitin dhe Beso Gegën, kryetari i Bashkisë, deklaroi konfidencialisht se Qeveria britanike dëshironte formimin e një qeverie kombëtare në vend të asaj të Durrësit “që është vegël e italianëve”. Po ky bashkëkohës shënon në kujtimet e tij se diplomati Eden, njëherësh i “Inteligjencies Services”, prezent në Kongresin e Lushnjës, “kaloi disa orë ankthi, derisa u kuptua mirë, qëllimi i milicisë shqiptare kundër Kongresit”; shih edhe Marenglen Verli, *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 90.

* Nëpunës i legatës britanike në Beograd.

Kombeve. Shqipëria kishte mobilizuar të gjitha forcat e saj për të ruajtur pavarësinë dhe territorin e saj, por i kishte ndihur edhe fati.

Pakësimi i interesimit të SHBA për Evropën për shkak të problemeve politike të brendshme, dhe në kuadër edhe për Shqipërinë, u pasua kështu nga rritja e interesimit të Britanisë së Madhe për këtë vend. Por, vakumin në muajt prill-nëntor 1920 e mbushën vetë shqiptarët me mobilizimin e madh për të shpëtuar vendin e tyre që fatmirësisht rezultoi i efektshëm. Shqipëria kishte shpëtuar nga rreziku që i qëndroi mbi kokë gjatë gjithë zhvillimit të Konferencës së Paqes së Parisit. Mbetej të mbroheshin rezultatet e arritura në vitin 1920 dhe të konsolidohej e demokratizohej shteti i brishtë, që i kishte shpëtuar asgjësimit.

Marenglen VERLI

SUMMARY

THE GREAT POWERS DIPLOMACY AND THE CHALLENGE OF ALBANIANS IN JANUARY 1920

It is generally known the progress of the Albanian question approach at the Peace Conference. Nonetheless neutral in the world conflict, Albania risked to be annihilated. The accord or the compromise of the 13-14 January 1920, was the peak of the worst. In absence of the USA representative, France, Great Britain and Italy approved a solution variant that was opposed not only by the USA but even from Yugoslavia. Exactly from this moment the developments in the Albanian soil of diplomacy and popular movement took an interesting path, which historiography should deepen the view. This paper aims to shed light in the weekly days after the January 14 compromise who visibly influenced the growing of the Albanian factor in taking the decisions for the future of Albania.

Was lucky for Albanians that Yugoslav delegation as a cause of internal contradictions between the Croatian Ante Trumbić (foreign minister) and the Serb Nikola Pasic (premier), wouldn't accept to renounce from Fiume to accept compensations in Albania. This slack of the process introduced the USA, that had not signed the January 13-14 compromise, but were forced to accept, if the Yugoslavs and the Italians would agree for the solution offered from the Franco-British diplomacy. Meantime in Albania, there was a general conscience about the catastrophic decisions of the Conference for Albania and was overwhelmed the view that it should be radicalized the stands against the further dismemberment of the country after 1913. Also, on January 21 had started the works the Lushnja Congress that on January 28-31, in the conditions when the diplomatic efforts for the reassert of the Albanian state independence and its integrity wouldn't give any result, undertook the organizing of the internal popular resistance. The decrease of the USA concern for Europe as a cause of internal political problems, and in the framework even for Albania, was followed from the growing of interest of the Great Britain for this country.

KUD: 94(496.5) .086/.087
94(497.1) "1921/1922"
327(496.5:497.1)

Sali KADRIA

ÇËSHTJA E CAKTIMIT TË KUFIJVE SHQIPTARO- JUGOSLLAVË NË VITET 1921-1922

Rreziku që i vinte Shqipërisë nga shtetet fqinje në lidhje me kufijtë e saj u shfaq që më 9 nëntor 1921. Përfaqësuesi britanik në Konferencën e Ambasadorëve deklaroi se dëshironte t'u tërhiqte vëmendjen përfaqësuesve të fuqive të tjera se vendimi që po nënshkruanin, konfirmonte në përgjithësi vijën kufitare të Shqipërisë të caktuar në vitin 1913, megjithatë ky vendim i bënte kësaj vije korrigjime lokale, disa prej të cilave kishin një shtrirje shumë të rëndësishme.¹

Vendimi i datës 9 nëntor 1921, nuk i kënaqi shqiptarët, sepse ai e privonte Shqipërinë nga disa vise në sektorët e Dibrës, Podgoricës dhe të Prizrenit². Qëndrimi i “ftohtë” që mbajtën Fuqitë e Mëdha ndaj çështjes shqiptare, i detyroi shqiptarët që ta pranonin si “fait accompli” vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të Parisit. Përfaqësuesit kombëtarë shqiptarë mendonin se mospranimi i vendimit nga shqiptarët, do ta linte Shqipërinë pa kufij të njohur ndërkombëtarisht, e cila do të sillte me siguri një pushtim greko-serb. Gjithashtu, ata vendosën të pranonin këtë vendim me argumentin se në rast të një qëndrimi të kundërt, Shqipëria rrezikonte të humbiste simpatinë e Fuqive të Mëdha si dhe “miqtë” e tjerë të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Më 18 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve njoftoi Qeverinë shqiptare dhe atë jugosllave lidhur me vendimin për

¹ *The British National Archives*, (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/ 5730, Deklarata e bërë nga lordi Hardinge i Penshurst, para nënshkrimit të tekstit të vendimit të 9 nëntorit 1921.

² TNA, FO 371/ 7331, A. Young për markezën Curzon të Kedleston, Beograd, 30 janar 1922; Miranda Vickers, *Shqiptarët. Një histori moderne*, përkthyer nga Xhevdet Shehu, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2008, f. 161.

krijimin e zonës neutrale të përcaktuar në seksione të veçanta dhe u kërkoi atyre tërheqjen e forcave të armatosura nga kjo zonë.³

Qeveria shqiptare i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve që të lejohej të formonte një trupë xhandarmërie shqiptare e cila të vendosej në zonën neutrale që tashmë ndodhej nën kontrollin e saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë.⁴ Edhe qeveria jugosllave kërkoi vendosjen e forcave të saj të xhandarmërisë në zonën neutrale, për të garantuar sigurinë e Komisionit të Caktimit të Kufijve në terren.⁵ Meqenëse secila palë kërkonte vendosjen e trupave të saj në zonën neutrale, kërkesa e Qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave u refuzua nga Konferenca, pasi u gjykua se prania e tyre mund të çonte në një konflikt të armatosur midis dy shteteve.⁶

Qeveria jugosllave kërkoi shtyrjen e afatit të tërheqjes së trupave të saj nga zona neutrale deri më 10 dhjetor 1921, për shkak të kushteve të vështira atmosferike të stinës së dimrit.⁷ Megjithëse Konferenca e Ambasadorëve kishte kërkuar tërheqjen e trupave ushtarake të dy shteteve nga zona neutrale, deri më 20 dhjetor 1921, forcat jugosllave nuk u tërhoqën plotësisht nga kjo zonë. Me sa dukej, Qeveria jugosllave synonte të mbante një pjesë të këtyre forcave në zonën neutrale.⁸ Për të justifikuar praninë e këtyre trupave në zonën neutrale, ajo vazhdoi me akuzën tashmë të njohur se bandat shqiptare vazhdonin të kryenin eksese në pjesën e territorit të saj, si dhe duke përdorur argumentin se ajo nuk pranonte të tërhiqte trupat e saj nga disa pjesë të zonës neutrale, pa u tërhequr forcat e ushtrisë dhe të xhandarmërisë shqiptare të cilat i mbanin të pushtuara.⁹ Madje, Qeveria jugosllave kërcënonte se ajo do të detyrohej të ripushtonte zonën neutrale nëse qeveria e Tiranës nuk do t'i përmbahej neutralitetit.¹⁰

³ TNA, FO 371/ 5735, Konferenca e Ambasadorëve për Mid'hat Frashërin, përfaqësuesin e Shqipërisë dhe për të ngarkuarin me Punë të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllavene, Paris, 18 nëntor 1921.

⁴ Po aty, FO 371/ 5734, Notë e Mid'hat Frashërit për Jules Cambon, kryetarin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris, datë 21 nëntor 1921.

⁵ Po aty, FO 371/ 5735, Tel. i Lord Hardinge për markezin Curzon të Kedleston, Paris, 29 nëntor 1921.

⁶ Po aty, FO 371/ 5734, Tel. i Legatës britanike në Paris për F. O., Paris, 23 nëntor 1921; Po aty, FO 371/ 5735, Lord Hardinge për markezin Curzon të Kedleston, Paris, 7 dhjetor 1921.

⁷ Po aty, FO 371/ 5735, Lord Hardinge për Foreign Office, Paris, 10 dhjetor 1921.

⁸ Po aty, FO 371/ 5736, Tel. i Heathcote-Smith për Foreign Office, Durrës, 13 dhjetor 1921.

⁹ Po aty, FO 371/ 5736, Tel. i Sir A. Young për Foreign Office, Beograd, 27 dhjetor 1921; Po aty, FO 371/ 7326, Ekstrakt i gazetës serbe "Epoka", bashkëlidhur relacionit të sir A. Young për Foreign Office, Beograd, 27 dhjetor 1921.

¹⁰ Po aty, FO 371/ 7326, Letër e Jules Cambon për sir E. Drummond, Sekretar i

Përfaqësuesi britanik në këtë konferencë kishte kundërshtuar mbajtjen të pushtuar të zonës neutrale nga trupat jugosllave dhe kërkoi dërgimin e Komisionit të Çaktimit të Kufijve të Shqipërisë sa më shpejt të ishte e mundur në terren.¹¹

Mbështetur në propozimin e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që zona neutrale në kufirin midis Shqipërisë e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene duhej të zgjerohej. Të dy qeveritë duhej të tërhiqnin forcat e tyre nga zona neutrale deri sa të përcaktohej vija kufitare midis dy shteteve.¹² Anëtarët e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve deklaruan se gjatë inspektimit të zonës neutrale, ata nuk kishin gjetur asnjë bazë reale për pretendimet e palës jugosllave se, pas tërheqjes së trupave të tyre nga zona e Dibrës mund të ndodhnin trazira. Ky komision theksonte së në pjesën e zonës neutrale që inspektoi nuk kishte anarki dhe për këdo që njihte këto anë, situata ishte më e qetë nga sa mund të pritej.¹³

Qysh më 17 janar 1922, Fuqitë e Mëdha formuan Komisionin për Çaktimin e Kufijve të Shqipërisë (KCK). Më 18 janar 1922, Komisioni Hetimor njoftonte Lidhjen e Kombeve se trupat serbe mbanin ende të pushtuar manastirin e Shën Naumit.¹⁴ Në fillim të muajit mars 1922, Komisioni i Çaktimit të Kufijve arriti në Shqipëri. Ai përbëhej nga koloneli britanik J. Giles, koloneli francez Perre dhe gjenerali italian Enrico Tellini. Delegati shqiptar në KCK ishte ushtaraku dhe diplomati i shquar Ali Riza Kolonja. Delegatët e shteteve të interesuara për kufirin kishin të drejtën të jepnin mendim, por nuk kishin të drejtën e vendimmarrjes. Konferenca e Ambasadorëve kishte përcaktuar një zonë neutrale me një gjerësi 10 kilometër për çdo anë të kufirit. Kufiri shqiptaro-jugosllav u nda në gjashtë seksione që fillonin nga grykëderdhja e lumit Buna dhe mbaronin në pjesën e liqenit të Prespës, në kufirin ku ndaheshin Shqipëria, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene dhe Greqia.¹⁵

Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Paris, 7 janar 1922.

¹¹ *Po aty*, FO 371/ 5736, Lord Hardinge për Foreign Office, Paris, 28 dhjetor 1921.

¹² *Po aty*, FO 371/ 7326, Telegram i Ambasadës britanike për Foreign Office, Paris, 18 janar 1922.

¹³ *Po aty*, FO 371/ 7326, H. C. A. Eyres për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, 14 shkurt 1922.

¹⁴ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: "Shtëpia botuese Enciklopedike", 1992, f. 209.

¹⁵ *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: "Toena", 2007, f. 206, Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: "55", 2006, f. 180.

Kryeministri jugosllav N. Pashiç kërkonte shtyrjen e përcaktimit të kufirit verior nisur nga mendimi se nëse në këtë periudhë shmangej vendimi ndërkombëtar përfundimtar për kufijtë me Shqipërinë, situata në të ardhmen mund të rikthehej në favorin e jugosllavëve. Anëtarët e Qeverisë shqiptare ishin ndarë në dysh në lidhje me çështjen se nga cila anë duhej të fillonte punën Komisioni i Caktimit të Kufijve. Shumica e anëtarëve të qeverisë mendonin se kufiri me Greqinë kishte rëndësi më të madhe, por Ahmet Zogu nuk ishte i bindur se gjendja në kufirin verior ishte më e sigurtë.¹⁶ Komisioni i Caktimit të Kufirit Verior vendosi të merrej fillimisht me përcaktimin e kufirit verior të Shqipërisë. Mirëpo, sapo filloi punën ai ndeshi në problemin e përkatësisë së territorit të Vermoshit dhe të Shën Naumit.¹⁷ Qeveria shqiptare ishte e shqetësuar nga dislokimi i trupave jugosllave në zonën e Shën Naumit.

Në pranverë të vitit 1922, komisioneri britanik i raportonte Qeverisë britanike se zona neutrale në pjesën veriore të Shqipërisë ishte mbushur me agjentë serbë të drejtuar nga ish-gjenerali i ushtrisë malazeze Martinoviq, i cili paguhej nga Qeveria jugosllave. Përmes shpërndarjes së të hollave, këta agjentë propagandonin në mesin e banorëve të luginës së Cemit dhe të Vermoshit se, Komisioni kishte vendosur shkëputjen e tyre të plotë nga Shkodra. Prandaj, e vetmja shpresë për ta ishte t'i kërkonin Qeverisë jugosllave përfshirjen e tyre në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene. Ndryshe nga sa pritej, komisioneri britanik, J. Giles, shprehej se prania e delegatit shqiptar Ali Riza Pashë Kolonjës, në këtë komision, u pa me dyshim nga banorët e zonës së Malësisë së Mbishkodrës. Meqenëse ky i fundit ishte një ish-zyrtar osman, i cili kishte jetuar më herët në Turqi dhe pronat e tij gjendeshin në skajin jugor të Shqipërisë, malësorët katolikë dyshonin se ai nuk do të tregonte interesin e duhur për të mbrojtur trojet dhe pasurinë e tyre.¹⁸ Në qershor-korrik 1922, Komisioni i Caktimit të Kufijve shkoi në Guci dhe Vermosh për të dëgjuar palët e interesuara. Komisioni i Caktimit të Kufijve të Veriut i kërkoi Qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave që të merreshin masa për lirimin e territorit kufitar midis tyre, duke e kthyer atë në zonë neutrale, deri në përcaktimin përfundimtar të vijës kufitare mes

¹⁶ TNA, FO 371/ 7331, H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 15 qershor 1922.

¹⁷ Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi 151 (më tej: F), Viti 1922 (më tej: V.), Dosja 43 (më tej: D), fl. 1, Letër e Ali Riza Kolonjës delegatit shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Korçë, 26 shkurt 1922.

¹⁸ TNA, FO 371/ 7330, Raport i Kol. Liet. britanik J. Giles për ngjarjet në Komisionin e Caktimit të Kufijve nga data 1 deri më 31 maj 1922, Shkodër, 31 maj 1922.

dy shteteve. Ai u deklaroi të dy qeverive se vendimi për krijimin e zonës neutrale për një periudhë të përkohshme, nuk kishte asnjë lidhje me vendimin e caktimit të kufirit përfundimtar midis dy shteteve. Komisioni ishte i mendimit se gjerësia e zonës neutrale duhej të ishte sa më e ngushtë që të ishte e mundur, sepse derisa të vendoseshin kufijtë, kjo zonë do të mbetej jashtë ligjit. Prandaj, gjatë kësaj periudhe rendi publik duhej të mbahej aq sa ishte e mundur.

Më 17 korrik 1922, Qeveria jugosllave kërkoj rektifikimin e kufirit shqiptaro-jugosllav në zonën e Vermoshit. Ndërkohë, trupat jugosllave pushtuan fshatin Vermosh dhe pavarësisht protestave të Qeverisë shqiptare, ato nuk u larguan prej tij me pretekstin se fshati ndodhej brenda shtetit jugosllav por jashtë zonës neutrale.¹⁹ Qeveria jugosllave shfaqti pretendimet e saj mbi Vermoshin, duke argumentuar nga pikëpamja ekonomike se ky vend ishte i vetmi shteg kalimi i fisit të Kuçit për në krahinën e Gucisë. Ajo pretendonte se sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit të vitit 1878, zona e Vermoshit i përkiste fisit malazez të Kuçit, por Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913, e la Vermoshin brenda shtetit shqiptar, duke u prerë rrugën fiseve të Kuçit dhe Vasojeviçit për në Guci.

Në fakt, një pjesë e mirë e kullotave kishin mbetur jashtë Shqipërisë në vitin 1913, duke i privuar banorët e fshatit Vuthaj nga burimi i vetëm i jetesës së tyre. Qëllimi i drejtuesve të Qeverisë jugosllave ishte aneksimi i plotë i Vermoshit, pasi përmes kësaj zone krijohej një rrugë e shkurtër, e cila mund të lidhte Serbinë me Adriatikut. Për shkak të problemeve ndërkufitare, rreth 100 familje nga krahina e Kelmendit u detyruan të zbrisnin në brigjet e Adriatikut pasi ishte e pamundur që ata të jetonin në këtë klimë konflikti.²⁰ Komisioni i Caktimit të Kufijve arriti në përfundimin se Vermoshi duhej t'i përkiste Shqipërisë. Qeveria jugosllave protestoi kundër këtij vendimi me argumentin se vija kufitare në këtë sektor cenonte ekzistencën ekonomike të banorëve të saj si dhe vija kufitare ishte caktuar shumë pranë qytetit të Podgoricës, duke rrezikuar sigurinë e tij. Në fillim, Konferenca e Ambasadorëve mbajti një qëndrim të prerë kundër kërkesës jugosllave për Vermoshin, por më vonë Qeveria franceze ndryshoi qëndrimin e saj.²¹

¹⁹ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 211.

²⁰ "Jugosllavt nuk kan të ngim - Malcija e Madhe në rrezik. Nierzt e shtetit t'onë a do t'a dijnë ket punë?", në *Ora e Maleve*, nr. i veçantë, Shkodër, 9 shtator 1923, f. 1-2.

²¹ *Affaire du Monastère de Saint-Naoum: (Frontière Albanaise). Publications de la Cour Permanente de Justice Internationale. Serie B. Actes et documents relatifs aux arrêts et aux avis consultatifs de la Cour. 15 juin – 4 septembre 1924, Documents relatifs à l'avis*

Më 18 korrik 1922, në notën e paraqitur nga delegacioni francez në Konferencën e Paqes thuhej se “është e vështirë të mohohet vlera e disa prej argumenteve të paraqitura prej Qeverisë serbo-kroato-slllovene”. Me sa dukej qëndrimi francez kushtëzohej edhe nga interesat ekonomike, sepse një kompani franceze kishte blerë pyjet malazeze në rrethin e Orakovcit ku 1/3 e pyjeve ishin të malazezëve dhe 2/3 u përkisnin shqiptarëve të Kelmendit. Përfundimi i Komisionit të Caktimit të Kufijve u përcaktua në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, më 11 tetor 1922.²² Konferenca e Ambasadorëve me vendimet e saj të datave 10 nëntor 1922 dhe 13 janar 1923, miratoi përfundimisht vijën kufitare në veri dhe verilindje të Shqipërisë. Pas këtij vendimi u suprimua zona neutrale për këtë sektor kufitar, por në praktikë mbeti e diskutueshme çështja e Vermoshtit.²³

Çështja e Shën Naumit u kthye në një çështje të rëndësishme për Qeverinë shqiptare dhe për opinionin publik në Shqipëri. Shkaku ishte se gjatë vitit 1913, Komisioni i Caktimit të Kufirit nuk arriti të shkonte në sektorin nga Struga deri në manastirin e Shën Naumit. Duke përfutur nga rasti, trupat ushtarake serbe përfshinë nën kontrollin e shtetit serb zonën malore dhe një pjesë të fushave të katundeve Tushemisht, Zagorçan, Çërravë dhe Alarup. Në mesin e muajit tetor 1920, popullsia e Pogradecit i kërkonte kryetarit të Parlamentit shqiptar që të rregulloheshin kufijtë nga ana e manastirit të Shën Naumit në dobi të shtetit shqiptar. Ata sugjerorin që kufiri mes dy shteteve të ndante në mes liqenit e Ohrit që nga vendi i quajtur Gurët e Gjetë në grykën e Malit të Thatë, ku pjesa veriore t’i mbetej shtetit jugosllav, ndërsa ajo jugore, e cila përfshinte katundet Tërpezicë, Lubanishtë dhe Peshkëpi, t’i mbetej shtetit shqiptar.²⁴ Ndërkohë, kryeministri jugosllav, N. Pashiq, jo vetëm që kundërshtonte dorëzimin e Shën Naumit, por ai kishte kërkuar më herët që fshati Lin pranë Pogradecit duhej të mbetej brenda shtetit jugosllav, me pretendimin se banorët e tij ishin kryesisht sllavë.²⁵ Në fund të muajit gusht 1922, Komisioni i Caktimit të Kufijve u vendos në Strugë për t’u marrë me sektorin e zonës përreth

consultative. Société D’ éditions A. W. Sijthoff - Leyde, no. 9, 1924, pp. 115-116, 117.

²² Amadeo Giannini, *L’Albania dall’ indipendenza all’unione con l’Italia 1913-1939*, Milano: Istituto per gli studi di politica internazionale, 1940, p. 155.

²³ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 212.

²⁴ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, trajtesë dhe dokumente të përgatitura nga prof. dr. Kaliopi Naska, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2012, dok. nr. 4, f. 43-44, Letër [mungon emri i dërgues-it/ve], drejtuar kryetarit të Parlamentit të shtetit shqiptar, Pogradec, 14 tetor 1920.

²⁵ *TNA*, FO 371/ 7331, A. Young për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, 30 janar 1922.

Shën Naumit. Përfaqësuesit e tij u kërkuan dy qeverive të interesuara që të merrnin masa për krijimin e një zone neutrale.

Delegati jugosllav shprehej se Qeveria jugosllave nuk mund të pranonte krijimin e një zone neutrale. Ai mbronte mendimin se kufiri në këto zona ishte caktuar sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës dhe sipas marrëveshjes së arritur midis qeverive të Serbisë dhe Greqisë. Prandaj, ky kufi konsiderohej përfundimtar dhe se nuk kishte më vend për vazhdim të kontestimeve midis serbëve dhe shqiptarëve. Ali Kolonja u deklaroi anëtarëve të Komisionit se pohimi i delegatit jugosllav nuk ishte i vërtetë, pasi KCK-ja duke mos qenë në gjendje t'i studionte këto zona në vitin 1913, nuk kishte se si të merrte vendime dhe se vija kufitare e përcaktuar sipas marrëveshjes mes qeverive serbe dhe greke nuk mund të kishte karakter zyrtar ndërkombëtar. Komisioni mori në konsideratë argumentet e delegatit shqiptar. Shumica e anëtarëve të saj ishin të mendimit se territori në jug të liqenit të Ohrit që shtrihej deri në Shën Naum, përfshirë edhe Peshkëpinë, duhej t'i përkiste Shqipërisë. Ata nuk kishin arritur ende në një mendim përfundimtar lidhur me të ardhmen e Shën Naumit dhe të Lubanishtës. KCK i kërkoi delegatit jugosllav që qeveria e tij të vepronte në pajtim me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, të evakuonte zonën neutrale brenda një afati të shkurtër.²⁶

Në gusht të vitit 1922, Konferenca e Ambasadorëve vendosi t'i kërkohej në mënyrë të prerë Qeverisë jugosllave tërheqja e plotë dhe e menjëhershme e të gjitha forcave të saj nga zona neutrale dhe të merrte masat e duhura për të parandaluar dhunimin e saj në të ardhmen.²⁷ Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve propozoi përfshirjen e manastirit të Shën Naumit në zonën neutrale. Konferenca e Ambasadorëve pranoi propozimin e Komisionit Hetimor për përfshirjen e manastirit të Shën Naumit në zonën neutrale. Komisioni Hetimor u shpreh se çështja e Shën Naumit mund të merrte zgjidhje, nëse ky vend lirohej dhe i rikthehej përfundimisht Shqipërisë. Ky komision i paraqiti Komisionit të Caktimit të Kufijve disa dokumente mbi të cilat mund të mbështetej vendimi përfundimtar për këtë çështje.²⁸

²⁶ *AQSH*, F. 151, V. 1922, D. 43, fl. 9-10, Shkresë e Ali Kolonjës, delegat shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, Strugë, 2 shtator 1922.

²⁷ *TNA*, FO 371/ 7327, Ambasadori britanik, Lord Hardinge, për Foreign Office, Paris, 31 gusht 1922.

²⁸ *Po aty*, FO 371/ 7328, Raport për Shqipërinë i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, 26 janar 1922; *Po aty*, FO 371/ 7329, Raport i përgjithshëm për Shqipërinë i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve paraqitur para Këshillit të Lidhjes

Çështja se cilit shtet duhej t'i përkiste territori i Shën Naumit hapi një debat të nxehtë në mesin e anëtarëve të Komisionit të Kufijve. Problemi lidhej me faktin se vendimi final i paraqitur në protokollin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, ishte shkruar në trajtën se kufiri “shkon deri në Shën Naum”. Pra, nuk përcaktohej qartë nëse shprehja “deri në” përfshinte apo jo Shën Naumin brenda kufijve të shtetit shqiptar. Qeveria shqiptare pretendonte se kjo shprehje e përfshinte Shën Naumin brenda kufijve të shtetit shqiptar, ndërsa Qeveria jugosllave doli me argumentin se me këtë shprehje, aktet ndërkombëtare nuk e përfshinin brenda territorit shqiptar manastirin e Shën Naumit.²⁹

Komisioneri britanik, J. Giles, ishte i bindur se sipas protokollit të mbajtur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, manastiri i Shën Naumit duhej t'i kalonte shtetit serb. Përfundimisht, J. Giles i shprehu mendimin e tij Foreign Office se, procesverbalet e Konferencave të Ambasadorëve të viteve 1913 dhe 1921 parashikonin që Shën Naumi të mbetej jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, meqenëse pjesa e tretë e komisionit nuk kishin arsye të forta lokale që dilnin kundër pikëpamjes së tij, ai ishte i mendimit që Qeveria britanike duhej të mbështeste pikëpamjen serbo-kroato-slllovene.³⁰ Qeveria italiane kërkoi që Konferenca e Ambasadorëve në Paris duhej të merrte vendim për çështjen e Shën Naumit.³¹

Qeveria jugosllave protestoi kundër përfundimit të arritur nga shumica e Komisionit të Kufijve, që manastiri i Shën Naumit duhej t'i kalonte Shqipërisë. Ajo parashittoi argumentin se në vitin 1913 ky territor iu njoh Serbisë dhe Qeveria jugosllave nuk pranonte asnjë lloj diskutimi për këtë çështje.³² Qeveria jugosllave u shpreh se fshatrat përreth Shën Naumit në pjesën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene ishin popullsi e krishterë që i përkisnin kombësisë sllave. Në fshatrat e zonës përreth Shën Naumit, si Tushemisht, Zagoriçan, Çërravë dhe Alarup dominonte popullsia sllave. Sipas saj, Pogradeci, Starova, Rëmenji dhe Vërdova kishin popullsi

së Kombeve, datë 24 prill 1922.

²⁹ Mehdi Frashëri, *Kujtime 1912-1933*, Tiranë: Omsca, 2005, f. 173; Monika Shoshori Stafa, *Çështja e Shën Naumit*, studim historiografik - dokumentues, Tiranë: “Albas”, 2008, f. 50-52.

³⁰ TNA, FO 371/ 7327, Telegram i Foreign Office për H. C. A. Eyres në Durrës [që t'i transmetohej J. Giles], F. O., 18 gusht 1922.

³¹ Po aty, FO 371/ 7327, Telegram i Bentinck për Foreign Office, Athinë, 17 gusht 1922.

³² Po aty, FO 371/ 7327, Legata serbe për Foreign Office, Londër, 12 gusht 1922.

të përzier të përbërë pothuajse përgjysmë nga sllavë të krishterë dhe shqiptarë myslimanë.³³

Mungesa e qartësisë lidhur me përkatësinë e Shën Naumit, lidhej me faktin se nga të gjitha konferencat e ambasadorëve, ajo e Londrës e vitit 1913 dëshmonte më tepër dobësi në hartimin e dokumentacionit në lidhje me vendimet e saj. Sipas protokollit të datës 19 mars 1913 të kësaj konference, në tekstin e projekt-propozimit italian thuhej si më poshtë: “Kufiri do të fillonte nga bregu jugor i liqenit të Ohrit midis qytetit të Starovës dhe manastirit të Shën Naumit, i cili do të mbetej jashtë Shqipërisë”. Në tekstin e projektit austro-hungarez për kufijtë e Shqipërisë të datës 21 maj 1913 thuhej se “kufiri do të ndiqte bregun perëndimor të liqenit të Ohrit pranë fshatit të Linit dhe duke e përshkruar liqenin, do të dilte në bregun e tij jugor në një pikë midis manastirit të Shën Naumit që do të mbetej jashtë Shqipërisë dhe fshatit Starovë...”.³⁴

Më 8 gusht 1913, para se të nënshkruhej protokollin për kufijtë jugorë të Shqipërisë, ambasadori austro-hungarez, Mensdorff, që përfaqësonte Austro-Hungarinë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër paraqiti projektin e Vjenës për caktimin e kufijve jugorë të Shqipërisë. Në pikën 2 të këtij projekti, përcaktohej shprehimisht: “...Kazaja e vjetër osmane e Korçës bashkë me bregun perëndimor dhe jugor të liqenit të Ohrit, nga fshati Lin deri në manastirin e Shën Naumit janë integrisht pjesë të Shqipërisë”. Ky propozim nuk ndeshi në kundërshtimin e pjesëmarrësve dhe u miratua nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës si vendimi përfundimtar për kufirin jugor të Shqipërisë, më 11 gusht 1913.³⁵

Në shtator 1922, komisionerët italianë dhe francezë parashtruan mendimin se Komisioni i Caktimit të Kufijve në vitet 1913-1914, kishte vendosur që fshati Lin t’i mbetej shtetit serb, por sipas vendimit të 9 nëntorit 1921, parashikohej që fshati Lin duhej t’i kalonte Shqipërisë. Problemi kryesor sipas tyre qëndronte në faktin se në këtë dokument nuk thuhej asgjë për manastirin e Shën Naumit. Komisionerët italianë dhe francezë

³³ *Po aty*, FO 371/ 7327, Aide-Memoire e Legatës serbe në Londër për Foreign Office, Londër, 29 gusht 1922.

³⁴ *Po aty*, FO 371/ 7327, Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, datë 18 gusht 1922; *Po aty*, FO 371/ 7330, Miles W. Lampson në emër të sekretarit të Shtetit për lord Hardinge në Paris, F. O., 22 shtator 1922.

³⁵ *Österreich-Ungarns Aussenpolitik: von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914. (Teil 2: Diplomatische Aktenstücke, 27. Februar 1909 bis 31. August 1910) Veröffentlichungen der Kommission für neuere Geschichte Österreichs; Band 20*, Wien, Leipzig: Österreichischer Bundesverlag, (1930), dok. no. 8353, pp. 120-121.

mendonin se protokolli i vitit 1913 ia kishte dhënë Shqipërisë manastirin e Shën Naumit. Ata shpreheshin se mungesa e përcaktimit në vendimin e datës 9 nëntor 1921 se cilit shtet duhej t'i përkiste Shën Naumi, nënkuptonte se ky manastir duhej t'i mbetej Shqipërisë. Ndryshe nga këta të fundit, komisioneri britanik, J. Giles, shfaqti mendimin se nëse Konferenca e Ambasadorëve e Parisit kishte për qëllim t'ia jepte Shqipërisë territorin e Shën Naumit, ajo do ta kishte përshkruar në mënyrë të ngjashme me rastin e Linit ose si në protokollin e vitit 1913. Komisioneri britanik i rekomandoi qeverisë së tij se Konferenca e Ambasadorëve duhej ta përcaktonte në mënyrë të qartë këtë çështje. Në të kundërtën, theksonte ai, Komisioni i Caktimit të Kufijve me shumicë votash do t'ia jepte shtetit shqiptar manastirin e Shën Naumit si dhe rrethinat e tij deri në Çërravë.³⁶

Qeveria britanike njoftoi Konferencën e Ambasadorëve se zgjidhja e çështjes së Shën Naumit kishte ndeshur vështirësi. Shkak për këtë ishin bërë opinionet e ndryshme që kishin anëtarët e Komisionit të Caktimit të Kufijve në lidhje me manastirin e Shën Naumit. Ambasadori britanik i paraqiti Konferencës mendimin e komisionerit britanik, J. Giles, i cili arsyetonte se teksti origjinal i protokollit të Londrës shkruante se kufiri midis Shqipërisë dhe Serbisë shtrihej deri në manastirin e Shën Naumit. Ndërkaq, teksti i modifikuar i vendimit të 9 nëntorit 1921, përmend në mënyrë të veçantë fshatin Lin, por nuk flet për manastirin e Shën Naumit.

J. Giles kishte arritur në përfundimin se, nëse Konferenca e Ambasadorëve e Parisit kishte dashur t'ia jepte Shën Naumin Shqipërisë, ajo do ta kishte cilësuar atë në mënyrë të veçantë, si për fshatin Lin. Përfaqësuesit e Qeverisë britanike shpreheshin se projekti italian dhe ai fillestar austriak i vitit 1913 parashikonin që manastiri i Shën Naumit do të mbetej jashtë Shqipërisë. Mirëpo, projekti austro-hungarez që ishte miratuar përfundimisht nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës ishte në kontradiktë me këtë vendim. Për arsyet e lartpërmendura, Ambasada britanike sugjeroi që kjo çështje t'i parashtrohej menjëherë shqyrtimit të Komitetit Teknik Gjeografik pranë Konferencës së Ambasadorëve i përbërë nga përfaqësuesi Watson i Britanisë së Madhe, Bellot i Francës, Mazzolini i Italisë dhe Okada i Japonisë.³⁷ Për shkak të vështirësisë që paraqiste,

³⁶ TNA, FO 371/ 7330, Raport përshkrues i komisionerit britanik, Kol. Liet. J. Giles, në Komisionin e Caktimit të Kufijve për ngjarjet e ndodhura nga data 22 korrik deri më 9 shtator 1922, Kampi pranë Strugës, Maqedoni, 9 shtator 1922.

³⁷ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 12, f. 61, Ambasada britanike në Paris, i drejtohet Konferencës së Ambasadorëve, Paris, 27 shtator 1922.

Konferenca e Ambasadorëve vendosi që çështja e Shën Naumit të shqyrtohej nga Komiteti Teknik Gjeografik që ishte ngritur pranë saj.

Zyrtarët e Qeverisë britanike mbajtën një qëndrim të lëkundur. Harold Nicolson funksionar i lartë në Foreign Office mendonte se vendimi për Shën Naumin i vitit 1913 që u pranua përfundimisht nga Konferenca e Ambasadorëve, nuk binte në kundërshtim me vendimin e vitit 1921. Ai u shpreh se meqenëse manastiri i Shën Naumit nuk kishte asnjë lloj rëndësie tjetër veçse ishte objekt i vjetër fetar, ai duhej t'i mbetej shtetit jugosllav.³⁸ Me porosi të drejtuesve të Foreign Office, përfaqësuesit britanikë në terren ndërmorën një fushatë hetimi për të vërtetuar përkatësinë etnike të manastirit të Shën Naumit. Nga vëzhgimet në terren të J. Giles rezultonte se manastiri dhe Peshkopata e Ohrit i ishin dorëzuar Ekzarkatit bullgar nga sulltani. Ai pranonte se banorët e fshatrave përreth manastirit deri në Malin e Thatë flisnin shqip dhe bullgarisht, por për nga ndjenjat ata ishin më tepër shqiptarë se sa jugosllavë. Nga pikëpamja etnologjike, gjeografike dhe strategjike si dhe nga e drejta e vetëvendosjes, Giles mendonte se kjo pjesë duhej që t'i mbetej Shqipërisë.³⁹

Komiteti Teknik Gjeografik duhej t'i jepte përgjigje pyetjes së parashtruar nga ambasada britanike në Paris nëse manastiri i Shën Naumit që ndodhej në bregun jugor të liqenit të Ohrit duhej t'i jepej Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene apo Shqipërisë. Komiteti Teknik i propozoi Konferencës që të merrte këto vendime. 1. T'i kërkonte Komisionit të Çaktimit të Kufijve që të përcillte të gjithë informacionet e vlefshme në lidhje me manastirin e Shën Naumit si dhe argumentet me shkrim të secilit anëtar të Komisionit dhe delegatëve të dy qeverive të interesuara në lidhje me çështjen se kujt duhej t'i përkiste manastiri. 2. T'i bëhej me dije komisionit se ai duhej të shtynte çaktimin e kufirit shqiptaro-jugosllav për rajonin e Shën Naumit deri sa Konferenca të merrte një vendim në lidhje me të.⁴⁰ Këto kërkesa u miratuan nga Konferenca e Ambasadorëve, më 11 tetor 1922, dhe iu përcollën KCK-së.

³⁸ TNA, FO 371/ 7327, Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, datë 18 gusht 1922; *Po aty*, FO 371/ 7330, Miles W. Lampson në emër të sekretarit të Shtetit për lord Hardinge të Penshurst në Paris, F. O., 22 shtator 1922.

³⁹ *Po aty*, FO 371/ 7330, Raport përshkrues i komisionerit britanik, Kol. Liet. J. Giles, në Komisionin e Çaktimit të Kufijve për ngjarjet e ndodhura nga data 11 tetor deri më 2 nëntor 1922, Prizren, 2 nëntor 1922.

⁴⁰ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 13, f. 63-64, Shënim i Watson, Bellot, Massolini, delegatë të Komitetit Teknik Gjeografik, për Konferencën e Ambasadorëve, Paris, 6 tetor 1922.

Shtyrja e vendimit për Shën Naumin nga Konferenca e Ambasadorëve dhe qëndrimi i Qeverisë jugosllave shqetësoi diplomacinë shqiptare. Mehmet Konica, ministri Fuqiplotë i Shqipërisë në Londër, njoftonte se kishte biseduar me funksionarët e Foreign Office lidhur me çështjen e Shën Naumit. Ai shprehej se pavarësisht argumenteve të parashtruara prej tij në mbështetje të interesave të Shqipërisë, “por më kot, Foreign Office si duket u ka dhënë fjalën serbëve, që Shën Naumi do të mbetet në Jugosllavi”. M. Konica dyshonte se shkaku i qëndrimit të lëkundur të diplomacisë britanike në këtë çështje ishin “lodrat e guvernës tonë mi çështjen e vajgurit”. Sipas tij, qëndrimi i Foreign Office ishte kuptuar nga deklarata e komisionerit britanik, J. Giles.⁴¹

Në tetor 1922, Ali Kolonja u emërua në detyrën e ministrit Fuqiplotë të Shqipërisë në Beograd dhe majori Bajram Fevzi, mori detyrën e delegatit shqiptar në KCK. Me sa dukej, në zëvendësimin e Ali Kolonjës ndikuan motivet politike të skenës politike shqiptare. Studiuesi Tajar Zavalani shprehet se preteksti i largimit të tij nga kjo detyrë ishte se gjatë punës në rajonin e Dibrës, A. Kolonja u shpreh para dibranëve se duhej të ruanin frymën kombëtare se do të vinte dita Dibra, Kosova e vise të tjera do t’i bashkoheshin shtetit të cunguar shqiptar. Popullsia e Dibrës protestoi kundër tij pranë deputetëve të Kosovës në Parlamentin shqiptar. Këta deputetë me Bedri Pejanin në krye, i bënë presion Qeverisë shqiptare për shkarkimin nga detyra të Ali Riza Kolonjës për qëndrimin e mbajtur.⁴²

Komisioni i Caktimit të Kufijve i kërkoi Qeverisë shqiptare qysh më 23 tetor 1922, që të paraqiste faktet dhe argumentet e nevojshme se përse manastiri i Shën Naumit duhej t’i përkiste Shqipërisë. Bajram Fevzi i paraqiti Qeverisë shqiptare argumentet e tij për mbetjen e Shën Naumit brenda shtetit shqiptar. Në dokumentin e paraqitur prej tij, pohohej se në salnamenë osmane të vitit 1308, sipas kalendarit islam, manastiri i Shën Naumit nën emrin Sari Salltik, i ishte bashkuar kazasë së Ohrit. Nëse fshati Lubanishtë kishte qenë realisht çiflig i manastirit, atëherë ky dokument mund të konsiderohej i saktë. Përfaqësuesi shqiptar mbështeste idenë se nga pikëpamja administrative manastiri në fjalë kishte bërë pjesë gjithmonë në kazanë e Starovës, njësoj si Peshkëpia. B. Fevzi i kërkonte Qeverisë

⁴¹ *Po aty*, dok. nr. 17, f. 70-71, Mehmet Konica, ministër Fuqiplotë në Legatën shqiptare në Londër, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Londër, 19 tetor 1922.

⁴² Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: “Phoenix & Shtëpia e Librit”, 1998, f. 269.

shqiptare dokumente mbështetëse për argumentet e tij si dhe pikëpamjen e saj mbi këtë çështje.⁴³

Më 27 tetor 1922, nga Prizreni, komisar britanik, J. Giles, i paraqiti mendimet e tij Konferencës së Ambasadorëve, të cilat nuk ndryshonin nga qëndrimi i tij i mëparshëm. Ai arrinte në përfundimin se nëse parimi i ndryshimit të termave të protokollit të Londrës nuk mund të pranohej për arsye politike, komisar britanik ishte i mendimit që manastiri i Shën Naumit duhej t'i lihej Jugosllavisë.⁴⁴ Në dokumentin e paraqitur nga komisar italian njëherësh kryetari i KCK-së, thuhej se ai mbështeste parimin e pandryshueshmërisë absolute të protokollit të Londrës të vitit 1913 dhe të vendimit të 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris. E. Tellini pohonte se nëse vihej në diskutim ky protokoll, do të hapeshin çështje të tjera më të rëndësishme se ajo e manastirit të Shën Naumit, siç ishin ato të qyteteve të Strugës dhe të Dibrës, ku popullsia e tyre mund të rebelohej nëse ajo shihte se protokollin ishte ndryshuar në një pikë të saj.

Ai argumentonte se megjithëse ishte e vërtetë se protokollin e Londrës nuk kishte shtuar fjalën “përfshirë” pas manastirit të Shën Naumit, por meqenëse një manastir nuk është një element topografik ndarjeje, siç mund të jetë një lum apo një majë mali, territori që shtrihej deri te Shën Naumi përfshinte domosdoshmërisht këtë lokalitet. Tellini mendonte se vija administrative që ndante kazatë maqedonase të Resnjës dhe të Ohrit në veri nga kazatë shqiptare të Korçës dhe Starovës në jug, përputhej me të dhënat e regjistrave të përgjithshëm të Portës së Lartë (salnameja e vitit 1912 dhe e viteve të mëparshme). Në këto regjistra nuk përmendej manastiri i Shën Naumit, sepse ai nuk përbënte një fshat. Prandaj, komisar Tellini i hodhi poshtë të dhënat e paraqitura nga delegati jugosllav se manastiri i Shën Naumit dhe fshati Lubanishtë i paguanin taksat në Ohër dhe pretendimin se ky territor ishte pjesë e kazasë e Ohrit. Tellini theksoi se në rripin e tokës midis liqeneve të Ohrit dhe të Prespës, protokollin e Londrës saktësonte se duhej të ndiqej kufiri i kazasë së Korçës. Kjo vijë, theksonte ai, nuk u largohej kufijve etnikë të popullsisë dhe mund të shërbente si kufi natyror. Tellini mendonte se fshati Lubanishtë duhej t'i mbetej shtetit jugosllav, por

⁴³ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 20, f. 74-75, Bajram Fevzi, delegati shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, Prizren, 25 tetor 1922.

⁴⁴ *Po aty*, dok. nr. 22, f. 76-77, Mendim i komisarit britanik Lt. Col. J. Giles, “Mbi dhënie të manastirit të Shën Naumit”, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 27 tetor 1922.

mbështetur në interpretimin strikt të protokollit si dhe për arsye lokale, etnike e topologjike, komisari italian arrinte në përfundimin që manastiri i Shën Naumit duhej t'i jepej Shqipërisë.⁴⁵

Komisari francez në KCK u shpreh se mbështetur në të dhënat e mbledhura në terren, manastiri ortodoks i Shën Naumit ishte themeluar në shek. X dhe rindërtuar në shek. XVI nga bullgarët. Nga pikëpamja fetare, ai bënte pjesë në Ekzarkatin e Ohrit, por nga pikëpamja administrative ishte pjesë e kazasë së Starovës deri në luftën e viteve 1912-1913. Manastiri kishte rënë në duart e serbëve vetëm pas kësaj periudhe dhe ndodhej tani në zonën neutrale. Shqiptarët kishin kontribuar prej një kohe të gjatë në mirëmbajtjen e manastirit. Në këtë manastir gjendeshin dy murgjër të vendosur nga jugosllavët, ku njëri fliste serbisht dhe tjetri shqip. I gjithë rajoni përreth, theksonte komisari francez, prej shekujsh u përkiste shqiptarëve dhe fshatrat Tushemisht, Zagorçan, Çërravë, Plasë dhe Alarup, banoheshin nga shqiptarë. Fshati Peshkëpi në juglindje të manastirit bënte pjesë në kazanë e dikurshme të Starovës. Shën Naumi kishte lidhje nga toka dhe uji vetëm me qytetin shqiptar të Pogradecit, i cili ndodhej larg tij në distancë prej 6 km.

Nga kjo rezultonte se ky manastir ishte plotësisht i huaj për nga origjina për Jugosllavinë, ndërsa për arsye ekonomike, gjeografike dhe etnike, ai i lidhej natyrshëm me Shqipërinë. Gjithashtu, ai theksoi se edhe protokollin e Londrës i vitit 1913, shprehej se ish-kazaja e Korçës me shtrirje nga fshati Lin deri te manastiri i Shën Naumit do të ishte pjesë e Shqipërisë. Ai mendonte se duke analizuar kontekstin dhe idenë e përgjithshme të fjalisë së mësipërme, ajo duhej interpretuar në kuptimin e dhënies së Shën Naumit Shqipërisë. Komisarit francez arrinte në përfundimin se manastiri duhej t'i jepej Shqipërisë, duke lënë jashtë saj fshatin Lubanishtë, banorët e të cilit ishin për nga origjina dhe gjuha bullgarë, por të përfshinte brenda territorit të Shqipërisë fshatin Peshkëpi, banorët e të cilit ishin me gjuhë, origjinë dhe ndjenjë shqiptare.⁴⁶

Më 28 tetor 1922, Qeveria jugosllave paraqiti faktet dhe argumentet e saj në favor të përfshirjes së fshatit dhe manastirit të Shën Naumit në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Në gjashtë dokumentet e paraqitura Konferencës, Qeveria jugosllave përpiquej të provonte gjoja se manastiri i Shën Naumit kishte qenë pjesë administrative e kazasë së Ohrit

⁴⁵ *Po aty*, dok. nr. 24, f. 86-88, Mendimi i komisarit italian mbi dhënien e manastirit të Shën Naumit, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 28 tetor 1922.

⁴⁶ *Po aty*, dok. nr. 25, f. 91-92, Mendimi i komisarit francez mbi dhënien e manastirit të Shën Naumit, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 28 tetor 1922.

dhe i kishte paguar taksat e tij ndaj shtetit osman në zyrën e taksave në Ohër. Prandaj, Qeveria jugosllave kërkonte që fshati dhe manastiri i Shën Naumit t'i përkiste Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, duke pretenduar se ato ishin të banuara me serbë.⁴⁷

Në këtë periudhë, Qeveria shqiptare u ndesh me problemin e sigurimit të dokumenteve të nevojshme për të provuar se manastiri ishte shqiptar. Delegati shqiptar, Bajram Fevzi, i dorëzoi Konferencës së Ambasadorëve mendimin e Qeverisë shqiptare, më 4 nëntor 1922. Ai i ankohej qeverisë së tij se studimi i dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme shqiptare “dukej pa brumë dhe disi përfytyrues, dhe kjo vinte nga mungesa absolute e dokumenteve për konsultim...si dhe ky nuk është veçse vështrim provizor”.⁴⁸ Në dokumentin e paraqitur nga Qeveria shqiptare paraqiteshin argumentet e mëposhtme. Vendndodhja e manastirit të Shën Naumit kishte qenë tempull i një kulti të shenjtë shumë më përpara se të përhapej doktrina e krishterë. Nga ndërtimi i manastirit e deri në këtë periudhë, banorët e krishterë dhe myslimanë të rrethinave të Starovës, Korçës, Elbasanit dhe Bilishtit shkonin çdo vit aty për pelegrinazh, në respekt të traditës së trashëguar.

Nën regjimin osman, administrimi fetar i manastirit të Shën Naumit bëhej nga Peshkopata e Ohrit, e cila ishte në varësi të Patriarkanës së Stambollit. Pas krijimit të shtetit bullgar, u themelua Ekzarkati bullgar, i cili synonte shkëputjen e bullgarëve nga ndikimi i Patriarkanës, prandaj Peshkopata e Ohrit bashkë me manastirin kaluan nën varësinë e Ekzarkatit bullgar. Salnametë osmane nuk përmendnin se cilit rreth administrativ i përkiste manastiri i Shën Naumit, pasi në rrethinat më të afërta të tij nuk kishte banesa. Këto salname flisnin vetëm për fshatin Peshkëpi që ndodhej pranë tij, i cili ishte nën varësinë e kazasë së Starovës ndërsa fshati Lubanishtë i ishte dhënë kazasë së Ohrit. Përderisa Peshkëpia administrohej nga Starova, Shën Naumi që ndodhej më afër Starovës se Peshkëpia duhej patjetër të varej nga administrata civile e kazasë së Starovës. Nga pikëpamja strategjike, ishte e pamundur të përvijohej një kufi natyror nëse Shën Naumi nuk i lihej Shqipërisë. Lidhjet rrugore të Korçës me Elbasanin mund të viheshin para një rreziku të madh. Gjithashtu, në mbështetje të këtij

⁴⁷ *Po aty*, dok. nr. 23, f. 78-79, Mendimi i delegatit jugosllav kolonel M. Jovanović, mbi dhënie e manastirit të Shën Naumit, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 28 tetor 1922.

⁴⁸ *Po aty*, dok. nr. 28, f. 95, Bajram Fevzi, delegati shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, Prizren, 4 nëntor 1922.

argumenti paraqitej precedenti i krijuar për mbrojtjen e rrugës Strugë-Dibër, ku shtetit jugosllav i kishin kaluar rreth 20 fshatra, shumica e të cilave ishin shqiptare. Manastiri i Shën Naumit, thuhej në dokument, duhej t'i përkiste Shqipërisë mbështetur edhe në përmbajtjen e Protokollit të Londrës së vitit 1913. Në këtë mënyrë ky dokument ishte interpretuar edhe nga Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve i dërguar në Shqipëri në vitin 1921. Qeveria shqiptare informonte se sipas një fermi zyrtar, i gjithë territori i Shën Naumit dhe njëzet shtëpi në Peshkëpi i përkisnin një shqiptari me emrin Eshref bej Starova nga Pogradeci. Nën regjimin osman, Eshref Beu paguante të dhjetën pranë zyrave të financës në Starovë. Qeveria serbe kur pushtoi Shën Naumin i njohu Eshref Beut të drejtën e pronës mbi tokat dhe godinat e tij.⁴⁹

Qeveria shqiptare i kërkonte Xhemil Dinos, përfaqësuesit të saj në Paris që të interesohet me çdo mënyrë që Shën Naumi t'i mbetet Shqipërisë. Ajo i kërkonte Xh. Dinos të koordinonte veprimet me Mehmet Konicën, ministrin shqiptar në Londër.⁵⁰ Me të marrë udhëzimet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Xhemil Dino ishte nisur menjëherë për në Londër ku u takua me Mehmet Konicën. Ky i fundit, i shkruante Qeverisë shqiptare që t'i kërkonte kompanisë anglo-persiane që të ndërhynte pranë Qeverisë britanike për Shën Naumin. Diplomati shqiptar shprehej se “nuk kam dyshim se [kjo kompani - S. Kadria] do ta mbaronte punën nëntëdhjetë e nëntë për qind.... Në mbështetemi mi nonjë tjetër politikë e cila siguron t'arthmen e vendit tonë, puna ndryshon...”.⁵¹ Xhemil Dino, i ngarkuar me detyrën e ministrit Fuqplotë të Shqipërisë në Paris, paraqiti pretendimet e shtetit të tij pranë Konferencës së Ambasadorëve në Paris kryesisht mbështetur në argumentet e paraqitura më herët. Ai theksonte se manastiri i Shën Naumit dhe territori që e rrethonte atë, ishte një rajon shqiptar nga të gjitha pikëpamjet.⁵²

⁴⁹ *Po aty*, dok. nr. 30, f. 98-101, Delegacioni shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 4 nëntor 1922.

⁵⁰ *AQSH*, F. 151, V. 1922, D. 43, fl. 38, Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuar Xhemil Dinos, sekretar i parë në Legatën shqiptare në Paris, Tiranë, 13 nëntor 1922.

⁵¹ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 37, f. 115-116, Mehmet Konica, ministër Fuqplotë në Legatën shqiptare në Londër, drejtuar Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, Londër, 24 nëntor 1922.

⁵² *Po aty*, dok. nr. 38, f. 117, Letër e Xhemil Dinos, ministër Fuqplotë i Shqipërisë në Paris, drejtuar Raymond Poincares, president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Paris, 25 nëntor 1922.

Shumica e anëtarëve të Komisionit të Caktimit të Kufijve ishin të mendimit që Shën Naumi duhej t'i përkiste shtetit shqiptar. Meqenëse komisioneri francez doli në mbështetje të kolegut të tij italian, si dhe gjatë gjithë kohës kishte mbajtur një qëndrim të kundërt me komisionerin britanik, J. Giles i kërkoi Qeverisë britanike që të ndikonte pranë Qeverisë franceze për zëvendësimin e komisionerit francez përpara fillimit të punës gjatë vitit të ardhshëm.⁵³

Komiteti Teknik Gjeografik u shpreh se çështja e Shën Naumit nuk ishte përcaktuar qartë në Protokollin e Konferencës së Londrës të vitit 1913. Por, mbështetur në themele etnike dhe ekonomike, të parashtruara nga anëtarët e Komisionit të Caktimit të Kufijve, nuk kishte dyshim që manastiri i Shën Naumit duhej t'i përkiste Shqipërisë. Mbështetur në këtë argumentim, Komiteti Teknik Gjeografik i propozoi Konferencës së Ambasadorëve që manastiri i Shën Naumit t'i kalonte Shqipërisë.⁵⁴ Lord Hardinge, përfaqësuesi i Britanisë së Madhe në Konferencën e Ambasadorëve, i kërkoi Foreign Office që kjo çështje duhej të vendosej nga shumica e votave në komision, i cili do të ishte në favor të Shqipërisë.⁵⁵ Për shkak të përkeqësimit të kushteve klimatike, në fund të nëntorit 1922, Komisioni vendosi të ndërpriste punimet.⁵⁶ Mbështetur në kërkesën e Ambasadës britanike në Paris të paraqitur në fund të shtatorit 1922, Konferenca e Ambasadorëve miratoi një rezolutë të posaçme më 6 dhjetor 1922, me të cilën i bëhej e njohur Komisionit të Caktimit të Kufijve si dhe qeverive shqiptare dhe jugosllave se Konferenca vendosi që Shën Naumi t'i jepej Shqipërisë.⁵⁷ Më 23 dhjetor 1922, R. Poincaré, njoftoi ministrin jugosllav dhe kryetarin e delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve se ishte vendosur që Shën Naumi t'i mbetej Shqipërisë. Ndërkohë, qeveria shqiptare njoftohej se dhënia e Shën Naumit do të realizohej praktikisht vetëm kur të caktohej përfundimisht nga KCK-ja kufiri serbo-kroato-sllaven dhe shqiptar.⁵⁸

⁵³ TNA, FO 371/ 7331, Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles për ngjarjet e Komisionit të Caktimit të Kufijve nga data 3 nëntor deri më 11 dhjetor 1922, Beograd, datë 12 dhjetor 1922.

⁵⁴ Po aty, FO 371/ 7328, Telegram i lord Hardinge për Foreign Office, Paris, 6 nëntor 1922.

⁵⁵ Po aty, FO 371/ 7328, Telegram i lord Hardinge për Foreign Office, Paris, 27 nëntor 1922.

⁵⁶ Po aty, FO 371/ 7331, Raport përshkrues i komisionerit britanik, Kol. Liet. J. Giles, për ngjarjet e Komisionit të Caktimit të Kufijve, nga data 3 nëntor deri më 11 dhjetor 1922, Beograd, 12 dhjetor 1922.

⁵⁷ A. Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare...*, f. 337.

⁵⁸ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 47, f. 127, Njoftim i Raymond Poincaré,

Sali KADRIA

SUMMARY

THE QUESTION OF THE DEMARCATION OF THE ALBANIAN-YUGOSLAV BORDERS IN 1921-1922

The decision of November 9, 1921, did not satisfy the Albanians because it deprived Albania of some areas in Dibër, Podgorica and Prizren sectors. The Yugoslav government tried its best to delay the withdrawal of its troops from the neutral zone. At the beginning of March 1922, the International Border Commission arrived in Albania. The issues of Vermosh and St. Naum obstructed the border demarcation between the two neighboring states. In July 1922, the Border Commission concluded that Vermoshi should belong to Albania. The Yugoslav government protested against this decision. Serbian military troops took control of St. Naum monastery, the mountainous area and a part of the field's villages of Tushemisht, Zagorçan, Çërrava and Alarup. The Yugoslav delegate defended the opinion that the border in these areas had been set according to the decision of the London Conference of Ambassadors and the agreement reached between the governments of Serbia and Greece.

Albanian delegate Ali Kolonja declared to the Border Commission members that the Yugoslav delegate's assertion was untrue. The question of which state should belong the territory of St. Naum opened a heated debate among the members of the Border Commission. British commissioner J. Giles was convinced that according to the protocol held at the Conference of Ambassadors in London, the monastery of St. Naum had to pass to the Serbian state. The Italian and French commissioners felt that the 1913 protocol had granted Albania the monastery of St. Naum and that the lack of determination in the decision of 9 November 1921 to which state should belong St. Naum meant that this monastery should remained to Albania.

president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, drejtuar kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve, Paris, 25 dhjetor 1922.

Albana MEMA

INSTITUCIONI I KËSHILLIT TË NALTË (REGJENCA) NË SHQIPËRI NË VITET 1920-1924

Krijimi i regjencës kolektive (Këshilli i Naltë i shtetit shqiptar)

Deri më 21 janar të vitit 1925, kur u shpall Republika I Shqiptare, *de jure*, Shqipëria vazhdonte të ishte një monarki parlamentare. Ishte ky fakt, vazhdim i vendimit ndërkombëtar të vitit 1913 dhe i Statutit Organik të Shqipërisë, por edhe një shprehje e atij kompromisi, që vendosën politikanët shqiptarë të asaj kohe. Kongresi i Lushnjës dhe Këshilli Kombëtar, e konsideruan të hershëm përcaktimin përfundimtar të formës së shtetit shqiptar, ndërkohë që, në dispozitat përkatëse të akteve të miratuara prej tyre, risanksionojë forma e monarkisë.

Gjithashtu, ka pasur mendime se, në vitet 1920-1924 u krijua një kundërshti midis formës *de jure* të shtetit shqiptar dhe formës së zbatuar në praktikën e qeverisjes. Kjo, për faktin se, u aplikua një formë republikane qeverisjeje, madje një formë origjinale me një kryetar shteti kolegjal në krye.¹ Ky konstatim ka një bazë, e cila lidhet me varësinë e dukshme të Këshillit të Lartë nga Parlamenti dhe faktin se, ndryshe nga një monark, që e trashëgonte pushtetin, ky institucion zgjidhej nga Parlamenti ose Këshilli Kombëtar dhe nuk kishte prerogativa mbi të. Republika me një kryetar kolegjal shteti, ka gjetur pak zbatim në praktikën e shteteve demokratike. Format e qeverisjes të aplikuara në republikat bashkëkohore janë: republika presidenciale, parlamentare dhe presidenciale-parlamentare, të gjitha me një kryetar shteti individual në krye.

¹ Sali Hidri, “Këshilli i Lartë dhe forma e regjimit të shtetit shqiptar në vitet 1922-24”, Në: “Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924”, Instituti i Historisë, 1977, f. 77.

Është mjaft interesant zëvendësimi i një monarku “fantazmë”, me një regjencë kolegjiale. Të katër anëtarët e Këshillit të Lartë të Shtetit, nuk ishin gjë tjetër veçse përfaqësia e mbretit. Për më tepër, regjenca kolektive në këtë periudhë, nuk zëvendësonte një mbret të trashëgueshëm të traditës shqiptare dhe as të vendosur nga ndonjë organ përfaqësues i popullit shqiptar, por një mbret që ndonëse jetonte fizikisht nuk ishte i përshtatshëm për shkak të rrethanave ndërkombëtare të vendosej në fron.

Sidoqoftë, Kongresi i Lushnjës dhe Këshilli Kombëtar e ngarkuan veten me detyrën e organizimit të përkohshëm të shtetit shqiptar dhe nuk morën përsipër një përcaktim përfundimtar të formës së shtetit. Kjo e fundit, iu ngarkua Kuvendit Kushtetues, që doli nga zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1923, i cili do të hartonte e do të miratonte edhe statutin e nevojshëm për kushtetimin e shtetit shqiptar.

Vendosja përfundimtare e formës së qeverisjes, nuk përbënte një problem të lehtë për t’u zgjidhur, në kushtet shoqërore e politike të Shqipërisë së kohës. Duhej të merrej në konsideratë vendimi i Fuqive të Mëdha, tradita shqiptare, raporti i forcave shoqërore dhe ngjarjet politike që ndodhën, si dhe idetë e rrymat e mendimit të kristalizuara në atë periudhë. Debatet për formën e regjimit, u zhvilluan në vitet 1922-1924. Mirëpo, kur erdhi puna për të vendosur konkretisht, komisionet e caktuara nuk propozuan asnjërin nga këto forma por, kërkuan që të mbetej në fuqi Këshilli i Lartë, të cilit secili grup i atribuonte përmbytjen që i interesonte, monarkike apo republikane.

Si duhet shpjeguar një lidhje kaq e fortë pas Këshillit të Lartë, si përfaqësues kolektiv i kryesisë së shtetit, në një kohë kur kërkohej një zgjidhje përfundimtare e formës së regjimit për shtetin shqiptar? Kapja pas Këshillit të Lartë, lidhej me një sërë rrethanash. Në radhë të parë, me gjendjen e brendshme dhe ekzistencën e raporteve të tilla politike klasore që nuk lejonin të sigurohej epërsia e dukshme e disa forcave shoqërore mbi të tjerat dhe prandaj në formën e regjimit kërkohej të gjendej një *modus vivendi*. Pikërisht për këtë arsye, u ruajtën vendimet e Lushnjës. Ky qëndrim lidhej gjithashtu edhe me gjendjen e jashtme të vendit dhe me oportunitetin për të respektuar vendimet ndërkombëtare të viteve 1913-1914 për formën e regjimit në Shqipëri.

Më vonë, Qeveria shqiptare, do të vinte në dukje se, Kushtetuta e Lushnjës ishte pasojë e zemërimit popullor kundër vendimit të Fuqive të Mëdha. Anëtarët e Kuvendit përbënin një prezantim të drejtë të popullsisë, por ishte rryma nacionaliste progresive që kishte shumicën e vendeve, duke krijuar kështu, kushtet për një politikë të pastër nacionaliste. Sipas saj,

Statuti i Lushnjës, synonte të pastronte dhe të ndryshonte sistemin qeverisës që kishte pasur vendi në periudhën e mëparshme. Në të gjitha qeveritë e mëparshme të Shqipërisë, me përjashtim të periudhës së regjimit të Princ Vidit, kreu i qeverisë ishte njëkohësisht kryeministër dhe president, kështu që për të ndryshuar një ministër ishte e nevojshme për të larguar kreun e qeverisë. Kjo anomali e rrezikshme që kishte shkaktuar shumë ngërçe u shmang nga Statuti, i cili i ndau të dy postet. Qeveria pohonte se liderët e kuvendit, në këtë pikë, gjetën një kombinim të kënaqshëm në këto rrethana dhe u gjet e këshillueshme t'i delegohej autoriteti suprem një Këshill të Naltë, që u emërtua Këshill Regjence, me qëllim për të theksuar vendosmërinë e popullit për të ruajtur sovranitetin e shtetit kundër përpjekjeve të Fuqive për t'i imponuar Shqipërisë një mandat të huaj.

Ky forum, përfaqësonte kreun e ekzekutivit shqiptar, por, autoriteti i tij ishte shumë i limituar, pasi autoriteti i vërtetë, ishte deleguar në duart e kabinetit, i cili ishte formuar nga 6 deri në 8 anëtarë, sipas nevojave të politikës. Është për t'u theksuar se në formimin e kabinetit nuk u tregua kujdes ndaj përkatësive religjioze, por u caktuan njerëzit më të zotë. Autoriteti i kabinetit ishte më i gjerë se në çdo qeveri tjetër parlamentare, duke u limituar vetëm nga diktati i parlamentit, i cili ishte një dhomë e vetme legjislativi, e përbërë nga përfaqësuesit e popullit shqiptar, të zgjedhur nga popullsitë e krahinave të ndryshme. Këshilli i Regjencës, i përbërë nga 4 anëtarë, do të përfaqësonte kryetarin e shtetit shqiptar, derisa ky dhe forma e regjimit të vendoseshin përfundimisht nga një asamble kushtetuese. Ndër të tjerë, në përbërjen e tij kishte "...një këshilltar ligjor, një kryesekretar që zotëronte gjuhë të huaja, dy sekretarë dhe një protokollist.....".²

Institucionet qeverisëse të kohës, duhej të ishin institucione të mirorganizuara, të destinuara për të sjellë stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm në vend. Por, nuk ndodhi kështu me institucionet shqiptare. Përbërja e tyre nga elementë me nivel të ulët të përgjegjshmërisë politike e shtetformuese, që kishin si qëllim kryesor përfitimet personale në raport me nevojën për stabilizimin e shtetit dhe të institucioneve kombëtare, solli krizë brenda këtyre institucioneve dhe mungesë efektiviteti në veprimtarinë e tyre. Në lidhje me formën e regjimit në Shqipëri, ashtu si edhe për çdo çështje tjetër të krijimit dhe konsolidimit të institucioneve kombëtare qeverisëse, në vitet 1920-1924, pati mendime e sugjerime të shumta edhe

² AQSH, Fondi. 146, viti. 1921, dos. 63, fl.16-17. Shkresë e Këshillit të Naltë, dërguar Kryeministrit dt. 25.10.1920, mbi godinën e Këshillit të Naltë dhe punonjësit e saj.

nga organizatat e emigracionit shqiptar jashtë vendit. Ndër ta, Federata Panshqiptare “Vatra”, ishte elementi më i fuqishëm i diasporës shqiptare, që ndikoi fuqishëm në drejtim të pasurimit të mendimit politik shqiptar dhe të strukturimit dhe modernizimit të institucioneve të këtij shteti. “Vatra” i konsideronte si element themelor të një shteti të përparuar demokratik, partitë politike opozitare.

Në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të institucioneve të shtetit shqiptar, “Vatra” propozonte zgjedhjet për parlamentin e parë shqiptar dhe themelimin e kushtetutës. Diaspora shqiptare e Amerikës, që kishte luftuar për vendosjen e një princi evropian në fronin e Shqipërisë, mbështeti princ Vidin, duke besuar se ai do të arrinte të stabilizonte gjendjen në Shqipëri dhe do të mbronte interesat e saj në arenën ndërkombëtare. Kjo do të thotë se, “Vatra” përkrahte formën monarkike të qeverisjes, si një formë thellësisht e domosdoshme për Shqipërinë në ato momente vendimtare dhe tepër të vështira të stabilizimit të shtetit shqiptar. Ajo, e pa institucionin e monarkisë, si më efektivin dhe adekuatin për ta realizuar këtë detyrë tepër të vështirë dhe njëkohësisht jetike për ekzistencën e shtetit dhe progresin e kombit shqiptar. Por, ajo kishte kërkuar një Princ nga një derë mbretërore evropiano-perëndimore, pikërisht, sepse donte ta orientonte shtetin e ri nga perëndimi dhe të shkonte sa më shpejt dhe më mirë, drejt një monarkie konstitucionale e demokratike, duke marrë për model monarkitë e tilla më të përparuara në Evropë.

Edhe në vitet ‘20, “Vatra” përkrahu formën monarkike të qeverisjes si më efektive dhe të përshtatshme për stabilizimin e shtetit shqiptar. Lidhur me formën e regjimit, ajo shprehte mendimin se: “Forma e shtetit s’mund të porositet në një mënyrë absolute”. “Monarkitë ashtu sikurse edhe republikat mund të jenë të mira ose të këqija”, pra ajo nënkuptonte se ato mund të ishin demokratike ose jo. “Vendi, koha, karakteri i popullit munt të dëftojnë një formë si më të duhur se tjetrën për atë popull”. Më tej “Vatra” shprehej se: “forma monarkike është sot ajo që çfaqet si më e zonja për të shiguruar themelet e shtetit në Shqipëri”.³

Gazeta “Dielli”, bënte një sugjerim tepër të veçantë për kreun e shtetit. Sipas Faik Konicës, “një president është zgjidhja më e pëlqyer, çdo shtet duhet të ketë një në krye”. Por, vazhdonte ai, “në qoftë se mbahet forma e sotme e një Këshilli prej katër regjentësh, atëherë njeri nga këta duhet të ketë titullin “kryeregjenti i Shqipërisë”, dhe vetëm ky të personifikojë shtetin, të tre regjentët e tjerë të veprojnë vetëm si këshilltarët e kryeregjentit.

³ *Dielli*, Boston , Mass, 18 prill 1923, “Nga Tryeza e Kryetarit”.

Po cilitdo prej regjentëve, dhe këtu do të jetë ndryshimi në themel nga sistemi i një republike me një president, t'i vijë radha për kryesinë".⁴ Këtu kemi një përpjekje për të kapërcyer defektin themelor që kishte Këshilli i Naltë lidhur me funksionimin normal të tij. Konica shkruante: "Zgjidhja më e mirë për Shqipërinë, pas mendjes s'onë, është një formë e mesme, një Këshillë katër vetash me një president në krye. Pothuajse të gjithë shqiptarët nuk mohojnë se për Shqipërinë është keq republikë e keq monarki dhe se një Këshill katër vetash me një president në krye, do t'ishte të paktën sot për sot, zgjidhja më praktike."⁵ Ai synonte kështu ta bënte regjencën kolektive më funksionuese dhe efektive, për të shmangur rreziqet e përçarjeve brenda saj, të cilat do të kishin efekte destabilizuese për vendin.

Veprimtaria e institucionit të kryetarit të shtetit (Këshillit të Naltë)

Fillimisht organet ekzekutive, pra Këshilli i Lartë dhe Qeveria, u perceptuan pozitivisht nga opinioni shqiptar. Në një artikull në gazetën "Agimi", Kristo Floqi, analizonte Shqipërinë si shtet politik dhe theksonte se Kongresi i Lushnjës dhe vendimet e marra prej tij, në një kohë të vështirë e kritike, ku fati dhe jeta politike e Shqipërisë ishte në duart e një diplomacie të pashpirt, shënuan një faqe të artë në jetën tonë kombëtare. Ai ndër të tjera shkruante: "Qeverija shqyptare e sotme u nda n'shejë - asht e vërtetë - si një nga ma të mirat Qeveri konstitucionale të botës së qytetnueme. Kjo Qeveri asht e ka qenë e vetmja Qeveri Shqyptare në gjith Qeverit e tjera qi ka punue ma mirë, ma energjisht e ma patriotisht. Asht e vetmja qi Shqyptari pa të realizueme për njiment Shqypnin politike të Konferencës së Londrës 1913".⁶

Megjithatë, që në fillimet e jetës konstitucionale të shtetit të ri shqiptar, shihen mosmarrëveshje dhe kundërshti mes organeve kryesore të qeverisjes, në lidhje me kompetencat e secilit prej tyre dhe me ndarjen e pushteteve përkatëse. Kjo tregon se, institucionet e shtetit shqiptar, ishin akoma të paformuara si duhet dhe se atyre u mungonte koncepti i ndarjes së pushteteve dhe i shtetit të së drejtës. Një gjë e tillë shihet qartë, në një komunikim zyrtar mes Këshillit Kombëtar dhe Këshillit të Naltë. Këshilli i Laltë i shtetit shqiptar, me shkresën e tij datë 10.11.1920, njoftonte Këshillin Kombëtar, se "qeveria nuk konsultohej me të për punët qeveritare. Këshilli i Laltë nuk pyetej fare në lidhje me delegacionet me rëndësi që dërgohen

⁴ Po aty, 19 shkurt 1924, F. K. "Shënime mi kanunin e themelit".

⁵ Po aty, nr. 2703, dt. 17.04.1924, "Mbret, president apo regjente".

⁶ *Agimi*, nr. 6, Tetor 1920, Vjeti II, Kristo Floqi, "Shqypnija si shtet politik".

jashtë vendit, madje as nuk njoftohet për përbërjen e tyre. Për këtë arsye, duke mos dashur të mbajë mbi vete një përgjegjësi të tillë, Këshilli i Naltë, bën me dije se nuk mund të vazhdojë detyrën e tij.”⁷

Forma dhe organizimi i Këshillit të Naltë, kërkonin një bashkëpunim harmonik të katër anëtarëve të tij, pasi rreziku i paralizimit të veprimtarisë së tij ishte evident. Por, a e zotëronin personat e zgjedhur aftësinë për të siguruar këtë marrëveshje dhe harmoni, e cila ishte jetike për shtetin? Për të gjykuar për këtë, na vlen midis të tjerash edhe një telegram konfidencial i ministrit të Jashtëm britanik, Eyres, dërguar Earl Curzon, më 18 mars 1921, në të cilin thuhej: “Aqif Pasha, sipas të dhënave është një patriot i mirë i shkollës së vjetër, besnik por, me defektin e trajnimit dhe besimit; Abdi Bej Toptani, pëlqehet nga të gjithë, por është patriot në favor të rendit të vjetër të bejlerëve, pak a shumë një reaksionar; L. Bumçi, është një burrë inteligjent me karakter të lartë; dr. Turtulli, është ndoshta burri më inteligjent dhe më i edukuar në Shqipëri, por nuk ka qëllim të rrinte në këtë vend”.⁸ Pas krizës së rëndë të vitit 1921 dhe kryengritjes së marsit 1922, u bë domosdoshmëri që shteti shqiptar të shkonte drejt stabilizimit. Tani duhej përcaktuar më mirë struktura e tij dhe sidomos ndarja e kompetencave midis organeve më të larta të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, për t’i dhënë shtetit bazën e tij kushtetuese dhe nënshtetasve sigurimin e lirive dhe të drejtave demokratike.

Më 8 dhjetor 1922, u shpall Kushtetuta e re ose Statuti i Zgjeruar i Lushnjës. Me zgjerimin e Statutit të Lushnjës, krijoheshin kushtet ligjore, për ta vënë shtetin shqiptar në rrugën e demokracisë dhe për t’u siguruar shtetasve liritë brenda ligjit. Në këtë periudhë, Ahmet Zogu, ndryshe nga ç’kishte ndodhur në vitet 1920-1922, kur ishin ndërruar 7 kryeministra, mundi të qëndronte në postin e kryetarit të Qeverisë, për më tepër se një vit, gjë që për kushtet e atëhershme të Shqipërisë, nuk ishte e pakët. Zogu u përpoq të vendoste në Shqipëri një administratë me metoda qeverisjeje perëndimore. Me gjithë vështirësitë, qeveria e Zogut mundi të bënte mjaft hapa drejt forcimit të administratës shtetërore e të unitetit kombëtar, të zhvillimit ekonomik dhe të lehtësimit të varfërisë. Se në çfarë niveli ishte gjendja e Këshillit të Naltë si dhe e institucioneve të tjera kryesore të shtetit, në dhjetorin e vitit 1921, e provojnë edhe ngjarjet e grushtit të shtetit të kësaj kohe.

⁷ AQSH, Fondi. 149, viti.-, dos. I-1866, fl. 1. Shkresë e Këshillit të Naltë, dërguar Këshillit Kombtar, dt. 10.11.1920, mbi njoftimin për mospyetjen e K. Naltë në punët qeveritare.

⁸ *The British National Archives (TNA)*, Foreign Office 371/5726, f. 638-641. Telegram konfidencial i Eyres, dërguar Earl Curzon, Durrës, dt. 18 mars 1921.

Fatkeqësisht, autorë kryesorë të grushtit të shtetit, ishin dy anëtarët ndoshta më me influencë të tij, Aqif Pasha dhe L. Bumçi. Kjo dëshmon se Këshilli i Lartë nuk mund të qëndronte si organ i pavarur dhe si arbitër në lojën parlamentare të partive. Madje, jo vetëm kaq por, ai mori edhe një nisëm të rrezikshme si për stabilitetin e vendit dhe ndërtesën e tij shtetërore ashtu edhe për vetë autoritetin dhe vijueshmërinë konstitucionale të tij. Si rezultat i këtij akti, ai iu nënshtrua një sulmi të ashpër politik, kryesisht nga “Partia Popullore”, e cila ishte partia më e fuqishme dhe më e organizuar në atë kohë. Këtë qëndrim të kësaj partie e ka shprehur ndër të tjera edhe njëri nga drejtuesit kryesorë të saj, Sejfi Vllamasi, i cili e ka pohuar qartazi në kujtimet e tij.⁹

Këshilli i Naltë me në krye Aqif Pashën, ashtu edhe krerët e tjerë të komplotit, bënë presione e kërcënime mbi Pandeli Evangjelin, që ky të jepte dorëheqjen. Ky i fundit, ju përgjigj se do ta jepte dorëheqjen me t’u mbledhur parlamenti. Kjo përgjigje nuk i kënaqi ata. Atëherë dy anëtarët e Këshillit të Naltë Aqif Pasha me Imzot Bumçin, më 6 dhjetor 1921, me këtë akt arbitrar e skandaloz të poshtëshënuar e pushuan nga puna kryeministrin: “Tue qenë se kabineti i Z. Suaj mbas dorëheqjes dhe të Zija Dibrës, *ipso jure* asht i ramë tue humbun shumicën legale me katër pjestarë dorëheqës, detyrën për të formuar kabinetin e ri si kryeministër ja kemi ngarkue z. Qazim Koculit”. Pandeli Vangjeli këtë akt e refuzoi me përbuzje.¹⁰ Kjo ngjarje dëshmon se sa e brishtë ishte situata politike në Shqipëri dhe sa të dobëta ishin institucionet e sigurisë. Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë nënkolonel Ali F. Kosturi, i cili ishte në dijeni të komplotit dhe ishte simpatizues i kësaj ndërmarrjeje, për të justifikuar dorëheqjen e tij dhe për të mbetur jashtë përgjegjësisë, plagosi veten në këmbë.¹¹

Në këtë rast duhet theksuar fakti se, edhe pse paraqitja e S. Vllamasit ka nota tendencioze dhe emocionale, kuptohet aventura e rrezikshme e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë. Këtë e vërteton edhe letra e Këshillit të Naltë, drejtuar Kryeministrit Pandeli Evangjeli, me të cilën njoftohet për rënien e kabinetit të kryesuar prej tij dhe formimin e kabinetit të ri, të kryesuar nga Qazim Koculi. Ky është një dokument themelor për të kuptuar shkeljen flagrante të kushtetutshmërisë dhe realizimit të një grushti shteti nga lart prej Këshillit të Naltë. Në letrën e Këshillit të Naltë thuhej se, “meqenëse përveç tre anëtarëve të kabinetit, edhe Z. Zija Dibra ka lajmëruar se jep

⁹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, Përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: “Neraida”, 2000, f. 259-260.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, f. 260-261.

dorëheqjen, kabineti i juaj “ipso jure asht i ramë duke humbun shumicën legale me katër pjestarë dorëhekës. Për këtë arsye, detyrën e formimit të qeverisë ia ngarkojmë Qazim Koculit”. Letra ishte nënshkruar në emër të Këshillit të Naltë vetëm nga dy anëtar të tij: Aqif Elbasani dhe Imzot Bumçi.¹² Në përgjigjen e tij drejtuar anëtarëve të Këshillit të Naltë, kryeministri Pandeli Evangjeli, u bëri të njohur atyre arsyet e refuzimit, për të dhënë dorëheqjen si kryeministër dhe arsyetonte se me dekretin e shkarkimit të tij, Këshilli i Naltë ka kryer një veprim arbitrar, autoritar dhe antikonstitucional. Në letrën e tij, kryeministri Evangjeli, kundërshtonte arsyet, mbi të cilat Këshilli i Lartë u bazua për të rrëzuar kabinetin e tij, kabinet i cili, kishte besimin e përfaqësuesve të popullit. Sipas tij, ky vendim binte në kundërshtim të plotë me dispozitat kushtetuese të Statutit të Lushnjës. Kryeministri, pohonte se kabineti mund të vazhdonte edhe pas dorëheqjes së Z. Dibrës, duke pasur 6 ministra nga 7 që duheshin. Sipas Statutit të Lushnjës, Këshilli i Lartë, kishte të drejtë të zgjidhte kryeministrin dhe ky i fundit zgjidhte ministrat, me të cilët do të bashkëpunonte. Por, megjithatë, fjalën e fundit e kishte Parlamenti, me mocionin e besimit ose të mos besimit të qeverisë.

Gjithashtu, duhej mbledhur Parlamenti, i cili ishte i mbyllur përkohësisht, për t’i shpjeguar veprimet e këtij kabineti kundra interesave të vendit. Një tjetër pikë antikonstitucionale, ishte fakti se në shkresën me të cilën njoftohej rrëzimi i qeverisë së P. Evangjelit, kishin nënshkruar vetëm dy nga katër anëtarët e tij. Për këto arsye, kryeministri njoftonte se do të mbetej në detyrë deri në mbledhjen e ardhshme të Parlamentit, i cili, ishte planifikuar të mbledhej në datën 15 të këtij muaji. Letra e kryeministrit Evangjeli, ishte një analizë serioze e antikushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit të Naltë.¹³

Por, vazhdimi i mosmarrëveshjeve mes dy organeve kryesore shtetërore, kërcënimi me armë i kryeministrit për të dhënë dorëheqjen dhe shqetësimi i tij për krijimin e një precedenti për shpërthimin e një lufte të mundshme vëllavrasëse, bënë që kryeministri Pandeli Evangjeli, të japë dorëheqjen. Në letrën e dorëheqjes, të cilën ai ja dorëzoi prefektit të Korçës, Kolë Tromara, shkruante: “Me qenë që mosmarrëveshja midis Shkëlqesisë suaj dhe mua përmis zgjedhjen e Ministrëve për të kompletuar kabinetin nënë

¹² *AQSH*, Fondi. 147, viti. 1921, dos. I-18, fl.8. Shkresë e Këshillit të Naltë, ku i kërkohet kryeministrit P. Evangjeli të japë dorëheqjen dhe njoftohet për caktimin e kryeministrit të ri.

¹³ Po aty, fl.6. Letër e kryeministrit P. Evangjelit dërguar Këshillit të Naltë, dt. 6.12.1921, mbi zëvendësimin e dy ministrave dhe veprimet antikonstitucionale të Këshillit të Naltë.

kryesinë t'ime po vazhdon, e vështronj të nevojshme për të mirën të Atdheut të jap dorëheqjen".¹⁴

Prëzimi i kabinetit të kryesuar nga Pandeli Evangjeli, pati impakt edhe në jetën shoqërore në vend. Mënyra e prëzimit të tij nga Këshilli i Naltë, e zemëroi popullin dhe opinionin publik në vend, e konsideronte këtë akt të Këshillit të Naltë, një veprim arbitrar që ishte në kundërshtim të hapur me Statutin e Lushnjës. Duke e denoncuar grushtin e shtetit, gazeta "Dielli" shkruante: "Sjellja e Regjencës që shtrëngoje z. Pandeli Evangjeli dhe kabinetin e tij të japë demicjen e zemëroj keq popullin, i cili e quan këtë punë si shkelle të shtatutit të Lushnjës. Korça, Berati, Elbasani, Durrësi, Gjirokastra dhe Vlora protestuan".¹⁵

Protestat kundër grushtit të shtetit, të cilat janë fshehur nga historiografia e mëparshme, pohohen nga burime të ndryshme. Ato dëshmonin se, në vend, me gjithë pamaturinë politike dhe institucionet e dobëta, ekzistonte një bërthamë e shëndoshë e opinionit publik, e cila e kuptonte drejt rrezikshmërinë e këtyre ngjarjeve, për fatet e mëtejshme të procesit të konsolidimit të shtetit shqiptar. Ka disa studiues të kohës, si për shembull Sëire apo ndonjë tjetër, që këtë ngjarje e kanë quajtur si një prëzim jokushtetues të qeverisë së Evangjelit nga Këshilli i Naltë, për shkak të mosmarrëveshjeve midis tyre. Sigurisht, në këto përcaktime kanë ndikuar dy faktorë kryesorë.

Së pari, fakti që grushti i shtetit u krye pa zhurmë dhe pa gjakderdhje; Së dyti, ishin mungesa e dispozitave të qarta ligjore dhe e kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni dhe pikërisht nga dokumenti themeltar "Bazat e Kanunores", që krijonte paqartësi dhe pështjellim. Megjithatë, logjika e thjeshtë e krijimit dhe e prëzimit të qeverive përmes votëbesimit në parlament e bënte këtë një veprim jo ligjor dhe i jepte trajtën e një grushti shteti.

Por nga ana tjetër, duhet theksuar edhe fakti se, ky gjithashtu kishte qenë një veprim edhe i pa menduar mirë i këtyre dy pjesëtarëve të Këshillit të Naltë. Veprim i cili, dëshmonte edhe për kapacitetin e ulët politik të tyre edhe duke i gjykuar nga pikëpamja e një politike joparimore dhe joligjore. Së pari, ata gabuan pasi nuk kishin parashikuar me saktësi vendosmërinë e Q. Koculit për të përballuar presionet si një kryeministër i ardhur në pushtet me forcë dhe për t'i shtypur tendencat që do të shfaqeshin kundër tij. Gabimi i dytë, ishte emërimi i H. Prishtinës. Ata nuk arritën të parashikojnë se ndaj tij kundërshtimi do të ishte edhe më i madh dhe për më tepër do të krijonte një

¹⁴ AQSH, Fondi. 147, viti. 1921, dos. I-18, fl.7. Letër e kryeministrit P. Evangjeli, dërguar Këshillës së Naltë, dt. 6.11.1921, mbi dorëheqjen e tij si kryeministër.

¹⁵ Dielli, nr. 2331, dt. 10.01.1922, "Sjellja e Regjencës zemëroi tërë popullin në Shqipëri".

armiqësi të madhe jashtë Shqipërisë. Kryeministri nuk do të mund t'u qëndronte presioneve të jashtme e atyre të brendshme duke krijuar edhe rrezikun e madh të thellimit të përçarjes krahinore në vend.

Me dorëheqjen e Hasan Prishtinës, dy anëtarët e Këshillit të Naltë, Aqif Pasha dhe Imzot Bumçi ngarkuan Idhomene Kosturin të formonte një qeveri prej drejtorëve të zyrave, derisa të mblidhej parlamenti, që të formonte një qeveri definitive. Ky kabinet asnjans kishte për mision mbajtjen e qetësisë për të dy palët deri në vendosjen e legalitetit. Këtu shohim një fenomen tepër interesant dhe ndoshta të rrallë për mënyrën e përfundimit të një grushtshteti, nga vetë organizatorët e tij. Kjo u arrit në sajë të presionit politik të atyre forcave politike, të cilat ishin për një zhvillim paqësor dhe ligjor të institucioneve kombëtare. Pra, kjo dëshmonte se raporti ishte në favor të këtyre forcave, të cilat kërkonin konsolidimin dhe zhvillimin legal dhe të qetë të shtetit shqiptar. Kjo do të dëshmohej edhe me vendimet që do të merrte më tej Parlamenti shqiptar për të kapërcyer pasojat e grushtit të shtetit. Grushti i shtetit nuk u prit mirë edhe nga disa pjesëtarë të opozitës. Pra, Këshilli i Naltë do të gjykohej negativisht, jo vetëm prej Partisë Popullore, e cila ishte e acaruar pasi P. Evangjeli ishte pjesëtar i saj, por edhe nga disa individë opozitarë. Kjo do t'i jepte një goditje të rëndë jo vetëm autoritetit të komplotistëve por, edhe autoritetit të këtij institucioni. Kjo dëshmon se grushti i shtetit, la një shije të keqe edhe në një pjesë të opozitës, e cila ende nuk kishte kaluar e tëra drejt përdorimit të metodave radikale dhe të dhunshme për marrjen e pushtetit.

Por, grushti i shtetit nuk dështoi vetëm nga refuzimi popullor dhe ndoshta nuk ishte ky faktori kryesor. Mendoj se presioni kryesor mbi organizatorët e grushtit të shtetit, erdhi pak më vonë nga forcat e ushtrisë dhe të civilëve të komanduara nga Zogu. "Me t'u marrë lajmi i grushtit të shtetit, Zogu dërgoi një numër ushtarësh nën komandën e Azis Çamit për të zënë Shkallën e Tujanit, para se ta zinin ushtarët që kish dërguar nga Mati toger Mehmet Dajçi, sipas urdhrit telegrafik të Zija Dibrës, Ministrit të Luftës. Forcat e komanduara nga Zogu hynë në Tiranë dhe gjendja në kryeqytet u normalizua menjëherë. Deputetëve dhe gjithë shokëve të tyre, që u kthyen nga Elbasani, iu bë një pritje madhështore, më 16 dhjetor 1921. Parlamenti u hap më 22 dhjetor 1921.¹⁶ Grushti i shtetit do të vinte në provë edhe një institucion tjetër të lartë si dhe dominimin e tij mbi Këshillin e Lartë. Tashmë pritej të provohej fuqia e një organi themelor ligjvënës, siç ishte Parlamenti, i cili ishte gjendur para një grushtshteti të paprovokuar dhe tërësisht të pajustifikueshëm. Qëndrimi i tij, do të ndikonte shumë në forcimin e legjitimitetit dhe të

¹⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike ...*, f. 265-266.

institucioneve shtetërore në të ardhmen ose do të ndodhte e kundërta, në se nuk do të mbahej qëndrimi i duhur ligjor, do t'u hapej rruga anarkisë dhe krizave të tjera edhe më të rrezikshme politike dhe institucionale.

Ky moment ishte shumë i rëndësishëm, për të provuar nëse klasa politike drejtuese e vendit, do të tregojë e aftë të dilte mbi kufizimet dhe interesat e saj dhe të vinte në plan të parë forcimin e institucioneve dhe vijueshmërinë normale të shtetit. Në të vërtetë, ajo u tregua e urtë, vetëm për ta shtyrë krizën dhe për t'i dhënë vendit vetëm një qetësi të përkohshme. Pasi në krye të komplotit qëndronin dy anëtarë të Këshillit të Naltë, Aqif Pasha me Imzot Bumçin, Parlamenti vendosi shkarkimin e tyre, duke i zëvendësuar këta me Imer Pashë Vrionin dhe me Ndoc Pistullin. Me dekretin e tij, nr. 743, datë 23.12.1921, Këshilli Kombëtar njoftoi shkarkimin e dy anëtarëve të Këshillit të Naltë, por, pa përcaktuar arsyet e një vendimi të tillë. Këto arsye thuhej se do t'i njoftoheshin popullit me një deklaratë të posaçme.¹⁷

Dy anëtarët e tjerë të Regjencës, Abdi Toptani dhe dr. Turtulli, mbasi e konsideruan rrëzimin e dy kolegëve të tyre, një shkelje të Statutit të Lushnjës, dhanë dorëheqjen. Në letrën e tyre dërguar Këshillit Kombëtar, ata theksonin: "Me qenë se vendimi që mori dje i ndershmeni Parlament për të dy pjesëtarët e tjerë nuk na duket të jetë pas Statutit të përkohëshme të Lushnjës, jemi të detyruar t'i lutemi fort Parlamentit që të pranojë dorëheqjen t'onë".¹⁸ Në vend të tyre, Parlamenti zgjodhi Refik Toptanin dhe Sotir Pecin. Vetë dorëheqja e anëtarëve të Këshillit të Naltë, ishte një reagim i çuditshëm, pasi ata i referoheshin Statutit të Lushnjës, kur dy kolegët e tyre kishin kryer një grushtshteti, një akt që vinte në kundërshtim të hapur me dispozitat e Statutit të Lushnjës dhe për më tepër, ata ishin bashkëpërgjegjës, pasi nuk kishin bërë asnjë përpjekje për ta ndaluar këtë zhvillim të rrezikshëm. Kjo ishte një provë tjetër domethënëse, e kapacitetit të ulët politik dhe menaxhues, të ajkës drejtuese të shtetit shqiptar, në këtë periudhë, por, edhe e ndërgjegjes së tyre kushtetuese. Zhvillimet politike të vitit 1921, vunë në provë të gjitha institucionet politike shtetërore të krijuara nga Kongresi i Lushnjës. Rënia e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë, shënoi pikën më kritike të këtij organi të lartë kushtetues dhe indirekt, dështimin e formulës qeverisëse të përzgjedhur në Kongresin e Lushnjës. Më tej, autoriteti dhe

¹⁷ AQSH, Fondi. 152, viti. 1921, dos.36, fl.1. Shkresa nr. 743 më 23. XII .921 e Këshillit Kombëtar (Eshref Frashëri) dërguar Min. së P. të Brendshme, mbi rrëzimin e anëtarëve të Këshillit të Naltë.

¹⁸ Po aty, Fondi. 147, viti. 1921, dos. I-18, fl.23. Shkresë e anëtarëve të Këshillit të Naltë, dt. 22.12.1921, ku njoftojnë kryetarin e Parlamentit për dorëheqjen e tyre.

pesha e këtij institucioni të lartë do të pësonte një rënie të ndjeshme, ndërsa dominimi i Parlamentit mbi të, do të rritej.

Por, ky akt i Këshillit të Naltë do të acaronte në kulm edhe marrëdhëniet midis partive politike në gjirin e parlamentit. Në këtë mënyrë, institucioni i kryetarit të shtetit, në vend që të ruante unitetin dhe kohezionin politik në vend, çka është prerogativë kryesore e tij, do të kthehej në një mekanizëm konfrontimi dhe përçarje politike të thellë dhe me pasoja të pariparueshme. Parlamenti, në mbledhjen e parë të tij, diskutoi mbi deputetët e Drinit dhe duke marrë parasysh se në viset e prefekturës së Drinit, që u liruan nga okupacioni jugosllav nuk ishin bërë zgjedhjet parlamentare të rregullta dhe mbasi populli i asaj prefekturë kërkonte të bëheshin zgjedhje të lira, vendosi t'i rrëzojë ata nga deputetësia. Sigurisht në këtë qëndrim, ndikoi shumë angazhimi i tyre në mbështetje të grushtit të shtetit. Largimi i deputetëve që kishin marrë pjesë në komplot, do ta nxirrte ballafaqimin politik nga Parlamenti, jashtë tij dhe do ta kthenin atë nga një ballafaqim politik brenda suazës konstitucionale, në një konflikt jashtë saj dhe që do të merrte trajtën e një konfrontimi me armë, për shkak se krerët e larguar nga parlamenti, dispononin forca paramilitare të gatshme për tu vënë nën urdhrat dhe komandën e tyre. Pra, Këshilli i Lartë u bë shkak edhe për krizën e parlamentit dhe parlamentarizmit në Shqipëri në këtë periudhë.

Por, edhe vetë kriza e Këshillit të Lartë nuk do të mbaronte këtu. Ajo u shfaq sërish me forcë gjatë kryengritjes së marsit 1922, kur dy regjentët Ndoc Pistulli dhe Ymer Pashë Vrioni, krejt papritur dhanë dorëheqjen. Për të kuptuar situatën e krijuar, mjafton të japim diskutimet që u bënë në atë kohë në Parlament, të cilat ishin tepër të tensionuara. Në diskutimin e tij K. Tasi theksonte: “Dorëheqja e dy pjesëtarëve të Këshillit të Naltë u bë në një kohë, që edhe sikur vdekja tu kishte ardh, lipsesh të qëndronin në detyrë, e mos ta kishin ba një punë të tillë.” Pas tij, deputeti N. Ivanaj u shpreh: “Për arsye se dy anëtarët e Këshillit të Naltë dhanë dorëheqjen e tyne natën e kryengritjes janë të dënuem moralisht se dorëheqja e tyne mundet me qenë e lidhun me kryengritjen, jo pse kishin pjesë në kryengritje, por pse ata Zotëni e dhanë dorëheqjen, pse e dinin se do të plaste kryengritja”.¹⁹ Zëvendësimi i anëtarëve të dorëhequr, u bë me vështirësi dhe provonte se plotësimi i këtij organi të lartë ekzekutiv, ishte një detyrë e vështirë. Problemet kryesore me të cilat u përballën ligjvënësit, dëshmohen në diskutimet që ata bënë në seancat parlamentare.

¹⁹ BKK, Viti II, 1922, f. 305-313. Diskutimet mbi dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit të Naltë, 3 tetor 1922.

Kështu, Mehdi Frashëri, këmbëngulte për zgjedhjen e personave me autoritet dhe të paanshëm, pra, jo partiakë. Ai argumentonte faktin se anëtarët e Këshillit të Lartë, zënë vendin e Presidentit të Republikës, të një mbreti dhe përfaqësojnë fuqinë sovranë. Sipas tij, cilësia më me rëndësi e një fuqie sovranë është paanësia e plotë, sepse po t'i mungojë fuqisë sovranë paanësia, atëherë kjo, jo vetëm mbetet pa rëndësi, por bëhet dhe e dëmshme.²⁰ Njëri nga krerët e opozitës së asaj kohe, Ali Këlcyra, si shkak të trazirave në zgjedhjen e Këshillit të Naltë, konsideroi partinë e shumicës, sepse dy anëtarët e Këshillit të Naltë kishin qenë të zgjedhur në parti por, më në fund nuk kishin rënë dakord. Ai kundërshtoi propozimin që Këshilli i Naltë të mbetej me dy anëtare dhe kërkoi plotësimin e tij me katër anëtarë.

Në këtë konflikt të ashpër politik, u arrit deri aty sa edhe të viheshin në pikëpyetje edhe vendimet e Kongresit të Lushnjës, i cili kishte vlerën e konstituimit të shtetit shqiptar dhe të bazave të tij. Interesante në këtë rast, ishte replika e N. Ivanajt, i cili pohoi se, "Kongresi i Lushnjës nuk ishte një kongres legjislativ për gjithëmotin e jetës, por qe një gja e përkohshme". Ai vinte në dukje se, "ky Kongres kishte një rëndësi të posaçme, sepse kishte shpëtuar Shqipërinë në një moment shumë kritik, por, ai nuk vuni ligja themeltare për gjithmonë, e se ç'ka ka caktue Kongresi i Lushnjës nuk do me thanë se nuk mund të ndryshohet asgjë pse Kongres i Lushnjës bani edhe asi sendesh qi s'duhesh të baheshin e se ra edhe në disa gabime të cilët na kanë kushtue shumë."²¹ Ky, ishte një gjykim kritik për veprimtarinë ligjvënëse të Kongresit, i cili, ka një vlerë të posaçme, për të kuptuar larminë e mendimit politik e juridik të asaj kohe.

Diskutimet nuk përfunduan këtu, ata u rikthyen edhe një herë për këtë çështje, në fillim të dhjetorit 1922. Në këtë seancë, Hilë Mosi, vuri edhe një herë në dukje se, çështja e plotësimit të Këshillit të Naltë, të cilën, e cilësonte me të drejtë, një çështje kapitale për shtetin, për arsye të mosmarrëveshjeve në parlament, nuk ishte zgjidhur ende. Mehdi Frashëri, kërkoi që dy anëtarët e Këshillit të Naltë të zgjidheshin prej deputetëve "të gjithë Shqipnis, e mendimet regjionale mund t'i influencojnë vetëm deputetët e ndonji krahine, por jo deputetët e Shqipnis e Parlamentin Shqiptar". Pra, ai kërkoi që të shmangeshin influencat, mendësitë dhe paragjykimet krahinore në zgjedhjen e tyre. Midis deputetëve pati edhe propozime konkrete. Kështu, Ali Këlcyra, propozoi zgjedhjen e Mit'hat

²⁰ BKK, Viti II, 1922, f. 305-313. Diskutimet mbi dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit të Naltë, 3 tetor 1922.

²¹ Po aty, f. 595- 603. Bisedime për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Naltë, 28 tetor 1922

Frashërit, për të cilin tha: “Cilësinat ma të vlefshme qi duhet të ketë një njeri për këtë shkallë, i shoh ma tepër në Z. e tij Mid’hat Frashërin, i cili veç cilësinave të tjera ka edhe besimin e respektin e popullit.”²² Më në fund, në këtë seancë, u bë votimi, prej të cilit rezultuan fitues Xhafer Ypi (34 vota) e Gjon Çoba (33 vota).

Megjithatë, në periudhën deri në shpërthimin e trazirave të qershorit 1924, Këshilli i Naltë, funksionoi si institucion me po ato prerogativa që kishte pasur edhe më parë. Por, sigurisht autoriteti i tij kishte pësuar rënie, si për shkak të ngjarjeve që kishin ndodhur, ashtu edhe për shkak të nivelit të personaliteteve që ishin tashmë në krye të tij. Ndërsa, pas kryengritjes së qershorit, ai do të zhvlehtësohej thujse tërësisht sepse në Shqipëri mbeti vetëm njëri prej anëtarëve të tij madje edhe ky për periudha të caktuara kohe. Siç dihet, do të ishte Kuvendit Kushtetues, që doli nga zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1923, i cili do të hartonte e do të miratonte edhe statutin e nevojshëm për kushtetimin e shtetit shqiptar. Deri në këtë kohë forma përfundimtare e qeverisjes së shtetit shqiptar, akoma nuk ishte vendosur. Kështu debatet për formën e regjimit në vend, do të vazhdonin dhe do të ishin tema kryesore e diskutimeve në Parlament dhe në faqet e organeve të shtypit. Këto debate do t’i referoheshin gjerësisht edhe formës së regjimit, i cili nënkuptonte pikësëpari edhe qëndrimin ndaj Regjencës apo Këshillit të Naltë. Nga ana tjetër, këto diskutime do të kishin parasysh dhe do t’i referoheshin edhe përvojës së viteve të kaluara, të veprimtarisë së këtij organi.

Duket se në mendimin konstitucional shqiptar të kësaj kohe ka pasur ndikim edhe mendimi i shprehur nga ideologu i rilindjes sonë kombëtare Sami Frashëri, një kundërshtar i rreptë i absolutizmit. Ai e vlerësonte rolin e individit, por për punët e qeverisjes, preferonte format kolegjiale, të qeverisjes popullore, të cilat kanë qenë karakteristike për të drejtën zakonore shqiptare.²³ Pra, Samiu konsideronte më të përshtatshëm për shtetin shqiptar një formë qeverisjeje me kryetar kolegjial në krye të shtetit. Organizimi politik i shtetit shqiptar, që propozohej në vepër, në thelb, ishte një organizim perëndimor. Por, edhe vepra e Samiut, ndonëse nisej nga dy premisa realiste, siç ishin dëshira për një qeverisje demokratike dhe merrte parasysh nivelin ende të prapambetur dhe fisnor në të cilin ndodhej shoqëria shqiptare, nuk kishte parasysh përfitimet e kësaj forme qeverisëse dhe

²² Po aty, f. 863-867. Bisedimet për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Naltë, 2 dhjetor 1922.

²³ Luarasi, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, Pjesa II, Tiranë, 1994, f. 5.

shkallën e efektivitetit shtetformues të saj si dhe kontributin që ajo do të sillte në një qeverisje të stabilizuar të vendit.

Në një artikull të botuar në gazetën “Dajti”, H. Jusuf Banka, jepte arsyet e tij pse monarkia i përshtatej kushteve në të cilat ndodhej Shqipëria në këtë periudhë. Sipas tij, politikisht, Shqipëria nuk do të kishte kundërshtarë të gjithë ato shtete që nuk kanë afrim me mbretin (ngjashmëri me mbretërinë si formë qeverisje), por, përkundrazi mbreti do të vendosej me pëlqimin e fuqive evropiane. Monarkia nuk do ta rëndonte ekonomikisht shtetin”.²⁴ Ky ishte një perceptim interesant i formës monarkike të qeverisjes, së cilës i njiheshin disa attribute që në fakt ndihmonin për të kapërcyer disa nga vështirësitë që ndeshte Shqipëria e asaj kohe në procesin e shtetformimit. Së pari, mbreti shihej si një garanci për të tejkaluar dhe sfumuar vështirësitë që buronin nga ndarja e popullsisë në tre besime fetare, e cila shihej si një pengesë e madhe për ndërtimin e një qeverisje unike dhe të centralizuar kombëtare. Së dyti, mbreti shihej si mbështetja më e fortë e krijimit të një partie nacionaliste, që të qëndronte mbi grupet politike me fizionomi krahinore dhe fetare, e cila mund të krijohet dhe të konsolidohet vetëm prej tij.

Me këtë konstatim, vihej gishti në një nga plagët më të rënda politike të kohës, në dobësinë e nacionalizmit shqiptar dhe në paaftësinë e tij për të dalë si një bllok i vetëm, unik dhe i fuqishëm e dominues politik, çka perceptohej me të drejtë nga autori, si një garanci për ndërtimin e një shteti kombëtar të fortë, vital dhe të stabilizuar. Së treti, duke pohuar një fenomen tashmë të provuar, mungesën e homogjenitetit të plotë kulturor, shpirtëror e politik brenda vendit, Monarkia shihej si mbushëse e këtij boshllëku dhe si agjent pozitiv në krijimin e këtij homogjeniteti në një periudhë të caktuar historike. Për formën e regjimit që duhet të kishte vendi, dhanë mendimin e tyre edhe anëtarët e kuvendit kushtetues. Hilë Mosi, në një shkrim në gazetën “Dajti”, datë 24 mars 1924, kërkonte ruajtjen e monarkisë. Ai theksonte se me Statutin Organik, sipas të drejtës ndërkombëtare, ishte përcaktuar qartë regjimi monarkik i shtetit. Trajta e Regjencës ose e Këshillit të Naltë nuk ishte një formë përfundimtare regjimi për një shtet, por diçka e përkohshme, në kushte jo normale. Këtë trajtë të përkohshme regjimi, e përcaktonte edhe Statuti Organik i Shqipërisë, në kreun e dytë, ku fliste për të drejtat e Mbretit.²⁵ Pra, sipas tij, mohimi i monarkisë ishte në

²⁴ *Dajti*, nr. 19, dt. 20 mars 1924, H. Jusuf Banka, “Monarki apo Republikë?”

²⁵ Po aty, nr. 20, dt. 24 mars 1924, Hil Mosi, Mis i Kuvendit Kushtetues, “Forma e regjimit”.

kundërshtim flagrant *de jure* e *de facto* me Statutin Organik të vitit 1914 dhe me Statutin e Lushnjës.

Po kaq interesante dhe sigurisht e diskutueshme, ishte edhe pikëpamja që shfaqte kjo gazetë për ndërgjegjen kombëtare, të cilën e nënkuptonte si institucionin themelor të ndërtimit të një qeverisje efektive kombëtare dhe demokratike dhe që i mungonte shqiptarëve të paktën në nivelin e duhur. Ajo shkruante: “Shqiptari ka pasur gjithmonë një ndërgjegje e madhështie race e gjaku, dhe jo ndërgjegje kombëtare. Ndërgjegjen kombëtare e formojnë traditat e nënshtetësitë politike të përbashkëta”.²⁶ Kjo gazetë nënvizonte se, Kongresi i Lushnjës krijoi një “katrumvirat” që u zgjodhën me unanimitet. Por, kësaj Regjence nuk i la asnjë të drejtë apo kompetencë që kanë kryetarët e republikave më të lira në botë, përveç se të firmoste dekretet automatikisht. Kjo për arsyen se regjenca nuk do dinte t’i përdorte mirë këto liri. Edhe pse u ndërruan anëtarët e Regjencës, dispozitat e Statutit apo zakonet kushtetore mbetën po ato. U zgjerua Statuti i Lushnjës, po Regjenca mbeti po ajo.²⁷ Pra, forma republikane, nuk shihej e përshtatshme për gjendjen shoqërore në të cilën ndodhej vendi. Mbrohej pikëpamja se, vetëm regjimi monarkik, mund të largonte këto rreziqe që i kanoseshin vendit nga regjimi republikan. Gjithashtu thuhej se Mbreti në krye të shtetit, do të çonte në zhdukjen e influencave personale.

Problemet e shumta në përcaktimin e pushteteve, në marrëdhëniet mes organeve kryesore qeverisëse të shtetit shqiptar ishin prezente në fillim të vitit 1924, kur kriza politike në vend po shkonte drejt apogjeut të saj. Kështu, u shfaq edhe një herë konflikti mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve mes Këshillit të Lartë dhe Kryeministrit. Këshilli i Lartë, në një shkresë dërguar Kryeministrit, referonte parimet e drejtësisë kushtetuese dhe të jurisprudencës në Shqipëri. Sipas tij, kryesia e shtetit nuk ishte vetëm një zyrë noteriale e Këshillit Ministror. Për çështjet dhe emërimet me rëndësi duheshin marrë parasysh edhe mendimi i kryesisë së shtetit. Regjenca argumentonte se, në çdo shtet fuqitë ekzekutive, legjislative e gjyqësore ishin të përcaktuara sipas Statutit. Pra, kryesia e shtetit fuqinë ekzekutive e ushtronte me ndërmjetësinë e kabinetit. Mirëpo, marrëdhëniet dhe detyrat reciproke të kryesisë së shtetit me atë të Këshillit Ministror, sado që ishin në kompetencën e fuqisë ekzekutive, prapë ishin të rregulluara me ligje të posaçme të caktuara nga fuqia legjislative. Këshilli i Lartë, kërkonte

²⁶ Po aty, nr. 23, dt. 5 prill 1924, “Forma qeveritare e Shqipniës”.

²⁷ Po aty, nr. 24, dt. 11 prill 1924, “Forma qeveritare e Shqipniës”.

të caktohej me ligj kompetenca e tij, për të cilën bëhej fjalë në nenin 60 të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës.²⁸

Degradimi i Këshillit të Naltë ishte i plotë, në muajt e qeverisjes revolucionare të Nolit. Ai jo vetëm u zhduk si institucion, por, edhe u keqshfrytëzua nga qeveria, duke uzurpuar kompetencat dhe duke e tjetërsuar natyrën e tij. Për të kuptuar më mirë degradimin e këtij institucioni dhe shkatërrimin e tij, mjafton t'i referohemi qarkores së Këshillit të Ministrave, dërguar Prefekturave, më 2 korrik 1924: "Shkelqësie e tyre Z. Sotir Peci, Mis i Këshillit të Naltë me mbështetje të nenit 51 të Statutit me shkresën nr. 169 me I.VII. 924 i ngarkon titullarit të kësaj Kryesije për një kohë të shkurtën të drejtën e ushtrimit të Këshillit të Naltë për sa qi shkelqesia e tyre do të jetë i larguar nga Tirana si për ndrrim ajri dhe për të bërë disa banjo të nevojshme për përmirësimin e shëndetit të vet qi ndodhet i pamundun prej kohësh. Titullari i kësaj Kryesije duke e falenderuar shkelqesiën e tyre për mbesimin e treguem pranonj barrën e ngarkueme deri në kthimin e Shkelqesiës së Tij, me lutje qi në këtë mënyrë t'u njoftohet autoriteteve të mvaruna n'atë Ministrie."²⁹

Për ta shtuar edhe më tej këtë krizë të rëndë institucionale, vetëm pas 20 ditësh në qeverisje, kryeministri Noli, i cili kishte marrë në mënyrë antiligjore edhe përgjegjësitë e Këshillit të Naltë, largohet nga vendi për rreth tre muaj, duke lënë një vakum të madh institucional dhe politik në vend. Në një qarkore tjetër, drejtuar prefekturave, më datë 22 korrik 1924, ai njoftonte se Këshilli i Ministrave, ... "me rastin e vajtjes së kryeministrit Imzot Nolit për të përfaqësuar bashkë me Luigj Gurakuqin Shqipërinë në Shoqërinë e Kombeve, vendosi qi në vend të tij të mbetet si Kryeministre dhe *ipso jure* si Këshille e Lartë Sulejman Delvina për tërë kohën që do jetë larg Kryeministri Imzot Fan Noli".³⁰ Megjithatë, Këshillit të Lartë i duhet njohur njëfarë peshe në këtë kohë. Së pari, kjo vërtetohet nga refuzimi i vazhdueshëm dhe këmbëngulës i regjentit të vetëm të mbetur në vend S. Pecit për të legjitimuar qeverinë e Nolit që kishte ardhur në pushtet me dhunë, pa u vërtetuar kjo më parë nga një shumicë parlamentare pasi të zhvilloheshin zgjedhjet si dhe presioni që bëri Peci në emër të Regjencës, që Noli të zhvillonte sa më parë zgjedhjet. Dhe ishte pikërisht ai, që firmosi

²⁸AQSH, Fondi.147, viti. 1924, dos. I-57, fl.24-26. Shkresë e Këshillit të Naltë dërguar Kryeministrit, dt.29.4.1924, mbi marrëdhëniet ndërmjet tyre.

²⁹AQSH, Fondi. 152, viti. 1924, dos. 169, fl. 1. Qarkore e Kryesisë së Këshillit Ministerial dërguar Min. së P. të Brendshme, dt. 4. VII. 924, mbi barrën e Këshillit të Naltë.

³⁰Po aty, fl.3. Qarkore e Min. së P. të Brendshme, dt. 26. 8. 924, mbi zënien e vendit të kryeministrit nga Sulejman Delvina.

dekretin e vonuar të zgjedhjeve të shpallura nga qeveria e Nolit, detyruar ta bënte këtë jashtë dëshirave të saj, për shkak të rrethanave të brendshme dhe ndërkombëtare.

Forma e regjimit ishte vendosur të përcaktohej nga Asambleja Kushtetuese e vitit 1923. Por, përpara kësaj, asnjëri nga grupet politike në vend nuk ishte shprehur qartë për të. Gazeta “Drita” shkruante se, as qeveria dhe as kundërshtarët e saj nuk kishin guxuar ende të bisedonin mbi këtë pikë delikate të statutit. Megjithatë, vërente ajo, ishte kuptuar se, me përjashtim të një grupi bejlerësh që duan të krijojnë një klasë aristokracie, të dy palët duan të ruajnë *status quo*-në e Lushnjës, mbase jo përfundimisht, por për një kohë relativisht të gjatë. Nga dokumentet dhe materialet e shfletuara, kemi krijuar mendimin se, ky ishte një konstatim i drejtë. Më tej gazeta pohonte se, forma origjinale e Këshillës së Lartë, e vendosur në Lushnjë, nuk mund të mbahej përgjithmonë. Me këtë mënyrë zgjedhjeje dhe me kompetencat e sotme, *status quo*-ja e Lushnjës, nuk mund të ruhet përgjithmonë. Dispozitat kushtetuese të Kongresit të Lushnjës, me gjithë mangësitë e tyre të krijuara në një kohë kur nevojat e vendit ishin urgjente, nuk mund të qëndrojnë si bazë për regjimin e shtetit. Pasojat që kanë buruar nga pallati i Këshillit të Lartë, e bëjnë të frikshme mbajtjen e formës së caktuar në Lushnjë si fuqi sovrane.³¹ Edhe ky ishte një përfundim korrekt, të cilin, tashmë e kishte vërtetuar edhe përvoja e shkurtër e atyre viteve. Defekti i Këshillit të Lartë si institucion në krye të shtetit, dukej se ishte mjaft serioz. Edhe shtetarë të njohur të asaj kohe, ngritën me forcë shqetësimin se modeli i krijuar nga Kongresi i Lushnjës, nuk mund të vijonte me tej dhe i pari institucion, që duhej ndryshuar dhe reformuar, ishte ai i kryetarit të shtetit.

³¹ *Drita*, nr. 142, datë 17 Vjesht e II 1923, “Forma e regjimit”.

Albana MEMA

SUMMARY

THE INSITUATION OF THE HIGER COUNCIL IN ALBANIA DURING 1920-1924

Political developments of 1921 tested all state political institutions created by the Congress of Lushnja. The collapse of two High Council members marked the most critical point of this high constitutional institution and brought the failure of the ruling formula elected at the Lushnja Congress. Further, the authority of this high institution would suffer a significant fall, while the domination of the Parliament on it would increase. But this act of the High Council would also exacerbate relations between political parties in the parliament. In this way, the head of state institution instead of maintaining political unity and the political cohesion in the country, which is its prime prerogative, would turn into a political confrontation and disagreement mechanism with irreparable consequences.

KUD: 94(496.5) .086 (093.2)
328(496.5) "1925/1939" :341.222
341.121 :341.222(496.5) (093.2)

Hasan BELLO

ASPEKTE TË PARLAMENTARIZMIT SHQIPTAR NË VITET 1925-1939

Një aspekt i rëndësishëm i jetës politike të shtetit shqiptar është parlamentarizmi i viteve 1925-1939. Kjo periudhë përkon me dy eksperimente themelore nga këndvështrimi juridik dhe politologjik, me ndryshimin e formës së regjimit nga drejtimi kolektiv i shtetit (regjenca) në Republikë (1925-1928) e më pas në Monarki (1928-1939). Në këtë artikull do të përpiqemi të shqyrtojmë në mënyrë sintetike disa aspekte kryesore nga veprimtaria dhe jeta parlamentare e kësaj periudhe. Duke u nisur nga këto kritere artikulli nuk synon të analizojë në detaje jetën parlamentare dhe diskutimet e zhvilluara nga deputetët. Ai ka si qëllim të paraqesë një panoramë të përgjithshme, duke u përqendruar në problematikat kryesore.

Rikthimi i Ahmet Zogut pas ngjarjeve të qershorit 1924 u shoqërua me normalizimin e jetës parlamentare. Një pjesë e deputetëve u rikthyen, ndërsa ata që ishin implikuar në lëvizjen e qershorit, së bashku me Fan Nolin ndoqën alternativën e emigrimit dhe braktisjen e detyrës nga frika e ndëshkimit. Për këta të fundit, Kryesia e Parlamentit mori masa të menjëhershme që t'i ndërpriteshin marrëdhëniet financiare me shtetin.¹ Gjithashtu u evidentuan deputetët që ishin implikuar në lëvizjen e qershorit 1924 dhe që kishin marrë detyra të rëndësishme shtetërore në qeverinë e Nolit. Ajo i kërkoi Komisionit të Drejtësisë të hartonte një listë emërore për deputetët që kishin shkelur kushtetutën dhe që ishin larguar në arrati.² Për

¹ Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: *AQSh*), F. Parlamenti, D.3, V.1925, fl.4. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për Ministrinë e Financave, Tiranë, 18.01.1925.

² *AQSh*, F. Parlamenti, D.4, V.1925, fl.1-2. Letër e Kryesisë së Kuvendit Kushtetues, për Komisionin e Drejtësisë, Tiranë, 20.01.1925.

këtë u kërkuar ndihmë nga Ministria e Brendshme, e cila përgatiti një listë të detajuar.³

Lista e deputetëve që pas lëvizjes së qershorit 1924, në kundërshtim me kushtetutën, kishin marrë funksione administrative

Nr.	Emri	Qyteti ku ishte zgjedhur deputet para qershorit 1924	Detyra shtetërore që kishte marrë pas ardhjes në pushtet të qeverisë së Fan Nolit	Arka nga ku kishte marrë rrogën dhe ku kishte ende marrëdhënie financiare
1	Ali Begeja	Durrës	Kryetar i Bashkisë Tiranë	Arka e Bashkisë Tiranë
2	Sami Koprencka	Berat	Nënprefekt i Pogradecit	Arka e Pogradecit
3	Kol Tromara	Korçë	Prefekt, Elbasan	Arka e Elbasanit
4	Spiro Koleka	Vlorë	Prefekt, Korçë	Arka e Korçës
5	Bahri Omari	Gjirokastrë	Anëtar në Komisionin e Semplifikimit	Arka e Tiranës
6	Abdyl Kuçi	Gjirokastrë	Pyetës në Gjyqin Politik	Arka e Tiranës
7	Rasim Babameto	Gjirokastrë	Kryetar i Gjyqit Politik	Arka e Tiranës
8	Ismail Haki Tatzati	Gjirokastrë	Komandant i Grupit të Tiranës	Arka e Tiranës
9	Pjetër Bumçi	Shkodër	Drejtor i Doganës së Durrësit	Arka e Durrësit
10	Nush Bushati	Shkodër	Konsull i Shqipërisë në Vjenë	Arka e Ministrisë së Punëve të Jashtme
11	Dervish Mitrovica	Kosovë	Qark, komandant i Shkodrës	Arka e Xhandarmërisë
12	Numan Ferizi	Kosovë	Prefekt Berat	Arka e Beratit

³ Po aty, fl.6. Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Kryesinë e Kuvendit Kushtetues, Tiranë, 12.02.1925.

13	Doktor Fahri	Kosovë	Drejtor i Spitalit të Vlorës	Arka e Vlorës
14	Ibrahim Gjyrezi	Shkodër	Nënprefekt i Malësisë së Madhe	Arka e Shkodrës
15	Shuk Gurakuqi	Shkodër	Anëtar në Komisionin e Semplifikimit	Arka e Tiranës
16	Mustafa Tragjasi	Vlorë	Anëtar në Komisionin Administrativ të qeverisë revolucionare	Arka e Tiranës
17	Qazim Koculi	Vlorë	Ministër	Arka e Tiranës
18	Fan Noli	Korçë	Kryeministër	Arka e Tiranës
19	Sylejman Delvina	Gjirokastrë	Ministër	Arka e Tiranës
20	Luigj Gurakuqi	Shkodër	Ministër	Arka e Tiranës
21	Xhemal Bushati	Shkodër	Ministër pa portofol	Arka e Tiranës
22	Kostaq Paftali	Durrës	Anëtar në Komisionin Administrativ të qeverisë revolucionare	Arka e Tiranës

Në bazë të kësaj liste emërore, Ministrisë së Financave iu kërkua që personave në fjalë t'u ndërpritej çdo marrëdhënie financiare me institucionet e shtetit shqiptar që nga data kur ata ishin përfshirë në lëvizjen e qershorit dhe kishin marrë përsipër funksionet e lartpërmendura, duke hequr dorë nga detyra si përfaqësues të popullit në Parlament.⁴ Ajo u tregua e gatshme për riorganizimin e administratës parlamentare, duke nisur që nga policët, kopistët, stenografët, daktilografistët, etj. Ndërsa, anëtarët e Dhomës së Deputetëve dhe Senatit u dalluan për seriozitetin dhe integritetin e tyre moral e politik. Kjo vihet re nga problematikat që ata trajtuan në seancat parlamentare, ku të bie në sy niveli intelektual dhe shkalla e lartë e përgatitjes profesionale me të cilat trajtonin projektligjet e paraqitura për

⁴ Po aty, fl.7. Letër e Kryesisë së Kuvendit Kushtetues, për Ministrinë e Financave, Tiranë, 23.02.1925.

shqyrtim. Ata ishin të ndjeshëm edhe ndaj akuzave që ngriheshin në faqet e shtypit. Një rast tipik ishte ai i kryetarit të Senatit, Eshref Frashëri, për të cilin *Gazeta e Korçës* kishte botuar artikullin “Ç’flitet andej këndeje për një...komplot”.

Autori i këtij shkrimi, një gazetar i njohur lokal, aludonte pasi ishte informuar nga një autoritet me rëndësi i administratës së, Eshref Frashëri ishte implikuar në përgatitjen e një komploti kundër rendit kushtetues dhe përmbykses me dhunë të presidentit të Republikës, Ahmet Zogu. Ky lajm kishte ngjallur një indinjatë të thellë tek kryetari i Senatit, i cili i kishte telegrafuar presidentit dhe më pas i kishte shpjeguar verbalisht se akuzat e mësipërme ishin shpifje. Për këtë kishte kërkuar që të ndërmerreshin hetime qoftë ndaj gazetarit, qoftë ndaj tij personalisht. Meqenëse këto aludime kishin pasur si burim fillestar një nëpunës të administratës lokale, Eshref Frashëri për t’i hapur rrugë hetimeve të paanshme nga ana e Prokurorisë kërkoi nga presidenti që të jepte dorëheqjen nga Kryesia e Senatit.⁵ Por, Ahmet Zogu e kundërshtoi këtë kërkesë. Ai i shkruante Eshref Frashërit se meqenëse këto akuza drejtoheshin ndaj një funksionari të lartë të shtetit shqiptar dhe kishin një ndikim të madh për prestigjin e institucioneve shtetërore në sytë e popullit, kishte urdhëruar Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme të ndërmerrnin hetime të posaçme lidhur me këto akuza.

Për këtë, ishte ngritur edhe një komision hetimor, i cili do t’i tregonte popullit seriozitetin e çështjeve që kishin të bënin me rendin dhe sigurinë vendit. Aq më tepër kur bëhej fjalë për personalitete të rëndësishme, siç ishte rasti i kryetarit të Senatit. Prandaj, me hidhërim të thellë dhe me sinjeritet për kontributin e tij në administratën e shtetit shqiptar, deri në përfundim të hetimeve, presidenti Ahmet Zogu u detyrua të pranonte dorëheqjen e paraqitur nga Eshref Frashëri.⁶ Kjo tregon për frymën demokratike dhe emancipuese që ekzistonte tek drejtuesit e Parlamentit për t’i hapur rrugë hetimeve të institucioneve kompetente. Ndërkohë u njoftua Prefektura e Gjirokastrës që nënkryetari i Senatit, Petro Harito, të nisej menjëherë drejt Tiranës për të marrë përsipër përgjegjësitë e kryetarit të Senatit derisa kjo çështje të sqarohet nga Komisioni Hetimor.⁷

⁵ Po aty, fl.79. Letër e kryetarit të Senatit Eshref Frashëri, për presidentin e Republikës së Shqipërisë, Ahmet Zogu, Tiranë, 15.09.1925.

⁶ Po aty, fl.80. Letër e presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ahmet Zogu, për kryetarin e Senatit, Eshref Frashëri, Tiranë, 20.09.1925.

⁷ Po aty, fl.81-82. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Prefekturën e Gjirokastrës, Tiranë, 21.09.1925.

Nr.	Lista e senatorëve në vitin 1925⁸
1	Abdurrahman Dibra
2	Eqerem Vlora
3	Eshref Frashëri
4	Halit Rroji
5	Hafez Xhemal
6	Jusuf Gjinali
7	Nafez Dervishi
8	Pandeli Evangjeli
9	Salih Vuçiterni
10	Sami Vrioni
11	Spiro Papa
12	Shevqet Vërlaci
13	Zija Toptani

Lista e personelit e Sekretariatit të Përgjithshëm të Senatit⁹

Nr.	Emri	Funksioni
1	Demir Vila	Sekretar i përgjithshëm
2	Et'hem Frashëri	Redaktor
3	Faik Ruga	Redaktor
4	Bajram Jakup	Ndihmësredaktor
5	Kel Beni	Ndihmësredaktor
6	Zija Ohri	Protokollist
7	Athanas Sallabanda	Llogaritar

Zëvendësimi i deputetëve që jepnin dorëheqjen për arsye shëndetësore ose për shkak të caktimit të tyre si përfaqësues të shtetit shqiptar në vende të ndryshme të botës bëhej sipas një procedure rigoroze në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën. Kështu, në vend të deputetit të Beratit, Qerim Vrioni, i cili la mandatin e deputetit për shkak të një sëmundje të rëndë, kandidoi Qemal Karaosmani. Komisioni zgjedhor i kësaj prefekturë në mbledhjen e 27 nëntorit 1925, i dorëzoi Gjykatës së Shkallës I procesverbalet e qendrave të votimit, sipas nënprefekturave

⁸ Po aty, fl.105. Lista e senatorëve në vitin 1925.

⁹ Po aty. Lista e personelit të Sekretariatit të Përgjithshëm të Senatit në vitin 1925.

përkatesë së, bashku me rezultatet e dala nga ky proces. Sipas procesverbalit në fjalë, Qemal Karaosmani rezultonte fitues me 320 vota.¹⁰

Nr.	Prefektura/Nënprefektura	Nr. i votave
1	Berat	126
2	Fier	46
3	Lushnjë	90
4	Skrapar	40
5	Mallakastër	18

Kryesia e Parlamentit pasi pranoi unanimisht zgjedhjen e deputetit të ri, njoftoi Këshillin e Ministrave për publikimin e këtij lajmi në Fletoren zyrtare; urdhëroi Ministrinë e Financave për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të deputetit të dorëhequr dhe lidhjen e këtyre marrëdhënieve për Qemal Karaosmanin.¹¹

Vendosja e legjitimitetit u konsiderua nga Qeveria shqiptare si një model për krijimin e precedentëve historikë, për t'i treguar kundërshtarëve politikë dhe të gjithë atyre që pretendonin ta merrnin pushtetin me dhunë se kjo ishte një alternativë e dështuar. Kjo vihet re edhe nga një kërkesë që zëvendësministri i Drejtësisë, Hysen Vrioni, në emër të Këshillit të Ministrave, i drejtoi Dhomës së Deputetëve e Senatit lidhur me shqyrtimin e caktimit e datës 24 dhjetor si ditë përkujtimore për rivendosjen e legjitimitetit.¹² Ndërsa, Qeveria shqiptare vendosi krijimin e një medaljeje për dekorimin e të gjithë atyre që kishin kontribuar për largimin e qeverisë së dalë nga lëvizja e qershorit 1924. Ajo do të shpërndahej në shenjë kujtimi vetëm një herë në jetë për çdo person që e meritonte; ky distiktiv tërhiqej vetëm kur personi përfitues dënohej për tradhti kombëtare, ndërsa kur ai vdiste, ajo trashëgohej nga familjarët.¹³ Kjo kërkesë e Qeverisë shqiptare gjeti konsensus të plotë nga deputetët. Ajo u konsiderua si një akt simbolik, i cili do të rrënjoste në mendësinë e politikanëve shqiptarë se rruga e ardhjes në pushtet ishte nëpërmjet zgjedhjeve dhe jo duke përdorur forcën dhe mjete

¹⁰ Po aty, fl.109. Procesverbal i Komisionit Zgjedhor në Prefekturën e Beratit, për Parlamentin, Berat, 27.11.1925.

¹¹ Po aty, fl.111. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 10.12.1925.

¹² *AQSh*, F. Parlamenti, D.36, V.1925, fl.1. Letër e zëvendësministrit të Drejtësisë, Hysen Vrioni, për Kryesinë e Dhomës së Deputetëve, Tiranë, 23.11.1925.

¹³ Po aty, fl.2. Vendim i Komisionit Qeveritar lidhur me përkujtimin e 24 dhjetorit 1924, Tiranë, 23.11.1925.

të tjera antikushtetuese.¹⁴ Një qëndrim të ngjashëm mbajti edhe Senati, i cili pas miratimit ia paraqiti Kryesisë së Republikës për ta dekretuar.¹⁵

Dhoma e Deputetëve dhe Senati ishin institucione që gëzonin kredibilitet në masat e gjera të popullsisë. Krahës funksionit legjislativ ato shiheshin edhe si zyra ku qytetarë të ndryshëm drejtonin lutje për zgjidhjen e problemeve personale, në raport me padrejtësitë e bëra nga nëpunës të shtetit, institucionet e pushtetit lokal e qendror. Një rast tipik ishte kërkesa e Luka Raskoviqit, i cili kishte shërbyer si shofer i amerikanëve të vrarë në pyllin e Mamurrasit, më 6 prill 1924. Në këtë ngjarje, ai kishte mbetur i plagosur rëndë dhe pas një mjekimi në spitalin e Tiranës ishte transportuar drejt Italisë ku kishte qëndruar në një qendër të specializuar për disa muaj.

Kjo kishte bërë që për afro një vit e gjysmë të humbiste aftësinë për punë, duke shkaktuar një dëm të rëndë ekonomik për familjen e tij të varfër. Në kërkesën drejtuar Senatit, Luka Raskoviq shkruante se kryeministri i asaj kohe Iliaz Vrioni i kishte premtuar se Qeveria shqiptare do të merrte përsipër të gjitha shpenzimet dhe dëmshpërblimin për personin në fjalë. Por si rezultat i rrethanave që ishin krijuar ky premtim kishte vite që ishte shkelur. Prandaj, ai kërkonte nga ky institucion mbështetje për të nxitur autoritet vendimmarrëse për ta dëmshpërblyer.¹⁶ Kërkesa u lexua para Senatit dhe u vendos t'i kalohej komisionit të financave për ta shqyrtuar dhe analizuar në rrugë zyrtare. Ky i fundit kërkoi sqarime nga Ministria e Brendshme,¹⁷ e cila informoi se kriminelët që kishin shkaktuar këtë ngjarje ishin dënuar me ekzekutim. Prandaj, ajo nuk kishte mundësi për t'i gjobitur, me përjashtim nëse Luka Raskoviq i drejtohej gjykatës për të përfituar nga trashëgimia e tyre. Ndërsa, lidhur me premtimet e bëra nga ish-kryeministri, Iliaz Vrioni, ky institucion nuk dispononte asnjë dokument zyrtar.¹⁸ Megjithatë, Komisioni i Financave i dërgoi Kryesisë së Senatit shpjegimet e nevojshme bashkangjitur me rregulloren mbi shpërblimet dhe pensionet e nëpunësve të shtetit kur vriteshin dhe plagoseshin në krye të detyrës.¹⁹

¹⁴ Po aty, fl.7. Vendim i Dhomës së Deputetëve drejtuar Senatit, Tiranë, 24.11.1925.

¹⁵ Po aty, fl.8. Letër e kryetarit të Senatit drejtuar Kryesisë së Këshillit të Ministrave ku vë në dijeni se pas miratimit të ligji në fjalë i kishte kaluar Kryesisë së Republikës për dekretim, Tiranë, 26.11.1925.

¹⁶ *AQSh*, F. Parlamenti, D.75, V.1928, fl.1. Letër e Luka Raskoviq drejtuar Senatit, Tiranë, 14.3.1928.

¹⁷ Po aty, fl.2. Letër e Komisionit të Financave drejtuar Ministrisë së Brendshme, Tiranë, 01.04.1928.

¹⁸ Po aty, fl.5. Letër e ministrit të Brendshëm, Koço Kotta, për Kryesinë e Senatit, Tiranë, 17.05.1928.

¹⁹ Po aty, fl.6. Letër e Komisionit të Financave, për Kryesinë e Senatit.

Kjo tregon seriozitetin me të cilin anëtarët e pushtetit legjislativ ushtronin detyrën si përfaqësues të popullit dhe mbrojtës të interesave të tij, qoftë edhe kur bëhej fjalë për një person të vetëm. Këto qëndrime ndikuan jashtëzakonisht shumë jo vetëm për mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore, por edhe për ndërtimin e ekuilibrave të brendshëm social, juridik dhe politik. Raste të ngjashme vihen re pothuajse gjatë gjithë legjislativave, çka tregon se tek individët, institucioni i Parlamentit shihej si një mekanizëm i rëndësishëm dhe me peshë në shtetin shqiptar të kësaj periudhe.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i protokollit të shtetit ishin edhe festat, ceremonitë zyrtare dhe simbolika e shtetit shqiptar. Në evenimente të tilla bëhej kujdes që sipas hierarkisë të ftoheshin të gjithë drejtuesit dhe nëpunësit e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe të gjyqësorit. Kështu, me rastin e paradës së madhe të 8 tetorit, ditëlindjes së Mbretit Zog, kryeministri, Koço Kotta, kërkoi nga kryesia e Parlamentit listën e deputetëve pjesëmarrës, me qëllim që t'u rezervoheshin vendet dhe ftesat përkatëse.²⁰ Kjo kërkesë gjeti gatishmëri të plotë nga Parlamenti. Madje, kryesia shprehu dëshirën që, meqenëse sesioni i ardhshëm parlamentar ishte shumë afër në këtë paradë të merrnin pjesë edhe deputetët që banonin jashtë kryeqytetit.²¹ Prandaj, ajo kërkoi që të rezervoheshin afërsisht 50 vende. Paraprakisht ajo i dërgoi kryeministrit një listë me emrat e deputetëve kryesorë dhe të nëpunësve të Parlamentit.²²

Nr.	Emri i deputetit
1	Zija Toptani
2	Jusuf Gjinali
3	Rexhep Mati
4	Shahzivar Alltuni
5	Seid Toptani
6	Abdurrahman Sali Mati
7	Hafez Xhemali
8	Fiqiri Rusi
9	Kol Mjeda
10	Jashar Erebara

²⁰ *AQSh*, F. Parlamenti, D.18, V.1929, fl.1. Letër e kryeministrit, Koço Kotta, për kryetarin e Parlamentit, Tiranë, 24.9.1929.

²¹ Po aty, fl.2. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për kryeministrin, Koço Kotta, Tiranë, 28.09.1929.

²² Po aty, fl.3-4.

11	Halid Rroji
12	Ndrek Kiçi
13	Maliq Bushati
14	Kolec Deda
15	Ejell Serreqi
16	Mark Kapedani
17	Ferid Vokopola
18	Bahri Begolli
19	Ahmet Hastopalli
20	Riza Kishta
21	Hajdar Blloshmi
22	Anton Beça

Nr.	Emri i nëpunësit	Funksioni
1	Xhemil Rruga	Sekretar i Përgjithshëm
2	Gjush Benushi	Redaktor-stenograf
3	Hifzi Pojani	Redaktor-stenograf
4	Kol Fishta	Ndihmësredaktor-stenograf
5	Taf Agolli	Ndihmësredaktor-stenograf
6	Anastas Frashëri	Ndihmësredaktor-stenograf
7	Athanas Sallabanda	Sekretar-llogaritar
8	Zija Ohri	Sekretar-bibliotekar
9	Rrok Deda	Protokollist
10	Pasho Frashëri	Kopist

Kryesia e Parlamentit tregoi një interes të posaçëm që në këtë paradë të merrnin pjesë edhe disa deputetë, emra të njohur dhe me influencë të qyteteve kryesore shqiptare, që për momentin nuk ndodheshin në Tiranë. Prandaj, ajo kërkoi nga Prefekturat e Vlorës, Gjirokastrës, Elbasanit, Beratit dhe Korçës të vinin në dijeni këto personalitete lidhur me paradën e organizuar me rastin e ditëlindjes së Mbretit Zog.²³ Nga dokumentacioni i kohës, konstatohet se protokolli i shtetit dhe rigoroziteti që ndiqej për të tilla raste karakterizohej nga një seriozitet maksimal. Kështu, pavarësisht këtyre shkresave, kryeministri Koço Kotta, kërkoi edhe një herë nga Kryesia e Parlamentit listën e saktë të deputetëve pjesëmarrës për shkak se Komanda e Mbrojtjes Kombëtare duhej të merrte masa lidhur me sigurimin e organizimit. Aq më tepër që deputetët do të pajiseshin me bileta nominale,

²³ Po aty, fl.5-6. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për prefekturat, Tiranë, 03.10.1929.

duke përcaktuar numrin e saktë të vendeve sipas hierarkisë së nëpunësve të shtetit shqiptar.²⁴ Kjo e detyroi Kryesinë e Parlamentit që të kërkonte nga të gjitha prefekturat të vinin në dijeni deputetët se në datën e caktuar duhej të gjendeshin në Tiranë.²⁵ Me këtë rast, pas organizimit të paradës së madhe do të shtrohej një gosti ku do të ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e kombit. Kjo e fundit do të organizohej nga Ministria e Punëve të Jashtme, e cila do të ftonte trupin diplomatik dhe personalitete që shërbenin në Shqipëri. Prandaj, edhe ky institucion kërkoi nga Kryesia e Parlamentit listën e deputetëve që do të merrnin pjesë në këtë pritje zyrtare.²⁶ Një ftesë e tillë gjeti mirëpritjen e kryetarit të Parlamentit, Pandeli Evangjeli, i cili e falënderoi ministrin e Jashtëm për kujdesin e treguar ndaj përfaqësuesve të kombit.²⁷ Kjo tregon se midis drejtuesve të institucioneve të larta shtetërore të shtetit shqiptar, siç ishte rasti i kryetarit të Parlamentit, Pandeli Evangjeli, dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Rauf Fico, ekzistonte një raport korrekt dhe miqësor. Një frymë e tillë bashkëpunuese ndërmjet tyre, që përfaqësonin njëri pushtetin legjislativ (Parlamentin) dhe tjetri pushtetin ekzekutiv (Qeverinë) krijonte një klimë të favorshme për rritjen e efijecës institucionale.

Për ata deputetë që nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në paradën e madhe të 8 tetorit, për arsye të ndryshme personale dhe familjare, Kryesia e Parlamentit kërkoi që ata të ishin të pranishëm në qendrat e prefekturave. Në ceremonitë e organizuara, deputetët duhej të përfaqësonin institucionin e tyre, duke mbajtur nga një fjalim përshëndetës ku të evidentoheshin arritjet e shtetit shqiptar për përmirësimin e kushteve ekonomike, sociale dhe politike gjatë drejtimit të vendit nga Mbreti Zog.²⁸ Një detyrë tjetër, pjesë funksionale e institucionit të Parlamentit ishte edhe miratimi i dekoratave të nivelit të lartë, që Qeveria shqiptare shpërndante me rastin e festave dhe ceremonive zyrtare.

Kështu, me propozim të Kryeministrit një komision i posaçëm qeveritar kishte vendosur që ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, Dino Grandit, i cili si përfaqësues i Mbretit të Italisë dhe qeverisë fashiste italiane

²⁴ Po aty, fl.7. Letër e kryeministrit, Koço Kotta, për kryetarin e Parlamentit, Tiranë, 03.10.1929.

²⁵ Po aty, fl.8. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për prefekturat, Tiranë, 04.10.1929.

²⁶ Po aty, fl.9. Letër e Ministrit të Punëve të Jashtme, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 01.10.1929.

²⁷ Po aty, fl.10. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për ministrin e Punëve të Jashtme, Tiranë, 02.10.1929.

²⁸ Po aty, fl.11. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për deputetët e prefekturave, Tiranë, 03.10.1929.

do t'i parashtronte Mbretit Zog ndjenjat e përshëndetjet e popullit mik e aleat, t'i akordohej në shenjë nderimi "Grand Kordoni i Urdhrit Besa".²⁹ Këtë dekretligj Kryesia e Parlamentit ia dërgoi për shqyrtim Komisionit të Jashtëm.³⁰ Kjo tregon se mekanizmat e brendshëm parlamentar funksiononin maksimalisht, duke respektuar hallkat e nevojshme në përputhje me ligjin dhe jetën parlamentare të institucioneve bashkëkohore të shteteve perëndimore. Komisioni në fjalë pas shqyrtimit të dekretligjit konfirmoi se ai ishte në përputhje me dispozitat ligjore,³¹ duke i hapur rrugën miratimit në seancën parlamentare.³² Pas miratimit nga Parlamenti, ligji për dekorimin e Dino Grandit me "Grand Kordoni i Urdhrit Besa" u dekretua edhe nga Mbreti Zog.³³

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së Parlamentit ishte përcaktimi dhe sanksionimi i simbolikës, stemës dhe flamujve të shtetit shqiptar. Ndonëse një legjislacion i tillë ishte hartuar vite më parë, ndryshimi i disa karakteristikave thelbësore kishte shtruar problemin e rishikimit të këtij legjislacioni. Prandaj, një grup deputetësh, pjesë e Komisionit Parlamentar të Ushtrisë, Drejtësisë dhe Administratës shqyrtuan me kujdes dekretligjin për stemën dhe flamujt e shtetit shqiptar. Ata konstatuan se projektligji i përgatitur nga specialistët përkatës dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave, plotësonte të gjitha kriteret e nevojshme teknike dhe ligjore.³⁴ Kjo i hapi rrugën projektligjit për t'u votuar nga Parlamenti.³⁵ Deputetët gëzonin një status të respektuar në raport me institucionet e tjera kushtetuese. Kështu, me rastin e 28 nëntorit, Festës së Pavarësisë, kryeministri Koço Kotta, kërkonte nga kryesia e Parlamentit caktimin e një deputeti për të mbajtur fjalën para popullit dhe nxënësve të kryeqytetit, në sheshin para xhamisë së Et'hem Beut.³⁶ Nga pikëpamja funksionale Parlamenti shqiptar dhe Kryesia e tij ndiqte, një procedurë rigorozë. Kjo vihet re nga një sërë dokumentesh

²⁹ Po aty, fl.12. Dekretligj për dekorimin e Dino Grandit, Tiranë, 12.04.1929.

³⁰ Po aty, fl.13. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Komisionin e Jashtëm Parlamentar, Tiranë, 12.12.1929.

³¹ Po aty, fl.14. Letër e kryetarit të Komisionit të Jashtëm Parlamentar, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 12.12.1929.

³² Po aty, fl.15. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Kryeministrinë, Tiranë, 22.12.1929.

³³ Po aty, fl.16. Dekret i Mbretit Zog, për dekorimin e Dino Grandit, Tiranë, 04.05.1929.

³⁴ Po aty, fl.21. Letër e kryetarit të Komisionit Parlamentar të Ushtrisë, Drejtësisë dhe Administratës, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 11.04.1930.

³⁵ Po aty, fl.22. Letër e kryetarit të Parlamentit, për kryeministrin Koço Kotta, Tiranë, 11.5.1930.

³⁶ Po aty, fl.34. Letër e kryeministrit Koço Kotta, për kryetarin e Parlamentit, Tiranë, 27.11.1929.

ku shihet qartë se jeta parlamentare dhe aktiviteti i deputetëve ndiqte një mekanizëm që ishte në përputhje me aktet normative dhe rregulloren.

Në rastet kur një deputet merrte funksione ekzekutive, ndërronte jetë apo emërohej në një detyrë tjetër që binte ndesh me pushtetin legjislativ, ai zëvendësohej sipas legjislacionit. Kështu, më 30 mars 1929, Kryesia e Parlamentit vinte në dijeni Këshillin e Ministrave se deputeti i Korçës, Qani Dishnica, kishte vdekur. Prandaj, duheshin marrë masa, në përputhje me Statutin, që në vend të tij të zgjidhej dikush tjetër dhe të vihej në dijeni Ministria e Financave për të ndërprerë marrëdhëniet financiare me të ndjerin.³⁷ Për këtë u ngrit edhe një komision i posaçëm, i cili filloi procedurat për organizimin e zgjedhjeve të reja në Prefekturën e Korçës. Ato u zhvilluan, më 25 maj 1929, dhe kaluan brenda një normaliteti të plotë. Ndërsa, më 29 maj, komisioni ku bënte pjesë prefekti Hil Mosi, kryetari i Gjyqit të Shkallës I, Ilvi Kadi, kryetari i Bashkisë, Vasil Avrami, anëtari i Bashkisë, Petraq Kondi, dhe anëtari suplementar, Taqi Fundo, filloi këqyrjen e procesverbalit të zgjedhjeve të paraqitur nga Prefektura e Korçës dhe nënprefekurat Pogradec, Bilisht, Kolonjë dhe Leskovik. Nga kjo rezultoi se pjesën dërrmuese të votave, rreth 463 e kishte fituar kandidati, Tefik Mborja.³⁸ Ky proces rezultoi i rregullt dhe nuk u kontestua nga kandidatët e tjerë. Prandaj, Qeveria kërkoi nga Kryesia e Parlamentit që të vazhdonte procedurat lidhur me miratimin e këtij rezultati.³⁹

Në funksion të përmbushjes së detyrave të saj, Kryesia e Parlamentit u tregua e kujdesshme edhe për trajtimin financiar të deputetit të sapo zgjedhur. Ajo kërkoi nga Ministria e Financave që marrëdhëniet financiare të Tefik Mborjes, në bazë të ligjeve dhe rregullores së brendshme të Parlamentit shqiptar të fillonin që nga dita kur ai ishte zgjedhur si deputet. Kjo për shkak se personaliteti në fjalë ishte në vështirësi të mëdha financiare.⁴⁰ Megjithatë një procedurë e tillë ndiqej për të gjithë deputetët apo për Kryesinë e Parlamentit. Kështu, ky institucion vihej në dijeni se në mbledhjen e 16 tetorit 1929, ishte zgjedhur kryetari i ri, Pandeli Evangjeli, nënkryetari Hysen Vrioni, kujdestari Fiqiri Rusi, dhe sekretari, Ejell Serreqi. Prandaj, duheshin marrë masa që trajtimi financiar i tyre të bëhej

³⁷ *AQSh*, F. Parlamenti, D.3, V.1929, fl.1. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 30.3.1929.

³⁸ Po aty, fl.2. Procesverbal i Komisionit të zgjedhjeve të Prefekturës së Korçës, Korçë, 29.05.1929.

³⁹ Po aty, fl.3. Letër e kryeministrit, Koço Kotta, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 27.06.1929.

⁴⁰ Po aty, fl.4. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Ministrinë e Financave, Tiranë, 27.08.1929.

në përputhje me ligjin mbi pagat.⁴¹ Në bazë të rregullores për këtë Kryesia e Parlamentit vinte në dijeni edhe Kryeministrinë, me qëllim që kjo e fundit t'ia komunikonte këtë Oborrit Mbretëror.⁴²

Një rast i ngjashëm ishte edhe zëvendësimi i deputetit të Durrësit, Vasil Rusi, pasi ndërroi jetë. Kështu, procesverbalet e zgjedhjeve që u bënë për vendin vakant, sipas lajmërimit të Prefekturës së Tiranës, u shqyrtuan nga një komision i posaçëm, i cili ishte ngritur në bazë të artikullit 66, të Ligjit për Zgjedhjet në Dhomën e Deputetëve. Komisioni konstatoi se kandidati Stavro Stavri, kishte arritur të merrte këto vota:

Qyteti	Nr. i votave të fituara
Tiranë	93
Durrës	38
Kavajë	68
Krujë	47
Shijak	45
Gjithsej	291

Kjo bëri që Komisioni Zgjedhor të arrinte në përfundimin se Stavro Stavri, ishte kandidati fitues për deputet në Parlamentin shqiptar.⁴³ Ashtu si në rastin e mësipërm, Kryesia e Parlamentit kërkoi nga Ministria e Financave shkëputjen e marrëdhënieve financiare me ish-deputetin, Vasil Rusi, dhe lidhjen e pagës për deputetin e ri, Stavro Stavri, që nga dita e zgjedhjes së tij si deputet.⁴⁴ Konform rregullores së brendshme të Parlamentit, për këtë u vunë në dijeni edhe instancat e larta të shtetit shqiptar.⁴⁵ Në rastet kur deputetët mungonin për një periudhë të caktuar pa marrë leje dhe pa justifikuar mungesën e tyre në seancat parlamentare, Kryesia merrte masa për shkarkimin në bazë të rregullores dhe për zëvendësimin e tyre me një deputet tjetër. Kështu, nënkryetari i Parlamentit, Hysen Vrioni, vinte në dijeni Këshillin e Ministrave se deputeti i

⁴¹ Po aty, fl.5. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Ministrinë Financave, Tiranë, 10.10.1929.

⁴² Po aty, fl.6. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 17.10.1929.

⁴³ Po aty, fl.7. Procesverbal i Komisionit të zgjedhjeve të Prefekturës së Tiranës, Tiranë, 02.12.1929.

⁴⁴ Po aty, fl.8. Letër e kryetarit të Parlamentit, për Ministrinë e Financave, Tiranë, 03.12.1929.

⁴⁵ Po aty, fl.9. Letër e kryetarit të Parlamentit për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 04.12.1929.

Prefekturës së Kosovës, Hasan Kryeziu, kishte munguar për dy muaj pa marrë asnjë autorizim. Sipas nenit 31 të Statutit Themeltar, ai konsiderohej i shkarkuar. Prandaj, Kryesia e Parlamentit në bazë të nenit 34 kërkonte nga Qeveria që të merreshin masa për organizimin e zgjedhjeve dhe për caktimin e kandidaturave të reja.⁴⁶ Kjo procedurë gjeti zbatim praktik dhe brenda një periudhe dymujore në Prefekturën e Kosovës doli si deputet, Halim Derralla, i cili bëri betimin në Parlament se do të përfaqësonte denjësisht elektoratin dhe do të zbatonte rregulloren.⁴⁷ Në procesverbalin e Komisionit Zgjedhor të Prefekturës së Kosovës theksohej se, ai kishte marrë shumicën absolute të votave (105 vota). Kjo tregonte kredibilitetin që kjo figurë gëzonte në mesin e popullsisë.

Nr	Prefektura/Nënprefektura	Nr i votave⁴⁸
1	Prefektura e Kosovës-qendër	20
2	Lumë	43
3	Tropojë	42

Ky rast tregon qartë se rregullorja e Parlamentit zbatohej në mënyrë rigoroze. Ajo aplikohet njësoj për të gjithë përfaqësuesit dhe pa bërë asnjë lloj diferencimi. Ndërkohë që Kryesia e Parlamentit kërkoi gjithashtu nga Ministria e Financave të ndërpriste marrëdhëniet financiare me ish-deputetin, Hasan Kryeziu, dhe lidhjen e tyre me Halim Derrallën.⁴⁹ Një praktikë e ngjashme ndiqej edhe kur deputetët ndërronin jetë. Kështu, pasi deputeti i Durrësit, i ndjeri Jusuf Gjinali vdiq, Kryesia e Parlamentit kërkoi nga Këshilli i Ministrave organizimin e zgjedhjeve për zëvendësimin e tij me një deputet tjetër.⁵⁰ Kandidaturë për vendin vakant doli, Izedin Beshiri, i cili kaloi nëpërmjet një procesi të rregullt zgjedhor. Kjo vihet re nga korrespondenca e Kryeministrit me Prefekturën dhe Kryesinë e

⁴⁶ *AQSh*, F. Parlamenti, D.3, V.1930, fl.1. Letër e nënkryetarit të Parlamentit, Hysen Vrioni, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 05.04.1930.

⁴⁷ Po aty, fl.4. Letër e Kryeministrit, për Parlamentin, Tiranë, 14.06.1930.

⁴⁸ Po aty, fl.5. Procesverbal i Komisionit Zgjedhor i Prefekturës së Kosovës, Kukës, 05.06.1930.

⁴⁹ Po aty, fl.6. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për Ministrinë e Financave, Tiranë, 20.06.1930.

⁵⁰ Po aty, fl.10. Letër e Kryesisë së Parlamentit, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 11.11.1930.

Parlamentit lidhur me procesverbalet e zgjedhjeve.⁵¹ Nga ky dokumentacion rezulton se deputeti në fjalë mori gjithsej 250 vota.⁵²

Nr.	Prefektura/Nënprefektura	Nr. i votave
1	Prefektura e Tiranës-Qendër	74
2	Durrës	43
3	Kavajë	57
4	Krujë	31
5	Shijak	45

Në rastet kur deputetët kryenin ndonjë vepër e cila binte ndesh me legjislacionin e shtetit shqiptar dhe me detyrën që ata përfaqësonin, organet kompetente nisnin procedurën për heqjen e imunitetit, me qëllim që prokuroria dhe gjykata të kishin të drejtë të hetonin apo gjykonin çështjen. Një rast i tillë ishte ai i deputetit Fejzi Alizoti, i cili kishte botuar një artikull kritik në gazetën *Besa* ndaj Nebil Çikës, drejtorit të gazetës *Arbënia* dhe revistës *Minerva*. Pas padisë së Nebil Çikës, prokuroria kërkoi nga Ministria e Drejtësisë që të merrte masa për t'i hapur rrugën procesit hetimor.⁵³ Kjo bëri që kryeministri i kohës, Mehdi Frashëri, t'i kërkonte Kryesisë së Parlamentit të shtronte për diskutim në seancën më të afërt parlamentare çështjen e heqjes së imunitetit të këtij deputeti.⁵⁴ Sipas nenit 26 të Statutit Themeltar, ndalohej që gjatë sezonit parlamentar të ndiqej çështje penale ndaj çdo deputeti, pa pasur më parë lejen e Parlamentit. Prandaj, ndjekja e kësaj procedure standarde ishte në përputhje me Kushtetutën.

Një rast i ngjashëm ishte edhe ai i deputetit Fiqiri Rusi.⁵⁵ Por, tani nisja e hetimeve u bë me kërkesë të Prokurorisë për shkak se ky deputet në dy numra të gazetës *Besa*, më 26 dhe 27 shkurt 1936, kishte botuar dy artikuj me nëntituj “Frymë e helmt... Qëllime të errëta” dhe “Ku po vemi?” në të cilët qeverinë e drejtuar nga Mehdi Frashëri, e përfytyronte sikur që prej ditës që kishte filluar veprimet e saj “ka mbjellë pemë me fruta të helmëta si propagandë shkatërrimtare që mohon çdo gjë të shenjtë të

⁵¹ Po aty, fl.11. Letër e Kryeministrit, për Parlamentin, Tiranë, 22.12.1930.

⁵² Po aty, fl.12. Procesverbal i Komisionit Zgjedhor i Prefekturës së Kosovës, Kukës, 27.12.1930.

⁵³ *AQSh*, F. Parlamenti, D.27, V.1936, fl.1.Letër e Prokurorisë së Shtetit, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 23.1.1936.

⁵⁴ Po aty, fl.1. Letër e kryeministrit, Mehdi Frashëri, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 03.02.1936.

⁵⁵ Po aty, fl.5. Letër e kryeministrit, Mehdi Frashëri, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 29.02.1936.

historisë dhe i venë zjarr kësaj; si vepra e fjalë tmerri, turpit, baltë, përçarje e kauze si gremina anarkie që hapi vetë Qeveria plot viktimë, tmerr e lot në dëm të qetësisë shembullore dhe të rregullit të pashoq të vendit tonë”.⁵⁶ Kjo sipas Prokurorisë, kishte shkaktuar panik në popull, cenonte sigurinë dhe rendin publik, si dhe përhapte shpifje ndaj Qeverisë. Prandaj, në bazë të legjislacionit të shtetit shqiptar ajo kishte filluar hetimet kryesisht dhe kërkonte nga Parlamenti që deputetit Fiqiri Rusi t’i hiqej imuniteti parlamentar me qëllim që çështja në fjalë t’i referohej Gjykatës së Shkallës I. Ky deputet ishte njëkohësisht edhe drejtor i gazetës *Besa*.⁵⁷

Nuk munguan raste kur paditës të deputetëve në Prokurori ishin funksionarë të lartë të shtetit shqiptar. Një rast tipik ishte padia që ministri i Punëve Botore, Ndoc Saraçi, banues në Tiranë, bëri kundër deputetit Abdurrahman Dibra, i cili ishte njëkohësisht drejtor i gazetës *Shqiptari*. Kjo për shkak se ky i fundit kishte botuar në gazetë dy artikuj, duke shpifur se gjoja ministri në fjalë kishte favorizuar në mënyrë të kundërligjshme një mjeshtër të huaj.⁵⁸ Kërkesa iu dërgua Kryesisë së Parlamentit, e cila kishte të drejtën në bazë të ligjit që t’ia parashtronte për diskutim e votim Dhomës së Deputetëve.⁵⁹

Rrethanat e krijuara për shkak të rritjes demografike dhe paqartësisë së nenit 35 për përcaktimin e periudhës legjislative, shtruan nevojën e rishikimit të disa neneve të Statutit Themeltar, që kishin të bënin me zgjedhjen e përfaqësuesve të Dhomës së Deputetëve. Komisioni i ngritur për këtë problem, hartoi një raport justifikues, i cili pas miratimit nga Këshilli i Ministrave iu paraqit për t’u votuar Kryesisë së Parlamentit.⁶⁰ Në raport theksohej qartë se për të gjitha zgjedhjet e realizuara ishin marrë si bazë dhe të mirëqena statistikën e regjistrimit të popullsisë të vitit 1923. Nga kjo kishte rezultuar se brenda territorit shqiptar jetonin 833 618 banorë. Ndërsa, Ligji zgjedhor parashikonte zgjedhjen e një deputeti për 15 000 banorë. Prandaj, numri i përfaqësuesve në Dhomën e Deputetëve në proporcion me numrin e popullsisë ishte 58 deputetë. Por, nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitin 1930, meqenëse ishte konstatuar një rritje

⁵⁶ Po aty, fl.6. Letër e Prokurorisë së Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë, për kryeministrin, Mehdi Frashëri, Tiranë, 29.02.1936.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty, fl.8. Letër e Prokurorisë së Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë, për kryeministrin, Mehdi Frashëri, Tiranë, 31.08.1936.

⁵⁹ Po aty, fl.7. Letër e kryeministrit, Mehdi Frashëri, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 04.09.1936.

⁶⁰ *AQSh*, F. Parlamenti, D.5, V.1936, fl.11. Letër e kryeministrit, Mehdi Frashëri, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 02.11.1936.

demografike që kapte shifrën e 1 000 000 banorëve, numri i deputetëve në legjislaturën e vitit 1932 duhej të ishte në raport me këtë shifër.

Megjithatë për shkak se ekzistonin dyshime lidhur me saktësinë absolute të regjistrimit të popullsisë ishte vendosur që parimisht të ndiqej e njëjta ndarje e zonave zgjedhore, në raport me 58 deputetë. Ndërsa, për zgjedhjet e vitit 1936, kur ishte konfirmuar numri i saktë i rritjes demografike të popullsisë: a) ose duhej rritur numri i kandidatëve për deputetë dhe i zonave zgjedhore nëpër qarqe; b) ose duhej modifikuar Statuti Themeltar. Por, kushtet ekonomike nuk e favorizonin shtimin e numrit të deputetëve. Shpenzimet që nevojiteshin për rrogat dhe dietat e tyre do ta rëndonin tej mase buxhetin e varfër të shtetit shqiptar. Aq më tepër kur bëhej fjalë për një periudhë kur vendi ynë ashtu si e gjithë bota, sapo kishte dalë nga kriza financiare e viteve '30. Prandaj, drejtuesit e shtetit shqiptar dhe Mbreti Zog e konsideruan të arsyeshme që numri i deputetëve të mbetej i njëjtë me legjislaturat e tjera. Mirëpo, kjo duhej bërë në përputhje me Statutin, i cili përcaktonte zgjedhjen e një deputeti për 15 000 banorë. Kjo shtroi nevojën e ndryshimit të nenit 16, duke e rritur numrin e tyre në 18 000 banorë, për një deputet. Këtu duhej marrë në konsideratë se në vitin 1936 ishte shënuar përsëri një rritje e ndjeshme në 1 015 626 banorë.⁶¹

Neni 17 i Statutit Themeltar sanksiononte se Parlamenti zgjidhej për një periudhë katërvjeçare. Ndërsa, neni 35 përcaktonte se në mbarim të periudhës ose në rast se Parlamenti shpërndahej, "Pushteti Përmbarues detyrohet që brenda dy javësh prej ditës së shpërndarjes së tij, të dekretojë zgjedhjet e reja, të cilat duhen bërë jo më vonë se dy muaj e gjysmë e jo më parë se një muaj prej datës së Dekretit".⁶² Nga kjo kuptohej se nenet e cituara përcaktonin vetëm afatin katërvjeçar dhe nuk sqaronin se kur fillonte dhe kur mbaronte ky afat. Përveç kësaj e paqartë mbetej gjithashtu edhe shpërndarja e jashtëzakonshme e Parlamentit. Prandaj u pa e nevojshme që të përcaktohej saktë se kur mblidhej dhe shpërndahej legjislatura parlamentare. Neni 35 u modifikua duke caktuar se legjislatura parlamentare zgjaste katër vite dhe mbaronte me zgjedhjet të cilat shpallehin me dekret mbretëror më datën 5 gusht dhe mbaronin më 5 tetor të çdo viti.⁶³ Por ky projekt-propozim i Komisionit Qeveritar hasi në disa pengesa nga Komisioni Parlamentar i Drejtësisë. Ai ishte i mendimit se neni 35 duhej modifikuar kështu: "Para mbarimit të periudhës parlamentare,

⁶¹ Po aty, fl.15. Raport justifikues i Komisionit Qeveritar për modifikimin e disa neneve të Statutit Themeltar, Tiranë, 02.11.1936.

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty, fl.16.

Pushteti Përmbaues detyrohet të dekretojë zgjedhjet e reja, të cilat duhet bamun jo më pak se dhjetë ditë dhe jo më shumë se tridhjetë ditë para datës së mbarimit të periudhës së mëparshme.

Dekreti Mbretëror duhet të shpallet së paku 80 ditë para periudhës së zgjedhjeve. Periudha parlamentare fillon më 15 tetor. Në rastin e shpërndamjes së Parlamentit, sipas artikullit 95 të Statutit, Pushteti Përmbaues detyrohet brenda dy javëve nga dita e shpërndamjes të dekretojë zgjedhjet e re, të cilat duhen bamun jo më vonë se dy muaj e gjysmë dhe jo më parë se një muaj prej datë së Dekretit Mbretëror. Në këtë rast periudha e Parlamentit të zgjedhur pas shpërndamjes fillon prej ditës së zgjedhjeve dhe në përjashtim të dispozitave të art.17 të Statutit, mbaron me 14 të muajit tetor që vjen mbasi të plotësohen tre vjet prej ditës së zgjedhjeve”.⁶⁴ Sipas Komisionit Parlamentar të Drejtësisë, përcaktimi i datës 5 gusht për fillimin e zgjedhjeve dhe 15 tetor për mbarimin e tyre nga ana e Komisionit Qeveritar, mund të krijonte vështirësi të paparashikuara. Prandaj, ai propozonte që të caktohej një afat i papërcaktuar fiks. Kjo do të krijonte rrethana lehtësuese edhe për Qeverinë. Ndërsa sanksionimi i tyre në Statutin Themeltar e detyronte Qeverinë që pavarësisht kushteve e vështirësive që ndodhej të shpallte fushatën e zgjedhjeve. Një propozim tjetër ishte se mandati i deputetit duhej të fillonte jo ditën kur ai zgjidhej, por kur legjislatura e re parlamentare do të fillonte punimet. Kjo ishte në përputhje me normat juridike të shteteve të qytetëruara evropiane dhe me nevojën që vendi gjatë periudhës tranzitore të zgjedhjeve të mos lihej pa Parlament.⁶⁵

Komisioni Parlamentar i Drejtësisë mori në shqyrtim edhe propozimin e Komisionit Qeveritar lidhur me ndryshimin e nenit që përcaktonte numrin e deputetëve në raport me popullsinë. Ai vendosi që të miratohej një dispozitë e përkohshme, sipas së cilës, numri i deputetëve në periudhën e tretë legjislative të ishte i njëjtë me atë të periudhës së dytë të legjislaturës mbretërore. Prandaj, për çdo prefekturë dhe nënprefekturë të Shqipërisë do të ruhej i njëjti numër deputetësh pavarësisht rritjes demografike të popullsisë. Komisioni e pa të arsyeshme të miratonte gjithashtu edhe një dispozitë tjetër të përkohshme, e cila përcaktonte se zgjedhjet për legjislaturën e tretë të periudhës mbretërore do të dekretoheshin brenda 15 ditëve nga data 15 nëntor 1936. Ato duhej të realizoheshin jo më larg se dy muaj e gjysmë dhe jo më afër se një muaj

⁶⁴ Po aty, fl.17-18. Raport justifikues i Komisionit Parlamentar të Drejtësisë, për Kryesinë e Parlamentit, Tiranë, 15.11.1936.

⁶⁵ Po aty, fl.19.

prej datës së shpalljes së dekretit mbretëror. Kjo legjislaturë fillonte ditën e zgjedhjeve dhe mbaronte zyrtarisht më 15 tetor 1940.⁶⁶

Modifikimet e Statutit Themeltar sipas propozimeve të Komisionit të Drejtësisë u miratuan edhe nga deputetët.⁶⁷ Kjo i hapi rrugën përmirësimit të procesit zgjedhor, duke ruajtur numrin e njëjtë të deputetëve, pavarësisht shtimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Këto zhvillime tregojnë seriozitetin e jetës parlamentare, të komisioneve qeveritare dhe Komisionit të Drejtësisë, i cili ligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave nuk i pranonte *a priori*. Por i shqyrtonte me kujdes, i analizonte duke dhënë sugjerime për modifikimin e tyre në funksion të interesave të shtetit. Madje, nuk mungonin edhe raste kur ato hidheshin poshtë për shkak të kontradiktave me Statutin Themeltar. Qëndrime të tilla tregojnë se institucioni i Parlamentit i përmbushte të gjitha detyrimet e tij kushtetues, duke evituar presionin e pushtetit ekzekutiv.

Në kuadër të veprimtarisë parlamentare deputetët ishin të ndarë në 10 komisione, sipas përvojës që ata kishin në mënyrë direkte ose në fusha të përafërta me to. Por disa prej tyre ishin njëkohësisht drejtues dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme. Në tabelat e mëposhtme kemi paraqitur në mënyrë të detajuar listën e tyre emërore sipas komisioneve përkatëse.⁶⁸

Komisioni i Drejtësisë

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Hafiz Xhemali
2	Nënkryetar	Qani Sulejmani
3	Sekretar	Faik Dishnica

Komisioni i Administratës

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Abdurrahman Dibra
2	Nënkryetar	Faik Dishnica
3	Sekretar	Fiqiri Rusi

⁶⁶ Po aty, fl.20.

⁶⁷ Po aty, fl.21.

⁶⁸ *AQSh*, F. Parlamenti, D.4, V.1936, fl.28. Komisionet Parlamentare në vitin 1936.

Komisioni i Financave

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Fejzi Alizoti
2	Nënkryetar	Hafiz Xhemali
3	Sekretar	Qani Sulejmani

Komisioni i Ekonomisë Kombëtare

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Hiqmet Delvina
2	Nënkryetar	Lame Kareco
3	Sekretar	Faik Dishnica

Komisioni i Arsimit

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Pandeli Evangjeli
2	Nënkryetar	Dhimitër Kacimbira
3	Sekretar	Ferit Vokopola

Komisioni i Punëve Botore

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Eshref Frashëri
2	Nënkryetar	Andon Beça
3	Sekretar	S.Simonidhi

Komisioni i Jashtëm

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Pandeli Evangjeli
2	Nënkryetar	Hiqmet Delvina
3	Sekretar	Tefik Mborja

Komisioni i Ushtrisë

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Xhavit Leskoviku
2	Nënkryetar	Fiqiri Rusi
3	Sekretar	Ferid Dervishi

Komisioni i Buxhetit

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Pandeli Evangjeli
2	Nënkryetar	Hiqmet Delvina
3	Sekretar	Qani Sulejmani

Komisioni i Lutjeve

Nr.	Funksioni	Emri i deputetit
1	Kryetar	Jashar Erebara
2	Nënkryetar	Qani Sulejmani
3	Sekretar	Ali Begeja

Hasan BELLO

SUMMARY

ALBANIAN PARLIAMENTARY ASPECTS IN THE YEARS 1925-1939

An important aspect of the political life of the Albanian state is the parliamentarism of 1925-1939. This period coincides with two basic experiments from the legal and political point of view, with the change of regime form from the collective direction of the state to the Republic (1925-1928) and later to the Monarchy (1928-1939). In this article, we will try to examine synthetically some key aspects of the activity and parliamentary life of this period. Based on these criteria, the article does not intend to analyze in detail the parliamentary life. It aims to present a general picture, focusing on the main issues.

Hamit KABA

KONFLIKTI SHQIPTARO-SOVJETIK: VËSHTRIME TË POLITIKËS GREKE

Në vitet 1953-1959 marrëdhëniet greko-shqiptare njohën disa zhvillime pozitive, të cilat u mundësuan falë përpjekjeve të dy palëve për mirëkuptim, ardhjes në krye të Bashkimit Sovjetik të Hrushovit dhe të “Detantës së vogël”, e cila ndikoi disi në zbutjen dhe shtensionimin e marrëdhënieve Lindje-Perëndim. Në procesin e afrimit greko-shqiptar luajtën rolin e ndërmjetësit organizma të tilla, si: Kombet e Bashkuara, ambasadat sovjetike në Moskë e në Athinë dhe ambasada franceze në Tiranë. Qeveria shqiptare mori iniciativën për përmirësimin dhe kapërcimin e ngërçit të krijuar në marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve. U paraqitën disa propozime nga të dyja palët, që kishin të bënin me rindërtimin e piramidave dhe shmangien e incidenteve kufitare, riatdhesimin e ushtarakëve e civilëve grekë të mbetur në Shqipëri nga konflikti civil në Greqi (1947-1949), pastrimin e kanalit të Korfuzit nga minat, tentativa për tregti të ndërsjellë, bashkëpunimin në luftën kundër epidemive në zonën kufitare, vendosjen e lidhjeve postare etj.¹ Përmirësimi i marrëdhënieve greko-shqiptare nuk arriti të finalizohet me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, të ndërprera pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste në vitin 1939. Këto zhvillime arritën pikën më të lartë të tyre, kur u bë e mundur që të dy palët të kontaktonin direkt me njëra-tjetrën, sikurse ndodhi në New York dhe në Moskë. Tendenca ishte inkurajuese por rezultatet e arritura jo të plota. Prija e Shqipërisë për një lloj hapjeje me Perëndimin, për marrëdhënie më të mira me fqinjët dhe sidomos hapat konkretë për të zgjidhur disa nga problemet e saj të rëndësishme me Greqinë, u vlerësuan

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), Viti 1959, Dosja 428, f. 17; Hamit Kaba, Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse*, (Prishtinë: Shtëpia Botuese “Brezi 81”, 2011), f. 203-204.

edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, pavarësisht armiqësisë së pandryshuar të udhëheqjes komuniste ndaj Shteteve të Bashkuara dhe botës së lirë.²

Duke filluar nga viti 1959, procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë u ngadalësua derisa u ndërpre. Secila palë fajësonte tjetrën për ngecjen. Enver Hoxha fajësonte mbretin e Greqisë, i cili “rihapi fushatën e luftës së Ftohtë”³ dhe ngriti sërish problemin e “Epirit të Veriut” në fjalimin e tij të mbajtur në Janinë, më 20 shkurt 1959. Pas vrasjes së një ushtari shqiptar në kufi, në prill 1960, ambasadori shqiptar në Moskë njoftoi kolegun e tij grek, se qeveria shqiptare i pezullonte të gjitha propozimet e saj, duke përfshirë edhe riatdhesimin e eshtrave të 23 oficerëve grekë, për të cilët ishte rënë dakord më parë. Pala greke fajësonte Shqipërinë se i kishte braktisur propozimet e mëparshme. Shkaqet kryesore që çuan në acarimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke ishin të vjetra dhe të reja. Ato mund të kërkojnë tek: pretendimet e Greqisë për të kushtëzuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me kërkesën për dhënie të autonomisë për “Vorio Epirin”; tek tentativat për të vendosur raketat amerikane në Greqi; tek rigjallërimi i incidenteve kufitare dhe i veprimtarisë së organizatave paramilitare greke, të cilat kërkonin bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë; tek mungesa e besimit të udhëheqjes shqiptare ndaj udhëheqjes së BS dhe dyshimit se, kjo e fundit, përkrahte pretendimet territoriale të Greqisë; tek tërheqja e qeverisë shqiptare nga iniciativat e pranuar më parë prej saj, për bashkëpunim ballkanik dhe kthimin e këtij rajoni në një zonë të lirë nga armët atomike; tek retorika antigreke e antiperëndimore e Shqipërisë dhe dënimet e ashpra ndaj kundërshtarëve të saj brenda vendit, të etiketuar si agjentë të Greqisë, të Jugosllavisë, të SHBA-së dhe Perëndimit në përgjithësi.

Konflikt interesash

Çarja sovjeta-shqiptare e viteve 1960-1961 krijoi situatë të re për Perëndimin dhe vendet fqinje të Shqipërisë: Greqinë, Jugosllavinë e Italinë. Në të shkuarën, Shqipëria kishte qenë mollë sherri për fqinjët, politikat e të cilëve në disa raste kishin kompromentuar e komplikuar edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kriza në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike dhe situata

² National Archive and Record Administration (NARA), RG 59, Department of State, *Albania, Guidelines for Policy and Operations*, Secret, February 1963, p. 6.

³ AMPJ, viti 1959, dosja 428, *Raport mbi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë që nga viti 1953 e deri në fund të vitit 1959*, f. 17.

delikate që po kalonte Shqipëria në vitet 1960-1961, do t'u lejonte vendeve fqinje të paraqitnin qëndrimet e tyre politike në kushtet e rrethanat e reja.

Italia dhe Jugosllavia e kishin pranuar krijimin e një Shqipërie sovraane dhe të pavarur, në kufijtë ekzistues.⁴ Greqia, gjithashtu e kishte pranuar parimisht ekzistencën e një shteti shqiptar të pavarur, por pa njohur kufijtë e tij, për shkak të pretendimeve ndaj Epirit të Veriut, të cilat ajo ishte munduar t'i mbështeste në kritere historike, etnike, strategjike e ekonomike.⁵ Greqia ishte mjaftë e ndjeshme ndaj zhvillimeve në Shqipëri, për shkak të ekzistencës së minoritetit grek në këtë vend, presionit të ushtruar nga Shqipëria dhe vendet e tjera të Bllokut Komunist gjatë Luftës së Ftohtë përmes vijës së përbashkët kufitare dhe pretendimeve të saj territoriale. Konflikti i Bashkimi Sovjetik me Shqipërinë e bënte këtë të fundit një vend më të cenueshëm dhe më të dobët politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht. Në fillim të krizës, kur Shqipëria e vogël ende nuk ishte ankoruar plotësisht pas Kinës komuniste, shpresat për një ndryshim të regjimit shqiptar ishin më të dukshme. Ndryshimi kërkohej nga shumë aktorë, sidomos jashtë vendit.

Të tre shtetet fqinje të Shqipërisë: Greqia, Italia e Jugosllavia e dëshironin rrëzimin e regjimit komunist të Shqipërisë, por asnjëra prej tyre nuk e pranonte dominimin e tjetrës. Trinomi i shteteve fqinje të Shqipërisë vëzhgonte jo vetëm zhvillimet e Shqipërisë, por edhe lëvizjet e njeri-tjetrit, duke u përpjekur që asnjëri të mos fitonte epërsi ndaj tjetrit. Kjo politikë kontribuonte padashje në ruajtjen e gjendjes ekzistuese në Shqipëri dhe të regjimit komunist në këtë vend. Zëvendësimi i qeverisë së Hoxhës me një "lolo" jugosllav apo sovjetik, nuk do të ishte i pranueshëm as për Italinë dhe as për Greqinë. Situata që po kalonte Shqipëria ishte një mundësi e mirë për t'u shfrytëzuar nga fqinji i saj jugor, Greqia e cila do të ngrinte më me forcë pretendimet tradicionale për "Epirin e Veriut" dhe kërkesat për përmirësimin e standardeve demokratike për minoritetin grek në Shqipëri. Duhet të përmendim se, qasja e politikës zyrtare dhe ajo e rretheve nacionaliste greke brenda dhe jashtë vendit ndaj këtij problemi, ka të përbashkëta por edhe dallime të qarta. Qeveria greke ndoqi një politikë më realiste dhe më të matur ndaj Shqipërisë. Politika e saj u ndërtua duke pasur në konsideratë jo vetëm interesat kombëtare të vendit, por edhe ato të

⁴ *Foreign Relations of United States (FRUS), Europe: political and economic developments* (in two parts), Volume IV, Part 2, 1951, p. 1320, 1324.

⁵ *NARA*, Record of the U.S. Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, File 767.00/21.12.1961, Royal Greek Embassy in Washington D.C. to Department of State, Secret, *Aide-Memoire*, December 21, 1961.

NATO-s dhe të grupimit të vendeve perëndimore, të udhëhequra nga SHBA. Deviza e SHBA dhe e NATO-s, që e konsideronte Shqipërinë si faktor përçarës brenda bllokut komunist, si një “pykë” ndërmjet kinezëve dhe sovjetikëve, nuk do ta lejonte Greqinë që të përmbushte objektiva e saj tradicionale. SHBA shpalli dhe mbrojti politikën “duart larg” (hands off policy) nga Shqipëria, duke u bërë të qartë vendeve fqinje dhe sidomos Greqisë, se ajo nuk do t’i mbështeste kërkesat e saj territoriale për Shqipërinë e Jugut.

Jugosllavia: e dyshuara për ndërhyrje në Shqipëri

Gjatë periudhës së konfliktit shqiptaro-sovjetik, Italia, Greqia, Perëndimi, por edhe vet regjimi komunist në Shqipëri krijuan dyshime të shumta mbi Jugosllavinë, si shtet që mund të sillte ndryshimin e regjimit në Shqipëri, përmes ndonjë puçi të brendshëm apo ndonjë sulmi të armatosur nga jashtë, vetëm apo në bashkëpunim me Bashkimin Sovjetik. Jugosllavia e Titos konsiderohej si shteti më i motivuar për të ndryshuar në favor të saj situatën në Shqipëri, për shkak të ndarjes së keqe me udhëheqjen shqiptare në vitin 1948, ndikimit të saj në radhët e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe duarve deri diku të lira për të ndërmarrë ndonjë sulm të armatosur kundër Shqipërisë. Jugosllavia ndryshe nga fqinjët e tjerë nuk ishte e angazhuar në asnjërin prej dy organizmave më të mëdha ushtarake të kohës, NATO-n dhe Traktatin e Varshavës. Gjithashtu në Jugosllavi gjendeshin një numër relativisht i madh emigrantësh, të larguar nga Shqipëria pas prishjes së marrëdhënieve të saj me Jugosllavinë, të cilët mund të përdroreshin nga kjo e fundit. Por jashtë dyshimeve të udhëheqjes shqiptare nuk mbeteshin as edhe një pjesë e popullsisë shqiptare të Kosovës.

Por, krahas rrethanave favorizuese ekzistonin edhe faktorë jofavorizues për të realizuar objektivat e supozuara nga Jugosllavia. As Greqia dhe as Italia nuk ishin dakord që në Shqipëri të vinte në pushtet një qeveri kukull, pro jugosllave. Një përpjekje për të shkatërruar nga brenda udhëheqjen shqiptare do të ishte po kështu e vështirë, sepse Hoxha po vazhdonte fushatën e spastrimeve brenda radhëve të PPSH, duke likuiduar kundërshtarët e tij realë dhe potencialë. Udhëheqja shqiptare e trajtoi konfliktin me Bashkimin Sovjetik si një sfidë ndërmjet dy shteteve, jo thjesht si një konflikt personal për pushtet, pavarësisht se ky komponent ishte i fortë dhe i dukshëm. Udhëheqja e lartë komuniste rizgjoji nacionalizmin e fjetur të shqiptarëve dhe dyshimin e tyre se po rrezikohej pavarësia e Shqipërisë, duke aktivizuar ndjenjën e fortë të mbrojtjes së

atdheut nga rreziku fqinj (veçanërisht ai grek), dhe ndjesinë për t'u përballur me Bashkimin Sovjetik, si sinonim i së keqes për kombin shqiptar. Kjo politikë e udhëheqjes komuniste bëri që, shumica e shqiptarëve të rreshtoheshin përkrah saj, pavarësisht nga privacionet dhe pakënaqësitë që kishin ndaj regjimit stalinist. Mundësitë e një sulmi jugosllav apo sovjetik mbi Shqipërinë, në rrethanat e Luftës së Ftohtë, ishin të pakta, duke pasur në konsideratë edhe reagimin e mundshëm të Perëndimit, prishjen e stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe të imazhit të Jugosllavisë, si një vend i paangazhuar. Në përgjithësi rrethanat e krijuara nga Lufta e Ftohtë nuk të lejonin të “kapërceje gardhin”. Rasti i Revolucionit Hungarez të vitit 1956 ishte i freskët. Ai përfundoi me një banjë gjaku, por as kush në Perëndim nuk u angazhua ushtarakisht në mbështetje të tij.

Informacione më të shumta për Shqipërinë vinin nga burimet diplomatike italiane dhe franceze, të cilat e kishin origjinën nga Shqipëria. Më 16 maj 1961, Ministri italian në Londër Prunas, i transmetonte Foreign Office [FO] dyshimet e qeverisë italiane, se sovjetikët me dijeninë e jugosllavëve, po përpunonin një plan për të eliminuar Enver Hoxhën nëpërmjet një atentati. Në këtë rast, Jugosllavia, sikurse edhe Greqia do të përfitonte një pjesë nga territori shqiptar.⁶ Më 18 nëntor 1961, ministri i Jashtëm i Italisë, në takimin që zhvilloi me Sekretarin Amerikan të Shtetit, do t'i përmendte disa thashetheme, “ndoshta jo të besueshme se, sovjetikët kanë dhënë në heshtje aprovimin, për një sulm të mundshëm jugosllav kundër Shqipërisë”. Më tej ai do të nënvizonte se “Italia mund të shikojë mundësinë e afrimit me Shqipërinë.”⁷ Këtë qëndrim do ta artikulonte qartazi delegacioni italian në NATO, gjatë një sesioni të tij në Venecia, në mars 1962. Ai do të këmbëngulte pranë Aleancës së Atlantikut të Veriut që, shtetet perëndimore të ndihmonin Shqipërinë, duke i lënë mënjane mosmarrëveshjet e tyre me regjimin komunist dhe duke mos e identifikuar regjimin e Hoxhës me popullin shqiptar.⁸ Qëndrimin deri diku të ndryshëm të politikës italiane ndaj Shqipërisë, krahasuar me atë të dy vendeve të tjera fqinje, do ta nënvizonte edhe Enver Hoxha, sipas të cilit Italia ishte më pak e rrezikshme, më pak jo popullore dhe në të njëjtën kohë, më e afta për t'i siguruar ndihmë ekonomike.⁹ Italia vazhdonte të ushqente dyshime lidhur

⁶ *The National Archives (TNA)*, FO 371/160341, Evelyn Shuckeburgh to Central Department, May 16, 1961.

⁷ *NARA*, File 767, Memorandum of Conversation, November 18, 1961.

⁸ *NARA*, Owen Jones (Belgrade) to D.C., March 9, 1962.

⁹ William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, (Cambridge, Massachusetts: M.I.T. PRESS, 1963), p. 169.

me planet jugosllavo-sovjetike për rrëzimin e regjimit të Hoxhës edhe në vitin 1963, kur kriza shqiptaro-sovjetike kishte përfunduar.¹⁰

Për të mbështetur dyshimet e tyre, italianët u referoheshin vështrimeve identike të Beogradit dhe Moskës ndaj çështjes shqiptare; vizitës së fundit të Dushan Mugoshës në Bashkimin Sovjetik; shtimit të numrit të shqiptarëve nga Kosova në ushtrinë jugosllave dhe vendosjen e tyre pranë kufijve shqiptaro-jugosllavë; kontakteve më të fundit të oficerëve të UDB-së me grupet e zgjedhura të refugjatëve shqiptarë në Belgjikë, në Francë etj. Sidoqoftë, vetë Ministria e Jashtme e Italisë nuk i konsideronte burimet e mësipërme të besueshme, por qëllimi i saj ishte që të tërhiqte vëmendjen e politikës amerikane, për të mos e nënvleftësuar rrezikun që mund të vinte nga planet e përbashkëta të Hrushovit dhe të Titos për të përmbysur udhëheqjen e tanishme në Shqipëri dhe për ta zëvendësuar atë me një tjetër protyre. Edhe burimet diplomatike greke ishin gjithashtu një prurje e rëndësishme për krizën shqiptaro-sovjetike dhe qëndrimin e vendeve fqinje ndaj saj. Kreu i diplomacisë greke Averoff, në nëntor 1961, do t'i karakterizonte marrëdhëniet e Titos me Hrushovin si "flirt i rëndë, por që nuk do të shkonin në krevat",¹¹ ("heavy flirtation but would not get to bed"). Ai i kërkoi ambasadorit amerikan në Athinë, që t'i përcillte urgjentisht Departamentit të Shtetit shqetësimet e tij lidhur me planin jugosllav për largimin e detyruar të udhëheqësve kryesorë të Shqipërisë dhe zëvendësimin e tyre me një regjim të ri, të pranueshëm për Titon.¹²

Është e vështirë t'u japësh përgjigje të qartë dyshimeve nëse ka ekzistuar vërtet një plan jugosllav apo sovjeto-jugosllav, për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri. Dokumentet amerikane, britanike, ruse, por edhe ato shqiptare, që kemi në dispozicion, sjellin të dhëna të pakonfirmuara dhe jo rrallë kontradiktore. Megjithatë, në dokumentacionin që disponojmë, nuk mungojnë dëshmitë për dëshirat e jugosllavëve, të cilët e konsideronin të mundshëm rrëzimin e Hoxhës. Madje, për jugosllavët do të ishte më mirë të kishin një regjim shqiptar prosovjetik sesa prokinëz. Ambasadori jugosllav në Bukuresht, do shkonte më tej. Ai do t'i bënte të ditur një anëtar të misionit diplomatik francez se "qeveria e tij kishte bërë mjaft për pavarësinë e Shqipërisë", ndërsa do të shtonte se "nuk është shumë vonë

¹⁰ NARA, File 767, A-1049, Julian P. Fromer-American First Secretary in Rome to D.C., January 22, 1963.

¹¹ NARA, File 76.00/11-1861, Briggs from Athens to Secretary of State, Nr. 648, November 18, 1961.

¹² Ibid.

për ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Greqisë dhe Jugosllavisë”.¹³ Punisa Peroviq, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe njëherazi sekretar i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë në Asamblenë e Republikës Federative të Jugosllavisë, nuk e mohonte mundësinë e një ndërhyrjeje sovjetike në Shqipëri, apo të një revolte brenda vendit, të inspiruar e drejtuar nga sovjetikët. Por sipas tij, revolta do të ishte e pasuksesshme, sepse sovjetikët nuk kishin grupe apo personalitete brenda vendit që do t’i mbështesnin. “Miq të sovjetikëve dhe tanët shprehej Peroviq, u kapën verën e shkuar dhe jugosllavët e dinë me siguri që konspiratorët e ekzekutuar majin e shkuar, po komplotonin në emër të BRSS”.¹⁴

Diplomati jugosllav, Branko Karagjorgje, do të deklaronte në ambasadën sovjetike në Beograd, se nuk kishte pasur asnjë bisedim zyrtar dhe jozyrtar për arritjen e një marrëveshjeje sovieto-jugosllave mbi Shqipërinë.¹⁵ Sidoqoftë, të tjerë diplomatë jugosllavë, si këshilltari i ambasadës jugosllave në Washington, Ruziç, do të pranonin se sovjetikët ishin përpjekur të bënin kauzë të përbashkët me Jugosllavinë kundër Shqipërisë, por kjo e fundit i kishin refuzuar propozimet e tyre.¹⁶ Ruziç pretendonte se Jugosllavia, sikurse edhe Greqia donte të ruante paqen dhe stabilitetin në Ballkan. Që të dy këto shtete ishin kundër ndërhyrjes së ndonjë shteti tjetër fqinj në Shqipëri, duke nënkuptuar këtu Italinë. Diplomati jugosllav do të nënvizonte se jugosllavët nuk ndanin të njëjtin mendim për shkallën e rrezikut që sillte prezenca e Kinës në Shqipëri. Për arsye të njohura, jugosllavët ishin kundër pranisë së kinezëve në Shqipëri, ndërsa politika greke ishte në të njëjtën frekuencë me politikën e Perëndimit për këtë çështje. Dilemave mbi mundësitë apo pamundësinë e ndërmarrjes së ndonjë sulmi të armatosur kundër Shqipërisë nga Jugosllavia apo Bashkimi Sovjetik, do të përpiquej t’u jepte përgjigje ambasadori i sapoemëruar i SHBA-së në Beograd, George F. Kennan.¹⁷ Kennan hodhi

¹³ NARA, Record of the U.S. Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, *Memorandum of Conversation on Situation in Albania*, July 11, 1961.

¹⁴ Ibid, William D. Broderick - Second Secretary of American Embassy in Beograd to the Department of State, December 5, 1961.

¹⁵ NARA, Record of the U.S. Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, *Ambassy Belgrade to Department of State*, January 11, 1962.

¹⁶ NARA, File 767, *Memorandum of Conversation*, February 2, 1962.

¹⁷ NARA, Record of Department of State relating Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, Kennan to Secretary of State, November 19, 1961; November 21, 1961; November 25, 1961; George F. Kennan u emërua nga Presidenti Kenedi ambasador i SHBA në Jugosllavi në pranverë të vitit 1961 (See; John Lewis Gaddis, *George F. Kennan: an*

bazat e politikës amerikane dhe të Perëndimit ndaj Shqipërisë në periudhën e konfliktit të saj me BS-në.

Në nëntor 1961, në kulmin e krizës shqiptaro-sovjetike, por edhe më pas ai do të dërgonte disa raporte në Uashington, duke nënvizuar se nuk ekzistonin dëshmi të mjaftueshme, që të provonin ekzistencën e ndonjë sulmi të mundshëm të Jugosllavisë apo Bashkimit Sovjetik kundër Shqipërisë. Kennan bënte të qartë se, jugosllavët i ndiqnin me vigjilencë të madhe zhvillimet në Shqipëri dhe e dëshironin rrëzimin e Hoxhës dhe zëvendësimin e tij me një regjim komunist pro jugosllav.

Mjeti më i mirë për të realizuar ndryshimet në Shqipëri, sipas mendimit të tij, ishin intrigat dhe manipulimet brenda radhëve të Partisë së Punës së Shqipërisë. “Jugosllavët këtë çast, raportonte Kennan, nuk zotërojnë aftësi manovruese për të realizuar puçin nga brenda”. (“Yugos do not at present dispose of capability of engineering internal putsch”), sepse Enver Hoxha, me politikën e egër të spastrimeve, kishte eliminuar pothuajse të gjithë elementët prosovjetikë apo projugosllavë nga udhëheqja shqiptare.

Ambasadori amerikan nuk e përjashtonte ndërhyrjen ushtarake të jugosllavëve në Shqipëri, por nga ana tjetër nuk e konsideronte atë si mjetin më efikas për të përmbysur udhëheqjen shqiptare. Kennan paralajmëronte Perëndimin që të mos pritej një ndarje shpërthyes e Shqipërisë me Bllokun Komunist, sepse në këtë rast mund të ndodhte ndonjë ndërhyrje e armatosur e Jugosllavisë apo Bashkimit Sovjetik. Ambasadori amerikan në Beograd, sillte në vëmendjen e politikës amerikane, se Shqipëria çlirohej dhe bashkohej me kauzën perëndimore, por do të kishte rivalitete brenda anëtarëve të NATO-s,¹⁸ duke nënkuptuar këtu Greqinë dhe Italinë. Shqipëria, për Kennan, ishte një vend i fiksuar stalinist, i cili nuk ia vlente të ndihmohej nga Perëndimi. Nga fundi i nëntorit 1961 Kennan do të arrinte në përfundimin se, jugosllavët nuk ishin në gjendje të ndikonin mbi rrjedhën e ngjarjeve në Shqipëri, pavarësisht se nuk u pëlqente realiteti ekzistues.¹⁹ Në janar 1962, Kennan u thirr të raportonte në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit Amerikan.²⁰ Ai nuk arriti të mbështeste me fakte të pakundërshtueshme variantin e një sulmi të mundshëm të Jugosllavisë mbi Shqipërinë, por as të provonte të kundërtën. Kennan do t'i bënte të ditur Komitetit se Titoja e kishte thirrur në zyrë dhe e kishte paralajmëruar se

American Life, (New York: The Pinguin Press, 2011).

¹⁸ NARA, Kennan form Belgrade to Secretary of State, November 21, 1961.

¹⁹ NARA, Kennan from Belgrade to Secretary of State, November 25, 1961.

²⁰ AMPJ, Dosja 477, viti 1962, fl. 6-8, (Referuar artikullit të autorëve Rober Allen dhe Paul Scott, të botuar në gazetën *Long Island Press*, January 24, 1962).

ishte kundër çdo ndërhyrjeje të perëndimit në Shqipëri. Në këto rrethana ambasadori i sugjeroi qeverisë amerikane të ndiqte politikën “duart larg” nga grindjet sovjeto-shqiptare. Sugjerimet e Kennan do të shërbenin si bazë e politikës amerikane për Shqipërinë, e cila do të formësohej gradualisht nga Departamenti i Shtetit.

Greqia dhe Italia: Raporti mbi Shqipërinë që tensionoi dy shtete

Kriza shqiptaro-sovjetike shtoi nervozizmin edhe ndërmjet vetë fqinjëve të Shqipërisë. Më 15 dhjetor 1961, Beogradi ngriti sërish pas shumë vitesh problemin e pakicës sllave në Maqedoninë greke, duke shtuar tensionin në marrëdhëniet me Greqinë.²¹ Produkt i krizës shqiptare dhe i dyshimit për supermacinë që mund të fitonte “tjetri” në Shqipëri ishte edhe acarimi i marrëdhënieve greko-italiane në verën e vitit 1960. Tensionimi pati si fillesë një raport për Shqipërinë, të paraqitur nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Italiane, në takimin e Aleancës së Atlantikut të Veriut, në Paris, më 2 maj 1960.²² Raporti i tensionoi marrëdhëniet mes dy fqinjëve, pavarësisht nga pretendimet e ambasadës italiane në Athinë, se ai ishte një dokument i pastër teknik, i cili nuk paraqiste pikëpamjen zyrtare italiane, qeveria e së cilës e kishte tërhequr atë, para protestës së autoriteteve greke.²³ Ai shkaktoi reagime të forta brenda dhe jashtë Greqisë, duke u bërë objekt kritikash, debatesh të ashpra dhe demonstrimesh në disa qytete greke.

Ky dokument, sipas komenteve të ambasadorit britanik në Athinë, Roger Allen, ngatërronte “Epirin” me Shqipërinë, duke i konsideruar shumë qytete të këtij rajoni, si Prevezën, Pargën, Konicën, Janinën etj., si qytete me fizionomi shqiptare, të banuar nga toskët [shqiptarë]. Në materialin e paraqitur nga Shtabi italian i Mbrojtjes përmendej se, dy të tretat e popullsisë së Epirit ishin shqiptarë autoktonë, të cilët përbënin elementin më të mirë vendas; se vllaho-romanët ose kuco-vllahët e zonës së Pindit ruanin karakteristika të qarta amtare, pra ishin një popullsi me identitet të veçantë, jo grek, që mbanin lidhje të forta me vendin e origjinës; se suljotët²⁴

²¹ AMPJ, Viti 1962, dos. 477, fl. 1-2; C.U. Sulzberger, *New York Times*, January 3, 1962; William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, (Massachusetts: The M.I.T. PRESS, Cambridge 1963), p. 172.

²² NARA, File 767, American Embassy in Athens to D.C., *Italian Military Report to NATO on Albania*, June 1, 1960; The National Archives of United Kingdom (TNA), File FO 371/152817, British Embassy in Athens to Foreign Office, June 10, 1960.

²³ NARA, Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, USRO/POL to Secretary of State/Washington, June 2, 1960

²⁴ Popullsi shqiptare kristiane e vendosur në krahinën e Sulit, e dalluar për shpirtin luftarak

ishin në thelb shqiptarë dhe jo grekë; se kisha dhe priftërinjtë grekë u kishin mohuar elementëve shqiptarë nacionalitetin e tyre kudo ku ata banonin në Greqi, ndërsa klerikët grekë ishin të varfër intelektualisht. Raporti përmendte se, përveç kishës katolike, fetë e tjera në Shqipëri ishin përdorur si mjete për të privuar popullin shqiptar nga nacionaliteti i tyre; se pretendimet greke për Epirin e Veriut ishin në fakt pretendime territoriale për Shqipërinë e Jugut; se qeveria greke, për shkak të pretendimeve të saj ndaj Epirit të Veriut, i kishte refuzuar të gjitha ftesat e Kombeve të Bashkuara për të organizuar një konferencë ballkanike, etj.²⁵

Raporti italian u bë objekt i një fushate të gjerë zyrtare dhe jozyrtare brenda dhe jashtë Greqisë. Qeveria greke protestoi pranë Ambasadës italiane në Athinë, më 10 maj 1960, por heshtjen për publikun do ta thyente shtypi. Artikulli i parë u botua në anglisht në gazetën “Athens Daily Post-Sunday,” më 29 maj 1960 nga Elias P. Demetracopoulos,²⁶ ndërsa më 30 maj, një tjetër artikull u publikua në “The Times”.²⁷ Në artikujt e botuar denoncoheshin “ëndrrat imperialiste italiane”, duke mos pranuar faljen e palës italiane, por duke këmbëngulur që qeveria italiane të kërkonte falje publike dhe të dënonte autorin e raportit. Shkrime të mbushura me zemërim kundër politikës italiane të shoqëruara me thirrje të forta patriotike, do të botoheshin në disa gazeta brenda Greqisë, si e pavarura konservatore “Kathimerini”, “Vima”, “Eleftheria”, etj. Vetëm gazeta e neokomunistëve “Avghi” e injoroi botimin e këtij episodi. Në disa qytete të Greqisë veriperëndimore, si Janina, u organizuan demonstrata masive të banorëve, ndërsa në të gjithë vendin u organizuan protesta “për të provuar unitetin grek, kur integriteti i atdheut sfidohet”.²⁸ Indinjata greke ndaj raportit u reflektua gjithashtu me qëndrimin e zyrtarëve dhe gazetarëve grekë, të cilët e bojkotuan ftesën e ambasadës italiane në Athinë, në pritjen e dhënë me rastin e festës kombëtare të Italisë, më 2 qershor 1960. Bojkotin e mësipërm ambasadori britanik në Athinë do ta krahasonte me “ditën më të keqe të

dhe rezistencën deri në vetëmohim ndaj trupave osmane përkrah kryengritësve grekë, në vitet e Revolucionit Grek për pavarësi.

²⁵ TNA, FO 371/152817, British Embassy in Athens to Foreign Office, No. 55, June 10, 1960. Duket se bëhet fjalë për propozimin e Qeverisë rumune, për të mbajtur një takim të kryetarëve të qeverive të vendeve ballkanike, për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme dhe çarmatimin lokal, të propozuar nga Teodor Zhivkov.

²⁶ Elias P. Demetracopoulos, “Italian Govt’s Report on Albania to shape completely inaccurate and damaging to Greece”, *Athens Daily Post-Sunday*, May 29, 1960.

²⁷ “Greek anger at Italian report on Albania”, *The Times*, May 30, 1960,

²⁸ TNA, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 3, 1960.

konfliktit të Qipros”,²⁹ kur zyrtarët grekë refuzuan të vizitonin ambasadën britanike në Athinë.

Më 31 maj 1960, raporti italian u bë gjithashtu objekt i një debati të nxehtë dhe patetik, në një seancë të veçantë të Parlamentit grek, pas kërkesës së firmosur prej 12 deputetëve të rajonit të Epirit.³⁰ Në seancë ishin të pranishëm edhe zëvendëskryeministri i M. Kanelopulos dhe ministri i Jashtëm i Greqisë, M. Averoff. Në debat u përfshinë të gjithë krahët e politikës greke, të cilët dënuan italianët. Përfaqësuesi i ekstremist të majtë të E.D.A. z. Iliu (Iliou) do ta cilësonte raportin si “manifestim të freskët të imperializmit italian” dhe do të kritikonte qeverinë greke për “fshehje të veprimeve të dëmshme kundër Greqisë me qëllim që të ruanin unitetin e Aleancës Perëndimore”.³¹ M. Kanelopulos do të përgjigjej se, dokumenti nuk mund të bëhej publik, për shkak se ai konsiderohej sekret ushtarak, por shtonte se qeveria greke ishte shprehur kundër tij, duke shfrytëzuar kanalet diplomatike. Lideri liberal demokrat Papandreu, do ta cilësonte NATO-n si një “dyqan antik” ku gjithçka ishte kthyer përmbys mënyrë të çrregullt, dhe ku minimi reciprok ishte bërë rregulli i ditës.³²

Ministri i Jashtëm, Averoff, i drejtoi një protestë të fortë ambasadorit italian në Athinë, duke kërkuar prej tij shpjegime, lidhur me raportin e paraqitur nga përfaqësuesit ushtarakë të Italisë në NATO.³³ Ai do t’i dëshmonte ambasadorit britanik në Athinë, se “raporti italian kishte prekur edhe ndjenjat e tij personale, si një kucovllah, që i përkiste një minoriteti kombëtar mjaft të helenizuar në Greqi, ndërsa ai vetë ishte trashëgimtar i Jorgos Averoff, i cili kishte bërë vepra të mëdha bamirësie për shtetin grek”.³⁴ Ankesa u paraqitën edhe pranë ambasadave amerikane e britanike në Athinë. Për të zbutur qëndrimin grek dhe për të qartësuar pozicionin italian ndaj raportit të përmendur, më 1 qershor 1960, u organizua një takim i veçantë i Këshillit të Atlantikut të Veriut.³⁵ Përfaqësuesi italian, M. Alessandrin, u shpreh se raporti përmbante pasaktësi të paqëllimshme dhe se ai nuk përfaqësonte pikëpamjet zyrtare të

²⁹ Ibid.

³⁰ *NARA*, File 767. 00/6-160, American Embassy in Athens to D.C., “Italian Military Report to NATO on Albania”, June 1, 1960.

³¹ *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 3, 1960.

³² *NARA*, File 767, American Embassy in Athens to D.C., Italian Military Report to NATO on Albania, June 1, 1960.

³³ *TNA*, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., June 1, 1960.

³⁴ Ibid

³⁵ *TNA*, FO 371/152817, United Kingdom Permanent Delegation to NATO (Paris) to Foreign Office, June 1, 1960.

Italisë. Pas diskutimeve të përfaqësuesit grek M. Melas dhe të drejtuesit të seancës M. Spaak, tensioni filloi të bjerë. Por, duket se stuhia diplomatike greko-italiane u fashit përfundimisht pas takimit të ministrit të Jashtëm të Italisë Segni me ambasadorin grek në Romë, më 3 qershor 1960, dhe faljes së kërkuar prej tij për incidentin e ndodhur.³⁶ Ministri italian do t'i shprehej ambasadorit grek se “qeveria italiane nuk kishte pasur kurrë asnjë qëllim që të lëndonte popullin grek dhe qeverinë greke, me të cilët Italia mbante dhe kishte si qëllim të ruante marrëdhënie shumë të ngrohta miqësie dhe aleance”.³⁷

Pas takimit me ministrin e Jashtëm grek, ambasadori britanik në Athinë do t'i përcillte Londrës rezultatet e takimit, të shoqëruara me komentet personale të tij. Ai shprehte keqardhjen për incidentin, duke e konsideruar atë të mbyllur zyrtarisht, ndërsa Averoff do ta cilësonte si “një dashnor të singertë të Italisë”³⁸ (Monsieur Averoff, who as sincere lover of Italy). Por, diplomati britanik mendonte se incidenti nuk mund të mbyllej kaq lehtë, sepse raporti i italianëve jo vetëm që largonte vëmendjen nga pretendimet e grekëve për Epirin e Veriut, por përsëriste të ashtuquajturit “fakte”, mbi të cilat bazoheshin pretendimet italiane për Epirin e Jugut. Duke komentuar këmbënguljen e rretheve nacionaliste greke, edhe pasi Averoff e kishte deklaruar të mbyllur incidentin, ambasadori britanik në Athinë do të shprehej: “Grekët priren të humbasin tërësisht kuptimin e përmasave kur janë të eksituar, dhe ky dokument ishte gjëja më e mirë për t'i eksituar ata”³⁹ (Greeks do tend to lose all sense of proportion where they are excited, and nothing could have been better calculated to excite them than this document). Shpjegimet e dhëna nga ndonjë përfaqësues diplomatik italian, se raporti ishte produkt i disa oficerëve italianë, të cilët kishin shfrytëzuar disa dosje të paraluftës, pa u konsultuar me Ministrinë e Jashtme të Italisë, nuk i bindi diplomatët perëndimorë.⁴⁰ Nga vendet e Bllokut Komunist nuk pati ndonjë koment publik për këtë ngjarje, e cila u injorua plotësisht prej tyre. Historia me raportin italian pati efekte negative në tri drejtime: së pari, shtoi dyshimet tradicionale greke në lidhje me seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e miqësisë italiane; së dyti, u vu në diskutim efektshmëria e mekanizmave të NATO-s, që lejoi qarkullimin e raportit

³⁶ TNA, FO 371/152817, British Embassy in Athens to F.O., *Italian Military Report on Albania*, June 10, 1960.

³⁷ Ibid.

³⁸ Ibid, p.5.

³⁹ Ibid, p.6.

⁴⁰ TNA, FO 371/ 152818, June 1, 1960.

italian, dhe së fundi, e mbushi atmosferën greke me emocione nacionaliste për të ashtuquajturën çështje të Epirit të Veriut. Në disa rrethe politike greke qarkulluan dyshime se dokumenti origjinal grek mund të kishte qenë i influencuar nga qarqet komuniste apo fashiste në Itali. Ndaj raportit italian pati reagime të forta edhe nga Federata Pan-Epirote e Amerikës,⁴¹ Shoqata e Epirit të Veriut në Francë dhe Evropën Perëndimore, shoqata të ndryshme brenda Greqisë, kisha greke dhe qytetarë të zakonshëm me origjinë greke. Protestat e tyre iu adresuan sidomos presidentit dhe zëvendëspresidentit të Shteteve të Bashkuara, Sekretarit Amerikan të Shtetit, Departamentit të Shtetit etj.

Konflikti shqiptaro-sovjetik në sytë e grekëve

Thyerja shqiptaro-sovjetike e vendosi Shqipërinë përballë sfidave të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme. Pozita ndërkombëtare e saj u dobësua më tej, ndërsa siguria kombëtare u bë më delikate, pas largimit të sovjetikëve nga baza ushtarake e Vlorës dhe refuzimit të BS që Shqipëria të merrte pjesë në takimet e Traktatit të Varshavës. Shqipëria, tani e tutje nuk do të ishte më një post i avancuar i Bllokut Komunist, i ndodhur në vijën e parë të përplasjeve Lindje-Perëndim. Kina komuniste, aleatja më e ngushtë e Shqipërisë, nuk ofronte garancitë e duhura për mbrojtjen e saj, për shkak të largësisë, teknologjisë së vjetruar dhe, mbi të gjitha, mungesës së gatishmërisë për të përfunduar një aleancë mbrojtjeje me Shqipërinë.⁴² Pavarësisht nga propaganda e udhëheqjes komuniste të Shqipërisë, dokumentacioni që kemi në dorë, nuk na provon se Shqipëria ka qenë e rrezikuar ushtarakisht nga NATO, apo ndonjë vend tjetër perëndimor. Përkundrazi, si e kemi përmendur më sipër, dyshimet më të mëdha në kohën e konfliktit ranë mbi Jugosllavinë e Titos dhe Bashkimin Sovjetik.

Me shkallëzimin e krizës Bashkimi Sovjetik e shtoi qëndrimin kritik ndaj udhëheqjes komuniste të Shqipërisë dhe politikës së saj të jashtme, e cila u konsiderua prej tij si jo koherente, e paqëndrueshme, që nuk i shërbente procesit të normalizimit të marrëdhënieve të saj me Jugosllavinë e Greqinë dhe që nuk kontribuonte për uljen e tensioneve në Ballkan.⁴³

⁴¹ NARA, Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, *Protest of Pan-Epirotic Federation of America to the President*, June 7, 1960.

⁴² *Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH)*, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës, Viti 1963, Dosja 7, Lista 15, f. 1-19.

⁴³ H.Kaba, E.Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, f.251, *Informacion i*

Kritikat sovjetike, në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-greke, u fokusua tek mungesa e përpjekjeve të udhëheqjes shqiptare për përmirësimin e tyre, tek retorika e saj e ashpër, jo vetëm kundër qarqeve drejtuese greke, por edhe kundër personaliteteve të opozitës, duke përfshirë Venizelosin dhe Partinë Komuniste greke, tek mungesa e përpjekjeve serioze për vendosur lidhje kulturore me forcat progresiste të Greqisë; tek lënia në mes të rrugës e iniciativave të mëparshme, të bëra nga udhëheqësit e BS, apo të vendeve socialiste të Ballkanit, lidhur me bashkëpunimin ballkanik dhe kthimin e këtij rajoni në një zonë të lirë, pa armë atomike dhe raketa, etj.

Kritikat sovjetike në mjedisin shqiptar u perceptuan si shenja të një qëndrimi të dyshimtë ndaj marrëdhënieve greko-shqiptare, si një trysni që i bëhej udhëheqjes komuniste të Shqipërisë për të pranuar kushtet e Greqisë.⁴⁴ Sekretari i parë i ambasadës sovjetike në Tiranë, Bespallov, i bënte të ditur Moskës, se korpusi i diplomatëve të huaj në Tiranë, ishte në dijeni të iniciativës së Jugosllavisë dhe Greqisë, të cilat po përgatiteshin të diskutonin në Kombet e Bashkuara ankesat e tyre për veprimet provokative të Shqipërisë në Ballkan.⁴⁵ Një formë tjetër presioni ishte edhe sugjerimi i ambasadorit sovjetik në Athinë, Sergejev, që Shqipëria të provonte se nuk ishte në gjendje lufte me Greqinë, duke paraqitur argumentet e veta për këtë çështje në Gjykatën e Hagës, në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo në ndonjë komision tjetër. Një propozim i tillë ishte përpjekje e maskuar, që Shqipëria të pranonte diskutimin e pretendimeve greke, duke qenë Moska iniciatore e tij.⁴⁶

Politika zyrtare greke: autonomi për Vorio Epirin

Rrethanat favorizuese që krijoi konflikti shqiptaro-sovjetik do të shfrytëzoheshin nga të gjitha kahjet e politikës greke: nga qeveria, organizatat nacionaliste brenda vendit, kleri vendas dhe organizatat e emigracionit në SHBA dhe në Evropën Perëndimore.

Më 31 tetor 1961, Palamas (drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Greqisë), do t'i bënte të njohura këshilltarit të ministrit amerikan në Athinë, Bennett, pikëpamjet e qeverisë së tij, në lidhje me

ambasadës së BRSS në RPSH mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë e Greqinë, korrik 1961.

⁴⁴ Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990, Paqja e vështirë*, (Tiranë: Shtëpia Botuese Koçi, 2004), f. 164-165.

⁴⁵ Ibid, p. 251.

⁴⁶ Ibid, p. 164-165.

zhvillimet në Shqipëri, dhe opinionin e saj ndaj politikës së SHBA.⁴⁷

Qeveria greke mendonte, se nuk ekzistonte përputhje e plotë ndërmjet pikëpamjeve amerikane e greke për Shqipërinë. Ajo kishte krijuar opinionin se amerikanët, po mbanin qëndrim indiferent ndaj Shqipërisë, dhe nuk po tregonin ndonjë interes të spikatur për regjimin e Hoxhës. Qeveria greke kërkonte nga SHBA angazhim më të madh në krizën shqiptare, dhe mbështetjen e saj për të mbajtur konstant rolin e Shqipërisë, si faktor përçarës brenda botës komuniste. Palamas do të theksonte, se qeveria e vendit të tij nuk tërhiqej nga Hoxha si person, por nga qëndrimi i tij opozitar me Moskën, gjë e cila ishte për t'u vlerësuar. Në këndvështrimin e qeverisë greke, mosbindja e udhëheqjes shqiptare ndaj Moskës, pavarësisht nga ngjyrimet ideologjike, e kishte bazën tek arsyet personale të saj. Palamas e karakterizonte Hoxhën si udhëheqës komunist që e drejtonte vendin e tij në mënyrë fisnore, nëpërmjet të afërmeve të tij.

Arsyet e prishjes me Moskën, për politikanin grek, duheshin kërkuar tek pakënaqësia e shqiptarëve ndaj nivelit të ndihmave sovjetike dhe përmirësimit të marrëdhënieve sovjeto-jugosllave. Rrëzimi i regjimit të Hoxhës dhe zëvendësimi i tij me një "lolo sovjetik", nuk ishte i mirëpritur për politikën zyrtare greke, sepse mund të shoqërohej me rikthimin e BS në Shqipëri, dhe me rihapjen e bazës ushtarake të Vlorës. Palamas shprehu shqetësimin e qeverisë greke, lidhur me shtimin e interesit italian në Shqipëri, duke vënë në dukje se, nëse italianët do të arrinin sukses në përmbyshjen e Hoxhës, Shqipëria mund të kthehej sërish drejt Moskës. Në këtë rast "Greqia do të preferonte Hoxhën".⁴⁸ Italianët, sipas Palamas, nuk kishin ndonjë "mirëkuptim të veçantë psikologjik" për situatën në Shqipëri. Sipas opinionit të tij, ndoshta, lidhja me francezët mund të kishte qenë e mirë, ndërsa zgjidhja më e mirë do të kishte qenë prania e britanikëve në Tiranë, sepse sipas diplomatit grek, këta të fundit, do të dinin si të vepronin në një situatë të tillë.⁴⁹ Por, britanikët nuk mund ta luanin këtë rol në Shqipëri, sepse ata nuk kishin përfaqësi diplomatike, dhe historikisht nuk ishin perceptuar nga shqiptarët si miq të tyre, por të grekëve. Duke iu përgjigjur shqetësimit të qeverisë greke, në lidhje me politikën aktuale të Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë, sekretari amerikan i Shtetit, Dean

⁴⁷ NARA, Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, *Memorandum of Conversation*, Participants: H.E. Christian Xanthopoulos-Palamas, Director General, Royal Ministry of Foreign Affairs, W. Tapley Bennett, Jr., Minister-Counselor, October 31, 1961.

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ Ibid.

Rusk, autorizoi ambasadorin amerikan në Athinë, Briggs, të informonte për këtë qëllim ministrin e Jashtëm grek Averoff.⁵⁰ Rusk e vlerësonte politikën zyrtare greke ndaj Shqipërisë, veçanërisht gatishmërinë e saj për të shqyrtuar në rrethana të përshtatshme zëvendësimin e Ligjit të Luftës me instrumente paqeje, dhe po kështu idenë për të vendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Politika amerikane nuk ishte e paimentuar për situatën në Shqipëri, por tani për tani, ajo dukej delikate dhe fluide.

Në rrethana të tilla, SHBA nuk mund të vepronjë para kohe dhe të merrnin ndonjë iniciativë, që do të fshinte ndryshimet midis Pekinit e Moskës dhe t'i hiqte Shqipërisë frymën e mosbindjes. Në këtë kohë SHBA nuk parashikonin t'i jepnin Shqipërisë ndihmë ekonomike. Për qeverinë amerikane do të ishte më mirë që Perëndimi të mos merrte ndonjë iniciativë të parakohshme, por ta linte situatën të precipitonte. Rusk, mendonte se ishte e vështirë të parashikohej ndonjë lëvizje e Shqipërisë drejt Perëndimit.⁵¹ Për sytë e Perëndimit dhe të SHBA-së thyerja shqiptaro-ruse kishte ndryshime thelbësore nga ajo jugosllavo-sovjetike e vitit 1948, për arsye se në Shqipëri qeveriste një regjim dogmatik stalinist, armiqësor me botën demokratike perëndimore dhe veçanërisht me SHBA-në, me mundësi të pakta ndryshimi. Në krye të PPSH-së ishte Enver Hoxha, një komunist stalinist ortodoks, me formim ideologjik dhe doktrinar të një personi të pandreqshëm. Regjimi komunist në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera të bllokut komunist ishte kundër politikave liberalizuese të Hurshovit. Shqipëria u lidh me Kinën, e cila në këtë periudhë ndiqte një politikë komuniste ekstreme ndaj Perëndimit, SHBA-së dhe Jugosllavisë.⁵²

Pikëpamjet më të plota të qeverisë greke për Shqipërinë, iu bënë të njohura ambasadës amerikane në Athinë, përmes memorandumeve të datave 14 dhe 21 dhjetor 1961.⁵³ Kryeministri grek, Karamanlis e vlerësonte plasaritjen e Shqipërisë me Moskën në këndvështrimin e sigurisë kombëtare të Greqisë dhe përgjegjësisë së saj si një vend anëtar i NATO-s. Në të dy memorandumet me përmbajtje pothuajse identike, theksohej ndjeshmëria më e madhe e shtetit grek ndaj situatës në Shqipëri, se sa ajo e vendeve të tjera anëtare të NATO-s. Greqia e konsideronte problemin e kufijve greko-shqiptarë si pjesë të kufijve veriorë të saj, përmes të cilëve ishte ushtruar

⁵⁰ NARA, XR 867.00, Rusk to Briggs, November 16, 1961.

⁵¹ Ibid.

⁵² Hamit Kaba, "Konflikti shqiptaro-sovjetik dhe sovjeto-jugosllav në sytë e Perëndimit", *Studime Historike*, nr.1-2, Tiranë 2008, f. 213-214.

⁵³ NARA, 767.00/12-1461, Briggs, (Athens) to Secretary of State, no. 737, December 14, 1961; Philips Talbot to Mr. McGhee, *The Greek Aide Memoire on Albania*, December 21, 1961.

presion i fortë nga vendet komuniste, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Çarja sovjeta-shqiptare ishte në favor të Perëndimit, jo vetëm sepse Blloku Komunist rrudhej me një anëtar tjetër, por edhe pse presioni i Bllokut do të ndjehej më pak, veçanërisht nga Greqia, një shtet kufitar me Shqipërinë.

Politikanët grekë shpresonin që hendeku ndërmjet Moskës dhe Pekinit të zgjerohej më tej, dhe Shqipëria të vazhdonte të mbetej jashtë ndikimit të Bllokut Komunist. Mbështetur në dy memorandumet e mësipërme, politika e qeverisë greke ndaj Shqipërisë konturohet si më poshtë: *Së pari*, qeveria greke, si edhe më parë do të vazhdonte të konsultohet dhe të mbante të informuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për planet e saj të ardhshme mbi Shqipërinë. *Së dyti*, Greqia do të favorizonte ekzistencën e shtetit të pavarur shqiptar, duke preferuar një regjim demokratik në Shqipëri. Në rrethanat kur vendosja e një regjimi të tillë në Shqipëri dukej një mision i pamundur, politikës zyrtare greke nuk i mbetej veçse të vlerësonte qëndrimin e pavarur të Shqipërisë ndaj BS dhe vendeve të tjera të Bllokut Komunist, dhe të shfaqte gatishmërinë e saj për të pranuar regjimin e Hoxhës.⁵⁴ (“Greece willing accept fact of Hoxha rule”). *Së treti*, mbajtja ende në fuqi e Ligjit të Gjendjes së Luftës me Shqipërinë, arsyetohej me moszgjidhjen e çështjes së Epirit të Veriut, një problem i mbetur pezull nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm të katër Fuqive të Mëdha.

Ndonëse e konsideronte “një çështje teorike” gjendjen e luftës ndërmjet dy vendeve, politika zyrtare greke kërkonte si këmbim paraprak për heqjen e saj, dhënien nga Shqipëria të autonomisë për “Epirin e Veriut”, si dhe garantimin e të drejtave të banorëve grekë aty.⁵⁵ Kjo nuk do të thoshte se Greqia po hiqte dorë nga pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë. Kjo politikë fleksibile dhe afatshkurtër projektohej, duke pasur në konsideratë mungesën e kushteve për arritjen e objektivave afatgjata të saj. Sidoqoftë, qeveria greke shprehej se nuk do të merrte përsipër që të ndërmernte e para iniciativën për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. *Së katërti*, Greqia do të favorizonte dhënien e një farë ndihme ekonomike dhe politike për regjimin shqiptar, nëse ky i fundit do ta kërkonte. Por ndihma greke do të ishte e kufizuar, aq sa Shqipëria të mund të qëndronte në këmbë. Politika elastike e Greqisë, përveç shkaqeve të tjera lidhej edhe me konkurrencën italiane në Shqipëri. Greqia ishte e vendosur që të mos lejonte kthimin e

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ NARA, Record of the U.S. Department of State Relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Roll 1, File 767.00, 21.12.1961, Phillips Talbot to Mr. McGhee, *Aide*, Memoire of Royal Greek Embassy in Washington. D. C.

Italisë në Ballkan. *Së pesti*, Qeveria greke dhe kryeministri i saj Karamanlis mbështesnin politikën amerikane “duart larg” (hands off policy) nga Shqipëria. *Së fundi*, Greqia nuk dëshironte të ndante me Italinë pikëpamjet e saj mbi Shqipërinë, për shkak të vështrimeve dhe interesave të ndryshme me të.

Organizatat joqeveritare: bashkim i Vorio Epirit me Greqinë

Situata e turbullt dhe delikate që po kalonte Shqipëria u shfrytëzua edhe nga organizatat e shumta greke brenda dhe jashtë vendit, të cilat iu kthyen më me forcë kërkesave të tyre tradicionale, që kishin të bënin me të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri, zgjidhjen e çështjes së “Epirit të Veriut” dhe bashkimit të tij me Greqinë. Mjaft aktive u tregua sidomos shoqatat e emigrantëve grekë në SHBA. Në qershor 1960, Federata Panepirote miratoi një rezolutë të veçantë për të hedhur poshtë raportin italian, të paraqitur në organizatën e NATO-s, duke theksuar negativitetin e tij për kombin grek, NATO-n dhe SHBA.⁵⁶

Një tjetër kërkesë iu drejtua sekretarit amerikan të Shtetit Christian Herter nga Chris P. Levantes.⁵⁷ Përmes saj kërkohej ndihma e SHBA për çlirimin e Vorio Epirit dhe bashkimi i tij me Greqinë. Në vazhdimësi të politikës amerikane, departamenti i Shtetit në përgjigjen e vet, qartësonte pozitën e shtetit amerikan, duke u shprehur se për këtë çështje duhej pritur një kohë tjetër, duke vënë në balancë opinionet e secilës palë.⁵⁸ SHBA sqaronte pozicionin e saj në lidhje me pretendimet territoriale të Greqisë ndaj Shqipërisë, duke theksuar ajo nuk kishte rënë dakord me ndonjë komb tjetër në lidhje me territorin apo kufijtë e Shqipërisë.⁵⁹

Për qëndrimin e saj aktiv ndaj zgjidhjes së problemit të Vorio Epirit dhe të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri u shqua sidomos, shoqata

⁵⁶ NARA, 767.00/6-570, Resolution from Pan-Epirotic Federation of America from Elias Betzios to Richard M. Nixon Vice –President of the United States, June 15, 1960

⁵⁷ NARA, 767.00/9-2960, September 29th. 1960

⁵⁸ NARA, Reply of Harold C. Vadelier-Director, Office of Eastern European Affairs to Mr. Levantis, October 31, 1960

⁵⁹ NARA, 767.022/10-2956, Internal Affairs of Albania 1960-1963, Roll 1, Edvard L. Freers-Director Office of Eastern European Affairs to Mr. Peppo, December 14, 1956; NARA, John S. Highland – Acting Assistant Secretary for Congressional Relations to Philip J. Philbin, House of Representative, October 31, 1961.

⁵⁹ NARA, Robert R. Schott to Mr. Istrou, July 29, 1961:⁵⁹ NARA, Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Memorandum of the United States Government, April 5, 1962.

“Pyrrhus Benevolent Society”, me qendër në New York.⁶⁰ Urdhri i Ahepa (Order of Ahepa) i qytetarëve amerikanë me orgjinë greke, në gusht 1961, miratoi një rezolutë të veçantë, në lidhje me kushtet e Epirit të Veriut, i cili iu dërgua edhe Sekretarit Amerikan të Shtetit, Dean Rusk (Din Rask).⁶¹ Në rezolutë bëheshin përpjekje për të argumentuar shkencërisht pretendimet greke për këtë rajon, duke iu referuar karakterit historik e etnik të tij, madje duke shfrytëzuar edhe deklaratën e Hrushovit në mbështetje të autonomisë së Epirit të Veriut.⁶² Rezoluta i sugjeronte Departamentit të Shtetit dhe Senatit, që të studionte kushtet, në të cilat gjendeshin grekët e këtij rajoni, dhe të zgjidhej problemi i tyre, duke çliruar dhe rivendosur të drejtat dhe privilegjet e banorëve të Epirit të Veriut. Gjithashtu, i tërhoqej vëmendja Sekretarit të Kombeve të Bashkuara, që të krijonin një Komitet për hetimin e kushteve, në të cilat jetonin grekët e këtij rajoni.⁶³

Gjatë kësaj periudhe u shtua aktiviteti i organizatës së emigracionit grek në Francë. Kjo organizatë, që mbulonte edhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore, i njohu drejtuesit e lartë të Evropës, me pretendimet dhe ankesat e saj me procesin e dehelenizimit arsimor, fetar dhe politik të Epirit të Veriut, që po ndodhte sipas saj në Shqipëri. Situata e krijuar gjykohej e përshtatshme për të zgjidhur një problem të mbetur pezull nga periudha e pas Luftës së Dytë Botërore. Çlirimi i popullsisë së Vorio Epirit nga zgjedha komuniste konsiderohej si një akt në mbrojtje të civilizimit perëndimor, kundër vërshimit të orientit imperialist dhe pushtimit mongol. Si rrugëzgjidhje shihej vendosja e këtij rajoni nën kontrollin e Kombeve të Bashkuara.⁶⁴

Këtij procesi ankesash iu bashkua edhe Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Greke. Presidenti i tij, Theoklitos, në tetor 1960, i dërgoi një telegram peshkopit të Canterbury, duke kërkuar prej tij mbështetje për çlirimin e Shqipërisë së Jugut, në frymën e besimit kristian.⁶⁵ Ministria e Jashtme britanike duke iu përgjigjur shqetësimit të peshkopit të Canterbury, shprehu opinionin se problemi i Epirit të Veriut ishte një çështje ende e pazgjidhur, ndërsa e konsideroi të drejtë mospërfshirjen e peshkopit anglez në një çështje politike.⁶⁶

⁶⁰ NARA, Robert R. Schott to Mr. Istrou, July 29, 1961:

⁶¹ NARA, 767.00/10-1861, Philip J. Philbin to Dean Rusk, October 18, 1961

⁶² See: William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift*, (Massachusetts: The M.I.T. Press, Cambridge, 1963), p. 40.

⁶³ NARA, 767.00/10-1861, October 18, 1961.

⁶⁴ TNA, FO 371/152818, May 1960.

⁶⁵ Ibid, October 26, 1960.

⁶⁶ Ibid, November 2, 1960.

Situata e krijuar pas Kongresit XXII të PKBS dhe prishjes përfundimtare të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike në dhjetor 1961, e bënë edhe më të vështirë dhe më të izoluar se më parë Shqipërinë. Kjo fazë shënon një aktivizim më të madh të organizatave nacionaliste greke, veçanërisht brenda vendit.⁶⁷ Në një mbledhje të zgjeruar të KEVA-s në shtator 1961 në Athinë, përfaqësuesi i Sillogut Panepirot të SHBA-së, Vasilis Fotos, premtoi akordim fondesh financiare nga emigracioni në SHBA për zhvillimin e aksioneve subversive ndaj Shqipërisë.⁶⁸ U formua Shoqata e Vullnetarëve Rezervë Vorio Epirotë dhe Këshilli Ushtarak me të njëjtin emër, të cilët koordinuan veprimtarinë me KEVA dhe EAVI-n, organizatë e rinisë Vorio Epirote. Këto organizata tërhoqën minoritarë grekë, të arratisur nga Shqipëria pas LDB, ose para përfundimit të saj.⁶⁹ Në festën e 25 marsit, Sillogu i Janinës, shpërndau trakte, të cilat bënin thirrje për organizimin e kryengritjes së armatosur në Shqipëri.⁷⁰

Në këtë periudhë u bë më intensive veprimtaria e organizatave të ndryshme të emigracionit grek në SHBA, si dhe e disa figura të njohura të botës politike e publike amerikane, të nxitura e mbështetura nga lobi grek në këtë vend. Presidenti i Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit të Shteteve të Bashkuara, J.W. Fulbright, në maj 1962 i përcolli Dean Rusk, një kopje të letrës, që i ishte dërguar atij nga presidenti i shoqatës “Pyrros Beevolent Society”, me qendër në Nju Jork. Ai e njohu diplomatën amerikan me ankesat e saj, për kushtet e vështira në të cilat gjendeshin disa prej familjeve të minoritarëve greke në Shqipëri.⁷¹

Në përgjigje të letrës së përcejellë nga Fulbright, Departamenti i Shtetit do të sqaronte, se politika amerikane e nxiste dhe mbështeste bashkimin e familjeve të ndara në të dy anët e Adriatikut. Por, nga ana tjetër, ajo nënvizonte pamundësinë e saj, për të ndikuar mbi regjimin komunist në Shqipëri, sepse ndërmjet dy vendeve nuk kishte marrëdhënie diplomatike, dhe as ndonjë vend të tretë, i cili do të përfaqësonte interesat amerikane në Shqipëri. Ndërmjet dy vendeve ende nuk kishte ndonjë kanal komunikimi që do të lehtësonte procesin e vështirë të afrimit shqiptaro-amerikan.⁷²

⁶⁷ Autori i këtij artikulli do të kishte dashur të kishte në dispozicion burimet dokumentare greke për këtë çështje, të cilat, për fat të keq ai nuk mundi t'i siguronte.

⁶⁸ B. Meta, *Shqipëria dhe Greqia ...*, f. 171.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *AMPJ*, Viti 1962, dosja 728, fl. 29.

⁷¹ *NARA*, 767.00/5-1862, J.W.Fulbright to Secretary of State (Dean Rusk), May 18, 1962.

⁷² *NARA*, 767.00/5-1862, Frederick G. Dutton (Assistant Secretary) to Senator Fulbright, May 28, 1962.

Në shkurt 1962 “Federata Panepirote e Amerikës” miratoi një rezolutë të posaçme, për gjendjen e popullsisë vorioepirote në Shqipëri, të shoqëruar me kërkesën për bashkimin e këtij rajoni me Greqinë.⁷³ Rezoluta e konsideronte të favorshme situatën, sepse ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik ekzistonin divergjenca të forta të karakterit politik e ideologjik, ndërsa situata brenda vendit mund të precipitonte në ndonjë kryengritje të brendshme, e cila mund të kërcënonte edhe demokracitë perëndimore. Rezoluta theksonte se Greqia, si shtet aleat i besuar i Perëndimit e meritonte të mbështetej në kërkesat e saj për bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë. Shoqata e greko-amerikanëve shprehte kundërshtimin e hapur, ndaj hapave që mund të ndërmernte qeveria amerikane në lidhje me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke vënë si kusht zgjidhjen paraprake të çështjes së Epirit të Veriut.

Më 22 qershor 1962, Constantine Stavropoulos në emër të shoqatës “Pyrrhus Benevolent Society” në Nju Jork, iu drejtua sërish sekretarit të shteti Dean Rusk, për problemin e Vorio Epirit.⁷⁴ Dokumenti përmban kritika të forta për politikën e ndjekur nga Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara, në lidhje me Shqipërinë, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar, politikë e cila nuk e kishte favorizuar bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë. Britania e Madhe fajësohej se kishte ndjekur politikën përça e sundo (divide and conquer) në Ballkan. Ajo nuk i kishte zgjidhur pretendimet greke as në Konferencën e Londrës të vitit 1913, dhe as më pas, ndërsa kishte miratuar në heshtje pushtimin e Shqipërisë nga Italia në vitin 1939. SHBA, bëheshin përgjegjëse për politikën e ndjekur prej tyre pas Luftë së Dytë Botërore, e veçanërisht në vitet 1947-1949. Politika amerikane fajësohej se nuk i kishte lejuar forcat e armatosura greke të pushtonin Shqipërinë në vitin 1949. Në këtë dokument pretendohet, se ndërmjet Ministrisë së Luftës dhe Departamentit të Shtetit kishte pasur mosmarrëveshje për zgjidhjen e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë. Ndërsa, Ministria e Luftës kishte qenë dakord me kërkesat e epirotëve, që trupat greke të avanconin në brendësi të territorit shqiptar, kishte qenë Departamenti i Shtetit ai, i cili i kishte ndaluar grekët të realizonin planin e tyre. Gjithashtu, politika amerikane bëhej fajtore, sepse në dimrin e vitit 1940-1941, kishte ndaluar përparimin e trupave ushtarake greke në ndjekje të ushtrisë italiane në zonën e Tepelenës. Shoqata e emigrantëve greke ishte

⁷³ NARA, Resolution of Panepirotic Federation of America, New York, February 25, 1962.

⁷⁴ NARA, 767.00/6-2262, Constantine Stavropoulos to Dean Rusk, June 22, 1962.

kundër disa thashetheme që qarkullonin në SHBA, se gjoja Departamenti i Shtetit do të lejonte Gjermaninë Perëndimore që të ndihmonte regjimin e Hoxhës, me qëllim që ta tërhiqte atë drejt demokracive perëndimore.

Ky version, sipas dokumentit nuk mund të arrihej me mjete paqësore, sepse nuk do pranohej nga E. Hoxha. Gjithashtu, ky plan nuk vlente për vorioepirotët, sepse nuk lejonte bashkimin e tyre me Greqinë.⁷⁵ Në dokument arrihet në përfundimin se “tani, është koha e përshtatshme për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri dhe për bashkimin e Vorio Epirit me atdheun mëmë - Greqinë”.⁷⁶ Dokumentet që njohim nuk provojnë që t’i jetë ngarkuar Gjermanisë Perëndimore një mision i tillë. Gjermania Perëndimore nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, ndërsa kjo e fundit kishte pretendime të forta ndaj saj, për dëmshpërblimet e pashlyera të Luftës së Dytë Botërore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndërmorën hapa konkrete për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, përveç disa sondazheve që nuk rezultuan të suksesshme, sepse udhëheqja komuniste e Shqipërisë vazhdoi politikën e saj antiamerikane dhe nuk pranoi të merrte ajo e para iniciativën.

Pas rezolutave, memorandumeve e kontakteve të shpeshta të greko-amerikanëve me zyrtarëve të lartë të Kongresit, Departamentit të Shtetit dhe figurave të tjera të shquara të SHBA, si dhe aktivitetit në rritje të shoqatave greke brenda vendit, qeveria amerikane do të shprehej qartazi dhe me vendosmëri për politikën e saj ndaj Shqipërisë dhe pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut. “The United States does not support any Greek territorial claims against Albania, and disapprove of the paramilitary operations against Albania, sponsored by the North Epirus Committee in Greece. The United States group may be unaware of some of these activities by its parent organization in Greece. Official U.S. support, however indirect, of the Greek Committee’s activities is not in line with existing U.S. policy”.⁷⁷ “Shtetet e Bashkuara nuk i mbështesin pretendimet territoriale greke kundër Shqipërisë dhe nuk aprovojnë operacionet paraushtarake kundër saj, të sponsorizuara nga Komiteti i Epirit të Veriut në Greqi. Grupi i Shteteve të Bashkuara mund të jetë i pandërgjegjësuar për disa nga këto aktivitete [të kryera] nga organizata e të parëve të tyre në Greqi. Mbështetja zyrtare e Shteteve të Bashkuara për aktivitetet e Komitetit Grek, ndonëse

⁷⁵ Ibid.

⁷⁶ Ibid

⁷⁷ *NARA*, Record of the Department of State relating to Internal Affairs of Albania, 1960-1963, Memorandum of the United States Government, *North Epirote Irredentist Activities*, April 5, 1962.

indirekt, nuk është në të njëjtën linjë me politikën ekzistuese amerikane”. Deklarata e hapur dhe e fortë e qeverisë amerikane u bë në një kohë kur rrethet dhe organizatat e ndryshme të emigracionit grek në SHBA kishin zhvilluar aktivitete të shumta në mbështetje të kauzës greke për Vorio Epirin, duke përdorur edhe lobimin në Departamentin e Shtetit dhe në Kongresin Amerikan. Në qendër të kritikës vendosej me të drejtë Komiteti për Epirin e Veriut, i cili ishte gjeneratori që ushqente veprimtarinë e nacionalistëve grekë, brenda dhe jashtë vendit, dhe organizonte aksionet e forcave paramilitare greke.

Politika amerikane e shihte Shqipërinë si faktor përçarës brenda Bllokut Komunist dhe veçanërisht brenda binomit BS-Kinë. SHBA u mundua të ruante prirjen gërryese të Shqipërisë edhe në vitet në vazhdim. Deviza e saj e njohur tashmë “lart duart nga Shqipëria”, ishte një sinjal i qartë për vendet fqinje të Shqipërisë, dhe veçanërisht për disa rrethe politike greke. SHBA nxitën dhe mbështetën idenë për të pasur marrëdhënie më të mira ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj, duke ndërmarrë hapa konkrete për zgjidhjen e disa prej ndryshimeve të njohura ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.⁷⁸

⁷⁸ NARA, RG 59, Department of State, *Albania, Guidelines for Policy and Operations*, February 1963, p. 6.

Hamit KABA

SUMMARY

ALBANIAN-SOVIET CONFLICT: OVERVIEW OF GREEK POLICY

The Albanian-Soviet conflict of the early '60s created a unique and delicate situation to the security of Albania. This conflict drew the attention of its neighboring countries, whose reactions unfolded in different ways. Yugoslavia, Greece, and Italy worked out specific policies towards Albania. On the grounds of their national interests and their international positions, they reaffirmed recognition of Albania's independence, but the Greek government presented its request for recognition of the autonomy of the Greek minority in Albania, while nationalist organizations both within and outside the country fervently requested unification of southern Albania with Greece.

All three countries were in favor of an overturn of the communist regime in Albania, but none was willing to accept domination by the other two. For the sake of maintaining balance between them, they somehow contributed to the maintenance of the current situation and the continuance of the communist regime in Albania. They helped [inadvertently] preserve of the national and territorial independence of Albania, as well as its role as a divisive factor within the Communist Block and, more specifically, in the great Sino-Soviet conflict. Shaping of Italian and Greek policy towards Albania was conducted under the strong influence of NATO and of the United States of America. Of the countries of the Balkan trinomial, Yugoslavia was considered the most interested in replacing Albania's existing regime with a puppet government under its subjugation. However, the actual documents provide no evidence as to whether or not Yugoslavia had planned an armed attack against Albania, despite strong allegations raised by Greece, Italy, and Albania's communist regime itself.

Kujtim MILLAKU

**ROLI I ARSIMIT DHE NDIKIMI I TIJ NË ZHVILLIMIN
INDUSTRIAL TË KOSOVËS GJATË VITEVE 1974-1990**

Pas Luftës së Dytë Botërore, duke marrë parasysh se në çfarë gjendje ndodhej Kosova, analfabetizmi ishte në shkallën më të lartë. Në vitin shkollor 1939/40, kishte vetëm 290 shkolla fillore deri në klasën e katërt me 635 paralele me gjithsej 32 790 nxënës, prej të cilëve vetëm 11 876 shqiptarë. Gjendje pothuajse e njëjtë mbeti edhe pas luftës, kur në vitin shkollor 1944/45 në shkollën fillore, do të thotë deri në klasën e katërt, kishte 432 paralele me 11 573 nxënës shqiptarë dhe 15 827 serbë dhe malazezë.¹ Nga të dhënat e kohës shihet se numri i nxënësve shqiptarë filloi të rritej vazhdimisht, por të dhënat nuk tregojnë se i gjithë procesi mësimor zhvillohej në gjuhën serbo-kroate dhe jo në atë shqipe. Në tabelën 1, shohim numrin e nxënësve shqiptarë të të dyja gjinive regjistruar në shkollat fillore që nga viti shkollor 1959/60 deri në vitin shkollor 1963/64.²

*Tabela 1.*³

Viti shkollor	1959/60	1960/61	1961/62	1962/63	1963/64
Nr. i shkollave	111	116	127	165	191
Nr. i nxënësve	34 500	44 554	54 875	62 804	69 325
meshkuj	18 145	23 797	30 382	35 367	39 627

¹ Косовво и Метохија 1943-1963, Просвета и школство, (Приштина: па botues 1963).

² Ibid.

³ Ibid.

femra	5 544	7 548	9 638	11 417	13 438
-------	-------	-------	-------	--------	--------

Sa i përket përkatësisë kombëtare, është interesant se numri i nxënësve shqiptarë, edhe pse ishin shumicë në Kosovë, ishte në përqindje mjaft të ulët deri në vitet '60, si në shkolla ashtu edhe në fakultete. Kjo vërehet edhe nga tabelat më poshtë që ishin publikuar nga organet kompetente të kohës: tabela 2 përmban të dhëna nga numri i nxënësve, ndërsa tabela 3 paraqet numrin e studentëve të rregullt dhe me korrespondencë në fakultete.

Tabela 2.⁴

Viti shkollor	1939/40	1944/45	1963/64
Shqiptarë	11 876	11 573	119 310
Serbë dhe malazezë	20 914	15 827	66 895
Turq	----	----	3 444

Tabela 3.⁵

Student	Serbë	Shqiptarë	të tjerë	gjithsej
Të rregullt	1 027	1 044	307	2 378
Me korrespondencë	1 857	1 140	516	3 510

Në krahasim me vitet e pasluftës (1948), popullsia e Kosovës ishte rritur më mbi 69% në vitin 1971. Popullsia karakterizohej për nga mosha e re, ngase 74% e saj ishin nën moshën 35-vjeçare, ndërsa popullsia e aftë për punë arrinte në 50.8% të popullsisë së përgjithshme.⁶ Por, duhet theksuar se nuk ishin problem vetëm nxënësit të cilët nuk vijonin mësimet. Probleme të mëdha, madje edhe në vitet '70 të shekullit XX, pati me kuadrin

⁴ Ibid.

⁵ Ibid.

⁶ Gazeta e delegatëve, viti I, nr. 8, Prishtinë 14 gusht 1975, 4.

profesional. Në vitin 1975, sipas Sekretariatit Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, struktura e kuadrove kualifikuese ishte siç është paraqitur më poshtë në tabelën 4.

Tabela 4.⁷

Numri i arsimtarëve		Prej tyre						
		Me fakultet	Me fakultet të pakryer	SHLP	SHLP të pakryer	Shkollë normale	Shkolla të tjera të mesme	Shkolla të tjera të mesme të pakryera
Gjithsej	11.383	143	158	2 769	596	6 834	581	132
Mësim klasor	5 449	2	17	75	78	5 109	75	79
Mësim lëndor	5 934	141	141	2 694	518	1 725	506	53

Siç po shihet, numrin më të madh të arsimtarëve e përbënin ata me SHLP dhe Shkollë Normale. Në shkolla fillore, sipas të dhënave të kohës, na del se mësim mbanin më se 50% arsimtarë pa përgatitje të mjaftueshme. Edhe pse në Kosovë gjatë vitit shkollor 1975/76 kishte 962⁸ ndërtesa shkollore, gjë që ishte shumë më pak se në vendet e tjera të Federatës, shumë nxënës edhe linin vijimin e rregullt për shkak të largësisë nga objekti shkollor, sidomos gjinia femërore. Këtu duhet përmendur edhe faktin se Kosova në krahasim me vendet e tjera të Federatës kishte natalitetin më të lartë. Pastaj, pjesa dërrmuese e këtyre ndërtesave shkollore ishin të vjetruara dhe vazhdimisht kërkonin investime. Duke ditur se zhvillimi i arsimit kushtëzon zhvillimin ekonomik të vendit, është menduar qysh në këtë kohë për arsimimin e punëtorëve, inkuadrimin e tyre në arsim duke filluar nga ai fillor e deri tek arsimi i lartë. Megjithatë, për të marrë arsimi rolin kryesor në ekonomi, kërkohet që ai të jetë adekuat. Shkollimi do të ketë efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik vetëm atëherë kur ekonomia i absorbon kuadrot e formuara. Kur flitet për marrëdhëniet e shkollimit në raport me zhvillimin

⁷ Programi afatmesëm i zhvillimit të arsimit dhe edukimit në KSA të Kosovës (1976-1980), Bashkësia Krahinore Vetëqeverisëse e Interesit për Arsim dhe Edukim, Prishtinë, tetor 1976, 9.

⁸ Ibid.

ekonomik, shkollimi vështrohet si sistem i cili është i pranuar dhe organizuar të shërbej si mjet për arritjen e qëllimeve ekonomike si faktor i zhvillimit ekonomik.⁹

Dihet mirë se shkollimi rrit produktivitetin e njerëzve, mundëson përshtatjen e tyre me kërkesat e reja të teknologjisë dhe kjo drejtpërdrejt ndikon në zhvillimin ekonomik. Në dekadat e para pas viti 1945, Kosova kishte probleme të mëdha me shkollimin e kuadrove profesionale. Shumica e punëtorëve paguheshin fare pak. Në Kosovë ekzistonte një prapambeturi e madhe ekonomike, një varfri e shkallës së lartë, prandaj edhe fuqia punëtore blihej e lirë dhe mund të gjendej lehtë.

Për shqiptarët shkollimi ishte më i vështirë, sepse duhej që shkollat t'i kryenin në gjuhën serbo-kroate, njëkohësisht edhe literatura përkatëse ishte po në atë gjuhë, gjë që paraqiste një pengesë serioze për shkollimin e kuadrove. Nxënësit shqiptarë, sidomos ata të pjesëve rurale, që nuk kishin njohuri të duhura për këtë gjuhë, ose s'mund të regjistroheshin, duke mos arritur ta kryenin provimin pranues, ose ngecnin gjatë shkollimit. Që nga viti 1947 ekzistonte një paralele e xehetarëve, të cilët aftësoheshin për mihjen e galerive në minierën "Kosova". Diplomat e para u morën pas dy vitesh të shkollimit, do të thotë më 1950, duke vazhduar deri në vitin 1961.¹⁰

Gjatë vitit 1952, shkalla e të punësuarve në Kosovë ishte 4.7%, në vitin 1970 u rrit në 7.7%, ndërsa në vitin 1981 në 11%, ndërsa mesatarja e të punësuarve në nivel Federate në këtë kohë ishte 27%.¹¹ Pengesë kryesore për punësimin e shqiptarëve paraqiste shkollimi i tyre. Deri më 31.11.1966, numri i të punësuarve me shkolla të larta dhe fakultete, në bazë të strukturës nacionale, ishte si vijon: serbë 1 647 ose 54.10%, shqiptarë 645 ose 21.19%, malazezë 543 ose 17.84%, turq 14 ose 0.47%, të kombësive të tjera 195 ose 6.40%.¹² Nga këto të dhëna shihet qartë struktura e ulët e të punësuarve me shkolla të larta dhe fakultete, sidomos të shqiptarëve, edhe pse ishin shumicë në Kosovë. Meqenëse për një zhvillim ekonomik faktor i domosdoshëm janë kuadrot, Kosova ishte e detyruar që këtë boshllëk ta plotësonte kohë pas kohe me ekspertë nga republikat e tjera. Mirëpo, në vitet në vijim do të ketë rritje në këtë drejtim prej 0.45%, por kur kemi

⁹ Marija Ratković, Efikasnost investiranja u obrazovanje, *Ekonomia*, (Beograd: Institut ekonomskih nauka, 1983), 13.

¹⁰ Kombinati "Kosova", prill 1970, Nr. 76.

¹¹ "Rilindja", 30 shtator 1983.

¹² Nuri Bashota, "Problemi i zhvillimit të Kosovës e Metohisë si rajon ma i prapambetur i Jugosllavisë", *Përparimi*, Nr. 6, Prishtinë 1967, 716.

parasysh se shkalla e natalitetit në këtë kohë ishte rreth 2.5%, atëherë shohim se rritja prej 0.45% është shumë e vogël.¹³

Një lëvizje e madhe u bë me hapjen e degëve të para të studimeve albanologjike në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike në vitin 1958, ndërsa Katedra e Albanologjisë u hap në vitin 1960 në Fakultetin Filozofik. Me krijimin e këtyre institucioneve filloi edhe arsimimi i lartë institucional në Kosovë. Grupet e para studimore që u organizuan në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, ishin: Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe, Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë Serbokroate, Grupi i Biologjisë dhe Kimisë, Grupi i Bazave të Arsimit Teknik dhe Fizikës, Grupi i Matematikës dhe Fizikës. Në vitin e parë akademik 1958-1959, u regjistruan 93 studentë të rregullt dhe 55 me korrespondencë. Studimet u zhvilluan në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Pas Prishtinës filloi edhe zgjerimi i shkollave të larta në qendrat e mëdha urbane të Kosovës. Hapja e Fakultetit Filozofik, Juridik, Teknik dhe të Mjekësisë, si dhe puna e shkollave të larta në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, krijoi edhe mundësi ligjore për themelimin e institucionit më të lartë arsimor-shkencor, pra të Universitetit të Prishtinës. Është theksuar se ndër faktorët që kanë ndikuar në krijimin e Universitetit të Kosovës është edhe ndryshimi i vërejtur politik që u bë nga politika jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Kosovës pas Plenumit të Brionëve, në vitin 1966.¹⁴ Më 18 nëntor 1969, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës miratoi Ligjin mbi themelimin e Universitetit të Prishtinës.¹⁵ Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës do të mbahej më 13 shkurt 1970, kurse më 15 shkurt, dy ditë më vonë, u mbajt edhe mbledhja solemne e Kuvendit për përvurimin e tij.¹⁶

Krijimi i Universitetit të Prishtinës do të ishte një nga shtyllat kryesore për krijimin e specialistëve të profileve të ndryshme që do t'i shërbenin zhvillimit socio-kulturor dhe ekonomik të Kosovës. Universiteti i Prishtinës luajti rol dhe pati ndikim edhe në zhvillimin e industrisë së Kosovës. Brenda një dekade u krijua një kontingjent i konsiderueshëm i kuadrove të kualifikuara e profesionale të cilët ishin një garanci për zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës, sidomos për industrinë e cila kishte shumë nevojë për këto kuadro. Në këtë drejtim, struktura arsimore e të punësuarve ishte më e ulët në ekonomi se në joekonomik, e në veçanti në

¹³ Ibid, 717.

¹⁴ Tempulli i dijes, Monografi 1970-2012, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2012, 44.

¹⁵ Fletorja Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 33, XXIV, Prishtinë, nëntor 1969.

¹⁶ Universiteti i Prishtinës 1970-2005, Prishtinë 2005, 14.

disa sektorë të industrisë, si në: industrinë e thëngjillit, metalurgjinë e ngjyrosur, industrinë e materialit ndërtimor dhe industrinë e tekstilit.¹⁷

Edhe pse në vitet '70 gjendja ndryshoi me shkollimin e shqiptarëve në gjuhën amtare, prapëseprapë gjendja e arsimit nuk ishte e mirë, sepse mungonin lokalet shkollore. Megjithatë, përsëri shqiptarët, edhe pse ishin shumicë, nuk qëndronin mirë me kualifikime në krahasim me pakicën serbe. Mungesa e kuadrove ishte evidente gjithherë. Shpesh kërkohet që të kishte më shumë kuadro në fakultetet, të cilat ishin të lidhura me zhvillimin ekonomik të Kosovës.¹⁸ Zhvillimi dhe zgjerimi i shpejtë i industrisë, kërkonte gjithnjë e më shumë kuadro të reja profesionale.

Sipas të dhënave që na ofron "Pasqyra e punës" e Odës Ekonomike, shohim se me kuadro as gjatë viteve '70 nuk ishin arritur objektivat, duke cekur si pengesë kryesore burimet afatgjata dhe stabile të financimit.¹⁹ Mënyrat e financimit të organizatave shkencore-hulumtuese, ishin të ndryshme: disa financoheshin nga fondi krahinor, disa nga fondi republikan dhe federativ e disa nga burimet e veta. Përveç financimit ishte themeluar edhe fondi i Titos, nga i cili që nga viti 1974/75, jepeshin bursa për shkollimin e punëtorëve të rinj dhe fëmijëve të punëtorëve dhe nga ky fond përfitonin si studentët ashtu edhe nxënësit.²⁰ Disa komuna me vendime të posaçme themeluan fonde për bursa për ngritjen e kuadrove profesionale të cilët studionin në fakultete, shkolla të larta si dhe shkolla të mesme sipas degëve të ndryshme dhe specialiteteve të cilat u nevojiteshin organeve shtetërore, enteve arsimore dhe organizatave bazë të punës së bashkuar etj.²¹ Sipas të dhënave të kohës, shohim se çdo i 5-ti banor ishte i përfshirë në arsimin fillor, në arsimin e mesëm çdo i 16-ti, në arsimin e lartë superior çdo i 59-ti banor i Kosovës.²² Gjithashtu, Kosova ishte vendi që më së paku ndante mjete për zhvillimin e arsimit. Reciprociteti në mes zhvillimit dhe kuadrove është i shumëfishtë. Kuadrot kushtëzojnë zhvillim, po ashtu

¹⁷ Shkëndija, Zhvillimi i arsimit dhe edukimit në KSA të Kosovës për periudhën e planit afatmesëm 1981-1985, Prishtinë, nëntor 1985, 11.

¹⁸ "Rilindja" 13 maj 1970.

¹⁹ Arkivi i Odës Ekonomike të Kosovës (AOEK), Pasqyra e punës, Oda Ekonomike e KSA të Kosovës, nr. 58, viti VI, Prishtinë 1970, 26.

²⁰ Arkivi Historik i Klinës (AHK), Fondi i Arsimit nr.6, Kutia I, dosja 8, dokumenti: Disa problem aktuale të standardit të nxënësve dhe studentëve në KSA të Kosovës, Bashkësia Krahinore Vetëqeverisëse e Interesit e Arsimit dhe Edukimit, Prishtinë, nëntor 1986, f. 13.

²¹ Arkivi Ndërkomunal i Pejës, Raporti mbi veprimtarinë e fondit për bursa të Komunës së Pejës për vitin 1974, Nr 111735/1, 1 qershor 1972/ Fletorja Zyrtare e KAKM, nr. 35/65.

²² AHK, Fondi i Arsimit nr. 6, kutia I, dokumenti 8, dokumenti: Marrëdhëniet shoqërore-ekonomike dhe pozita material e edukimit dhe arsimit të KSA të Kosovës, Bashkësia Krahinore Vetëqeverisëse e Interesit të Arsimit dhe Edukimit, Prishtinë, tetor 1986, f. 14.

zhvillimi kushtëzon formimin e kuadrove, atyre që shkollohen dhe atyre që specializohen për punë.

Shikuar nga aspekti i zhvillimit, kuadrot në ekonomi mund t'i ndajmë në dy grupe: kuadrot që janë bartës të zhvillimit, shpikës, krijues, ekspertë të lartë dhe të shkencës, profili i të cilëve mund të ndikojë në programet e reja ekonomike. Në grupin e dytë hyjnë kuadrot të cilët janë të aftë për pranim, realizim dhe nxitje të programeve të reja. Ata janë ekspertë të profilit inxhinier, teknikë dhe punëtorë të kualifikuar të cilët janë të përgatitur nëpër shkolla dhe praktika që stimulojnë zhvillimin.²³ Puna e këtyre kuadrove filloi të jap rezultatet pozitive në disa ndërmarrje industriale. Si shembull përmendet fabrika e amortizatorëve në Prishtinë, ku nga aplikimi i disa ideve inovative të kuadrove vendase pati efekte financiare pozitive në disa miliona dinarë në vit. Shembuj të tillë pati edhe në fabrikën e gypave në Ferizaj, fabrikën e akumulatorëve Mitrovicë, pastaj fabrikën e autopjesëve në Pejë.²⁴ Pavarësisht disa rezultateve, në industrinë e përpunimit të metaleve në Kosovë, për punë shkencore-kërkimore gjatë viteve '70 ndaheshin shumë pak fonde të cilat nuk tejkalonin më shumë se 0.4% të produktit shoqëror, ndërkohë që në nivel Federate ndaheshin deri në 2% të produktit shoqëror.²⁵ Ky ishte edhe një indikator tjetër i ngecjes së zhvillimit industrial të Kosovës në raport me njësit tjera të Federatës jugosllave.

Problemet me kuadrot e përcollën pothuajse shumicën e vendeve të pazhvilluara në Jugosllavi. Dihej mirë fakti se zhvillimi ekonomik në masë të madhe varej nga suksesi i përdorimit të arritjeve të reja në shkencë dhe teknologji. Gatishmëria dhe aftësia e kuadrove për t'i zotëruar këto arritje dhe aplikimin e tyre në kushte të veçanta, varet nga zhvillimi ekonomik në përgjithësi, do të thotë i secilës degë të ekonomisë dhe i secilit aktivitet veçmas.²⁶ Sipas shtypit ditor, në vitin 1978 në objektet e reja arsimore, u investuan afër 330 milionë dinarë, nga që llogaritej se Universiteti i Prishtinës i kishte dhënë ekonomisë së vendit 7 mijë studentë të diplomuar të cilët kontribuonin në sfera të ndryshme të punës dhe të prodhimit.²⁷ Në

²³ Mogućnost razvoja općina SAP Kosovo, dio 2, Razvojne mogućnosti, Zagreb 1979, 55.

²⁴ Hasan Damoni, Disa fjalë mbi transferrin tekniko-teknologjik, veprimtarin inovatore dhe punën shkencore-kërkimore në industrinë e përpunimit të metaleve të Kosovës, Produktiviteti dhe Inovacionet, viti IV nr.1-2-3, Prishtinë 1979, 175.

²⁵ Ibid., 176.

²⁶ Dvadeset godina tehinke i privrede Jugoslavije, Beograd 1966, 35; shih edhe Gazeta e delegatëve, viti I, nr. 8, Prishtinë, 14 gusht 1975, 19

²⁷ "Rilindja" 2 nëntor 1978.

këtë shumë të hollash nuk përfshihen vetëm investimet në objektet e fakulteteve, por edhe në objektet parauniversitare në shumë komuna të Kosovës.

Edhe pse është interesant se në vitet '80 i kushtojë një rëndësi mjaft e madhe edhe shërbimit ushtarak dhe thuhej se "të gjithë të rinjtë qofshin punëtorë, intelektualë, prodhues apo fermerë, duhet të shërbejnë në ushtri në kohë për 15 muaj. Për studentët thuhej se duhet të kryejnë shërbimin ushtarak në dy pjesë: pjesa e parë në kohëzgjatje prej 12 muajsh, kur ata do të shkonin në shërbim menjëherë pas shkollës së mesme, ndërsa pjesa e dytë për tre muajt e mbetur do të realizohej pas studimeve e më së voni me përfundimin e moshës 26-vjeçare të tyre.²⁸

Mirëpo, nuk mungonin as këshillimet rreth organizimit të punës ku theksohej rëndësia e arsimit në organizimin e punës së bashkuar ku edhe kërkohej një ndryshim rrënjësor i arsimit për t'u vënë në funksion të zhvillimit ekonomik që do t'i kontribuonte rritjes së prodhimit. Gjatë viteve '80, kishte zëra nga ekspertë të ekonomisë se duhej rritur numri i magjistrave dhe doktorëve të shkencave që do zënin punë në sferën e prodhimit, të cilët do ishin bartës të zhvillimit të përgjithshëm tekniko-teknologjik.²⁹ Por, numri i tyre në prodhim gjatë kësaj kohe ishte pothuaj inekzistent. Sipas të dhënave të viti 1982, në industri dhe xehetari nga radhët e shqiptarëve punonin vetëm 1 doktor shkence dhe 25 magjistër shkencash.³⁰ Të dhënat e vitit 1981 na japin këtë pasqyrë të kuadrove në Kosovë: 16,57% punëtorë të pakualifikuar, 11,94% punëtorë gjysmë të kualifikuar dhe 22,54% punëtorë të kualifikuar. Ndërsa, numri i punëtorëve me përgatitje të ulët profesionale arrin në shkallën 6,33%, 8% e punëtorëve nuk kishin të kryer as shkollën fillore, ndërsa me klasë të katërt ishin 11% dhe punëtorët me shkollën fillore përbënin 23% të të punësuarve.³¹ Edhe pse planifikimi i kuadrove dhe i arsimit është një parakusht i rëndësishëm profesional i lidhjes së punës me arsimin në OP të Kosovës, në bazë të hulumtimeve shohim se vetëm 7,69% e OPB-ve kishin një plan afatgjatë për arsimim të kuadrove, 13,46% nuk kishin fare dhe 71,15% kishin plan

²⁸ Јединство, 7 jul 1980.

²⁹ Isak Mustafa, Ndikimi dhe roli i kuadrove në ngritjen e produktivitetit të punës në OTHPB të KSA të Kosovës, Produktiviteti dhe Inovacionet, viti XI, nr. 1-2, Prishtinë 1986, 20.

³⁰ Enti i Krahinor Statistikës, Punëtorët në sektorin shoqëror në KSA të Kosovës, gjendja më 30.IX. 1982, Buletin 18, Prishtinë 1983, 48.

³¹ Arkivi i Odës Ekonomike të Kosovës, Informata aktuale ekonomike, nr. 9, Prishtinë 1984, 4.

vjetor të arsimimit të kuadrove të tyre.³² Edhe pse me marrëveshje OP-ve u kërkohej të kenë përcjellje të vazhdueshme të nevojave kadrovike në Kosovë në bazë të planeve afatmesme dhe afatgjata të nevojave kadrovike.³³

Nuk mungonin as përpjekjet e Odës Ekonomike të Kosovës me Rektoratin e Universitetit të Kosovës në Prishtinë, rreth marrëveshjeve ku palët obligoheshin që të merrni pjesë aktivisht në përgatitjen dhe transformimin e arsimit të lartë dhe t'i orientonin aktivitetet shkencore-kërkimore të organizatave të shkollimit superior sipas nevojave të punës.³⁴ Në dokumentet e OEK-ut, shihet se iu kushtua një rëndësi e madhe edhe mësimi të gjuhës angleze, frënge dhe asaj gjermane.³⁵ Rëndësi iu kushtua edhe sistemit të aftësimi permanent, ku do të përfshiheshin anëtarët e këshillave drejtuese të ndërmarrjeve, udhëheqësit e ndryshëm dhe kuadro të tjera, pastaj këshillimeve dhe seminareve të ndryshme.³⁶

Duke parë kërkesat gjithnjë në rritje, filloi të mendohej më seriozisht për zhvillimin e arsimit të orientuar, i cili do të luante një rol të madh në aftësimin e kuadrove të reja, për çka shumë organizata shoqërore ishin të interesuara. Parashihej që në një periudhë të afërt pjesa më e madhe e të rinjve, me baza edukativo-arsimore të kryera, të përfshihen në arsimin për fitim të shkallës përkatëse të profesionalizmit, me ç'rast do të shtohet numri i atyre të cilët do të orientohen në profesione prodhuese.³⁷ Kjo parashihej të arrihej deri në vitin 1990, gjithashtu duhej reformuar edhe arsimin e lartë apo superior për t'u përshtatur me ndryshimet e reja në teknologjinë e prodhimit. Krahas transformimit të rrjetit ekzistues të shkollave të mesme, të larta dhe fakulteteve, në pajtim me politikën e racionalizimit në këtë pjesë të sistemit arsimor, një kujdes i posaçëm do t'i kushtohet riorganizimit dhe ristrukturimit të brendshëm të sistemit të arsimit të orientuar në pajtim me nevojat e punës së bashkuar e kjo do të përshtatej me nevojat kadrovike që

³² AOEK, Roli i organizatës së punës së bashkuar në fushën e arsimit, Prishtinë mars 1983, 6.

³³ AOEK, Ujdia mbi bazat e politikës së punësimit dhe të të punësuarit në KSA të Kosovës për periudhën 1981-1985.

³⁴ Arkivi i Odës Ekonomike të Kosovës, Informata aktuale ekonomike, , nr. 8, Prishtinë 1984, 2.

³⁵ Ibid., nr. 3, Prishtinë 1984, 4.

³⁶ AOEK, Buletin i Odës, Botim special, Prishtinë, mars 1990, 21; Pasqyra e punës, Oda Ekonomike e KSA të Kosovës, Sekretariati për informata, viti VI, nr. 58, Prishtinë 1970, 26, 27.

³⁷ Gazeta "Shkëndija", Prishtinë, nëntor 1985, 30.

paraqiten si nevoja të reja në pikëpamje të degëve, profesioneve dhe profileve.³⁸

Në funksion të edukimit të orientuar u shpall edhe Ligji mbi arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar³⁹. Ky ligj specifikonte të gjitha obligimet nga të gjitha palët, sidomos nga organizatat e punës së bashkuar rreth nevojave të tyre për profesione të caktuara. Ligji përcaktonte të drejtën që edhe punëtorët të cilët dëshironin të aftësoheshin mund t'i ndiqnin mësimet pas orarit të punës ose në disa raste edhe gjatë orarit të punës.

Gjatë viteve '70 pati edhe bashkëpunime në mes universiteteve të ndryshme nga Britania e Madhe me Jugosllavinë, përkatësisht me disa universitete nga republikat e tjera, por nuk pati ndonjë projekt bashkëpunimi me ndonjë institucion arsimor të Kosovës.⁴⁰ Pavarësisht faktit se në vitet në vijim do të kemi një numër mjaft të madh të të diplomuarve, kjo nuk do të thotë se ata do të punësoheshin, pasi që sipas të dhënave të kohës shohin se numri i të papunëve ishte në rritje e sipër. Pastaj është interesant se nga rreth 520 organizata të punës së bashkuar në Kosovë, vetëm dy prej tyre kishin të organizuar punë shkencore-kërkimore. Ato ishin: Kombinati "Kosova" dhe KXXMK "Trepça", ndërsa të tjerat këtë punë ua besonin institucioneve shkencore-kërkimore jashtë Kosovës.

Sipas dokumenteve të kohës shohim edhe marrëveshje rreth zhvillimit të rrjetit dhe harmonizimit të kapaciteteve të shkollave të mesme të Kosovës. Pas tjerash, kërkohet edhe krijimi i kushteve materiale, teknike dhe kadrovike për zhvillimin e lëndëve profesionale, të ushtrimeve praktike dhe të praktikës profesionale, duke i riaktivizuar dhe formuar punëtoritë e shkollave për t'i ushtruar nxënësit për profesione të caktuara.

Për nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla, merrnin pjesë një numër institucionesh si, bie fjala, vetë Kuvendi i KSA i Kosovës, Lidhja e Sindikatave të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Kuvendi i Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit, kuvendet e komunave të Kosovës, Bashkësia Vetëqeverisëse e Arsimit dhe Edukimit etj. Të gjitha këto në interes të zhvillimit të arsimit nëpër shkollat profesionale, për të cilat theksohet se do t'i shërbenin zhvillimit ekonomik të Kosovës në të ardhmen. Gjithëherë mendohej të bëhej racionalizimi i degëve duke u harmonizuar me zhvillimin ekonomik të vendit, pastaj edhe bëhej propozimi i degëve të caktuara nëpër

³⁸ Ibid, 31.

³⁹ Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, Nr.3, , viti XXXV, Prishtinë 19 janar 1980.

⁴⁰ Vendim mbi ratifikimin e programit të bashkëpunimit arsimor dhe kulturor midis Jugosllavisë dhe Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, për vitet 1972 dhe 1973, Gazeta zyrtare e RSFJ, Nr. 58, 1 nëntor 1973, 302.

shkollat profesionale, gjë që më herët ishte anashkaluar duke bërë që për profile të caktuara në ekonomi të kishte mungesë të madhe, përderisa në disa profile kishte tepriçë të madhe. Kësaj çështjeje iu kushtua një rëndësi e madhe, sidomos në vitet '80, mirëpo në këtë kohë pati një ngecje në zhvillimin ekonomik, pasi që nuk kemi ngritje të kapaciteteve të reja ekonomike.

Gjatë kësaj periudhe kemi planifikim të kapaciteteve të regjistrimit të studentëve sipas kësaj përqindjeje:

- shkenca teknike dhe bioteknike 49%;
- shkenca shoqërore-humanitare dhe arte 35%;
- shkenca natyrore-matematike dhe medicinale 16%.⁴¹

Ngjarjet e vitit 1981 që kapluan Kosovën, nuk lanë pa prekur edhe arsimin. Kjo u shfaq në drejtim të kufizimit të fondeve për arsim, përjashtimin e kuadrove universitare dhe studenteve, që u fajësuan për pjesëmarrje në demonstratat e viti 1981.⁴² Kjo goditi rëndë rezultatet e arritura në një dekadë dhe ndikoi në rënien e numrit të studentëve. Nga 47 426 studentë sa kishte Universiteti i Prishtinës në vitin akademik 1979/80, ky numër kishte rënë në 37 857 studentë në vitin 1984/85.⁴³

Historikisht është dëshmuar se zhvillimi i arsimit ka sjellë shtim të produktivitetit të punës dhe kjo zakonisht ishte vërejtur në vendet e Perëndimit, por u pa se edhe te ne, pa një shkollim të kuadrove në të gjitha fushat, nuk mund të arrihej një zhvillim i mirëfilltë ekonomik. Për një kohë të gjatë në industrinë e Kosovës, punonin kuadro të cilat me shumicë nuk kishin kurrfarë shkollimi apo kishin të kryer vetëm arsimin bazik e kjo nuk mund të garantonte kurrfarë zhvillimi. Si duket nuk u bë asnjëherë hulumtimi i tregut të punës se sa kuadro dhe çfarë kuadros h i nevojiteshin vendit në ngritjen e cilësisë së punës në procesin teknik dhe teknologjik për një zhvillim më të madh ekonomik.

⁴¹ AHK, Fondi i Arsimit nr.6, kutia I, dosja 15. Dokumenti: Marrëveshja vetëqeverisëse mbi bazat e politikës së regjistrimit të studentëve në vitin e parë të studimeve në organizatat e shkollimit të lartë dhe superior në RS të Serbisë, Bashkësia e Arsimit të Orientuar të Vojvodinës, Kosovës, Bashkësia Republikane e Arsimit të Orientuar, Bashkësia e Universiteteve të Serbisë, Beograd, 1988, 3.

⁴² Marenglen Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*, Tiranë 2000, 340-341.

⁴³ Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë 1985, 306.

Kujtim MILLAKU

SUMMARY

ROLE OF EDUCATION AND ITS IMPACT ON THE INDUSTRIAL DEVELOPMENT OF KOSOVO DURING THE PERIOD 1974-1990

This paper shall address the role of education and its impact on the industrial development of Kosovo during the period 1974-1990. Today education is the most important pillar for a proper economic development of a country. Various studies that have been conducted indicate toward the benefits that education yields in terms of economic growth and development. Education in Kosovo went through several stage of development during the monist period. For a long time Kosovo lagged behind other countries of Yugoslav Federation, and it emerged from the war with the population with the highest level of illiteracy, and this problem persisted until 60s, and which had insignificant impact on the professional advancement and qualification of Albanian workers.

The situation changed positively with the opening of University of Prishtina, expansion of the network of primary and secondary schools in Albanian language. The staff that in the past were coming from other republics of the Federation were being replaced by Albanian staff. Even though during the 70s and 80s there were attempts to orient the education towards the needs of economic development of Kosovo, the number of qualified workers and specialists left much to be desired. It was observed that in Kosovo without investments in human resources there would not be economic development, therefore many institutions of higher education decided to respond to the needs of the industry which was in the early stages of development.

Sedat KRYEZIU

**MEMORANDUMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE
ARTEVE TË SERBISË I VITIT 1986 DHE IMPAKTI I TIJ NË
RINGJALLJEN E NACIONALIZMIT SERB**

Rrethanat e krijuara pas vdekjes së Titos nxorën në pah një varg problemesh të natyrave të ndryshme, me theks të veçantë problemet e karakterit etnik. Hegjemonizmi serb, që kishte dominuar në hapësirat e ish Mbretërisë Jugosllave dhe në dekadat e para të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, u ndie i rrezikuar nga procesi i decentralizimit të Jugosllavisë, që kishte filluar më 1968 e që një formë substanciale e kishte fituar më 1974. Përmes këtyre ndryshimeve republikat dhe krahinat jugosllave fituan tipare të elementeve shtetërore dhe frika nga ndarja e mundshme e ndonjëres prej njësisve federale alarmoi qarqet nacionaliste serbe, sidomos kur pjesa më e madhe e serbëve jetonte jashtë kufijve administrativë të Serbisë. Në këtë rrethana, u ringjall nacionalizmi i heshtur serb, i cili zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe të çështjes serbe i përmblodhi në një punim që u quajt "Memorandumi" i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, i vitit 1986.

Ky projekt ishte vazhdimësi e projekteve tjera të mëhershme nacional-shoviniste serbe, duke filluar nga "*Naçertania*" e Ilija Grashaninit (1844), pastaj "*Iseljavanja Arnauta*" (Shpërngulja e Arnautëve) të Vasa Çubriloviqit (1937) e "*Homogena Srbija*" (Serbia homogjene) e Stefan Moljeviqit (qershor, 1941), sepse pa njohjen e tyre nuk mund të shtjellohet fenomenologjia e nacionalizmit serb, që shkon thellë në gjysmën e parë të shekullit XIX.

Prandaj, punimi "*Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (ASSHA), i vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e nacionalizmit serb*" ka për qëllim të trajtojë rrethanat që ndikuan në

hartimin e këtij memorandum, esenca e tij, reagimet dhe këndvështrimet lidhur me përmbajtjen e saj dhe pasojat që solli ai.

Rrethanat që ndikuan në hartimin e "Memorandumit"

Procesi i decentralizimit të Jugosllavisë i viteve 1968-1974 kishte alarmuar qarqet nacionaliste serbe, pasi akordimi i atributëve shtetërore për subjektet federale jugosllave nënkuptonte edhe mundësinë e shkëputjes së tyre, sidomos kur një pjesë e madhe e serbëve jetonte jashtë kufijve administrativë të Serbisë.*

Këto ndryshime nxorën në pah problemet e pazgjidhura etnike, sidomos kur autonomia që i ishte akorduar Kosovës ishte shoqëruar me një ndërgjegjësim të shpejtë kombëtar të shqiptarëve dhe tendencave të tyre për t'u barazuar me njësitë tjera federale që mund të rezultonte në shkëputjen e saj nga federata jugosllave. Nacionalizmi serb, duke qenë i pafuqishëm, në mënyrë të heshtur i kishte rezistuar pa sukses këtyre ndryshimeve, por vdekja e Titos dhe ndryshimi i rrethanave politike në Jugosllavi, krijoi parakushtet për ringjalljen e tij, shenjat e hapura të së cilit do të shihen pas shpërthimit të demonstratave studentore në Kosovë më 1981.

Duke filluar nga ky vit, nacionalizmi serb filloi të punojë më aktivisht, kurse fillesat e një veprimtarie të konsoliduar të saj datojnë që nga viti 1984 me ngritjen e çështjes së krizës ekonomike dhe të statusit të Serbisë në federatë. Në këtë mënyrë, po këtë vit, akademiku serb, Dobrica Qosiq, duke folur për "Ngarkesat e së kaluarës dhe sfidat e së ardhmes" kërkoi që Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve (ASSHA) të angazhohej rreth "problemeve gjithë-shoqërore e kombëtare". Propozimi i akademikut Ivan Maksimoviq se "...problemet më akute shoqërore, politike, ekonomike, të mirëqenies sociale, shkencore dhe kulturore duhet të adresohen në formë të një memorandum, dhe ky memorandum duhet të qarkullojë në gjitha instancat që kanë të bëjnë me çështjet publike në Serbi dhe Jugosllavi", gjeti përkrahjen e kolegëve të tij në ASSHA, prandaj Kryesia e këtij institucioni

* Në rregullimin e brendshëm RSFJ ishte e ndarë në gjashtë republika dhe dy krahina autonome. Kufijtë midis republikave dhe krahinave nuk kishin karakter shtetëror, por vetëm karakter administrativ-juridik, d.m.th. secila njësi federale ushtronte pushtetin e saj juridik brenda kufijve të saj. Popullsia që jetonte në kuadër të një njësie federative i nënshtrohej ligjeve të asaj njësie, që në disa raste mund të ndryshonin nga ligjet e njësisë tjetër federative, por që ishin në përputhje me ligjet federative. Me fjalë tjera, serbët që jetonin jashtë Republikës së Serbisë, sikurse në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë e etj., nuk i nënshtroheshin ligjeve të R. së Serbisë por vetëm të republikës/krahinës ku jetonin dhe ligjeve federative.

në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 1985, emëroi një “komision për të përgatitur një memorandum mbi çështjet aktuale shoqërore”.

Mbledhja e parë e këtij komisioni u mbajt më 28 qershor, Dushan Kanazir dhe Antonije Isaković, që të dy me pozita të larta në Akademi, u zgjedhën kryetar dhe zv/kryetar të Këshillit. Po ashtu u zgjodh grupi punues që kryesohej Antonije Isaković.¹ Përveç këtyre dy kryesuesve, anëtar të komitetit ishin: Pavle Ivić, Mihajlo Marković, Milosh Macura, Dejan Medaković, Miroslav Pantić, Nikolla Pantić, Ljubisha Rakić, Radovan Samarxhić, Miomir Vukobratović, Vasilije Krstić, Ivan Maksimović, Kosta Mihajlović, Stojan Čelić dhe Nikolla Čobeljić.²

Zgjedhja e datës 28 qershor nuk ishte e rastësishme. Një ditë e tillë në historinë serbe simbolizon Betejën e Kosovës të vitit 1389, në të cilën serbët pretendonin ta kenë mbrojtur civilizimin e krishterë dhe se humbja përballë Perandorisë Osmane ishte shoqëruar me dyndjen e shqiptarëve në Kosovë. Për më tepër, puna në këtë projekt u shoqërua me përgatitjet për manifestimin e njëqind vjetorit të ASSHA, kur vetëm një muaj para manifestimit, gjithçka u ndal përmes publikimit të materialit, të quajtur atëherë Memorandumi i ASSHA.³

Gazeta beogradase “*Večernje Novosti*” arriti të shtie në dorë tekstin e papërfunduar të Memorandumit dhe ta botojë atë. Ky botim, shënoi faktikisht edhe fundin e punës mbi këtë material. Teksti kryesor në faqen e dytë të gazetës *Večernje Novosti*, të datës 24 shtator 1986, titullohej: “*Čka përmban draft Memorandumi i Komisionit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve*”. Nën të ishte vendosur titull sugjestiv: “*Oferta e pashpresë*”. Nën këto fjali të zgjedhura me kujdes nga redaksia fshihej teksti që për herë të parë do të nxirrte në dritë pjesë nga Memorandumi i papërfunduar i ASSHA. Të nesërmen, në faqen e njëjtë po të njëjtës gazetë qëndronte titulli: “*Edhe AVNOJ paska qenë i rrejshëm*”. Që të dy tekstet, i nënshkroi gazetari dhe redaktori i atëhershëm i gazetës *Novosti*, Aleksandar Gjukanović. Këto dy artikuj nxitën një debat të ashpër në publikun jugosllav si dhe polemika të ndryshme në faqet e kësaj gazete.⁴ Çështja e parë që e

¹ Kosta Mihailović, Vasilije Krstić, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts – Answers to Criticisms*, Serbian Academy of Sciences and Arts, Belgrade, 1995, 13.

² Enver Hoxhaj, *Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, Pejë 2008, 93.

³ *Vreme*, br. 247, 17 jul 1995, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1377420>, tërhequr më 30 tetor 2018.

⁴ Rade Dragović, *Memorandum SANU - tri decenije posle* http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera_Fejton_elektronik, tërhequr më 20 shtator 2018.

preokupoi opinionin publik jugosllav ishte se nga e mori gazetari tekstin? Ishte kjo një pyetje përgjigja e vërtetë e së cilës do të hidhte në dritë shumë gjëra, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte se çfarë fshihej pas këtij botimi. Qarkullonin versione të shumta, që nga vjedhja e këtij materiali e deri tek lëshimi i qëllimshëm. Njohësit e rrethanave shoqërore të viteve 80 tregojnë se ekzemplarët e parë të Memorandumit filluan të qarkullojnë në Beograd dhjetë ditë më herët sesa që ishte botuar në gazetën *Novosti*. Rrethi i ngushtë i “njerëzve të duhur”, përmes lidhjes së duhur, mund të siguronte një kopje edhe tek adresa “Francuska 7”, më saktë në restorantin e Klubit të Shkrimtarëve.⁵

Sipas Dobrica Qosiqit, ishte policia e Stane Dolancit që e kishte vjedhur Memorandumin dhe që e kishte filluar makinerinë e saj propagandistike kundër ASSHA.⁶ Sidoqoftë, versioni zyrtar thotë se Memorandumi ishte vjedhur. Në mesin e kontradiktave për “vjedhje” në ASSHA atyre ditëve të vitit 1986 u gjend gazetari Aleksandar Gjukanoviq. Tek ai ra dyshimi se personalisht e kishte vjedhur këtë dokument, dhe atë nga askush tjetër përveç se nga vjehrrin e tij, profesori dhe autori i njohur i shkrimit të kushtetutës, profesori i Fakultetit Juridik, akademiku Jovan Gjorgjeviq. Por, Gjukanoviqi kishte mohuar ta ketë vjedhur tekstin nga tavolina e punës së vjehrrit të tij. Në një shkrim në *Novosti* ai thotë se tekstin ia kishin dhënë vetë akademikët, e pas leximit ky kishte vendosur ta botonte në gazeta.⁷

Duket se një veprim i tillë kishte qenë i parapërgatitur me qëllim që të testohet reagimi i opinionit publik dhe njëkohësisht të shërbente si mekanizëm për mobilizimin e masave serbe. Ndonëse Memorandumi mbeti i papërfunduar, sipas mendimit të anëtarëve të kryesisë së ASHAS puna e bërë “*ka pasur pasoja domethënëse për zhvillimin shoqëror gjatë viteve të fundit. Ai është kuptuar edhe si një lloj programi kombëtar për marshimin e popullit serb drejt së ardhmes*”.⁸ Memorandumi bëri jehonë të madhe në gjithë Jugosllavinë, sidomos duke zgjuar frikë dhe pasiguri tek komunitetet jo serbe. Duke u konsideruar si një platformë nacionaliste Memorandumi u kritikua nga mediet e kontrolluara nga regjimi komunist gjatë vjeshtës së

⁵ R. Dragović, *Memorandum SANU - tri decenijeposle...*

⁶ Dobrica Ćosić: Piščevi ZapisI (1981-1991);

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:275783-Haranga-protiv-SANU, Fejtonelektronik, tërhequr më 25 shtator 2018.

⁷ R. Dragović, *Osmasednica CK KP Srbije*,

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:687287-Milosevic-cuti-o-Memorandumu, Fejton elektronik, tërhequr më 25 shtator 2018.

⁸ M. Tomaniq, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj*, Shkodër, 2006, 15-16.

vitit 1986 dhe pranverës 1987 si në Serbi ashtu edhe në njësitë tjera federale. Memorandumi u kritikua edhe nga instancat politike të Serbisë.

Komiteti Qendror i LK të Serbisë, atëherë i udhëhequr nga Ivan Stamboliqi kishte kërkuar tërheqjen e këtij Memorandumi. Kundërshtimi ndaj këtij akti konsistonte në faktin se ky dokument ishte në kundërshtim me diskursin e tij politik. Stamboliqi ndiqte një rrugë relativisht më të moderuar në krahasim me Millosheviqin, i cili po ndiqte vijën e ashpër nacionaliste e centraliste. Stamboliqi kishte harxhuar një energji të madhe politike për t'i bindur njësitë tjera federative për nevojën e ndryshimeve kushtetuese, duke arritur në fund të siguroj pëlqimin e tyre për ndryshimin e vetëm atyre dispozitave kushtetuese që rregullonin raportet midis R. të Serbisë dhe krahinave autonome, prandaj ai ia kishte frikën rritjes së vrullshme të pakënaqësisë serbe e sidomos shprehjen gjithmonë e më publike të saj, e cila kishte shkaktuar frikë tek subjektet tjera federative.

Duke u angazhuar për një politikë parimore Stamboliqi u përpoq ta zgjidhte problemin me rrugë institucionale, duke angazhuar për një lidhje më të fortë midis Serbisë dhe krahinave autonome e njëkohësisht edhe për një autoritet më të madh të pushtetit të Serbisë mbi krahina, duke respektuar formalisht autonominë. Pra, ai kërkonte ri-integrim administrativ të Republikës së Serbisë me krahinat autonome të Vojvodinës e të Kosovës, por pa i ngritur serbët kundër shqiptarëve.⁹ Ai ushtroi presion mbi udhëheqjen e shqiptarëve të Kosovës që të punonte për të gjetur rrugëzgjdhje. Por metoda e tij nuk doli e pranueshme as për serbët, as për shqiptarët.¹⁰ Shqiptarët ishin të vetëdijshëm për synimet finale të Stamboliqit, kurse qarqet nacionaliste serbe nuk kishin durim t'i prisnin rezultatet e punës së tij. Kritikën dhe presionet ishin të vazhdueshme, duke veçuar këtu vizitën e drejtpërdrejtë të Ivan Stamboliqit në ASSHA që i bëri me 29 tetor, mirëpo, akademikët mbrojtën Memorandumin dhe ishin konsekuent në qëndrimin e tyre. Duke e cilësuar memorandumin si “një tekst që juridikisht nuk ekziston”, ASSHA e liroi veten që ta shpreh qëndrimin e saj mbi përmbajtjen e tekstit, duke e zhvendosur fokusin në mënyrën problematike të daljes së tekstit në publik.¹¹ Në Kuvendin e jashtëzakonshëm të ASSHA, që u mbajt me 18 dhjetor 1986, pavarësisht presioneve të shumta, akademikët me shumicë votash, 114 nga gjithsej 137,

⁹ Jasminka Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*. Albin, 1998, 84.

¹⁰ Ibid., 86

¹¹ *Vreme*, br. 247, 17 jul 1995, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1377420>, tërhequr më 30 tetor 2018.

u deklaruan për besimin ndaj anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të Kryesisë së ASSHA.¹²

Në vazhden e këtyre kritikave, ajo që tërheq vëmendje ishte qëndrimi i Sllobodan Millosheviqit ndaj Memorandumit. Ai kishte qëndruar i heshtur, por me ndryshimin e rrethanave ai kishte kritikuar Ivan Stamboliqin dhe ithtarët e tij lidhur me qëndrimin e tyre ndaj memorandumit.¹³ Teksti i Memorandumit përbëhej prej 73 faqe, prej të cilave ashtu sikurse vërteton sot ASSHA, vetëm 30 faqe e kishin kaluar procedurën e redaktimit zyrtar. Teksti i saj ishte i ndarë në dy pjesë, pjesa e parë kishte të bënte me krizën e shoqërisë dhe ekonomisë jugosllave, kurse i dyti ishte emërtuar “Pozita e Serbisë dhe e popullit serb”. Nëntë pika të këtij dokumenti paraqesin kritika të shumta mbi gjendjen e atëhershme, paraqiteshin po ashtu një numër faktesh e dëshmi për pretendimet kryesore të autorëve të tekstit—*“Jugosllavia ka nevojë për ri-rregullim. Në të kundërtën, nuk do të ekzistojë. Populli serb, sikurse thanë akademikët, duhet të jetë i përgatitur edhe për këtë përfundim”*.¹⁴

Në pjesën e parë të Memorandumit, ku flitej për krizën ekonomike, qysh në fillim konstatohej se *“kriza ekonomike zgjat që pesë vite, kurse dalja nga ajo as që duket në horizont”*, por edhe theksohet se dalja nga kriza është e mundur vetëm përmes *“ndryshimeve themelore në sistemin ekonomik dhe politik”*. Problemi kryesor ekonomik i Jugosllavisë së viteve 80’, sipas hartuesve të Memorandumit, ishte dezintegrimi, si një tendencë bazë në ekonomi dhe shoqëri. Doktrina e vetëqeverisjes nuk kishte, as që mund të kishte ndonjë përgjigje të vendosur në mbylljen gjithnjë në rritje të ekonomive republikane, të cilat gjithnjë e më tepër u fokusuan kah tregu kombëtar.¹⁵ Kjo pjesë vazhdon të ofrojë të dhëna nga një studim i hollësishëm i gjendjes dhe shkaqeve që e sollën atë. U studiuan aspekte shumëdimensionale ekonomike duke filluar që nga vitet 1960 duke i përshkruar trendët dhe politikat ekonomike, të cilat Memorandumi i cilëson të gabuara, por theksi kryesor vihet tek decentralizimi. Këtu vërehet brenga e akademikëve serbë, sepse njësitë e veçanta ekonomike ishin shoqëruar me krijimin e njëjësive përkatëse politike e kjo do të çonte në krijimin e një ekonomie të veçantë për secilën republikë dhe krahinë gjë që jepte tipare

¹² Политика, 19 Децембар 1986, 7.

¹³ Viktor Meier, *Yugoslavia – A history of its demise*, Routledge, London-New York, 1999, 38.

¹⁴ Dragović, *Osmasednica CK KP Srbije...*

¹⁵ Mihailovic, V. Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts*, 96-97.

shtetërore dhe mundësonte një shkëputje të mëvonshëm të cilësdo prej tyre, e shqetësimi qëndronte sidomos tek Kosova.

Memorandumi i jepte rëndësi të theksuar edhe rregullimit kushtetues të Jugosllavisë, sidomos raportit të krahinave me Serbinë, duke potencuar se një kushtetutë e tillë promovonte elemente të konfederatës, pasi që kushtetutat republikane dhe krahinore mund të mos jenë në harmoni me kushtetutën federale, i vetmi detyrim ishte që këto kushtetuta republikane apo krahinore të mos binin në konflikt me kushtetutën federative. Nuk parashiheshin zgjidhje ligjore në rast të ndonjë konflikti të mundshëm. Në anën tjetër, në rast të një konflikti midis statusit republikan apo krahinor me atë federal, prioritet kishte statusi republikan apo krahinor dispozitat e të cilave mbeteshin në fuqi deri në kohën kur Gjykata Kushtetuese ta lëshonte vendimin e saj.¹⁶

Në pjesën e parë të Memorandumit trajtohen edhe probleme tjera nga fusha ekonomike e shoqërore, çështjet sociale, etj. Por, pjesa më e diskutueshme e Memorandumit, dhe ajo çfarë bëri jehonë të madhe në opinionin publik jugosllav të asaj kohe, por edhe të opinionit ndërkombëtar më vonë, ishte pjesa e dytë e Memorandumit që trajtonte çështjen e statusit të Serbisë dhe të popullit serb. Akademikët shkruan ato për çfarë flitej me të madhe pas miratimit të kushtetutës së vitit 1974 dhe në këtë mënyrë ranë në konflikt me elitën udhëheqëse e cila ishte e “shurdhër mbi pozitën e Serbisë në federatë”.

Prapambetja afatgjate në zhvillimin e ekonomisë së Serbisë, raportet e parregulluara juridike me Jugosllavinë dhe krahinat, si dhe “gjenocidi” në Kosovë, u paraqitën në skenën politike me një fuqi të bashkuar, që e acaroi situatën edhe më shumë. Këto tre çështje të mundimshme, që burojnë nga politika afatgjate ndaj Serbisë, me kompleksitetin e vet “rrezikojnë jo vetëm popullin serb, por edhe stabilitetin e gjithë Jugosllavisë”, ishte njëra nga qëndrimet kryesore të Memorandumit.¹⁷ Përmes parashikimit se “brenda dhjetë vitesh, nëse nuk ndryshon diçka, në Kosovë nuk do të ketë më serbë”, dhe se do të arrihej “Kosova e pastër etnikisht”, të përcaktuar me programin e Lidhjes së Prizrenit 1878-1881 - autorët e Memorandumit të ASSHA të vitit 1986 iu rrekën edhe gjendjes së popullit serb në krahinën e atëhershme autonome të Kosovës. Në kohën e revoltave dhe shprehjes së parullës “Kosova republikë”, akademikët nxorën edhe parashikimin e errët të shpërnguljes së serbeve dhe malazezëve nga Kosova. Duke cituar Jovan Cvijiqin, akademikët nxorën të dhëna mbi gjitha shpërnguljet, përfshirë

¹⁶ Ibid., 105.

¹⁷ Dragović, Memorandum SANU - tri decenijeposle

edhe atë të Arsenije Cernojeviqit, ku u dëbuan rreth 500.000 serbë, përfshirë edhe 150.000 që shtëpitë e tyre i braktisën gjatë viteve 1876-1912.

Gjatë katër viteve të Luftës së Dytë Botërore nga Kosova u dëbuan 60.000 serbë. Gjatë njëzet viteve, sipas tyre, Kosovën e braktisën rreth 200.000 serbë.¹⁸ Sigurisht që këto të dhëna janë të falsifikuara, sidomos kur flitet për shpërnguljen e serbëve nën Cernojeviqin, apo edhe gjatë viteve 1876-1912 kur dihet mirë se trevat e banuara me shqiptarë në pjesën verilindore të Kosovës u pushtuan nga ushtria serbe, e cila përveç aneksimit bëri edhe spastrimin etnik të atyre viseve.* Çështja e shpërnguljes së serbëve mori një theks të veçantë pas vitit 1981. Nxitja e mosbesimit të ndërsjellë dhe e shprehjeve se “nuk mund të jetohej me shqiptarët dhe se i vetmi shpëtim për serbët është bashkimi kombëtar”, sipas Azem Vllasit, atëherë kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, ishin slogane tjera të nacionalizmit që pengonin stabilizimin e gjendjes në Kosovë.¹⁹

*“Përmes vlerësimeve nga forumet e ndryshme politike popullit serb në Kosovë kurrësi nuk mund t’i mohohet e drejta që përmes gjitha mjeteve ligjore të mbrohet nga dhuna. Nëse këtë mbrojtje ata nuk mund ta realizojnë në krahinë, populli duhet ta kërkojë realizimin e saj në republikë dhe federatë”*²⁰, ishte pjesa ku u trajtua Peticioni 2016* dhe veprimtaria politike e serbëve nga Kosova, ku haptas paralajmëroheshin veprimet e tyre në të ardhmen. Për më tepër, tani problemi i serbëve të Kosovës do të bartet nga niveli krahinor në atë republikan e federal, duke i cilësuar institucionet e Kosovës si të paafta apo të pavullnetshme për t’i zgjidhur problemet e serbëve. Në perspektivë afatgjate, kjo nënkuptonte edhe suprimimin e institucioneve krahinore kur do të krijoheshin rrethanat e përshtatshme. Në rastin e Kosovës, ajo çfarë binte në sy ishte edhe përdorimi i termit “Kosovë e Metohi”, i cili asokohe nuk ishte emërtim zyrtar i Krahinës e as nuk përdorej në literaturën shkencore. Në fakt, Kosova e kishte pasur këtë

¹⁸ Mihailovic, Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts*, 129-130.

* Gjatë vitit 1877/78 ushtria serbe largoi me dhunë nga Sanxhaku i Nishit mbi 200.000 shqiptarë...për më tepër shih: Sabit Uka, “Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX”, *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Instituti Albanologjik Prishtinë, 1996, f. 162.

¹⁹ Dragović, *Memoradum SANU - tri decenijeposle*

²⁰ Ibid.

* Në tetor 1985 rreth 2016 serbë në Kosovë e nënshkruajnë një peticion me frymë nacionaliste: “Kjo është toka jonë. Nëse Kosova dhe Metohia nuk janë serbe, atëherë ne nuk kemi ndonjë tokë tonën”, për më tepër shih: Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, Pluto Press, London, 2000, f. 17.

emërtim para ndryshimeve kushtetuese të vitit 1967. Nocioni “Metohi” ka të bëj me pjesën perëndimore të krahinës dhe ky emër me etimologji greke do të thotë “tokë e kishës” prandaj tregon kinse kemi të bëjmë me një pjesë historikisht ortodokse serbe.²¹

Shtjellimi i pozitës së serbëve jashtë kufijve administrativë të Serbisë, paraqiste një çështje komplekse sepse sipas vlerësimeve dilte se jashtë kufijve të Serbisë së ngushtë jeton një numër mjaft i madh i serbëve, më i madh se numri i përbashkët i gjithë kombësive tjera. Sipas regjistrimit të vitit 1981 jashtë territorit të Serbisë jetonin 24% e gjithë serbëve apo 1,958.000 serbë, që është një numër më i madh se sa i sllovenëve, shqiptarëve apo maqedonasve në Jugosllavi veç e veç, apo shifër kjo pothuaj e njëjtë me numrin e banorëve boshnjakë në Bosnjë. Shifrat e serbëve nga regjistrimi i vitit 1981, në kohën e hartimit të referendimit rriten dukshëm, gjithnjë me tendencën e paraqitjes së një problemi të rënduar e tejet serioz për popullin serb, duke ekzagjeruar maksimalisht numrin e mundshëm të serbëve që jetonin jashtë Serbisë. Në këtë mënyrë, sipas autorëve të Memorandumit, në këtë periudhë jashtë Serbisë së ngushtë jetonin 3,285.000 serbë apo rreth 40.3% e numrit të përgjithshëm të tyre. Tani një theks i veçantë iu kushtua serbëve të Kroacisë, të cilët i ishin nënshtruar “diskriminimit dhe asimilimit”.²²

Memorandumi theksonte edhe pozitën e serbëve në Bosnjë-Hercegovinë. Edhe këtu serbët u përshkruan si viktimat. “*Të mësuar nga përvoja e gjenocidit gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të vetëdijshëm se gjenocidi mund të përsëritej në çdo kohë, sikurse ishte rasti për fat të keq, serbët filluan të largohen nga Bosnja-Hercegovina pasi që në këtë republikë aktet diskriminuese ndaj serbëve po bëheshin gjithnjë e më të shpeshta*”.²³ Me fjalë tjera, Memorandumi jepte mesazhin se “*Rivendosja e integritetit të plotë nacional dhe kulturor të popullit serb, pavarësisht se në cilën republikë apo regjion serbët banonin, është e drejtë e tyre historike dhe kushtetuese*”.²⁴ Për të arritur këtë të “drejt” ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974 ishte i domosdoshëm. Në këtë mënyrë, trajtimi i çështjes së serbëve jashtë Serbisë jepte indikacione drejt arritjes së një zgjidhjeje në të cilin

²¹ Çështja e Përgjegjësisë Politike: Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (1986), Raporti nr. 2, Prishtinë, 2003, 21.

²² Mihailovic, V. Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts*, 131-133.

²³ Ibid., 10-11.

²⁴ Meier, *Yugoslavia*, f. 46-47.

populli serb duhej të jetonte i bashkuar në rast të shpërbërjes së Jugosllavisë, që u vërtetua si një projekt që solli luftëra, vdekje e shkatërrime të shumta.

Memorandumi përmbyllet me “...gatishmërinë për të qenë në shërbim të realizimit të detyrave të përcaktuara në të dhe për hir të diktateve të historisë dhe gjeneratave të ardhshme”. Kjo dëshmon se si ASHAS shtroi rrugën për një politikë të caktuar të zgjerimit territorial, me marrëveshje apo manu *militari*, sikurse përcaktoi Dobrica Qosiqi, duke i dhënë diskursit serb një argument shtesë në luftën e ardhshme për Serbinë e Madhe.²⁵

“Memorandumi” i ASSHA në optikën e studiuesve të ndryshëm

Argumentet për shkrimin e Memorandumit dhe pasojat që dolën nga ky tekst janë studiuar thellësisht nga studiues të ndryshëm. Në këtë aspekt, në studimin e saj të detajuar, “*Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis*”, studiuesja Vesna Peshiq*, vë në pah se nacionalizmi serb përbëhej prej dy komponentëve. Derisa komponenti i parë ishte për konsum të brendshëm duke i ofruar lidhshirë konservativ serb një taksonomi reale dhe të fabrikuar të ankesave serbe ndaj popujve tjerë të Jugosllavisë, komponenti i dytë, i jashtëm, përmbante një rishikim të marrëdhënieve midis Serbisë me kombet tjera dhe me Jugosllavinë si tërësi. Këto komponentë u gërshetuan në Memorandumin e vitit 1986, prandaj bazuar në këtë dokument dhe në pozicionime të shkrimtarëve të njohur dhe anëtarëve serbë të ASSHA, të cilat shpreheshin në gazetatat ditore serbe, ajo identifikoi shtatë elemente kryesore të “zemërimit” serb:

1. Jugosllavia është një iluzion serb: Sipas këtij përkufizimi, serbët në mënyrë naive u viktimizuan duke pranuar jugosllavizmin dhe lidhjet vëllazërore me popujt tjerë, derisa këta “vëllezër” në mënyrë të vazhdueshme po i ndërtonin shtetet e tyre etnike-nacionale mbi eshtrat e serbëve të vdekur që luftuan në luftën për liri. Vetëm serbët e duan Jugosllavinë, ata ishin të vetmit për të abdikuar nga shteti serb për hir të unitetit jugosllav. Ata humbën një kohë të

²⁵ Enver Hasani, “Reflections on Serbian nationalism and the policy of ethnic cleansing” <http://sam.gov.tr/wp-content/uploads/2015/06/REFLECTIONS-ON-SERBIAN-NATIONALISM-AND-THE-POLICY-OF-ETHNIC-CLEANSING-ENVER-HASANI.pdf>, qasur më 1 nëntor 2018.

* Vesna Peshiq, është një politikane dhe sociologe serbe, që lindi më 6 maj 1940. U mor aktivisht me politik deri në vitin 2012.
https://en.wikipedia.org/wiki/Vesna_Peshiq

- konsiderueshme historike derisa e kuptuan se Jugosllavia ishte një iluzion serb.²⁶
2. Konspiracioni kundër serbëve: gjatë gjithë historisë jugosllave serbët iu ekspozuan konspiracionit të Kominternit, LKJ-së, Titos (kroat) dhe Kardelit (slloven), që luajtën role kryesore në vendimmarrjet jugosllave dhe të cilët zbatuan politikën kundër serbe. Si pjesë e revolucionit të saj social dhe luftës kundër hegjemonizmit serb, LKJ veproi për zvogëlimin e Serbisë, duke e katandisur atë në kufijtë e pashallëkut turk të Beogradit, promovoi shpërbërjen dhe asimilimin e popullit serb: “Ideologjia austro-hungareze dhe ajo e Kominternit u shkrinë në Titoizëm. Duke përcaktuar kufijtë politikë të republikave, duke zhvilluar etatizmin republikan...dhe duke hartuar kushtetutën e vitit 1974, Titoizmi bënte gjithçka për ta dezintegruar popullin serb dhe e arriti një gjë të tillë”.²⁷
 3. Serbia është shfrytëzuar: Serbia është shfrytëzuar ekonomikisht nga Sllovenia dhe Kroacia, e kjo sqaron prapambeturin ekonomike të saj. Pjesa më e madhe e Memorandumit të ASHAS i përkushtohet kësaj teme, të formuluar në këtë mënyrë: “Gjatë gjithë periudhës së pasluftës, ekonomia e Serbisë i ishte ekspozuar një shkëmbimi jo ekuivalent...”. Situata e Serbisë duhet të vështrohet brenda kornizave të dominimit politik dhe ekonomik të Sllovenisë dhe Kroacisë, të cilët ishin nismëtare të ndryshimeve në gjitha sistemet e mëparshme.
 4. Serbët janë humbës: sepse ata janë të vetmit që nuk kanë një shtet të mirëfilltë. Ata fituan në luftë, por humbën në paqe. Serbët dhe malazezët sakrifikuan shtetet e tyre për formimin e Jugosllavisë.
 5. Serbët u ekspozohen urrejtjes nga popujt tjerë jugosllavë: urrejtja kundër serbëve është një temë mbizotëruese në shkrimet e intelektualëve serbë, të shprehur në mënyra të ndryshme. Secili nga popujt jugosllavë ka një urrejtje të veçantë ndaj serbëve. Për shembull: “Komunistët maqedonas i kanë maqedonizuar serbët (p.sh kanë kryer etnocid kundër serbëve në republikën e tyre)”. Dhe kjo vlen për gjithë popujt tjerë.
 6. Serbët i janë nënshtruar gjenocidit: përsëri armiqtë dhe politika e tyre kundër serbëve. Motivi i liderëve serbë në provokimin e frikës

²⁶ Vesna Pesic, “Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis”, United States Institute of Peace, *Peaceworks* No. 8, First published April 1996, f. 18-19.

²⁷ Ibid, 19.

dhe përplasjeve etnike kishte për qëllim t'ua përkujtojnë serbëve mundësinë e përhershme të gjenocidit kundër tyre dhe për të parandaluar një fushatë gjenocidi ndaj serbëve. Kjo temë u interpretua në mënyra të ndryshme, por më së shumti duke paraqitur fotografi dhe të dhëna mbi krimet e ustashëve ndaj serbëve, në gjitha gazetat kryesore të republikës dhe në televizion. Priftërinjtë ortodoksë serbë kërkonin që të lejoheshin që t'i nxirrnin eshtrat e viktimave serbe nga varret masive të Luftës së Dytë Botërore dhe t'i rivarrosnin ata me dinjitet. Zhvarrosja dhe rivarrosja kishte një rol simbolik në përcaktimin e kufijve shtetërorë të Serbisë: ku ka varre serbe, aty janë edhe kufijtë serbë. Gjatë fushatave serbe në vazhdimësi rritej numri i viktimave serbe.²⁸

7. Një shtet kombëtar për gjithë serbët: “ne serbët duhet të mësohemi të mendojmë se ne mund të jetojmë të vetëm”. Në këtë mënyrë shteti kombëtar serb shihej si një “çështje e lirisë dhe e drejtës për të ekzistuar për etnosin serb si një tërësi e identitetit të tij historik, kulturor dhe shpirtëror, pavarësisht kufijve aktualë republikanë dhe kushtetutës jugosllave. Nëse kjo liri dhe këto të drejta nuk respektohen, atëherë nuk është përmbushur qëllimi historik i popullit serb – unifikimi i gjithë serbëve në një shtet.”²⁹

Këto shprehje nacionaliste, të cilët u përhapën nga intelijenca serbe përmes mjeteve të informimit, nuk do të ishin plotësisht të suksesshme nëse nuk do të përqafoheshin nga elita politike dhe ushtarake e Serbisë si një pjesë e aktivitetit të tyre ditor, ndonëse ata publikisht nuk i paraqitën qëndrimet e tilla të tyre. Një analizë të mirëfilltë mbi efektet e Memorandumit e paraqiti edhe ish kryetari i fundit i Jugosllavisë Stipe Mesiq*.

“Në rastin e Kroacisë ky akt nënkuptonte gjuhëzimin para Millosheviqit i cili tek vetja e tij i bashkoi planin hegjemonist të shekullit të

²⁸ Ibid, 20.

²⁹ Ibid.

* Stipe Mesiq i lindur me 24 dhjetor 1934 në Orahovicë. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Ishte i burgosur me një vit burg në Stara Gradishka për shkak të pjesëmarrjes në të ashtuquajturën "pranvera kroate". Në fillim të viteve të '90 merr pjesë në lëvizjen e më vonë në partinë e HDZ. Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kroacisë bëhet anëtar i Kryesisë së RSFJ-së, më vonë u bë kryetar. Largohet nga HDZ - ja për shkak të qëndrimeve të saja ndaj B-H dhe formon një parti të re të quajtur, HND (Hrvatski Nezavisni Demokrati - Demokratët e Pavarur Kroatë). Ishte kryetar i Kuvendit të Republikës së Kroacisë gjatë viteve 1992 - 1994. Në vitin 2005 zgjidhet president i Republikës së Kroacisë. https://en.wikipedia.org/wiki/Stjepan_Mesi%C4%87

kaluar të Garashaninit, planin Pashiq-Karagjorgjeviq mbi Ballkanin sipas Marrëveshjes së Londrës të vitit 1915 dhe të Memorandumit të Qosiqit në ASSHA – Serbët duhet ta përmbushin misionin e tyre historik, e ky mision mund të përmbushet vetëm nëse bashkohen në Serbinë homogjene dhe brenda kornizës të Jugosllavisë të cilën do ta mbizotërojnë me frymën e tyre duke ia dhënë edhe vulën e tyre. Serbët duhet ta kenë hegjemoninë e tyre në Ballkan dhe Jugosllavi. Prandaj atyre iu imponua detyra e parë: që ta krijojnë dhe organizojnë Serbinë homogjene e cila duhet të përfshijë gjitha rajonet etnike në të cilat jetojnë serbët”- shkruan në librin e tij “Kako smorazbili Jugoslaviju” kryetari i fundit i RSFJ, Stipe Mesiçi. Perceptimi i tij mbi dokumentin e ASSHA nënkupton në plotësi bashkërendimin e planit për krijimin e Serbisë së Madhe dhe të hegjemonisë absolute të Serbisë.³⁰

Sipas studiuesit kosovar, Enver Hasani, kombi serb, i ushqyer nga besimi se ai ishte një komb mbizotërues dhe se Serbia ishte një qendër e sllavëve të jugut, gjatë gjithë ekzistencës së Jugosllavisë u përpoq që ta ruante strukturën centraliste të shtetit. Në kohën kur gjithë shtetet tjera komuniste ishin duke ecur drejt demokracisë, shoqëria dhe klasa politike serbe luftonin për një legjitimitet të ri për ta ruajtur pushtetin. Klasa politike serbe kërkonte që t’i integrojë serbët e rëndomtë në projektin e Serbisë së Madhe, jo për t’ua mbrojtur pronën e tyre private por vetëm “tokat e shenjta serbe”. Ky memorandum shënoi fillimin e këtij diskursi dhe përgatitjet emocionale të shoqërisë serbe për kryerjen e spastrimeve etnike dhe të shkatërrimit të kulturave tjera. Ishte ky programi i parë kombëtar në Jugosllavi që bazohej në standardizimin e retorikës nacionaliste me këndvështrimin e eliminimit të kulturave tjera.

Studiuesi, Enver Hoxhaj, flet edhe për ndikimin e madh që e kishte “*Memorandumi*” tek Millosheviqi, dhe që zhbërja me dhunë e shtetit nuk mund të merret vetëm vepër e Millosheviqit, sepse si në çdo konflikt veprimi i aktorëve të veçantë është i lidhur ngushtë me faktorë e struktura tjera. Roli i veçantë i tij duhet kuptuar në lidhje të ngushtë me ndikimin e Akademisë serbe dhe Memorandumi dëshmohet këtu për bazë ideologjike e veprimtarisë së tij politike.

Është gjithë e njohur që Millosheviqi e instrumentalizoi në mënyrë të vazhdueshme dhe të vetëdijshme nacionalizmin serb dhe racizmin antishqiptar, ashtu siç ishte propaganduar çdo ditë duke filluar nga viti 1981, nga faktor me ndikim si shkrimtarë, klerikë, shkencëtarë dhe nga mediat. Dhe, ky nacionalizëm e ky racizëm nuk është aktualizuar gati askund më efektivisht se sa në memorandum dhe njëkohësisht i shkruara në një

³⁰ R. Dragović, Memorandum SANU - tri decenijeposle...

dokument, prapa përmbajtjes së të cilit qëndronte instanca më e lartë shkencore e vendit.³¹

Se sa kishte përgjegjësi politike Memorandumi vërehet edhe të hapat politikë që i propozonte, e që ushtruan ndikim të padiskutueshëm në formësimin e politikës millosheviqiane, siç ishin: Revidimi i kushtetutës së vitit 1974, "Ribashkimi" i Serbisë dhe luftimi i "agresionit shqiptar" përmes "shpalljes luftë", përmes "luftës revolucionare" dhe të "konfrontimit të hapur". Që nga vitet 1989 /90 të gjithë këta hapa u bënë vërtetësi. Në verën e vitit 1988 shqipja u hoq nga përdorimi zyrtar dhe në vend të saj gjuhë zyrtare në Kosovë u bë serbishtja; më 24 mars 1989 autonomia e Kosovës u hoq përmes grusht-shtetit; me 5 korrik 1990 me dhunën e policisë e të ushtrisë serbe u shuan parlamenti dhe qeveria e Kosovës.³²

Pasojat më të tmerrshme të Memorandumit u ndjenë në Bosnjë-Hercegovinë, prandaj edhe studiuesit boshnjakë e trajtuan këtë tekst nga kënde të ndryshme, përfshirë edhe atë psiko-social. Studiuesi boshnjak, Ismet Dizdareviq, sjell konstatime dhe analiza nga dy sociologë dhe psikologë kroatë rreth Memorandumit. Sipas tij, Dr. Ivan Shiber, në bazë të analizës psiko-sociale të Memorandumit konstaton porositë etnocentrike që gjenden në të. Në interpretimin psiko-social të memorandumit ai paraqet ngjashmërinë e qëndrimeve të Memorandumit me qëndrimin e ideologëve dhe realizatorëve të doktrinës fashiste. Sa çfarë është afërsia midis memorandumit dhe hartuesve e zbatuesve të ideologjisë fashiste më së miri paraqiten nga dr. Rudi Supeka. Psikologu social, Supek, në librin e tij "Drustvene predrasude. Socialno-psiholoska razmatranja", tregon për shtatë tema mbizotëruese të cilat karakterizojnë sindromin nacionalist.

Këto tema janë: "(1) dëmtimi (po na mashtrojnë, po na vjedhin, po na plaçkitin, kurse ne durojmë); (2) komploti (në shoqërinë tonë ekzistojnë forca të errëta të cilat qëllimisht punojnë kundër nesh, ata kanë agjentë të huaj e të vendit, të cilët janë infiltruar në organet drejtuese të shoqërisë dhe të popullit, dhe po e helmojnë atë); (3) rrezikimi biologjik (përmes teorive dhe perceptimeve të ndryshme morale e ideologjike, që po e dobësojnë fuqinë e popullit tonë, nga brenda që po e shkatërrojnë dhe rrënojnë...); (4) alarmi ideologjik (populli ynë është tepër i ndershëm, i sinqertë dhe naiv, duhet t'ia hapim sytë e t'i tregojmë të vërtetën, ta organizojmë si falangë kundër armiqve të ndryshëm, është detyrë e jona që ta sigurojmë prosperitetin e tij); (5) superioriteti etnocentrik (ndërgjegjia jonë tregon se populli ynë është trim, i ndershëm e punëtor, që mund të shërbej si shembull

³¹ Enver Hoxhaj, *Politika Etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, Pejë 2008, 130.

³² E. Hoxhaj, *Politika Etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, 133.

për popujt tjerë, të mbizotërojnë mbi popuj tjerë...); (6) autoritarizmi apo sado-mahoizmi (masat respektojnë vetëm forcën, atyre u duhen njerëz të forcës, që dinë të qeverisin si liderë të fuqishëm e që me ta mund të identifikohen në rrjedhat shoqërore...); (7) Hakmarria (atyre që shkatërrojnë qenien tone kombëtare do t'i përgjigjemi duke i likuiduar pa menduar dy herë, do t'i shkatërrojmë dhe fshijmë nga faqja e tokës, në këtë mënyrë ata edhe njëherë nuk do të vinë në kontakt me popullin tonë, e as që do ta kërcënojnë atë në ndonjë lloj mënyrë...)³³

Një analizë e hollësishme lidhur me mesazhet që bartte Memorandumi u krye nga një ekip studiuesish kroatë. Në “Memorialin e Republikës së Kroacisë”, përgatitur për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ndër të tjera viheshin në pah dy elemente: se Memorandumi gjeti përkrahje tek grupe të caktuara militante serbe, sidomos në Kosovë e Serbi, dhe se fryma nacionaliste që buronte nga ky Memorandum u shoqërua me debate të zjarrita në mediet serbe. Në vazhden e këtyre debateve u botuan dhe transmetuan artikuj e fjalime që promovonin nacionalizmin serb kurse paralelisht u demonizuan kroatët, shqiptarët dhe myslimanët.³⁴ Me fjalë tjera, filloi shprehja e hapur dhe publike e ndjenjave nacionaliste serbe.

Memorandumi ishte kritikuar edhe nga qarqet akademike jo nacionaliste në serbi. olivera milosavljeviq, historiane, autore e disa artikujve dhe studimeve të këtij dokumenti dhe përfshirjes së tij në zhvillimet e mëvonshme tragjike, duke u bazuar në një intervistë të dushan kanazirit të bërë më 1991, në mënyrë të pa rezervë konstaton se memorandumi ishte një ide e planit nacional serb. arkitekti bogdan bogdanoviq, i cili për shkak të mospajtimit me mënyrën e punës së akademisë e kishte braktisur atë qysh më 1981, u rreshtua padyshim në anën e kritikuesve të ashpër të këtij dokumenti. sipas mendimit të tij, publikimi i këtij dokumenti ishte “shprehje e bashkërendimit midis qarqeve të caktuara politike dhe intelektualëve të beogradit”. ai vazhdonte: “memorandumi ishte trimërim dhe mbulesë shkencore për nacionalizmin serb. një dokument i tillë nuk mund të publikohej pa bashkëpunimin midis akademikëve, liderëve kombëtarë dhe disa anëtarëve të caktuar partiakë. gjithsesi, jo të rrymës së stamboliqit. memorandumi në beograd u prit si një shenjë për

³³ Ismet Dizdarević, “Etnocentrički stavovi akademika Dobrice Ćosića”, *Ćosićev Rat*, zborni krakova sa naučne i stručne rasprave o knjizi “Bosanski Rat” Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013, 278-279.

³⁴ *Memorial of the Republic of Croatia*, Vol I, Case concerning the application of the connection on the prevention and punishment of the crime of genocide (Croatia v. Yugoslavia), International Court of Justice, March 2001, 37.

fillimin e vrapimit. intelektualët tonë na thonë të nisemi. kah? kah serbia e madhe, kuptohet. në luftë për realizimin e idealeve tona të larta”.³⁵ Akademiku Pavle Saviq, duke cekur se kishte në dispozicion 70 faqe tekst pa titull e nënshkrimesh, e cilësoi atë si një material që paraqet një konglomerat qëndrimesh heterogjene dhe të njëanshme, e që përmban karakteristika të pamfletit dhe materialit propagandistik, prandaj nuk mund t’i përshkruhen atributet shkencore.³⁶

Akademiku Vasa Çubriloqi u shpreh kundër që ASSHA të përzihet në politikën ditore, pasi që detyrë e saj janë hulumtimet shkencore e jo politika. Ai ishte konkret në kërkimin e përgjegjësisë, duke propozuar edhe shkarkimin e Këshillit të Akademisë.³⁷ Gjykimi i krimeve të luftës në hapësirat jugosllave bëri që pasojat e Memorandumit të studioheshin nga ekspertë dhe gjykatës së Tribunalit të Hagës. Prokurorët në Hagë dhe hetuesit e tyre vendosën tezën e njëanshme - Memorandumi i ASSHA është platformë ideore për “Serbinë e Madhe”, kurse dëshira për ta realizuar këtë qëllim është çelësi kryesor për rënien e Jugosllavisë.³⁸ Një konstatim të tillë e mbrojnë edhe gjykatësi i njohur hetues dhe avokati nga Serbia, Dragoljub Todoroviq, i cili shkruan se: “kur prej një periudhe pas 25 vitesh analizohet teksti i Memorandumit të ASSHA, vjen deri tek konkluzioni i bazuar se ky dokument përmban platformën kombëtare dhe serbomadhe për gjitha luftërat që i filloi në dekadën e fundit Slobodan Milosheviq”.³⁹

Kur Slobodan Millosheviq erdhi në pushtet më 1987, ai mori përsipër programin politik alternativ të paraqitur në draftin e Akademisë. Ai jo vetëm që vërtetoi diagnozën e draftit për zgjidhjen e problemit serb, por edhe i rekrutoi disa ish disidentë akademikë, që kishin qenë në komisionin e botimit. Kështu, filozofi neo-marksist Mihailo Markoviq dhe novelisti Antonije Isakoviq iu bashkuan (apo ribashkuan) Partisë Socialiste (ish komuniste) të Millosheviqit më 1990, kurse më 1992 novelisti Dobrica Qosiq pranoi postin e kryetarit të Jugosllavisë së sapo ishte shpallur nga parlamenti i dominuar nga ithtarët e Millosheviqit.⁴⁰

“Memorandumi” i ASSHA (SANU) i vitit 1986 padyshim që ishte produkt i programeve nacional-shoviniste serbe të shekullit XIX dhe të pjesës së parë të shekullit XX, përmes së cilit shpreheshin qëllimet për

³⁵ R. Dragović, *Memoradum SANU - tri decenijeposle...*

³⁶ *Политика*, 19 Децембар 1986, 7.

³⁷ Ibid.

³⁸ R. Dragović, *Memoradum SANU - tri decenijeposle...*

³⁹ Dizdarević, “Etnocentrički stavovi akademika Dobrice Ćosića”, 277

⁴⁰ Aleksandar Pavković, “The Serb National Idea: A Revoival 1986-1992”, *The Slavonic and East European Review*, Vol. 72, No. 3 (Jul. 1994), 446-447.

krijimin e një shteti të madh serb në kurriz të popujve tjerë të hapësirës ish jugosllave. Pra, Memorandumi ishte një udhëzues dhe inkurajues i përpjekjeve për rivendosjen e hegjemonisë serbe dhe të bashkimit të gjithë serbëve në një shtet që u manifestua me veprime politike që rezultuan me luftëra të përgjakshme në hapësirën jugosllave, gjenocidin dhe spastrimin etnik të kryer nga serbët kundër popujve tjerë me theks të veçantë kundër boshnjakëve dhe shqiptarëve.

Sedat KRYEZIU

SUMMARY

THE MEMORANDUM OF SERBIAN ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS, DRAFTED IN 1986 AND ITS IMPACT ON THE RESURRECTION OF SERB NATIONALISM

The death of Josip Broz Tito, the President of the Socialistic Federative Republic of Yugoslavia, was followed by reappearance of Serbian nationalism, which had remained silent for many years. This nationalism was elaborated and “scientifically legalized” in the Memorandum of Serbian Academy of Sciences and Arts, drafted in 1986.

This draft, of a nationalistic-chauvinistic content, summarized the intentions of Serbs on creating a Great Serbian state on the back of other people of former Yugoslavia. Thus, the Memorandum became a guide and a promoter of efforts to install the Serbian hegemony and to unite all Serbs in a single state; these efforts were followed by political actions that produced bloody wars, genocide and ethnical cleansing that Serbs committed against other ethnicities, particularly against Bosnian Muslims and Albanians.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

ELEMENTËT GJEOPOLITIKE DHE GJENOCIDI NË LUFTËRAT E FUNDIT TË ISH-JUGOSLLAVISË

Duke vënë në funksion një numër burimesh primare të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë në Hagë dhe burimeve sekondare të literaturës historiografike dhe juridike për çështjen e gjenocidit në përgjithësi, dhe gjenocidit në Jugosllavi në veçanti, punimi tenton të vendos një ligjeratë historiografik të zhvillimit të studimeve të gjenocidit dhe studimeve historike për gjenocidin dhe dhunën në masë. Duke përvetësuar një koncept tipologjik të dhunës kundër civilëve, punimi trajton format e ndryshme të dhunës siç janë ushtruar në Jugosllavi kundër civilëve, dhe njëkohësisht mundohet të vë analizën në ushtrimin e dhunës në masë dhe gjenocidit në kontekst të strategjive gjeopolitike për zgjerim territorial të shteteve të Ballkanit.

Si formë e institucionalizuar e strategjisë politike mund të argumentohet që gjeopolitika i ka rrënjët thellësisht në periudhën e imperializmit, që nga koha kur u shpik si term nga suedezi Rudolph Kjellen në vitin 1899.¹ Si koncept i referohet ambicieve për zotërim maksimal të një territori të caktuar në mënyrë që të zgjerojë kapacitetet për rritje ekonomike dhe rrjedhimisht përhapjes së influencës kulturore. Në këtë mënyrë, aspekti gjeografik i territoreve në të gjithë globin i nënshtrohen konjunkturave të zotërimit të territoreve gjeografike me rëndësi ekonomike, politike dhe strategjike, si pasojë e së cilës ndërtohet një rend global i fuqive të ndryshme. Nga këto mendime, dhe posaçërisht nisur nga parimet euro-centrike, lindin synimet për të okupuar territore të cilat jo vetëm mbajnë

¹ David Atkinson dhe Klaus Dodds, "Geopolitical traditions: a century of geopolitical thought," në *Geopolitical Traditions: Critical Histories of a Century of Political Thought* (2000), 1.

rëndësi ekonomike dhe deri diku politike në kuptimin që krijojnë hapësirë më të madhe për përhapjen e një populli siç është rasti me Lebensraum nga Friedrich Ratzel² gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe që mbajnë rëndësi kyçe në zgjerimin e sundimit dhe influencës së një aktori të caktuar. Këtë koncept Agnew e quan “territorialitet hapësinor” (spatial territoriality) dhe në këtë formë e ndërlihdh përkufizimin e saj me hapësira abstrakte të pushtetit të cilat përkthehen në territore gjeografike – dhe kështu në mënyrë të natyrshme apo të panatyrshme krijojnë hapësira gjeografike të unifikuara në shërbim të përjetësimit të mëtutjeshëm të fuqisë së aktorëve të caktuar.³ Rrjedhimisht, dimensionin gjeografik merr rëndësi parësore në vendosjen e këtyre politikave.⁴ Si koncept i modernitetit, kjo mënyrë e të vepruarit ndërlihdhet ngushtë me zgjerimin e shteteve Evropiane nga perëndimi në lindje⁵, rrjedhimisht me Fuqitë e Mëdha dhe zhvillimet diplomatike të tyre në proces të rindërtimit të sferave të fuqisë në dobi të interesave të tyre shtetërore, dhe përfundimisht me trashëgiminë e gjeopolitikës botërore në vendet udhëheqëse të Bashkimit Evropian.⁶

Për këtë arsye kur Kjellen erdhi me idenë në formë më të artikuluar, e konceptoi termin “heartland” të Evropës, që deduktuar nga kuptimi i fjalës ka të bëjë me “tokën qendrore” të një shteti që mund të jetë ose pararendëse e shtetit ekzistues ose mund të paraqesë një koncept abstrakt mbi atë që një shtet e percepton si njësi gjeografike thelbësore për identitetin e atij shteti (një rast që është evident në strategjinë gjeopolitike të shtetit të Serbisë në raport me Kosovën). Si shembull, për Gjermaninë kjo e paraqet regionin gjeografik dhe politik që njihet si Evropa Lindore.⁷ Siç kanë argumentuar edhe studiues të gjeopolitikës, vetë termi “heartland” mban konotacione

² Gertjan Dijkink, *National identity and geopolitical visions: Maps of pride and pain* (London: Routledge, 1996), 18.

³ John A. Agnew, *Geopolitics: Re-visioning world politics* (New York, N.Y.: Routledge, 2003), 51.

⁴ Michael Heffernan, “On the origins of European geopolitics, 1890-1920,” në *Geopolitical Traditions: Critical Histories of a Century of Political Thought*, ed. Klaus Dodds (2000), 28.

⁵ Gertjan Dijkink, *National identity and geopolitical visions: Maps of pride and pain* (London: Routledge, 1996), 19.

⁶ John A. Agnew, *Geopolitics: Re-visioning world politics* (New York, N.Y.: Routledge, 2003), 51. Përtëpërmbledhurmë mire konceptin e gjeopolitikës, Dijkink equanatë “gjeografiimagjinare”. Gertjan Dijkink, *National identity and geopolitical visions: Maps of pride and pain* (London: Routledge, 1996).

⁷ Siç argumenton Dijkink, kjo ‘krizë ekzistenciale’ e Gjermanisë rrjedhë nga pozita qendrore (Mittellage) që mban ajo në kontinent. Gertjan Dijkink, *National identity and geopolitical visions: Maps of pride and pain* (London: Routledge, 1996), 20.

evidente kolonialiste, dhe si e tillë nuk është e vështirë të ngrihen paralele me strategjitë gjeopolitike të zgjerimit të vendeve perëndimore gjatë shekullit të XX.

Madje prej këtyre strategjive gjeopolitike të vendosjes së sundimit dhe influencës, zgjerimit territorial dhe ekonomik në bazë të interesave shtetërore, buroi një fenomen i mizor i modernitetit – Holokausti.⁸ Si produkt i ambicieve të nazistëve për rindërtim të shoqërisë moderne gjermane, ata u vunë të ristrukturojnë linjat territoriale etnike evropiane, dhe të instrumentalizojnë sentimentet anti-semitike që mbretëronin në shoqëritë evropiane⁹, në mënyrë që të përqendrojnë dhe të përhapin fuqinë në një hapësirë gjeografike që paraqet ndërlidhje të mira gjeografike për zgjerim të mëtutjeshëm të fuqisë, gjë që mund të kuptohet si nxitës parësor i strategjive gjeopolitike. Për nazistët, kjo ishte Evropa Lindore – dhe sipas një bisede të Hitlerit, koncepti i krijimit të Lebensraum nuk ishte aq sa për të vendosur kufij arbitrar gjeografik, sa ishte edhe për të shkatërruar plotësisht “armikun e tyre” në mënyrë që të shmanget çdo mundësi për hakmarrje dhe rrezikim të fuqisë së akumuluar të nazistëve.¹⁰

Ngjashëm mund të tërheqim paralele edhe për strategjinë gjeopolitike të Italisë fashiste në zgjerimin territorial, të cilin ata e quanin “spazio vitale”.¹¹ Këto ide nuk ishin të pazakonta as për fuqi të tjera botërore. Në SHBA, Alfred Thayer Mahan promovoi fuqishëm një politikë të zgjerimit territorial, imperialiste nga natyra, në mënyrë që SHBA të mund të luftonte për dominim global me fuqitë evropiane kolonialiste të kohës së re.¹² Por këto vizione gjeopolitike të zgjerimit territorial përmes spastrimit

⁸ Zygmunt Bauman, *Modernity and the Holocaust* (Ithaca, N.Y.: Cornell University Press, 1989).

⁹ Götz Aly, *Europa gegen die Juden* (Frankfurt am Main: S. Fischer, 2017).

¹⁰ David Atkinson and Klaus Dodds, “Geopolitical traditions: a century of geopolitical thought,” në *Geopolitical Traditions: Critical Histories of a Century of Political Thought* (2000), 2. Norman M. Naimark, *Genocide: A world history* (New York: Oxford University Press, 2017), 76. Fjalimi i Hitlerit në këtë kontekst paraqet një rëndësi të posaçme për studimet e gjenocidit, sepse sipas të dhënave historike, fjalimi vazhdon më tutje: ‘...pse kush kujtohet sot për armenianët?’, gjë që i jep kuptim më të zgjeruar strategjive gjeopolitike të gjenocidit kur kemi parasysh edhe gjenocidin armenian të viteve 1915-1916 të cilët u dëbuan nga turqit në shkretëtirat e Sirisë. Robert N. Proctor, *Racial hygiene: Medicine under the Nazis* (Cambridge (Massachusetts); London: Harvard University Press, 2002), 48.

¹¹ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 72.

¹² John A. Agnew, *Geopolitics: Re-visioning world politics* (New York, N.Y.: Routledge, 2003), 68.

të popullit armik ishin të pranishme edhe te Habsburgët, të cilët zgjerimin në drejtim të Evropës Lindore dhe spastrimin e popullit sllav, e mbiquanin “Drang nach Osten”.¹³ Kjo strategji më vonë u ndërlidh nga disa historianë apolegjistikë me hasmëritë ekzistuese ndër boshnjakët, kroatët dhe serbët, këtë duke ia atribuar ndarjen kufitare ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Perandorisë Osmane.¹⁴

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe realitetin e ri politik të krijuar, ushtruesit e fuqisë ndryshuan në relacion me krijimin e Bllokut Lindor, në të cilin rast “heartland” i Evropës u përfshi në anën e sovjetikëve. Ky ripërkufizim i kufijve kulturor dhe ideologjik krijoi edhe anomalinë e Gjermanisë Lindore brenda kontekstit evropian. Lufta e Ftohtë dhe armiqësitë e trashëguara nga kjo patën ndikim thelbësor në përpilimin e vizioneve gjeopolitike të Evropës Juglindore në veçanti si pasojë e pozitës gjeografike të shteteve që ndodhen brenda këtij entiteti nominativ.

Jugosllavia si pjesë e Bllokut Lindor fillimisht, dhe më vonë si shtet “socialist liberal” që bënte pjesë në Grupin e të “Painkuadruarve”¹⁵, u shndërrua në fushëbetejë ideologjike të të dy kampeve respektive të Luftës së Ftohtë. Hasmëritë e brendshme ekzistuese ndër-etnike dhe ndërtimi i një shoqërie jo-egalitare¹⁶ ku diskriminimi bëhej në bazë klasore dhe kombëtare, e dobësuan edhe më tutje atë, gjë që përfundimisht solli shpërbërjen e saj. Megjithë kompleksitetit të faktorëve që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe rolit të ndikimit ekonomik dhe politik nga të dy blloqet me fuqi globale, e një interesi të posaçëm paraqitet konjunktura e gjenocidit (dhe gjegjësisht spastrimit etnik) dhe gjeopolitikat lokale dhe globale në raport me dhunën si instrument i cytjes së interesave gjegjëse. Në këtë kuptim, lëvizjet në masë të popullsive të cytura nga aktorë të fuqishëm mbajnë pozitë qendrore në strategjitë gjeopolitike të shekullit të XX, e posaçërisht gjatë periudhës së fundit të këtij shekulli. Si rrjedhojë,

¹³ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 41.

¹⁴ Michael Mann, *The Dark Side of Democracy: Explaining Ethnic Cleansing* (New York: Cambridge University Press, 2005), 358.

¹⁵ Tvrtko Jakovina, “It’s Either Tito or the Soviet Aparatchik,” në *Revolutionary Totalitarianism, Pragmatic Socialism, Transition*, eds. Gorana Ognjenović dhe Jasna Jozelić (London: Palgrave Macmillan UK, 2016), 99–137, 108.

¹⁶ Në rrethana ku Serbia ishte e para ndër të barabartët, siç shprehët Ingrao. Shih Charles Ingrao, “Confronting the Yugoslav Controversies,” *The American Historical Review* (October 2009), 114: 4, 947–962, 948.

mund të konceptohet fare lehtë se çfarë roli mbartte gjenocidi si strategji gjeopolitike e vendeve të Evropës Juglindore në fundin e shekullit të XX.¹⁷

Në këtë kontekst, punimi i shtjellon disa aspekte të spastrimit etnik dhe gjenocidit si instrumente për zgjerimin e territorit të një aktori në fuqi brenda kornizave të strategjive gjeopolitike të Evropës Juglindore. Ky këndvështrim aplikohet në dy drejtime kryesore: zbatimi i politikave shfarosëse si mjet i krijimit të “Lebensraum” gjatë fundit të shekullit të XX përmes luftërave në Ballkan, dhe akuzat pasuese për gjenocid (dhe përkufizimet rrjedhëse për fenomenin e gjenocidit) si refleksion i gjeopolitikës bashkëkohore evropiane për sundim diplomatik. Analiza merr karakter të esesë diskursive dhe për bazë ka burime parësore (të dhënat nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë në Hagë), shtypin e periudhës së luftërave të fundit në ish-Jugosllavi, dhe ato dytësore duke përfshirë literaturën përkatëse, kështu duke ndjekur elementin e gjenocidit dhe politikave gjenocidale brenda kontekstit të strategjive gjeopolitike.

Gjenocidi dhe gjeopolitika në Ballkan

Studimet për gjenocid zënë fill me veprën e Rafael Lemkin, të titulluar *Axis Rule in Occupied Europe*, ku për herë të parë e përdori termin gjenocid¹⁸. Gjenocidi si koncept buron nga dëbimi i armenianëve prej Turqisë në 1915, ku vdiqën më shumë se 1.5 milion njerëz.¹⁹ Sot, kjo njihet si gjenocidi armenian, të cilin qeveria turke akoma nuk e njeh si gjenocid. Në botëkuptim historik, gjenocidi nënkupton krim në masë, që shkaktohet deri në atë pikë sa një grup i tërë etnik ose fetar është i kërcënuar me shfarosje. Si koncept ligjor, gjenocidi shfaqet pas vitin 1945, pas Tribunalit të Nurembergut, ku shtetarët gjermanë u gjykuan për krime në masë kundë hebrenjve, romëve dhe grupeve të tjera të shtypura. Ligji në vetvete nuk u përpilua deri në 1948, kur dhe u bë Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit e aprovuar nga Asambleja e

¹⁷ Një ndërlidhmëri shumë interesante me gjeopolitiken kolonialiste amerikane dhe luftën në Kolombi e shtjelloi Andrei Gomez-Suarez, “A genocidal geopolitical conjuncture: Contextualising the destruction of the Union Patriótica in Colombia (1980s-2010)” (University of Sussex, March 2011).

¹⁸ Mohamed Adhikari, Cathie Carmichael, Adam Jones, Shruti Kapila, Norman Naimark, dhe Eric D. Weitz, “Genocide and Global and/or World History,” *Journal of Genocide Research* (October 2017), 1–20, 2.

¹⁹ Kjo shifër kundërshtohet nga qeveria turke. Për më tepër shih <http://www.mfa.gov.tr/the-armenian-allegation-of-genocide-the-issue-and-the-facts.en.mfa>

Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara²⁰. Sot, krimi i gjenocidit ndëshkohet ndërkombëtarisht, ku në raste të tilla krijohen tribunale të veçanta për gjykimin dhe ndëshkimin e gjenocidit, siç është Tribunali Ndërkombëtar për krime të luftës në Ruandë dhe Tribunali Ndërkombëtar për krime lufte në ish-Jugosllavi me seli në Hagë.²¹

Holokausti, ose gjenocidi i hebrenjve, në literaturën e gjenocidit, me të drejtë konsiderohet si krimi më i madh i luftës që ndeshet me parimet e të drejtave të njeriut, i shkaktuar në shekullin XX. Si pasojë, shumë studiues e marrin si pikënisje për përcaktim të asaj se çfarë mund të konsiderohet gjenocid e çfarë jo. Kjo premisë është ndeshur me kundërshtime por edhe me përkrahje nga studiues të ndryshëm. Stephen Katz është ndër studiuesit më prominent që argumenton se Holokausti është i vetmi krim i luftës që mund të konsiderohet gjenocid, ndërkaq të tjerat - si gjenocidi armenian, e ai i Ruandës - mund të cilësohen si dhunë në masë.²² Argumenti që ky i fundit parashton, është i bazuar në dy elemente kryesore: në numrin e hebrenjve të shfarosur gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në mënyrën sesi janë shfarosur ata. Sipas Katz, planifikimi i detajshëm i kampeve të përqendrimit dhe shfarosjes është tregues i qartë i një plani të shfarosjes së plotë të hebrenjve. Ky rast, sipas tij, nuk është vërejtur te gjenocidi armenian apo ai i Ruandës. Dhuna në masë në studimet e gjenocidit përdoret si term tipologjik për të përshkruar dhunën që për nga natyra është gjenocidale që udhëheqet nga qëllimi për të shfarosur një numër masiv të civilëve të papërfshirë në luftë-pra të ketë qenë dhunë e qëllimshme dhe e planifikuar.²³

Studiues të tjerë, si Vahakn Dadrian, janë të mendimit se gjenocidi armenian është i pari krim i luftës që përputhet plotësisht me përkufizimin e Lemkinit, dhe megjithëse përmasat e vrasjes së armenianëve nuk ishin të përmasave të Holokaustit, ai argumenton se përqindja e vrasjeve nuk duhet të jetë kallëzues vendimtar i gjenocidit, veçanërisht në atë rast kur qëllimi për shfarosje totale është vërtetuar.²⁴ Studiues të tjerë si Jacques Semelin,

²⁰ Norbert Ehrenfreund, *The Nuremberg Legacy: How the Nazi War Crimes Trials Changed the Course of History* (New York: Palgrave Macmillan, 2007), 124.

²¹ International Criminal Tribunal for Rwanda me shkurtesën ICTR dhe, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia me shkurtesën ICTY

²² Stephen T. Katz, "The Uniqueness of the Holocaust: The Historical Dimension," në *Is the Holocaust Unique? Perspectives on Comparative Genocide*, ed. Adam Rosenbaum (Boulder: Westview Press Inc., 1996).

²³ Benjamin A. Valentino, *Final Solutions: Mass Killing and Genocide in the Twentieth Century* (Ithaca, N.Y.: Cornell University Press, 2004), 10.

²⁴ Vahakn Dadrian, "The Comparative Aspect of Armenian and Jewish Cases of Genocide," në *Is the Holocaust unique? Perspectives on Comparative Genocide*, ed. Alan

argumentojnë fuqishëm se ekziston një dallim shumë i zbehtë mes gjenocidit dhe masakrave në luftë. Sipas tij, çdo formë e vrasjes së civilëve është akt i masakrës, gjë që vetvetiu e bën atë gjenocidale.²⁵ William Schabas në anën tjetër argumenton se përkufizimi i gjenocidit në aspektin studimor nuk duhet të jetë i kufizuar me atë ligjor, ngaqë ky i fundit jep parametra tepër të ngushtë nëpërmes të cilave mund të akuzohen individë të caktuar. Sipas kësaj, përkufizimi ligjor nuk është treguesi kryesor i gjenocidit.²⁶

Rastet e tjera të krimeve në masë si gjenocidi kundër Hererove dhe Namave gjatë 1904 deri në 1907 në Namibinë e sotme, nuk janë procesuar ligjërisht asnjëherë si raste gjenocidale, por qeveria gjermane ka kërkuar falje botërisht për këto krime. Përderisa konventa përmban pikë shumë të qarta rreth asaj se çka mund të konsiderohet gjenocid, shpesh baza juridike e ligjeve ndërkombëtare ka hapësirë për argumentim të dyanshëm. Rasti i luftës në Bosnje është një shembull tipik për ilustrim të ndërlikueshmërisë së ligjeve dhe se si kjo ndikon në formimin e një vendimi. Përderisa lufta në tërësi nuk është njohur si gjenocid, por luftë civile, masakra e Srebernicës është njohur si gjenocid dhe për këtë është ngarkuar me akuzë për kryerjen dhe ndihmën në kryerje të gjenocidit dhe është shpallur fajtor Radislav Kërstiqi.²⁷

Ndërkaq, si bashkëpuntorë në kryerjen e gjenocidit janë shpallur nga Tribunali i krimeve të luftës në ish-Jugosllavi edhe Ljubisha Beara, Ljubomir Borovqanini, Vujadin Popoviqi e të tjerë. Përderisa i pari, Kërstiqi, është akuzuar dhe shpallur fajtor për krime të luftës në lidhje me gjenocid, të tjerët janë akuzuar dhe shpallur fajtorë si pjesëmarrës në kryerjen e gjenocidit apo organizimin dhe planifikim e gjenocidit, por jo drejtëpërdrejtë si dorasë të gjenocidit. Në anën tjetër, edhe Ratko Mlladiqi ishte gjykuar për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve të luftës, duke u akuzuar për 11 krime në tërësi. Është për t'u shënuar fakti që Mlladiqit, megjithëse emër i njohur për popullatën e gjërë në krah të të bëmave të tij kriminale, nuk i filloi procesi gjyqësor deri në vitin 2011. Vendimi përfundimtar i marrë në vitin 2017 e shpalli fajtor për 10 akuza,

S. Rosenbaum (Boulder, 1996), 101–136.

²⁵ Jacques Semélin, "The Political Uses of Massacres and Genocide," në *Genocide*, ed. Dirk A. Moses (London ; New York: Routledge, 2010), 286–336.

²⁶ William Schabas, "Drafting of the Convention and Subsequent Normative Developments," në *Genocide*, ed. Dirk A. Moses (London ; New York: Routledge, 2010), 54–105.

²⁷ ICTY, Krstic Case, Judgement, 2.8.01. Shih dhe <http://www.icty.org/specials/srebrenica20/index.html>

ndërkaq e liroi Mlladiqin nga akuza për gjenocid.²⁸ Kjo situatë ilustron në pika shumë të qarta se si mund të trajtohet gjenocidi si krim, dhe se si gjykohën rastet e tilla nga ligjet ndërkombëtare dhe kombëtare. Përderisa Tribunali ka pasur në shërbim dëshmitë dhe fuqinë ligjore për të persekutuar kriminelë për aktin e gjenocidit, Dhoma e Drejtësisë së Bosnjës, e cila merret gjithashtu me lëndët e krimeve të luftës, nuk e bën këtë.

Në 1997 Gjyqi i Qarkut i Dusseldorfit e shpalli fajtor Nikolla Jorgiqin për kryerjen e gjenocidit në rajonin e Dobojit në vitin 1992, por ky i fundit e kundërshtoi aktvendimin duke i dërguar në Gjyqin Evropian për të Drejta të Njeriut në bazë të përkufizimit të gjërë të gjenocidit, dhe se gjyqi gjerman nuk e kishte përdorur përkufizimin ndërkombëtar të saj, gjë të cilën gjyqi ia kundërshtoi.²⁹

Përpunimi i lëndëve për krimin e gjenocidit kërkon mbi të gjitha sasi shumë të madhe të dëshmive për të vërtetuar qëllimin për të kryer gjenocid. Për të vërtetuar qëllimin për kryerjen e gjenocidit, në rend të parë, duhet të jenë në disponim si dëshmi transkriptet, dëshmi vizuale apo audio të individëve duke pranuar këtë qëllim, dhe meqë kjo është pothuajse e pamundur, kjo shkakton ngecje thelbësore në aspektin ligjor, prandaj dhe nuk shohim shpesh që të akuzuarit për krime kundër njerëzimit të shpallën fajtorë për kryerjen e gjenocidit.³⁰ Prandaj, raste të tilla si Darfuri i sotëm, Sudani i vitit 1998, lufta e Bosnjës, dhe lufta e Kosovës nuk konsiderohen ligjërisht gjenocide. Në një klimë të tillë globale gjeopolitike, rasiti i Kongos së sotme, as që merret parasysh të jetë gjenocid, pavarësisht se njihet si luftë civile e cila deri më tash ka marrë jetën e rreth 5.8 milion njerëzve që nga viti 1998. Në lidhje me këtë zhvillim të ngjarjeve, shumë studies e konsiderojnë si dështim i akterëve ndërkombëtarë për vëzhgimin dhe parandalimin e gjenocidit, sepse siç argumenton Helen Fein, nuk duhet të pritët deri në momentin kur vritet 30% e popullatës që të ketë ndërhyrje ndërkombëtare.³¹ Studiuesit rëndom i referohen luftërave në ish-Jugosllavi gjatë viteve '90 si spastrim etnik ose etnocid.³²

²⁸ ITCY, Mladic Case, IT- 09-92. Shih <http://www.icty.org/case/mladic/4>.

²⁹ Marko Attila Hoare, *Genocide and resistance in Hitler's Bosnia : the Partisans and the Chetniks, 1941-1943* (Oxford; New York: Published for the British Academy by Oxford University Press, 2006), 82.

³⁰ Përmëtepër shih Clauss Kress, "The Crime of Genocide under International Law," *International Criminal Law Review* (2006), 461–502.

³¹ Në referencë me vrasjen e 30% tëpopullatës hebreje së gjithë botës gjatë Holokaustit.

³² Për më tepër shih Michael Mann, *The Dark Side of Democracy: Explaining Ethnic Cleansing* (New York: Cambridge University Press, 2005). Mann argumenton se spastrimi etnik rëndom është plan i dytësor në rast se arrihet përfundimi se kryesi i krimit nuk o ka

Kategoria e parë e spastrimit etnik konsiderohet dëbimi i dhunshëm i të gjithë anëtarëve të një grupi prej një krahine apo territori të caktuar nga një grup tjetër etnik. Ky veprim nënkupton edhe rastet kur të dhunuar janë një numër i madh i njerëzve por edhe në të kundërtën, kur ky numër është i kufizuar. Fokusi kryesor te spastrimi etnik qëndron të dëbimi i njerëzve. Sipas ligjit të vitit 1949 të Konventës për Gjenocide, spastrimi etnik konsiderohet si krim i ndërlidhur me gjenocidin.

Kategoria e dytë e spastrimit etnik përfshin vrasjet në masë, ku në shumë raste shifra e viktimave shkonte deri në mijëra. Në këto raste, grupet etnike të viktimizuara, nën pretekstin e dëbimit, janë grumbulluar dhe janë vrarë. Taktikë identike e spastrimit etnik është përdorur dhe në Kosovë.³³ Në rrethana të tilla, është vështirë të argumentohet se dhuna që i është shkaktuar viktimave nuk është gjenocidale, pavarësisht se konflikti në tërësi nuk konsiderohet gjenocid. Meqë premisa kryesore për klasifikim të gjenocidit, të cilën Tribunali i Hages po e zbaton në mënyrë rigorozë në bazë të statutit të tij, është vrasja e të gjithë meshkujve, femrave dhe fëmijëve të grupit etnik, atëherë ky krim mbetet t'i nënshtrohet përkufizimeve jo-fleksibile ligjore, të cilat përfundimisht nuk janë tregues i mirë i kontekstit kohor, social dhe politik në të cilin është kryer krimi.

Luftërat e ish-Jugosllavisë – çështje të strategjive gjeopolitike të dhunës në masë

Në një artikull të quajtur *The Geopolitics of the Balkans* të botuar në vitin 1946, Joseph Roucek bën një analizë të Ballkanit, t përmes asaj që sot njihet si argumenti primordialist. Kjo quhet ashtu sepse ai e shpjegon luftën për pushtet ndërmjet popujve të Ballkanit si pjesë e pandalshme e historisë së dhunshme të popujve ballkanas, të cilët gjithherë ishin në hasmëri njëri me tjetrin. Përmes një narrative të shkurtër historike, ai argumenton që strategjia gjeopolitike e secilit vend të Evropës Juglindore është thelbësisht mbisundimi mbi territorin tjetër, dhe përvetësimin eventual të të gjithë territorit të Ballkanit në hegjemoninë e njërit apo tjetrit popull/shtet. Sado arkaik qoftë argumenti që përdor ky punim, ai e parashtrohet një argument që është përdorur jo rrallë herë në shpjegimin e strategjive gjeopolitike të Ballkanit edhe për luftërat e fundit të shekullit të XX. Roucek e përmend në këtë relacion edhe çështjen e protëgë-ve të Fuqive të Madhe, ku e

kapacitet ushtarake për të kryer gjenocid.

³³ Për më tepër shih Josef Martinsen, *What happened in Kosovo? 1998-1999: a documentation*; Josef Martinsen, *Kosovo: The wells of death*.

përshkruan që secili shtet i kanalizonte interesat e saja gjeopolitike (globale) përmes ushtrimit të influencës në shtetin e caktuar.³⁴

Përkundër historisë së gjatë të luftërave ndërmjet veti gjatë shekullit të XX, rasti i luftërave në Jugosllavinë e viteve '90 është i atillë që i liron autorët e krimeve të luftës nga akuza e gjenocidit, pikërisht ngaqë nuk është dëshmuar qëllimi për viktimizim të të gjithë popullatës. Si rezultat Tribunali i Hages po i riformëson dhe precizon më tej përcaktimet e spastrimit etnik dhe gjenocidit, duke theksuar dallimin ndërmjet këtyre të dyjave.³⁵ Nën dritën e historikut të akuzuave dhe vendimeve, shumë studies po risipërfaqësojnë argumentin se përkufizimet ligjore të Konventës së Gjenocideve duhet të ndryshohen që të përputhën me natyrën e krimeve të luftës pas Luftës së Dytë Botërore.

Çështja më e ndërlikuar e luftërave në ish-Jugosllavi qëndron të fakti që shpërbërja e shtetit ishte shumë e dhunshme, ku secili aktor kërkonte zgjerime territoriale në krah të popujve të tjerë të Jugosllavisë, me përjashtim të Kosovës dhe Bosnje Hercegovinës. Kroatët njëjtë si serbët synonin përfshirjen e Bosnjës dhe Hercegovinës në territorin e tyre, madje të tilla plane ishin bërë edhe ndërmjet Franjo Tugjmanit dhe Slobodan Millosheviqit që nga marsi i vitit 1990. Ambiciet e tyre ishin tipike etno-nacionaliste, gjë që ishte një sentiment jo rrallë i gjendur edhe te popullatat gjegjëse.

Këto qasje u vënë në veprim edhe me aksionet e bandave nacionaliste, posaçërisht atyre serbe, që i sulmonin civilët.³⁶ Ambiciet gjeopolitike të Serbisë në raport me Bosnjën ishin artikulluar nga Jovan Cvijiq në 1908 me shkrimin "Aneksimi i Bosnje-Hercegovinës dhe çështja serbe", ku Bosnjën e kishte përshkruar si qendra e një shteti të zgjeruar serb dhe duket se një politikë e tillë kishte vazhduar gjatë shkatërrimit të Jugosllavisë.³⁷ Një gjendje e tillë i shtyu boshnjakët, të paktën sipas Mojzesit, që të formësojnë një identitet më të fuqishëm mysliman në

³⁴ Joseph S. Roucek, "The Geopolitics of the Balkans," *The American Journal of Economics and Sociology* (1946), 5: 3, 365–377, 371.

³⁵ Updated Statute of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (as amended 7 July 2009 by Resoluton 1877). http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_en.pdf

³⁶ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 164.

³⁷ David Bruce MacDonald, *Balkan holocausts?: Serbian and Croatian victim-centred propaganda and the war in Yugoslavia (New Approaches to Conflict Analysis)* (Manchester University Press, 2002), 221.

mënyrë që të krijojnë ndjesi të unitetit kombëtar. Ky transformim ishte i gjithanshëm gjatë periudhës 1991-1995.³⁸

Konflikti i përgjithshëm u pararend nga lufta në Kroaci që filloi në vitin 1991. Territori kroat ishte pjesë e Jugosllavisë e cila sipas kroatëve administrohej vetëm nga serbët. Kroatët në përgjithësi dëshironin ndarjen e Kroacisë nga Serbia, si dhe shpalljen e pavarësisë, prandaj ata e cilësuan lutën kundër Serbisë, si “Lufta për Atdheun”. Pavarësia u shpall në bazë të referendumit të mbajtur më 19 maj 1991, ku 94.17 përqind të popullatës votuan për pavarësi (referendumi u bojkotua nga serbët). Ndërkaq, pavarësia formalisht u shpall më 25 korrik, gjatë së cilës periudhë një e katërta e territorit kroat ishte nën administrimin serb.³⁹ Luftimet në Kroaci qenë të ashpra me disa fronte të hapura që përfunduan zyrtarisht në vitin 1995.

Lufta në Kroaci, shumë ngjashëm me ato tjerat në ish-Jugosllavi, ndërlidhet ngushtë me koncepte gjeopolitike zgjeruese. Lufta e vitit 1991-1995 në Kroaci njihet si luftë çlirimtare, dhe në këtë kuptim ajo është nisur për të marrë nën vete territore të Jugosllavisë një pjesë e së cilës popullatë ishte kroate.

Shumë prej këtyre nismave të viteve të '90 kishin ndërlidhje me ambiciet gjeopolitike të Ustashëve dhe shumë shpejtë u tentua të krijohet një ngjashmëri e politikave po edhe e simboleve si me atë të Shtetit të Pavarur të Kroacisë. Pikërisht sepse kishte një ndërlidhje të tillë që jehonte veprat e Ustashëve, serbët i akuzuan kroatët për tentativa të gjenocidit ndaj serbëve në Kroaci, në këtë formë duke e përfshirë elementin e gjenocidit si casi bellum për luftë ndaj kroatëve.⁴⁰ Është e një interesi të vihet re që të njëjtën akuzë e kishin përdorur serbët ndaj shqiptarëve në vitin 1986, të cilët i akuzonin shqiptarët që po kryenin gjenocid ndaj popullatës serbe në Kosovë dhe Kroaci.⁴¹ Këtë argument e zgjeron edhe Mirković, por ai vjen me një përfundim më të balancuar kur thekson që ringjallja e ‘ustashëve’ u has me reaksion të ringjalljes së ‘çetnikëve’.⁴² Dhuna gjatë luftës në Kroaci

³⁸ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 165.

³⁹ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 152.

⁴⁰ Paul Mojzes, *Balkan genocides* (Lanham Plymouth, UK: Rowman & Littlefield Publishers, Inc, 2011), 158.

⁴¹ Enver Hoxhaj, “Das Memorandum der Serbischen Akademie der Wissenschaften und Künste und die Funktion politischer Mythologie im kosovarischen Konflikt,” *Südosteuropa* (2002), 51: 10–12, 494–526.

⁴² Damir Mirkovic, “The historical link between the Ustasha genocide and the Croato-Serb civil war,” *Journal of Genocide Research* (November 2000), 2: 3, 363–373, 265.

nuk ishte e njëanshme meqëspastrimi etnik i kroatëve ishte vegël edhe e serbëve, siç është rasti me qytetin e Vukovarit, të cilin e spastruan që nga momenti që vendosen kontroll të plotë aty në nëntor të vitit 1991.⁴³

Në anën tjetër, shpallja e pavarësisë së Bosnjës më 6 prill 1992 e shënoi edhe fillimin zyrtar të luftës. Kjo u arrit përmes një referendumi, ku boshnjakët dhe kroatët votuan në numër të madh për shkëputjen nga Jugosllavia. Serbët e bojkotuan këtë referendum, dhe si kundërpërgjigje organizuan një referendum, që e mbiquanin plebishit, ku votuan për mbetjen e Bosnjës nën Jugosllavi. Serbët e Bosnjës dhe Hercegovinës nën udhëheqje të Radovan Karagjiqit shpallën luftë ndaj boshnjakëve duke i spastruar ata nga Bosnja.

Sa i përket luftës në Bosnje, në relacion me akuzat për gjenocid, vetëm rasti i Srebrenicës konsiderohet si gjenocid.⁴⁴ Kjo sepse nga 6 deri më 13 korrik të vitit 1995, forcat serbe hynë në Srebrenicë dhe masakruan rreth 8000 civilë. Kjo masakër u kry pavarësisht faktit që trupat holandeze të Kombeve të Bashkuara ndodheshin në vend, dhe mandati i tyre i ndalonte ata që të ndërhynin.⁴⁵

Ndryshe nga vendet e tjera të Jugosllavisë, situata në Kosovë u përkeqësua në mënyrë graduale që nga viti 1989 me heqjen e autonomisë të Kosovës nga ana e Serbisë. Me nisjen e aksioneve të spastrimit ndaj civilëve, fillojnë të shfaqen edhe brengat e para në opinion ndërkombëtar për rrezikun që mbartte kjo politike në raport me popullatën shqiptare. Në dhjetor të 1998 Huttenbachu shkruan për Kosovën, duke e cilësuar atë si “gjenocid në kryerje e sipër”.⁴⁶ Megjithatë, deri në qershor të 1999 qëndrimi i Huttenbachut ndryshon, kështu duke e cilësuar rastin e Kosovës si gjenocid. Për më tepër ai kritikon Ellie Wiesel, sipas të cilit Kosova është “gjenocid në kryerje e sipër” por jo “gjenocid”.⁴⁷ Të tjerë zëra, si ai i Zbigniew Brzezinski⁴⁸ e quajnë rastin e Kosovës një “mini-gjenocid”, gjë që hasi në kundërshtim të theksuar te studiues të fushës.⁴⁹

⁴³ Emir Suljagic, *Ethnic cleansing: politics, policy, violence: Serb ethnic cleansing campaign in former Yugoslavia* (Baden-Baden: Nomos, 2010), 263.

⁴⁴ <https://www.irmct.org/specials/srebrenica20/>

⁴⁵ Margit V. Wunsch Gaarmann, *The war in our backyard: The Bosnia and Kosovo wars through the lens of the German print media* (Berlin: Neofelis Verlag, 2015), 39.

⁴⁶ Henry R. Huttenbach, “The Clinton Apology - Much too Little, Much Too Late,” *The Genocide Forum* (1998), 5: 2, 7.

⁴⁷ Henry R. Huttenbach, “Hedging and Fudging about Genocide in Kosovo and Elsewhere: Wiesel et al.,” *The Genocide Forum* (1999), 5: 6, 4–5.

⁴⁸ Zbigniew Brzezinski, *Washington Post*, March 30

⁴⁹ Henry R. Huttenbach, “Hedging and Fudging about Genocide in Kosovo and Elsewhere:

Më 1999, rasti i Kosovës filloi të merrte vëmendje ndërkombëtare, shpeshherë duke u shtjelluar si rast precedent ku aktorët ndërkombëtarë do të ndërhyjnë në çështje që atëbotë konsideroheshin si problem i brendshëm i Jugosllavisë. Kjo për arsye që NATO kishte vendosur të ndërhynte në mënyrë që të ndalonte gjenocidin ndaj shqiptarëve.⁵⁰ Një nismë e tillë ishte kritikuar nga zërat e atëhershëm, duke e trajtuar intervenimin si kolonialist nga natyra dhe më tutje duke mos e arsyetuar bombardimin e Serbisë në bazë të asaj që po sulmoheshin civilët e pafajshëm. Më vonë, politikanët evropianë u akuzuan që e kishin përdorur termin “gjenocid” pa vend në mënyrë që të çonin përpara interesat e tyre politike në lidhje me gjeopolitikën botërore.⁵¹ Aristotel Kallis formuloi një diskurs empirik rreth ndërhyrjes ushtarake nga ana e ndërkombëtarëve në Kosovë, nën arsyetimin e natyrës shfarosëse të dhunës së ushtruar ndaj shqiptarëve. Sipas tij, heqja e statusit të autonomisë së Kosovës, nuk paraqiste një lëndë juridike që Jugosllavia duhej ta shtjellonte me mekanizmat e brendshme shtetërore,⁵² por ilustronte shtypjen sistematike të qeverisë serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilëve njëkohësisht po i mohohej e drejta për vetëvendosje.⁵³

Elementi i gjenocidit si fenomen që arsyeton qëllimin përfundimtar politik nuk është i pazakontë në historinë botërore. Izraeli, si shembull, e bazon shtetësinë e tij te Holokausti, madje duke tentuar të justifikojë edhe natyrën ofensive të politikave të saja në raport me Palestinën. Si për Holokaustin, edhe Bangladeshi e kishte përdorur arsyetimin e gjenocidit për të shpallur pavarësinë. Grodsky ofron argument të ngjashëm edhe për Kosovën për të cilën thotë se e ka përdorur “akuzën për gjenocid” si arsye për t’u ndarë (secesionuar) nga Serbia.⁵⁴ Në këtë pikë vlen të theksohet se

Wiesel et al.,” *The Genocide Forum* (1999), 5: 6, 4.

⁵⁰ Paul Bartrop, “The relationship between war and genocide in the twentieth century,” *Journal of Genocide Research* (December 2002), 4: 4, 519–532, 532.

⁵¹ Për këtë u akuzua në media edhe Rudolf Scharping, atëherë Ministri gjerman i Mbrojtjes. Për gjermanët ky intervenim ishte posaçërisht i pazakontë sepse po shënonte herën e parë që kishin marrë pjesë në luftë aktive që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Margit V. Wunsch Gaarmann, *The war in our backyard: The Bosnia and Kosovo wars through the lens of the German print media* (Berlin: Neofelis Verlag, 2015), 13.

⁵² PërstatusinjuridiktëKosovësnëKushtetutën e Jugosllavisë shihGazmendZajmi, “Kosova’s constitutional position in the former Yugoslavia,” në*Kosovo - Kosova, Confrontation or Coexistence* (Enschede: Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996), 95–103.

⁵³ Aristotle A. Kallis, “Eliminationist crimes, State Sovereignty and International Intervention: The Case of Kosovo,” *Journal of Genocide Research* (1999), 1: 3, 417–437.

⁵⁴ Brian Grodsky, “When two ambiguities collide,” *Journal of Genocide Research* (March 2012), 14: 1, 1–27, 4, 16.

termi “secesionim” që duket të jetë i pranishëm në shumicën e literaturës që e trajton këtë çështje, është gjithashtu i gabueshëm ngaqë e injoron një pjesë të mirë të historisë së Kosovës, dhe në këtë formë e përvetëson ligjërimin serb për historinë e Kosovës duke e konsideruar atë si territor thelbësisht serb.⁵⁵

Elementi i politikës ndërkombëtare kundër gjenocidit në Kosovë u përdor në dy forma kryesore: e para kishte të bënte me parandalimin eventuale të gjenocidit në mënyrë që mos të përsëriteshin ngjarjet e Bosnjës, dhe e dyta kishte të bënte me promovimin e një strategjie gjeopolitike euro-atlantike të dominimit mbi Ballkan. E para ishte e natyrës humanitare, dhe gjithsesi e vlefshme po të shikohet nga ky aspekt.⁵⁶ Kjo dëshmohet edhe nga reagimet në qarqet politike të Gjermanisë, ku Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë kishte deklaruar se ajo çfarë po ngjan në Kosovë është gjenocid.⁵⁷ Kjo deklaratë kishte prekur edhe me ndjenjat e gjermanëve sa i përket përgjegjësisë kolektive për parandalimin e gjenocidit, në një formë si barrë e faktit që ata kishin qenë kryesit e Holokaustit. Në këtë kontekst, përfshirja e Gjermanisë në luftën e Kosovës kishte karakter politik, ngaqë ishte hera e parë që Gjermania po përfshihej në një zonë lufte që nga Lufta e Dytë Botërore, dhe se këtë po e bënte me arsyetimin se po parandalonin gjenocid.

Një qëndrim kritik ndaj këtij arsyetimi, dhe rolin që e patën mediat gjermane për të bindur opinionin e përgjithshëm se përfshirja e Gjermanisë në luftën e Kosovës ishte çështje e moralit kolektiv, e merr Wunsch-Gaarman.⁵⁸ Qëndrimi i saj kritik megjithatë rrjedh nga fakti se ajo përqendrohet vetëm në shtypin gjerman, dhe duket se i ka dhënë fare pak kohë interpretimit të kontekstit historik të luftës së Kosovës, gjë që i jep një ngjyrim subjektiv trajtesës që e bën. Megjithatë, Wunsch-Gaarman nuk është ndër të parët që e shikon intervenimin e NATO-s në Kosovë si një dhunim kolonialist mbi Serbinë. Ndër të parët që ishte më i zëshëm për këtë çështje ishte Parenti. Në librin e tij *To kill a nation*, ai akuzon udhëheqësinë

⁵⁵ Një trajtesë interesante të kësaj problematike e bëjnë autoret Lene Kuehle dhe Carsten Bagge Laustsen në kapitullin “The Kosovo Myth: Nationalism and Revenge,” në librin *Kosovo between War and Peace: Nationalism, Peacebuilding and International Trusteeship* (Taylor & Francis, 2006).

⁵⁶ Në këtë aspekt mund të veçohet fjalimi i presidentit të atëhershëm të SHBA, Bill Clinton. Qasur në <http://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/03/25/clinton.transcript/>

⁵⁷ Margit V. Wunsch Gaarmann, *The war in our backyard: The Bosnia and Kosovo wars through the lens of the German print media* (Berlin: Neofelis Verlag, 2015), 39.

⁵⁸ Margit V. Wunsch Gaarmann, *The war in our backyard: The Bosnia and Kosovo wars through the lens of the German print media* (Berlin: Neofelis Verlag, 2015).

e SHBA për shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, dhe përdorimin e akuzës për gjenocid si formë për të shkatërruar Jugosllavinë dhe për ta futur atë nën ndikim global amerikan, më tutje duke e zgjeruar argumentin se ky akt është pjesë e strategjisë më të gjërë amerikane për të vendosur dominimin global.⁵⁹

Argumenti që parashtrohet Parenti është problematik ngaqë burimet i ka pothuajse plotësisht të pasakta, dhe shpeshherë teksti degradon në teori kryekëput konspirative. Kjo është problematike për faktin që përdor argumentin e strategjive gjeopolitike të SHBA brenda kornizave analitike shumë të dobëta që e bëjnë të vështirë të mirret seriozisht autori. Përkundër kësaj, këtë argument e shohim të përhapur si trend posaçërisht si formë e propagandës ruse, strategjitë gjeopolitike të së cilës kanë mbetur shumë të ngjashme që nga Lufta e Ftohtë. Një argument shumë të ngjashëm e shohim të ripërsëritur në 2008 edhe nga Wolfgram, i cili e trajton luftën e NATO-s kundër Serbisë të orkestruar përmes propagandës në atë formë që të bindë opinionin e gjerë se po bënte intervenim humanitar.⁶⁰

Në këtë kontekst, e shohim të përhapur edhe çështjen e gjeopolitikës dhe ndërlidhjen që kanë strategjitë gjeopolitike me gjenocidin kur bëhet fjalë për Ballkanin, vend i cili në formë të ngadalshme u shndërrua në “heartland” gjeostrategjik të forcave garuese botërore në fund të shekullit të XX. Të gjitha këto vështrime duket se marrin qasje tejet subjektive dhe cinike kur është fjala për çështje të intervenimit humanitar dhe duket se i shërbejnë një ligjërimi të përgatitur paraprakisht më shumë se sa që i shërbejnë historisë faktike. Në këtë kuptim, duhet të shohim që edhe këto kritika janë produkt i rrethanave politike dhe kohës nga të cilat ato burojnë.

Qasje të kundërt nga argumentet e parashtruara më sipër kanë shprehur Olson, Fielding, Burkhalter dhe Cassel kur e shpjegojnë që ndërhyrja për parandalimin dhe ndalimin e krimeve kundër njerëzimit arsyetohet në çdo situatë, pavarësisht se a është fjala për gjenocid apo jo. Në këtë kuptim, ata i referohen drejtëpërdrejtë teorive konspirative që duket se kishin filluar të shpërfaqëshin qysh në 1994, atëherë kur u përpilua ky raport.⁶¹

⁵⁹ Michael Parenti, *To kill a nation: The attack on Yugoslavia* (London ; New York: Verso Books, 2002).

⁶⁰ Mark A. Wolfgram, “Democracy and Propaganda,” *European Journal of Communication* (June 2008), 23: 2, 153–171, 160.

⁶¹ Jane Olson, Lois Fielding, Holly Burkhalter, dhe Douglas Cassel Jr., *Bosnia, War Crimes, and Humanitarian Intervention* (Notre Dame Law School, 1994), 446.

Një argument të përafërt ofron edhe Atilla Hoare, i cili i trajton këto argumente mbi “imperializmin perëndimor për të shkatërruar serbët” si teori konspirative që nuk bazohen në fakte për të kryer analizë mirëfilli të situatës në luftërat e ish-Jugosllavisë.⁶²

Si përfundim e shohim që në rastin e Evropës Juglindore roli i përdorimit të akuzës së gjenocidit kishte qenë i shumëfishtë. Së pari akuzat për kryerje të gjenocidit u lëshuan nga serbët, të cilët këto akuza i përdorën për të justifikuar dhunën në masë si instrument për zgjerim territorial në drejtim të tokave perëndimore, jug-perëndimore dhe jugore të Jugosllavisë. Më vonë, e shohim që nën pretekstin e ngjashëm të dhunës në masë dhe gjenocidit, identiteti kombëtar boshnjak u forcua gjithë që shërbeu për krijimin e forcave mbrojtëse karshi sulmeve të armatës jugosllave dhe trupave të pavarura serbe, ngjashëm sikur trupave të pavarura kroate.

Në anën tjetër, roli i përdorimit të akuzës së gjenocidit nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë dhe politikat e Millosheviqit në raport me Kosovën, kishin qenë të atilla që kishte mobilizuar masat serbe për krijimin e një diskursi të urrejtjes ndër-etnike mes shqiptarëve dhe serbëve, në këtë formë duke e justifikuar një luftë që ishte rrënjësisht ofensive si luftë defensive që kryhej për mbrojtjen e territorit të Kosovës si pjesë integrale e Serbisë.⁶³ Të njëjtat justifikime janë përdorur edhe në raport me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës [UÇK] kur serbët po e akuzonin UÇK se ishte grup terrorist dhe se po kryente krime kundër njerëzimit të popullata civile serbe.⁶⁴

Ndërkaq, në nivel ndërkombëtar elementin e gjenocidit e shohim të përdorur si pretekst për ndërhyrje në zgjidhjen e konflikteve në Evropën Juglindore për të parandaluar krime kundër njerëzimit. Kjo ndërhyrje hasi në kritika të ashpra nga opinioni perëndimor, ngaqë e konsideronin këtë si pjesë të strategjisë gjeopolitike të SHBA dhe Gjermanisë, specifikisht për të siguruar dominim mbi Evropën Juglindore. Kjo qasje mund të perceptohet si problematike shikuar nga këndvështrimi i përkufizimit të gjenocidit, i cili të paktën ligjërisht, është shumë strikt. Mbi të gjitha, përkufizimi i gjenocidit si një debat që vazhdon të jetë i hapur duket të jetë

⁶² Marko Atilla Hoare, “A Case study in Underachievement: The International Courts and Genocide in Bosnia-Herzegovina,” *Genocide Studies and Prevention: An International Journal*, 6: 1, 83.

⁶³ David Bruce MacDonald, *Balkan holocausts?: Serbian and Croatian victim-centred propaganda and the war in Yugoslavia (New Approaches to Conflict Analysis)* (Manchester University Press, 2002), 64–65.

⁶⁴ Mark A. Wolfgram, “Democracy and Propaganda,” *European Journal of Communication* (June 2008), 23: 2, 153–171, 160.

evidente se ka shërbyer si justifikim ligjor për të çuar përpara politika të caktuara të strategjive gjeopolitike por dhe njëkohësisht si mjet veprimi për të vënë në jetë strategjitë gjeopolitike për zgjerim territorial.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

SUMMARY

GEOPOLITICAL ELEMENTS AND GENOCIDE IN THE YUGOSLAV WARS

Through employing various historical sources, both primary and secondary, the paper aims to present a historical review of the development of geopolitical thought and its stance towards genocide within the Balkan states. The paper specifically looks into how concepts of mass violence, ethnic cleansing and genocidal violence were part of expansionist strategies within the Balkan states. It provides a historiographical narrative of genocidal actions on behalf of the perpetrators, but also a narrative of the Yugoslav wars and the socio-political context in which they occurred. By analyzing the way through which the wars broke out, the paper also looks into how the crime of genocide is conceptualized as a crime against humanity and how the perpetrators are subsequently convicted in international trials. By doing this, the paper also points out the disparity in defining genocide when it comes to historical studies and genocide studies as opposed to the definition provided by a legal framework, thus stressing the possible connotations that this may have had for employing genocide as a geopolitical tool in the region.

KUD: 323.1(=18:496.51) (081) "1998/1999"
355.3(=18:496.51) (081)

Miftar KURTI

ZONA OPERATIVE E SHALËS NË SHTYPIN E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË (1998-1999)

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte e shtrirë në gjithë Kosovën. Struktura e UÇK-së përbëhej nga Shtabi i Përgjithshëm dhe 7 zona operative.¹ Zona Operative e Shalës, e formuar më 28 qershor 1998, ishte njëra nga zonat operative. Komandant i saj ka qenë Rahman Rama. Shtrihej në Komunat e Mitrovicës, Vushtrrisë, Leposaviçit dhe Zubin Potokut. Kufizohej me Zonën Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Llapit. Përbëhej nga dy brigada: Brigada 141 “Mehë Uka” dhe Brigada 142. Brigada 141 përbëhej nga katër batalione, Njësia Speciale dhe Njësia për Intervenime të Shpejta, kurse Brigada 142 kishte dy batalione dhe Njësine Speciale. ZOSH-i ishte e strukturuar në brigada, batalione, kompani, togje, skuadra deri në grup. Kishte rreth 2 500 ushtarë. Luftimet, betejat më të ashpra janë zhvilluar kryesisht në fshatrat Pantinë, Ashlandhe në fshatrat tjera rrëzë Qyqavicës, por edhe në Mazhiq, Melenicë, Kaçanoll, Pasomë...etj.

Veprimet e saj luftarake kanë zënë një hapësirë të konsiderueshme në shtypin e kohës: Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mali i Zi, Gjermani, Britani, SHBA etj. Në fokus të këtij punimi janë veprimet luftarake të UÇK-së kundër forcave të policisë dhe ushtrisë jugosllave dhe mënyra se si ato veprime janë paraqitur në shtypin shqiptar në Kosovë dhe Shqipëri.

Për luftën e UÇK-së në Zonën Operative të Shalës janë shkruar dhe botuar qindra artikuj nëpër gazeta dhe revista në gjuhën shqipe. Për veprimtarinë e saj kanë shkruar këto gazeta e revista: *Bujku, Kosova sot, Koha ditore, Rilindja, Bota e re, Kombi, Gazeta shqiptare, Ushtria, Revista ushtarake, Zëri i popullit, Rilindja demokratike* etj. Janë botuar lajme,

¹Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëllimi 3, Toena, Tiranë, 2009, f.2829.

kronika, reportazhe, kumtesa, raporte të këshillave, organizatave, institucioneve vendore dhe të huaja; intervista, opinione, deklarata; analiza, komente etj. Për aq sa kemi ne informata veprimet luftarake të ZOSH-it, janë të pranishme në shtypin shqiptar nga muaji qershor i vitit 1998 deri në përfundim të luftës në qershor 1999 dhe janë botuar diku rreth 300 artikuj në faqet e këtyre gazetave dhe revistave.

Epopeja e UÇK-së në Prekaz (5-7 mars 1998), në Gllogjan (22 mars 1998), pastaj Beteja e Bardhit (Bellaqevcit) etj., u kanë paraprirë shumë aksioneve, sulmeve, betejave dhe veprimeve tjera luftarake të UÇK-së në gjithë Kosovën, pra edhe në ZOSH. Beteja e Bardhit ka zënë hapësirë të konsiderueshme në shtypin shqiptar të kohës, kurse jehona e saj kishte kaluar kufijtë e Kosovës. Në vazhdim po shkëpusim fragmente nga artikujt e botuar në shtypin e kohës.

Më 23.06.1998, në një mëngjes të hershëm kur njerëzit dolën për të shkuar në punë e kush për obligime të tjera, u pa tërë mrekullia e asaj që njerëzit shushurisnin ditë më parë e që ishte një gjë e pamundur për të gjithë banorët e kësaj ane. Mrekullia e kësaj ëndrre u pa në realitet me të lindur dielli i ditës 23 qershorit, ku njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin vendosur postbllokun e tyre vetëm disa dhjetëra metra larg kazermës ushtarake jugosllave në Sllatinë, që supozohet të jetë njëra ndër kazermat më të mëdha në Kosovë. Ata kishin vënë nën kontroll Mihjen sipërfaqësore "Kosova" të Bardhit të Madh dhe disa fshatra përreth Fushë-Kosovës. Marrja e kësaj ane ishte bërë vetëm brenda një nate dhe atë pa rezistencën më të vogël të policisë ushtarake serbe²... Tri ditë më pas, qysh në orën 6 të mëngjesit, zinxhirët e mbi 100 tankeve, autobllindave, mjeteve të tjera motorike zgjuan nga gjumi banorët e fshatrave të Fushë-Kosovës, të cilat u vendosën në pishat e Sllatinës së Madhe dhe bënë një përforcim në kazermën ushtarake të Pomozotinit.³

Nga artikujt e tjerë të gazetave që flasin për këtë betejë kuptojmë se forcat jugosllave vetëm brenda një dite kishin futur në lëvizje kundër UÇK-së 74 tanke, 72 automjete transportuese, 2 ambulanca, 8 autobusë përplot ushtarë. Gjatë luftimeve numri i forcave jugosllave do të arrijë diku 5000 ushtarë, kurse vija e frontit ishte e gjatë diku rreth 20km. Me këtë betejë praktikisht UÇK iu kishte afruar Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës diku 7-8 km. Forcat jugosllave kishin pësuar humbje të konsiderueshme, ndryshe

² Mrikë Krasniqi, *Marrja e kësaj ane ishte bërë vetëm Brenda një nate dhe pa rezistencën më të vogël të policisë ushtarake serbe*, Gazeta shqiptare, 30 qershor 1998, f. 16

³ Vjollca..., *As paqe, as luftë!*, Bota e re, 21 korrik 1998, f. 12.

nga ato të UÇK-së që nuk kishin pasur asnjë të vrarë as të plagosur.⁴ Një nga të veçantat e kësaj beteje, sipas shtypit, ishte fakti se UÇK me këtë synonte ta detyronte faktorin ndërkombëtar të lëvizë, ta kthejë kokën e të shohë çfarë po ndodh në Kosovë. Sepse lufta në Kosovë ishte e pashmangshme, se luftimet ndërmjet UÇK-së dhe forcave të okupatorit po zhvilloheshin vetëm pak kilometra larg kryeqytetit.⁵ UÇK me këtë rast duket se e kishte arritur qëllimin, ngase ajo betejë pati bërë bujë të madhe edhe në media të huaja. Nuk ishte e rastit, prandaj, se me të do të merret edhe Agjencia REUTERS. Korrespondenti i kësaj Agjencie prestigjioze, Kurt Schrok, nga vendi i ngjarjes raportonte kështu:

*Kryengritësit etnikë shqiptarë kanë futur në dorë Mihjen sipërfaqësore në perëndim të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, ndërsa janë duke u kryer patrullime ditore me armë në duar m'u në pjesën nga i cili vend syri mund të shoh qartë kryeqendrën. Kontrollin e minierës dhe fshatrave Bellaqevc, Grabovc dhe Hade e ka marrë UÇK-ja të hënën.*⁶

Kur flasim për këtë betejë nuk mund të thuhet se kjo betejë u zhvillua vetëm në zonën e përgjegjësisë të një zone operative, sepse atëherë ende nuk ishin përcaktuar as “kufijtë” e nënzoneve dhe zonave operative. Mirëpo, kjo i parapriu edhe betejave të tjera të ZOSH-it.

Një betejë tjetër e zhvilluar në qershor në zonën e përgjegjësisë të Nënzonës Operative të Shalës (NZOSH) është edhe Beteja e Pantinës. Beteja në fjalë ishte imponuar si rezultat i provokimeve dhe tentimeve të forcave serbe që të hynin në fshatin shqiptar në Pantinë. Fshatarët e Pantinës, në bashkëpunim me forcat e UÇK-së ishin mobilizuar për t'iu kundërvënë forcave serbe, të cilat ishin s'mbrapsur. Në këtë ballafaqim ishin plagosur dy shqiptarë.⁷ Fshatrat shqiptare (Pantinë e Okrashticë-M.K.) ishin sulmuar me autoblanda dhe tanke nga tri drejtime: afërsi e fshatit Pantinë, fshatit Liqej dhe nga hyrja e Akrashticës.⁸ Granatimet e këtyre dy fshatrave do të vazhdojnë disa ditë nga forcat jugosllave nga dy drejtime: Frashëri dhe Taraxha.⁹ Në gazeta të ndryshme të kohës janë botuar edhe artikuj të tjerë ku raportohej për “luftime në Kosovë që nga brezi kufitar e deri në Shalë të Bajgorës,¹⁰ për rezistencë të fortë të luftëtarëve të UÇK-së

⁴ Bujku, 24, 26, 29 dhe 30 qershor 1998; Haqif Mulliqi, *Njeriu nuk u lind për vete, por për Atdheun*, Reportazh, Kombi, 21 dhjetor 1998, f.14, 15; Koha ditore, 24, 26 qershor 1998.

⁵ Koha ditore, 24, 26 qershor 1998.

⁶ Po aty.

⁷ Bujku, 26 qershor 1998.

⁸ Bujku, 26, 27 qershor 1998.

⁹ Kombi, 25 nëntor 1998; Bujku, 29 qershor 1998.

¹⁰ Bujku, 13 korrik 1998.

për rreth Minierës “Trepça” në Stantërg, te Ura e Fazlisë, në fshatin Mazhiq, në Trepçali; për vendosje të postblloqeve në Tunelin e Parë dhe në Trepçë, por edhe për zhvendosje të popullatës nga lagjet dhe fshatrat për rreth Minierës “Trepça” si pasojë e luftimeve; për sulme kundër njësiteve të UÇK-së dhe popullatës shqiptare me artileri të forcave jugosllave nga Kazerma Ushtarake në Kutllovc, nga Kodra e Zherovnicës dhe nga Baza Ushtarake në Bajskësi dhe për përforcime të vazhdueshme të forcave ushtarake e policore me njësite dhe armatim etj.¹¹

Krahas luftimeve (në muajin korrik) rreth Minierës “Trepça” (në fshatrat Mazhiq, Melenicë etj.) përgjatë muajit gusht 1998 luftimet kthehen edhe në fshatin Pantinë. Beteja e Pantinës është dëshmi se luftimet shkojnë duke u zgjeruar dhe intensifikuar. Sepse, që nga mëngjesi i 6 gushtit 1998, forca të mëdha ushtarake dhe policore lëviznin nga dy drejtime (nga fshati Frashër dhe Vushtrria) duke sulmuar njësitet e UÇK-së atje. Pantina, do të granatohet me shumë predha nga topa të kalibrit 155mm dhe me mitraloza të rëndë. Për pasojë do të vritet Jeton Tërrstena dhe do të plagosen Ferki Aliu dhe Basri Sejdiu, Xhemajl Mehmeti e Xhevat Mehmetiqë ishin pjesë e Njësiteve të UÇK-së të NZOSH.¹² Artikujt e gazetave njoftojnë edhe për luftime tjera gjatë muajit gusht edhe në fshatrat e rajonit të Shalës së Bajgorës, me këtë rast gazetatat britanike “Dejli Telegraf” dhe “The Independent” shkruajnë se “Kryengritja në Kosovë ishte gjallë”.¹³

Ndërkohë që gazeta “Rilindja”, 22 gusht 1998, duke ju referuar gazetës serbe “Blic”, qysh në muajin gusht, do të paralajmëroi një ofensivë shfarosëse në rajonin e Shalës dhe Qyqavicës, e cila ndodhi në muajin shtator për të cilën të janë botuar dhjetëra artikuj.¹⁴ Artikujt ofrojnë të dhëna edhe për “Ofensivën” e forcave jugosllave në pjesën e dytë të muajit shtator 1998 kundër njësiteve të UÇK-së dhe popullsisë shqiptare në fshatrat e Shalës së Bajgorës dhe Llapit; për sulme të pareshtura me tanke mbi fshatrat: Kutllovc, Mazhiq, Melenicë, Rahovë, Rashan, Tërrstenë, Bare, Zjaçë; për vazhdimin e luftimeve në trekëndëshin Mitrovicë-Vushtrri-Podujevë; për djegie brenda një dite të dhjetëra fshatrave në këtë rajon dhe për dhjetëra policë dhe ushtarë serbë të vrarë etj.¹⁵ Gazetat raportojnë edhe për faktin se si nga Dobratini (Llapi-M.K.) granatohej Shala; se si çdo gjë i

¹¹ Ushtria, 15, 22 korrik 1998; Bujku, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 22, 23, 28, 29 dhe 30 korrik 1998.

¹² Bujku, 7 gusht 1998; Gazeta shqiptare, 8 shtator 1998.

¹³ Bujku, 6, 12 dhe 19 gusht 1998.

¹⁴ Rilindja, 22 gusht 1998.

¹⁵ Koha ditore, 6, 9, 10, 11, 12, 15, 16, 17, 18 dhe 19 shtator 1998; Gazeta shqiptare, 3 nëntor 1998; Bota e re, 23 shtator dhe 1 tetor 1998.

nënshtrohej tymit e flakës dhe se çdo gjë rrafshohej me tokë; se si për një pasdite shumë shtëpi ishin shndërruar në gërmadha; se si forcat serbe kishin shkatërruar fshatra të tëra,¹⁶ etj. Kësaj ofensive të policisë dhe ushtrisë serbo-malaziasë me mijëra trupa dhe artileri të rëndë po i kundërpërgjigjej me të gjitha forcat UÇK me njësitet e saj. Dëshmi për këtë është Komunikata nr.54 e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, botuar te “Bota e re”. Në atë komunikatë ndër të tjera thuhet: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës në nënzonat e Shalës dhe Llapit, prej 15 deri më 18 shtator është përballur me ofensivën e armikut, përbërë nga mijëra ushtarë e policë serbë, por edhe nga mercenarë rusë e rumunë, me mbi 250 tanke e mjete të tjera të armatosura dhe artileri të rëndë.*¹⁷ Kurse, sipas Komunikatës nr.55 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, *lufta e popullit tonë po futej në fazën e sigurt të ballafaqimit përfundimtar me armikun shekullor.*¹⁸

Në rajonin e Shalës së Bajgorës armiku kishte angazhuar një korpus ushtarësh e mercenarësh të ndryshëm rusë, rumunë etj.¹⁹ Megjithatë, *ushtarët e efektivit të Mazhiqit me muaj të tërë para kësaj ofensive, stoikisht ishin përballur me sulmet e pandërprera të armikut, duke qëndruar përherë nën predhat e granatahdhësve, tankeve e të artilerisë nga pozicionet serbe. Ashtu ishte edhe në vijat e tjera të frontit si në Melenicë, Rahovë, Pasomë e sektorët e tjerë. Rajoni i Shalës ishte i rrethuar dhe sulmuar nga Mitrovica, Podujeva, Vushtrria, Zherovnica etj. Në këtë ofensivë ishin angazhuar mbi 420 automjete të blinduara, mbi 180 tanke, si dhe mjete të tjera, si autoblanda, praga etj. Është parë që armiku kishte ngarkuar dy kamionë me ushtarët e tyre të vrarë. Humbje kanë pasur edhe në Kaçanoll, ku është rezistuar në bashkëveprim me njësitet e Zonës së Llapit. Njësitet e UÇK-së kanë arritur ta evakujnë e të ruajnë edhe popullatën civile, megjithatë armiku, duke përdorur arsenalin e madh të armatimit, kishte shkatërruar fshatra të tëra. Armiku ishte përpjekur ta fshinte nga faqja e dheut UÇK-në, mirëpo këtë nuk e kishte arritur.*²⁰

¹⁶ Kosova sot, 11, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 21 shtator 1998.

¹⁷ Kosova sot, 22 shtator 1998.

¹⁸ Bota e re, 1 tetor 1998.

¹⁹ Izedin Krasning, *Është thirrja e atdheut që duhet të jetë mbi të gjitha* (Intervistë me Zymer Halimin (Komandant Besin), zëvendëskomandant i Brigadës 141 “Mehë Uka” të ZOSH, Kombi, 21 dhjetor 1988, f. 30.

²⁰ Izedin Krasning, *Është thirrja e atdheut që duhet të jetë mbi të gjitha* (Intervistë me Zymer Halimin (Komandant Besin), zëvendëskomandant i Brigadës 141 “Mehë Uka” të ZOSH, Kombi, 21 dhjetor 1988, f. 30.

Gjatë Ofensivës së 15-18 Shtatorit në Shalë të Bajgorës, sipas shtypit, ishin vrarë 11 ushtarë dhe civilë shqiptarë, 3 ishin plagosur dhe 3 ishin zhdukur; 19 mijë banorë ishin zhvendosur nga shtëpia e tyre, 4 shkolla ishin shkatërruar, fshatra të tëra ishin djegur etj.²¹ Megjithatë, numri i të vrarëve dhe të plagosurve civilë e ushtarë ishte më i madh se sa raportohet në shtypin e kohës.²²

Një ofensivë e përmasave të njëjta si në Shalën e Bajgorës ishte ndërmarrë edhe në rajonin e Qyqavicës që nga 22 shtatori, e cila zgjatidisa ditë dhe për të cilën raportohet në të përditshmet shqiptare.²³ *“Djegje të fshatrave Vërnice, Vaganice, Pirç dhe Ashlan”, “Tragjedi njerëzore në fshatrat rreth Qyqavicës”,* etj. janë vetëm disa nga titujt e gazetave të kohës.

Nëse i referohemi shtypit, si pasojë e kësaj ofensive në rajonin e Qyqavicës do të mbesin të vrarë 12 shqiptarë dhe 8 tjerë do të plagosen, shumë të vdekur kishin mbetur brigjeve të Sitnicës. Vetëm në Komunën e Vushtrrisë, në ofensivë ishin përfshirë 62 për qind e fshatrave, 37 fshatra ishin boshatisur nga popullata, e cila ishte përndjekur nga ofensiva e forcave jugosllave. Ishin granatuar 18 fshatra, kurse ishin djegur pothuajse tërësisht fshatrat: Gllavotin, Zhilivodë, Bivolak, Beçuk, Pantinë, Pasomë, Dubovc, Gurabardh, Taraxhë, Liqej, Balincë, Okrashticë dhe Shtitaricë. Komesarja e Lartë e OKB-së, Sodaka Ogata, pas një vizite që kishte bërë kishte folur për një tragjedi njerëzore në fshatrat për rreth Qyqavicës.²⁴

*Forcat jugosllave në këtë ofensivë kishin vrarë dhjetëra shqiptarë, kurse rreth 350 civilë ishin burgosur, diku 30 mijë civilë ishin zhvendosur nga fshatrat e Vushtrrisë dhe Qyqavicës, etj.*²⁵ *Thjesht, kishim të bënim me një ofensivë të organizuar të ushtrisë serbe dhe të shumë mercenarëve në radhët e saj; ofensivë në të cilën morën pjesë diku 400 tanke, rreth 250 transportierë, autobllinda, praga etj., si dhe një korpus ushtarak.*²⁶ *Mirëpo, ishim të organizuar ushtarakisht dhe të stërvitur, kështu që ia dolëm të bëjmë një rezistencë të paparë, duke i shkaktuar dëme të mëdha armikut si në teknikë ashtu edhe në njerëz dhe ta evakuojmë popullatën e Shalës dhe*

²¹ Kosova sot, 22 shtator 1998.

²² Miftar Kurti, *Brigada 141 “Mehë Uka” e ZOSH*, Punim Masteri, Universiteti i Prishtinës, 2013.

²³ Kosova sot, 23 shtator 1998.

²⁴ Kosova sot, 23, 24, 26, 28 shtator 1998.

²⁵ Koha ditore, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 shtator 1998.

²⁶ Haqif Mulliqi, *Unë jetoj për Zotin dhe për t'i vrarë armiqtë e shqiptarëve* (Intervistë me Mensur Kosumin-zëvendëskomandant i ZOSH, Kombi, 28 tetor 1998, f. 38

*Qyqavicës duke e grumbulluar në një vend dhe duke i krijuar vetës hapësirë që të përballemi me armikun dhe të luftojmë me të fyt për fyt.*²⁷

Rezistencë e madhe ishte bërë në anën e Zhilivodës, Beçukut dhe nga ana e Oshlanit në rajonin e Qyqavicës.²⁸ Ofensiva (në Qyqavicë-M.K.) kishte zgjatur tri ditë e tri net. Shkiet granatonin edhe natën. Luftimet ishin zhvilluar në afërsi 100-150 metra, prandaj armikut iu pamundësua edhe përdorimi i dikurshëm i artilerisë së rëndë kundër UÇK-së.²⁹ Vukovari (Kroaci-M.K.) ishte lojë fëmijësh karshi asaj që u pa në Shalën e Bajgorës.³⁰

Se barbarizmi i forcave jugosllave kundër civilëve shqiptarë gjatë Ofensivës së shtatorit ishte i papërshtueshëm më së miri flet kjo dëshmi (deklaratë) e një gruaje shqiptare nga fshati Kçanoll, e cila kishte mbijetuar gjatë ofensivës në Shalën e Bajgorës: “...Unë ia vura re babait mirë litarin në dorë. Atëherë e kam vënë re aty afër një gisht të vogël të dorës së babait... Ata gjatë gjithë natës se lume e kishin pas masakruar kufomën e tij. Dorën e djathtë prej bërrylit e poshtë nuk e kishte fare, ndërsa edhe tjetrës ia kishin prerë pëllëmbën. Egërsisht”.³¹

Pas luftimeve që zhvillonte aso kohe UÇK-ja në Kosovë, pra edhe në zonën e përgjegjësisë të ZOSH, shkrimtari i madh shqiptar, Ismail Kadare, në një intervistë dhënë shtypit të kohës, duke folur për Kosovën flet edhe për UÇK-në dhe veprimet e saj, do të shprehet: “Shfaqja e UÇK-së nuk është shenjë e flijimit të Kosovës, por të rilindjes së saj”.³² Kurse poeti dhe profesori Agim Vinca, duke folur për rolin dhe rëndësinë e Protestës së 1 tetorit 1997, për UÇK-në dhe luftën e saj do të shprehet:

UÇK e ringjalli moralin dhe krenarinë e nëpërkëmbur të popullit dhe rinisë liridashëse të Kosovës, e zhveshi në masë të madhe, por jo përfundimisht, farsën tragjikomike të një klani mashtrues e manipulues politik dhe angazhimin e tij fals për kinse pavarësinë e Kosovës dhe, së fundi (e që mund të jetë me rëndësi të dorës së parë), e ktheu vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe të opinionit demokratik botëror kah Kosova

²⁷ Haqif Mulliqi, *Unë jetoj për Zotin dhe për t'i vrarë armiqtë e shqiptarëve* (Intervistë me Mensur Kosumin-zëvendëskomandant i ZOSH, Kombi, 28 tetor 1998, f. 38

²⁸ Haqif Mulliqi, *Unë jetoj për Zotin dhe për t'i vrarë armiqtë e shqiptarëve...*, f. 38

²⁹ Haqif Mulliqi, *O prite, prite, se asnjë të gjallë s'do ta lëshojmë*, Bisedë me luftëtaren e lirisë, Dritë Simnica, Kombi, 25 nëntor 1998.

³⁰ Haqif Mulliqi, *Shumë shkie mbetën të vrarë, ndërsa të tjerët ia mbathën si të pa kokë*, Reportazh nga Llapi dhe Shala e Bajgorës, Kombi, 27 shtator 1998, f. 10; Izedin Krasniqi, *Asgjë nuk mund ta shuajë qëndresën shqiptare*, Reportazh nëpër fshatrat e Shalës së Bajgorës, Kombi, 28 tetor 1998, f.35.

³¹ Safet Zeneli, *Terrori serb mbi shqiptarët*, Rrëfim, Kombi, 25 nëntor 1998, f.29.

³² Gazeta shqiptare, 8 shtator 1998.

dhe çështja e saj e pazgjidhur, e cila tani, në këta muajt e fundit, falë rezistencës së armatosur të bijve të denjë të Kosovës dhe sakrificave të shumta të popullit të saj, ka arritur shkallën më të lartë të ndërkombëtarizimit, duke iu afruar kështu zgjidhjes së saj përfundimtare.³³

Të gjitha djegiet masive, krimet dhe masakrat e ndryshme, forcat serbe i kryen në interes të arritjes të të vetmit qëllim të tyre strategjik - asgjësimin e UÇK-së, duke lënë atë pa prapavijë (logjistikë). Mirëpo, serbët i bënë hesapet pa hanxhiun, do të shprehet aso kohe analisti dhe ushtaraku shqiptar, Shpëtim Golemi (Dilaver Goxhai), në *Revistën ushtarake* nr.2, tetor 1998.³⁴ Ushtaraku Golemi vjen në përfundim se gjatë ofensivës korrik-shtator 1998, Forcat e Armatosura të Serbisë, policia e saj dhe forcat paramilitare mundën që t'i impononin UÇK-së vullnetin e vet në formën e luftimeve, por jo ta asgjësonin atë, pavarësisht se Serbia i përdori të gjitha llojet e armëve me forcë e sasi të madhe.³⁵ Veprimet luftarake në zonën e përgjegjësisë të ZOSH janë të pranishme në faqet e shtypit edhe në vitin 1999, madje duke filluar nga ditët e para të javës së parë të muajit janar. Aty ka zënë hapësirë edhe vrasja në pritë në fshatin Smrekonicë (Komuna e Vushtrisë), më 3 janar 1999, e ndihmëskomandantit për Logjistikë në Zonën Operative të Shalës, Xhevat Jusufi dhe plagosja e Zymer Halimit-zëvendëskomandant i Brigadës 141 "Mehë Uka" të ZOSH.³⁶

Një ngjarje tjetër që ka zënë hapësirë të konsiderueshme, duke u shndërruar madje në top lajm në faqet e shtypit në Kosovë e Shqipëri, është ajo që ka të bëjë me zënien rob të 8 ushtarakëve të UJ-së nga njësitet e UÇK-së të ZOSH, më datë 8 janar 1999, dhe arritja e marrëveshjes (13 janar 1999) për shkëmbimin e robërve të luftës. Me këtë rast qenë shkëmbyer 9 ushtarë të UÇK-së me 8 ushtarakë serbo-malazias. Se sa është shkruar e thënë në media të shkruara për ngjarjen kemi folur më gjerësisht në kapitullin *Lufta e drejtë dhe e pastër e UÇK-së-shkëmbimi i robërve të luftës*³⁷ dhe *Këmbimi i robërve të luftës në ZOSH sipas shtypit të kohës*.³⁸ Megjithatë, mendoj se është me interes të dihet se për zënien rob dhe arritjen e marrëveshjes mes UÇK-së dhe UJ-së me ndërmjetësimin e OSBE-së kanë shkruar "Koha ditore", "Kosova sot", "Rilindja", "Bota e re", "Kosova Press", "Zëri i

³³ Bota e re, 1 tetor 1998.

³⁴ Shpëtim Golemi, *Rruga më çoi në radhët e UÇK-së...*, f.128.

³⁵ Revista ushtarake, nr.2, tetor 1998.

³⁶ *Kosova sot*, 5 janar 1999; "Koha ditore", 5 janar 1999; "Zëri i popullit", 5 janar 1999; "Ushtria", 6 janar 1999; *Pobjeda*, 5. Januar 1999.

³⁷ Miftar Kurti, *Vrojtime historike*, Faik Konica, Prishtinë, 2017.

³⁸ Miftar Kurti, *Këmbimi i robërve të luftës në ZOSH sipas shtypit të kohës* Punim seminari, Studimet e Doktoratës, mars 2018.

popullit”, “Ushtria”, etj. Vetëm për këtë ngjarje janë shkruar diku rreth 60 artikuj në shtypin shqiptar në Kosovë dhe Shqipëri.³⁹ Natyrisht nuk kanë mbetur pa u përmendur dhe regjistruar edhe luftimet të “Ura e Gjakut” dhe te Xhamia në Shipole njësiteve të kësaj zone operative në njërën anë dhe forcave jugosllave në anën tjetër; luftimet në Vaganicën e Poshtme dhe Vaganicën e Epërme, por edhe në Vërnice, sepse *forcat serbe kishin atakuar çdo gjë shqiptare*.⁴⁰

Edhe gazetatat e muajve shkurt e mars shkruajnë për luftime të intensitetit të lartë. Ato njoftojnë (në muajin shkurt) edhe për një “*Plan sekret të forcave serbe*”. Në këtë *Plan sekret*, siç thuhej, parashihej ndër të tjera edhe *spastrim i tërësishëm të rrafshinës në lindje të lumit Sitnica, pastaj që t’i shkaktoheshin humbje sa më të mëdha forcave të UÇK-së. Për këtë gjë në Mitrovicë ishte vendosur edhe Brigada 80 e motorizuar nga Kragujevci*.⁴¹ Me synimin për të zbatuar planin në fjalë, më 22 shkurt, në orën 9:45 forcat e shumta serbe, me tanke, autobllinda e pizgauerë kishin tentuar t’i thyejnë pozicionet e mbrojtjes të zonës që e mbulonte Batalioni i Dytë i Brigadës 142 të ZOSH. Po ashtu, luftimet do të shpërthejnë edhe në Pantinë dhe Akrashticë. Si rezultat i një lufte të rreptë, forcat jugosllave kishin pësuar humbje, duke lënë të vrarë dhe të plagosur. Kështu, rreth orës 10:00, ishte bllokuar spitali i Mitrovicës, dhe aty ishin parë duke u vendosur ushtarë serbë të plagosur.⁴² Fshatrat e Komunës së Mitrovicës dhe Vushtrrisë: Shtitaricë, Bukosh, Liqej, Dolak, Pantinë, Akrashticë, Balincë, Vaganicë, Pirç, Vërnice, Mihaliq, Sallç, Druar, Kçiç i Madh, Zhilivodë, Beçuk, Strofc, Melenicë, Preten, Vidishiq, Mazhiqetj,⁴³ do të shndërrohen në arenë luftimesh ku do të mbesin shumë të vrarë dhe të plagosur nga të dy palët. Ngase humbjet e forcave jugosllave po shtoheshin përditë, më 13 mars 1999, do t’u sulen civilëve shqiptarë në Tregun e Mitrovicës, me ç’rast

³⁹ Koha ditore, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 24 dhe 25 janar 1999; Kosova sot, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 26 janar 1999; Zëri i popullit, 10, 12, 13, 14, 15 16 dhe 24 janar 1999; Bota e re, 16 dhe 31 janar 1999.

⁴⁰ Kosova sot, 16 janar 1999; Kosova sot, 21, 22 dhe 24 janar 1999; Koha ditore, 23 janar 1999; Izedin Krasniqi, *Lufta më vendimtare mund të bartet në pjesën veriore të Kosovës, por padyshim armikut nuk do t’i lëmë asnjë pëllëmbë toke të Atdheut* (Intervistë me Bekim Shytin-komandant i Njësisë Speciale të ZOSH), Kombi, 17 shkurt 1999, f.7; Kosova sot, 29 janar 1999.

⁴¹ Kosova sot, 21 shkurt 1999, f.5.

⁴² Kosova sot, 21, 22 dhe 23 shkurt 1999.

⁴³ Sabit Gashi, *Njësia Speciale e Zonës Operative të Shalës*, 19 dhe 30 korrik, 10 dhe 17 gusht 1999, *Çlirimi*, Prishtinë, 1999, f.11; *Rilindja*.....; Kosova sot, 20-28 shkurt dhe 1-16 mars 1999; Koha ditore, 23, 24 dhe 27 shkurt, por edhe 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 21 dhe 24 mars 1999; Rilindja.

do të bëjnë një masakër ku mbesin të vdekur 7 e 58 plagosen.⁴⁴ Se intensiteti i luftimeve dhe vija e frontit po zgjeroheshin, dëshmon fakti se forcat jugosllave do të ndërmarrin ofensivën e radhës në Shalë. Kështu, sipas shtypit, që nga ora 6:00, e datës 21 mars 1999, te shkolla e Breznicës, ishte përqendruar një konvoj i UJ-së në përbërje prej 26 tankesh, 7 pragash dhe 16 kamionësh me ushtarë. Nga ora 06:30, një tren transportues kishte ardhur nga drejtimi i Rashkës, në të cilin ishin ngarkuar 24 tanke. Kishin ardhur në Mitrovicë dhe kishin vazhduar rrugën në drejtim të Vushtrrisë. Po ashtu, rreth orës 08:30, 19 automjete të forcave serbe, ndër to 3 tanke e 4 autobllinda kishin ardhur nga drejtimi i Rashkës në Mitrovicë dhe prej aty kishin vazhduar rrugën në drejtim të Stantërgut. Rreth orës 10:30, një konvoj me 40 automjete ushtarako-policore serbe kishte ardhur nga drejtimi i Rashkës në Mitrovicë dhe kishte vazhduar rrugës për në Vushtri.⁴⁵

Pikërisht më 21 mars 1999 kishte filluar një ofensivë e re kundër fshatrave të rajonit të Shalës së Bajgorës, në zonën e përgjegjësisë të Brigadës 141 “Mehë Uka” të ZOSH. Burimet nga terreni njoftonin se ditën e martë, më 21 mars, këmbësoria e forcave ushtarako-policore serbe kishte tentuar që të hynte në fshatrat Melenicë, Vidishiq, Mazhiq, mirëpo njësitet e Brigadës 141 “Mehë Uka” të ZOSH me sukses kishte zmbarsur forcat serbe. Në mesditë luftimet ishin përhapur edhe në afërsi të Stantërgut. Njoftohej për humbje ndër forcat ushtarake serbe. Një helikopter disa here kishte aterruar në kazermën ushtarake në Mitrovicë dhe nga autoambulancat kishin sjellë të plagosur në Spitalin e Mitrovicës.⁴⁶

Nga data 24 mars 1999 e tutje, me fillimin e bombardimeve të NATO-s, shtypi në Kosovë, për aq sa kemi arritur të hulumtojmë nuk botohet për shkak të rrethanave të krijuara. Kjo përbën një hendikep të madh. Prandaj, një nga burimet e vetme, në mos vetmi, mbetet Agjencia “Kosova Press” dhe *Radio Kosova e lirë*, mirëpo aty-këtu disa shkrime, disa artikuj i gjejmë në gazetatat e Shqipërisë, Serbisë, SHBA-së etj. Luftës së UÇK-së në ZOSH i kanë dhënë hapësirë të konsiderueshme edhe në gazetatat shqiptare në Shqipëri, siç janë: *Zëri i Popullit*, *Rilindja*, *Rilindja Demokratike*, *Gazeta Shqiptare*, *Ushtria*, *Revista Ushtarake* etj., që e kanë pasqyruar veprimtarinë luftarake të ZOSH. Se ka qenë kështu mjafton t’i përmendim me këtë rast disa nga titujt e artikujve të gazetave dhe revistave, siç janë: “*Aspekte të veprimeve ushtarake në Kosovë*”, “*Pse UÇK-ja humbi*

⁴⁴ Koha ditore, 14 mars 1999; Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar*, Viprint, Mitrovicë, 2009.

⁴⁵ Koha ditore, 21 mars 1999

⁴⁶ Koha ditore, 24 mars 1999.

kontrollin në shumë territore të saj”,⁴⁷ *“Luftime rreth minierës “Trepça” në Staritërg”, “Barbarët nuk ndalen”, “Vritet Xhavit (Xhevat-M.K.) Jusufi”, “Tiranë: Kosova zgjidhje afatgjate”, “Ka një ligj për robërit e luftës”, “Alarm për 8 serbë të zënë rob”, “Lirohen tetë robërit serbë”, “UÇK djeg skenarin kriminal serb”, “Shmanget një masakër”, “A do të lirohen 9 “pengje” shqiptare”?, “Fundi i Millosheviqit”, “Ku mund të jesh më sigurt se në UÇK”, “Filluan bombardimet serbe”, “UÇK në mbrojtje të popullit”, “Spastrimi etnik në veri të Kosovës”, “Vrasjet nuk kanë të ndalur”, “Beogradi, shkelës i marrëveshjeve”, “Përforcime serbe në Kosovë”, “Vazhdojnë luftimet rreth malit të Qyqavicës”, “Ky është akti i fundit i barbarisë serbe”*,⁴⁸ *“Vritet komandanti i një reparti të UÇK-së”, “Kundërsulm i suksesshëm në Llap dhe Bajgorë”, “Luftime në Gumnishtë e Bozhlan (Shala e Bajgorës-M.K.)*⁴⁹ etj. Këta dhe artikuj të tjerë janë botuar në shtypin shqiptar të kohës gjatë periudhës kohore korrik-shtator 1998 dhe janar-mars 1999, kurse në muajit prill-maj 1999, janë të paktë artikujt për shkak të fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe-malaziasë.⁵⁰

Sa i përket qasjes që ka pasur shtypi shqiptar në Shqipëri për UÇK-në, po e huazojmë mendimin e studiueses Afërdita Sokoli, sipas të cilës *media e majtë e bëri veprimtarinë e UÇK pjesë të rëndësishme të hapësirës së saj. Ajo u rrek të tregonte se rruga e rezistencës paqësore në Kosovë nuk kishte justifikuar pritshmërinë, pavarësisht disa rezultateve dhe nuk kishte realizuar vullnetin e shqiptarëve. Qasja e medias së djathtë ndaj UÇK-së ndoqi fillimisht rrugën e denigrimit, në vijim të indiferentizmit ndaj afirmimit të saj, duke e finalizuar atë me pikëpamjen e vënies së UÇK nën kontrollin e Rugovës. Megjithatë, këto qasje nuk përjashtuan publikimet edhe në kundërshtim me linjën politike përfaqësuese, apo artikujt objektivë, veçanërisht të gazetarëve të huaj për çështjen në fjalë*.⁵¹ Zona Operative e Shalës pati konsideratë ndaj gazetarëve. Kësisoj mbante kontakte me gazetarët e gazetave të Kosovës: “Bujku”, “Bota e re”, “Kosova sot”, “Koha ditore” etj., por edhe me ata të gazetës “Kombi” etj.⁵² Për konsideratën dhe

⁴⁷ Revista ushtarake, shtator-tetor 1998

⁴⁸ Zëri i popullit, 15, 22 korrik 1998; Zëri i popullit, 5, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 24 janar 1999; Zëri i popullit, 26, 27 shkurt 1999; Zëri i popullit, 4, 17, 18 mars; Zëri i popullit, 21 prill 1999.

⁴⁹ Ushtria, 6 janar, 1 dhe 29 maj 1999

⁵⁰ Ushtria, 1 dhe 29 maj 1999.

⁵¹ Afërdita SOKOLAJ, *Çështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981 - 2000)*, Disertacion, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014, f. 13, 137, 169.

⁵² Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Brigada 141 “Mehë Uka”, *FALËNDERIM*, Dokumenti nr. 1/130, datë: 27. 11. 1998, Arkivi i Brigadës 141.

bashkëpunimin e treguar ZOSH, më 27 nëntor 1998, në fshatin Bajgorë, me rastin e shënimit të Ditës së Flamurit Kombëtar, UÇK u ka dhënë mirënjohje korrespondentëve të gazetave të kohës.⁵³

Mirëpo, fillimi i bombardimeve të NATO-s, djegia e çdo gjëje në Kosovë dhe fillimi i deportimit të madh si dhe spastrimit etnik të Kosovës nga gjithëka shqiptare, kishte ndikuar edhe te mediat. Të gjitha, pa përjashtim, ose ishin djegur, ose ishin detyruar të mbyllën dhe të marrin rrugën e “deportimit të madh”. Prandaj, 2-3 muajt e fundit, nëse nuk kemi shumë artikuj të botuar në shtypin e kohës, nuk do të thotë se nuk kishte luftime të ashpra. Bile luftimet më të ashpra dhe më të përgjakshme kanë ndodhur përgjatë muajve prill-maj, mirëpo, ato, fatkeqësisht nuk ishte e mundur të pasqyroheshin në media. Njëra nga arsyt ishte edhe fakti fillimi i bombardimeve të NATO-s mbi caqet jugosllave. Kësisoj, luftimet e UÇK-së kundër forcave jugosllave mbetën (në rrafshin mediatik) nën hijen e bombardimeve mbi caqet ushtarake e policore jugosllave. Prandaj, edhe numri i artikujve nëpër gazeta dhe revista është i reduktuar maksimalisht. Megjithatë, ishte *Agjencia Kosova Press*, organ i UÇK-së, ajo që mbulonte këto ngjarje dhe raportonte pothuajse për të gjitha betejat që bënin Njësitët e UÇK-së në Kosovë,⁵⁴ pra edhe në Zonën Operative të Shalës. Një nga artikujt e paktë dhe të fundit që është botuar në gazetat shqiptare, për aq sa dimë ne, që shkruan për veprimtarinë luftarake të ZOSH ishte ai i datës 29 maj 1999, botuar te gazeta *Ushtria* (Tiranë, 29 maj 1999).⁵⁵ Artikulli në fjalë paraqet luftimet mes njësiteve të Brigadës 141 të ZOSH dhe forcave jugosllave në fshatrat Gumnishtë dhe Bozhlan.

Në fund të këtij punimi duhet themi se ZOSH-i kishte bashkëpunim të mirë me shtypin e kohës, prandaj nuk është e rastit që për veprimtarinë e saj janë botuar mbi 300 artikuj. Nga kjo shumësi shkrimesh, artikujsh të botuar nëpër gazeta e revista, vërehet se shumë prej atyre artikujve janë shkruar me profesionalizëm dhe kompetencë, mirëpo ka të tillë që nuk i plotësojnë kriteret elementare profesionale për t’u botuar në ndonjë gazetë a revistë, pavarësisht natyrës së shkrimit, gjinisë apo zhanrit, pavarësisht qëllimit dhe synimit. Mosverifikimi i burimeve, ngatërrimi i datave, i emrave të njerëzve dhe të vendeve, betejave e ngjarjeve; cilësimet: luftë, konflikt, kryengritje, vetëmbrojtje popullore; ngatërrimi i dëshmorit me viktimën, i ushtarit me civilin etj., përbëjnë një problematikë më vete, që mbetet të trajtohet në të ardhmen, sepse këto të dhëna të gabuara, këto

⁵³ Arkivi i Brigadës 141.

⁵⁴ Instituti i Historisë-Prishtinë, *Arkivi i luftës I-IV*, Kosova Press, Prishtinë, 2016.

⁵⁵ *Ushtria*, 29 maj 1999.

lëshime, këto gabime po përsëriten edhe në fushat e pretendimeve shkencore. Sido që të jetë, gjatë shfletimit të shtypit të bien në sy edhe shumë fakte të tjera me rëndësi.⁵⁶

⁵⁶ Miftar Kurti, *Vrojtime historike*, Faik Konica, Prishtinë, 2019, f.60.

Miftar KURTI

SUMMARY

OPERATIONAL ZONE OF SHALA IN THE PRESS KOSOVA AND ALBANIA (1998-1999)

The Kosovo Liberation Army was stretched throughout Kosovo. In its composition had seven operational zones. One of them was the Operational Zone of Shala (OZSH), which was founded on June 28, 1998. Its commander was Rrahman Rama. Stretched in the territory of the municipalities of Mitrovica, Vushtrri, Zubin Potok and Leposavic. It was bordered by the Drenica Operational Zone and the Llapi Operational Zone. It consisted of two brigades: Brigade 141 "MehëUka" and Brigade 142, Special Unit and Rapid Intervention Unit. There were about 2,500 soldiers.

The fiercest fighting took place mainly in the villages of Pantinë, Ashlan, Shipol, Vaganicë, Mazhiq, Melenica, Kaçanoll, Pasomë, Druar, Liqe, Bukosh, Dumnica, Samadrexha etc. Its military operations launched since June 1998 and lasted until the month of June 1999. ZOSH's actions, battles and other military actions have echoed in the press of the time: in Kosovo, Albania, Serbia, Montenegro, Germany, Britain, USA and so on. The focus of this paper is on the KLA's fight against Yugoslav police and army forces and how those actions were presented to the Serbian and Montenegrin press. The following newspapers that have written on this topic: *Bujku*, *Kosova sot*, *Koha ditore*, *Rilindja*, *Bota e re*, *Kombi*, *Gazeta shqiptare*, *Ushtria*, *Revista ushtarake*, *Zëri i popullit*, *Rilindja demokratike* etc. Various articles have been published: news, chronicles, reports, press releases; interviews, opinions, statements; analysis, comments etc.

KUMTESA

Emine KALAJA-HAJDARI
Premtim ALAJ

TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE E MITROVICËS

Mitrovica dhe rrethina e saj është e pasur me trashëgimi kulturore, veçanërisht me atë arkeologjike, që pa dyshim është treguesi më i mirë i zhvillimit të jetës me një intensitet të lartë, gjatë gjithë periudhave parahistorike dhe historike. Dëshmitë arkeologjike dhe ato epigrafike flasin se, jeta në të u zhvillua që nga parahistoria, dhe kjo falë pasurive të shumta natyrore, si dhe pozitës strategjike dhe sidomos asaj gjeografike e ndodhur në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Ibrit e Sitnicës, dhe në afërsi të masiveve të Kopaonikut dhe Rogoznës. Mbetjet materiale të kulturave nga këto epoka janë të vetmet dëshmi, që jo gjithherë janë të mjaftueshme që të krijojmë një pasqyrë të qartë mbi mënyrën e zhvillimit të kulturës gjatë gjithë ekzistencës së tyre.

Në mbarë territorin e Kosovës nuk është zbuluar asnjë vendbanim nga epoka e paleolitit dhe mezolitit,¹ për dallim nga epokat pasuese prej të cilave kemi vendbanime më të shumta në numër, ekzistenca e të cilave tanimë është vërtetuar, pas hulumtimeve dhe gërmimeve të bëra. Epoka e neolitit është e prezantuar me një varg vendbanimesh. Vendbanimi më i vjetër nga treva e Mitrovicës është ai i Zhitkocit që i takon neolitit të hershëm,² i cili është i vendosur në një terren të hapur fushor, buzë lumit Ibër. Pas hulumtimeve të bëra në këtë lokalitet, janë zbuluar shtresa nga

¹ Janë dhënë disa supozime se, në territorin e Kosovës ka vendbanime të periudhës së paleolitit, siç është stacioni shpellor i Radavcit afër Pejës, por që nuk janë vërtetuar ende, shih: Edi Shukriu, *Kosova antike*, (Prishtinë, MKRS), 2004, 36.

² Adem Bunguri, “Të dhëna të reja mbi neolitin dhe eneolitin në Kosovë”, *Iliria* XXXIII, (2007/2008), 62.

kultura e starçevës dhe ajo e vinçes.³ Në shtresat kulturore të këtij lokaliteti është gjetur qeramikë e pikturuar dhe barbotine, që është karakteristikë e kulturës së starçevës.⁴ Në afërsi, si kohore dhe fizike është edhe lokaliteti i njohur arkeologjik, ai i Karagaqit,⁵ në të cilin janë zbuluar materiale të shumta, të cilat dëshmojnë vazhdimësinë e jetesës në këtë vendbanim që nga neoliti, me ndërprerje të vogla, deri në periudhën romake.⁶

Një vendbanim tjetër është edhe ai i Fafosit i cili shtrihet pranë lumit Sitnicë afër Mitrovicës, në vendin ku është ndërtuar fabrika e industrisë kimike e përpunimit të fosfatit, prej të cilës ka marrë edhe emrin.⁷ Këtu janë konstatuar dy vendbanime të kulturës së vinçes dhe janë të njohur si Fafosi I dhe Fafosi II. Banesat e fazës Fafos I ishin kasolle mbitokësore, të ndërtuara me shtylla druri e thurje thuprash të lyera me baltë, me planimetri drejtkëndëshe,⁸ ndërsa tjetri përbëhej nga shtëpitë kasolle të vendosura njëra krahas tjetrës.⁹ Në dy vendbanimet janë zbuluar objekte të ndryshme për përdorim të përditshëm si objekte kulti, vazo ritualesh, altar dhe figurina antropomorfe.¹⁰

Epokës së neolitit i takon edhe vendbanimi i Vallaçit, i cili gjendet në afërsi të Mitrovicës, dhe është vendbanimi i vetëm neolitik me mbrojtje të fuqishme natyrore nga të tri anët.¹¹ Këtu janë hasur edhe gjurmë të periudhës së hekurit. Edhe nga ky vendbanim kemi figura të shumta antropomorfe dhe zoomorfe. Epoka pasuese, ajo e eneolitit e që njihet si periudha transitore nga epoka e gurit në atë të metaleve, karakterizohet me njohjen dhe përdorimin e bakrit dhe dyndjen e fiseve indoevropiane, dhe me vendosjen e vendbanimeve në kodra të mbrojtura. Nga kjo periudhë nuk kemi asnjë vendbanim të zbuluar në Mitrovicë, dhe kjo vjen si pasojë e kërkimeve të pakta. Periudha e bronzit njihet për proceset integruese të bazuar në ekonominë bujqësore, blegtori, xehetari dhe tregti. Nga kjo kohë e kemi nekropoline Karagaqit.¹²

³ Nikola Tasić, "Starčevačka kultura", *ABKM*, (1998), 38.

⁴ Nikola Tasić, "Žitkovac i neki problemi relativnog hronološkog odnosa neolitskih i eneolitskih naselja na Kosovu i u dolini Ibra", *GMKM*, III, (1958), 46.

⁵ Dragoslav Srejović, "Karagač and the problem of the ethnogenesis of the dardanians", *Balkanica* IV, (1973)

⁶ Srejović, "Karagač and the problem, 39.

⁷ Milot Berisha, *Guidë arkeologjike*, Prishtinë, 2012, 28.

⁸ Branislav Jovanović, "Stratigrafija naselje vinčanske grupe kod Kosovske Mitrovice", *GMKM*, VI, (1961), 9-67; Bunguri, "Të dhëna të reja mbi neolitin", 2007/08, 65.

⁹ Berisha, *Guidë arkeologjike*, 2012, 28.

¹⁰ Material nga arkivi i Muzeut të Kosovës.

¹¹ Bunguri, "Të dhëna të reja mbi neolitin", 2007/08, 72.

¹² Srejović, "Karagač ...", 39.

Prezenca e varrezës së Karagaqit, është një dëshmi e qartë edhe për vendndodhjen e një vendbanimi diku në afërsi të saj, por mbetet në të ardhmen që të konfirmohet. Gjatë gjurmëve janë konstatuar dy horizonte të gjurmimit, që janë quajtur Karagaq I dhe II.¹³ Fazës Karagaq I, i takonte tipi i varrezave të sheshta (me urna), me rit të varrimit me djegie e njohur në literaturën arkeologjike si kultura e Bërnices, e që kryesisht i takon periudhës së bronzit të vonë ose fazës tranzitore në mes të bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm.

Fillimi i epokës së hekurit përcillet me ndryshime të mëdha etnike dhe kulturore, jo vetëm në Iliri, respektivisht në Dardani, kur edhe bëhet konsolidimi i tyre, por në tërë Ballkanin. Nga kjo periudhë Kosova është e përfaqësuar nga një shumësi vendbanimesh dhe vendvarrimesh. Të parat janë të fortifikuara dhe të vendosura kryesisht mbi kodra të larta që ofronin mbrojtje natyrore, ndërsa varrezat ishin tumulare. Kjo periudhë përfaqësohet nga horizonti i fundit i banimit në Vallaç. Përveç shtresës kulturore neolitike të kulturës së vinçës së vonë, në këtë vendbanim janë dëshmuar edhe gjurmë të periudhës së fazës së parë të hekurit.¹⁴

Periudhës së hekurit i takojnë edhe varret e horizontit të dytë Karagaq II. Përgjatë fazës Karagaq II, nekropoli është ripërdorur dhe më gjasë është përdorur riti i varrimit tumular.

Dy fazave të hekurit nga ky regjion i takojnë edhe disa gjetje nga Soçanica, e që është një dëshmi e qartë se fillimet e jetës në këtë lokalitet datojnë që nga periudha e hekurit.¹⁵

Sa i përket periudhës helenistike, kur influenca greke në shumë fusha ishte e madhe, ajo është tërësisht e pa dëshmuar në komunën e Mitrovicës deri me tani. Duhet pasur parasysh fakti se në pjesën veriore të vendit ende nuk është bërë një përnjohje sistematike arkeologjike në vitet e fundit, si rrjedhojë edhe njohuritë e reja për këtë territor janë të kufizuara dhe mbeten në stadin preliminar. Pas pushtimit dhe vendosjes së administratës romake në Dardani, respektivisht në Kosovë romakët ndërmorën një sërë ndërtimesh, si në infrastrukturë, zgjerimin e eksploatimit të xeheve, themelimin e qyteteve, ndërtimin dhe rindërtimin e fortifikimeve etj. Në këtë fushatë ndërtimesh, romakët nuk ishin të detyruar të fillonin nga e para, ngaqë ata në Dardani gjeten një infrastrukturë dhe

¹³ Srejojić, 1973, 42-43.

¹⁴ Miloš Jevtić, *Keramika starijeg doba na Centralno Balkanskom Području*, (Beograd 1983), 28, 29. Tabela. XXXIII, fig. 1-3, 8-10.

¹⁵ Katalog Arkeologjik i Kosovës, (MKRS, 2013), fig. 181, 183, 188, 195, 196.

urbanizim të organizuar mirë.¹⁶

Gjatë këtyre ndërtimeve, romakët ndiqni linjat ekzistuese të rrugëve, si dhe themelonin qytetet e tyre në qendrat urbane ekzistuese autoktone.¹⁷ Qëllimi i tyre ishte që të arrinin deri tek potencialet e mundshme ekonomike, e të cilat ishin të shumta, sidomos në pjesën veriore të Kosovës që shquhet për pasurit nëntokësore të saj. Njëri ndër vendbanimet më të mëdha që i takon kësaj pjesë është ai i Soçanicës, i cili kishte edhe statusin e municipiumit. Themelimi i tij ka ardhur si rezultat i reformave ekonomike të aplikuara nga perandori Trajan.¹⁸ Ky lokalitet ndodhët në pjesën veriore të Kosovës, shtrihet në luginën e lumit Ibër, i rrethuar më masivet e Kopaonikut dhe Rogoznës. Kjo pjesë karakterizohet me veti gjeomorfologjike të masiveve të pasura me xehet e plumbit, zinkut, hekurit, arit dhe argjendit.¹⁹ Këtu janë zbuluar disa objekte, siç është forumi me horean, bazilika, tempulli si dhe objekte të tjera. Përveç këtyre në afërsi të qyteti janë zbuluar edhe katër nekropole, prej të cilave dy janë më në afërsi të qytetit dhe dy më larg.²⁰ Njëra është në vendin e quajtur Ravnisht, një në Prisoje.

Kriza e madhe ekonomike dhe politike që përfshiu Perandorinë Romake përgjatë shekujve III-IV, ndërhyrjet e fiseve barbare, e në veçanti zhvendosja e ekonomisë xehetare në plan të dytë si rezultat i kësaj krize, ishin disa nga shkaqet që vendbanimi gradualisht humbi rëndësinë dhe karakterin që kishte dikur. Edhe përkundër reformave që ndërmori perandori Dioklecian, të cilat i vazhdojë me pastaj edhe Konstantini I, më qëllim të ngjalljes së veprimtarisë xehetare, Minucipiumi DD, nuk arriti dot t'i bëj ballë krizës së madhe që kishte përfshirë tërë Perandorinë.²¹ Nga periudha e antikitetit të vonë dhe mesjetës kemi disa lokalitete si: kështjella në Zveçan e cila ndodhet në anën e majtë të rrjedhës së lumit Ibër mbi qytetin e Mitrovicës²², pastaj kështjella e Trepçës në fshatin Rashan²³ dhe

¹⁶ Emil Čerškov, *Romaket në Kosovë dhe Municipiumi DD te Soçanica*, (Prishtinë, Rilindja, 1973), 23-24.

¹⁷ Naser Ferri, *Monumente ushtarake të periudhës romake në Mezi të Epërme*, (Pejë, Dukagjini, 2001), 59.

¹⁸ Emine Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani gjatë periudhës romake (Proceset ekonomike, social-politike dhe kulturore)*, (Prishtinë, IHP, 2017).

¹⁹ M. Rizaj, S. Kastrati, F. Peja, K. Luci, E. Beqiraj, "Veprimtaria metalurgjike në Kosovë deri në mesjetë", <https://www.researchgate.net>.

²⁰ Slobodan Fidanofski, "Rimski i ranovizantijski period", *ABKM*, (Beograd, 1998), 268.

²¹ Čerškov, *Romaket në Kosovë*, 1973, 217.

²² Grup autorësh, *Kosova dikur e sot*, (Beograd, 1973), 445-446.

²³ Po aty, 464

lokaliteti arkeologjik në mes të fshatrave Bare dhe Vidishiq i quajtur qyteti mesjetar i Trepçës.²⁴

Janë dëshmuar edhe shumë toponime, si gradina, kalaja, kisha etj, në shumë fshatra të regjionit të Mitrovicës, e që janë një indikacion i qartë se kemi të bëjmë me lokalitete arkeologjike, të cilat mbetet në të ardhmen që të konfirmohen. Të gjitha këto lokalitete të dëshmuara në këtë pjesë të Kosovës, janë një tregues se ky rajon, duke zotëruar një pozitë të mirë gjeografike, dhe duke qenë i pasur me minerale të ndryshme, ka qenë i banuar që në parahistori e për të vazhduar edhe në periudhat pasuese, në të cilat gjurmime arkeologjike janë bërë në fillim shek. XX, dhe nuk kanë vazhduar më, as pas luftës në Kosovë, për arsye se institucionet përkatëse nuk kanë qasje në pjesën veriore të Kosovës. Nga kjo shumësi e vendbanimeve dhe nekropoleve të dëshmuara, në rajonin e Mitrovicës dhe komunave tjera në veri të Kosovës, vetëm disa prej tyre janë futur në listën e monumenteve nën mbrojtje të Ministrisë së Kulturës, së Rinisë dhe të Sportit të Kosovës.

²⁴ Cf: Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, vendim Nr. 110/2018 Dt. 03.10.2018, mbi aprovimin e listës së trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme.

Emine KALAJA-HAJDARI
Premtim ALAJ

SUMMARY

MITROVICA'S ARCHAEOLOGICAL INHERITANCE

The Mitrovica region is rich in its cultural inheritance, especially in terms of its archaeology, which in turn is an indicator of a high intensity life since prehistory. Archaeological evidence suggests of human inhabiting the region since prehistory due to abundant natural riches, as well as its strategic location situated between two important rivers; Iber and Sitnica and surrounded by the Kopaonik and Raguza mountains.

There is evidence of dwellings from the neolith period, continuing with the Roman era as well as the medieval ages, which have left many cultural and material objects. Based on the written sources as well as archaeological excavations in the region, although few in number, one could conclude that the region was and continues to be a central artery of the general development in Kosovo.

Luan TETAJ

MARRËDHËNIET SHQIPTARO-MALAZEZE NË LUFTËN KUNDËR PUSHTIMIT OSMAN NË SHEK. XVII

Studimi i marrëdhënieve të historisë së popujve të Ballkanit, dhe veçanërisht marrëdhëniet e shqiptarëve dhe malazezëve nën sundimin osman, kanë ekzistuar edhe përkundër shumë vështirësive të mëdha. Për këtë arsye, periudha e sundimit osman dhe shekujt e parë të kësaj periudhe paraqesin pjesën më të errët të ndriçimit të historisë sonë. Bashkëpunimet dhe veprimet luftarake mes shqiptarëve dhe malazezëve janë të njohura që nga periudha të hershme. Që nga shekulli XIV dhe XV, shqiptarët dhe malazezët u gjendet në pozita të barabarta përballë pushtimeve osmane. Prandaj, rrethanat në të cilat vepronin shqiptarët dhe malazezët i detyruan t'i bashkërendonin veprimet e tyre luftarake duke e plotësuar njeri-tjetrin në luftë kundër armikut të përbashkët.

Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit, shqiptarët dhe malazezët ishin më të vendosur në luftën e tyre çlirimtare kundër Perandorisë Osmane. Në një kronikë të vitit 1486, thuhej se: “80 feudalë të Zetës dhe shqiptarët me gjithë fshatarët e tyre për pesë vjet me radhë, luftuan kundër pushtuesve osmanë në rrethet e Lezhës dhe Durrësit dhe i thyen me sukses të gjitha sulmet e forcave osmane”. “Mendohej së rreziku i madh që u kanosej nga ushtria osmane i bashkoi edhe më tepër këta feudalë”. Në fund të kronikës së tij, ky kallogjeri thotë: “Si vëllezër të një nëne, bartën barrën dhe vuajtjen e luftës, në dashurinë dhe akordin më të mirë, gjë që nuk ekzistonte deri atëherë”.¹ Gjatë asaj kohe, krahinat që kontrolloheshin nga feudalë nuk ishin në gjendje t'i bëni rezistencë të fuqishme ushtrisë osmane, sepse luftimet ishin shumë të fuqishme. Feudalët pasi e kuptuan fuqinë e ushtrisë osmane, kaluan në anën e tyre, u konvertuan në fenë islame dhe në këtë mënyrë i shpëtuan pozitat dhe privilegjet e tyre. Në njëfarë mënyre, ky ishte

¹ Arkivi Institutit të Historisë-Tiranë, Dosja, A-III/62, f.1.

fundi i shpartallimit të feudalizmit mesjetar te popujt e Ballkanit, ku ranë në sundimin e plotë dhe të gjatë të sundimit osman.

Në gjysmën e parë të shek. XV, shqiptarët dhe malazezët i vunë themelet e bashkëpunimit në luftën e mëtejshme kundër pushtimit osman. Ky bashkëpunim u thellua edhe më shumë veçanërisht nga heroi kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i cili gjithë veprimtarinë e tij politike dhe luftarake e zhvilloi në Shqipëri. Ai luftoi fuqishëm që kauzës së tij për çlirimin e tokave shqiptare dhe ballkanike t'i bashkëngjiteshin edhe shtetet fqinje dhe evropiane në luftën çlirimtare për dëbimin e pushtuesve osmanë nga Ballkani. Bashkimi i forcave të shteteve ballkanike dhe evropiane, ishte mundësia e vetëm që t'i bëhej ballë një fuqie siç ishte Perandoria Osmane. Skënderbeu gjatë asaj kohe lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me, më udhëheqësit e Zetës dhe me Brankoviqët, të cilët gjatë asaj kohe ishin duke bërë përpjekjet e fundit në luftën e tyre kundër ushtrisë osmane. Bashkëpunimi i Skënderbeut me Cërnejeviqët zgjati rreth dhjetë vite, madje kishte edhe rezultate të mira të bashkëpunimit të tyre.²

Qeverisja e Cërnojeviqëve në Malin e Zi, la një vakum të pushtetit. Kishte rezultate të rëndësishme, përforcoi pushtetin fisnor që ishte dobësuar, por jo shkatërruar, i cili përballë një mungese të një shteti të fortë feudal lokal mori shumicën e qeverisjes vendore. U dha një rol më të madh peshkopëve të Malit të Zi, të cilët u zhvendosën në Cetinë. Peshkopët morën kështu disa nga funksionet laike të dinastisë së rrëzuar të Cërnojeviqëve.³

Gjatë asaj kohe, përmes luftës së armatosur, Skënderbeu arriti të çlironte një pjesë të madhe të krahinave të vendit nga osmanët. Së bashku me Cërnejeviqët vazhdoi luftën kundër ushtrisë osmane në rrethet e Zhablakut dhe Podgoricës. Gjurasht Cërnejeviq kur u shtrëngua të ikte nga ushtria osmane në Venedik, së bashku më të u nisën disa krerë të popullit të Hotit dhe Kelmendit, të cilët i drejtohen Evropës për ndihmë.⁴ Por, kërkesat e tyre drejtuar vendeve perëndimore nuk hasen në mirëkuptimin e tyre. Në fillim të shek. XVII, fiset e Malit të Zi dhe fiset shqiptare të Veriut, bashkëpunonin dhe vepruan ngushtë më veprimet dhe projektet e tyre çlirimtare. Vlladika i Malit të Zi, Ruffin Njegushi, në vitin 1609, u bëri thirrje krerëve popullorë të Mirditës, që të bashkëveprojnë në sulme kundër ushtrisë osmane. Në letrën që mban datën 8 korrik të këtij viti, i drejtohet të

² *Po aty.*

³ Zdenko Zlatar, *The Poetics of Slavdom, the Mythopoeic Foundations of Yugoslavia*, Volume II, Peter Long, New York, Washington, D.C. Baltimore-Bern, Frankfurt am Main-Berlin-Brussels-Vienna-Oxford, 2007, 461.

⁴ *AIH*, Dosja, A-III/62.

parit të Mirditës, Mark Nika, ku ndër të tjerat thuhej: “Unë do të isha i lumtur së bashku me malazezët e mi kur t’i të mundesh të shikosh se si fati jonë është plotësisht i përbashkët dhe se mund të realizohej liria sa më parë në qoftë se ne së bashku me trimëri luftojmë kundër armiqve tanë të përbetuar. Të lus si vëlla, të caktojme kohën se kur do ta sulmojmë ushtrinë osmane dhe të më lajmëroni se kur pashai i Shkodrës mendon të sulmojë kundër nesh”.⁵

Në skajin më verior të alpeve shqiptare, në zonën kufitare mes Shqipërisë dhe Malit të Zi u krijua lidhja e fuqishme - bashkimi i Maleve Shqiptare. Malet e Mbishkodrës me emrin e njohur në burimet arkivore të kohës u quajtën “Malet Shqiptare”.⁶ Përveç Malësisë së Madhe, në këtë bashkim malesh u përfshinë edhe disa fise malazeze. Në relacionin e hollësishëm të vitit 1614, kalorësi venedikas, Francesk Bolica (Bolizza), përmend 11 qendrat e Malësisë që kanë lidhur besën dhe janë ngritur në kryengritje. Në këtë bashkim përfshiheshin këto qendra, si: Rieni ose Rouci (Raçeçi), Bjelopavliqi (Palabardhi), Pipëri, Bratonosiqi, Vasojeviqi, Kuçi, Kelmendi, Rapsha, Hoti, Shkreli dhe Kastrati.⁷

Duke iu referuar dokumenteve, mendohet se mes viteve 1604 dhe 1612, u bë bashkimi i Maleve. Kur sanxhakbeu i Shkodrës, Ali beg Mehmet Begoviqi e sulmoi Malin e Zi në vitin 1604, nga rreth 3 000 ushtarë që mbledhi, kishte edhe nga fisi i Kuçit (... *frà quali vi fece venire quelli di Chuzzi montanari et hora ribelli*).⁸ Në vitin 1612, Asllan Pasha filloi ekspeditën ushtarake kundër Maleve Shqiptare. Mes këtyre dy ngjarjeve, në kuvend u lidh besa në mes të krahinave për të vazhduar luftën kundër ushtrisë osmane. Bashkimi i Maleve Shqiptare u fuqizua shumë dhe kishte mundësi të mbolidhte rreth 6 000 burra të aftë për luftë, aq sa kishte nxjerr kohë më parë bashkimi tjetër i Dukagjinit. Relatori venedikas, tregon së malësorët përveç se janë trima dhe luftëtarë, behën edhe më të fuqishëm

⁵ Po aty.

⁶ Injac Zamputi, “Bashkimi i Maleve Shqiptare në fillim të shekullit XVII”, *Buletini, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Seria shkencave shoqërore* 1 (Tiranë, 1957), 63.

⁷ Fransoa Lenorman, *Turci i Crnogorci*, s. francuskog prevela, Marina Vukčević, Predgovor, Branko Pavičević, Cid Podgorica, 2002, 251-255; Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, Vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963, dok. (3): “1614 Relacioni i Mariano Bolicës drejtuar Mikel Mafjos, mbi sanxhakun e Shkodrës”, 269; Zojzi, Rrok, *Ndarja krahinore e popullit shqiptar*, Tiranë, 1962, 41; Ukgjini, Nikë, “Malësia e Madhe dhe kontributi i saj në mbrojtjen e katolicizmit gjatë pushtimit osman (XV-XX)”, *Phoenix*, Viti VI, nr. 1-3/27-29 (Shkodër, 2002), 41.

⁸ Lenorman, *Turci i Crnogorci*, 319.

falë pozitës së tyre natyrore. Por, fuqia e tyre kryesore qëndron në bashkimin e tyre (*...la maggior fortezza loro sta nell'unione...*) ku janë bashkuar në Kuvend dhe janë betuar për të kundërshtuar çdo përpjekje të autoriteteve osmane.⁹ Bashkimi i Maleve Shqiptare sa vinte dhe fuqizohej dita-ditës. U krijua një unitet i fortë së bashku me unitetet tjera etnike të Ballkanit në projektet e tyre çlirimtare. Malet Shqiptare u bënë qendrat e dy kuvendeve ndërballkanike (kuvendet e Kuçit), që përfaqësoheshin si unitete më vete në kuvendet e përbashkëta. Organizimi i kuvendeve e fuqizoi edhe më shumë bashkimin e Maleve Shqiptare, dhe u diskutuan mundësi të shumta për gjetjen e rrugës së luftës së përbashkët çlirimtare kundër pushtuesve osmanë në trevat ballkanike.

Gjatë kësaj kohe, marrëdhëniet e shqiptarëve me malazezët sa vinin dhe forcoheshin edhe më tepër me organizimin e kuvendeve ndërballkanike. Thirrja dhe mbajtja e kuvendeve ndërballkanike kishte arritur shkallën më të lartë të organizimit të luftës kundër pushtuesve osmanë. Ndër kuvendet më të rëndësishme ishte Kuvendi i Moraçës, i cili zhvilloi punimet në Manastirin e famshëm Moraça në Malin e Zi, më 26 prill 1608. Krerët që përfaqësonin krahinat e tyre, në krye me vojvodën Gërdan dhe vojvodët e tjerë, pasi u koordinuan së bashku, e njoftuan papën së ata do ngritën në lëvizje të armatosur kundër pushtuesve osmanë me ndihmën e Karl Manuelit. Ata kërkonin nga papa mbështetjen e ndërmarrjes së tyre, e cila ishte me interes edhe për gjithë popujt e krishterë.¹⁰ Më 9 qershor të vitit 1608, kërkesat e njëjta iu drejtuan edhe mbretit të Napolit.¹¹

Moraça u bë qendër e lëvizjeve çlirimtare të trevave ballkanike. Feudalizmi osman ishte futur në një krizë, sepse rrugët për shtrirjet e reja, plaçkitja dhe pasurimi i tyre ishte mbyllur. Shqiptarët dhe malazezët me pozitën e tyre në kufijtë perëndimorë të Perandorisë, ishin ndarë në sferën e interesit nga shtetet perëndimore përmes detit, me pasuritë venedikase në fqinjësi mjaft të përshtatshme për infiltrim. Në këto rrethana, shqiptarët dhe malazezët i shfrytëzuan të gjitha lidhjet e tyre për fillimin e lëvizjeve çlirimtare. Venediku e kishte ndërprerë luftën kundër osmanëve, dhe në të njëjtën kohë kishte frenuar organizimin e kryengritjeve ballkanike. Por, kjo nuk ndikoi te popujt e Ballkanit që t'i ndalin përpjekjet e tyre çlirimtare.

⁹ Po aty, 315; Zamputi, "Bashkimi i Maleve Shqiptare", 63.

¹⁰ Bartl, Peter, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane, mbi çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*, Tiranë: Dituria, 2011, 176.

¹¹ Jovan N Tomić. *Građa za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI i početkom XVII veka, Knj.I 1595-1606 [Archivio di Stato di Venezia]*, Beograd: Srpska kraljevska akademija, 1933. dok. CCC (365), 524.

Në kuvendet ndërballkanike të Kuçit, mbajtur më 14 korrik - 8 shtator 1614, u mblodhën të përбетuarit 25 krerë nga më kryesorët të vendeve ballkanike.¹² Shtytje të madhe projekteve ballkanike dhe evropiane për dëbimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani, i kanë dhënë kuvendet shqiptare dhe ato ndërballkanike. Projektet e dala nga kuvendet dhe lufta e shqiptarëve gjatë shekullit XVI dhe XVII, vëri në lëvizje popullin shqiptar, që në vazhdimësi qëndroi në vëmendjen e shteteve evropiane. Shqiptarët i zgjeruan përtej kufijve të tyre projektet çlirimtare, ku vunë në lëvizje edhe popujt e tjerë të Ballkanit, dhe zunë vend të rëndësishëm në kuvendet e përbashkëta me malazezët, hercegovasit, boshnjakët serbët dhe bullgarët.

Më 11 nëntor të vitit 1620, në Beograd u mbajt Kuvendi ndërballkanik, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e fiseve të Shqipërisë Veriore, Malit të Zi, vojvodët e Likës, krerët e Dukagjinit dhe Kelmendit etj.¹³ Projektet për luftën çlirimtare u diskutuan në mënyrë të detajuar. Në Kuvend u morën disa vendime të rëndësishme për të çuar luftën përpara: Fillimisht u arrit një besëlidhje e të gjitha krahinave të përfaqësuara në Kuvend, të çlirohen njëherë e përgjithmonë nga pushtuesit osmanë. Në Kuvend parimisht ranë dakord të mbeteshin nën sundimin e mbretit spanjoll. Kuvendi i drejtohej papës dhe mbretit të Spanjës për ta mbështetur kauzën e tyre për çlirimin e trevave ballkanike. Kuvendi kishte caktuar tre persona për të prezantuar kërkesat e tyre, Gavrilin nga Novogostit (Nikshiqi), vëllai i Gardan Vojvodës; At Pjetër Tomazin, vëllai i kontit Thoma nga Vergovaci i mbretërisë së Bosnjës dhe kapedanin shqiptar, Gjon Renësi, i cili do t'i paraqiste projektin papës dhe mbretit. Kuvendi kishte hartuar plan për fillimin e kryengritjeve çlirimtare.¹⁴ Lëvizjet e malësorëve shqiptarë dhe malazezë me organizimin e tyre arritën të ngrinin rreth

¹² Luigi M. Ugolini, *Pagine di Storia Veneta ai tempi di Scanderbeg e dei suoi successor* (con due documenti), dok. (2), 34; *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, (më tej: *AQSH*) Fondi. 846, D. 76, Dy kuvendet e Kuçit; *AIHT*, Dosja.P - 44, Mbledhja e marrëveshje e krerëve serbë në Kuç, në vitin 1614, për kryengritjet kundër turqve.

¹³ Shufflay, Milan, *Historia e shqiptarëve të Veriut - serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë: Rilindja, 1968, 71; Erdeljanović, Jovan, *Stara Crna Gora*, Naselja, Rodoljub, 1926, 298; Milan, Prelog, *Povijest Bosne u doba osmanlijska vlade I*, Sarajevo: J. Studnička i drug, 1912, 92;

¹⁴ Zamputi, Injac, *Dokumente të shekujve XVI-XVII, për historinë e Shqipërisë*, Vëll. III (1603-1621), Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989, dok. (210): "1610 - Projekti për luftën çlirimtare i përpunuar në Kuvendin ballkanik të Belgradit dhe që iu lëshua në dorë tre fisnikëve, njëri prej të cilëve kapedani shqiptar Gjon Renësi të paraqitej në oborrin e Papës e të mbreti i Spanjës, ashtu edhe për të biseduar mbi kapitujt e marrëveshjes", 365.

dhjetëmijë luftëtarë që pretendonin ta pushtonin Shkodrën dhe Podgoricën etj. Në luftimeve që u zhvilluan gjatë vitin 1687 dhe në fillim të vitit 1688, forcat ushtarake osmane nën udhëheqjen e Sulejman Pashës dhe një pjesë të sanxhakbejlerëve të Hercegovinës, pësuan humbje. Malësorët shqiptarë të Kuçit, Piprit dhe Kelmendit, në maj të vitit 1688, e sulmuan dhe e pushtuan kështjellën e Medunit, por në mungesë të armëve luftarake për ta mbrojtur, u detyruan t'ua dorëzojnë venedikasve.

Pas kësaj fitoreje të rëndësishme, në maj të vitit 1688, u mbledhën shqiptarët dhe malazezët në një Kuvend të përbashkët në Gradec, ku e lidhen besën për të vazhduar luftën, dhe vendosën ta sulmonin dhe ta çlironin kështjellën e Podgoricës, duke koordinuar veprimet e tyre me ato të flotës venedikase që të sulmonte Ulqinin dhe Tivarin. Ndërkohë, rreth 800 turq nga Podgorica, Gruda, Hoti e Genta shkuan në drejtim të Gradecit, por u vrenjtën nga kryengritësit dhe pastaj u larguan.¹⁵

Ushtria osmane në tërheqje e sipër u sulmua nga kryengritësit malazezë, ku mbetën të vrarë rreth 30 ushtarë të ushtrisë osmane, i plagosur kishte mbetur Hasan Grudiqi nga Podgorica, i cili ishte njëri me popullaritet të madh. Gjatë kësaj kohe, peshkopi i Cetinës mori një letër kërcënuese nga Sulejman Pasha i Shkodrës, ku ky i fundit i bëri me dije se do të arrinte me 20 000 luftëtarë për t'i bindur të nënshtrohen. I alarmuar, ai kërkoi ndihmën nga proveditori i përgjithshëm venedikas. Peshkopi dhe krerët malazezë kërkojnë që mos t'i braktiste dhe të niste ndonjë ndihmë, siç do të shihte të arsyeshme urtësia juaj. Ju lutem të nisni ndonjë galere në drejtim të Ulqinit dhe Tivarit për ta frikësuar dhe zbrazur Sulejman Pashën. Për ta mposhtur ushtrinë osmane, kërkojmë që Gjon Anton Bolica ta komandojë luftën, sepse veprën e tij e lavdërojnë shumë. Kërkoni ushtarë venedikas për të vendosur në garnizone të Cetinës dhe të kenë përkrahje në ngjarjet e ardhshme.¹⁶

Perandoria Osmane urdhëroi Sulejman Pashën që t'i shpartallonte malësorët shqiptarë dhe malazezë për të kaluar pastaj kundër nikshiqasve dhe të tjerëve që jetojnë në bindje të Venedikut. Sulejman Pasha e mbledhi ushtrinë me rreth 10 000 luftëtarë, pasi iu bashkuan edhe ushtritë e Verleiz (Vërlac) Pashës, sanxhakbeut të Vlorës, dhe sanxhakbejlerët e Ohrit e të

¹⁵ Zamputi, Injac, Selami Pulaha *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, (1675-1699)* Vëll. IV, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1990, dok. (67): "1688 maj - Peshkopi i Cetinës lajmëron proveditorin e përgjithshëm venedikas se, Sulejman Pasha i Shkodrës u ka dërguar atij dhe krerëve malazezë një letër kërcënuese", 127.

¹⁶ *Il Montenegro da Relazioni dei Provveditori Veneti (1687-1735)*, Roma Ferdinando Ongania, MDCCXCVI, 32-33.

Elbasanit. Proveditori kishte nisur për në Shqipëri galerat, nxiti banorët e Nikshiqit që ta ndihmonin Malin e Zi, ku për Cetinë kishte nisur kalorësin, Gjon Anton Bolica, me një garnizon hajdutësh dhe mbikëqyrësin, Perini, më një batalion italianësh rreth 500 detarësh, për ta siguruar dhe mbrojtur Malin e Zi.¹⁷

Në këto rrethana, ushtria e Pashës u detyrua të tërhiqej për në Shkodër, pa i arritur qëllimet e veta pushtuese. Kjo ishte një goditje e fuqishme që mori Pasha, pa pasur mundësi të riorganizohej për sulme të reja. Shqiptarët u treguan të denjë në raport me popujt e tjerë të Ballkanit, zunë vend të rëndësishëm në kuvendet ndërballkanike. Edhe pse gjatë shek. XVII, nuk u realizuan përpjekjet e tyre shekullore për t'u çliruar nga sundimi osman, shqiptarët nuk i ndalën përpjekjet e tyre çlirimtare edhe në shekujt e mëvonshëm.

¹⁷ *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, Vëll. IV (1675-1699), dok. (72): "1683 korrik 7 - Proveditori i përgjithshëm venedikas i referon Senatit për urdhrin që ka marrë Sulejman Pasha i Shkodrës që të nënshtrojë malësorët shqiptarë dhe malazezë, dha hollësira për zhvillimin e luftimeve të kaluara dhe për veprimet e flotës në ujërat e Bunës, Ulqinit e Tivarit", 132

Luan TETAJ

SUMMARY

ALBANIAN MONTENEGRIN RELATIONS IN THE STRUGGLE AGAINST THE OTTOMAN CONQUEST DURING THE XVIIITH CENTURY

Relationships between Albanians and Montenegrins date back to the earliest times, at the time Slavic tribes penetrated the Balkans. Those relations took place in different periods of conflict and cooperation until the time of the invasion of the Balkans by the Ottoman Empire. The fate of Albanians and Montenegrins under the Ottoman invasion, except some minor changes, was similar. Faced to the Ottoman invasion the Albanians and Montenegrins, cooperate in the fight against the common enemy.

During the XVIIthcentury Albanians and Montenegrins compared to other Balkan countries were more determined in their struggle against the Ottoman Empire. Their relations became more and more strengthened with the organization of inter-Balkan Assemblies: the Morača Assembly in 608, the Kuçi Assemblies on July 14 - September 8, 1614, the Belgrade Assembly in 1620. Very important decisions were made in those assemblies in order that the projects and the liberation struggle of the Balkan peoples to be supported by the most powerful states in Europe. Coastal countries like Albania and Montenegro have jointly carried out projects in the common fight against the Ottoman Empire.

Ilirjana KACELI
Alban DOBRUNA

IDETË ARSIMORE DHE SHKOLLA SHQIPE GJATË VITEVE 1908-1910

Vitet 1908-1910 u karakterizuan nga shumë zhvillime dhe ngjarje historike. Në Perandorinë Osmane kishte filluar një lëvizje kundër sulltanit e quajtur “turqit e rinj”. Ata krijuan në Stamboll një komitet të fshehtë të quajtur “Bashkim e përparim” që si qëllim kishte përmbysjen e regjimit absolutist të sulltanit, vendosjen e një regjimi kushtetues parlamentar zbatimin e reformave për modernizimin ekonomik e shoqëror. Turqit e rinj prematuan se do të njihnin të drejtat kombëtare të popujve të shtypur të Perandorisë. Kjo ishte arsyeja, që shqiptarët ishin bashkuar me lëvizjen e turqve të rinj dhe kishin bërë përpjekje të formonin në gjirin e kësaj lëvizjeje një krah demokratik-përparimtar. Ata ishin lidhur me përfaqësues të popujve të shtypur të Perandorisë Osmane si dhe me elementë të moderuar turq, të cilët synonin të përmbysnin absolutizmin e sulltan Abdyl Hamitit si dhe të shpallnin kushtetutën.

Në artikujt e botuar në shtypin e turqve të rinj dhe në korrespondencat me Ahmet Rizain e krerët e tjerë xhonturq, gjatë viteve 1896-1905, u parashtruan si kërkesa të ngutshme “njohja e kombësisë shqiptare dhe çelja e shkollave shqipe”, “bashkimin i tokave shqiptare në një vilajet të vetëm”, duke mos reshtur së parashtruari kërkesën për formimin e një Shqipërie autonome. Atdhetarët rilindës, pa marrë parasysh pengesat që nxirrnin xhonturqit, duke e vlerësuar gjithnjë si detyrë kryesore luftën për çlirimin e Shqipërisë, shfrytëzuan mundësitë legale që u krijuan pas shpalljes së kushtetutës Hyrriyetit për të organizuar në përmasa mbarëshqiptare lëvizjen politike-kulturore. Shqiptarët e përshëndetën shpalljen e Hyrriyetit,¹ sepse mendonin që triumfi i saj do të sillte një epokë të re, epokën e lirisë, barazisë dhe qytetërimit. Në fillimet e saj, kur turqit e

¹ Hyrriyeti ose Kanuni Esasiye njihet si Kushtetuta e dytë në historinë e Parlamentin osman. Në të vërtetë ajo ishte rikonfirmimi i Kushtetutës osmane të vitit 1876.

rinj sa kohë nuk i kishin forcuar mirë pozitat e tyre, ata iu bënë lëshime kombeve të shtypura duke iu dhënë disa të drejta, por më vonë filluan të merrnin masa për të kufizuar dhe më pas për të shtypur lëvizjen e gjerë kulturore-arsimore dhe politike që kishte nisur në Shqipëri.

Klubet kombëtare

Shumë shpejt atdhetarët shqiptarë e kuptuan se revolucioni xhonturk nuk do t'i plotësonte kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Prandaj, duke shfrytëzuar ato pak liri që ju ishin dhënë pas shpalljes së *Hyrriyetit* (kushtetutës) filluan të realizonin në rrugë legale disa nga të drejtat themelore në ngritjen e mëtejshme të lëvizjes arsimore e kulturore.² Liria e shpallur ishte jo vetëm e përkohshme, por një “liri e rreme”,³ prandaj atdhetarët shqiptarë nxituan drejt realizimit të objektivave politike, duke punuar për përhapjen e arsimit dhe të kulturës shqiptare si dhe për bashkimin politik të shqiptarëve. Kështu nisën ngritjen e klubeve kombëtare që u shtrinë në shumë qytete e fshatra të vendit si dhe në qytete të ndryshme të Perandorisë ku kishte shqiptarë. Sipas gazetës “Zgjimi i Shqipërisë”, këto institucione përbënin vatra ku do të afroheshin dhe do të bashkoheshin shqiptarët pa dallim feje.⁴

Klubet kishin statutet dhe programet e tyre në të cilat shprehej dhe kërkohej që kombi shqiptar të gëzonte të gjitha liritë që garantoheshin nga një regjim kushtetues, siç qe e drejta e mësimi në gjuhën amtare. Sipas tyre çdo klub kishte organet e tij drejtuese.⁵ Më 31 korrik të vitit 1908, u themelua klubi i parë shqiptar “Bashkimi” i Manastirit, me kryetar, Fehim Zavalanin, dhe anëtarë të kryesisë, Gjergj Qiriazin e Naum Naçin, që luajtën rol të rëndësishëm edhe në përhapjen e klubeve të tjera në të gjithë trojet me shqiptarë të asaj kohe. Ky klub u shndërrua në një ndër klubet më të mëdha dhe më të rëndësishëm, që luajti një rol aktiv në formimin e klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e regjimit xhonturk. Me krijimin e tij ky klub, përmes dërgimit të përfaqësuesve në qytete të ndryshme të vendit, do të krijojë komitete të reja në qytetet e

² Majlinda Peza, “Klubet, shoqëritë dhe arsimi në Elbasan në vitet 1909-1911”, *Buletini shkencor*, UNIEL: seria e shkencave shoqërore 2/2011, 115.

³ “*Dielli e Flamurit*”, 95/1911, 4.

⁴ “Të hapurit e klubeve”, *Zgjimi i Shqipërisë*, 10/1909, 2.

⁵ Kristaq Prifti, *Lëvizja politike-kulturale në Shqipëri në pragun e Kongresit të Manastirit*, Tiranë: Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit, 1972, 56.

Korçës, Vlorës, Elbasanit, Shkodrës, Shkupit, Tetovës, Beratit, Selanikut, në cilësinë e degëve të klubit të Manastirit.⁶

Gjatë vitit 1908, u hapën rreth 80 klube dhe shoqëri patriotike kombëtare.⁷ Klubet ishin organizata që përfshinin në gjirin e tyre përfaqësues nga të gjitha shtresat e shoqërisë për të mbështetur bashkimin, sepse “*jemi një komb, jemi gjithë fis, gjithë djemtë e kësaj Shqipërie*”.⁸

Në klube merrnin pjesë intelektualë, nëpunës të aparatit shtetëror, mësues shkollash, oficerë etj. Ato bashkonin në gjirin e tyre rrymat kryesore politike që u shfaqën gjatë lëvizjes kombëtare si atdhetarët me pikëpamje radikale, ashtu edhe patriotët me pikëpamje të moderuar. Së bashku me krijimin e tyre, filloi ngritja e shkollave shqipe, dhënia e mësimit të gjuhës amtare në shkollat e huaja në Shqipëri dhe u bënë përpjekje për miratimin e përdorimit të një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe.

Rëndësia e mësimit të gjuhës amtare për atdhetarët lidhej me faktin se iu siguronte shqiptarëve: ruajtjen e identitetit kombëtar, bashkimin për çlirim kombëtar, çelte rrugën drejt pavarësisë si dhe e drejtonte vendin në rrugën e progresit. Këto ishin arsyt që patriotët iu futën rrugës së botimit të librave dhe përhapjes së arsimit kombëtar çështjes më të madhe jetike për kohën: shkrimin e mësimit të gjuhës shqipe, hapjes së shkollave shqipe dhe organizimit të arsimit kombëtar.

Klubet dhe atdhetarët përfaqësues të tyre punuan shumë në përhapjen e diturisë dhe arsimit në gjuhën shqipe si dhe u përpoqën për lëvrimin e saj, për ngritjen kulturore të popullit shqiptar duke hapur shkolla, duke ngritur shtypshkronja dhe duke botuar gazeta e libra. U kujdesen për sigurimin e fondeve e të lokaleve të nevojshme e të domosdoshme, për zhvillimin e procesit mësimor, u morën me përgatitjen e personelit pedagogjik dhe njëkohësisht me sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore shkollore. Ndërkohë që në statutet e tyre këto klube do të paraqiteshin si organizata me karakter thjesht humanitar. Krahës qendrave të vilajeteve, si: Shkodër, Shkup, Manastir, Janinë, klube u hapën edhe në qytete të tjera në Shqipëri si në Korçë, klubi “Dituria” në vitin 1908,⁹ po atë vit u hapën edhe klubet “Bashkimi” në Filat dhe “Labëria” në Vlorë,¹⁰ më pas “Drita” në Gjirokastrë, në Kavajë, në Tepelenë, Leskovik¹¹ etj.

⁶ *Historia e popullit shqiptar II*, (Tiranë, Toena, 2002), 381.

⁷ Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: AlbPaper, 2002, 66.

⁸ “Klubet tanë”, *Lirija e Selanikut*, 29/1909, nr. 1.

⁹ “Dituria e Korçës”, *Dielli*, 16 tetor 1908, 2.

¹⁰ “Klubi i Vlorës”, *Lirija*, 12/1908, 2.

¹¹ “Nga Filati”, *Dielli*, 31/1990, 2.

Dy klube të mëdha që u formuan dhe vepruan jashtë trojeve etnike shqiptare, ishin ai i Selanikut dhe i Stambollit, që në krahasim me klubet e tjera ndoqën një politikë më të moderuar. Klubet gëzonin përkrahjen në popull, në një kohë të shkurtër nëpërmjet punës kulturore ata u kthyen në qendra agjitacioni dhe propagande nëpërmjet të cilave organizuan lëvizjen kombëtare. Veprimtaria e tyre për të vepruar në mënyrë legale u sillte vështirësi nga regjimi sundues, sepse u ndodhën gjatë gjithë kohës nën vëzhgimin e vazhdueshëm të veprimtarisë e tyre e cila kufizonte haptazi veprimtarinë e tyre politiko-kombëtare. Për këtë arsye, pranë tyre u krijuan komitete të fshehta, të cilët filluan të merreshin me propagandën kundërosmane dhe me organizimin e luftës për autonominë e vendit. Burimet austro-hungareze tregojnë se Komiteti i parë i Fshehtë u formua pranë klubit “Bashkimi” të Manastirit.¹² Nisi kështu një fazë e re dhe e rëndësishme në organizimin e Lëvizjes Kombëtare dhe zhvillimin e saj.

Me nismën e klubeve, për herë të parë në historinë e Shqipërisë, filluan të botoheshin brenda dhe jashtë vendit gazeta në gjuhën shqipe, si: gazeta “Korça” (1908-1910), “Lidhja Orthodoxe” (1909-1910), “Koha” (1911-1912), u botuan në qytetin e Korçës. Në Manastir doli “Bashkimi i kombit” (1909-1910) nga Fehmi Zavalani etj. Jashtë Shqipërisë vijuan të botoheshin organe të rëndësishme të shtypit atdhetar shqiptar, si: “Shqypeja e Shqypënisë”, “Shkopi”, “Rrufeja”, “Dielli”, “Liria e Shqipërisë” etj. Në vitet 1908-1912, në organet e shtypit gjetën pasqyrim problemet dhe ngjarjet kryesore të Lëvizjes Kombëtare të atyre viteve që çuan në rritjen e lëvizjes arsimore -kulturore. Në organet e shtypit u pasqyrua hapa pas hapi konflikti që shpërtheu në fillim të vitit 1910 për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Në shtypin e kohës u botuan një varg shkrimesh për mbrojtjen e kulturës shqiptare.

Hapja e shkollave shqipe më 1908

Që në fillimet e tyre klubet u bënë qendra të veprimtarisë kulturore të elitës intelektuale shqiptare, të cilët filluan përpjekjet për hapjen e shkollave dhe lëvrimin e gjuhës shqipe. Në një periudhë shumë të shkurtër, u hapën shkolla jo vetëm në qytete, por edhe në disa fshatra. Si p.sh. shkolla fillore e Elbasanit, e Vlorës, Kaninës, Tiranës,¹³ dy shkollat e Beratit,

¹² Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH) -Vj-18-5-568, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, nr.75, dt.7 dhjetor 1908, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

¹³ “Liria”, Selanik, 1908, 4 gusht 1908.

Gjirokastrë, rifilloi shkolla e vajzave në Korçë si dhe u hap shkollë për djem, po kështu edhe shkollat në Filat e në Loros të Çamërisë.¹⁴ Përpjekje për të çelur shkolla shqipe u bënë edhe në mjaft qytete të tjera, si në Dibër, Manastir, Durrës, Kavajë etj.

U hapën gjithashtu shkolla në Nistrovë të Dibrës, Manastir, Myzeqe (Libofshë), Korenckë, Gostenckë dhe Çorovodë. Shkollat shqiptare të asaj periudhe dalloheshin për karakterin kombëtar dhe laik. Ato u kthyen jo vetëm në qendra të arsimit, por edhe në vatra të zgjimit e të bashkimit të tyre kombëtar. Lëvizja për arsimin kombëtar pas shpalljes së kushtetutës së vitit 1908, u zhvillua në tri drejtime kryesore: në përhapjen e mësimit shqip në forma individuale, në hapjen e shkollave të reja shqipe dhe në përpjekjet për futjen e gjuhës shqipe në shkollat e huaja.¹⁵ Megjithatë, duhet të theksojmë se rritja e interesimit për mësim dhe këndim në gjuhën shqipe u shoqërua me kërkesën e madhe për libra në gjuhën shqipe dhe për tekste shkollore, por edhe për hapjen e shkollave të reja. Shkollat u kthyen në lëvizje të gjerë patriotike dhe ato u ndoqën jo vetëm nga fëmijët, por edhe të rriturit në kurset e mbrëmjes.

Sipas të dhënave dokumentare arkivore dhe atyre të shtypit shqiptar në periudhën gusht-nëntor 1908, në trevat shqiptare qenë ngritur rreth 20 shkolla të ditës e 15 kurse a shkolla të mbrëmjes që dëshmonin për përparim të madh në fushën e arsimit kombëtar.¹⁶ Mësimin e gjuhës shqipe filluan ta japin mësuesit patriotë, si: Hysen Ceka, Babe Dudë Karbunara, Petro Nini Luarasi, Thoma Papano, Josif Bageri, Motrat Qiriazi etj. Duke parë që kishin vështirësi për hapjen e shkollave shqipe, atdhetarët shqiptarë bënë përpjekje që mësimi i shqipes të përfshihej në sistemin shtetëror shkollos, si në shkollat shtetërore turke që ekzistonin ashtu edhe ato greke që kishin buxhet të përcaktuar nga shteti që është hapi i parë për kthimin më pas të shkollave fillore në shkolla kombëtare. Përpjekjet e para u bënë nga Refik Toptani në Tiranë, Aqif Pashë Elbasani në Elbasan,¹⁷ në Vlorë nga Jani Minga, në Shkup nga Nexhip Draga dhe në Kosovë nga mësuesit e klerikët atdhetar: Mulla Syla,¹⁸ Mulla Hamiti, Mulla Zeka, Mulla Dema etj.¹⁹

¹⁴ *Historia e popullit shqiptar*, 387.

¹⁵ Hysni Myzyri, *National Education During the Albanian Renaissance (1844-1912)*, Tiranë, 2007, 188.

¹⁶ *Historia e popullit shqiptar*, 388.

¹⁷ Gazeta "Lirija", Selanik, datë 1 shtator 1908.

¹⁸ Nuredin Ahmeti, *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912)*, Prishtinë, 2011, 113.

¹⁹ Abdullah Vokri, *Shkollat dhe arsimi në anën e Llapit brenda viteve 1878-1944*, Prishtinë, 1995, 18.

Duke u ndodhur përballë kërkesave këmbëngulëse të popullsisë shqiptare për çeljen e shkollave shqipe, Ministria e Arsimit, nxori në tetor të vitit 1908 urdhëresën, sipas së cilës gjuha shqipe futej si lëndë mësimi në shkollat mejtepe (filllore) dhe plotore (ruzhdie). Më pas mësimi i shqipes hyri edhe në gjimnazin e Manastirit.²⁰ Në kohën kur Qeveria osmane nuk bënte asnjë shpenzim për shkollat shqipe me nismën e atdhetarëve në disa qytete u krijuan fonde kombëtare lokale për çeljen dhe mbajtjen e shkollave shqipe. Nevojave të tyre për mjete didaktike dhe për libra shqip, iu përgjigjën kolonitë shqiptare në Bukuresht e Sofje, të cilët dërguan dhe pajisën shkollat shqipe me mjetet e duhura. Vetëm në vitin 1908, shoqëria “Bashkimi” e Bukureshtit, dërgoi në Shqipëri 20 mijë copë abetare dhe libra të tjerë.²¹

Kongresi i Manastirit

Hovi që mori shkolla shqipe dhe përhapja e letërsisë kombëtare shtroi nevojën për caktimin e një alfabeti të vetëm në kushtet kur disa lloje alfabetesh që përdorshin në shtypjen e librave shkollor, krijonte vështirësi në shkrimin e gjuhës shqipe. Pikërisht ky do të ishte një nga objektivat kryesore të kongresit të posaçëm që do të mbledhej më 14-22 nëntor 1908, në qytetin e Manastirit. Më 23 shtator 1908, sipas burimeve të kohës, rezulton se është bërë ftesa e parë, nga klubi “Bashkimi” i Manastirit për Kongresin e Alfabetit.²² Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare.²³ Midis delegatëve kishte personalitete të njohura të Lëvizjes Kombëtare, lëvrues të gjuhës dhe mësues të shqipes, drejtorë gazetash e letrarë në zë, si: Midhat Frashëri, At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi, Dom Nikollë Kaçorri, Bajo Topulli, Mati Logoreci, Hafiz Ibrahim Efendi Shkupi, Refik Topçani, Dhimitër Mole, Shahin Kolonja, Simon Shuteriqi, Lef Nosi, Mihal Grameno, Glikor Cilka etj.²⁴

²⁰ AIH, Vj-18-12-5463, Raport i konsullit austro-hungarez nga Janina, nr.47, 1 nëntor 1908, dërguar Ministrisë së punëve të Jashtme në Vjenë.

²¹ Hysni Myzyri, *National Education*, 193.

²² *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Botim i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: 1972, 316.

²³ Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri I, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2004, 116.

²⁴ AIH, Vj-18-9-901, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, nr.64, dt.23 nëntor 1908, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

Ky Kongres për problemet që ngriti, çështjet që diskutoi si dhe për elitën përfaqësuese intelektuale të shqiptarëve që morën pjesë, vlerësohet si kongresi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillimet e shekullit XX. Punimet e Kongresit i drejtoi Mit'hat Frashëri, ndërsa Atë Gjergj Fishta u zgjodh kryetar i Komisionit të Posaçëm për Alfabetin. Pas shumë diskutimeve, Kongresi miratoi jo një, por dy alfabete. Njëri ishte alfabeti i Stambollit, ndërtuar mbi parimin fonetik (për çdo zë një germë) me shumicën dërrmuese të germave të alfabetit latin dhe me plotësim nga alfabetet jo latine. Me alfabetin e Stambollit ishte shkruar një letërsi relativisht e pasur. Ndërsa tjetri ishte alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” të Shkodrës, i cili ishte me germa latine, që dukej si më i përdorshëm dhe më praktik. Praktikiteti i tij bëri që me kalimin e kohës ky alfabet (latini) u përhap gjithnjë e më shumë dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë alfabeti i vetëm për gjithë shqiptarët. Ishte alfabeti që edhe sot përdoret për shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe.

Kongresi i Elbasanit

Pavarësisht se në korrik të vitit 1909, shteti osman pranoi që në programin mësimor të shkollave qytetëse osmane dhe në shkollat e mesme të futej mësimi i gjuhës shqipe u pa se me lëvizjet që po bënin, pas Kongresit të Dibrës po mundoheshin me çdo mjet të dilnin kundër Lëvizjes Kombëtare. Kjo përbënte një shqetësim për elitën kombëtare të kohës e cila iu përvesh punës për thirrjen e një Kongresi Gjuhësor në Elbasan. Më 2-8 shtator 1909, u hap Kongresi i Elbasanit dhe kryetar u zgjodh Dervish Biçaku. Delegatët në Kongres ishin përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare. Në Kongres u morën disa vendime me karakter arsimor. Së pari krijimi i një shkolle Normale (qendrore kombëtare) në Elbasan, që do të përgatiste mësuesit e parë për shkollat fillore shqipe. Së dyti, u vendos krijimi i një shoqërie qendrore shkollore në Korçë, (Shoqëria e mësonjëtorëve shqipe, e quajtur “Përparimi”). Në vendimet e Kongresit parashikoheshin, gjithashtu, masa në të mirë të njësimt të gjuhës së shkruar dhe të krijimit të gjuhës së përbashkët letrare shqipe. “*Kongresi - thuhej në pikën 11 të vendimeve - u dorëzon [rekomandon] të gjithë shkrimtarëve shqiptarë që të përdorin në shkrimet e tyre, me sa t’u mundet, dialektin e Elbasanit, sepse është dialekt, që kuptohet në gjithë anët e Shqipërisë*”.²⁵

²⁵ Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, (maket), Tiranë, 1990, 200.

Së treti, zgjedhja e Klubit të Manastirit si klub qendror për dy vitet e ardhshme²⁶ etj. Vendimet e Kongresit të Elbasanit dhe formimi i Shoqërisë “Përparimi” në Korçë, ndikuan drejtpërdrejt në zgjerimin e rrjetit të shkollave kombëtare shqipe. Gjatë vitit arsimor 1909-1910, u shtua numri i shkollave e i kurseve në gjuhën shqipe dhe arsimit kombëtar u shtri në të gjitha trevat shqiptare. Në këtë situatë, zhvillimi i arsimit shqiptar e bëri edhe më të ngutshme nevojën e përgatitjes së mësuesve dhe të ngritjes së një shkolle pedagogjike.

Hapja e shkollës *Normale*, kërkonte një kuadër të mirë pedagogjik për përgatitjen e brezave të ardhshëm. Prandaj duhej sjellë për të punuar aty ajka e personaliteteve shqiptare. Për këtë qëllim, u ftuan: Qamil Bala nga Gjilani, Bajo Topulli nga Gjirokastra, Luigj Gurakuqi nga Shkodra, Aleksandër Xhuvani nga Elbasani, Sotir Peci nga Amerika etj. Shkolla Normale u hap, më 1 dhjetor 1909, cila ishte e para shkollë pedagogjike në historinë e arsimit shqip.²⁷ Drejtori i parë i saj ishte Luigj Gurakuqi që drejtonte një trupë pedagogjike me arsimtarë të njohur nga qyteti i Elbasanit dhe Tirana, si: Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Sotir Peci, Hysen Blloshmi, Hafiz Ibrahim Dalliu etj. Shkolla Normale e filloi veprimtarinë e saj me rreth 50 nxënës nga të gjitha territoret shqiptare. E rëndësishme është të përmendim se krahas viseve të tjera, “një numër mjaft i madh i nxënësve u dërgua në këtë shkollë nga vilajeti i Kosovës” dhe për këtë ishte përkujdesur atdhetari i madh Hasan bej Prishtina.

Në gazetën “Tomorri” dt.24.3.1910, shkruhej: “Nxënësit sikurse e shohim ne mos lathitemi, në shënimt që kemi marrun, janë sivjet gjithë, gjithë, njëqind e njëmbëdhjetë. Nga zemra deshërojmë motin që vjen të shtohen dhe të shumohen për me i deftyem kështu botës se sa dijmë edhe ne të çemojmë vlerën e randësien e ditunis, dhe se sa na mallënjehet zemra e na kënaqet shpirti, kur shohim që kombi ynë me çapa të sigurta po udhëton në rrugë të përparimit dhe të qytetënies së vërtetë”.²⁸ Në janar u dërguan në Normale 5 nxënës të tjerë, tre nga Gjilani dhe dy nga Vuçitërna. Po kështu edhe në shkurt 1910, Hasan Prishtina dërgoi edhe 16 nxënës të tjerë nga Kosova dhe deklaroi se: “munt të dërgojë edhe pesëdhjetë e gjashtë

²⁶ Lef Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbye historisë sonë kombëtare*, material depozituar në AME.

²⁷ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2017, 96.

²⁸ “Tomorri”, datë, 24.3.1910.

(56) të tjerë, sikur të jetë i sigurt se në Mësonjëtorë t'Elbasanit ka vend për ta".²⁹

Një vit pas hapjes, Shkolla Normale arriti të kishte 140 nxënës, nga të cilët 70 ishin nga vilajeti i Kosovës. Këtë fakt Luigj Gurakuqi do ta vlerësonte se 1/3 e nxënësve kanë ardhur "nga ajo Kosovë kreshnike që ka qenë kurdoherë çerdhe atdhetarësh të mirë e trimash skifterë".³⁰ Por, edhe Shkolla Normale nuk e pati jetën të gjatë, sepse gjatë vitit 1910 u acaruan së tepërmi marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe xhonturqve. Në të katër anët e vendit shpërthyen mitingje dhe protesta të organizuara kundër alfabetit arab dhe reaksionit xhonturk. Në Kongresin e dytë të Manastirit, që u zhvillua më 2-3 prill 1910, delegatët dënuan veprimet e turqve të rinj, veçanërisht të ndërmarra për shtypjen e kryengritjes së vitit 1910.

Xhonturqit nga ana e tyre morën masa të rrepta për shtypjen e këtyre trazirave në Shqipëri duke dërguar forcat ushtarake osmane të drejtuara nga Shefqet Turgut Pasha. Ushtria osmane mori masa të egra në Shqipërinë e Mesme, veçanërisht në Elbasan. Në këtë qytet jo vetëm që mbylli Shkollën Normale, por ndoqi e keqtrajtoi edhe përkrahësit e saj dhe anëtarët e drejtuesit e klubeve. Tortura çnjerëzore iu bënë mësuesit të Normales, Hafiz Ibrahim Dalliu, i cili u dënua nga Gjykata Ushtarake në Elbasan, me 10 vjet burgim. Në Elbasan Shefqet Turgut Pasha, i ndihmuar nga elementë turkomanë, hartoi listën e personave që do të arrestoheshin nën akuzën: "Asht përpjekë për abecenë latine, ka çue djalë në shkollën shqipe, ka lidhë miqësi me të krishterët, ka sjellë gazeta e libra shqipe" etj. Shumë mësues e patriotë të njohur që kishin punuar në Shkollën Normale e kishin ndihmuar atë, si: Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Dervish Biçakçiu, Refik Toptani, u arratisën jashtë atdheut, për t'u shpëtuar përndjekjeve. Shumë të tjerë u dënuan në mungesë dhe Lef Nosin, drejtuesin e gazetës "Tomorri" e internuan në Bursë (Anadoll), Simon Shuteriqin e keqtrajtuan etj.

²⁹ "Lirija", Nr.75, Selanik, 13 shkurt 1910, 1.

³⁰ Hysni Myzyri, *Arsimi Kombëtar Shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996, 225.

Ilijana KACELI
Alban DOBRUNA

SUMMARY

EDUCATIONAL IDEAS AND ALBANIAN SCHOOL DURING THE YEARS 1908-1910

Albanian patriotic elite took great strides in spreading and fulfilling the mission they had undertaken to open Albanian schools and teaching in their native language. Albanian patriots had to face three major difficulties: First, the obstacle by Turkish and Greek foreign authorities and reaction within the country. Second, the lack of funds and that of educated teachers. But despite these obstacles, the education and the Albanian school system, at any moment did not lack the assistance, the moral and financial support provided by the intellectuals, patriots, cultural societies, clubs and colonies of Albania inside and outside the country, especially from the Albanian diaspora. These patriots and brave men who put the interest of their homeland above their personal ones, fought for protection against fragmentation, and tried by any means necessary for the development of education and culture in their mother tongue as well as the economic progress of Albania, by totally using their personal assets and sparing no life.

Fitim RIFATI

ORGANIZATAT PARARENDËSE TË KOMITETIT “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS” (1913-1916)

Viti 1913 shënon një fazë të re në historinë e popullit shqiptar. Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) njohën formimin e shtetit shqiptar, por jo në kufijtë e tij etnikë. Prijësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u angazhuan që Shqipëria të përfshinte në kufijtë e saj politikë të gjitha viset shqiptare. Rrjedhimisht, formimi i organizatave me karakter politik dhe ushtarak, ishte i rëndësishëm për realizimin e këtij qëllimi. “Shkipnia”, “Besa Shqiptare”, “Komiteti i Fshehtë” i Kosovës”, “Klubi i Shkupit” e ndonjë tjetër, janë organizata pararendëse, të cilat në programin e tyre politik kishin synime të njëjta me ato të Komitetit “Mbrotjja Kombëtare e Kosovës”. Po ashtu, anëtarë të këtyre organizatave ishin pjesë aktive e Komitetit “Mbrotjja Kombëtare e Kosovës”.

Përmes këtij punimi, i cili e shtron këtë çështje në mënyrë analitike dhe krahasimtare, synohet t’u jepet përgjigje pyetjeve të mëposhtme, si: Kur dhe pse u formua organizata “Shkipnia”?; Cili ishte Programi i saj dhe kush bënte pjesë në të?; Kur u formua organizata “Besa Shqiptare” dhe çfarë aktiviteteve realizoi ajo?; Kur dhe pse u formua “Komiteti i Kosovës”?; Kush ishte drejtues i organizatës “Komitetit i Kosovës” dhe çfarë aktiviteteve realizoi ai?; Në çfarë rrethanash veproi “Klubi i Shkupit” dhe cili ishte Programi i tij?; Pse këto organizata politike shqiptare kanë lidhje organike dhe i paraprinë formimit të Komitetit “Mbrotjja Kombëtare e Kosovës”? Për shqiptarët në Evropën e fillimshekullit XX, organizatat, kryesisht të fshehta, paraqisnin modelin më të mirë të bashkimit politik e revolucionar, në shërbim të realizimit të të drejtave kombëtare dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare. Pas pushtimit të Shqipërisë nga ushtritë e shteteve fqinje ballkanike dhe ricopëtimit të saj nga Fuqitë e Mëdha me vendim të

Konferencës së Ambasadorëve në Londër¹, që i mohuan shqiptarëve një Shqipëri politike të shtrirë në kufij etnikë, formimi i organizatave me karakter e program politik, ishte domosdoshmëri për të mbrojtur e çliruar nga pushtimi i huaj fizionominë kombëtare në të gjitha trevat etnike shqiptare. Ndërmjet viteve 1913-1916, organizatat shqiptare si: “Shkipnia”, “Besa Shqiptare”, “Komiteti i Fshehtë” i Kosovës, “Klubi i Shkupit” e ndonjë tjetër, përfaqësojnë një lidhje organike dhe paraprijëse të formimit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, në vitin e fundit të Luftës së Parë Botërore.

Së pari, në vjeshtë të vitit 1913, kur plotësisht ishin bërë të njohura vendimet e Fuqive të Mëdha për ricopëtimin e trevave shqiptare në favor të monarkive ballkanike, para se të fillonte kryengritja shqiptare kundër pushtimin dhe aneksimit serbo-malazez, veprimtarë e atdhetarë të spikatur shqiptarë, si: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Riza Kryeziu, Mersin Dema, Mahmut Jura, Ali Pustina etj., formuan organizatën “Shkipnia”, krijimi i së cilës relatohet nga zëvendëskonsulli britanik në Manastir, Charles Alexis Greig, më 14 tetor të vitit 1913.²

Qëllimi kryesor, i shprehur në Statutin e kësaj organizate, ishte vendosja e lidhjeve të forta mes shqiptarëve dhe promovimi i bashkimit e progresit të tyre. Komiteti Shqiptar, si organi më i lartë administrativ i saj, kishte për obligim luftimin e të gjithë armiqve të brendshëm e të jashtëm “që janë kundër interesave të shqiptarëve”. Ky Komitet, duke marrë për bazë ndryshimet eventuale që mund të sillnin rrethanat politike brenda e jashtë Shqipërisë politike, do të ndërmerre masat e duhura, që kishin për qëllim avancimin dhe realizimin e interesave kombëtarë të shqiptarëve. Në çdo degë të kësaj organizate, në kuadër të organizimit të brendshëm, funksiononte Këshilli, i cili kishte për obligim zbatimin e çdo udhëzimi të Komitetit Qendror, sidomos për rastet që kishin në shprehje dënime me vdekje ndaj individëve armiqësorë apo edhe dënime të tjera, të evidentuara ose përcaktuara paraprakisht.³

¹ *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1912-1913*, zgjedhi, përgatiti dhe redaktoi: prof. dr. Muhamet Shatri, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Historisë-Tiranë, Tiranë: “Toena”, 2012, 368. Shënim në protokollin e Mr. H. C. Norman-it, Foreign Office, 26 mars 1913.

² *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913) I*, Përgatiti: Valentina Duka, Toena, Tiranë: 2012, f.242-243, Raport konfidencial i zëvendëskonsullit britanik në Manastir, C. A. Greig për Crackanthorpe në Beograd, 14 tetor 1913.

³ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914) II*, Përgatiti: Valentina Duka, Tiranë: “Toena”, 2012, 183, Raport konfidencial i zëvendëskonsullit britanik në Manastir, C. A. Greig për Crackanthorpe, 29 janar 1914; Ledia Dushku,

Simbol identifikues i kësaj organizate ishte flamuri kombëtar, i cili, së bashku me idealin kombëtar të shqiptarëve, konsiderohej “i shenjtë”. Çdokush që tregohej armiqësor ndaj flamurit dhe idealit kombëtar shqiptar, dënohej “me zjarr dhe gjak”. Masat rigoroze dhe dënimet e ashpra, që përcaktonte kjo organizatë, veç tjerash parashihnin shkatërrimin e çdokujt që ushtronte ndikim të çfarëdoshëm në kundërshtim me vendimet e Komitetit Shqiptar. Ky Komitet kishte të drejtën ekskluzive për të shprehur mirënjohje ndaj secilit anëtar që i shërbente interesave të atdheut. Po ashtu, ai ushtronte të drejtën ekskluzive për të analizuar dhe kritikuar çdo vendim që binte në kundërshtim me interesat kombëtarë të popullit shqiptar.⁴

Përbërja dhe veprimtaria e kësaj organizate ishte e rëndësishme të mbahej e panjohur për opinionin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Kryetari dhe Komiteti Shqiptar përbënin hierarkinë kryesore. Në këtë kontekst, anonimati i kryetarit, anëtarëve të Komitetit dhe anëtarësisë, kategorikisht mbeteshin sekretë, madje për këtë çështje secili betohej me zotim para kryetarit të organizatës. Kësisoj, sekreti i kësaj organizate kërkohej të ruhej deri në momentin kur “me ndihmën e Zotit, bashkimi dhe qëllimi i shqiptarëve të realizohen”. Rrjedhimisht, kryeqendra e Komitetit akordohej të jetë gjithmonë në territorin e Shqipërisë politike, ndërsa vendndodhja e saj mbahej sekret. Në këtë mënyrë, sipas raportit të zëvendëskonsullit britanik, organizimi i brendshëm i organizatës “Shkipnia” shtjellohej në njëzet e pesë paragrafë të tjerë, të cilët akoma nuk kishin rënë në duart e diplomatit britanik.⁵

“Shkipnia” kishte për synim çlirimin dhe bashkimin me Shqipërinë të viseve shqiptare të pushtuara dhe aneksuara Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Pra, kjo organizatë dëshironte formimin e një Shqipërie politike kombëtare, në territorin e së cilës do të përfshiheshin edhe Manastiri, Shkupi, Janina etj. Kjo organizatë arriti të krijonte degë në Vlorë, Shkodër, Mat, Durrës dhe në disa zona shqiptare nën Mbretërinë e Serbisë dhe Malit të Zi.⁶ Pohohet se “Shkipnia”, në kuadër të veprimtarisë së saj, bashkëpunoi me Partinë Demokratike të kryesuar nga Abdyl Ypi dhe përfaqësues të organizatave bullgare, për arsye se në programet e tyre luftohej kundër

“Shoqëria “Shkipnia” dhe Isa Boletini”, *Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, 2015, 121.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

armikut të përbashkët.⁷ Ndër aksionet kryesore të organizatës “Shqipnia”, për realizimin e Programit politik, ishte kryengritja antisërbo-malazeze e vjeshtës së vitit 1913.

Së dyti, ardhja e princ Vidit në Shqipëri, më 7 mars të vitit 1914, inkurajoi shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera të pushtuara e aneksuara. Kësisoj, më 18 mars të atij viti, në Durrës u formua Shoqëria “Besa Shqiptare”, njoftim që i relatohet konsullit austro-hungarez në Durrës, Heinrich von Löwenthal, më 25 prill të vitit 1914.⁸ Kjo organizatë kishte edhe Statutin themeltar prej 14 parimesh, që rregullonte jetën e veprimtarinë e saj dhe synonte edukimin politik të popullit shqiptar, për çlirimin e trojeve shqiptare nën zgjedhën e shteteve fqinje ballkanike. Selia qendrore e saj ishte në qytetin e Durrësit, por zyra e organizatës mund të ndryshonte në përputhje me kërkesat që shtronte veprimtaria e saj dhe natyrën e aksioneve që mund të ndërmernte. Kjo organizatë parashihte hapjen e degëve të saj edhe jashtë Shqipërisë politike. Degët do të funksiononin sipas Programit, ndërsa organizimi i brendshëm i tyre mund të pësonte ndryshime eventuale në pikëpamje të vendndodhjes dhe në përputhje me kushtet lokale.⁹

Si organ më të lartë administrativ kishte Këshillin Drejtues, numri i anëtarëve të të cilit nuk ishte i përcaktuar, por që mund të rritej në përputhje me rrethanat e brendshme të organizatës dhe nevojave të saj karshi situatës së jashtme që kërkonte realizimi i Programit. Kjo organizatë synonte shtrirjen e aktivitetit në të gjitha viset etnike shqiptare, prandaj anëtar i saj mund të bëhej secili shqiptar pa dallim përkatësie fetare. Pranimi në radhët e saj i një anëtari të ri paraprakisht kërkonte plotësimin e dy kriterëve të rëndësishme. I pari kushtëzohej me dhënien e garancisë nga dy anëtarë të organizatës për kandidatin që aspironte anëtarësimin, ndërsa kriteri i dytë kërkonte miratimin për anëtarësim nga organi kryesor vendimmarrës - Këshilli Drejtues.¹⁰ Plotësimi i këtyre dy kushteve për anëtarësim në struktura të kësaj organizate, kishte peshë specifike në jetën dhe veprimtarinë e saj, sepse paraprakisht mënjante çdo mëdyshje eventuale të organeve më të larta, duke i ofruar atyre besueshmëri se anëtari i ri

⁷ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët I*, 242-243, Raport konfidencial i zëvendëskonsullit britanik në Manastir, C. A. Greig për Crackanthorpe në Beograd, 14 tetor 1913.

⁸ *Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë* (në tekstin e mëtejshëm: *AIHT*), Fondi: Arkivi i Vjenës, Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, të përkthyer në gjuhën shqipe, Vj.24-13-1362, nr. 21/P, Raport i të dërguarit perandorak e mbretëror në Durrës, H. Löwenthal, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 25 prill 1914.

⁹ *Po aty*, Vj.24-41-4120, nr.204, Statuti i Shoqërisë “Besa Shqiptare”.

¹⁰ *Po aty*.

përfaqësonte një profil atdhetar në shërbim të qëllimeve dhe Programit të organizatës.

Statuti i kësaj organizate përcaktonte edhe organizimin e burimeve financiare. Të ardhurat financiare ajo synonte t’i siguronte përmes pagesës së kuotizacionit. Kësisoj, secili anëtar detyrohej të paguante çdo muaj një shumë prej 12 groshë, si obligim anëtarësie. Në këtë mënyrë, pagesa e kuotizacionit krijonte fondin e organizatës dhe mjetet e grumbulluara në të parashihej prerazi të shfrytëzohen dhe investohen vetëm për nevoja dhe qëllime të saj.¹¹ Përcaktimi i rrugës së organizimit dhe sigurimit të të ardhurave financiare të organizatës, përmes kontributeve vetjake të anëtarësisë, mënjante çdo pretendim të jashtëm për të dyshuar se kjo organizatë mbështetej materialisht nga organet shtetërore të Shqipërisë ose prej ndonjëres nga Fuqitë e Mëdha, të interesuara për zgjidhjen dhe avancimin e çështjes shqiptare.

Për dallim nga organizata “Shkipnia”, e cila parashihte aplikimin e masave ndëshkuese me vdekje, për çdo anëtarë që devijonte nga Programi ose vepronte kundër interesave të saj, organizata “Besa Shqiptare” parashihte largimin nga lista e anëtarësisë ose nga strukturat drejtuese nëse anëtari “ngre krye” e nuk i bindet urdhrave të Këshillit Drejtues ose nuk angazhohet e nuk punon sipas Programit dhe i kundërvihet rregullave të tij. “Besa Shqiptare” kërkonte respektimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe angazhim sipas Programit të saj, në mënyrë që të plotësohej kriteri i anëtarësisë.¹² Ushtrimi i veprimtarisë së saj përbrenda Shqipërisë politike diktonte edhe pozicionin e kësaj organizate në raport me Qeverinë e shtetit shqiptar. Në këtë kontekst, ajo nënvizoi se “mban qëndrim dashamirës ndaj Qeverisë kombëtare”. Po ashtu, ruajtja e vetive identitare dhe karakteristikave të saj programore, kishin rëndësi të madhe për veçim nga ndonjë strukturë apo organizëm tjetër politik përbrenda territorit të shtetit shqiptar. Prandaj, ajo kategorikisht nënvizoi në Statutin e saj themeltar se “nuk do të ketë lidhje me partitë personale”.¹³ Pra, respektimi i organeve shtetërore shqiptare dhe refuzimi në çdo formë bashkëpunimi me organizma e shoqëri të tjera politike në Shqipëri, ishin aspekte të rëndësishme për ushtrimin e pavarur të jetës dhe aktivitetit të organizatës “Besa Shqiptare”.

Secili anëtar i kësaj organizate, e kishte për obligim të deklarohej paraprakisht se i tërë aktiviteti i tij politik dhe e tërë qenia e tij shpirtërore, vihej në shërbim e funksion të realizimit të parimeve të organizatës. Nëse

¹¹ *Po aty.*

¹² *Po aty.*

¹³ *Po aty.*

ndonjëri prej tyre do të paraqiste elemente dyshimi e pabesie ndaj organizatës dhe mekanizmave të saj, atëherë ai shpallej tradhtar. Prandaj, paraprakisht çdo individ që paraqitej për anëtarësim, zotohej me këtë formulë betimi: *“Betohem për atë që besoj dhe jap fjalën si burrë i ndershëm se, duke ruajtur tani e kurdoherë në zemër kujtimin e martirëve të Shqipërisë, do të punoj për shoqërinë “Besa Shqiptare” e do të luftoj derisa të kem jetë për zmadhimin dhe përparimin e Shqipërisë (politike, F. R.) dhe që ajo t’i rimarrë gjithë tokat që armiqtë i kanë shkëputur dhe se do t’i quaj e do t’i kem si vëllezër të vërtetë të gjithë shqiptarët, qofshin të krishterë apo myslimanë, toskë apo gegë”*. Për këtë arsye, Programi i saj dhe Këshilli Drejtues ishin të paprekshëm. Prandaj sabotimi apo mosrespektimi i tyre nga secili anëtar nuk tolerohej në asnjë formë.¹⁴

Kjo shoqëri politike parashihte nxjerrjen e një organi zyrtar, i cili do të botohej një herë në javë jashtë Shqipërisë. Megjithëse nomenklatura drejtuese, strukturore dhe e anëtarësisë, ruhej në anonimitet, nga veprimtaria e realizuar vërtetohet se pjesëtarë të saj ishin Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri etj.

Veç tjerash, synim i saj ishte ruajtja e shqiptarësisë së trevave të aneksuara Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Operacioni për ruajtjen e veçorive kombëtare shqiptare planifikohej të niste në Kosovë, veçanërisht në zonën e pushtimit serb, ku popullsia shqiptare e kësaj treve ishte më e rrezikuar. Për këtë arsye, “Besa Shqiptare” i kërkonte asaj të refuzonte rrugën e emigrimit, të qëndronte në Kosovë dhe të ballafaqohej në formë elastike me pushtetin shovinist serbo-malazez, në mënyrë që në të ardhmen të ketë mundësi të realizojë orvatje të armatosura për çlirim.¹⁵ Kjo organizatë gëzoi relativisht përkrahjen e Austro-Hungarisë, përmes lidhjeve klandestine të orkestruara nga “Komiteti Austriako-Shqiptar”.¹⁶ Ndër aksionet e armatosura të organizatës “Besa Shqiptare”, ishte Kryengritja e mars-prillit të vitit 1914 në Kosovë.

Së treti, fillimi i Luftës së Parë Botërore prishi ekuilibrin politik edhe në Gadishullin Ballkanik. Shqiptarët e Kosovës që vepronin në Shqipëri, e konsideruan këtë situatë pjesërisht të favorshme për organizimin e një kryengritjeje të re çlirimtare në Kosovë. Në krye të kësaj ideje u vu

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*, Vj.24-13-1362, nr. 21/P, Raport i të dërguarit perandorak e mbretëror në Durrës, Lovental, dërguar MPJ në Vjenë, Durrës, 25 prill 1914.

¹⁶ Hafif Bajrami, *Shqiptarët në luftë për shtet kombëtar*, Prishtinë: “Faik Konica”, 2018, f.178-182.

Hasan Prishtina, i cili, pas përpjekjeve për të sensibilizuar qëllimin e saj, zgjodhi muajin shkurt të vitit 1915, për ta realizuar atë praktikisht.¹⁷

Në prag të fillimit të kryengritjes së armatosur, sikurse ishte vepruar njësoj në vitet 1913 dhe 1914, del në pah një organizatë e emëruar “Komiteti i Fshehtë” i Kosovës me qendër në Shkodër dhe me kryetar Kadri Prishtinën. Në kuadër të kësaj problematike, viti 1914 mendohet si referencë e gjenezës së këtij Komiteti, me disa anëtarë nga Kosova, si: Bajram Curri, Rexhep Mitrovica, Halim Gostivari, Salih Gjuka, doktor Fahri Gjilani etj.¹⁸

Në anën tjetër, gjeneral konsulli austro-hungarez në Shkodër, Karl Halla, në një telegram sekret dërguar Vjenës zyrtare, më 14 shkurt të vitit 1915, shkruan: “*Për përkrahjen e kryengritjes është formuar një Komitet nën drejtimin e Kadri Prishtinës... Ai (Komiteti) mu lut për sigurimin e një shume rreth 600 napolona ari për blerje të municionit*”.¹⁹ Mirëpo, veç një shume të vogël, të caktuar për krerë si: Bajram Curri, Mehmet e Halim Deralla etj., konsulli austro-hungarez, me sugjerimet përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, në këtë kohë nuk akordoi ndonjë ndihmë tjetër për nevoja të operacionit të shqiptarëve.²⁰

Ndër veprimet e armatosura të këtij Komiteti konsiderohet “Aksioni i Zhurit”, në shkurt të vitit 1915. Kjo organizatë, në krye me Kadri Prishtinën, vazhdoi aktivitetin edhe për disa muaj.

Së katërti, pushtimi austro-hungarez dhe bullgar i Kosovës, në nëntor-dhjetor të vitit 1915, nxiti personalitetet më të njohura të kësaj treve për t’i dhënë çështjes shqiptare një zgjidhje të re politike, konform

¹⁷ *AIHT*, Vj.25-4-455, nr.53/P, Raport i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, 19 shkurt 1915.

¹⁸ Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997, 21-24. Studiues të tjerë mbështesin tezën se kjo organizatë u krijua në pranverë të vitit 1915. Krahajo: Beqir Meta, “Ndikimi i Luftës I Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar”, *Studime shoqërore*, nr.2-2015, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2015, 192; Sali Kadria, “Aspekte të gjendjes së nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1916-1918 në zonën e pushtimit austro-hungarez”, *Studime historike*, nr.3-4/2014, viti LXVIII (LI), Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2015, 112.

¹⁹ *AIHT*, Vj.25-4-465, nr.45, Telegram sekret i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, Shkodër, 14 shkurt 1915.

²⁰ *Po aty*, Vj.25-4-499, nr.65/P, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, Shkodër, 28 shkurt 1915.

rrethanave të kohës. Në krye të kësaj ndërmarrjeje ishte Nexhib Draga, drejtues i “Klubit të Shkupit”, i formuar që në vitin 1908.²¹

Dokumentacioni i kohës e vë në qendër këtë Klub, si një organizatë me tipare politike. Në mes tjerash, kjo organizatë veçohet për disa aktivitete politike, në të cilat merrnin pjesë personalitetet më me ndikim nga qytetet e Kosovës, si: Shkupi, Prishtina, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prizreni etj. Ndër ta dallohen: Nexhib Draga, Jashar Erebara, Nexhib Mahmutbegolli, Ahmet Murteza Berisha, Ejup Gagja, Isuf Morina, vëllezërit Qamil e Qemal Kulimbare, Mehmet Ali Gjilani, Xhemal Hysen Zade etj. Një raport ushtarak austro-hungarez, i datës 19 shtator 1916, thekson se përfaqësuesit e këtyre trevave po mbanin mbledhje në ambiente të “Klubit të Shkupit”, me pretendimin për të formuar një shtet të pavarur shqiptar.²²

Ndërkohë, në fund të vitit 1916, me aplikimin e masave shtypëse nga Mbretëria e Bullgarisë ndaj propagandës politike shqiptare, u shua edhe aktiviteti i kësaj organizate. Rrjedhimisht, një Shqipëri e pavarur dhe e bashkuar në trevat etnike shqiptare, binte në kundërshtim me interesat bullgarë e austro-hungarezë dhe në përgjithësi me fuqitë e Aleancës Qendrore gjatë Luftës së Parë Botërore, prandaj pushoi edhe veprimtaria e organizatave me program politik.

Për sa më sipër, ndonëse këto organizata politike e revolucionare genë jetëshkurtra dhe me emërtime të ndryshme, nuk e shuan këmbënguljen e atdhetarëve shqiptarë për çlirim e bashkim kombëtar. Vendi ku u krijuan, koha dhe rrethanat në të cilat vepruan, karakteri dhe programi që përfaqësonin, personalitetet përbërëse që morën pjesë dhe i drejtuan hapur e në mënyrë anonime, aktivitetet politike, diplomatike e të armatosura dhe trashëgimia politike që krijuan, janë elemente të rëndësishme dhe analoge, të cilat provojnë një cikël politik e revolucionar, paraprijës i formimit të një organizate politike e revolucionare më të konsoliduar e më jetëgjatë, siç ishte Komiteti “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”.

²¹ Rreth formimit dhe veprimtarisë së “Klubit të Shkupit” në fillesat e tij, shih: Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2004, 69-72.

²² *Po aty*, Vj.26-15-1585, nr.13876, Raport i shkruar nga Rhomen, gjeneral i anterisë, drejtuar komandës epreore të armatës perandorake e mbretërore, Beograd, 19 shtator 1916.

Fitim RIFATI

SUMMARY

THE PRELIMINARY ORGANIZATIONS OF THE “NATIONAL PROTECTION OF KOSOVO” COMMITTEE (1913-1916)

The year 1913, marked a new phase in the history of the Albanian people. The decisions of the Ambassadors Conference in London (1912-1913), recognized the formation of the Albanian state, but not in its ethnic boundaries. The leaders of the National Albanian Movement, made efforts to include in Albanian political boundaries all the ethnic Albanian territories. Consequently, the formation of organizations with political and military character was important for accomplishing this goal. "Shqipnia", "BesaShqiptare", "Komiteti i Fshehtë", "Klub i Shkupit" and any other, are the forerunners whom in their political program had the same goals as those of the "National Protection of Kosovo" Committee. Also, members of these organizations were an active part of the "National Protection of Kosovo" Committee.

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Jeton DOKO

**GJENDJA E SHQIPTARËVE KATOLIKË NË VITET
GJATËDHJETA TË SHEK.XX NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SIPAS DY DOKUMENTEVE TË ARKIVIT
SHTETËROR TË MAQEDONISË SË VERIUT**

Në fondin e Komisionit Republikan të Çështjeve Religjioze i kemi gjetur 2 informata mbi pozitën e Ipeshkvisë Katolike Shkup-Prizren. Meqë në informatën e sipërpërmendur në mënyrë kategorike pranohet se 90% të katolikëve të Maqedonisë janë shqiptarë vendosëm ta botojmë në tërësi. Për Kishën Katolike të Shkupit më së shumti ka shkruar Dr. Don Gasper Gjini(1930-1985) në librin e tij “Ipeshkvia Shkup Prizren nëpër shekuj” e botuar në vitin 1986 në gjuhën Kroate, ndërsa në gjuhën shqipe është e botuar në vitin 1992. Po ashtu, ai e ka botuar librin e uratave “Shujta shpirtërore”, e botuar 2 herë në vitin 1978 dhe 1986. Ai ka qenë një atdhetar i madh dhe studiues i pa lodhur dhe i pa lëkundshëm i së kaluarës sonë fetaro-kombëtare. Këto dy dokumente i kemi gjetur në fundin e Komisionit Republikan për Çështje Fetare të Republikës së Maqedonisë, i cili fond ruhet në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë në Shkup.

Dok.1.

Shkup, nr.prot.01-70/1

4.IV.1969

INFORMATË

**PËR GJENDJEN DHE MARRËDHËNIET E KISHËS
KATOLIKE NË R.S. TË MAQEDONISË**

Siç është e njohur përveç kishës greko-katolike (uniate) [kishë katolike e ritit lindor, J.D] në RSM ekziston dhe vepron edhe kisha katolike nëpërmjet Ipeshkvisë të Shkupit. Për shkak të numrit të vogël, përveç në RSM veprimtarin e vet e zhvillon edhe në territorin e Krahinës të Kosovës

dhe të një pjese te RS të Malit të Zi. Faktikisht, pjesën më të madhe të kishave, priftërinjve dhe besimtarëve i kanë në Kosovë.

Në RSM, kisha katolike ekzistojnë në Shkup dhe Manastir ndërsa kapella në Ohër dhe Kumanovë me gjithsej 3 priftërinj dhe 1 kujdestar shpirtëror. Përveç këtyre, në RSM janë edhe 65 motra katolike prej të cilëve në Shkup 44 dhe në Manastir 21. Prej tyre 61 janë motra medicinave (Shkup 40, Manastir 21) dhe 5 janë në vende tjera pune pranë kishës, njëra është në kopsht të fëmijëve.

Sipas të dhënave jo të plota në Shkup ka rreth 200 familje katolike, në Manastir 52 anëtarë të familjeve etj. Numri më i madh i katolikëve në Shkup janë shqiptar, disa kroat dhe slloven, derisa numri i maqedonasve katolik është gati i padiskutueshëm. Në Manastir kryesisht janë kroat dhe slloven (maqedonas pothuajse nuk ka). Prej strukturës së katolikëve shihen se ende Ipeshkvin e Shkupit e përmbajnë katolikët që nuk janë me kombësisë maqedonase. Sipas kësaj mund të konstatohet se, edhe pse kisha katolike është e pranishme në Maqedoni, disa dekada te maqedonasit nuk ka arritur të ketë rrënjë më të thella. Kuptohet kjo nuk është edhe ashtu nëse merret parasysh edhe uniatët, të cilët në linjë të fundit janë pjesëtar të kishës katolike. Por para disa kohësh ishte konstatuar se numri i uniatëve po zvogëlohet.

Në jetën religjioze dhe punët religjioze është e njohur se kisha katolike është shumë aktive, për çka ndikon disiplina e hekurt. Më këtë, ajo nuk dallon prej vendeve të tjera. Aq më tepër që numri i besimtareve është kufizuar dhe ato janë në gjendje objektive të veprojnë në mënyrë të organizuar. Kjo shihet si në meshat e tyre ashtu edhe në punën fetare religjioze me fëmijët. Por në qoftë se është i vërtet konstatimi për zvogëlimin e numrit të besimtarëve, atëherë nuk ka arsye për brengosje. Kjo mundet në një fare mënyrë të shihet edhe në lidhjet dhe qe ky komision i ka me priftërinjtë si dhe sjellja e kujdesshme ndaj kishës autoqefale maqedonase.

Gjatë tërmetit të Shkupit u shkatërrua ndërtesa e Ipeshkvisë së Shkupit kështu që Ipeshkvia për një kohë u shpërngul në Ferizaj, ku edhe ende gjendet. Por, në lidhje me këtë, si dhe për shkak të sjelljes pozitive dhe ndihmës në Shkup, si nga ana e ipeshkvit Dr. Çekada, si dhe kisha katolike në përgjithësi, u morën masa të nevojshme për dhënien e lokacionit për katedrale dhe për ndërtesë administrative të Ipeshkvisë. Të gjitha këto probleme janë eliminuar dhe siç jemi të njohur Ipeshkvia merr masa konkrete rreth fillimit të punimeve ndërtimore. Siç duket, së pari do të ndërtohet ndërtesa administrative, e pastaj edhe katedralja.

Marrëdhëniet e Ipeshkvisë së Shkupit me vite janë të shkëlqyeshme për këtë ndihmë të madhe për kontakte të hapura ka dhënë edhe ipeshkvi Çekada. Shikimi i hapur dhe real ndaj punëve për interes të shtetit si dhe çështjet prej të cilave kishte interesim edhe kisha edhe ipeshkvi Çekada e ndryshoj sjelljen edhe qëndrimin i tij. Ishte gjetur zgjidhje, që nga të dy anët u pa si jashtëzakonisht i mundshëm dhe e dobishëm.

Në kohën e katastrofës së tërmetit është e madhe merita e ipeshkvit Çekada që kisha katolike tregoj interes të atillë jo vetëm në vendin tonë, por edhe në Vatikan, Evropën Perëndimore, derisa edhe në SHBA dhe Kanada, ipeshkvi Çekada aktivisht u angazhua për të ndihmuar Shkupit. Pas kësaj marrëdhënie bëheshin edhe më të sigjerta, për këtë dha kontribut edhe prifti i Shkupit Hartli (tani në Zagreb), i cili tregoj dëshirë dhe interes të madh për bashkëpunim dhe marrëdhënie të shkëlqyera. Faktikisht vite me radhë ky komision ka lidhje të mira dhe konstruktive më priftërinjtë në Shkup dhe Manastir. Kjo nuk mbeti pa jehone edhe te ipeshkvi.

Para më shumë se 1 viti ipeshkvi Dr. Smiljan Çekada është bërë argjipeshkëv i Sarajevës, ai ende udhëheq edhe Ipeshkvin e Shkupit. Por se shpejti pritet që në këtë ipeshkvi të vijë në ipeshkëv i tjetër. Kandidati për ipeshkëv ende nuk është i njohur, por, për shkak të numrit të besimtarëve besohet se do të jetë sekretari i Çekadës, Gaspër Gjini, prej kombësisë shqiptare. Në kohën e fundit ka disa fjalë se ipeshkvi i ri mund të jetë ndonjë uniat për këtë siç duket angazhohet edhe ipeshkvi Bukatko i Beogradit, përndryshe uniat. Më mirë të themi se flitet se do të jetë ipeshkëv me ndihmës. Njëri do të jetë prej kombësisë shqiptare apo person, i cili e njëj mirë gjuhën shqipe.

Është e natyrshme që të jemi të interesuar për personalitetin e personit të ri. Jepen vërtetime se Vatikani mban llogari që ipeshkvijtë të jenë mirë të pranuar, si të atillë, edhe nga ana e pushtetit. Por në vendosje ajo është e pavarur dhe përveç sugjerimeve eventuale ajo është e pavarur dhe përveç ndonjë sugjerimi eventual apo dukuri e pakënaqësisë, shteti nuk ka mundësi të ndikojë në lidhje me kandidatin. Përndryshe, edhe për Vatikanin nuk është e njëjte si reagon shteti.

Duke biseduar për vendosjen e uniatit për ipeshkëv të ri të Shkupit, shtrohet dukuria prej analizës çka kjo dot tregojë dhe cilat do të jenë pasojat tani edhe në perspektivën e ardhshme? Aq më tepër që edhe dikur tregonin ndjeshmëri të veçantë kur në vitin 1954-1955 në regjinën e Strumicës dhe Gjevgjeliës ishin priftërinj uniatet me kualifikime të larta arsimore, atëherë u morën edhe disa masa administrative. Nëse merret si reale njoftimi që ishte dhënë në "Informatën për Kishën Uniate në Maqedoni" atëherë nuk ka

për çka të dramatizohen gjërat. Por nëse merret parasysh ipeshkvi uniat te këto elemente të reja kualitative, punë organizative dhe ndonjë plan për zgjerimin e kishës uniate greko-katolike gjendja do të ishte më ndryshe. Pa marrë parasysh gjendjen e tanishme faktike se uniatizmi deri tani nuk ka mundur të këtë rrënjë të thella te popullata maqedonase është për tu besuar se në situatën e re mund të vijë deri te disa ndryshime. Apo në masë të vogël mund të vijë deri te ashpërsimi i marrëdhënieve ndërreligjioze, ndaj kësaj nuk duhet të mos shihet edhe fakti i lëvizjes ekumeniste, e cila në një farë mënyre i lidh kishën katolike me kishën ortodokse.

Analizat e deritanishme shkojnë deri te mendimi se nuk duhet që Ipeshkvia e Shkupit të këtë uniat. Por në lidhje me marrëdhëniet e përgjithshme që janë me kishën katolike si nga ana e shtetit RSM, veçanërisht nga kisha autoqefale maqedonase, me të drejtë parashtrohet pyetja e oportunitetit prej reagimeve eventuale. Për më tepër që edhe nuk mundet shumë të ndihmojë nëse Vatikani ka ardhur deri në atë vendim. Por, një sinjalizim i vëmendshëm nëpërmjet komisionit për çështje religjioze si mendim i saj do të mundë të ndikonte për ndryshimin e mendimit, në çdo rast kjo duhet të shihet si çështje e shpejtuar sepse pas vendosjes së ipeshkvit çdo reagim do të jetë pa asnjë dobi. Përndryshe, si kandidat i mundshëm-uniat për ipeshkëv përmendet Herbuti, famullitar i kishës në Zagreb, ndërsa një kohë ka qenë edhe sekretar i Çekadsës.

Në lidhje me kishën katolike duhet të shihet edhe qëndrimi i saj ndaj kishës autoqefale maqedonase në një farë mënyre edhe ndaj kombit maqedonas. Në vitin e fundit ndodhën disa ngjarje që mund të jenë si barometër për politiken e kishës katolike në këtë drejtim.

Duke u shmangur menjëherë prej qëllimeve të vërteta, sigurisht si në këtë ashtu edhe në mënyra të ndryshme, pa dyshim mund të konkludohet se kisha katolike ka simpati ndaj kishës autoqefale maqedonase, simpati dhe pozitivistet. Për këtë dëshmojë edhe Ipeshkvia në vend ashtu edhe Vatikani . Për këtë kemi shumë vërtetime. Por më të theksuara ishin ato gjatë varrimit të kardinalit Beja të delegacionit të kishës autoqefale maqedonase, veçanërisht gjatë kohës së vizitës në Rome, të delegacionit shtetëror-kulturor dhe kishtar të RSM-së, në lidhje me 1100 vjetorit prej vdekjes të Çirilit të Selanikut. Nuk ka dyshim se vëmendja që e tregoi Vatikani në lidhje me afirmimin e kombit maqedonas dhe autoqefalitetit të kombit maqedonas në lidhje me ndikimin që Vatikani e ka në botë, kjo është me rëndësi të madhe. Për ndryshe këshilli i kishës autoqefale maqedonase ka edhe disa kontakte me Selinë e Shenjtë dhe faktor të ndryshëm të kishës katolike në Jugosllavi. Kjo, jo vetëm që nuk është në lidhje me

ekumenizmin por ka edhe një ndikim jo të vogël dhe ne lidhje me afirmimin e kishës ortodokse maqedonas. Se kjo është kështu mundet të konkludohet edhe me reagimet e ashpra dhe nervozitetin që e tregon udhëheqja e kishës autoqefale serbe.

Duke e marrë krejt këtë parasysh, mund të konkludohet se ka interes dhe rezon që këto marrëdhënie me kishën katolike të vazhdojnë. Kuptohet gjithçka me një maturi dhe me një vëmendje të veçantë.

Në bazë të krejt kësaj propozohen këto konkluzione:

1. Marrëdhëniet në kishën katolike në RSM konsiderohen si të kënaqshme;
2. Si me ipeshkvin ashtu edhe me priftërinjtë duhet të vazhdojnë marrëdhëniet e bashkëpunimit, kontaktet dhe bisedat të jenë të shfrytëzuara për punën e tyre dhe veprimtarin e tyre posaçërisht te ato që mund të kenë ndikim në zhvillimin e marrëdhënieve të mira.

Kuptohet, kontaktet me përfaqësuesit e kishës katolike do tu duhet të shfrytëzohen që tu tregohen edhe aspekte të politikës të përgjithshme të RSFJ-së të kishës katolike, sepse edhe ipeshkvi i Shkupit merr pjesë në konferencën e ipeshkvijve të Jugosllavisë;

3. Njëpërmjet komisionit për çështje religjioze, do të mundet të sinjalizohet që përfaqësuesi i Vatikanit në RSFJ që të mos vendoset uniat në krye të peshkopatës të Shkupit. Por kjo nuk duhet të jetë shkak për prishjen e marrëdhënieve të vendosura normale me kishën në RSM.

Me ipeshkvin e ri, pa marrë parasysh a do të jetë uniat apo jo do, duhen të vendosen marrëdhënie normale që do të jenë në vazhdimësi të bashkëpunimit normal. Në raste se për ipeshkëv vendoset uniat do të duhet një vëmendje më të madhe të veçantë në marrëdhënie dhe të veprimtarisë.

4. Marrëdhëniet që janë të vendosura midis kishës maqedonase autoqefale dhe kishës katolike ndikojnë ndaj afirmimit të autoqefalitetit të kishës ortodokse maqedonase. Këto marrëdhënie do të jenë të dëshirueshme që edhe në ardhmëri të vazhdojnë. Por nuk do të jetë e dëshirueshme që prej këtyre kontakteve kisha katolike të merr konkluzion se duhet të jetë arbitër ndërmjet kishës maqedonase dhe kishave të tjera ortodokse.

Shkrimi i shtypit të kishës katolike, si atij në Romë, veçanërisht ai ne vend (veçanërisht “Zëri i Koncilit”) për kishën maqedonase ishte mjaft konstruktiv dhe, edhe më tej duhet të shfrytëzohet disponimi nëpërmjet gazetës “Zëri i Koncilit” të informohet opinioni për ngjarjet aktuale të lidhura më afirmimin të autoqefalitetit të kishës ortodokse maqedonase.

5. Njëpërmjet komisionit për çështje religjioze pranë Kuvendit Komunal-Shkup do të duhej të shihet që në të ardhmen të shihet mundësia rreth

ndërtimit të ordinariatit ipeshkvnor dhe kishës katedrale në Shkup, 3 prill 1969 Komisioni Republikan për Çështje Religjioze të R.S. Maqedonisë

206-01-20/1
4-70 9
000000

И Н Ф О Р М А Ц И Ј А

ЗА ПОЛОЖБАТА И ОДНОСИТЕ ВО РИМО-КАТОЛИЧКАТА ЦРКВА ВО СР МАКЕДОНИЈА

Како што е познато, покрај гркокатоличката /унијатите/ црква, во СР Македонија постои и делува и Римокатоличката црква преку скопската бискупија. С оглед на малиот број припадници, покрај СРМ скопската бискупија се протега и на подрачјето на СА Покривна Косово и на дел од СР Црна Гора. Веушност, грото на црквите и свештениците и припадниците оваа бискупија ги има на Косово.

Во СРМ католички цркви постојат во Скопје и Битола а капели во Скрид и Куманово, со вкупно 3 свештеници и еден исповедник-духовник. Покрај овие во СРМ има и 65 католички сестри од кои во Скопје 44 и Битола 21. Од нив 61 се медицински сестри или бодноголедачи /Скопје-40, Битола-21/, едни е во детска градинка и 5 се на други работи при црквата.

Според непелосните податоци во Скопје има околу 200 католички семејства, во Битола 52 члена /не семејства/ и др. Најголемиот број на католици во Скопје се доселени Албанци, нешто Хрвати и Словенци, додека бројот на Македонци-католици е скоро незнатен. Во Битола се во главно Хрвати и Словенци /македонци скоро нема/.

Од структурата на католиците се гледа дека се уште скопската бискупија ја сочинуваат католици, што не се од македонската националност. Според тоа, би можело да се констатира, дека и покрај тоа што католичката црква е присатна во Македонија неколку децении се пак меѓу македонците не успејала да фати посериозни корени. Се разбира, ова не е така ако се земат вообзир и унијатите, кои во крајна линија припаѓаат на католичката црква. Меѓутоа, неодамна беше констатирано дека и бројот на унијатите стагнира.

ИЗДАЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА СЕПТИМА МАКЕДОНИЈА
СКОПЈЕ

Faksimili i dok.1. Arkivi Shtetëror i Republikës Veriore të Maqedonisë – Shkup: fondi i Komisionit Republikan të Çështjeve Religjioze.

Dok.2.

Shkup, *tepër sekret*, Nr.prot. 08-218/1

12.XI.1969

SHËNIM

Për emërimin e ipeshkvit të ri të Shkupit

Prej më shumë se 2 vitesh ipeshkvi i Shkupit Dr. Smiljan Çekada ishte zgjedhur për argjipeshkëv të Sarajevës. Por edhe pse nuk ishte i zgjedhur ipeshkvi i ri, ai deri tani e ka udhëhequr Ipeshkvinë e Shkupit. Këto ditë jo zyrtarisht, Komisioni ishte informuar për zgjidhjen e ipeshkvit të ri. Në numrin e fundit të gazetës “Zëri i Koncilit” (Glas Koncila) i 9.11. të këtij viti është botuar lajmi se Selia e Shenjtë, Ipeshkvinë e tanishme të Shkupit e kanë ndarë në Ipeshkvi të Shkupit dhe të Prizrenit, si dhe atë se ajo do të udhëhiqet prej një ipeshkvi si ipeshkëv i “Shkupit dhe i Prizrenit”.

Për ipeshkëv të Ipeshkvisë së re të Shkupit dhe Prizrenit është zgjedhur Dr. Joakim Herbut, ndërsa për ndihmës ipeshkëv Don Nikë Prela. Sipas shënimeve të dhëna në lajm mësohet kjo:

Dr. Joakim Herbut është i lindur në vitin 1928 në Kërsturin Rus, gjatë viteve 1952-1955 ka shërbyer si sekretar i ipeshkvit të Shkupit S. Çekadës (ku ka mësuar dhe gjuhën shqipe), kurse pastaj ka qenë sekretar e ipeshkvit të Krizhevcit, Dr. Bukatkos. Pas mbarimit të studimeve të së drejtës kishtare në Universitetin Papanor në Lateran deri atëherë ka qenë ipeshkëv në Ipeshkvinë e Krizhevcit në Zagreb. Sipas kësaj Dr. Joakim Herbut është nga radhët e kishës katolike-lindore. Ndihmës i tij, ipeshkvi Don Nikë Prela është i lindur në vitin 1918 në Kotorr-Republika Socialiste e Malit të Zi me kombësi është shqiptar. Si famullitar ka shërbyer në shumë vende në Republikën Socialiste të Malit të Zi, vendi i fundit ku ka shërbyer ka qenë Mula. Për ndryshe vendimi për ndihmës ipeshkëv të Ipeshkvisë së Shkupit dhe Prizrenit e ka gjetur si ipeshkëv në Rusmanesk.

Me të dhëna të tjera për këta udhëheqës katolik deri tani ky komision nuk disponon. Konsultime për emërimet e ipeshkvit dhe ndihmës ipeshkvit nuk është zhvilluar.

12.XI.1969.

PREJ KOMISIONIT REPUBLIKAN PËR ÇËSHTJE
RELIGJIOZE TË MAQEDONISË.

СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИЧКА КОМИСИЈА ЗА ВЕРСКИ ПРАВИЛА
12. XI - 1969 г.
Бр. 218/1
СКОПЈЕ

Б Е Л Е Ж К А

За новоименуваниот бискуп Скопски

Пред повеќе од две години скопскиот бискуп Д-р. Смиљан Чекада беше именувен за надбискуп Сараевски. Меѓутоа,, бидејќи не беше именувен нов бискуп тој до сега ја додеше и скопската бискупија.

Овие дена, незванично, Комисијата беше запознаена за именување то на нов бискуп. Во последниот број на листот "Глас Конциле" од 9.XI.о.г. објавена е вест дека Св. Столица досегашната скопска бискупија ја поделила на скопска и призренска, како и тоа дека ќе се управува од еден бискуп како "скопски и призренски".

За бискуп на новата скопска и призренска бискупија именувен е Д-р. ЈОАКИМ ХЕРБУТ а за помошен бискуп ДОН НИКО ПРЕЛА. Според податоците изнесени во споменатата вест се дознава следното:

Д-р. Јоаким Хербут е роден 1923 год. во Руски Крстур, / 1952-1955 г./ служел како секретар на скопскиот бискуп Чекада /тука научил и албански јазик/, потоа бил секретар на Крижевачкиот бискуп Д-р. Букатко и т.н. После завршените студии на црковното право на Папското свеучилиште во Латеран пак се до сега бил духовник на семејството на Крижевачката бискупија во Загреб. Според тоа, Д-р. Јоаким е од редот на источно-католичката црква.

Помошниот бискуп Дон Нико Прелае е роден 1918 година во Котор- СР Црна Гора. По народност е Албанец. Како жупник служел во повеќе места во СР Црна Гора, последното место му е Кула. Инаку, поставувањето му за пом. бискуп на скопската и призренската бискупија го затекло како насловен бискуп русмански.

Со други подробности за овие католички функционери за сега оваа Комисија не располага. Посветувањето на новоименуваниот бискуп и пом. бискуп уште не е извршено.

10.XI.1969 г.

ОД РЕПУБЛИЧКАТА КОМИСИЈА ЗА ВЕРСКИ ПРАВИЛА



ОБЈАВЕН АРХИВ НА
РЕПУБЛИКА СЕРБИЈА МАКЕДОНИЈА
СКОПЈЕ

Faksimili i dok.2. Arkivi Shtetëror i Republikës Veriore të Maqedonisë-Shkup: fondi i Komisionit Republikan të Çështjeve Religjioze.

RECENSIONE

TRADITA E NDËRTIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHTETIT TË GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT

**(Pëllumb Xhufi, *Skënderbeu: ideja dhe ndërtimi i shtetit*, Tiranë:
Dituria, 2019, 239 f.)**

Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeut i kremtuar gjatë vitit 2018, veç tjerash ishte edhe një nxitje për studiuesit që përmes studimeve, artikujve e botimeve të shumta të sjellin prurje të reja për jetën dhe veprimtarinë e Kastriotit. Këtij qëllimi i ka kontribuar veçanërisht, studiuesi i mirënjohur i historisë mesjetare shqiptare, prof. dr. Pëllumb Xhufi, me studimin e tij të fundit me titull: “*Skënderbeu: ideja dhe ndërtimi i shtetit*”, botuar në Tiranë në vitin 2019 nga Shtëpia Botuese: “Dituria”.

Ky studim, siç e thekson edhe vetë autori, është një histori e përpjekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut për të krijuar, aty nga fundi i mesjetës, një shtet të bashkuar shqiptar. Këtë qëllim dhe mision të Skënderbeut, autori e sheh dhe e lidhë me një traditë dhe vazhdimësi të përpjekjeve të ngjashme që kishin bërë para tij feudalë e princër të Arbërit që gjatë shek. XII-XIII, duke e lidhur me traditën e *Shtetit të Arbrit*. Arbëri përfaqësonte një njësi të dalluar të vendeve arbërore, në të cilën, për shkak të pozitës së veçantë gjeostrategjike, u zhvilluan më së pari proceset autonomiste “*izopolitisë*” shtetformuese. Si model të shtetndërtimit, ai e veçon edhe rastin e familjes fisnike arbërore të Balshajve, e cila për herë të parë arriti që në vitin 1370 të bashkojë në një formacion shtetëror pjesë të gjëra të Veriut dhe Jugut arbëror (Zetën, Kosovën, Durrësin, Vlorën etj.). Organizmi shtetëror të arbërorët pasqyronte, pra, mënyrën e organizmit të familjes së madhe patriarkale arbërore. Këtë veçori të organizmit shtetëror të arbërorët e vuri re, për sa u përket Balshajve, G. Gelçiq, i cili shprehu i pari mendimin se “fakti që të gjithë vëllezërit merrnin pjesë në drejtimin e vendit nën sovranitetin drejtues të vëllait të madh, mund t’i detyrohet një

praktike të vjetër zakonore kombëtare”. Në rastin e Balshajve, kjo mënyrë organizimi tipike e familjes dhe e shtetit tek ata, që është e njëjta me atë të princërve të tjerë bashkëkohës arbërorë, përbën një provë më shumë të origjinës së tyre arbërore. Një formë e tillë “feudalizmi familjar”, sipas autorit, përbënte padyshim një faktor kohezioni e solidariteti.

Gjenia e Skënderbeut, sipas Xhufit, qëndron në faktin se në qendër të përpjekjes së tij ai vuri luftën për jetë a vdekje kundër invazionit osman. Kjo zgjedhje e pakompromis e diferencoi dukshëm imazhin e Kastriotit nga ai i shumë sovranëve e princërve të tjerë të Evropës e Ballkanit, që u dorëzuan ose nuk u qullën përballë rrezikut osman.

Autori i këtij libri, mbështetur në një pasuri të madhe dokumentesh arkivore dhe një bibliografi të gjerë, tregon përpjekjet e heroit, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, që krahas luftës tepër të vështirë kundër invazonit osman, të punojë për të realizuar idenë e ndërtimit të një shteti të bashkuar shqiptar. Skënderbeu dha sinjalin e kryengritjes shqiptare në vitin 1443, në kohën kur Huniadi i Hungarisë po u mbyllte osmanëve rrugën drejt Evropës Qendrore, dhe heroi shqiptar, i ndërgjegjshëm për rolin e jashtëzakonshëm gjeopolitik që fitonte Shqipëria, vendosi të ngrinte një digë të dytë në brigjet lindore të Adriatikut, që u mbyllte osmanëve rrugën drejt Italisë dhe Perëndimit përgjithësisht. Shqipëria mesjetare po fitonte një rol të ri gjeostrategjik, që Skënderbeu e shfrytëzoi në funksion të projektit të tij të krijimit të shtetit të bashkuar arbërorë, duke thyer pritjet e duke e vendosur Arbërinë e arbërorët në qendrën e përplasjes epokale Lindje-Perëndim. Andaj, ai po i jepte atyre një dimension e funksion ndërkombëtar prej protagonistit, të panjohur më parë. Thënë më thjeshtë, ai i jepte luftës për liri dhe për shtet të përqendruar të arbërorëve, një dimension mbarevropian.

Si asnjëherë, epopeja e lavdishme e Kastriotit dhe e popullit të tij, u bë kryeshqetësimi i kancelarive evropiane. Siç do të shprehej edhe Senati i Venedikut, “*fundi i Shqipërisë do të thoshte fundi i Italisë dhe i mbarë botës së krishterë*”. Për këtë mision të tij, si barrierë e Evropës përkundrejt vërshimit osman, ishte më se i ndërgjegjshëm vetë Skënderbeu, i cili pikërisht për këtë arsye, i lejonte vetes, siç u shpreh vetë ai në një rast, “*ta ngrinte fort zërin*” përpara përfaqësuesve të shteteve më të fuqishme të kohës, që, ndryshe nga ai, u vidheshin detyrimeve të luftës së përbashkët.

Prestigji i jashtëzakonshëm ndërkombëtar, që Gjergji ynë fitoi në fushat e betejës kundër osmanëve, nga njëra anë i siguronte atij mbështetjen e Evropës së krishterë në luftën antiosmane, por nga ana tjetër bëri të mundur legjitimimin e përpjekjes për të ndërtuar një mbretëri shqiptare. Këtë projekt të tij e njihnin tashmë në vitin 1463 si papa Piu II, ashtu edhe

Mbretëria e Napolit, Republika e Venedikut, ajo e Raguzës etj. Në fund, sukseset ushtarake të Skënderbeut, pas vitit 1451, fuqizuan ndjeshëm pozitën e tij në raport me princërit e tjerë shqiptarë. Siç vërehet me të drejtë Kenneth M. Setton, ylli i principatave të ndryshme të Topiajve, Balshajve, Muzakëve, Arianitëve përëndoi për t'i dhënë jetë një shteti të përqendruar në duart e një njeriu të vetëm, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Një peshë të veçantë në këtë studim, Xhufi i kushton tezave dhe hipotezat që kanë ekzistuar dhe vazhdojnë edhe në ditët e sotme për dhe kundër shtetit të Skënderbeut, vlerësimet, motivet, arsyet dhe qëllimet e këtij shteti. Në kuadër të kësaj tematikë, autori vë përballë njëri tjetrit argumentet dhe kundërgargumentet e autorëve, si: *Eduard Gibbon, J. Ph. Fallmerayer, David Abulafia, Steven Ruciman, Nenneth M. Setton, Oliver J. Schmitt* e ndonjë tjetër.

Vlerësimet mbi shtetin e Kastriotit, prof. Xhufi i fillon me historianin anglez të shek. XVIII E. Gibbon, i cili dha disa konsiderata për Skënderbeun në kuadrin e veprës së tij shumëvëllimëshe mbi Perandorinë Bizantine, ndonëse ai e njihnte shumë pak historinë e shqiptarëve. Ky autorë, luftën antiosmane të shqiptarëve në shek. XV e sheh si vepër të një njeriu të vetëm, të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Por ky, sipas Gibbonit, e ngriti flamurin e kryengritjes e të qëndresës nisur nga motivi i lavdisë së tij personale dhe i hakmarrjes. Gjithnjë sipas Gibbon, lavdia e heroit nuk mund të ngrihej veçse me rrënimin e atdheut të tij. Sipas tij, nëse Skënderbeu do të kishte peshuar mes pasojave të nënshtrimit dhe atyre të qëndresës, ai duhej të kishte hequr dorë nga një luftë e pabarabartë, rezultati i së cilës varej nga jeta dhe gjenia e një burri të vetëm. Ndonëse këto ide janë hedhur poshtë si të pabazuara që në vitin 1857 nga Fallmerayer, megjithatë disa studiues të ditëve tona, kanë marrë guximin t'i ripërthypin pa ndonjë kritikë vlerësimet e Gibbonit. Në mesin e tyre, dallohen David Abulafia, Steven Runciman dhe Oliver J. Schmitt.

Derisa dy të parët, nuk janë të njohur për ndonjë kontribut të veçantë në njohjen e rrethanave shqiptare dhe të Skënderbeut, autori i tretë, Schmitt, ka bërë një monografi të tërë mbi Skënderbeun. Andaj, caku i kritikës së prof. Xhufit është i orientuar drejt vlerësimeve që ky i fundit i ka bërë figurës së heroit tonë.

Që në fillim të kritikës, Xhufi, lexuesit ia bënë me dije se “idetë” e Schmittit mbi Skënderbeun ishin të kopjuara nga historiani anglez i shek. XVIII, E. Gibbon dhe të njëjta i ishin *servuar* lexuesit si ide origjinale të tij, në librin Skënderbeu (Tiranë: K&B, 2008, 578 f.), me autorë O. J. Schmitt. Në këtë libër, Schmitt pretendon të ketë “zbuluar” sekretet, që, sipas tij,

qëndrojnë në sjelljet dhe veprimet e Skënderbeut. Gjithnjë, sipas tij, në luftën e tij 25-vjeçare nuk ka asgjë heroike e sublime; ajo nuk ishte një luftë për liri dhe nuk ishte ngjarje kombëtare. Ato ishin thjeshtë vepra në kërkim të lavdisë personale dhe me motive hakmarrjeje për vrasjen e babait, Gjonit, nga ana e Sulltan Muratit. Si e tillë, lufta e shqiptarëve në krye me Skënderbeun, me efekte jashtëzakonisht formësuese e ndërgjegjësuese, kthehet nga Schmitt në një mikrodramë personale me motive hakmarrjeje. E vërteta është se Schmitt nuk ka asnjë ide apo argument origjinal kur e shpjegon motivin e luftës së Skënderbeut me arsye personale dhe hakmarrjeje. Pavarësisht se ai nuk e citon, idetë në fjalë ishin dhënë që në shek. XVIII nga Eduard Gibbon. Si e tillë, këto ide ishin *vjedhur* nga Schmitt duke u prezantuar lexuesit si “*zbulime*” të tija. Andaj, prof. Xhufi, është i pari ndër ne, i cili, duke i njohur mirë burimet e “idesë” së Schmittit, e dekonspiron dhe e zhveshë në tërësi autorin zviceran nga mashtrimet, duke na bërë me dije se *idetë* e tija janë thjeshtë *riciklime* të Gibbonit.

Përderisa Gibbon nuk kishte ndonjë interes për historinë e Skënderbeut, dhe nuk kishte ndonjë studim të veçantë për të, në rastin e Schmittit, i cili e riciklon *tale quale* tezën e Gibbonit, si studiues i ri, ai kërkon me çdo kusht të thotë diçka të madhe, diçka sensacionale, për një figurë të mirëkonsoliduar të historisë shqiptare dhe evropiane, siç është Skënderbeu. Kështu, Schmitt, duke mos vlerësuar rezultatet e historiografisë shqiptare, në përpjekje gjoja, për të “*demistifikuar*” figurën e Skënderbeut, ai rrëshqet dhe përfundon të tezat joserioze dhe të paargumentuara të E. Gibbonit.

Studiuesi, P. Xhufi, i dëshpëruar me operacionin e Schmittit, duke e vlerësuar si një studiues të talentuar dhe zotërues të burimeve për historinë e Skënderbeut, ai mundohet të gjejë arsyet që kanë mundur ta shtyjnë Schmittin në këto veprime joshkencore. Sipas Xhufit, përkundër dyshimeve të shumta që ka, ai mendon se pas tentativës për ta deformuar të vërtetën mbi figurën e heroit, qëndrojnë thjeshtë interesa sensacioni e marketingu që Schmitt dëshiron t’i bëjë imazhit të tij.

Megjithatë, tezat e Schmittit dhe ndonjë tjetër si ai, nuk ia kanë arritur t’i lëkundin të arriturat e konsoliduara në historiografinë për Skënderbeun edhe luftën antiosmane të shqiptarëve të shek. XV. Autori, P. Xhufi, arrin në konkluzion se përveç studimeve të shumta nga A. Buda, K. Frashëri, A. Plasari etj., edhe në planin formal, dokumentacioni arkivor në arkivat e vendeve perëndimore, sidomos atyre italiane, ofrojnë shembuj të shumtë që flasin qartë e prerë për një *shtet* (status) të Skënderbeut.

Historia 25-vjeçare e shtetit të Skënderbeut tregon se si ai, në luftë e në paqe, ka kryer funksionet bazë të mbrojtjes, të politikës së jashtme, të financave, të tregtisë, të drejtësisë, të shërbimit kufitar, të atij të zbulimit, të prezantimit simbolik e ceremonial etj. Duke e lidhur fatin e këtij shteti drejtpërdrejt me luftën kundër invazionit osman, Skënderbeu arriti të kompaktësojë radhët e krerëve arbërorë që në Kuvendin e Lezhës, më 2 mars 1444, të izolojë të pavendosurit e të sigurojë mbështetjen e shteteve të krishtera të Evropës si për përballimin e luftës, ashtu edhe për zgjerimin e fuqizimin e shtetit të tij. Nga ana tjetër, gjendja e përhershme e luftës i dha shtetit të Skënderbeut një karakter mbizotërues ushtarak. Duke qenë në fushëbetejë me osmanët, edhe funksione të tilla bazike shtetërore, si veprimtaria ekonomike e tregtare, u vunë kryekëput në funksion të luftës dhe ndiqnin nevojat e saj.

Libri më i ri i prof. Pëllumb Xhufit, *Skënderbeu: ideja dhe ndërtimi i shtetit*, është një kontribut i ri, në historiografinë mbi Skënderbeun, i cili do të ndihmojë studiuesit dhe lexuesit e pasionuar pas historisë së heroit, që të njihen më mirë me traditën dhe funksionimin e shtetit të Skënderbeut.

Gjon BERISHA

GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU NË 550-VJETORIN E VDEKJES

(Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes”, mbajtur në Prishtinë, më 16 tetor 2018), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2019, 317 f.

Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, më 16 tetor të vitit 2018, Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë Tiranë dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, organizuan në Prishtinë Konferencën shkencore ndërkombëtare: “*Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*”. Mbajtjes së kësaj Konference që iu kushtua 550-vjetorit të kalimit në amshim të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut i paraprinë një sërë aktiviteteve kulturore e shkencore, si: ekspozita, tryeza shkencore, botime tematike, emisione televizive etj. Manifestime shkencore-kulturore gjatë gjithë vitit 2018, përveçse në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi, në kujtim të përvjetorit të Heroit tonë u mbajtën edhe në shumë vende të botës.

Para një auditori të gjerë, ku merrnin pjesë personalitete të larta të jetës politike, shoqërore e kulturore të vendit, përfaqësues diplomatik të akredituar në Kosovë, studiues, historian e studentë, studiuesit patën rastin që përmes kumtesave të tyre t’i prezantojnë rezultatet e tyre shkencore. Në dy sesionet shkencore të Konferencës, të cilat i zhvilluan punimet në Sallën e Madhe të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, me kumtesa morën pjesë mbi 30 studiues nga të gjitha trevat shqiptare si dhe ata ndërkombëtarë nga Akademia e Shkencave të Hungarisë, nga Rumania, Polonia etj. Që të gjithë këta studiues, përmes kumtesave të tyre shpalosën të dhëna dhe interpretime

të reja mbi figurën dhe epokën e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Duke vlerësuar cilësinë e kumtesave dhe prurjet e reja që sollën shumë prej tyre, redaksia e botimeve të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, vendosi t’i publikojë në një vëllim të veçantë, të cilën tashmë lexuesit e kanë në dispozicion.

Në këtë përmbledhje studimesh, personaliteti i Skënderbeut, gjen trajtim nga aspekte dhe fusha të ndryshme: si nga fusha e historisë politike e ushtarake, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të arkeologjisë, rolit dhe funksionit të Skënderbeut si burrë shteti dhe udhëheqës ushtarak në plan shqiptarë e ndërkombëtar, rolin e tij në Betejën e Dytë të Kosovës, për të vazhduar me tema mbi vendin që zë figura dhe epoka e Skënderbeut në historiografinë kombëtare dhe në atë ndërkombëtare, trajtimet e ndryshme letrare në letërsinë shqipe dhe në atë botërore, në publicistike e në vepra artistike.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, hyri në skenën e historisë në një moment tepër kritik për Shqipërinë dhe për fatin e Evropës. Nën udhëheqjen e tij lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë të lartë e të organizuar, shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të vendit dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Figura e tij paraqet një nga ato raste, jo të shpeshta në histori, kur shtresat e ndryshme shoqërore të një kombi takohen me një personalitet të shquar, në të cilën gjejnë shprehjen e vet aspiratat e vetitë e tyre më të mira dhe që për këtë arsye bëhet simbol i bashkimit kombëtar dhe i luftës së tyre të përbashkët. Ai e kuptoi, më qartë se kushdo tjetër, detyrën që shtronte çasti historik, nevojën e bashkimit politik si kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e interesave të vendit. Duke njohur këtë botëkuptim, se shqiptarët nuk mund të arrinin në fitore, pa kapërcyer copëtimin politik të vendit në një varg zotërimesh, pa një bazë organizative të qëndrueshme, pa bashkërendimin e mjeteve dhe të burimeve njerëzore, ekonomike, ushtarake e materiale e të gjitha veprimeve që zhvilloheshin në rrafsh të brendshëm me veprimet e ndërmarra në aspekt ndërkombëtar, Skënderbeu ndërmoi veprime konkrete. Një nga hapat e parë në këtë drejtim që themelimi, me nismën e nën drejtimin e tij, i Besëlidhjes Shqiptare të Lezhës, që përbënte të parin bashkim të gjerë politik të shqiptarëve. Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me botën e jashtme.

Njëra ndër vendet me të cilat Skënderbeu ndërtoi raporte ndërshtetërore ishte edhe Republika e Raguzës, temë e trajtuar nga studiuesi Gjon Berisha “*Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe qëndrimi modus vivendi i*

Republikës së Raguzës”. Që nga fillimi i pushtimeve osmane në Ballkan, Ragusa shërbeu si qendër e informacioneve në Evropën e krishterë lidhur me rrethanat në Arbëri, ku zhvilloheshin luftime kundër pushtuesit osman dhe përmes Raguzës mbaheshin lidhje me mbretin hungarez Sigismundin. Lidhjet e Kastriotëve me Raguzën të dokumentuar, sipas këtij studimi, na dalin shumë herët. Që më 21 mars 1413 Gjoni ishte bërë qytetar i Raguzës, pas vendimit të Këshillit të Rogatëve. Këto u intensifikuan më 1420, me arritjen e një marrëveshje tregtare ndërmjet Gjon Kastriotit dhe Raguzës në bazë të së cilës tregtarët raguzan do të paguanin vetëm një doganë nëpër zotërimet e Gjonit, kurse ai u garantonte atyre sigurinë e kalimit nëpër gjithë atë zonë; për tu ngritur edhe më lartë në vitin 1439, kur Republika mori vendim për t’u dhënë djemve të Gjon Kastriotit qytetarinë. Marrëdhëniet ndërmjet Raguzës dhe Skënderbeut edhe nga fundi i viteve ‘50 të shek. XV, kishin të bënin, kryesisht me mjetet financiare për luftën anti-osmane në Arbëri. Gjatë luftërave të tij, Skënderbeu, disa herë e vizitoi Raguzën, sidomos gjatë udhëtimeve të tij për në Itali. Në këto raporte të ndërsjella, u angazhuan edhe diplomatë arbërorë, siç ishin vëllezërit Gjon e Pal Gazulli, kurse Skënderbeu kishte edhe depozita financiare në qytetin e Raguzës.

Që nga gjysma e parë e shekullit XV, pas pushtimit të Bosnjës ata u bënë fqinj të drejtpërdrejtë të Republikës së Raguzës. Në këto rrethana, raguzanët, si tregtarë që ishin, kishin kuptuar shumë më herët se kjo do të ndodhte dhe kishin vendosur marrëdhënie diplomatike me osmanët. Kontaktet e para zyrtare politike filluan më 1392, kurse përpjekjet e raguzanëve për të negociuar garancinë për tregtinë e tyre në Ballkan, me Sulltan Bajazidin I (1389-1402), u kurorëzuan në vitin 1396. Pas kësaj, kontaktet vazhduan. Raguzanët intensifikuan kërkimet e tyre për një *modus vivendi* me osmanët pas betejës së Varnës më 1444. Në këto rrethana dhe kushte u zhvilluan edhe raportet me Skënderbeun.

Figura e Skënderbeut gjeti trajtim edhe nga prizmi i trashëgimisë së shekujve të mëvonshëm, duke shërbyer si shembull për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në shek.XVII-XVIII. Në këtë drejtim, të dhëna të reja sjellë studimi i historianit hungarez Antal Molnár, me temë “*Kujtimi i Skënderbeut dhe fillimi i ndërtimit të kombit katolik shqiptar*”. Sipas Molnar, falë programit dhe misionit kombëtar të prelatëve katolikë, Kosova u bë djep i identitetit kombëtar shqiptar. Sipas studiuesit, Molnár, klerikët shqiptarë përdorën kauzat e humanistëve dhe intelektualëve me origjinë shqiptare, të cilët studionin dhe vepruan në universitetet italiane në shekujt XV dhe XVI. Boshti i traditës kombëtare mbi të cilën u farkëtua kjo ide

ishte kulti i Skënderbeut, që kishte mbijetuar në frymën humaniste, por edhe ndër malësorët katolikë shqiptarë.

Pas kthimit të Skënderbeut në Arbëri, edhe familjet fisnike drishtase si familjet e tjera fisnike shqiptare të asaj kohe, e përkrahën Skënderbeun. Përkrahja e parë e tyre erdhi me pjesëmarrjen në Kuvendin e Lezhës, e thirrur nga Skënderbeu, më 2 mars të vitit 1444, në qytetin e Lezhës. Në kohën kur u mbajt Kuvendi në fjalë, siç është e njohur, qyteti i Drishtit ndodhej nën sundimin e Venediku, por fillimisht një gjë e tillë nuk i pengoi fisnikët drishtas si, Pjetër Spanin dhe Lekë Dushmanin, që të marrin pjesë në këtë Kuvend. Çështja e qytetit mesjetar të Drishtit, u trajtua nga studiuesja Teuta Shala-Peli, me titull: *“Përpyjekjet për çlirimin e Drishtit nga sundimi Venedikas, në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”*. Sipas saj, qyteti i Drishtit sikurse qytetet tjera të Shqipërisë së Veriut, nuk kishte një jetë të qetë politike jo vetëm para periudhës së Skënderbeut, por as edhe gjatë saj. Duke u mbështetur në burimet dhe literaturën, të cilat i referohen zhvillimeve politike në qytetin e Drishtit gjatë periudhës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, kemi vërejtur se në periudhën kohore 1443-1468, kishte disa tentime për ta shkëputur Drishtin nga sundimi venedikas. Mirëpo, edhe përkundër këtyre përpjekjeve, qyteti i Drishtit vazhdoi të mbes nën sundimin venedikas deri në vitin 1478, kur edhe përfundimisht kalon në sundimin osman.

Aspektet e politikës së jashtme të Heroit tonë Kombëtar, si dhe raportet e tij me Selinë e Shenjtë, janë trajtuar nga studiuesi Dominik Qerimi, *“Marrëdhënia e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë Shenjtë, klerin dhe Kishën Katolike”*. Ky studim, përfshinë pikëpamjet se si kjo çështje gjatë historisë është parë dhe gjykuar me kritere të ndryshme, varësisht nga rrethanat ideologjike dhe pushtetit politik të kohës. Studiuesi merr për bazë qasjen ndaj kësaj çështjeje nga ana e studiuesve në periudhën e komunizmit dhe atë të post komunizmit.

Sipas studiueses Evalda Paci, e cila, përmes studimit saj: *“Vepra e Marin Barletit në pikëpamje vëzhgimesh ndërdisiplinore”*, Marin Barleti përfaqëson një prej autorëve më të studiuar nga ana e historianëve dhe medievistëve, ndërkohë që dija e filologjisë ka dhënë padyshim një kontribut të pamohueshëm dhe në lidhje me orientimin ndaj interpretimeve më të thelluara të teksteve të veprave të tij. Roli i shqipëruessve që janë marrë me Rrethimin e Shkodrës dhe me Historinë e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, konsiderohet dhe rimerret në vëzhgimet tona çdo herë që kemi në dorë për qëllime konsultimi variantet në gjuhën shqipe që duke u bërë dhe objekt ribotimi, kanë ardhur sërish në vëmendjen e filologut, i cili

shqyrton dhe vë në dukje modifikimet që vihen re në pasazhe të ndryshme të kapitujve a krerëve të caktuar të veprave në fjalë, ndryshimet që mund të jenë realizuar dhe me vetëdije nga ana e kujdesuesve të këtyre botimeve, elementet që duke qenë ideuar të ndihmojnë dhe të mbështesin *brendësimin* e teksteve në fjalë, dhe mund të jenë vendosur në pjesë përmbyllëse të botimeve, duke pasuar gjithë shtjellimin e përmbajtjes.

Gjithnjë sipas studiueses, Paci, veprat e Marin Barletit duket se u përpiluan në një kontekst favorizues në shumë pikëpamje, ndërkohë që dhe studimi i rrethanave në të cilat ato u konkretizuan shpie në konkludime mbi një panoramë më të gjerë që mbetet dhe dëshmi e rëndësisë që kishte në atë kohë kultura e shkrimit, por dhe përjetësimi i një kujtese me rëndësi dhe vlerë kombëtare.

Është e natyrshme, se më rastin e një përvjetori të tillë, të trajtohen edhe raportet e Skënderbeut, me njërin ndër personalitet më të njohura të kohës, siç ishte Janosh Huniadi. Kjo tematikë u trajtua nga studiuesi hungarez nga Budapesti, Krisztián Csaplár-Degovics me studimin e tij në gjuhën angleze: *“The first appearance of the Hunyadi - Skanderbeg alliance in the albanian historiography”*, në të cilin na ofron të dhëna të rëndësishme mbi atë se si janë trajtuar raportet e Huniadit me Skënderbeun në historiografinë shqiptare dhe në atë austro-hungareze të shek.XIX, përkatësisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Meqë trevat shqiptare kishin qenë nën sundimin osman, veprat e kronistëve osmanë, kanë qenë pikë referimi e shumë studiuesve shqiptarë të cilët kanë pasur si objekt kërkimi historinë e shek.XV. Sipas studiuesit Eduart Caka *“Aspekte të situatës politiko-ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV bazuar në regjistrat kadastralë osmanë të kësaj periudhe”*, më i saktë se informacioni që japin kronikat është dokumentacioni i madh osman që gjendet nëpër arkivat e ndryshme të vendeve që më herët kishin qenë pjesë e Perandorisë Osmane. Në këtë kontekst, dokumentacioni arkivor osman, duke nisur qysh nga gjysma e dytë e shek. XX është përdorur edhe prej autorëve shqiptarë. Në kuadër të dëshmimeve, burimet më të rëndësishme osmane të cilat mbartin të dhëna në lidhje me këtë shekull janë defterët kadastral osmanë. Kjo, për vetë faktin se akti i parë që osmanët kryenin pas instalimit të pushtetit të tyre në një zonë të caktuar ishte regjistrimi i popullsisë dhe të ardhurave të atij vendi dhe, vendosja e sistemit të timarit. Si për periudhën e përpilimit ashtu edhe për saktësinë e informacionit që përmbajnë, defterët kadastral osmanë paraqesin një rëndësi të veçantë në studimin e hapësirës shqiptare të shekujve XV-XVI. Regjistrat në fjalë gjithashtu na japin të dhëna tejet të rëndësishme edhe në

lidhje me epokën e Skënderbeut, periudhë e cila zë një vend parësor dhe tejet të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar.

Mbi bazën e regjistrimit kadastral osman të viteve 1467-1468, një kontribut për të ndriçuar aspekte socio-etnike që karakterizuan nahijen e Tetovës në këtë kohë, kan dhënë studiuesit Qerim Dalipi dhe Besim Morina *“Rrethanat socio-etnike në nahijen e Tetovës, sipas regjistrimit të viteve 1467-1468”*. Në këtë kontekst, sipas tyre pasi sqarohen rrethanat e përfshirjes së nahijes së Tetovës në kuadër të qarkut të Shkupit dhe më pas të pashasaxhakut të Shkupit, hidhet dritë mbi regjistrimin osman, shtrirjen territoriale dhe vendbanimet që ishin në kuadër të saj, numrin e banorëve dhe të timarlinjve, rrethanat fetare etj. Gjithashtu, duke shfrytëzuar literaturë relevante mbi antroponimet dhe patronimet, por edhe mbi toponimet arbërore, të cilat gërshetohen me ato të pranishme në këtë nahije, studiuesit në fjalë, nxjerrin në sipërfaqe struktura etnike, në veçanti prania e arbërve në trojet e tyre etnike.

Për rolin, mënyrën e trajtimit dhe portretizimit të Skënderbeut në kronikat klasike osmane, një rëndësi të veçantë zë edhe studimi i osmanologut, Iljaz Rexha, *“Skënderbeu nga këndvështrimi i kronikave klasike osmane dhe i historiografisë moderne turke”*.

Ndër ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare të shekullit XV, padyshim, radhitet edhe Beteja e Dytë e Kosovës (1448), në të cilën spikasin figurat e dy personaliteteve më të njohura të kohë, Skënderbeut dhe Huniadit. Në këtë libër, kjo tematikë është trajtuar nga disa studiues: B. Muhadri *“Beteja e Dytë e Kosovës, më 1448, sipas autorëve shqiptarë të kohës: Marin Barleti, Dhimitër Frangu”*; E. Rexha, *“Historiografia serbe për Betejën e Dytë të Kosovës, 1448”* dhe P. Thëngjilli, *“Vështrim kritik mbi bazën dokumentare dhe bibliografike të Betejës së Dytë të Kosovës (1448)”*.

Në këtë libër, një hapësirë të rëndësishme ka zënë edhe fusha e arkeologjisë mesjetare. Njëra ndër studimet e kësaj fushe është ajo e arkeologut Adem Bunguri. Objekt i këtij punimi janë rezultatet e vrojtimeve sipërfaqësore të kryera nga autori në disa nga fortifikimet e kësaj periudhe, topografikisht të lokalizuara në rajonin e Dibrës. Ai synon jo vetëm paraqitjen para opinionit shkencor të këtyre rezultateve, por edhe korrigjimin e ndonjë mendimi voluntarist që nuk i përgjigjet të vërtetës historike. Që në fillim, studiuesi Bunguri, konstaton mbi përputhjen e plotë të përshkrimeve të Barletit me topografinë e kalave të Skënderbeut në terren, aq sa shpesh mbetesh i mahnitur nga detajet dhe saktësia e tyre. Kalatë dhe strukturat fortifikuese që lidhen me periudhën e Skënderbeut në rajonin e Dibrës të trajtuara janë: Kalaja e Koxhaxhikut, Kështjella e

Modricit, Kalaja e Skudrinës, Kalaja e fshehtë e Skënderbeut, Qyteza e Valikardhës, Kulla e Skënderbeut dhe Qyteti i Stelushit. Fortifikimet mesjetare dhe të dhënat arkeologjike të paraqitura në këtë studim, dëshmojnë se gjatë epopesë Skënderbejane, rritet ndjeshëm numri i vendbanimeve dhe fortifikimeve ushtarake, dukuri që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, Dibra, shndërrohet në këtë periudhë në një rajon strategjik të luftërave çlirimtare të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot-Skënderbeut.

Për vetë rëndësinë dhe rolin e spikatur që pati figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në historinë e Shqipërisë, jo pak diskutime janë ngritur hera-herës qoftë në rrafshin studimor historiografik, qoftë edhe në rrafshin politiko-mediatik, mbi origjinën dhe përkatësinë etnike apo krahinore të tij. Në këtë drejtim, studiuesi Muhamet Bela i rikthen në debat hipotezat e autorëve të ndryshme mbi origjinën krahinore të Skënderbeut, me titull: *“A ishte Skënderbeu nga Hasi?”*. Duke hedhur hipotezën se Skënderbeu është me origjinë nga Kastratët në Has, pikërisht fare pranë Drinit ku shtrihej fshati *Brrut*, autori, këmbëngulë të këtë dhënë një kontribut në këtë çështje mjaft të trajtuar edhe më herët nga autorë të ndryshëm.

Disa të dhëna me rëndësi, për fjalimin e fundit të Skënderbeut sipas Stefan Zanoviqit, na i sjellë studiuesi Jakup Krasniqi, i cili apelon që ky fjalim i shoqëruar me urti e dije, të shfrytëzohet edhe sot, për kohën tonë, në shekullin XXI. Sipas autorit, qëllimi është që vizioni historik i Skënderbeut t’ju shërbejë gjeneratave të shekullit tonë dhe shekujve në vazhdim.

Skënderbeu i detyroi të gjitha kohërat të flisnin për të. Andaj, veprimtaria kombëtare e radhiti atë në grupin e figurave më emblematike, si shëmbëlltyrë e udhëheqjes luftarake, sakrificës e përpjekjeve për pavarësi politike dhe bashkim të të gjitha viseve shqiptare në një shtet kombëtar. Prandaj, vepra e tij patriotike ka inspiruar breza të tërë, u thurën këngë në popull, u emëruan sheshe, rrugë, shkolla, dhe u ngritën buste. Ai u bë frymëzim edhe në artin letrar, muzikor dhe në atë pamor. Në këtë rrjedhë, janë shkruar edhe studime mbi vendin dhe rëndësinë e tij në letërsinë botërore, por një sintezë gjithëpërfshirëse të këtyre veprave ende nuk e kemi as në letërsinë shqipe as në letërsinë e përbotshme. Studiuesit Myrvete Dreshaj-Baliu dhe Begzad Baliu, na prezantojnë tipologjinë e pamjes fizike dhe karakterin luftarak të Skënderbeut, të përbërësve etno-psikologjikë e etikë të imazhit të tij, të ndërtuara në shkrimet e përbotshme letrare e artistike, qofshin ato prozaike, poetike apo dramatike, si të poetëve: Pal

Jovi, Jacques de Lavardin, Pierre de Ronsard, Edmund Spenser, Henry Wadsworth Longfellow, Margarita Sarroti etj.; të romansierëve: Antonio Posenti, Xheims M. Ludllou, Benjamin Disrael etj.; si dhe të dramaturgëve: Lope De Vega, Tomas Uinkop, Mauricio Gerardin etj.

Në lidhje me idetë për mbrojtje të përbashkët kundër pushtuesve osmanë, studiuesja Mirie Rushani në studimin me titull: *“Gjeografia politike e Evropës në shek. XV dhe ideja për mbrojtje të përbashkët në luftën kundër invazionit turk”*, në të cilin trajton ndërmarrjet e përbashkëta kundër sundimit osman. Sipas saj, këto ide mund t’i gjejmë të artikuluar në forma të ndryshme, qysh prej mesjetës e deri më sot. Këto ide, të cilat filluan të materializohen si pasojë e invazionit osman, do të ngriten edhe në projekte panevropiane gjatë kohës së Skënderbeut.

Gjon BERISHA

KRIMI I DOKUMENTUAR NË DISA TRAJTA

**(Teuta Shala-Peli, *Krimet serbe në rajonin e Pejës mars-qershor 1999*,
Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2019, f.348)**

Teuta Shala-Peli, Doktor e shkencave historike, Bashkëpunëtore e lartë shkencore në Institutin e Historisë, autore e këtyre monografive: *Prof.dr. Sabile Keqmezi-Basha-Identiteti shkencor dhe krijues*, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, Prishtinë 2011; *Kontribute për Historinë*, “Brezi 81”, Prishtinë 2013; *Ditë e dhembjes krenare*, “Beqir Musliu”, Prishtinë 2014; *Drishti në Mesjetë*, Instituti i Historisë, Prishtinë 2016; *Days of the proud pain*, Instituti i Historisë, 2018; autore e dhjetëra shkrimeve profesionale në fushën e historisë, por edhe pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, vetëm sa po e plotëson dhe formëson gjithnjë e më shumë personalitetin e saj profesional dhe shkencor. Në vazhden e kësaj është edhe vepra e saj më e re, monografia e gjashtë me radhë, me titull “*Krimet serbe në rajonin e Pejës mars-qershor 1999*”.

Prof.assoc.dr. Teuta Shala-Peli, edhe pse e specializuar në periudhën e Mesjetës, ajo merret edhe me historinë bashkëkohore. Madje edhe me Luftën e Kosovës 1998-1999, për të cilën ka zgjedhur të shkruajë. Të shkruajë për krimet e Serbisë, për krimet serbo-malaziasë ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, me theks të veçantë për krimet e kryera në rajonin e Pejës. Dhe për krimet e kryera në këtë rajon ka përgatitur edhe një monografi goxha voluminoze.

Vetëm të dëgjosh rrëfime për luftën në radio, të shikosh në televizion apo të lexosh nëpër gazeta, revista a libra të ndryshëm është vështirë e përbalueshme në aspektin emocional, e lëre më t’i vësh veti detyrë që ato rrëfime t’i shkruash, t’i grumbullosh, t’i sistemosh e t’i përmbledhësh në një libër. Aq sa është e vështirë t’i përballosh emocionalisht, po aq e zorshme, po aq e vështirë është t’i trajtosh ato në rrafshin profesional. Përgjegjësia shtohet edhe më tepër kur synon që krimet

e ndodhura t'i argumentosh, t'i faktosh, t'i përmbledhësh në një libër dhe t'i botosh. Teuta Shala-Peli, ka kaluar nëpër situata, nëpër sfida të tilla. Dhe pavarësisht emocioneve, vështirësive të natyrave të ndryshme, ajo ia ka dalë të na e sjell një monografi për krimet serbe ndaj shqiptarëve në një rajon të caktuar, në rajonin e Pejës, në një periudhë 3-4 mujore të vitit 1999.

Puna e vështirë, e lodhshme dhe profesionale që ka bërë studiuesja Teuta Shala, do vlerësohet për disa arsye. E para, ajo, me shumë përkushtim, për aq sa ka gjetur të dhëna, ka argumentuar krimet serbe në rajonin e Pejës. Dhe ka argumentuar këto krime monstruoze në disa trajta. E dyta, me këtë ka kryer një obligim moral, profesional, human e kombëtar. E treta, ka sjellë dëshmi konkrete për krimet dhe gjenocidin e Serbisë në Kosovë. E katërta, autorja e ka bërë atë që ne të tjerët nuk e kemi bërë. Nuk e kanë bërë as institucionet. Sepse, një punë e tillë e bërë nga kjo historiane i flet historisë, dëshmon të vërtetën, dëshmon para historisë dhe organeve të drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare që deri sot vetëm e kemi folur, por nuk kemi faktuar sa duhet e si duhet, ani se kemi mjaft argumente, fakte, dëshmi e dëshmitarë të gjallë në kujtesën e të cilëve ende ruhen të freskëta ato përjetime, rrëfime, dhimbje e tragjedi.

Në fakt, kjo studiuese, me anë të kësaj monografie, i flet edhe të ardhmes sonë. Ajo është shumë konkrete, ajo ka hulumtuar, grumbulluar, sistemuar, analizuar, pastaj i ka qitur në letër dhe i ka përmbledhur në këtë monografi. Në fund edhe e ka përgatitur për botim në Institutin e Historisë. Kësisoj ajo na ofron të dhëna konkrete, relevante për krimet që kanë ndodhur, vendin ku ka ndodhur, kohën kur ka ndodhur, kush janë kryerësit e krimeve dhe kush viktimat. Ajo e dëshmon me fakte dhe argumente se çfarë krimesh kanë ndodhur në rajonin e Pejës në periudhën kohore mars-qershor 1999. Se ato krime janë kryer nga kriminelë serbo-malazez kundër shqiptarëve të pafajshëm. Tipat dhe llojet e krimeve janë: plagosje, vrasje, masakra kundër individëve, familjeve dhe një pjese të popullatës shqiptare, bile edhe deportim i dhunshëm. Pra, për të qenë edhe më konkret, autorja sjell të dhëna konkrete, me emër e mbiemër se cilët individë kanë pësuar, cilat familje, cila etni, çfarë moshe e gjinie janë. Cilët kanë pësuar dhe nga kush kanë pësuar.

Ideja për ta bërë këtë libër është e qëlluar. Ashtu siç është e qëlluar edhe tema që ka zgjedhur ta trajtojë autorja. Sistemimi dhe strukturimi i lëndës është bërë ashtu siç e ka konceptuar autorja, ashtu siç ajo ka menduar se është më mirë. Referencat vijnë nga shumë anë. Struktura e librit përbëhet nga kapituj, nënkapituj dhe njësi më të vogla: nga grafikone, skica, tabela, fotografi, faksimile etj., nga parathënia, hyrja, përfundimi,

konkluzionet, burimet dhe literatura, indeksi i emrave etj. Pra, për krimet këtu mund të lexohen në qindra faqe tekst, një mori të dhënash statistikore të paraqitura në dhjetëra grafikone, por edhe shikohen me sy në disa fotografi. Tipat dhe llojet e ndryshme të krimeve janë paraqitur sipas renditje kronologjike (ditë, javë, muaj). Llojet e krimeve janë të ndryshme. Edhe format dhe mënyrat se si janë kryer krimet janë të ndryshme, janë të shumta. Nga kjo shumëllojshmëri krimesh dhimbja është e madhe dhe të shumta janë pasojat që u kanë shkaktuar kriminelët e një shteti kriminal (siç ishte Serbia) shqiptarëve të moshave të ndryshme, të gjinive të ndryshme. Largimet e dhunshme nga shtëpia e prona, keqtrajtimet, arrestimet, burgosjet, vrasjet, masakrimet deri edhe të zhdukja e trupave përbëjnë akte kriminale, krime makabre me të cilat kjo studiuese është marrë në këtë monografi.

Përveç rrëfimeve dhe përshkrimeve të gjalla, paraqitur në formë kronologjike e të trajtuara në aspektin tematik, autorja, në një kapitull të veçantë ka dhënë edhe biografite e shkurtra të atyre që janë vrarë a zhdukur, por edhe lista emërore të të vrarëve, të plagosurve dhe të të pagjeturve. Aty shihet se viktimat janë shqiptarët e pafajshëm që vijnë nga familje, lagje e fshatra të ndryshme të rajonit të Pejës. Janë moshash e gjinive të ndryshme. Sigurisht edhe nga shtresa të ndryshme, me përjetime e profesione të ndryshme, por me një ëndërr të përbashkët: të jetonin të lirë në atdheun e vet. Fatkeqësisht ëndrra e tyre u pre në mes, sepse ata u vranë e u masakruan në mënyrë mizore, por edhe u zhdukën pa gjurmë, vetëm e vetëm se dëshironin të ishin të lirë, vetëm e vetëm se ishin shqiptarë, të cilët nuk dëshironin që më asnjë çmim t'i lëshonin shtëpitë dhe pronat e veta, vendin e vet. Edhe pse ata i priste keqtrajtimi err e terr, i priste arrestimi, burgosja, madje edhe pushkatimi e masakrimi, qëndruan deri në vdekje në shtëpitë në vatrën e tyre pavarësisht se kjo u kushtojë me jetë. Një nënë, një grua, një studiuese e historisë, siç është Teuta Shala-Peli, nuk qëndrojë duarkryq, por i hyri punës që t'i dokumentoi këto krime. Dhe dëshmi e mirë, dokument me vlerë që na flet, që na dëshmon është kjo monografi.

Monografia "*Krimet serbe në rajonin e Pejës mars-qershor 1999*" e Prof.assoc.dr. Teuta Shala-Peli, është një dëshmi tronditës për atë që ka ndodhur në Kosovë, për krimet që kanë bërë serbo-malaziasit dhe Serbia ndaj shqiptarëve duarthatë. Kjo është një monografi që sjell të dhëna, fakte, argumente, dëshmi për një kohë e për një periudhë të hidhur nëpër të cilën ka kaluar Kosova dhe shqiptarët, me theks të veçantë rajoni i Pejës që është temë trajtimi. Kjo monografi duhet pasuar nga monografi të tjera, nga autorë e studiues të tjerë.

Vetëm kështu mund të dëshmojmë, faktojmë dhe argumentojmë të vërtetën historike për Luftën e Kosovës të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila iu kundërvu me të gjitha forcat Serbisë për krimet monstruoze që po i bënte ndaj popullatës civile të pafajshme.

Miftar KURTI

SHTYPI SHQIPTAR NË MAQEDONI (1945-1991)

(Sevdail Demiri, *Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor dhe arsimor*, Shkup, 2015, f. 245).

Autori i këtij libri është punonjës shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Monografia në fjalë u mbrojt fillimisht si tezë doktorate në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup më 2013, nën udhëheqjen shkencore të prof. dr. Katerina Todorovskës.

Autori këtë libër e ka ndarë në hyrje, dhe tre kapituj të veçantë, të cilët merren me problematikën e trajtuar. Që në hyrje të monografisë trajtohet zhvillimi i shtypit shqiptar nga viti 1848 deri më 1945. Duke bërë një sintezë të përgjithshme të arritjeve të shtypit shqiptar, autori me të drejtë këtë periudhë e quan një rilindje në fushëveprimtarinë publicistike, por edhe shkencore të shqiptarëve. Kurse copëza të rëndësishme ndeshim edhe në kapitullin e parë, ku preket një problematikë rreth rrethanave politike të shqiptarëve në Republikën Socialiste të Maqedonisë pas Luftës së Dytë Botërore. Me anë të burimeve arkivore të vjela në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë, autori evidencon edhe ngritjen kulturo-arsimore të shqiptarëve në këtë shtet. Sipas autorit, numri i shkollave vinte e shtoej nga viti në vit, por edhe ngritja e infrastrukturës në fushën kulturore, e cila sipas tij, filloi të shënoj ngritje të ndjeshme pasi u themeluan edhe teatro të ndryshëm etj. Boshti kryesor i librit për autorin është, shtjellimi i veprimtarisë së shtypit shqiptar në Republikën Socialiste të Maqedonisë, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas studiuesit Demiri, rrethanat e favorshme për zhvillimin e këtij shtypi u krijuan në prill të vitit 1945, kur u themelua gazeta “Flaka e vëllazërimit”, organ që la gjurmë në historinë e gazetarisë shqiptare. Drejtor dhe kryeredaktor i parë i gazetës “Flaka e vëllazërimit” (viti 1945), ishte Petro Janura, kurse më pas (deri më 1991) gazeta u udhëhoq nga kryeredaktorët: Murteza Peza, Resul Shaqiri, Lutfi Rusi,

Sefedin Sulejmani, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, Fejzi Bojku. “Flaka e Vëllazërimit” ishte kroniste korrekte e kohës, e cila ka regjistruar gati se të gjitha ndodhitë e problemet në RSFJ, respektivisht RSM, me theks të veçantë te shqiptarët.

Rubrika kulturore-arsimor e gazetës “Flaka e vëllazërimit”, ishte në një nivel të lartë profesional e artistik, për të cilën shkruan gazetarë e shkrimtarë të njohur, profesorë e intelektualë, siç ishin: Petro Janura, Murteza Peza, Lutfi Rusi, Ali Aliu, Luan Starova, Ramiz Kelmendi, Adem Gajtani, Rexhep Zllatku, Teki Dervishi, Fejzi Bojku, Shkëlzen Halimi etj. Autori na tregon përmes faktografisë se “Flaka e vëllazërimit” i dha hapësirë të rëndësishme edhe ngjarjeve të rëndësishme nga fushat kulturore, arsimore dhe shkencore. Në faqet e gazetës, autori veçon ngjarje me peshë që u pasqyruan si: simpoziumin “500-vjetori i Skënderbeut” mbajtur në Prishtinë më 1968; “Konsulta gjuhësore”, mbajtur në Prishtinë më 1968; “Themelimi i Universitetit të Prishtinës”, më 1970; “Kongresi i Drejtshkrimit”, mbajtur në Tiranë më 1972; “Themelimi i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Shkup”, më 1974” etj. Në faqet e kësaj gazete shkruan pena të njohura nga e gjithë Jugosllavia. Rëndësi tjetër Sevdail Demiri në këtë monografi, i jep edhe revistës “Jehona” që filloi së botuari nga viti 1962, si revistë për art, shkencë dhe çështje kulturore.

Revista kishte Kolegjiun e Redaksisë që udhëhiqej nga kryeredaktori, si dhe Këshillin Botues që udhëhiqej nga kryetari i Këshillit. Kryeredaktor i parë i revistës “Jehona”, i cili thirrej drejtor përgjegjës, ishte Murteza Peza, ndërsa më pas revista u udhëhoq nga: Xhevat Gega, Sejfedin Sulejmani, Rexhep Zllatku dhe në fund Kim Mehmeti. Në Kolegjiun e Redaksisë ndër vite bënë pjesë këta emra të njohur të gazetarisë, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare. Po radhisim emrat e Redaksisë së periudhës së parë të revistës: Azem Zylfiqari, Murat Isaku, Tomo Buklevski-Maquli, Hamit Thaqi, Xhevat Gega, Mateja Matevski, Mahmud Hysa, Qamuran Tahiri, Jakim Sinadinovski, Fehmi Muça dhe Murteza Peza. Jehona në faqet e veta, prej numri në numër u rrit dhe la gjurmë të thella në afirmimin e ideve përparimtare, dhe ndikoi drejtpërdrejt në formimin e opinionit kulturor e shkencor në këtë nënqiell tonin. Jehona i dha ndihmesë të konsiderueshme afirmimit dhe rritës së penave të reja krijuese, që sot zënë vend të merituar në letërsinë tonë. Jehona ishte nismëtare dhe nxitëse e çështjeve që kanë të bëjnë me kulturën, me shkencën dhe me letërsinë në përgjithësi. Në këtë revistë, shkruan pena të ndryshme, si: Blazhe Koneski, Luan Starova, Petro Janura, Sejfedin Sulejmani, Skënder Rizaj, Shukri Rahimi, Masar Kodra etj. Kjo revistë, sipas autorit, mbeti revista më elitare

për shqiptarët në Republikën e Maqedonisë. Vend me rëndësi në faqet e këtij libri ndeshim edhe mbi revistat për fëmijë “Gëzimi” respektivisht “Fatosi”.

Në vitin 1950, filloi botimin revista për fëmijë “Gazeta e pionierëve”, e cila një vit më vonë u quajt “Gëzimi”, dhe këtë emër do ta bartë deri në fund. “Gëzimi” ishte revista kryesore, e cila shërbente si literaturë ndihmëse në të gjitha shkollat me mësim në gjuhën shqipe, jo vetëm se në Maqedoni, ku kishte më së shumti shtrirje dhe lexues, por edhe në Kosovë, në Serbi, në Mal të Zi etj. Në fillim botohej në kuadër të redaksisë së “Detska radost” në Shkup, ndërsa më vonë nga njësia “Flaka e vëllazërimit”. Botohej një apo dy herë në muaj gjatë vitit shkollor. Në këtë revistë u botuan qindra e mijëra krijime letrare e artistike për shkollarë, në një nivel të lartë artistik, andaj kur të shfletohet nga perspektiva e sotme, të lë të mendosh se bëhet fjalë për një antologji të vërtetë të letërsisë shkollore. Shumë nga ata nxënës (lexues), përkatësisht bashkëpunëtorë të “Gëzimit”, më vonë u bënë gazetarë të njohur, shkrimtarë e punëtorë shoqërorë. Pra, kjo revistë u bë një fushëveprimi, ku u përgatitën gjeneratat e ardhshme në profesionet e tyre të ndryshme. Drejtor i parë dhe kryeredaktor shumëvjeçar i revistës “Gëzimi”, ishte gazetari e shkrimtari i njohur, Mehmedali Hoxha, i ndihmuar gjithashtu nga gazetari dhe shkrimtari i njohur, Fejzi Bojku. Deri në mbylljen e saj në vitin 2004, kjo revistë u udhëhoq edhe nga Rexhep Zllatku, Resul Shabani, Naxhi Osmani, Shaip Emërllahu, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Islam Saliu, Ahmet Selmani e Lumturije Zajazi.

Në vitin 1955, paraqitet revista e dytë për shkollarë në gjuhën shqipe në Maqedoni, me emrin “Fatosi”. Edhe kjo revistë luajti rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit kulturor-arsimor të popullatës më të re shqiptare në Maqedoni. Botohej një apo dy herë në muaj, dhe dalëngadalë u bë revista më e lexuar shqipe për fëmijë në Maqedoni dhe jashtë saj. Revista “Fatosi”, në periudhën më të gjatë u udhëhoq dhe u redaktua gjithashtu nga gazetarët e shkrimtarët e dalluar për fëmijë, Mehmedali Hoxha dhe Fejzi Bojku. Pos tyre, si kryeredaktorë (deri në vitin 1999), figurojnë edhe: Lutfi Rusi, Sejfedin Sulejmani, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, Eshref Aliu, Abdylhadi Zylfiqari, Halil Zendeli, Selvie Qoku, dhe Luljeta Jusufi. Në revistën “Fatosi”, shkruanin gjithashtu pena të njohura të letrave shqipe, ndërsa shpeshherë linte përshtypjen se madje ishte më e hapur se “Gëzimi” në aspekt të bashkëpunimit me lexuesit e vegjël, të cilët rregullisht i botonin punimet e tyre amatoreske.

Marrë në përgjithësi, libri me titull “Shtypi shqiptar në Maqedoni 1945-1991, (aspekti kulturor-arsimor)”, paraqet një përpjekje serioze për të pasqyruar historikun e shtypit shqiptar në këto hapësira. Konkretisht, me këtë nënkuptojmë një përpjekje për zbardhjen e rrugës zhvillimore të gazetës “Flaka e vëllazërimit”, “Jehona” dhe revistave “Gëzimi”, “Fatosi”, të cilat për pesë dekada me radhë, ishin ndër shtyllat më të forta zhvillimore të proceseve kulturor-arsimore të shqiptarët e Maqedonisë.

Në fund mund të konstatojmë se libri i dr. Sevdail Demirit, është një kontribut me vlerë në historiografinë shqiptare. Kjo monografi i hap rrugë studiuesve të tjerë që të merren më thellësisht me aspekte të ndryshme të shtypit shqiptar jo vetëm në Republikën Socialiste të Maqedonisë, por edhe në tërë territorin e Jugosllavisë gjatë periudhës 1945-1991.

Kosovar BASHA

AKTIVITETE

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË GJATË VITIT 2019

I. Aktivitetet shkencore

Bazuar në Planin e punës për vitin 2019, Instituti i Historisë ka organizuar disa konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, përmes së cilave është synuar që të arrihen rezultate dhe njohuri të reja në fushën e historiografisë shqiptare dhe më gjerë. Gjatë këtij viti janë organizuar tri konferenca shkencore me tematika dhe për periudha të ndryshme historike:

Konferenca shkencore:

a) “Kosova-rruga drejt lirisë”

Më 11 qershor të vitit 2019, më rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe 20-vjetorit të ndërhyrjes së forcave të NATO-s, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Tiranë, dhe Institutin për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, organizuan Konferencën shkencore ndërkombëtare: “Kosova - rruga drejt lirisë”, në të cilën morën pjesë studiues nga vende të ndryshme të rajonit, përveç atyre shqiptarë. Punimet e Konferencës u zhvilluan në dy seanca, rezultatet e së cilës do të botohen më 2020.

b) “Shqiptarët dhe ndërkombëtarë në vitet 1912-1926”

Instituti i Historisë-Tiranë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, organizuan këtë Konferencë, punimet e së cilës u mbajtën, më 25 tetor 2019, në Tiranë. Në këtë Konferencë nga studiuesit e Institutit të Historisë-Prishtinë, u prezantuan dy kumtesa: Ardita Hajdari-Buqinca, “Shtypi francez për veprimtarinë e Hasan

Prishtinës, 1912” dhe Fitim Rifati, “Kosova në sfondin e marrëdhënieve austro-hungareze e bullgare, 1915-1918”.

c) *“Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore”*

Akademia e Shkencave-Tiranë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve e Kosovë, Institutin e Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, Institutin e Historisë Tiranë dhe Institutin për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, organizuan më 14-15 nëntor 2019, në Tiranë, këtë konferencë shkencore ndërkombëtare. Konferenca u organizua me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Përveç studiuesve nga Tirana dhe atyre ndërkombëtarë, nga Prishtina me kumtesa morën pjesë këta studiues: Sabit Syla, “Kosova ndërmjet Fuqive të Boshtit dhe Aleatëve të Mëdhenj perëndimorë”; Muhamet Shatri, “Tiparet fashiste që demonstroi antifashizmi serb dhe qëndrimi ndaj popullsisë shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore”; Hakif Bajrami, “Rëndësia e KNÇ-së së Kosovës për përhapjen e antifashizmit te shqiptarët”; dhe Bejtullah Destani, “Balli Kombëtar në dokumentet britanike”.

II. Veprimtaria botuese

Në kuadër të veprimtarisë botuese, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, gjatë vitit 2019, nxori këto botime:

1. *Revista shkencore “Kosova”, nr. 44 (2019)* Revista shkencore “Kosova”, organ vjetor i Instituti të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, me një traditë më shumë se dyzetvjeçare, me një redaksi të zgjedhur, të përbërë nga ekspert të të gjitha periudhave historike, çdo vit e më shumë ka ardhur duke e rritur cilësinë e studimeve të botuara. Në këtë numër (nr. 44) të organizuar në artikuj, kumtesa e konferenca, materiale dhe recensione, brenda vitit 2019 ka arritur të mbledhë, përzgjedhë, redaktojë dhe botojë studime, kumtesa e materiale të larmishme nga fusha e historisë kombëtare dhe jo vetëm. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë rezultate të reja, frytë i punës dhe kërkimeve arkivore të studiuesve. Tematikat e trajtuara në kuadër të artikujve shkencorë fillojnë me periudhën mesjetare, përkatësisht me trajtimin e fenomenit të prikës dhe dhuratave që bënin familjet arbërore me rastin e martesës gjatë shek. XIV-XV, për të vazhduar me artikuj të periudhës osmane që si fokus kanë burimet ekonomike të sanxhakut të Prizrenit gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI, si dhe veçimi i disa rasteve të marrëdhënieve shqiptaro-malazeze në shek. XVII. Një rëndësi i është kushtuar edhe së luftërave ballkanike dhe ngjarjeve të viteve ‘20 dhe ‘30 të shek. XX.

Në kuadër të artikujve nga historia bashkëkohore në trajtim janë marrë edhe tematika që kanë të bëjnë me jetën arsimore dhe ekonomike të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, për të arritur deri të lufta e fundit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këtë numër e begatojnë edhe kumtesat, materialet, dokumentet dhe recensionet.

2. *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes (Përmbledhje studimesh).*

Kjo përmbledhje studimesh, përmban materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes”, organizuar në Prishtinë, më 16 tetor 2018, nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë. Libri në fjalë ofron rezultate të reja jo vetëm për jetën dhe veprën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por edhe për kohën në të cilën jetoi dhe veprimet e tij. Në këtë përmbledhje studimesh, personaliteti i Skënderbeut, gjen trajtim nga aspekte dhe fusha të ndryshme: si nga fusha e historisë politike e ushtarake, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të arkeologjisë, rolit dhe funksionit të Skënderbeut si burrë shteti dhe udhëheqës ushtarak në planin shqiptar e ndërkombëtar, rolin e tij në Betejën e Dytë të Kosovës, për të vazhduar me tema mbi vendin që zë figura dhe epoka e Skënderbeut në historiografinë kombëtare dhe në atë ndërkombëtare, trajtimet e ndryshme letrare në letërsinë shqipe dhe në atë botërore, në publicistikë e në vepra artistike.

3. *Jasharajt dhe lufta çlirimtare (Përmbledhje studimesh).*

Kjo përmbledhje me studime përmban materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, organizuar në Prishtinë, më 6 mars 2018, me rastin e 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë përmbledhje, trajtohen aspektet humane, kombëtare, politike, ushtarake e diplomatike të luftës çlirimtare e të simbolit të saj Adem Jashari. Ofrohen të dhëna dhe rezultate të reja shkencore për familjen e Jasharajve dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shumë dimensionet e saj: Kontributi i Jasharajve në luftën çlirimtare të Kosovës 1991-1999; qëndresa epike e grave të familjes Jashari gjatë vitit 1998; pasqyrimi i sakrificës së Jasharajve në shtypin shqiptar dhe atë ndërkombëtar; qëndrimi i diplomacisë dhe i shtetit shqiptar ndaj luftës çlirimtare në Kosovë; lufta e Kosovës në kancelaritë ndërkombëtare; procesi i legjitimitetit të saj dhe i ndërhyrjes së NATO-s; ndihma e ushtrisë shqiptare për përgatitjen e UÇK-së; evoluimi i qëndrimit të partive politike në Shqipëri ndaj luftës në Kosovë dhe ndikimi i ngjarjeve të vitit 1998 në veprimtarinë e tyre, etj.

4. *Fitim Rifati, Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918.*

Monografia trajton ngjarje, personalitete dhe fenomene shumëdimensionale politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore-arsimore, që e kanë karakterizuar Kosovën gjatë Luftës së Parë Botërore. Në këtë monografi paraqitet një skemë e përgjithshme e Kosovës nën sundimin e Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi, gjatë viteve 1912-1914; shpaloset situata ndërkombëtare në fillim të Luftës së Parë Botërore, qëndrimi i shqiptarëve të Kosovës ndaj saj; mobilizimi i dhunshëm në radhët e ushtrisë serbo-malazeze dhe veprimet e armatosura të shqiptarëve për çlirim; parashtrohen të dhëna mbi tërheqjen serbo-malazeze nga Kosova; pushtimet bullgare e austro-hungareze dhe ndarja e Kosovës në dy zona okupimi dhe administrimi; shtjellohet gjendja dhe pozita e Kosovës në zonën austro-hungareze, sikurse ngërthehet një tablo të njëjtë e Kosovës në zonën bullgare, gjatë viteve 1915-1918, si dhe trajtohet tërheqja nga Kosova e administratës dhe trupave ushtarake bullgare e austro-hungareze dhe ripushtimi serb, në shtator-tetor 1918. Të gjitha çështjet e ngritura në këtë monografi e vënë Kosovën në fokus të veçantë, për territorin e së cilës u përplasën posaçërisht shqiptarët, serbët, malazezët, bullgarët, austro-hungarezët, osmanët etj.

5. Sabit Sylja, *Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare 1998-1999 (Batalioni V "Rexhep Musa")*.

Monografia trajton luftën dhe qëndresën, traditën e saj historike, kulturore shaljane nga periudhat më të hershme historike deri te lufta e UÇK-së. Bazuar në burime dhe literaturën relevante, veçanërisht në burime arkivore të Arkivit të Batalionit IV, të Brigadës 141 "Mehë Uka", të Zonës Operative të Shalës, janë trajtuar shumë çështje që kanë të bëjnë me këtë luftë, posaçërisht me Batalionin IV "Rexhep Musa", veprimtaria e të cilit është një shembull më i mirë se në çfarë kohe dhe rrethana ka dalë në skenë UÇK-ja në këtë rajon; se si është organizuar lufta çlirimtare në Shalën e Bajgorës; se si ka funksionuar Batalioni; cila ka qenë zona e përgjegjësisë, struktura e tij organizative; cilat janë disa nga betejat kryesore dhe veprimet tjera luftarake në zonën e tij të përgjegjësisë. Batalioni IV "Rexhep Musa", si njësi vartëse e Brigadës 141 "Mehë Uka", siç del në këtë monografi, ka qenë mjaft i organizuar. Ai është i strukturuar në njësi më të vogla: kompani, togje dhe skuadra. Ka funksionuar tamam si një njësi e mirëfilltë ushtarake. Kishte një kuadër profesional të nivelit të lakmueshëm, të cilët kanë organizuar stërvitje të nevojshme aq sa ishte e mundur në kohë e rrethana të luftës. Kishte logjistikë të organizuar mirë, e bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me popullatën civile dhe me subjekte të tjera politike dhe jopolitike që funksiononin aso kohe. Se është kështu, dëshmia më e mirë është Arkivi i

pasur i këtij Batalioni, i ruajtur me shumë kujdes dhe pedanteri, i cili është pjesë e kësaj monografie.

6. Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës (Marsqershor 1999)*.

Objekt studimi i këtij libri janë krimet e forcave serbe në rajonin e Pejës respektivisht në Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan dhe Kliçinë, gjatë muajve: mars, prill, maj dhe qershor të vitit 1999, duke përfshirë vrasjet e popullsisë civile shqiptare, si dhe format e tjera të dhunës të përdorura nga forcat serbe nga fundi i marsit 1999, përkatësisht nga 25 marsi e deri më 14 qershor 1999.

7. Jakup Krasniqi, *Ballafaqime historike për çlirim e bashkim kombëtar*.

Libri është një përmbledhje botimesh, artikujsh shkencorë, studimesh e refleksionesh historike për historinë e kombit shqiptar. Trajton disa ngjarje e piketa të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, me një tematikë të gjerë, duke filluar nga krijimi i shtetit të parë shqiptar nën Gjergj Kastrioti-Skënderbeun, krijimin e shtetit modern shqiptar më 1920, Kosovën para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, për të ardhur kësaj në epopenë e ndritur të UÇK-së dhe luftën për pavarësi. Përmes këtij publikimi, kërkohet për të bërë një autopsy të historisë së kombit shqiptar, për të zgjidhur një nga problemet e trajtimit të historisë, atë të politizimit, personalizimit dhe dështimit të institucioneve përkatëse në shkrimin e kësaj historie. Për rishikimin e historisë nuk mjafton vetëm diskutimi, apo vënia në dyshim e gjithçka është shkruar deri tani, sepse shkenca e historisë nuk është dogmë dhe duhet të zhvillohet përditë, të evoluojë dhe të bëhet revolucionare, sa herë ka nevojë dhe sidomos kur bëhen zbulime të mëdha.

8. Frashër Demaj, *Shqiptarët në dokumentet diplomatike të Britanisë së Madhe 1911-1912 (Dokumente)*.

Ky botim është përmbledhje e dokumenteve nga The National Archives (TNA) në Londër. Këto dokumente, kryesisht, përfshijnë ngjarjet, rrethanat dhe qëndrimet e diplomacisë angleze ndaj çështjes shqiptare të viteve 1911-1912. Në këtë botim ka korrespondenca diplomatike, akte, njoftime, qëndrime, ngjarje, telegrame, protesta, raporte, memorandume, nota, statistika, traktate politike etj. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre dokumenteve në kohën e dërgimit nga nënkonsullatat, konsullatat, ambasadat dhe Ministria e Punëve të Jashtme, janë konfidenciale dhe deri në vitin 1967 kanë qenë “closed” (të mbyllura) në pamundësi shfrytëzimi nga studiuesit dhe të interesuarit tjerë. Lënda arkivore është përgatitur dhe publikuar mbi bazë kronologjike.

9. Sabit Syla, Jakup Krasniqi dhe Nuri Bexheti, *Kosova në arkivat e shtetit shqiptar 1950-1969 (Dokumente)*.

Botimi është përmbledhje e dokumenteve nga arkivat e shtetit shqiptar që përfshinë periudhën dhjetëvjeçare 1950-1969, të cilat ofrojnë të dhëna të vlefshme për shumë çështje, si: terrorin dhe persekutimet mbi shqiptarët; presionin për të ndërruar nënshtetësinë; emigrimin dhe shpërndarjen e tyre në Turqi; zhvillimet ekonomike, shoqërore, kulturore-arsimore e shëndetësore; qëndrimin e organeve jugosllave karshi shqiptarëve e pjesëmarrjen e tyre në organet e pushtetit lokal, krahinor dhe qendror në Jugosllavi; njoftimet statistikore të regjistrimeve të popullsisë; veprimtarinë e UDB-së; ligjin kushtetues të Kosovës e mbledhjet e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës; përpjekjet për përdorimin e flamurit kombëtar; gjendjen politike etj. Për më tepër, dokumentacioni hedhë dritë edhe mbi qëndrimin e shtetit shqiptar në raport me çështjen e Kosovës në vitet '50 dhe '60 të shek. XX!

10. Sabit Syla, *Dokumente diplomatike të Qeverisë shqiptare për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*.

Në këtë vëllim janë të përmbledhura: udhëzime, informacione, promemorie, relacione, analiza, komente, skedë e raporte të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Brendshme, si dhe një sërë informacionesh tjera ushtarake nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për ngjarjet historike të vitit 1981 në Kosovë. Dokumentacioni në këtë vëllim pasqyron dy tendenca qartësisht të dallueshme, atë të SHBA-së dhe vendeve perëndimore nga njëra anë dhe atë të vendeve të ish-Bllokut Komunist, të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik nga ana tjetër. SHBA dhe vendet perëndimore, pavarësisht nga qasjet dhe diferencat ndërmjet tyre, dëshmuar se gjykimet e tyre ndaj kërkesave të demonstruesve shqiptarë të Kosovës së vitit 1981 dhe shkaqeve të shpërthimit të tyre, ishin më afër realitetit. Përkundrazi, vendet e Bllokut Komunist në rastin më të mirë heshtën, ose mbështetën Jugosllavinë, sikurse vepruan Kina, Vietnami, Koreja e Veriut etj. Qëndrim projugosllav do të mbanin përgjithësisht edhe vendet e "paangazhuara" të Afrikës, Amerikës Qendrore dhe të Amerikës Latine. Dokumentacioni, dëshmon qartë se zhvillimet e Kosovës të Pranverës së vitit 1981, u gjykuan dhe u komentuan nga këndvështrime të ndryshme, duke pasur në konsideratë kulturat e ndryshme politike e shkencore, Luftën e Ftohtë, përplasjen e klaneve nacionaliste brenda Jugosllavisë, por edhe të drejtat kombëtare të popullit të shtypur të Kosovës.

11. Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922-1941*.

Ky botim, përmban më shumë se 200 dokumente, të përzgjedhura nga koleksioni i materialeve arkivore, kryesisht të Arkivit të Jugosllavisë dhe pjesërisht të Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë dhe Arkivit të Qytetit të Shkupit. Shumica e dokumenteve janë të karakterit diplomatik, si: shkresa, telegrame, depesha, informata, analiza, korrespondenca midis përfaqësive diplomatike jugosllave në Stamboll e Ankara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd. Një numër i konsiderueshëm i dokumenteve i referohen përpjekjeve të autoriteteve politike e diplomatike shqiptare, qoftë për ta penguar procesin e shpërnguljes, e gjithashtu edhe për riatdhesimin e atyre të cilët ishin shpërngulur në Turqi.

III. Hulumtimet shkencore

Në kuadër të veprimtarisë kërkimore-shkencore, gjatë vitit 2019 punonjësit e Instituti të Historisë “Ali Hadri” dhe bashkëpunëtorët e tjerë në projektin “*Historia e Kosovës*”, kanë kryen kërkime shkencore hulumtuese në arkiva dhe biblioteka të vendeve të ndryshme, si në: *The National Archives at College Park, Maryland* dhe *National Archives in DC* and *The NYU Library in New York*, (nga Sabit Sylja); *Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit* dhe në *Arkivin e Ministrisë për Evropën dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë* (Sabit Sylja, Miftar Kurti, Fatmir Arifi); *National Archives at New York City* dhe *The New York Public Library* (Gjon Berisha); *Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut* (Bedri Muhadri); *Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë*, *Arkivi i Instituti të Historisë në Tiranë*, *Arkivi për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit* dhe *Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme - AMEPJ* (Haxhi Ademi, Skënder Lutfiu); *Arkivi i Instituti të Historisë në Tiranë* (Teuta Shala-Peli); *Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë* (Alban Dobruna); *OSA Archivum* në Budapest (Mrika Limani-Myrtaj); *Arkivi Osman (Başbakanlık Osmanlı Arşivi)* në Stamboll (Mead Osmani); *Arkivi Osman (BOA)* (Agron Islami); *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (Luan Tetaj); *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (Fitim Rifati); *Haus-, Hof- und Staatsarchiv* në Vjenë (Selver Islamaj); *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (Skënder Zhitia), etj.

IV. Projektet shkencore kolektive

Gjatë këtij viti është vazhduar puna në projektet kolektive dhe individuale. Përveç projektit “*Historia e Kosovës*”, në të cilin është

punuar në vazhdimësi, Instituti ka filluar së realizuari edhe projektin “*Gjenocidi serb në Kosovë 1998-1999*”.

Si zakonisht, gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe punë të tjera të natyrës së administrimit, menaxhimit, si dhe përfaqësimit sa më të denjë të Institutit të Historisë në raport me institucionet vendore e ndërkombëtare.

Sabit SYLA
Gjon BERISHA

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

KOSOVA

44/2019

U shtyp në shtypshkronjën:
NORD- Prishtinë

Prishtinë
2019